



**UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I DREJTËSISË**



**DISERTACION  
PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE  
“DOKTOR”**

**“ASPEKTET PROCEDURALE TË GJYKIMIT KUSHTETUES”**

**PUNOI  
ERIND MERKURI**

**UDHËHEQËSE SHKENCORE  
PROF.DR.AURELA ANASTASI  
(AKADEMIKE E ASOCIUAR)**

**Tiranë, 2015**

## PËRMBAJTJA

Mirënjohje.....	VI
Abstrakt.....	VII
Lista e Shkurtimeve.....	IX
Hyrje.....	X

### KREU I

#### DREJTËSIA KUSHTETUESE NË SHQIPËRI

Hyrje.....	1
1. Vështrim historik mbi kontrollin kushtetues në Shqipëri.....	1
2. Organizimi i Gjykatës Kushtetuese.....	7
2.1 Kriteret për emërimin e gjyqtarëve kushtetues.....	7
2.2 Rotacioni i anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.....	8
2.3 Pavarësia e Gjykatës Kushtetuese.....	10
2.4 Statusi i gjyqtarëve kushtetues.....	12
3. Burimet normative të procesit kushtetues.....	13
3.1 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.....	15
3.2. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.....	15
3.3. Legjislacioni i brendshëm.....	18
3.4. Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese.....	19
3.5. Rregullorja e Gjykatës Kushtetuese.....	22
Konkluzione.....	24

### KREU II

#### PARIMET DHE JURIDIKSIONI I GJYKATËS KUSHTETUESE

Hyrje.....	26
1. Parimet e gjykimit kushtetues.....	26
2. Juridiksioni i gjykatës kushtetuese dhe objekti i gjykimit kushtetues.....	34
2.1 Procesi i kontrollit të normës kushtetuese.....	34
2.2 Procesi i kontrollit të amendamentit kushtetues.....	37
2.3 Ligjet, si objekt i gjykimit kushtetues.....	43
2.4 Ometimi ligjor, si objekt i mundshëm në gjykimin kushtetues.....	46
2.5 Marrëveshjet ndërkombëtare.....	49
2.5.1 Marrëveshjet ndërkombëtare të paratifikuara.....	50
2.5.2 Kontrolli i ligjit ratifikues. A është i mundur kontrolli aposteriori i marrëveshjes ndërkombëtare?.....	53
2.5.3 Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara.....	54
2.6 Aktet normative të organeve qendrore.....	55
2.7 Aktet normative të organeve vendore.....	59



2.8 Aktet, veprimet dhe mosveprimet si shkak i lindjes së mosmarrëveshjes së kompetencave midis organeve qendrore.....	59
2.9 Aktet, veprimet dhe mosveprimet si shkak i lindjes së mosmarrëveshjes së kompetencave midis organeve qendrore dhe njësisve të qeverisjes vendore.....	64
2.10 Aktet për krijimin dhe veprimtaria e partive dhe organizatave me karakter politik.....	67
2.11 Vendimet e Kuvendit për statusin e Presidentit të Republikës, si objekt i gjykimit kushtetues.....	69
2.12 Vendimet e Kuvendit për shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese.....	74
2.13 Kërkesat për ndalimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë.....	74
2.14 Vendimet që kanë të bëjnë me mandatin e deputetëve.....	74
2.15 Çështjet e shtruara për referendum.....	77
2.16 Aktet gjyqësore, të arbitrazhit, administrative dhe veprimet apo mosveprimet e organeve të administrates publike.....	78
2.16.1 Aktet normative dhe procesi i rregullt ligjor substancial.....	84
2.17 Vendimet e Këshillit të Ministrave për shkarkimin apo shpërndarjen e organeve vendore të zgjedhura drejtëpërsëdrejti.....	91
Konkluzione.....	93

### KREU III

#### PJESËMARRËSIT NË GJYKIMIN KUSHTETUES

Hyrje.....	99
1. Kërkuesi.....	99
2. Subjektet e pakushtëzuar.....	100
3. Gjykatat.....	105
3.1 Gjykatat e zakonshme.....	105
3.2 Gjykatat e arbitrazhit.....	112
3.3 Organet <i>quasi</i> gjyqësore.....	114
3.4 Gjykata Kushtetuese.....	115
3.5 Gjykatat dhe kontrolli konvencional.....	122
4. Subjektet e kushtëzuara.....	127
5. Individët.....	133
6. Subjektet që mund të nisin një proces për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave....	146
7. Subjektet e tjera.....	160
7.1 Kuvendi.....	160
7.2 Këshilli i Ministrave.....	163
7.3 Kandidati i pavarur për deputet.....	164
8. Subjektet e interesuara.....	164
9. Përfaqësimi në gjykimin kushtetues.....	168
Konkluzione.....	169

## KREU IV AFATET, AKTET PROCEDURALE DHE PROVAT NË GJYKIMIN KUSHTETUES

Hyrje.....	172
1. Afatet procedurale.....	172
1.1 Natyra e afatit.....	173
1.2 Llojet e afateve.....	174
1.2.1 Afati 2 vjeçar për kërkesat e individëve për proces të rregullt ligjor.....	176
1.2.2 Afati 3 vjeçar për kundërshtimin e ligjeve dhe akteve normative nënligjore.....	180
1.2.3 Afati 6 mujor përzgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave.....	182
1.2.4 Kontrolli i zgjedhshmërisë së deputetëve.....	184
1.2.5 Afati i pacaktuar për të kontrolluar papajtueshmërinë e ushtrimit të funksioneve të deputetëve.....	184
1.2.6 Afati për verifikimin e zgjedhjes së deputetëve.....	184
1.2.7 Afati 60 ditor për shqyrtimin e kërkesave përmbajtjen e një referendum..	185
1.2.8 Afati 15 ditor për kundërshtimin e vendimit të këshillit të ministrave për shkakrimin apo shpërndarjen e organeve vendore të zgjedhura drejtëpërsëdrejti.....	185
1.2.9 Afati i pacaktuar për kontrollin <i>apriori</i> të marrëveshjeve ndërkombëtare.....	187
1.2.10 Mungesa e afatit për kontrollin e kushtetueshmërisë së partive dhe organizatave politike.....	187
1.3 Rivendosja në afat.....	188
2. Aktet procedurale.....	192
2.1 Kërkesa.....	196
2.2 Njoftimi.....	201
2.3 Procesverbali gjyqësor.....	204
2.4 Aktet e tjera procedurale (relacioni/mendimi/opinion).....	205
2.5 Vendimi gjyqësor.....	207
3. Provat në gjykimin kushtetues.....	209
3.1 Prova me ekspertë.....	210
3.2 Prova me dëshmitarë.....	214
3.3 Prova me dokumenta.....	217
Konkluzione.....	219

## KREU V GJYKIMI KUSHTETUES

Hyrje.....	222
1. Faza e parë – shqyrtimi paraprak.....	222
1.2 Gjykimi i çështjes nga Mbledhja e Gjyqtarëve.....	227
1.3 Natyra e vendimit të kalimit të çështjes për gjykim në seancën plenare dhe e vendimit për moskalim në seancë plenare.....	228
1.4 Procedurat e veçanta në fazën paraprake.....	232
2. Pezullimi në gjykimin kushtetues.....	234
3. Bashkimi dhe ndarja e çështjes.....	243

4. Gjykimi në seancë plenare.....	245
4.1 Gjykimi në seancë gojarisht.....	246
4.2 Gjykimi mbi bazë dokumentash.....	248
4.3 Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese.....	249
4.4 Interpretimi, plotësimi dhe korigjimi i vendimit.....	251
5. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese.....	252
5.1 Teknikat e interpretimit të Gjykatës Kushtetuese.....	256
5.2 Format dhe emërtimet e vendimeve që merr Gjykata Kushtetuese.....	261
5.3 Hyrja në fuqi e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.....	275
5.4 Efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.....	276
5.4.1 Efekti i gjëse së gjykuar.....	276
5.4.2 Efekti <i>erga omnes</i> .....	280
5.4.3 Efekti i forcës së ligjit.....	282
5.4.4 Efekti përfundimtar i vendimit.....	283
5.5 Fuqia e vendimeve gjyqësore.....	284
6. Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.....	292
Konkluzione.....	297

## KREU VI

### RAPORTI I GJYKATËS KUSHTETUESE ME GJYKATAT E TJERA NË NIVEL KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR

Hyrje.....	306
1. Raporti midis gjykimit kushtetues dhe gjykimit të zakonshëm në rastet e kërkesave për kontroll incidental.....	306
2. Akti nënligjor normativ midis juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit gjyqësor të zakonshëm.....	307
3. Raporti midis gjykimit kushtetues dhe gjykimit të zakonshëm administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencave.....	310
4. Raporti midis gjykimit kushtetues dhe gjykimit të zakonshëm për kontrollin e kushtetueshmërisë së krijimit dhe veprimtarisë së partive dhe organizatave politike.....	311
5. Raporti i Gjykatës Kushtetuese me Konventen Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore dhe me Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.....	313
6. Raporti i Gjykatës Kushtetuese me Gjykatën Evropiane të Drejtësisë dhe me legjislacionin e BE.....	319
6.1 Raporti i Gjykatës Kushtetuese me GJED.....	319
6.2 Kontrolli i legjislacionit të BE-së nga Gjykata Kushtetuese.....	323
Konkluzione.....	329
REKOMANDIME.....	334
BIBLOGRAFIA.....	342

## MIRËNJOHJE

Tema që unë kam përzgjedhur, “Aspekte procedurale të gjykimit kushtetues”, si objekt punimi, lidhet me dëshirën personale për t’u thelluar dhe analizuar procesin kushtetues në tërësinë e tij, si një nga mekanizmat më komplekse dhe gjithashtu më dinamike. Realizimi i tij ka kërkuar domosdoshmërisht një trajtim si nga ana teorike dhe doktrimore ashtu edhe nga ana praktike dhe jurisprudenciale. Arritja e këtij qëllimi nuk mundej që të realizohej pa ndihmën e shumë personave të cilët më kanë mbështetur në mënyrë të vazhdueshme për realizimin e këtij disertacioni.

Një falenderim i veçantë i takon udhëheqëses time Prof. Dr. Aurela ANASTASI për ndihmën, kontributin, orientimet, konsultimet, idetë si edhe referencat e duhura të së cilës më ndihmuan për realizimin e plotë të këtij punimi. Falenderoj gjithashtu edhe Prof.Dr.Evis ALIMEHMETI për konsultimet e vazhdueshme në lidhje me aspekte të veçanta të disertacionit.

Gjej rastin të falenderoj dhe miqtë e mi Shpëtim Beqiraj dhe Ajet Maksuti për sugjerimet dhe diskutimet e tyre praktike të cilat bënë të mundur pasurimin e metejshëm të punimit. Po kështu falenderoj koleget e mia, Doc.Adea Pirdeni, Doc.Fjorda Shqarri dhe Dr.Nadia Rusi për komentet dhe diskutimet e tyre të vyera që më ndihmuan në trajtimin e aspekteve të caktuara të procesit kushtetues.

Një mirënjohje të veçantë shpreh për familjen dhe të fejuarën time, Oljana Papa, që më kanë mirëkuptuar në çdo rast dhe më kanë mbështetur në përfundimin e plotë të këtij disertacioni.

## ABSTRAKT

Kushtetutat e reja dhe moderne, synojnë rregullimin e ushtrimit të pushtetit shtetëror, bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Pavarësisht se ky parim i rëndësishëm ndihmon në kontrollin e ndërsjelltë midis pushteteve, historia ka treguar se jo gjithmonë ka qenë efiçase si zgjidhje. Kështu në botë ka plot shembuj ku një shumicë parlamentare e ardhur në pushtet me metoda demokratike ka përdorur pushtetin e saj për të kontrolluar pushtetet e tjera të një vendi dhe cënimin e të drejtave dhe lirive themelore. Për këtë arsye hartuesit e kushtetutave, mbas luftës së dytë botërore, në vendet e Evropës perëndimore dhe mbas rënies së komunizmit, në vendet e Evropës lindore, kanë përcaktuar dhe rregulluar krijimin e Gjykatës Kushtetuese si një institucion në të cilin mund të kërkohet mbrojtja e sferës së kompetencave së organeve të tjera me natyrë kushtetuese si edhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Kjo mundësi, mund të realizohet vetëm duke përdorur rrugët procedurale nëpërmjet të cilave vihet në lëvizje Gjykata Kushtetuese. Qëllimi i këtij punimi është pikërisht analizimi i këtyre mekanizmave procedurale në lidhje me parimet e gjykimit kushtetues, juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, legjitimitimin e kërkesve, pozitën procedurale të palëve në proces, afatet procedurale dhe përllogaritjen e tyre, aktet procedurale dhe provat që mund të përdoren si edhe karakteristikat e tjera procedurale për secilin gjykim kushtetues. Njohja e mirë e këtyre parimeve dhe rregullave procedurale, ndihmon që kërkesat që i paraqiten Gjykatës Kushtetuese të kenë mundësi më të mëdha suksesi për pranimin e tyre në vend të mosshqyrtimit të tyre për shkak të mangësive procedurale.

**Fjalë kyçe:** *Gjykatë Kushtetuese, proces kushtetues, legjitimim, afate procedurale, akte procedurale, prova.*

## ABSTRACT

New and modern Constitutions, aim to regulate the exercise of state power, based on the principle of separation of powers and to the respect for human rights and fundamental freedoms. Despite the fact that this important principle helps to control the activity between different state institutions, the history has shown that this has not always been an efficient solution. So, the world is full of examples where a parliamentary majority, that have come to power through democratic processes, has used its power to control the others power of a country and had violated the human rights and fundamental freedoms. For this reason, the drafters of the constitution after the Second World War in Western Europe and after the fall of communism in Eastern European countries, have established and regulated the creation of the Constitutional Court as an institution which can defend the sphere of the competencies of other institutions with constitutional nature and the protection of human rights and fundamental freedoms.

This possibility can only be realized using procedural means, through which the Constitutional Court is put into motion. The purpose of this paper is, precisely, to analyze these procedural mechanisms with regard to the principles of the constitutional process, the jurisdictions, the admissibility of the applicants, the procedural position of the parties, the terms and their calculation, procedural acts and evidence that can be used, as well as, procedural characteristics for each constitutional process. A good knowledge of these principles and rules of

procedure, helps so that the requests presented to the Constitutional Court have higher chances to succeed and to be accepted instead of dismissing them because of procedural deficiencies.

**Keywords:** *Constitutional Court, the constitutional process, legitimacy, procedural terms, procedural acts, evidence.*

## SHKURTIME

LDKK – Ligji për dispozitat kryesore kushtetuese dhe ligjet e tjera kushtetuese plotësuese të saj.

LGJA – Ligji nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

GJEDNJ – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

GJED – Gjykata Evropiane e Drejtësisë

BE – Bashkimi Evropian

Rregullorja – “Rregullorja e brendshme mbi gjykimin kushtetues dhe funksionimin e administratës e Gjykatës Kushtetuese”, e miratuar me vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve. Hyrë në fuqi më datën 15.6.2009.

LGJK – Ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

KLSH – Kontrolli i Lartë i Shtetit.

K.C. – Kodi Civil.

K.P. – Kodi Penal.

K.Pr.C. – Kodi i Procedurës Civile.

K.Pr.P. – Kodi i Procedurës Penale.

K.Pr.A. – • Ligj, nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

KQZ – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

TFBE – Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian.



## HYRJE

Në çdo degë të së drejtës gjithmonë flasim për të drejtën materiale dhe të drejtë procedurale. Nga kjo ndarje nuk bën përjashtim edhe e drejta kushtetuese. Kështu kemi të bëjmë me të drejtën materiale kushtetuese, kur flasim për të drejtat dhe liritë themelore, si edhe organizimin e funksionimin e organeve kushtetuese. Nga ana tjetër, flasim për të drejtë procedurale kushtetuese kur kemi të bëjmë me parashikime të ligjit themelor që trajton procedurat me anë të të cilave veprojnë organet kushtetuese. Ndër këto procedura rëndësi paraqet procesi që ndjek Gjykata Kushtetuese. E përcaktuar nga Kushtetuta si organi që bën interpretimin përfundimtar dhe garantën e saj, procesi që ndjek kjo gjykatë paraqet një rëndësi të veçantë. Në fundit të fundit është nëpërmjet procesit kushtetues që garantohet mbrojtja e kushtetushmërisë dhe e parimeve të përcaktuara në aktin themelor të vendit.

Është fakt i njohur se drejtësia kushtetuese si nëndegë e së drejtës kushtetuese, dekadat e fundit ka marrë një zhvillim të madh. Kjo lidhet me përvojat e vendeve përëndimore e cila ka treguar se një Gjykatë Kushtetuese, e pavarur, kompetente dhe profesionale është një garanci efektive për, ruajtjen e demokracisë dhe të rendit kushtetues. Për këtë arsye edhe vendet e Evropës Lindore të cilat dolën nga regjimi komunist, zgjedhën sistemin e drejtësisë kushtetuese të centralizuar të tipit kelzenian. Në këtë drejtim, secili prej vendeve të Evropës lindore krijoi gjykatën e vetë kushtetuese. Krijimi i gjykatave domosdoshmërisht u shoqërua edhe me hartimin dhe përpunimin e normave me karakter procedural të cilat mundësonin vënien në lëvizje të këtij mekanizmi kushtetues. Ekzistenca e këtyre normave solli edhe detyrimin për njohjen e tyre nga shumë aktorë të fushës së drejtësisë, si vetë gjyqtarët kushtetues, gjyqtarët e zakonshëm, juristët e institucioneve dhe praktikantëve të pavarur të së drejtës. Për këtë arsye, analiza dhe thellimi në këtë fushë paraqet rëndësi të veçantë.

**Arsyet** e zgjedhjes së kësaj teme janë të shumta por që më kanë ngacmuar gjithmonë dëshirën për t'u thelluar më tej në këtë fushë. Së pari duhet theksuar se në përgjithësi ka një moskuptim për procesin kushtetues në tërësinë e tij. Kështu në përgjithësi studiuesit e së drejtës kushtetuese, për të nxjerrë kuptimin e një norme i referohen vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, e cila nëpërmjet një jurisprudence që po pasurohet çdo ditë i japin zgjidhje problemeve të shumta që lindin nga interpretimi i ligjit themelor. Por, vendimet e gjykatës që prezantohen gjithmonë janë vetëm sinteza, përfundimi i një procesi të gjatë dhe shpeshherë edhe të vështirë, vështirësi që rrjedh nga natyra e veçantë që ka gjykimi kushtetues në përgjithësi. Gjykata Kushtetuese është një institucion që ka karakter juridiksional, për rrjedhojë veprimtaria e saj rregullohet nga norma procedurale, që sistemojnë çdo aspekt të veprimtarisë vendimmarrëse të gjykatës. Për shkak të ngjashmërive që paraqet në plan të parë gjykimi kushtetues me gjykimin e zakonshëm që zhvillohet pranë gjykatave të pushtetit gjyqësor, shpeshherë ka një konfuzion midis zbatuesve të ligjit (për juristët e institucioneve, avokatët, gjyqtarët) sikur normat procedurale standarde janë normat kryesore të aplikueshme që rregullojnë veprimtarinë procedurale të Gjykatës Kushtetuese. Ky keqkuptim sjell si pasojë që shumica e çështjeve që paraqiten për gjykim pranë këtij institucioni, deklarohen të papranueshme pikërisht për shkaqe procedurale. Është e tepërt të themi që në këto raste mund të kemi cënime të të drejtave kushtetuese të individëve apo prishje

të balancave midis institucioneve, por për shkaqe procedurale këto shkelje dhe parregullsi nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese. Në fakt normat procedurale standarde të rregulluara në Kodet e Procedurave Administrative, Civile dhe Penale janë norma të cilat përdoren nga Gjykata Kushtetuese, por përdoren si norma plotësuese dhe jo si norma kryesore. Rregullimi procedural i veprimtarisë së Gjykatës Kushtetuese, ka një natyrë dhe fizionomi tjetër, e cila nuk është ende e kuptueshme nga masa e gjerë e punonjësve të drejtësisë. Arsyeja e dytë e e përzgjedhjes së kësaj teme është përvoja e re dhe e pakët të drejtësisë kushtetuese në vendin tonë. Në Shqipëri, megjithëse, pak vite më parë, u festua 100 vjetori i pavarësisë, drejtësia kushtetuese e mirëfilltë ka funksionuar vetëm 23 vitet e fundit të ekzistencës së saj, periudhë e cila nis me krijimin e Gjykatës Kushtetuese në vitin 1992<sup>1</sup>. Ky fakt ka sjellë si pasojë që jo vetëm prakticienët e së drejtës, por edhe vetë gjykatësit kushtetues të kishin probleme në kuptimin dhe zbatimin e normave procedurale kushtetuese, të paktën përsa i përket periudhës fillestare të fillimit të drejtësisë kushtetuese. Në këtë drejtim duket sikur ka kontribuar edhe mungesa për një kohë të gjatë e ligjit që do të rregullonte organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese. Së treti rendisim edhe mungesën për një kohë të gjatë të doktrinës që trajton këtë veprimtari procedurale. Ky boshllëk duket sikur po plotësohet vitet e fundit, sepse janë botuar disa artikuj, monografi apo tekste juridike të cilat duke trajtuar aspekte të ndryshme të veprimtarisë procedurale të Gjykatës Kushtetuese, po e mbushin gradualisht këtë vakum të shfaqur në doktrinë. Gjithsesi këto studime dhe publikime përgjithësisht trajtojnë aspekte të veçuara të procedurës kushtetuese dhe nuk e trajtojnë atë në mënyrë tërësore. Edhe në ato pak studime të cilat kanë trajtuar gjerësisht drejtësinë kushtetuese, rezulton se përsëri kanë lënë jashtë trajtimit aspekte të rëndësishme të procesit kushtetues. Së katërti në shumë pak studime bëhet krahasimi i vendimmarrjes së Gjykatës sonë Kushtetuese për aspekte procedurale, me vendimmarrjen e gjykatave të tjera homologe në Evropë. Njohja dhe përshtatja e kësaj jurisprudence të huaj është e nevojshme në kuadër të globalizimit të së drejtës kushtetuese, fenomen sipas së cilit, duke përdorur teknikën e interpretimit krahasues, gjykatat kushtetuese synojnë përafrimin e qëndrimeve për çështje të njëjta. Së fundmi, angazhimi im personal si pedagog i së drejtës kushtetuese më ka orientuar drejt një kërkimi të thelluar në fushën e procesit kushtetues, me synimin për të pasuruar doktrinën shqiptare me punime të reja në këtë fushë.

**Qëllimi kryesor** i këtij punimi është të japë një panoramë të plotë të elementeve procedurale të cilat venë në lëvizje sistemin e drejtësisë kushtetuese në vendin tonë. Për këtë arsye në përmbajtjen e këtij punimi gjejmë trajtim burimet normative, parimet e procesit, juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese, pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues, elementët e gjykimit kushtetues, gjykimi kushtetues në tërësinë e tij, sqarimi i raportit dhe i ndërthurjes së kompetencave midis Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave të zakonshme për gjykime të veçanta. Kështu, shqyrtimi i akteve nënligjore normative dhe zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencave përmendet nga legjislati ynë edhe si kompetencë e Gjykatës Kushtetuese ashtu

<sup>1</sup> Përgjashtëmishit forma të kontrollit kushtetues gjejmë gjatë periudhës së monarkisë (viti 1932) dhe gjatë periudhës së regjimit komunist (viti 1977), por këto kanë qenë raste të izoluara të cilat nuk kanë sjellë ndonjë zhvillim të madh në këtë drejtim.

edhe e gjykatave administrative. Një tjetër ndërthurje kompetencash kemi edhe në gjykimin e partive politike në rast të veprimtarive antikushtetuese të tyre, e cila përveçse është pjesë e juridiksionit kushtetues, është edhe vepër penale, sipas dispozitave të Kodit Penal, për rrjedhojë pjesë e juridiksionit të gjykatave të zakonshme, etj.

**Risia** që sjell ky punim është paraqitja e plotë e kuptimit të normave procedurale kushtetuese përsa i përket parimeve që rregullojnë gjykimin kushtetues, juridiksionin, afatet procedurale, aktet procedurale në një gjykim kushtetues, provat që mund të paraqiten, llojet e gjykimeve që zhvillohen përpara kësaj gjykate, efektet e vendimeve të kësaj gjykate dhe mënyra e zbatimit të tyre, raporti në planin procedural midis Gjykatës Kushtetuese, gjykatave të zakonshme dhe gjykatave ndërkombëtare. Trajtim të veçantë kanë edhe subjektet që janë pjesëmarrës në gjykimin kushtetues por duke i trajtuar në pozitën e tyre procedurale si palë ndërgjyqëse dhe rolin që ato marrin në llojet e ndryshme të gjykimeve kushtetuese. Në këtë aspekt theksojmë se disa prej nënçështjeve që trajtohen në këtë punim, janë trajtuar shumë pak ose aspak nga doktrina. Këtu mund të përmendim si trajtime të reja burimet normative të procesit kushtetues, pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues, veçanërisht pozita procedurale e subjekteve të interesuara, provat në gjykimin kushtetues, afatet procedurale, aktet procedurale, procedura e seleksionimit të kërkesave, natyra e vendimeve të kësaj faze, teknikat e arsyetimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese etj. Përsa i përket nënçështjeve të tjera të cilat janë trajtuar edhe më parë nga doktrina, punimi synon trajtimin e tyre sipas një qasje të re dhe të strukturuar ndryshe për të nxjerrë në pah karakteristikat e nevojshme procedurale. Për më tepër në këto nënçështje mbahet në një qëndrim analitik dhe kritik për të dhënë një kuptim sa më të plotë të aspekteve procedurale që karakterizojnë procesin kushtetues në këto raste. Një tjetër aspekt i ri është edhe përdorimi si material referues dhe analitik i vendimeve të kolegjeve të Gjykatës Kushtetuese, të cilat më parë nuk janë përdorur dhe analizuar nga doktrina kushtetuese.

**Metodologjia** që është ndjekur për përgatitjen e këtij punimi ka qenë e ndryshme. Fillimisht, për përgatitjen e këtij punimi është përdorur metoda hulumtuese e cila përfshin gjetjen dhe përzgjedhjen e literaturës së duhur për realizimin e punimit shkencor. Identifikimi i kësaj literature ka pasur vështirësitë e veta. Përsa i përket burimeve shqiptare, literatura që trajton aspektet e procesit kushtetues është e pakët, por megjithatë shumë e mirë. Në lidhje me burimet e huaja jam përpjekur që të identifikoj literaturën e atyre sistemeve juridike, ku drejtësia kushtetuese e tyre përshtatet më shumë me sistemin në Shqipëri. Për këtë arsye i jam referuar literaturës që trajton drejtësinë kushtetuese, në Itali dhe Gjermani, por gjithashtu edhe në vendet e Evropës Lindore të cilat, kanë një të kaluar juridike të përafërt me sistemin tonë. Kështu edhe këto vende kanë pasur një të kaluar komuniste dhe më pas kanë përqafuar një sistem të centralizuar të kontrollit kushtetues, si në vendin tonë. Përveç studimeve doktrimore, kërkimi është drejtuar edhe në konsultimin me praktikën gjyqësore. Për këtë arsye janë analizuar të gjitha vendimet e Gjykatës sonë Kushtetuese dhe janë përzgjedhur ato që kanë të bëjnë me trajtimin e aspekteve të procesit kushtetues. Ky lloj studimi është thelluar, përveç vendimeve të dhëna në seancë plenare nga Gjykata Kushtetuese edhe në ato vendime që janë marrë prej saj në Kolegj apo në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Analiza e këtyre vendimeve ka nxjerrë në pah trajtimin



nga gjykata të shumë aspekteve që paraqesin rëndësi të veçantë për këtë punim. Pjesë e këtij kërkimi ka qenë edhe analiza e jurisprudencës së gjykatave kushtetuese të huaja, ku në veçanti është konsultuar baza elektronike e të dhënave e Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), e quajtur "CODICES". Kjo jurisprudencë është përdorur si krahasim por edhe si analizë e disa elementëve të gjyqimit kushtetues për të cilat Gjykata jonë Kushtetuese deri më sot nuk ka një praktikë të mirëfilltë.

Metodë tjetër e përdorur ka qenë edhe analiza e detajuar e normave juridike të pasqyruar në Kushtetutë dhe në ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese. Duke dashur të bëhet një analizë sa më e plotë, pjesë e kërkimit ligjor kanë qenë edhe normat procedurale të ligjeve të tjera të cilat përdoren nga Gjykata Kushtetuese si legjislacioni plotësues. Këtu mund të përmendim Kodin e Procedurës Civile, Penale, ligjin për referendumin etj. Për të kuptuar dhe përdorur drejt këto burime me qëllim arritjen e konkluzioneve të duhura janë përdorur disa teknika si analiza ligjore e bazuar në legjislacionin parësor, Kushtetuta e vendit tonë, ligji organik i Gjykatës Kushtetuese, Kodi i procedurës Civile, Kodi i Procedurës Penale, Ligji për organizimin e gjykatave administrative dhe gjyqimit e mosmarrëveshjeve administrative, ligji për referendimet, Rregullorja e Kuvendit, si edhe plot akte të tjera juridike që trajtojnë problematika të procesit kushtetues. Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, gjykatave kushtetuese të huaja, është konsultuar dhe analizuar për të parë si i kanë zbatuar dhe nxjerrë kuptimin normave procedurale dhe si kanë ndikuar në nevojën për ndryshime ligjore. Përdorimi i vendimeve në këtë punim ndjek këtë rregull: në punim citohet vetëm thelbi i vendimit, kurse pasazhi konkret, kur është e nevojshme, si rregull jepet në referencë për të krijuar një ide sa më të qartë për lexuesin në lidhje me vendimmarrjen konkrete të Gjykatës për atë rast. Megjithatë në rastet kur është e nevojshme të jepen shembuj sa më të plotë, apo në rastet kur mbahet një qëndrim i kundërt me vendimmarrjen kushtetuese, pasazhet nga vendimi jepen të plota në tekstin e punimit.

Punimi është hartuar edhe mbi bazën e metodës analitiko – teorike ku trajtohet pjesa teorike e zhvillimit të drejtësisë kushtetuese, bazuar në studimet teorike përkatëse vendase dhe të huaja. Në realizimin e këtij punimi nuk është lënë veçmas edhe metoda krahasimore për çështje që kanë të bëjnë me organizimin, funksionimin dhe rregullat procedurale që janë të diskutueshme, ngjallin debat dhe që ndiqen nga disa gjykata të huaja, veçanërisht ato italiane dhe gjermane, nga e cila udhëhiqet shpeshherë edhe Gjykata jonë Kushtetuese. Kjo lloj metode është e rëndësishme për të kuptuar sjelljen që duhet të ndjekë Gjykata jonë Kushtetuese me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të procedurave dhe vendimmarrjes së saj, duke u bazuar në përvojat më të mira.

Në punim është përdorur edhe metoda sintetike, kur është shfaqur e nevojshme të nxirren përfundime konkrete lidhur me zgjidhjen e problematikave që shfaqen në fushën e procesit kushtetues. Përshkrimi historik, përdoret shpeshherë në pjesë të ndryshme të këtij punimi, për të dhënë shembuj të përdorimit të drejtësisë kushtetuese në vendin tonë. Kjo metodë shërben edhe për të nxjerrë kuptimin e normave juridike, sipas kohës së miratimit të tyre. Vend të

*padiskutueshëm zë edhe metoda interpretuese kur shqyrtohet jurisprudenca vendase dhe e huaj, me qëllim nxjerrjen e kuptimit dhe mësimave përkatëse prej saj.*

*Këto metoda ndërthuren gjatë këtij punimi kryesisht me përshkrimin dhe analizimin e procedurave që karakterizojnë gjykimin kushtetues, duke dhënë referencat përkatëse dhe burimet bibliografike, të shoqëruara në çdo rast dhe me qëndrime nga jurisprudenca kushtetuese shqiptare dhe ajo e huaj.*

*Duke pasur si qëllim dhënien e një tabloje sa më të qartë të procesit kushtetues jam përpjekur që të krijoj një strukturë të qartë të punimit. Struktura e punimit është e ndarë në gjashhtë krerë.*

*Në **kreun e parë** do të trajtohen si nënçështje e parë, historiku i gjykimit kushtetues në vendin tonë. Synimi i trajtimit të kësaj nënçështje ka si qëllim të tregojë shembujt e parë të një kurajo gjyqësore e cila donte të vinte në rend të parë kushtetutshmërinë e veprimtarisë së organeve shtetërore të kohës. Pavarësisht rezultave që patën këto raste, duhet theksuar se mendimi juridik shqiptar edhe në ato kohë e pranonte mundësinë e ushtrimit të kontrollit kushtetues. Nënçështja e dytë që do të trajtohet në këtë kapitull ka të bëjë me organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, administratën e saj si edhe statusin e gjyqtarëve kushtetues. Qëllimi është që të japë një pasqyrë përmbledhëse se si organizohet ky institucion, i cili ushtron drejtësinë kushtetuese dhe garanton respektimin e parimeve themelore. Në nënçështjen e tretë do të trajtohen burimet e së drejtës që rregullojnë veprimtarinë e procesit kushtetues. Ato janë akte si me karakter kombëtar është edhe me karakter ndërkombëtar.*

***Kreu i dytë** është i ndarë në disa nënçështje. Në nënçështjen e parë do të trajtohen parimet e gjykimit kushtetues, me qëllim dhënien e një pasqyrë sa më e plotë e parimeve që zbatohen nga Gjykata Kushtetuese. Kur është e mundur parimet shoqërohen me shembujt përkatës. Nënçështja e dytë trajton juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese. Në këtë nënçështje gjejmë trajtim kufijtë e kontrollit kushtetues përta i përket objektit të këtij kontrolli. Këtu trajtohen aktet e ndryshme, veprimet dhe mosveprimet që mund të jenë objekt i një gjykimi kushtetues.*

***Kreu i tretë** trajton pjesëmarrësit në një gjykim kushtetues. Në këtë pjesë analizohet pozita procedurale e palëve dhe mënyra e legjitimitetit të tyre në procesin kushtetues. Këtu përveç subjekteve kërkuese klasike të cilët janë trajtuar gjerësisht në doktrinë, gjen vend një trajtim i veçantë i gjykatave të zakonshme, i organeve quasi gjyqësore dhe i Gjykatës Kushtetuese si subjekt i aftë për të vënë në lëvizje vetën e saj në kuadër të një gjykimi për kontroll incidental. Si një risi, trajtim kanë edhe pjesëmarrësit e tjerë në një gjykim kushtetues, përkatësisht subjektet e interesuara, pozita e tyre procedurale dhe mënyra e thirrjes së tyre. Në përfundim kreu mbyllet me trajtimin e përfaqësuesve në gjykimin kushtetues.*

***Kreu i katërt** trajton afatet procedurale, si një moment me rëndësi në një proces gjyqësor. Pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues, mundet që t'i ushtrojnë të drejtat e tyre vetëm brenda afateve të përcaktuara të cilat kanalizojnë rrjedhën e një procesi kushtetues. Në këtë pjesë do të analizohen llojet e afateve dhe mënyra e përllogaritjes së tyre. Më pas nënçështja e dytë vijon me trajtimin e akteve procedurale kushtetuese, nëpërmjet të cilave pjesëmarrësit në*

gjykimin kushtetues venë në lëvizje dhe veprojnë në gjykimin kushtetues. Në këtë nënçështje analizohen akte procedurale të tilla si kërkesa, relacioni, procesverbali gjyqësor, opinioni i këshilltarit etj. Nënçështja e tretë ka të bëjë me analizën e provave që përdoren në një gjykim kushtetues. Trajtimi i këtyre çështjeve mund të themi që bëhet për herë të parë në një studim doktrinor. Në këtë pjesë përshkruhen provat që mund të përdoren në një gjykim kushtetues dhe mënyra e marrjes së tyre.

Në **kreun e pestë** do të gjejë vend trajtimi i fazave të ndryshme të gjykimit kushtetues, ku përfshihen shqyrtimi paraprak, shqyrtimi në themel si edhe faza vendimmarrëse e gjykatës, ku përfshihet mënyra e arsyetimit të vendimeve gjyqësore dhe metodave interpretuese të përdorura prej saj, si edhe llojet e vendimeve që merren në përfundim të një procesi. Në nënçështjet e fundit do të ketë vend trajtimi mbi llojet dhe efektet e ndryshme të vendimeve që merr Gjykata Kushtetuese si edhe mënyra e zbatimit të tyre.

Në **kreun e gjashtë** do ta trajtohet raporti i Gjykatës Kushtetuese me gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të vendit tonë, raporti me Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, raporti me Gjykatën Evropiane të Drejtësisë dhe me mundësinë për të kontrolluar legjislacionin e Bashkimit Evropian. Trajtimi i këtij raporti do të shihet më ngushtësisht në planin procedural, duke sjellë në vëmendje pikat e kontaktit dhe dallimet midis këtyre dy juridiksioneve. Po kështu trajtim do të gjejnë edhe ndryshimet që kanë pësuar rregullat tona procedurale për shkak të ndikimit të jurisprudencës së GJEDNJ-së. Duke pasur në konsideratë synimin e vendit tonë për t'u integruar në Bashkimin Evropian është e nevojshme që të analizohet edhe pozicioni që do të ketë Gjykata jonë Kushtetuese në raport me Gjykatën Evropiane të Drejtësisë. Në këtë kre si çështje me interes do të analizohet edhe mundësia që artikullohet nga shumë gjykata kushtetuese të huaja për të kontrolluar kushtetushmërinë e akteve të organeve të Bashkimit Evropian.

Në secilin kre në përfundim të tij është edhe pjesa e konkluzioneve, ku do të pasqyrohet sinteza e këtij kreu kurse në fund do të jetë edhe pjesa e rekomandimeve, për përmirësimin e legjislacionit procedural kushtetues.

Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetutës është organi që garanton respektimin e Kushtetutës,<sup>2</sup> por që të mbrosh të drejtat e tua, apo pavarësinë dhe kompetencat e institucionit që përfaqëson, është e nevojshme që të kesh njohuritë e duhura, për të ditur si duhet t'i drejtohesh këtij institucioni të rëndësishëm kushtetues, mbrojtësja e fundit e rendit demokratik në një vend.

---

<sup>2</sup> Kushtetuta, neni 124.

## KREU I

### DREJTËSIA KUSHTETUESE NË SHQIPËRI

#### Hyrje

Siç e përmendem më sipër në hyrjen e këtij punimi, drejtësia kushtetuese në Shqipëri është një fenomen i kohëve të fundit. Më parë formalisht, ekzistenca e një organi kushtetues të pavarur, i ngarkuar për kontrollin e akteve të organeve të tjera kushtetuese dhe të drejtën për t'i shfuqizuar ato nuk njihet. Megjithatë pavarësisht se Gjykata Kushtetuese u krijua vetëm në fund të shekullit XX në vendin tonë, koncepti i supremacisë së Kushtetutës mbi aktet e tjera, nuk ishte i panjohur për mendimin juridik shqiptar. Madje historia na tregon se ka pasur edhe raste kur ky kontroll është ushtruar.

Qëllimi i këtij kreu është që fillimisht të japë një pasqyrë historike në lidhje me evolucionin e konceptit të supremacisë kushtetuese dhe shqyrtimin e pak rasteve të shfaqura në praktikë në të cilën është ushtruar kontrolli kushtetues. Më pas kalohet në një analizë të përgjithshme të organizimit të brendshëm të Gjykatës Kushtetuese, përbërjes së saj, mënyrës së emërimit të gjyqtarëve dhe të Kryetarit të Gjykatës, statusin e administratës gjyqësore si edhe garancitë procedurale dhe protokollare që i shërbejnë funksionimit të Gjykatës Kushtetuese. Si pjesë e fundit të këtij kreu gjejmë trajtim edhe burimet normative që përdor Gjykata Kushtetuese si material për zhvillimin e procesit kushtetues.

#### 1. Vështrim historik mbi kontrollin kushtetues në Shqipëri

Më datë 29.4.1992, Kuvendi miratoi ligjin nr. 7561, me anë të të cilit u rregullua me ligj kushtetues, pushteti gjyqësor në Shqipëri. E veçanta e këtij ligji është fakti se nëpërmjet tij u rregullua për herë të parë edhe organizimi i një institucioni tjetër të panjohur më parë në Shqipëri, ai i Gjykatës Kushtetuese. Ky rregullim bëhej në nenet 17-28 të ligjit kushtetues, dhe në të përcaktoheshin mënyra e zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues, statusi i tyre, juridiksioni i Gjykatës, subjektet që mund ta vinin në lëvizje, vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese etj.

Ky moment shënon lindjen zyrtarisht të kontrollit kushtetues në Shqipëri, kontroll i cili në ditët e sotme rregullohet nga nenet 124 – 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.<sup>3</sup> Pavarësisht këtij perceptimi se kontrolli kushtetues në Shqipëri ka lindur në vitin 1992, në historinë e jurisprudencës shqiptare, ndeshim disa raste që tregojnë se kontrolli kushtetues është ushtruar edhe më parë në vendin tonë, megjithëse rrallë.

Kontrolli kushtetues në thelb bazohet në idenë e supremacisë së Kushtetutës mbi të gjitha aktet e tjera juridike si ligjet ashtu edhe aktet e tjera nënligjore. Kjo ide duket se ka gjetur mbështetje që në kushtetutat më të hershme të vendit tonë, megjithëse jo gjithmonë në mënyrë të shprehur. Kështu, akti i parë themelor i këtij vendi, **Satuti Organik i Shqipërisë** i vitit 1914,<sup>4</sup> nuk përmbante në fakt një dispozitë të shprehur të supremacisë së tij mbi aktet e tjera juridike. Megjithatë nga një analizë tërësore e tij mund të konkludojmë indirekt se kjo supremaci e kushtetutës së asaj kohe konfirmohej nga disa dispozita të tjera. Kështu neni 58 i Statutit,

<sup>3</sup> Ligji nr.8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", amenduar me ligjet nr.9675, datë 13.1.2007, nr.9904, datë 21.4.2008, nr.88/2012.

<sup>4</sup> Puto, Arben, "Çështja Shqiptare në Aktet Ndërkombëtare të Perindhës së Imperializmit", Vëllimi II, Shtëpia Botuese "8 Nëntori", Tiranë 1987, Dokumenti Nr.152, faqe 572-605.



parashikonte kuorumin e nevojshëm të pjesëmarrjes dhe të votimit në mënyrë që organi legjislativ i parashikuar prej tij, Asambleja Kombëtare, të merrte vendime të vlefshme.<sup>5</sup> Duke rregulluar kuoromet përkatëse, statuti indirekt përcaktonte se çdo lloj vendimmarrje në kundërshtim me këtë dispozitë nuk do të ishte e vlefshme, pasi ishte marrë në kundërshtim me një dispozitë statutore. Pikërisht nga ky argument megjithëse indirekt, konfirmohet supremacia e Statutit Organik mbi aktet e tjera të vendit në atë kohë.

Kushtetuta e dytë e këtij vendi ka qenë **Statuti i Lushnjës** i miratuar në mbledhjen e Kongresit të Lushnjës datë 30.1.1920, i titulluar “Bazat e Kanunores së Këshillit të Naltë”.<sup>6</sup> Ky akt themelor, i përbërë vetëm nga 6 nene, rregullonte në mënyrë embrionale organizimin shtetëror, por në të nuk gjejmë asnjë referim që trajton qoftë edhe indirekt idenë e supremacisë së tij mbi aktet e tjera.

Kushtetuta e tretë e këtij vendi dhe akti i parë kushtetues që njohu në mënyrë të shprehur supremacinë e kushtetutës mbi aktet e tjera juridike është **Statuti i Zgjeruar i Lushnjës** i vitit 1922,<sup>7</sup> i cili njëkohësisht mendohej të vendoste edhe garancitë për këtë supremaci.<sup>8</sup>

Nga përmbajtja e neneve 74 – 126, rezulton qartë dhe shprehimisht supremacia e Statutit të vitit 1922, mbi të gjitha aktet e tjera, duke parashikuar edhe pasojat për ato akte juridike që binin në kundërshtim me të, pafuqinë e tyre juridike. Ndonëse statuti nuk parashikonte se cili organ do të shprehej për antikushtetutshmërinë dhe pafuqinë juridike të akteve që eventualisht mund të binin në kundërshtim me kushtetutën, disa mundësi dilnin indirekt nga disa dispozita të tjera të Statutit. Mundësia e parë ofrohej nga neni 41 i Statutit, i cili i jepte të drejta parlamentit që të kontrollonte qeverinë. Ky kontroll bëhej nëpërmjet ngritjes së një komisioni hetimor i cili ndër të tjera kishte si kompetencë që të shqyrtonte edhe aktet zyrtare që u dukeshin të nevojshme. Ndërsa sipas nenit 42 të Statutit, parlamenti kishte të drejtë që të akuzonte ministrat dhe t’i dërgonte përpara Gjyqit të Naltë. Këto dy dispozita duhet të shihen të lidhura ngushtësisht me paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 127, i cili ngarkonte me përgjegjësi penale një sërë zyrtarësh të lartë, në rast se vepronin në kundërshtim me parashikimet e statutit. Theksoj se mundësia e parë, rëndonte më tepër mbi individët që tentonin të shkelnin statutin, por në asnjë moment nuk trajtohet fati i akteve antikushtetuese. Mundësia e dytë përcaktohej nga neni 80 i statutit, dispozitë e cila parashikonte se “gjykatat janë të pavarme. Në të dhanunit e gjykimeve të veta nuk varen prej asnjë autoriteti tjetër veçse prej atij të ligjës”.

E formuluar si një dispozitë e cila synonte të garantonte pavarësinë e gjyqësorit, ky parashikim statutor i detyronte gjyqtarët që t’i bindeshin vetëm ligjit. Në rastin konkret mund të shtrohet për diskutim çështja nëse termi “ligj” i përdorur në këtë dispozitë përfshinte vetëm ligjet klasike të votuara nga parlamenti i kohës, apo edhe vetë Statutin e Zgjeruar të Lushnjës. Dilemën nëse akti themelor i vendit në atë kohë konsideroj “ligj” ose jo, duket sikur e zgjidh neni 128 i

<sup>5</sup> Statuti Organik i Shqipërisë, neni 58: *Që Asambleja të mund të marrë vendime të vlefshme është e domosdoshme që të jenë të pranishëm të paktën gjysma e anëtarëve të saj.*

<sup>6</sup> Luarasi, Aleks, “Akte Juridike për Historinë e Shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri – Pjesa II”, Shtëpia Botuese Luarasi, Tiranë 1999, fq.61-62.

<sup>7</sup> Po aty, fq.65-81.

<sup>8</sup> Konkretisht keto dispozita ishin: **Neni 74** – Aktet e kabinetit si edhe aktet e veçanta të ministrave që janë në kundërshtim me këtë Statut, me ligjet, e me dekretet, janë pa fuqi. **Neni 126** – Çdo ligj ose dekretligj në kundërshtim me shkronjën dhe me shpirtin e këtij statuti është antikushtetutor dhe i pafuqi. **Neni 127** – Mbrojtja e këtij Statuti është e drejta dhe detyra e të gjithë popullit shqiptar. Të gjithë zyrtarët dhe nëpunësit e shtetit, civilë a ushtarakë qofshin, janë të përgjegjshëm për veprat e tyre kundër këtij Statuti dhe dënohen sipas ligjeve në fuqi për sa këto parashohin, dhe për shpërdorim detyre për sa këto nuk parashohin. Urdhëri i të parëve të tyre nuk i liron prej kësaj përgjegjësie.

Statutit, dispozitë e cila parashikonte se “ky statut është ligja themelore e Shtetit shqiptar deri sa Kuvendi Kushtetues të mos ketë vendosur Statutin definitiv”.

Pikërisht termi që përdor dispozita e sipërcituar, “*ligja themelore*”, tregon se edhe ky Statut, konsiderohej “ligj” dhe për rrjedhojë duhej të merrej në konsideratë nga gjykatat në zgjidhjen e çështjeve konkrete që gjykoheshin prej tyre. Pikërisht gjatë gjykimit të këtyre çështjeve, gjykatat shqiptare në atë kohë duket sikur e kishin mundësinë që në rast se konstatojnë akte që ishin në kundërshtim me ligjin e kohës, t’i konsideronin ato me pafuqi juridike dhe për rrjedhojë mos t’i zbatonin. Në rast se këto dy mekanizma nuk do të funksionin, për mbrojtjen e Statutit, atëherë neni 127, pika 1 e linte në dorë të popullit mbrojtjen e tij.

Kushtetuta e katërt e vendit tonë, ka qenë **Statuti Themeltar i Republikës**<sup>9</sup> i viti 1925. Edhe ky Statut e trajtonte supremacinë e tij mbi aktet e tjera juridike. Kështu, neni 140 përcaktonte se “ç’do ligjë ase dekretligjë në kundërshtim me shkrojnë dhe me shpirtin e këtij Statuti është antikushtetore dhe e pa fuqishme”.

Ky statut në nenin 141 të tij dhe në ndryshim nga ai paraardhës, përcaktonte të drejtën e Parlamentit të kohës, për të bërë interpretimin autentik të dispozitave të këtij statuti. Ky interpretim bëhej nga mbledhja e përbashkët e të dyja dhomave duke ndjekur për analogji procedurën dhe kuorumin që kërkohej për ndryshimin e statutit.

Në këtë rast, mund të flasim për një formë kontrolli kushtetues të ushtruar nga parlamenti. Mendojmë se interpretimi autentik mund të kërkohej në ato raste kur organe të ndryshme shtetërore kishin kundërshti për mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të dispozitave të caktuara të statutit. Interpretimi që jepte parlamenti shërbente edhe për zgjidhjen e konfliktit që kishte lindur.

Formë tjetër e ushtrimit të kontrollit kushtetues është kontrolli që ushtrohej nëpërmjet gjykatave. Kështu neni 98 i këtij statuti, përcaktonte varësinë e gjykatave vetëm prej ligjit, për rrjedhim edhe në këtë rast, gjykatat kishin mundësinë (të paktën teorikisht), që duke aplikuar nenin 140 të statutit, të shmangnin zgjidhjen e çështjeve bazuar në akte juridike që binin në kundërshtim me statutin.

Kushtetuta e pestë e vendit ishte **Statuti Themeltar i Mbretërisë**<sup>10</sup> i vitit 1928. Edhe ky Statut, (në mënyrë të ngjashme me dispozitat e statuteve të mëparshme) parashikonte supremacinë e tij mbi aktet e tjera të vendit, fakt që përcaktohej në nenin 232 të tij. Sikurse edhe Statuti i Republikës, statuti përcaktonte të drejtën e parlamentit për të bërë interpretimin autentik të tij. Mënyra e interpretimit autentik, rregullohej nga nenet 224 – 229 të këtij Statuti. Për këto raste parashikohej një procedurë e përforcuar për realizimin e interpretimit autentik që lidhej me propozimin, shumicën e kërkuar për miratim, si dhe me sanksionimin përfundimtar nga Mbreti. Pavarësisht këtij parashikimi, formulimi i nenit 98 që i konsideronte gjykatat të pavarura dhe vetëm nën autoritetin e ligjit, do të sillte edhe rastin e parë të njohur deri më sot të kontrollit kushtetues në vend.

Parlamenti i asaj kohe më datë 5.11.1931 miratoi ligjin “Mbi gjykimin e shpejtë të padive posedimore”. Ky ligj ndryshoi nenet 1052 dhe 1053 të Kodit Civil të vitit 1929, duke parashikuar se paditë posedimore tashmë mund të ngriheshin në çdo kohë, mjafton që paditësi t’ia mbështeste pretendimet e tij në një titull pronësie, ndërkohë që dispozitat e shfuqizuara të Kodit Civil parashikonin ngritjen e kësaj padie vetëm brenda një viti. Padia e parë e ngritur mbi bazën e këtij ligji, përfundoi me Vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë në favor të paditësve, por Gjykata e Diktimit (Dega Civile), e investuar mbi ankimin e të paditurve, konstatoi se ligji ishte

<sup>9</sup> Po aty, fq.87-106

<sup>10</sup> Po aty, fq.107-136.

antikushtetues, për rrjedhojë prishi vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e ktheu çështjen për rigjykim.<sup>11</sup> Arsyet e një vendimmarrje të tillë, duhen gjendur në parashikimet statutorë të kohës, ku në veçanti nenin 232 i Statutit përcaktonte se “dispozitat e ligjëvet, që vijnë në kundërshtim me dispozitat e këtij statuti, janë të pa-fuqishme”. Përmbajtja e nenit 232 i lidhur me nenin 98 të statudit, që i detyronte gjykatat të ishin të varura vetëm prej ligjit, i jepte Gjykatës së Diktimit bazën ligjore procedurale-formale, që të vendoste në lidhje me kushtetutshmërinë ose jo të ligjit, të cilin ajo ishte e detyruar ta zbatonte gjatë zgjidhjes së një çështjeje konkrete. Ndërsa nga ana materiale vendimmarrja e Gjykatës së Diktimit bazohej në nenin 218 të Statutit i cili përcaktonte se “ligjet nuk mund që të kenë fuqi mbrapa-vepruese përveç atyne që lehtësojnë ndëshkimet penale”.

Në këtë çështje ishte mëse e qartë se ligji “Mbi gjykimin e shpejtë të padive posedimore”, kishte fuqi prapavepruese, pasi i shrinte efektet e tij edhe për raste që kishin ndodhur përpara hyrjes së tij në fuqi. Po kështu ligji objekt gjykimi, duke mos pasur karakter penal, rezultonte haptazi antikushtetues për Gjykatën e Diktimit dhe për rrjedhojë në këndvështrimin e saj këto akte ishin pa fuqi juridike. Ishin pikërisht këto dispozita që i dhanë mundësi gjykatës më të lartë të kohës, që të ushtronte kontrollin e parë kushtetues në vend.

Por në zhvillimin e mëtejshëm të kësaj çështjeje, u përfshinë organet më të larta shtetërore, për pasojë ky precedent i rëndësishëm nuk pati jetë të gjatë. Pavarësisht arsytimit të Gjykatës së Diktimit për antikushtetutshmërinë e ligjit dhe pafuqinë juridike të tij, gjykata e shkallës së parë në rigjykim mbajti të njëjtin qëndrim, duke zbatuar dispozitat ligjore të deklaruara pa fuqi juridike dhe në përfundim pranoi padinë e paditësave. Tashmë e ndodhur përballë ankimit të të paditurve dhe faktit se gjykata e shkallës së parë kishte mbajtur të njëjtin qëndrim, Gjykata e Diktimit duhej që të shprehej në Këshillin e Përgjithshëm.<sup>12</sup> Për të shmangur rrëzimin sërish të ligjit si antikushtetues, vetë Mbreti ndërhyri duke kërkuar dorëheqjen e kryetarit të Degës Civile dhe duke shkarkuar të gjithë anëtarët e tjerë të Gjykatës së Diktimit. Anëtarët e rinj të sapo emëruar mbajtën qëndrim të ndryshëm, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, për rrjedhojë ligji “Mbi gjykimin e shpejtë të padive posedimore” mbeti i pacënuar.

Mbas periudhës së monarkisë dhe pushtimit italo-gjerman të Shqipërisë gjatë viteve 1939-1944, në Shqipëri u vendos një pushtet i ri i kontrolluar nga Partia Komuniste Shqiptare (më vonë Partia e Punës). Në mars të vitit 1946, hyri në fuqi Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë,<sup>13</sup> e cila në nenin 6, 42, 62, 73 parashikonte supremacinë e Kushtetutës mbi veprimtarinë dhe aktet juridike të organeve shtetërore, si Kuvendi Popullor, Presidiumi i Kuvendit Popullor, Këshilli i Ministrave dhe organet lokale. Megjithatë ndryshe nga kushtetutat e mëparshme kjo Kushtetutë, për herë të parë përcaktonte shprehimisht një formë të kontrollit kushtetues, formë kjo që sot do të cilësohej me natyrë politike. Kështu në nenin 58, pika 3, Kushtetuta e RPSH përcaktonte se Presidiumi i Kuvendit Popullor kishte ndër të tjera edhe si detyrë të vendoste mbi pajtueshmërinë (konformitetin) e ligjeve me Kushtetutën me kusht që ky vendim të aprovohej më pas nga Kuvendi Popullor.

<sup>11</sup> Nova, Koço, “Zhvillimi i organizimit gjyqësor në Shqipëri”, Kombinati Poligrafik, Tiranë 1982, fq. 83-85.

Anastasi, Aurela, “Historia e së drejtës kushtetuese në Shqipëri 1912-1939”, Shtëpia Botuese “Pegi”, Tiranë 2007, fq.185-187.

<sup>12</sup> Këshilli i përgjithshëm i Gjyqit të Diktimit ishte mbledhja e përbashkët e Degës Civile dhe Degës Penale të kësaj gjykate, pra, në të merrnin pjesë të gjithë gjyqtarët dhe kryesohej nga Kryetari i Degës Civile të kësaj gjykate.

<sup>13</sup> Palnikaj, Dritan, *Kushtetutat*, Shypshkronja “Grand Prind”, Tiranë 2006, fq.177-206.



Kontrolli kushtetues i ligjeve për herë të parë del qartë nga përmbajtja e kësaj dispozite, dhe parashikohet në mënyrë të shprehur. Kjo kompetencë ushtrohet nga dy organe, të cilët pasonin njëri – tjetrin. Në rradhë të parë kjo kompetencë i takonte Presidiumit të Kuvendit Popullor, i cili nësë shprehej pozitivisht, pra nëse e konsideronte një ligj si antikushtetues atëherë, vendimin e tij ja kalonte për miratim përfundimtar Kuvendit Popullor, i cili do të shprehej në sesionin e tij më të afërt. Kushtetuta nuk përcaktonte subjektet që legjitimohen për të bërë kërkesen pranë Presidiumit, por referuar doktrinës së kohës,<sup>14</sup> kërkesa mund të bëhej nga cilido organ i cili gjatë veprimtarisë së tij vërente mospërputhje midis ligjit që do t'i duhej të zbatonte dhe Kushtetutës.

Kushtetuta e vitit 1946 rregullonte gjithashtu edhe kontrollin kushtetues të akteve nënligjore. Kështu neni 91 i kësaj Kushtetute parashikonte se “Presidiumi i Kuvendit Popullor munt të anullopë vendimet dhe urdhëresat e Qeverisë kur janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe me ligjet. Qeveria munt të anullopë urdhërat dhe udhëzimet e ministrave kur janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe me ligjet si edhe me vendimet dhe urdhëresat e e Qeverisë”.

Këto dy paragrafe tregojnë për ekzistencën e një kontrolli hierarkik ndërmjet organeve shtetërore, ku organet më të larta kontrollonin kushtetutshmërinë e akteve juridike të organeve më të ulta. Edhe në këtë rast, mendoj se kërkimi për deklarim antikushtetues të akteve juridike bëhej nga organet përkatëse që ishin të detyruara të zbatonin këto akte. Gjithsesi në këto raste nuk përjashtohet edhe mundësia e kontrollit kryesisht nga vetë këto organe, duke qenë se në atë kohë pushteti shtetëror ishte tejet i centralizuar.

Pavarësisht se ekzistonin parashikimet kushtetuese të trajtuara më sipër, deri në dhjetor të viti 1976, periudhë në të cilën hyri në fuqi **Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë**.<sup>15</sup> nuk pati raste të kontrollit kushtetues. Kushtetuta e vitit 1976, ruante në vija të përgjithshme të njëjtin parashikim si kushtetuta paraardhëse. Megjithatë, kjo kushtetutë i zvogëloi mënyrat e ushtrimit të kontrollit kushtetues. Supremacia e Kushtetutës mbi aktet e tjera rezultonte nga përmbajtja e neneve 12 dhe 110. E vetmja formë kontrolli kushtetues që parashikonte Kushtetuta e vitit 1976, ishte e drejta e Kuvendit Popullor për shqyrtimin e kushtutshmërisë së ligjeve.<sup>16</sup> Pra, në ndryshim nga Kushtetuta e vitit 1946, Kushtetuta e vitit 1976 parashikonte që kontrolli kushtetues të ushtrohet vetëm nga Kuvendi Popullor dhe jo paraprakisht nga Presidiumi i tij. Po kështu, organet e larta shtetërore, tashmë kontrollonin vetëm ligjshmërinë dhe rregullueshmërinë e akteve të organeve të më ulta, por jo kushtetutshmërinë e tyre.<sup>17</sup>

Megjithëse e drejta e kontrollit kushtetues mbi ligjet i takonte organit legjislativ, në këtë periudhë do të kemi rastin e dytë të kontrollit kushtetues, i cili në fakt do të ushtrohet nga Gjykata e Lartë. Si shkak për ushtrimin e kontrollit kushtetues, Gjykatës së Lartë i shërbyen parashikimet e ndryshme kushtetuese (të Kushtetutës së vitit 1946 dhe asaj të vitit 1976) në lidhje me pronën private. Kushtetuta e vitit 1946, pavarësisht se vuri bazat juridike të ndërtimit të një sistemi diktatorial, në përmbajtjen e saj e njëjtte edhe të drejtën e pronës private si formë pronësie. Në bazë të këtyre dispozitave kushtetuese, Dekreti mbi pronësinë i vitit 1955, parashikonte si mjete mbrojtëse të pronarit disa padi. Në ndryshim nga sa më sipër, Kushtetuta e vitit 1976 e suprimoi pronën private, duke njohur vetëm pronën shtetërore dhe pronën vetjake.

<sup>14</sup> Dhima, Dhimo, “E Drejta Kushtetuese e Republikës Popullore të Shqipërisë”, Shtypshkronja Mihal Duri, Tiranë 1963.

<sup>15</sup> Palnikaj, Dritan, “Kushtetutat”, Shypshkronja “Grand Prind”, Tiranë 2006, fq.123-173.

<sup>16</sup> Kushtetuta e vitit 1976, neni 67.

<sup>17</sup> Kushtetuta e vitit 1976, nenet 79, 82 dhe 86.

Ndodhur përpara këtij fakti, si edhe duke marrë në konsideratë se paditë për mbrojtjen e pronësisë dhe të trashëgimisë parashikoheshin ende nga legjislacioni i kohës në fuqi, Gjykata e Lartë në atë kohë me Vendimin e Plenumit të saj nr.3, datë 17.10.1977, miratoi Udhëzimin “Mbi disa çështje që kanë të bëjnë me paditë e pronësisë dhe të trashëgimisë”.<sup>18</sup> Në thelb të arsyetimit të saj Gjykata e Lartë ndër të tjera shprehet se:

*Duke u mbështetur në Kushtetutën e RPS të Shqipërisë, pleniumi i Gjykatës së Lartë mori në shqyrtim disa çështje që i kanë lindur praktikës gjyqësore lidhur me gjykimin e padive të pronësisë dhe të trashëgimisë...*

*Në praktikën gjyqësore vihen re të meta në lidhje me gjykimin e këtyre çështjeve. Kështu, gjykatat vazhdojnë të deklarojnë pronësinë mbi tokën për personat e veçantë. Pranojnë padinë e rivendikimit dhe padinë mohuese kur konflikti ka si objekt tokën, të çdo natyre qoftë...*

*Në kushtet e sotme, kur pronësia mbi tokën është e deklaruar e shtetit, pa të drejtë gjykatat kanë pranuar për gjykim konfliktet në bazë të nenit 59 të dekretit “Mbi Pronësinë” etj...*

Mbas analizës së mësipërme në pikën 2 të Udhëzimit të saj, Gjykata e Lartë orientoi gjykatat e tjera, si me poshtë:

*Toka është në pronësinë e vetme të shtetit, prandaj në asnjë rast gjykatat nuk mundën që të deklarojnë pronësinë e tokës në favor të personave të veçantë. Shtetasit që kanë në posedim tokën, në qoftë se çënohen në mënyrë të kundraligjshme në këtë posedim, mund të mbrohen vetëm me padinë posedimore.*

Udhëzimi i mësipërm i Gjykatës së Lartë, megjithëse jo në mënyrë të shprehur, përcakton se tashmë paditë për mbrojtjen e pronësisë dhe paditë për trashëgiminë, bien në kundërshtim me Kushtetutën dhe për rrjedhojë nuk duhej që të zbatoheshin më nga gjykatat. Në këtë rast, ajo i konsideron personat që zotëronin tokën thjesht si posedues, por jo më si pronarë, duke treguar edhe mjetin mbrojtës, padinë posedimore. E thënë më qartë, Gjykata e Lartë ndonëse jo në mënyrë të shprehur, la pa fuqi juridike, si antikushtetuese, parashikimet ligjore të kohës në lidhje me mbrojtjen e pronësisë private.

Por edhe ky lloj kontrolli në Shqipëri nuk u zhvillua më tej. Rasti i sipërcituar mbeti një rast sporadik dhe i izoluar deri në fundin e regjimit komunist në Shqipëri. Si rezultat i ndryshimeve demokratike që ndodhen në vendin tonë, duke filluar nga muaji dhjetor i vitit 1990, Kuvendi Popullor u detyrua që të shfuqizonte Kushtetutën e vitit 1976 dhe të miratonte Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991, “Për dispozitat kryesore kushtetuese”. Ky ligj kushtetues u plotësua më vonë me ligje të tjera kushtetuese, ndër të cilët më i rëndësishmi ishte ligji kushtetues nr. 7561, datë 29.4.1992, në të cilin siç u shpjegua më sipër u parashikua për herë të parë një formë e institucionalizuar e kontrollit kushtetues. Ky ligj përzgjodhi modelin kelzenian të kontrollit kushtetues, atë të centralizuar. Gjykata Kushtetuese u krijua në muajin qershor të vitit 1992 dhe pikërisht më datën 13.7.1992 dha vendimin e saj të parë, duke i hapur rrugë kontrollit kushtetues në Shqipëri, i cili sot funksionon në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të vitit 1998,

<sup>18</sup> “Udhëzime dhe Vendime të Gjykatës së Lartë të RPSSH (Përmbledhje të viteve 1974, 1975, 1976, 1977)”, Shtëpia Botuese “8 Nentori”, Tiranë 1982, fq. 14-16

por edhe shumë akteve të tjera të cilët në tërësinë e tyre përbëjnë sistemin e burimeve normative për veprimtarinë procedurale të Gjykatës Kushtetuese.

## **2. ORGANIZIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE.**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë u krijua në bazë të ligjit kushtetues nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”. Ligji kushtetues i kohës e cilësonte Gjykatën Kushtetuese si autoritetin më të lartë që mbron dhe garanton respektimin e Kushtetutës dhe të ligjeve, si dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.<sup>19</sup> Mirëpo LDKK, në pjesën kushtuar Presidentit të Republikës, ndër atributet e këtij të fundit, vazhdoi të përmendte, madje në krye të attributeve të tjera, sigurimin e respektimit të vetë LDKK, të ligjeve të tjera dhe të lirive të shtetasve, çka ishte një përplasje atributesh dhe një anomali, sepse, duke e cilësuar Gjykatën Kushtetuese si “autoritetin më të lartë në mbrojtjen dhe garantimin e Kushtetutës”, e vinte atë në një pozitë më të lartë sesa Kryetari i Shtetit. Tani me Kushtetutën në fuqi atributi për garantimin e saj i besohet vetëm Gjykatës Kushtetuese, çka është plotësisht i përligjur.<sup>20</sup>

### **2.1 Kriteret për emërimin e gjyqtarëve kushtetues.**

Sipas bazës juridike të cituar më sipër, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë përbëhet nga nëntë anëtarë, nga të cilët pesë anëtarë zgjidheshin nga Kuvendi Popullor dhe katër anëtarë nga Presidenti i Republikës.<sup>21</sup> Referuar ligjit të kohës, anëtarë të Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidheshin juristë të njohur për aftësitë e tyre, që kishin punuar jo më pak se 10 vjet në veprimtari juridike ose si pedagogë në Fakultetin e Drejtësisë dhe që kishin reputacion të lartë moral.<sup>22</sup>

Edhe Kushtetuta aktuale parashikon se Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë anëtarë, por ka ndryshuar formulën e përzgjedhjes, ku në këtë rast anëtarët e Gjykatës Kushtetuese emërohen nga Presidenti me pëlqimin e Kuvendit.<sup>23</sup> Sipas Kushtetutës rezultojnë se mandati i anëtarëve është 9 vjeçar pa të drejtë riemërimi dhe duhet që të jenë juristë me kualifikim të lartë dhe me përvojë pune jo më pak se 15 vjet në profesion.<sup>24</sup>

Nga këto kritere rezultojnë se vetëm dy kritere janë të vlerësueshëm objektivisht. Kriteri i parë, ai i të qenit jurist është lehtësisht i verifikueshëm. Duke qenë se Kushtetuta përmend vetëm këtë cilësi, atëherë parimisht anëtar i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet çdo individ i cili ka ushtruar profesionin e juristit në një nga format e tij më të ndryshme si, jurist i thjeshtë (ndërmarrjeje, institucioni etj), avokat, noter, prokuror apo gjyqtar. Kriteri i dytë objektivisht i matshëm është kriteri kohor, përvojë pune 15 vjet në profesion. Në këtë rast qartazi kushtetutbërësi ka dashur ta rrisë vjetërsinë në profesion në krahasim me LDKK e cila parashikonte një vjetërsi 10 vjeçare në profesion. Kriteri tjetër me “kualifikim të lartë”, në një masë të madhe është një kriter subjektiv. Në lidhje me këtë kriter kushtetutes vetë Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin e mëposhtëm:

<sup>19</sup> Ligji kushtetues, nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, neni 17.

<sup>20</sup> Omari, Luan; Anastasi, Aurela, “E drejta kushtetuese”, Shtëpia Botuese “ABC”, Tiranë 2010, fq.432-433.

<sup>21</sup> Ligji kushtetues, nr.7561/1992, neni 18, pika 1.

<sup>22</sup> Po aty, neni 20.

<sup>23</sup> Kushtetuta, neni 125, pika 1.

<sup>24</sup> Kushtetuta, neni 125, pika 2.

*Në këndvështrimin e Gjykatës kualifikimi i gjyqtarëve është së pari një vlerësim kriteresh dhe vlerash i bërë nga Presidenti dhe më pas edhe nga Kuvendi. Është mision dhe përgjegjësi e Presidentit që mes kandidaturave, që plotësojnë kriteret kushtetuese/ligjore, të bëjë përzgjedhjet që ai mendon se janë më të përshtatshme dhe që paraqesin vlera për të ushtruar funksionin e një gjyqtari kushtetues. Pas përzgjedhjes së bërë nga Presidenti, Kuvendi ka, gjithashtu, kompetencën ekskluzive të vlerësojë faktet e paraqitura, me qëllim të vlerësimit jo vetëm të plotësimit të kushteve formale, por edhe të meritës së kandidaturës përkatëse.<sup>25</sup>*

Siç mund të konstatohet me lehtësi, vetë Gjykata Kushtetuese nuk ka dashur të japë një kuptim shterues të termit “kualifikim të lartë” duke ruajtur funksionin e vetë si një ligjvënës negativ,<sup>26</sup> por ka përcaktuar si një vlerësim kriteresh dhe vlerash që duhet të bëhen nga të dyja organet kushtetuese të përfshira në këtë proces. Në këtë kuptim, Presidenti dhe Kuvendi, bazuar në parimin e luajalitetit kushtetues, duhet të bashkëpunojnë për përcaktimin e kriterëve ligjore, në përputhje me kërkesën kushtetuese për kualifikim të lartë, në funksion të sigurimit të një përbërjeje cilësore të Gjykatës Kushtetuese.<sup>27</sup>

Sipas procedurës që zbatohet për emërimin e gjyqtarëve kushtetues, Presidenti i Republikës emëron nga rradhët e gjyqtarëve, Kryetarin e Gjykatës me pëlqimin e Kuvendit. Mandati i kryetarit është 3 vjeçar dhe mund të ripërtërihet por gjithmonë brenda mandatit 9 vjeçar që gëzon gjyqtari kushtetues. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese ka disa kompetenca të natyrës administrative dhe procedurale, si përfaqësimin e Gjykatës, thirrjen e saj, përgatitjen dhe kryesimin e seancave plenare, bashkërendimin e punës midis gjyqtarëve, caktimin e gjyqtarit relator për çështjen që do të shqyrtohet, etj. Këto kompetenca i japin mundësi Kryetarit të shprehet mbi të gjitha në përcaktimin e kalendarit të gjykimeve, nëpërmjet të cilit Kryetari “mund të zgjedhë momentin e favorshëm për diskutimin e çështjeve të ndryshme dhe caktimin e gjyqtarit relator”, që, duke mbetur i pandryshuar kolegjaliteti i shqyrtimit dhe i vendimit, “mundet sidoqoftë të ndikojë mbi vetë parashtrimin e trajtimit”.<sup>28</sup>

## **2.2 Rotacioni i anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.**

Sipas Kushtetutës duhet që anëtarët e Gjykatës Kushtetuese të kryejnë një rotacion midis tyre duke u zëvendësuar 3 anëtarë çdo tre vjet. Qëllimin e këtij mënyre rotacioni dhe avantazhin që paraqet, vetë Gjykata Kushtetuese e ka përkufizuar si më poshtë:

*Për parashikimin kushtetues që ka vendosur rregullin/sistemin e përtëritjes periodike dhe të pjesshme të përbërjes të Gjykatës, kjo vëren se ky rregull/sistem është konsideruar se ka më shumë avantazhe se ai i përtëritjes tërësore, sepse në këtë mënyrë garantohet vazhdimësia e jurisprudencës dhe realizohet kombinimi i përvojës së Gjykatës (e paraqitur si shumica e koncepteve dhe qëndrimeve që janë bërë të qëndrueshme gjatë*

<sup>25</sup> Vendimi nr.24, datë 9.6.2011 i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 21.

<sup>26</sup> Po aty. Me tëj në vendimin e saj Gjykata Kushtetuese shprehet se: *Gjykata vlerëson se Presidenti dhe Kuvendi, gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre kushtetuese janë interpretuesit e parë të normës kushtetuese dhe përcaktimi, nga ana e Gjykatës, i kriterëve që duhet të plotësojë një kandidaturë, çon në marrjen, nga kjo e fundit, të kompetencës kushtetuese të secilit prej këtyre organeve.*

<sup>27</sup> Vendimi nr.24, datë 9.6.2011 i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 23.

<sup>28</sup> Sadushi, Sokol, “Drejtësia kushtetuese në zhvillim”, Shtëpia Botuese “Toena”, Tiranë 2012, fq.137-138.



vendimmarrjes së një trupe të caktuar gjyqësore) me atë vetjake të gjyqtarëve të rinj, çka do të ishte më e vështirë në rast se mandati i të gjithë gjyqtarëve do të përfundonte në të njëjtën kohë. Funkzioni themelor i Gjykatës është garantimi i respektimit të Kushtetutës, interpretimi përfundimtar dhe sigurimi i epërsisë së saj në sistemin ligjor, nëpërmjet dhënies së drejtësisë kushtetuese. Rregullimi kushtetues i nenit 125/3 të Kushtetutës përbën një parim organizativ, i cili bazohet pikërisht në veçoritë specifike të procesit kushtetues që, përveç njohurive të gjyqtarëve, kërkon dhe përvojën e duhur. Ky rregullim ka për qëllim ruajtjen në përbërje të Gjykatës të një shumice prej dy të tretave të anëtarëve me stazh në detyrë, çka bën të mundur krijimin e një përvoje juridike të posaçme dhe të specializuar në gjykimin kushtetues, e cila nuk mund të përftohet askund tjetër. Kjo bazë njohurish tekniko-juridike në fushën e gjykimit kushtetues, duke qenë se ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e vendimmarrjes, konsiderohet nga Gjykata si një vlerë e mbrojtur nga Kushtetuta.<sup>29</sup>

Nga pasazhi i mësipërm kuptojmë që ky lloj sistemi nxjerr dy avantazhe thelbësore a) vazhdimësinë e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe b) krijimin e një përvoje juridike të specializuar në gjykimin kushtetues. Pavarësisht rregullimeve kushtetuese dhe ligjore rotacioni i anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese ka qenë gjithmonë problem si me LDKK ashtu edhe me Kushtetutën aktuale.

Me LDKK problem u paraqit nga vetë Gjykata Kushtetuese e cila e vënë në lëvizje kryesisht, me nismën e saj, bëri një interpretim sipas të cilës dorëheqja e tre gjyqtarëve kushtetues dhe zëvendësimi i tyre me tre të tjerë do të konsiderohej si rotacioni i parë i kësaj gjykate.<sup>30</sup> Kjo mënyrë veprimi nuk u pranua nga Kuvendi Popullor i cili nëpërmjet një ligji kushtetues<sup>31</sup> nuk e quajti të vlefshëm këtë rotacion të parë dhe kërkoi që Gjykata Kushtetuese ta kryente atë brënda 30 ditëve nga moment i hyrjes në fuqi të këtij ligji. Reagimi i Gjykatës Kushtetuese qe inicimi i një tjetër procesi kushtetues, kryesisht prej saj, që çoi në shfuqizimin e këtij ligji, si antikushtetues.<sup>32</sup> Konflikti midis Kuvendit dhe Gjykatës Kushtetuese u zgjidh me një mendim të shprehur nga Komisioni i Venecias që i njihte Kuvendit të drejtën për të ndryshuar ligjin kushtetues, me shumicën e cilësuar të parashikuar në një rast të tillë. Si rrjedhojë Gjykata Kushtetuese u detyrua ta pranojë përtëritjen që kërkohet.<sup>33</sup>

Ndërsa problemi në rotacion që u shfaq me Kushtetutën aktuale ishte ulja e mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese nga 12 vjet<sup>34</sup> në 9 vjet<sup>35</sup> dhe ruajtja sipas dispozitave tranzitore të mandatit të gjyqtarëve të zgjedhur sipas LDKK-së.<sup>36</sup> Këto parashikime të ndryshme

<sup>29</sup> Vendimi nr.24, datë 9.6.2011 i Gjykatës Kushtetuese, parag.34.

<sup>30</sup> Vendimi nr.4, datë 2.6.1995 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>31</sup> Ligji nr. 8257, datë 19.11.1997 "Për një plotësim në ligjin nr.7561, datë 29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

<sup>32</sup> Vendimi nr.57, datë 5.12.1997 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>33</sup> Omari, Luan; Anastasi, Aurela, "E drejta kushtetuese", Shtëpia Botuese "ABC", Tiranë 2010, fq.435.

<sup>34</sup> Neni 18, parag.3 i ligjit nr.7561/1992 parashikonte se: Afati i 3 anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të caktuar në zgjedhjen e parë mbaron në krye të 3 vjetëve. Emrat e tyre caktohen me short, në secilin grup gjyqtarësh të zgjedhur nga Kuvendi Popullor dhe nga Presidenti i Republikës. Pas 3 vjetëve të tjerë, zëvendësohen në të njëjtën mënyrë, me short, nga 3 gjyqtarë të tjerë. **Gjyqtarët zëvendësues qëndrojnë në detyrë 12 vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje.**

<sup>35</sup> Kushtetuta, neni 125 pika 2: **Gjyqtarët emërohen për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi, nga radhët e juristëve me kualifikimin të lartë dhe me përvojë pune jo më pak se 15 vjet në profesion.**

<sup>36</sup> Kushtetuta, neni 179, pika 1: **Mandati i organeve kushtetuese që do të ekzistojnë me hyrjen në fuqi të kësaj Kushtetute mbaron me afatet e parashikuara në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse.**

kushtetuese sollën si pasojë një anomali në rotacionin që duhej të kryente Gjykata Kushtetuese në vitin 2010, ku përfundoi mandati 12 vjeçar i tre gjyqtarëve të zgjedhur në periudhën prill të vitit 1998 dhe i atyre të zgjedhur në maj të vitit 2001, që ishin me mandat 9 vjeçar. Kjo solli si rezultat që në këtë vit duhej të zëvendësoheshin 6 gjyqtarë kushtetues.

Zgjidhja që u bë nga Kuvendi ishte zëvendësimi i 3 gjyqtarëve, dy në vitin 2010 dhe një në vitin 2011, si edhe kthimi mbrapsht i emërimeve të Presidentit për tre vendet e reja vakante. Kjo mënyrë veprimi e Kuvendit e cilësuar nga Gjykata Kushtetuese si “ngërç politik” midis organeve kushtetuese dhe për rrjedhojë jashtë juridiksionit të saj,<sup>37</sup> solli si pasojë që tre gjyqtarë të kësaj Gjykate të zëvendësoheshin në vitin 2013.

Megjithëse kjo mënyrë rotacioni me 1/3 e anëtarëve çdo tre vjet paraqet avantazhet e cituara më sipër, jam i mendimit që kjo dispozitë e ka humbur kuptimin e saj. Kështu, rezulton që në vitin 2007 nga tre anëtarë që duhet të zëvendësoheshin u zëvendësuan në fakt vetëm dy, dhe zëvendësimi i të tretit u realizua vetëm në vitin 2008. Po kështu e njëjta situatë u paraqit edhe në vitin 2010 ku vetëm dy anëtarë u zëvendësuan dhe një i tretë në vitin 2011. Pra dukshëm kemi dy sfazime nga rregulli i përgjithshëm i cili padiskutim do të pasqyrohet edhe në të ardhmen. Në këtë drejtim mendoj se ndjekja e përvojave të vendeve të tjera të cilët e kanë eliminuar këtë rregull do të sjellë më shumë qëndrueshmëri në përbërjen e Gjykatës Kushtetuese. Një mekanizëm i ngjashëm, megjithëse disi më i komplikuar parashikohej fillimisht edhe në Kushtetutën Italiane për rotacionin e anëtarëve të Gjykatës së saj Kushtetuese. Nga ky mekanizëm u hoq dorë më vonë nëpërmjet një amendamenti kushtetutës dhe sot gjyqtarët e kësaj gjykate emërohen me mandat të plotë dhe jo me periudha fikse rotacioni.<sup>38</sup>

Për sa më sipër jam i mendimit se duhet hequr dorë nga kjo mënyrë rotacioni që praktikisht nuk funksionon më dhe të kalohet në emërimin e gjyqtarëve sipas kohës së mbarimit të mandatit të gjyqtarëve që ikin. Duke qenë se që nga viti 1998, përbërja e Gjykatës ka ndryshuar në mënyrë tërësore dhe gjyqtarët aktualë janë emëruar në periudha të ndryshme atëherë, bie dhe rreziku që të kemi një ndryshim tërësor të kësaj gjykate, duke ruajtur në këtë mënyrë edhe vazhdimësinë e jurisprudencës së saj.

### **2.3 Pavarësia e Gjykatës Kushtetuese.**

Për të garantuar sa më mirë pavarësinë e ushtrimit të detyrës nga gjyqtarët kushtetues e drejta në fuqi parashikon një sërë garancish që gëzon Gjykata Kushtetuese si institucion. Në këtë drejtim rezulton se Gjykata Kushtetuese gëzon pavarësi të plotë organizative, administrative e financiare për realizimin e detyrave të caktuara në Kushtetutë dhe në ligjin e saj organik.<sup>39</sup> Gjykata Kushtetuese administron buxhetin e saj, i cili si pjesë e buxhetit të shtetit, hartohet prej saj dhe i paraqitet për miratim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Në mjetet financiare përfshihet edhe çdo e ardhur tjetër që nuk është e ndaluar me ligj, ndërsa llogaritë financiare të Gjykatës Kushtetuese kontrollohen nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.<sup>40</sup> Pra në këtë rast Gjykata Kushtetuese dukshëm ka pavarësi të theksuar financiare.

Në lidhje me pavarësinë organizative që përfshin strukturimin e brendshëm administrativ të Gjykatës Kushtetuese mund të themi se ky institucion gëzon pavarësi të plotë. Sipas

<sup>37</sup> Vendimi nr.41, datë 19.7.2012 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>38</sup> Zagrebelesky, Gustavo; Marceno, Valeria; “*Giustizia costituzionale*”, Shtëpia Botuese “il Mulino”, Bologna 2012, fq.131.

<sup>39</sup> LGJK, neni 3, pika 2.

<sup>40</sup> LGJK, neni 6.

parashikimeve të LGJK-së kompetente për përcaktimin e strukturës organizative, të numrit të personelit dhe të pagës së tyre është Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.<sup>41</sup> Po ky organ sipas dispozitave të ligjit organik ka të drejtën që të emërojë Sekretarin e Përgjithshëm të Gjykatës<sup>42</sup> ndërsa nëpunësit e tjerë emërohen dhe largohen nga Kryetari i Gjykatës.<sup>43</sup>

Pavarësisht se neni 14 i LGJK-së titullohet “Nëpunësit civilë” dhe sipas pikës 4 të kësaj dispozite rezulton se punonjësit e administratës së Gjykatës Kushtetuese i nënshtrohen rregullave të shërbimit civil, përsëri këta punonjës nuk konsideroheshin se gëzonin statusin e nëpunësit civil. Formulimi ligjor që nuk shprehej qartë që nëpunësit kishin këtë status, por shprehej vetëm se i nënshtroheshin rregullave të shërbimit civil, është interpretuar si rrethanë që këta nëpunës nuk e gëzojnë këtë status por rregullat e tij i zbatojnë me analogji.

Këtë qëndrim gjejmë edhe në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë në ato raste kur ka shqyrtuar mosmarrëveshje të marrëdhënieve të punës dhe njëra nga palët ka qenë vetë Gjykata Kushtetuese. Kështu, në këtë drejtim Gjykata e Lartë, lidhur me pretendimin për rikthimin në punë të personit të larguar nga puna në Gjykatën Kushtetuese, është shprehur se:

*I drejtë çmohet vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë edhe lidhur me pjesën që ka vendosur të rrëzojë kërkesën e paditësit për t’u rikthyer në vendin e mëparshëm të punës. Si nga fryma e Kodit të Punës, nga praktika tashmë e konsoliduar e gjykatave si dhe nga qëndrimi i mbajtur nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me Vendimet Unfikuese nr.31 datë 14.04.2003 dhe nr.7 datë 10.06.2011, paditësi nuk mund të rikthehet në vendin e punës pasi e drejta e rikthimit në punë nuk gëzon mbrojtje ligjore ndërsa e drejta e dëmshpërblimit është një e drejtë që gëzon mbrojtje konform dispozitave të Kodit të Punës.<sup>44</sup>*

Situata ndryshoi me hyrjen në fuqi të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i cili në nenin 2, parashikon se “ky ligj zbatohet për çdo nëpunës (në vazhdim “nëpunës civil”), që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore”. Më tej në nenin 4, pika 1, shkronja “b”, ligji shprehet se “Institucion i pavarur” është administrata e Kuvendit, e Presidentit, e pushtetit vendor, e Gjykatës Kushtetuese, e Gjykatës së Lartë, e Prokurorisë dhe çdo institucion i pavarur, i parashikuar në Kushtetutë apo i krijuar me ligj dhe që i raporton Kuvendit, përfshirë degët e tyre territoriale”. Pra, dukshëm nga formulimi i këtyre dy dispozitave rezulton se legjislatori ka dashur që edhe nëpunësit që kryejnë funksione administrative në Gjykatën Kushtetuese të trajtohen si nëpunës civilë. Në këtë drejtim lind e nevojshme që nenet 12, 13 dhe 14 të LGJK-së që flasin për emërimin, largimin dhe statusin e personelit të Gjykatës të ndryshohen për t’u përshtatur me ligjin e ri.

Sipas këtyre rregullimeve të reja dhe duke pasur në konsideratë faktin që marrëdhënia e shërbimit civil është marrëdhënie juridike e natyrës administrative,<sup>45</sup> atëherë rezulton se organi kompetent për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që mund të lindin midis nëpunësve të kësaj gjykate dhe vetë institucionit do të jetë gjykata administrative.<sup>46</sup> Në kundërshtim me këtë model

<sup>41</sup> LGJK, neni 13.

<sup>42</sup> LGJK, neni 14.

<sup>43</sup> LGJK, neni 12.

<sup>44</sup> Vendimi nr. 00-2011-2308 (572), datë 15.12.2011 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

<sup>45</sup> Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, neni 1, pika 2.

<sup>46</sup> LGJA, neni 7.

disa gjykata kushtetuese të vendeve të tjera, kanë kompetencën për të vendosur vetë në lidhje me ankesat e personelit të tyre dhe për mosmarrëveshjet që mund të lindin në marrëdhëniet e punës midis tyre dhe institucionit. Kjo mënyrë veprimi justifikohet me faktin e garancisë më të madhe për pavarësinë e institucionit dhe konsiderohet si çështje e juridiksionit të brendshëm.<sup>47</sup> Jam i mendimit që zgjidhja e aplikuar nga këto vende është më e saktë pasi nga njëra anë ruan pavarësinë e Gjykatës Kushtetuese dhe nga ana tjetër ruan edhe prestigjin e këtij institucioni.

## 2.4 Statusi i gjyqtarëve kushtetues.

Gjyqtari kushtetues gëzon një status të veçantë i cili synon që t'i garantojë atij një pavarësi të plotë në ushtrimin e funksioneve. Një nga garancitë e para është kohëzgjata e mandatit dhe mospërtëritja e tij. Mospërtëritja e mandatit konsiderohet një garanci pavarësie, sepse bën që gjyqtarët të mos kenë ndonjë interes të kërkojnë "dashamirësi ose favorizim" nga ana e autoritetit që ka në dorë emërimin ose zgjedhjen. Mospërtëritja e mandatit është rregull pothuajse në të gjitha vendet evropiane.<sup>48</sup>

Një tjetër garanci për gjyqtarin kushtetues është përcaktimi nga Kushtetuta i rasteve se kur mundet që të mbarojë parakohe mandati i tij. Kështu, sipas nenit 127 të Kushtetutës mandati i gjyqtarit kushtetues mund të mbarojë para kohe kur: a) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi; b) nuk paraqitet pa arsye në detyrë për më shumë se 6 muaj; c) mbush moshën 70 vjeç; ç) jep dorëheqjen; d) me vendim gjyqësor të formës së prerë deklarohet i paafte për të vepruar. Ndërsa neni 128 parashikon rastet dhe procedurën e shkarkimit të gjyqtarit kushtetues të cilat janë për shkelje të Kushtetutës, për kryerjen e një krimi, për paafte si mendore a fizike, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit. Po kështu edhe procedura që kërkohet në këtë rast, një vendimarrje prej dy të tretat e anëtarëve të Kuvendit e shoqëruar me vetë vendimarrjen e Gjykatës Kushtetuese e cila është përfundimtare, forcon më tej garancinë e gjyqtarit kushtetues.

Kushtetuta është kujdesur gjithashtu për ruajtjen e integritetit fizik të gjyqtarit kushtetues si edhe të banesës së tij nga kontrollet e autoriteteve shtetërore duke përcaktuar se kontrolle të tilla mund të kryhen vetëm me autorizimin e vetë Gjykatës. Nëse gjyqtari kushtetues arrestohet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi, Prokurori i Përgjithshëm vë menjëherë në dijeni Gjykatën Kushtetuese. Kur Gjykata Kushtetuese nuk jep pëlqimin brenda 24 orëve për dërgimin në gjykatë të gjyqtarit të arrestuar, organi kompetent është i detyruar ta lirojë atë.<sup>49</sup> Po kështu gjyqtari kushtetues gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrim të funksioneve të tij.<sup>50</sup>

Një tjetër garanci për gjyqtarin kushtetues është edhe ndalimi për të kryer veprimtari të tjera shtetërore, politike ose private.<sup>51</sup> Megjithatë, përvoja e aktuale ka treguar se nuk është konsideruar e ndaluar mësimdhënia në institucione të ndryshme të arsimit të lartë. Një tjetër element i garancisë së gjyqtarëve kushtetues është edhe garancia që parashikohet për të gjithë gjyqtarët e Republikës së Shqipërisë sipas së cilës paga dhe përfitimet e tjera të tyre nuk mund të ulen.<sup>52</sup>

<sup>47</sup> Teresi, Francesco, *"I giudizi della Corte Costituzionale"*, Shtëpia Botuese "Cacucci", Bari – Itali 2010, fq.229

<sup>48</sup> Omari, Luan; Anastasi, Aurela, *"E drejta kushtetuese"*, Shtëpia Botuese "ABC", Tiranë 2010, fq.436.

<sup>49</sup> Kushtetuta, neni 126.

<sup>50</sup> Po aty.

<sup>51</sup> Kushtetuta, neni 130.

<sup>52</sup> Kushtetuta, neni 138.



Përveç këtyre garancive të cilat detajohen më tej nga LGJK-ja rezulton se gjyqtarët kushtetues gëzojnë edhe një sërë privilegjesh të tjera. Kështu paga e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese është e barabartë me pagën e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, ndërsa paga e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese është 20 për qind më e lartë se paga e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Paga dhe përfitimet e tjera të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese nuk mund të ulen dhe as të preken.<sup>53</sup> Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese gëzojnë një mbrojtje të veçantë të vetes, familjes dhe pronës, kur një gjë të tillë kërkohet prej tyre për shkak të rrethanave serioze ose çmohet se është e domosdoshme. Organet përkatëse të ngarkuara me ruajtjen e personaliteteve të larta, janë të detyruara t'i përgjigjen çdo kërkesë të bërë në këtë drejtim. Ato përfitojnë leje të pagueshme vjetore 40 ditë e cila bëhet gjatë muajit gusht-shtator. Gjithashtu përfitojnë falas Fletoren Zyrtare, gazeta dhe revista juridike si edhe përfitojnë në mënyrë të barabartë po ato të drejta që gëzojnë deputetët, sipas statusit të tyre.<sup>54</sup> Në përfundim të mandatit, me përjashtim të rastit kur shkarkohet nga detyra sipas procedurave të përcaktuara në ligj, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese caktohet në një detyrë tjetër të barabartë ose të përafërt, si dhe përfiton pagesë kalimtare dhe/ose pension suplementar, sipas legjislacionit në fuqi.<sup>55</sup>

Përveç sa më sipër, gjyqtarët kushtetues, gëzojnë edhe një trajtim të veçantë protokollar. Në marrëdhëniet protokollare Kryetari i Gjykatës Kushtetuese vjen menjëherë pas Kryeministrit, ndërsa gjyqtarët e saj barazohen në trajtimin protokollar me ministrat. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese ftohen të marrin pjesë në delegacionet zyrtare, ceremonitë, pritjet dhe veprimtaritë e ndryshme të karakterit kulturor, shoqëror dhe sportiv, sipas protokollit të përcaktuar për këtë qëllim.<sup>56</sup> Këto detyrime ligjore detajohen më tej në Ceremonialin zyrtar të Republikës së Shqipërisë<sup>57</sup> ku mund të përmendim, dorëzimin e Kushtetutës së vendit që Kryetari i Gjykatës Kushtetuese i bën Presidentit të sapozgjedhur, në momentin që ai merr detyren,<sup>58</sup> rezervimin e një salle në aeroportin ndërkombëtar,<sup>59</sup> përcaktimin e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese si pjesë e grupit të parë të rangjeve zyrtare,<sup>60</sup> ndërsa në grupin e dytë janë anëtarët e Gjykatës Kushtetuese,<sup>61</sup> si edhe përcaktimin e vendit në rradhë të dytë të Kryetarit të Gjykatës në rastin e paradave jubilarë të Forcave të Armatosura.<sup>62</sup>

Të gjitha këto garanci dhe privilegje i japin mundësi gjyqtarit kushtetues që të ushtrojë në pavarësi të plotë funksionet e tij.

### 3. BURIMET NORMATIVE TË PROCESIT KUSHTETUTES.

Gjykata Kushtetuese është një institucion i cili ushtron aktivitet juridiksional të ngjashëm me aktivitetin që kryejnë gjykatat e zakonshme. Për të realizuar detyrën e saj Gjykata Kushtetuese kryen një aktivitet të gjerë procedural, aktivitet i cili duhet që të normohet nga

<sup>53</sup> LGJK, neni 17.

<sup>54</sup> Konkretisht të drejtat e parashikuara nga nenet 16 pika 1, 19, 20, 23, 25 dhe 26 të ligjit nr.8550, datë 18.11.1999 "Statusi i deputetit".

<sup>55</sup> LGJK, neni 18.

<sup>56</sup> LGJK, neni 19.

<sup>57</sup> Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.229, datë 23.04.2004 "Për miratimin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

<sup>58</sup> Po aty, pika 13.3.

<sup>59</sup> Po aty, Kapitulli V, pika 2.3.

<sup>60</sup> Po aty, Kapitulli VI, pika 1.

<sup>61</sup> Po aty, Kapitulli VI, pika 2.

<sup>62</sup> Po aty, Kapitulli VII, pika 7.

norma juridike për të qëndruar brenda kornizës së shtetit të së drejtës. Për këtë qëllim është miratuar edhe një ligj organik nga Kuvendi. Pavarësisht kësaj rezulton se normat juridike që rregullojnë procedurën e gjykimit kushtetues janë të shpërndara në shumë ligje të ndryshme, fakt ky i cili e bën të vështirë shpeshherë identifikimin e tyre në praktikë, mbi të gjitha kur një pjesë e mirë e zbatuesve të së drejtës (jurist, avokatë, gjyqtarë etj) kanë një konfuzion mbi natyrën e gjykimit kushtetues dhe dallimin e tij nga gjykimi i zakonshëm.

Identifikimi i burimeve normative dhe zbatimi me korrektësi i këtyre të fundit në një gjykim kushtetues është një detyrë e përbashkët e subjekteve procedurale, pjesëmarrësve në proces dhe vetë Gjykatës. Zbatimi i tyre nga palët ndihmon që çështja e tyre të jetë e suksesshme dhe për më tepër nuk rrezikon të rrezohet apo të shpallet e papranueshme për shkaqe procedurale. Zbatimi i tyre nga vetë Gjykata sjell si pasojë administrimin sa më të mirë dhe efektiv të drejtësisë kushtetuese.

Por siç mund të konstatohet normat procedurale kushtetuese janë shumë të shpërndara në akte të ndryshme juridike që janë edhe të niveleve të ndryshme në hierarkinë e normave. Njohja e tyre shpeshherë paraqitet problematike veçanërisht nga zbatuesit e së drejtës. Kjo ka sjellë në jo pak raste që çështja të mos kalojë për gjykim pikërisht sepse pretendimet nuk janë ngritur në mënyrën e duhur nga pikëpamja procedurale. Një tjetër problem është fakti se i gjithë ky korpus juridik është formuluar me terma të përgjithshme. Kjo situatë i ka dhënë mundësi Gjykatës Kushtetuese që të ketë një hapësirë të gjërë veprimi dhe për rrjedhojë të vendosë nëpërmjet jurisprudence së saj rregulla procedurale më të detajuara. Pra, zbatimi i normave procedurale që rregullojnë gjykimin kushtetues në situata konkrete është formalizuar nga Gjykata nëpërmjet precedentëve të saj.

Identifikimi i normave juridike sjell qartësi dhe siguri juridike në zbatimin e tyre. Ligjzbatuesit në rolin e pjesëmarrësit në proces apo vetë gjykata e kanë më të qartë terrenin juridik ku duhet të veprojnë dhe mënyrën se si duhet të veprojnë. Kjo është e rëndësishme veçanërisht për pjesëmarrësit në proces të cilët kanë më shumë mundësi që çështja e tyre të ketë sukses. Por normat e analizuar në mënyrë abstrakte mbeten shpeshherë të paplota dhe pa kuptim. Për këtë arsye shihet e nevojshme që jurisprudenca kushtetuese e cila ka sqaruar dhe detajuar më tej kuptimin e këtyre normave procedurale dhe zbatimin konkret të tyre të ketë kujdesin e duhur. Megjithatë nuk mundet që të lihet jashtë vëmendjes edhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e cila në disa raste, veçanërisht në kuadër të shqyrtimit të kërkesave për një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet vendimeve të saj ka detyruar gjykatat kushtetuese të vendeve anëtare, përfshirë edhe atë të Shqipërisë, që të ndryshojnë praktikën e tyre gjyqësore, madje edhe mënyrën e zbatimit të normave të tyre procedurale. Ky moment është veçanërisht i theksuar përse i përket normave procedurale që rregullojnë juridiksionin e gjykatave kushtetuese dhe në disa raste edhe mënyrën e marrjes së provave nga ana e tyre.

Me termin burim të së drejtës doktrina ka konsideruar çdo element, fakt ose akt, pavarësisht nga forma e tij, që përmban një rregull të detyrueshëm për anëtarët e një shoqërie të caktuar.<sup>63</sup> Këto burime për shkak të formës, nivelit të hierarkisë, prejardhjes dhe natyrës mund të ndahen në burime formale, burime materiale, burime të brendshme dhe ndërkombëtare, burime parësore dhe burime dytësore. Në kontekstin e këtij punimi do të trajtohen të gjitha këto lloje burimesh për drejtësinë kushtetuese. Nëse do t'i marrim në nivel hierarkik, duke i qëndruar mënyrës së formulimit të nenit 116 të Kushtetutës, këto burime janë, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore, legjislacioni

<sup>63</sup> Omari, Luan; Anastasi, Aurela; "E drejta kushtetuese", Shtëpia Botuese "ABC", Tiranë 2010, fq.14.

organik i Gjykatës Kushtetuese dhe ligjet e tjera plotësuese dhe në fund Rregullorja e Gjykatës Kushtetuese. Këto burime janë burime formale pasi paraqiten në formë të shkruar dhe kanë fuqi detyruese të përgjithshme. Por përveç këtyre nga doktrina njihen edhe burimet materiale të cilat në rastin tonë janë jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe jurisprudenca e GJEDNJ.

Nga tërësia e tyre, Kushtetuta dhe sipas mendimit tim, për shkak të parashikimit të nenit 17, pika 2 të Kushtetutës, edhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, janë burime parësore për procesin kushtetues. Pavarësisht kësaj këto burime dallojnë nga njëri – tjetri pasi i pari është burim i brendshëm, ndërsa i dyti, për shkak të natyrës që ka Konventa, e cila është një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar, është burim ndërkombëtar. Mbas këtyre burimeve në hierarki vijnë burimet e tjera normative të cilat bashkërisht me ato parësore po i trajtomë në vijim.

### **3.1 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.**

Kushtetuta është miratuar nga Kuvendi Popullor me ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 dhe me referendum popullor më datë 22.11.1998. Ajo ka hyrë në fuqi me shpalljen e saj nga Presidenti i Republikës me Dekretin nr.2260, datë 28.11.1998. Kushtetuta është amenduar më pas me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007, me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008 dhe së fundi me ligjin nr.88, datë 18.9.2012. Kushtetuta, si ligji me fuqinë më të lartë në vend,<sup>64</sup> e ka parashikuar Gjykatën Kushtetuese në nenet 124-134 të saj. Në këto dispozita janë përcaktuar emërimi i gjyqtarëve kushtetues, garancitë kushtetuese për statusin e tyre, është përcaktuar juridiksioni i kësaj gjykate, subjektet që mund ta vënë në lëvizje atë etj. Pra, Gjykata Kushtetuese është një institucion që ka fituar personalitet juridik për shkak të parashikimit në vetë aktin themelor të vendit.

Përveç dispozitave kushtetuese që rregullojnë krijimin e këtij institucioni, vetë Kushtetuta ka parashikuar edhe dispozita të shumta juridiko-kushtetuese, që kanë të bëjnë si me përcaktimin e kompetencës së Gjykatës Kushtetuese ashtu edhe me rregulla procedurale.<sup>65</sup> Në 13 prej këtyre dispozitave parashikohet kompetenca lëndore e Gjykatës Kushtetuese, pra mundësia e saj për të vendosur për çështje që janë përcaktuar qartë në Kushtetutë. Në 11 prej tyre përcaktohet edhe subjekti që mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Ndërsa 2 dispozita të tjera, përcaktojnë rregullat ngushtësisht procedurale për gjykimin kushtetues.

Në përgjithësi mund të themi që kemi një rregullim mëse të mjaftueshëm në Kushtetutë përse i përket normave procedurale kushtetuese.

### **3.2 Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.**

Nisur nga rëndësia, një burim që ka lidhje me procedurat kushtetuese është **Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore**, veçanërisht neni 6 i saj. Kjo dispozitë që specifikon procesin e rregullt, parashikon rregulla që janë të zbatueshme edhe në gjykimet kushtetuese. Këtu zë vend të rëndësishëm jurisprudenca e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila në disa vendime ka përcaktuar se deri ku shtrihet zbatueshmëria e nenit 6 të Konventës në gjykimet kushtetuese.

<sup>64</sup> Kushtetuta, neni 4, pika 2.

<sup>65</sup> Nëse mund të bëjmë një listë shteruese këto dispozita janë nenet 70, 90, 91, 115, 124, 126, 127, 128, 131, 132, 133, 134, 137, 140, 145, 152 dhe 180 të Kushtetutës.



Zbatueshmëria e nenit 6 të KEDNJ-së ndaj procesit kushtetues ka qenë një çështje që ka krijuar shumë debat në jurisprudencën e GJEDNJ-së. Kështu në çështjen *Ortenberg – Austria*, GJEDNJ mbajti qëndrimin se gjykata kushtetuese nuk mund të konsiderohet “tribunal”, sepse nuk përcakton të gjitha faktet kryesore të çështjes.<sup>66</sup>

Në këtë drejtim GJEDNJ nuk ka mbajtur një qëndrim të qartë në lidhje me faktin nëse të gjitha garancitë e nenit 6 të Konventës janë të zbatueshme edhe për gjykatat kushtetuese. Disa shtete që janë palë në Konventë nuk e kanë konsideruar nenin 6 të zbatueshëm, pasi, në këndvështrimin e tyre procedurat përpara gjykatave kushtetuese nuk bien brenda nocionit të “të drejtave dhe detyrimeve të tij civile”. Ky qëndrim është mbajtur edhe nga komisioni në çështjet e tij të para dhe nga GJEDNJ në çështjen *Buchholz*.<sup>67</sup> Në disa çështje të tjera GJEDNJ ka mbajtur qëndrimin se një gjykatë kushtetuese duhet të veprojë në përputhje me standardet e përcaktuara në nenin 6 të Konventës, përsa i përket dhënies së vendimit “brenda një afati të arsyeshëm”.<sup>68</sup> Një konkluzion i ngjashëm u arrit nga GJEDNJ në çështjen *Ruiz-Mateos*<sup>69</sup> përsa i përket parimit të barazisë së armëve dhe në çështjen *Krémár* përsa i përket të drejtës për t’u dëgjuar.<sup>70</sup> Në çështjen *Ruiz-Mateos* qeveria Spanjolle (e mbështetur edhe nga qeveritë Gjermane dhe Portugeze që ndërhyjnë në këtë gjykim), shprehimisht argumentuan se neni 6, pika 1 nuk zbatohet në procedurat përpara gjykatave kushtetuese. GJEDNJ-ja pranoi që procedurat përpara gjykatave kushtetuese kanë karakteristikat e tyre, por megjithatë, konstatoi se pavarësisht këtij parashikimi, neni 6 ishte cënuar. Duke vepruar në këtë mënyrë GJEDNJ-ja në mënyrë të shprehur rrëzoi mënyrën e arsyetimit të paraqitur nga qeveria Spanjolle. Ky rast u confirmua në çështjet *Pammel* dhe *Pierre-Bloch* ku sipas GJEDNJ “fakti që procedurat janë zhvilluar përpara një gjykate kushtetuese nuk është argument i mjaftueshëm për ta konsideruar çështjen jashtë zbatimit të nenit 6/1”.<sup>71</sup> Në gjykimet e tjera GJEDNJ-ja duket sikur orientohet më shumë nga drejtimi për të pranuar ankesa të tilla. Në shkurt të vitit 2000, në çështjen *Gast & Popp*, GJEDNJ-ja u shpreh se “procedurat përpara gjykatave kushtetuese parimisht nuk janë jashtë qëllimit të nenit 6/1 të Konventës”.<sup>72</sup>

Në mars të vitit 2000 GJEDNJ-ja formuloi pikëpamjen e saj në një mënyrë më të qartë duke deklaruar se “për më tepër, sipas precedentëve të Gjykatës, neni 6 pika 1 zbatohet në procedurat përpara Gjykatave Kushtetuese”.<sup>73</sup>

Nga sa më sipër me të drejtë mund të themi se procedurat e gjykatave kushtetuese konsiderohen se janë brenda qëllimit të zbatimit të nenit 6 të KEDNJ-së. Megjithatë, ato gëzojnë një status të posaçëm. Si shembull shërben çështja *Süssmann*. Süßmann u ankua për kohëzgjatjen e procedurave përpara Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane. Süßmann depozitoi një ankim në të njëjtën kohë me një ankim të ish-nëpunësve civile të Republikës Demokratike Gjermane, të cilët kundërshtonin një parashikim të Traktatit mbi Bashkimin e Gjermanisë, sipas të cilit kontratat e punës për rreth 300.000 persona konsideroheshin të zgjidhura. Në këtë rast GJEDNJ u shpreh se:

<sup>66</sup> Shih Kuijer, Martin, *Applicability of Article 6 ECHR*, material i marrë nga interneti në adresën elektronike [www.bilhr.org/media/documents/Applicability\\_of\\_Article\\_6.doc](http://www.bilhr.org/media/documents/Applicability_of_Article_6.doc), fq.19 (parë për herë të fundit më datë 4.8.2013)

<sup>67</sup> GJEDNJ, çështja “*Buchholz kundër Gjermanisë*”, datë 6 maj 1981, parag.48.

<sup>68</sup> GJEDNJ, çështja “*Bock kundër Gjermanisë*”, datë 29 mars 1989, parag.37. Shih gjithashtu edhe GJEDNJ, çështja “*Gast dhe Popp kundër Gjermanisë*”, aplikimi nr.29357/95, datë 25 shkurt 2000, parag.69 dhe GJEDNJ, çështja “*Klein kundër Gjermanisë*”, aplikimi nr.33379/96, datë 27 korrik 2000 parag.27.

<sup>69</sup> GJEDNJ, çështja “*Ruiz-Mateos kundër Spanjës*”, datë 23 qershor 1993, parag.63.

<sup>70</sup> GJEDNJ, çështja “*Krémár kundër Çekisë*”, aplikimi nr. 35376/97, datë 3 mars 2000, parag.45.

<sup>71</sup> GJEDNJ, çështja “*Pammel kundër Gjermanisë*”, datë 1 korrik 1997, para.53 dhe GJEDNJ, çështja “*Pierre-Bloch kundër Francës*”, datë 21 tetor 1997, parag.48.

<sup>72</sup> GJEDNJ, çështja “*Gast dhe Popp kundër Gjermanisë*”, aplikimi nr.29357/95, datë 25 shkurt 2000, parag. 64.

<sup>73</sup> GJEDNJ, çështja “*Krémár kundër Çekisë*”, aplikimi nr.35376/97, datë 3 mars 2000, parag.36.

...roli si garante e Kushtetues e bën veçanërisht të nevojshme për një Gjykatë Kushtetuese që ndonjëherë të marrë në konsideratë interesa të tjera sesa thjesht vendin kronologjik mbi bazën e të cilave janë regjistruar çështjet në listë, si natyra e çështjes dhe rëndësia sipas kushteve politike dhe sociale... duke pasur në konsideratë kontekstin e vetëm politik të bashkimit të Gjermanisë dhe pasojat serioze shoqërore që kanë mosmarrëveshjet në lidhje me zgjidhjen e kontratave të punës, Gjykata Kushtetuese Federale kishte të drejtë të vendoste për t'u dhënë përparësi këtyre rasteve...<sup>74</sup>

Si konkluzion, gjykatat kushtetuese duhet të kenë në konsideratë kërkesat thelbësore të nenit 6, pika 1 të KEDNJ në parim, por kanë një hapësirë të gjerë vlerësimi. Ky diskrecion i bazuar në rolin dhe statusin e veçantë të gjykatave kushtetuese, duhet marrë në konsideratë me të drejtën për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, të drejtën për një gjykim publik dhe në disa raste të lidhura me mënyrën e marrjes së provave. Megjithatë ky diskrecion nuk mund të shtrihet edhe përsa i përket parimit të paanshmërisë. Mungesa e paanshmërisë do të cënonte thelbin e gjykimit të drejtë duke cënuar besimin e publikut në administrimin e drejtësisë.<sup>75</sup>

Nga sa më sipër rezulton se neni 6 nuk zbatohet përpara gjykatave kushtetuese, kur ato nuk mund të vendosin mbi themelin e një rasti konkret dhe që janë të lidhura vetëm me të drejta kushtetuese dhe të vendosin mbi pajtueshmërinë me kushtetutën kombëtare të një ligji të brendshëm (*Valasinas kundër Lituanisë dhjetor 2000*). Por neni 6 zbatohet në procedurat kushtetuese kur vendimi i Gjykatës Kushtetuese prek zgjidhjen e një çështje ndaj së cilës neni 6 gjen zbatim (*Deumeland v Germany (1986)*).<sup>76</sup>

Në jurisprudencën e saj GJEDNJ, ka ndërhyrë edhe në procedurat që janë zhvilluar para Gjykatës sonë Kushtetuese. Si shembuj mund të përmendim çështjet *Qufaj kundër Shqipërisë*,<sup>77</sup> *Marini kundër Shqipërisë*<sup>78</sup> dhe *Shkalla kundër Shqipërisë*<sup>79</sup> ku GJEDNJ ka gjetur shkelje të nenit 6 të Konventës, për shkak të procedurave që kishte ndjekur Gjykata jonë Kushtetuese në trajtimin e këtyre çështjeve. Në rastin e parë GJEDNJ ka përcaktuar se Gjykata Kushtetuese ka cënuar të drejtën e aksesit në gjykatë nëpërmjet refuzimit të saj për të marrë në shqyrtim ankesat për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Ky qëndrim i GJEDNJ-së u reflektua më vonë në jurisprudencën kushtetuese. Përsa i përket rastit të dytë, çështja *Marini*, Gjykata jonë Kushtetuese u konsiderua në shkelje të parimit të sigurisë juridike për shkak të paaftësisë së saj për të marrë vendim, që erdhi si rezultat i barazisë së votave. Edhe ky vendim ndërhyr në procedurat e Gjykatës Kushtetuese, por deri më sot legjislacioni përkatës nuk është ndryshuar dhe fatkeqësisht Gjykata jonë vazhdon ende të vendosë për refuzimin e çështjes. Përsa i përket vendimit të tretë GJEDNJ gjeti shkelje të së drejtës për akses në gjykatë për shkak të mënyrës se si Gjykata jonë Kushtetuese kishte përllogaritur afatin dy vjeçar. Në këtë rast Gjykata

<sup>74</sup> GJEDNJ, çështja "*Süssmann kundër Gjermanisë*", datë 16 shtator 1996, parag.38-46.

<sup>75</sup> Kujer, Martin, *Applicability of Article 6 ECHR*, material i marrë nga interneti në adresën elektronike [www.blhr.org/media/documents/Applicability\\_of\\_Article\\_6.doc](http://www.blhr.org/media/documents/Applicability_of_Article_6.doc), fq.23-25.

<sup>76</sup> Shih: INTERIGHTS MANUAL - RIGHT TO A FAIR TRIAL UNDER THE EUROPEAN CONVENTION ON HUMAN RIGHTS (ARTICLE 6), Viti 2009, marrë në internet nga adresa elektronike [www.interights.org/files/.../INTERIGHTS%20Article%206%20Manual.pdf](http://www.interights.org/files/.../INTERIGHTS%20Article%206%20Manual.pdf), fq.18 (parë për herë të fundit me datë 18.8.2013).

<sup>77</sup> GJEDNJ, vendimi i Dhomës së Tretë, aplikimi nr.54268/00, çështja "*Qufaj Co. sh.p.k. kundër Shqipërisë*", datë 18 nëntor 2004.

<sup>78</sup> GJEDNJ, vendimi i Dhomës së Katërt, aplikimi nr. 3738/02, çështja "*Marini kundër Shqipërisë*", datë 18.12.2007.

<sup>79</sup> GJEDNJ, vendimi i Dhomës së Katërt, aplikimi nr.26866/05, çështja "*Shkalla kundër Shqipërisë*", datë 10.5.2011.

Kushtetuese nuk kishte marrë në konsideratë faktin se dita e fundit e ankimit ishte ditë pushimi, dhe për rrjedhojë ky afat shtyhej për ditën pasardhëse të punës.

### 3.3 Legjislacioni i brendshëm.

Legjislacioni i brendshëm, i cili për nga rëndësia e tij është me natyrë dytësore në raport me aktet e mësipërme, përbëhet nga ligji organik i Gjykatës Kushtetuese dhe ligje të tjera plotësuese, të cilat mbulojnë boshllëqet që ka ligji organik. Më konkretisht këto akte janë:

a – **Ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.**<sup>80</sup> Qëllimi i këtij ligji është përcaktuar që në nenin 1, pika 1 ku parashikohet se “ky ligj përcakton rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Gjykatës Kushtetuese, statusin e gjyqtarit, paraqitjen e kërkesave dhe shqyrtimin e tyre, parimet dhe rregullat e gjykimit kushtetues, marrjen e vendimeve dhe ekzekutimin e tyre”. Nga formulimi i kësaj dispozite, rezulton qartë se ky ligj është burimi kryesor i detajuar që rregullon në mënyrë të plotë të gjithë procesin kushtetues në tërësinë e tij. Ky ligj është i ndarë në nëntë krerë me një total prej 88 nenesh.<sup>81</sup> Në hartimin e këtij ligji kanë kontribuar anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, deputetë, specialistë të Ministrisë së Reformës Institucionale, ekspertë të Komisionit të Venecias. Si modele janë përdorur legjislacioni respektiv i Polonisë, Gjermanisë, Sllovenisë, Italisë, Maqedonisë, Hungarisë etj. Diskutimi dhe hartimi i tij ka zgjatur mbi një vit derisa më në fund u miratuar nga Kuvendi.<sup>82</sup>

Nga mënyra se si është strukturuar, ky ligj rregullon bazat e veprimtarisë procedurale të Gjykatës Kushtetuese, megjithëse rregullimi që bën ky ligj nuk është shterues. Në këtë drejtim duket sikur ligjvënësi është treguar i kursyer, duke parashikuar vetëm dispozitat që janë karakteristike për këtë lloj gjykimi, të cilat qëndrojnë në thelb të tij, ndërsa për sa i përket procedurave të tjera që nuk rregullohen nga ky ligj, legjislatori në nenin 1 pika 2 të ligjit, ka parashikuar se “për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj, Gjykata Kushtetuese merr parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes”.

Ky parashikim kushtetues na tregon se ekzistojnë edhe akte të tjera normative që rregullojnë veprimtarinë procedurale të Gjykatës Kushtetuese dhe që duhet të merren në konsideratë në gjykimin kushtetues. Këto dispozita do t’i konsiderojmë si burime dytësore, pasi janë legjislacion plotësues i akteve të mësipërme.

b – Një nga këto burime që zë vend të rëndësishëm në kategorinë e burimeve dytësore është **Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.**<sup>83</sup> Në pjesën më të madhe të rasteve ky është ligji plotësues që zbaton Gjykata Kushtetuese në veprimtarinë e saj përkrah ligjit të saj organik. Nga Kodi i Procedurës Civile janë përdorur dispozitat për bashkimin apo ndarjen e çështjeve, rregullat për përlogaritjen e afateve procedurale, njoftimi, pushimi i çështjeve etj.

<sup>80</sup> Ky ligj shfuqizoi ligjin e mëparshëm nr.8373, datë 15.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

<sup>81</sup> LGJK, ndahet në këto krerë: **Kreu I: Dispozita të Përgjithshme (nenet 1-6); Kreu II: Organizimi i Gjykatës Kushtetuese (nenet 7-15); Kreu III: Statusi i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese (nenet 16-19); Kreu IV: Parimet e gjykimit kushtetues (nenet 20-26); Kreu V: Paraqitja dhe shqyrtimi paraprak i kërkesës (nenet 27-31); Kreu VI: Funksionimi i Gjykatës Kushtetuese (nenet 32-48); Kreu VII: Procedurat e veçanta (nenet 49-71); Kreu VIII: Vendimet e Gjykatës Kushtetuese (nenet 72-81); Kreu IX: Dispozita kalimtare dhe të fundit (nenet 82-88).**

<sup>82</sup> Abdiu, Fehmi, “Kushtetuta dhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë”, Shtëpia Botuese Redona 2001, Tiranë, Dhjetor 2000, fq.20-26.

<sup>83</sup> Miratuar me ligjin nr.8116, datë 29.03.1996, i ndryshuar.



c – Një burim tjetër dytësor që është përdorur nga Gjykata Kushtetuese në veprimtarinë e saj (ndonëse më rrallë se K.Pr.C.), është **Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë**.<sup>84</sup> Ky akt rezulton të jetë përdorur në rastin e bashkimit të çështjeve që kanë pasur si objekt shkeljen e të drejtave për një proces të rregullt ligjor me karakter penal, si edhe në rastin e përcaktimit të mënyrës së marrjes së provave.

ç – Për disa nga llojet e gjykimit kushtetues burim normativ për procesin kushtetues është **Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar**. Ky ligj merr rëndësi si burim për shkak të parashikimit të nenit 131, shkronja “e” e Kushtetutës, ku sipas së cilës, Gjykata Kushtetuese ka të drejtë që të verifikojë zgjedhjen e deputetëve. Për realizimin e kësaj kompetence, e cila nuk ka gjetur zbatim që pas zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2001, është e nevojshme që Gjykata Kushtetuese të bazohet edhe në kuadrin ligjor që rregullon zgjedhjet në përgjithësi.

d – Si burim normativ për procesin kushtetues është edhe **Ligji nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” dhe konkretisht pjesa e Nëntë e tij me titull “Referendumet”**. Kjo pjesë e Kodit Zgjedhor “të vjetër”, e cila është ende në fuqi<sup>85</sup> përmban rregullime ligjore që kanë të bëjnë me procedurat që duhen ndjekur edhe nga Gjykata Kushtetuese përsa i përket zhvillimit të llojeve të ndryshme të referendumeve, veçanërisht nenet 123, 124 dhe 129 të tij.

dh – Së fundmi mund të përmendim edhe **Ligjin nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”**.<sup>86</sup> Dispozitat e këtij ligji relativisht të ri, megjithëse në vetvete rregullojnë aktivitetin e gjykatave administrative, në këndvështrimin tim, mund të rregullojnë edhe procesin kushtetues, të paktën për disa lloje gjykimesh. Kështu nga tërësia e kompetencave të saj rezulton se objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese janë edhe aktet administrative. Për ta konkretizuar më mirë mund të përmendim, kompetencën e gjykatës për të gjykuar vendimet e Kuvendit për shkarkimin e Presidentit, anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, vendimin e Kuvendit për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, vendimin e Këshillit të Ministrave për shkarkimin apo shpërndarjen e organeve vendore të zgjedhura drejtpërsëdrejti. Duke qenë përpara kësaj situatë jemi të mendimit që disa parashikime, si p.sh. gjykata vendos rrëzimin e padisë dhe kur vlerëson se pavarësisht shkeljeve procedurale të konstatuara të veprimtarisë administrative, pasojat do të ishin të njëjta,<sup>87</sup> mund të gjejë zbatim si parim edhe në ato raste kur nga organet proceduese si Kuvendi apo Këshilli i Ministrave ka pasur shkelje procedurale. Megjithatë, zbatueshmëria e këtij ligji në gjykimin kushtetues mbetet ende një çështje për debat dhe deri më sot nuk kemi pasur raste konkrete që të verifikojmë zbatueshmërinë e këtij ligji në praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

### 3.4 Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese.

Praktika kushtetuese ose më mirë precedentët e saj janë një tjetër burim i rëndësishëm për veprimtarinë procedurale të Gjykatës Kushtetuese. Nëpërmjet vendimeve të saj, Gjykata Kushtetuese, i jep kuptimin e duhur normave kushtetuese dhe ligjore që ajo duhet të zbatojë në

<sup>84</sup> Miratuar me ligjin nr.7905, datë 21.03.1995, i ndryshuar.

<sup>85</sup> Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 185.

<sup>86</sup> Referuar parashikimit të nenit 70 pika 5 të ligjit nr.49/2012 dhe Dekretit të Presidentit të Republikës nr.8349, datë 14.10.2013, neni 1, ky ligj ka filluar efektet e tij me datë 4.11.2013.

<sup>87</sup> LGJA, neni 40, pika 3.

veprimtarinë e saj. Kështu normat abstrakte që rregullojnë procesin kushtetues, marrin “jetë” dhe bëhen të aplikueshme në raste dhe situata konkrete.

Pavarësisht se është theksuar vazhdimisht në doktrinën juridike shqiptare se në sistemin e burimeve, por edhe në sistemin hierarkik të normave juridike, precedenti nuk parashikohet dhe si i tillë nuk është burim i së drejtës, personalisht ndaj një mendim të ndryshëm.

Në thelb të tij, precedenti është një zgjidhje e dhënë nga një gjykatë, zgjidhje e cila është e detyrueshme për t’u ndjekur në çështje të tjera të ngjashme. Duke qenë se në zgjidhjen e konflikteve të ndryshme që mund të lindin midis organeve shtetërore, por edhe midis atyre dhe shtetasve, fjalën e fundit e ka pushteti gjyqësor, atëherë kjo zgjidhje e dhënë nga gjykata bëhet detyruese edhe për organet administrative, për shkak se ato janë të detyruara që sjelljen e tyre ta modifikojnë tashmë në përputhje me qëndrimin që ka mbajtur gjykata. Në thelb ky është zbatimi i parimit *stare decisis*, parim i cili është i lidhur ngushtësisht me natyrën e precedentit.

Precedenti shfaqet në dy forma, në formën horizontale dhe në atë vertikale. Në formën e tij horizontale kemi të bëjmë me precedentë të cilët ndiqen nga gjykata që e ka dhënë atë, ndërsa në formën vertikale gjykatat më të ulëta janë të detyruara që të ndjekin precedentët e vendosur nga gjykatat më të larta. Në rast të një konflikti midis tyre prevalojnë precedentët e dhënë nga gjykatat më të larta. Një gjykatë mund ta ndryshojë precedentin e dhënë më parë prej saj, por kurrësesi nuk mundet që të ndryshojë precedentin e dhënë nga një gjykatë më e lartë.

Nëse i referohemi Kushtetutës së Shqipërisë konstatojmë se në asnjë dispozitë të saj nuk përmendet fjala “precedent”. Neni 116 i Kushtetutës në listimin e akteve normative që kanë fuqi juridike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë nuk e përmend precedentin si akt. Gjithashtu neni 124, pika 2 i Kushtetutës thekson se Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës, ndërsa neni 145, pika 1 përcakton se gjykatat e zakonshme i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Po kështu, po të vërejmë dispozitat e tjera kushtetuese, nuk rezultojnë që precedentit të parashikohet shprehimisht si burim.

Kjo analizë e shkurtër të krijon përshtypjen se pikëpamjet tradicionaliste në lidhje me precedentin në Shqipëri janë juridikisht, të justifikuar. Megjithatë jam i mendimit se një analizë më e kujdesshme e dispozitave kushtetuese do të na çonte në një përfundim të ndryshëm.

Kështu, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si shumë kushtetuta në botë, është në formë të shkruar dhe të kodifikuar. Duke qenë një fushë e cila rregullohet nga një akt i vetëm është e nevojshme që të merret në konsideratë fakti se dispozitat e një akti të tillë nuk mundet që të interpretohen të shkëputura nga njëra-tjetra, por duhet të interpretohen të lidhura me njëra-tjetrën, pra Kushtetuta është një akt i cili interpretohet në tërësi. Për rrjedhojë, aktet normative të renditura në nenin 116 të Kushtetutës nuk janë të vetmet të parashikuara prej saj. Kështu, jurisprudenca kushtetuese, por edhe doktrina kanë identifikuar edhe akte të tjera të cilat kanë fuqi të përgjithshme.

Nga një vështrim i kujdesshëm i Kushtetutës, sipas nenit 132 të ligji themelor,<sup>88</sup> rezultojnë këta elementë:

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme;
2. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare;
3. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare;

<sup>88</sup> Kushtetuta, neni 132: 1. *Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Gjykata Kushtetuese ka vetëm të drejtën e shfuqizimit të akteve që shqyrton.* 2. *Vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare. Gjykata Kushtetuese mund të vendosë që ligji ose akti tjetër normativ të shfuqizohet në një datë tjetër. Mendimi i pakicës botohet bashkë me vendimin.*

4. Në vendimin e saj Gjykata Kushtetuese mund të përcaktojë që ligji ose akti tjetër normativ të shfuqizohet në një datë tjetër.

Nga krahasimi i përmbajtjes së kësaj dispozite me dispozita të tjera dhe veçanërisht me nenet 84 dhe 117 të Kushtetutës, rezulton se vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi në të njëjtën mënyrë që hyjnë në fuqi edhe ligjet apo aktet e tjera normative, pra me publikimin e tyre në Fletoren Zyrtare. Gjithashtu është parim i njohur tashmë, që aktet normative kanë fuqi detyruese të përgjithshme, karakteristikë që sipas nenit 132 e kanë edhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Duke përfunduar arsyetimin mendoj se nga krahasimi i mësipërm, rezulton qartë se vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë të gjitha karakteristikat e një ligji. Por, duke qenë se ligje, në kuptimin formal të fjalës mund të cilësohen vetëm aktet normative me fuqi të përgjithshme, të miratuara nga Kuvendi, atëherë i vetmi emërtim që mund t'u jepet vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është ai i *precedentit*. Në jurisprudencën e saj Gjykata Kushtetuese është shprehur se:

*...Zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i garantuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila në nenin 132 dhe 145 të saj sanksionon shprehimisht këtë koncept kushtetues. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit...*

*...Prandaj jurisprudencë kushtetuese përbën çdo vendim i Gjykatës Kushtetuese...<sup>89</sup>*

Nga pasazhet e mësipërme, rezulton se Gjykata Kushtetuese, për të shmangur debatin që mund të lindte, qëllimisht përdor termin jurisprudencë dhe jo precedent. Por nga mënyra se si është shprehur, konkluzioni i saj është një dhe i vetëm, vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë precedentë.

Kështu Gjykata ka theksuar se vendimet e saj janë detyruese për të gjitha organet e tjera shtetërore dhe kanë forcën e ligjit. Vendimet e kësaj Gjykate janë të detyruara t'i zbatojnë jo vetëm gjykatat e zakonshme dhe organet e ndryshme administrative, por edhe Kuvendi si organi i vetëm ligjvënës në vend. Parimisht Kuvendi nuk mundet që një normë, apo ligj të shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese si të papajtueshëm me aktin themelor në vend, ta miratojë përsëri pavarësisht ndryshimeve në formë që mund t'i bëjë aktit të ri. Kjo për faktin se Gjykata Kushtetuese ka të drejtë të mbajë të njëjtin qëndrim, duke e shfuqizuar përsëri normën e re të miratuar nga parlamenti.<sup>90</sup> Të njëjtin qëndrim mban edhe jurisprudenca kushtetuese gjermane. Kështu Senati i Dytë i kësaj Gjykate, me vendimin e datës 23.10.1951 është shprehur se:

*...një vendim që shpall një ligj të pavlefshëm, jo vetëm që ka fuqinë e ligjit (31 parag. 2 BVerfGG), por në bazë të 31 parag. 1 BVerfGG, i detyron të gjitha organet kushtetuese federale, që bazuar në pjesën arsyetuese të vendimit, të mos miratojnë përsëri një ligj federal me të njëjtën përmbajtje.<sup>91</sup>*

<sup>89</sup> Vendimi nr. 5, datë 7.2.2001 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>90</sup> Një një rast "ekstrem" Gjykata Kushtetuese u shpreh për konstatimin e pavlefshmërisë konstitucionale të disa amendamenteve kushtetuese, me arsyetimin se Kuvendi duhet t'i bindej një vendimi të mëparshëm të kësaj Gjykate. Më shumë shih Vendimin nr.57, datë 5.12.1997 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>91</sup> BVerfGE 1, 14, "Vendime të Përzgjedhura të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane", botim i Fondacionit "Konrad Adenauer", Shtëpia Botuese "Vinsent-Grafika", Shkup 2010, faqe 48.

Së fundi në jurisprudencën e saj Gjykata Kushtetuese ka pranuar që t'i konsiderojë precedentë vendimet e saj duke mbajtur këtë qëndrim:

*Ky efekt detyruës ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Në respekt të doktrinës dhe të jurisprudencës kushtetuese, Gjykata thekson se efekti detyruës që pasqyrohet mbi argumentet thelbësore të vendimit të saj përbëjnë edhe një 'ratio decidendi', eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë. Nga kjo pikëpamje, Gjykata thekson se nga standardi i detyrueshmërisë së zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vetë Gjykata Kushtetuese.*

*Çdo ndryshim i "precedentëve të Gjykatës Kushtetuese apo korrigjim i doktrinës kushtetuese zyrtare nuk mund të bëhet mbi bazën e faktorëve të rastit, siç mund të jetë edhe ndryshimi i përbërjes së saj".<sup>92</sup>*

Nga analiza tërësore e dispozitave kushtetuese, jurisprudencës së kësaj gjykate, por edhe praktikave të huaja, rezulton qartë se vendimet e Gjykatës Kushtetuese, duke pasur tiparet e një precedenti, kanë forcën e ligjit dhe si të tilla janë të detyrueshëm për të gjithë organet dhe subjektet e tjera, si dhe për vetë Gjykatën Kushtetuese. Këto vendime kanë fuqi juridike normative, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pra e thënë ndryshe, përbëjnë precedent.

### **3.5. Rregullorja e Gjykatës Kushtetuese.**

Burimi i fundit që mund të citojmë është Rregullorja e Brendshme mbi gjykimin kushtetues dhe funksionimin e administratës, e miratuar me vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve. Ky akt ka hyrë në fuqi më datën 15.6.2009 dhe është i përbërë nga 32 nene dhe është i ndarë në dy pjesë. Sipas nenit 1, pika 1, gërma "a" të kësaj rregullore rezulton se objekti i pjesës së parë është përcaktimi i rregullave të hollësishme lidhur me kontrollin kushtetues duke përfshirë: pranimin administrativ të kërkesave, shqyrtimin paraprak të tyre, mënyrën e funksionimit dhe vendimmarrjes së kolegjeve dhe Mbledhjes së Gjyqtarëve në këtë proces, rregulla të posaçme të gjykimin kushtetues si dhe marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese e publikimin e tij.

Kjo rregullore përcakton edhe rregulla procedurale, veçanërisht ato rregulla që kanë të bëjnë me veprimtarinë procedurale të Gjykatës Kushtetuese gjatë shqyrtimit të një kërkesë në të gjitha fazat e saj. Hartimi i rregullave procedurale nga vetë Gjykata Kushtetuese, konsiderohet nga doktrina e huaj si element i domosdoshëm, pa të cilin do të vihej në rrezik autonomia dhe pavarësia e kësaj gjykate kundrejt ligjvënësit për faktin se, baza e pushtetit rregullues të kësaj gjykate, do të ishte vetëm ligji i zakonshëm.<sup>93</sup> Për ta argumentuar arsyetimin e mësipërm i referohemi Italisë, ku rezulton se është vetë ligji organik i Gjykatës Kushtetuese Italiane që e autorizon këtë institucion të ketë pushtetin për të vendosur rregulla procedurale në lidhje me gjykimin kushtetues dhe kjo rregullore duhet që të publikohet në Gazetën Zyrtare.<sup>94</sup>

<sup>92</sup> Vendimi nr.21, datë 29.4.2010 i Gjykatës Kushtetuese, parag.16.

<sup>93</sup> Zagrebelesky, Gustavo; Marceno, Valerio. "Giustizia costituzionale". Shtëpia Botuese "Il Mulino". Bologna 2012, fq.138

<sup>94</sup> Ligji nr.87 i vitit 1953, nenet 14 dhe 22.



Në rastin e Gjykatës Kushtetuese Shqiptare, ligji organik e parashikon rregulloren e kësaj Gjykate në dy raste dhe me konkretisht sipas nenit 13, gërma "d", Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese ka si kompetencë që të miratojë rregulloren e brendshme për veprimtarinë e administratës së Gjykatës Kushtetuese, ndërsa sipas nenit 14, pika 5, të drejtat dhe detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm dhe të nëpunësve e punonjësve të tjerë të shërbimeve përcaktohen nga ky ligj dhe Rregullorja e Brendshme. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se Rregullorja e Gjykatës shërben për disiplinimin e veprimtarisë së administratës, përcakton të drejtat dhe detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm si dhe punonjësve të tjerë të administratës gjyqësore. Në asnjë pjesë të ligjit nuk rezulton asnjë dispozitë që të autorizojë Gjykatën për të vendosur vetë rregulla procedurale.

Nëse bëjmë një vështrim historik na rezulton se edhe ligji i mëparshëm që rregullonte veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese nr.8373, datë 15.7.1998, në nenin 47 të tij, parashikonte se për veprimtarinë e administratës së Gjykatës Kushtetuese përgatitet rregullorja e brendshme që miratohet nga kryetari i saj. Nga përmbajtja e kësaj dispozite del qartë se edhe në këtë rast qëllimi i rregullores së Gjykatës ka qenë disiplinimi i veprimtarisë administrative të Gjykatës Kushtetuese dhe jo përcaktimi i rregullave procedurale gjyqësore. Po kështu edhe gjatë hartimit të LGJK, rregullorja e brendshme e Gjykatës ka qenë e konceptuar si një akt që do të disiplinonte vetëm veprimtarinë administrative dhe jo atë procedurale – gjyqësore. Në librin e tij "Kushtetuta dhe Gjykata Kushtetuese", autori Fehmi Abdiu<sup>95</sup> shprehet se "Drejtimi administrativ gjen vend tek rregullorja ... që është konceptuar si dokument që ka të bëjë me veprimtarinë administrative të gjykatës, pa pasur vend për të vendosur rregulla të veçanta për veprimtarinë gjyqësore".<sup>96</sup>

Për me tepër kjo rregullore nuk është publikuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, sipas parashikimeve të nenit 117, pika 1<sup>97</sup> të Kushtetutës, fakt që përforcon argumentin se kjo rregullore nuk është një akt me karakter normativ, por një akt me karakter të brendshëm dhe për këtë arsye konsiderohet brenda fushëveprimit të nenit 119 të Kushtetutës<sup>98</sup> dispozitë e cila parashikon efektin e këtyre akteve dhe faktin e moszbatimit të tyre për individët dhe subjektet e tjera që nuk janë pjesë e institucionit.

Si konkluzion mund të themi se Rregullorja e Gjykatës Kushtetuese, vlen vetëm për personelin administrativ që varet prej saj dhe nuk mund të përdoret kurrësesi kundrejt subjekteve kërkuese në Gjykatën Kushtetuese. Për këto arsye vlefshmëria e pjesës së parë të kësaj rregulloreje e cila vendos rregulla procedurale për faza të ndryshme të gjykimit kushtetues është e diskutueshme. Madje vetë Gjykata Kushtetuese duket se është në dijeni për këtë fakt sepse në nenin 1, pika 2 të Rregullores kjo Gjykatë ka përcaktuar se "këto rregulla nuk shmangin detyrimin për zbatim të dispozitave të ligjit organik të Gjykatës, të KPC si dhe ligjeve e akteve të tjera për

<sup>95</sup> Fehmi Abdiu, ka qenë anëtar i Gjykatës Kushtetuese gjatë periudhës 1998-2010 dhe Kryetar i kësaj Gjykate në periudhën 1998-2004, pra ai ka pasur funksion të rëndësishëm në momentin e hartimit të LGJK. Për këtë arsye mendoj se qëndrimi i tij duhet marrë si autoritar në këtë rast, në lidhje me qëllimin e ligjvënësit në hartimin e këtyre dispozitave.

<sup>96</sup> Abdiu, Fehmi, "Kushtetuta dhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë", Shtëpia Botuese "Redona 2001", Tiranë, Dhjetor 2000, fq.24.

<sup>97</sup> Kushtetuta, neni 117: *Ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave, të institucioneve të tjera qendrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare.*

<sup>98</sup> Kushtetuta, neni 119: *1. Rregulloret e Këshillit të Ministrave, të ministrave e të institucioneve të tjera qendrore, si dhe urdhrat e Kryeministrit, të ministrave e të drejtuesve të institucioneve qendrore kanë karakter të brendshëm dhe janë të detyrueshme vetëm për njësitë administrative që varen prej tyre. 2. Këto akte nxirren në bazë të ligjit dhe nuk mund të shërbejnë si bazë për të marrë vendime në lidhje me individët dhe subjektet e tjera. 3. Rregulloret dhe urdhrat nxirren në bazë dhe për zbatim të akteve që kanë fuqi juridike të përgjithshme.*

aq sa ato lidhen me çështjet e trajtuara nga kjo rregullore". Dukshëm një formulim i tillë mbështet konkluzionin mbi vlerën e kufizuar normative të kësaj rregulloreje.

## **KONKLUZIONE.**

Pavarësisht se kontrolli kushtetues në Shqipëri në mënyrë të shprehur ka filluar të funksionojë në vitin 1992, vërejmë se ka pasur tentativa të guximshme më të hershme për realizimin e këtij kontrolli edhe më parë.

Nëse i referohemi rastit të parë të kontrollit kushtetues në vend atij të vitit 1932, rezulton se ai bazohej në një ide që tashme ishte pranuar dhe ishte e vjetër të paktën 10 vjeçare. Siç u analizua më sipër në mënyrë të shprehur supremacia e kushtetutës ishte njohur që në Statutin e Zgjeruar të Lushnjes të vitit 1922. Kjo ide u mbart edhe në Statutin Themeltar të Republikës të vitit 1925 dhe në Statutin Themeltar të vitit 1928. Të treja këto statute parashikonin faktin se pasoja për aktet e tjera që binin në kundërshtim me këto statute ishte pafuqia e tyre juridike.

Në këtë drejtim mund të themi që vendimmarrja e Degës Civile të Gjyqit të Diktimit në vitin 1932, për kushtetushmërinë e ligjit për gjykimin e shpejtë të padive posedimore, kishte një bazë juridike të konsoliduar për kushtetutat tona të asaj kohe. Këtu nuk përjashtohet fakti se gjyqtarët e asaj kohe kishin studiuar në vendet e huaja perëndimore ku normalisht duhet të ishin njohur edhe me format e kontrollit kushtetues, atë amerikan dhe atë kelzenian që zbatoheshin në Austri dhe Çeki.

Nëse do të ishte pranuar nga shteti i asaj kohe, kontrolli kushtetues në Shqipëri do të kishte pasur karakteristikat e kontrollit kushtetues në amerikë, duke qenë se u ushtrua nga gjykatat e zakonshme. Fatkeqësisht, ndërhyrja e ashpër e pushtetit të kohës, e cila kulmoi me shkarkimin e të gjithë Gjykatës së Diktimit pengoi në konsolidimin e kësaj risie në Shqipëri.

Edhe gjatë periudhës komuniste, pavarësisht se kontrolli kushtetues ishte vendosur në duart e organit legjislativ, do të ishin gjykatat të cilat do të merrnin përsipër edhe në këtë kohë realizimin e këtij kontrolli. Kjo mund të shpjegohet me faktin se Kuvendi Popullor në këtë kohë ishte më tepër një organ formal, i cili mbledhej rrallë dhe nuk kishte ndonjë funksion praktik kryesor, por vetëm sanksionimin e direktivave të Partisë së Punës. Nga ana tjetër gjykatat në atë kohë ishin nga të paktet organe të cilat përballeshin përditë me zbatimin e ligjit dhe për rrjedhojë ato kishin më shumë mundësi që të vërenin përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën e vendit. Në praktikën gjyqësore të asaj kohe vërehet se Kushtetuta përdorej si referim në zgjidhjen e çështjeve të caktuara, por udhëzimi i cituar në këtë punim është rasti i parë i kohës së regjimit komunist, ku Gjykata e Lartë orienton gjykatat më të ulta që të mos zbatojnë dispozita të caktuara ligjore pasi bien në kundërshtim me Kushtetutën e vendit. Megjithatë ky vendim, ishte në të njëjtën linjë me dogmat ideologjike të kohës dhe synoi të kufizonte në maksimum të drejtat e shtetasve për pronë private.

Për sa më sipër mund të themi që forma të kontrollit kushtetues në Shqipëri ka pasur edhe më parë. Praktika gjyqësore që filloi të krijohej në vitet 1992 dhe me tej kishin deri diku një bazë ideore të pranuar edhe më parë mbi supremacinë e kushtetutës dhe kontrollin kushtetues të akteve juridike.

Përsa i përket organizimit të Gjykatës Kushtetuese, si ligjvënësi kushtetues dhe ai i zakonshëm, janë përpjekur të krijojnë një institucion i cili gëzon pavarësi të plotë. Për këtë arsye si në Kushtetutë dhe në LGJK ka parashikime të shumta për garancive të Gjykatës si institucion dhe garancive për gjyqtarët kushtetues. Të gjitha këto garanci në tërësinë e tyre

përfshirë edhe trajtimin protokollar kanë si qëllim shmangien e ndërhyrjeve nga jashtë dhe trajtimin e gjyqtarëve në përputhje me nivelin dhe prestigjin që u takon.

Në lidhje me burimet normative që rregullojnë procesin kushtetues mund të konkludojmë se në përgjithësi edhe për këtë degë të së drejtës ndiqet i njëjti rregull, ku burim parësor është Kushtetuta, më pas vijnë marrëveshjet ndërkombëtare dhe më tej ligjet. Por për këtë fushë mundet gjithashtu që të individualizojmë edhe disa problematika. Problematika e parë është shpërndarja e normave procedurale në akte të ndryshme juridike. Këtu mund të përmendim 11 akte të tilla të cilat janë trajtuar në këtë punim. Është mëse e kuptueshme që një shpërndarje e tillë e legjislacionit sjell probleme me parimin e sigurisë juridike dhe të qartësisë së normës. Problematika e dytë është edhe natyra e veçantë e gjykimit kushtetues. Duke qenë i ndryshëm nga gjykimi i zakonshëm pjesëmarrësit në një gjykim kushtetues e kanë shumë të vështirë që të zbatojnë *mutatis mutandis* normat juridike që rregullojnë gjykime të tjera në një gjykim kushtetues.

## KREU II

### PARIMET DHE JURIDIKSIONI I GJYKATËS KUSHTETUESE

#### Hyrje.

Gjykimi përbëhet nga disa elementë të cilët plotësojnë njëri – tjetrin dhe në tërësinë e tyre formojnë procesin kushtetues. Këto elementë në rradhë të parë kanë të bëjnë me parimet e gjykimit kushtetues, parime këto të cilat karakterizojnë të gjithë gjykimin kushtetues që nga fillimi dhe deri në përfundimin e tij. Me pas, element i rëndësishëm është juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese që lidhet domosdoshmërisht dhe me objektin e gjykimit. Pa një çështje apo mosmarrëveshje nuk mundet që të ketë një gjykim kushtetues. Në këtë pjesë të punimit synohet që të detajohet se cilat akte mund të jenë pjesë e gjykimit kushtetues.

Secili prej këtyre elementeve paraqet rëndësinë e tij të veçantë. Për këtë arsye po vijojmë me trajtimin e tyre.

#### 1. PARIMET E GJYKIMIT KUSHTETUES.

Gjykimi kushtetues në tërësinë e tij zhvillohet mbi bazën e disa parimeve të cilat trajtohen nga LGJK në nenet 20-26 të tij, por mund të gjenden edhe në ligje të tjera. Këto parime përshkruajnë të gjithë veprimtarinë e procesit kushtetues dhe janë baza mbi të cilën garantohej funksionimi i këtij institucioni.

**Parimi i Kolegjialitetit.** Shqyrtimit kolegjial të çështjeve nga Gjykata Kushtetuese, i nënshtrohen të gjitha fazat e gjykimit kushtetues që mund të klasifikohen si vijon: Kolegji për shqyrtimin paraprak të kërkesave, i përbërë nga tre gjyqtarë, mbledhja e gjyqtarëve dhe trupi gjykses.<sup>99</sup> Ky parim është i lidhur me ligjshmërinë në veprimtarinë gjyqësore ashtu edhe me barazinë e të gjithë gjyqtarëve në proces. Kjo i shërben krijimit të një jurisprudence të qëndrueshme që arrihet vetëm nëpërmjet kolegjialitetit të gjithë trupës vendimarrëse të gjyqtarëve.<sup>100</sup>

Por parimi i Kolegjialitetit kohët e fundit ka shfaqur problematikat e veta. Në rradhë të parë kolegjialiteti paraqet një të metë në lidhje me mënyrën e caktimit të gjyqtarit relator i cili caktohet nga Kryetari i Gjykatës. Duke qenë se ky gjyqtar përgatit dosjen, materialet e tjera të çështjes, dhe është ai që paraqet qëndrimin e parë në lidhje me çështjen, qëndrim që edhe mund të influencojë gjyqtarët e tjerë, atëherë roli i tij është shumë i rëndësishëm.

Po kështu specializimi i gjyqtarëve kushtetues për tematika të caktuara, patjetër që ndikon edhe në vendimmarrjen e gjyqtarëve. Në këtë mënyrë ky gjyqtar për një çështje që i përket ekspertizës së vetë do të ketë një influencë të madhe mbi gjyqtarët e tjerë të cilat nuk kanë specializimin e duhur për atë fushë.<sup>101</sup> Duke i'u referuar Gjermanisë, çështjet mbasi paraqiten vazhdojnë rrugën e tyre procedurale nëpër senatet respektive dhe u caktohen gjyqtarëve sipas fushave të tyre të specializimit. Kjo bëhet mbi bazën e marrëveshjes së përbashkët të gjyqtarëve me kryetarët e senatëve për të shërbyer si relatorë në çështje të caktuara. Kështu është tipike në Gjermani që të paktën një gjyqtar i senatit të dytë të jetë i profilizuar në të drejtën ndërkombëtare

<sup>99</sup> Omari, Luan; Anastasi, Aurela: "E drejta kushtetuese", Shtëpia Botuese "ABC", Tiranë 2010, fq.466.

<sup>100</sup> Sadushi, Sokol, "Drejtësia Kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq.340.

<sup>101</sup> Ruggeri, Antonio; Spadaro, Antonino, "Lineamenti di giustizia costituzionale", Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2009, fq.65.



dhe evropiane. Një tjetër gjyqtar duhet që të jetë i profilizuar në çështje të cilat përfshijnë të drejtën tatimore dhe të sigurimeve shoqërore, ndërsa dikush tjetër të jetë i profilizuar në çështjet e së drejtës familjare. Ndoshta për ta zbutur disi këtë situatë, rregullat e procedurës në Gjermani kërkojnë që gjyqtari relator të përgatisë një relacion voluminoz, ku përveç pasqyrimit të pretendimeve të palëve, duhet të gjejnë pasqyrim edhe qëndrimet e ndryshme të doktrinës për këtë çështje si edhe praktika gjyqësore e ngjashme.<sup>102</sup> Por shpesh herë nën presionin edhe të kohës, praktika ndërkombëtare ka treguar se gjyqtarët bazohen shpesh në qëndrimin që ka mbajtur gjyqtari relator.<sup>103</sup>

**Parimi i publicitetit.** LGJK në dispozitat e tij përcakton se gjykimi kushtetues në seancë plenare mund të zhvillohet gojarisht ose mbi bazë dokumentash. Në ato raste kur ajo vendos që do të zhvillohet gojarisht seancat si rregull bëhen publikisht, por mundet që Gjykata Kushtetuese ta përjashtojë publikun nga seanca plenare ose një pjesë të tij, me arsyetimin e mbrojtjes së moralit publik, të rendit publik, të sigurisë kombëtare, të së drejtës së jetës private ose të së drejtave vetjake.<sup>104</sup> Publiciteti i seancave i shërben transparencës së Gjykatës dhe ndihmon në rritjen e besimit në drejtësinë kushtetuese. Për të rritur këtë besim edhe më tepër, Gjykata Kushtetuese, lejon edhe praninë e mediave në sallën e gjyqimit për sa kohë nuk pengon zhvillimin normal të seancës gjyqësore.<sup>105</sup> Kjo tregon për një hapje shumë të madhe të Gjykatës ndaj transparencës, të cilën nuk e gjejmë në vende të tjera. Kështu në Gjermani seancat publike nuk mund të regjistrohen dhe transmetohen, me përjashtim të pjesës së parë të seancës kur hyn trupi gjykues dhe deklarohet çështjen që ka për shqyrtim.<sup>106</sup>

**Publikimi i vendimeve.** Gjykata Kushtetuese ndjek rregullin e publikimeve të vendimeve të saj. Vendimet e dhëna në seancë plenare botohen rregullisht në Fletoren Zyrtare. Ky botim lidhet drejtpërsëdrejti edhe me hyrjen në fuqi të tyre. Një tjetër formë botimi është edhe botimi në tërësi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në përmbledhjet vjetore, detyrim i cili buron nga ligji. Po kështu në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni botohen rregullisht vendimet e Gjykatës Kushtetuese të dhëna në seancë plenare, në mbledhjet e gjyqtarëve dhe në kolegji. Kjo mundëson njohjen me jurisprudencën e kësaj gjykate, rrit transparencën e këtij institucioni dhe e bën atë më të besueshëm në sytë e publikut.

**Përdorimi i gjuhës shqipe.** Sipas nenit 22 të LGJK në shqyrtimin e çështjeve përdoret gjuha shqipe. Kjo dispozitë është pasqyrim i nenit 14 të Kushtetutës që përcakton si gjuhë zyrtare të vendit gjuhën shqipe. Gjykata Kushtetuese është një institucion shtetëror, prandaj dhe procesi zhvillohet në gjuhën zyrtare.<sup>107</sup> Pra, procedurat në Gjykatë zhvillohen në gjuhën shqipe ndërsa pjesëmarrësit në gjykim, që nuk dinë gjuhën shqipe, përdorin gjuhën e tyre. Ata marrin dijeni për të gjithë zhvillimin e procesit me anë të përkthyesit, që si rregull sigurohet nga Gjykata Kushtetuese.<sup>108</sup>

**Procesi gojor.** Zhvillimi i procesit gojor në Gjykatën Kushtetuese mundëson realizimin e së drejtës për tu dëgjuar dhe mbrojtur si një nga elementët e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Zhvillimi i procesit në këtë mënyrë, koha që Gjykata u vë në dispozicion palëve, dëgjimi i

<sup>102</sup> Kommers, Donald P.; Miller, Russell A.; "The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany", Shtëpia Botuese "Duke University Press", Londër 2012, fq.26 – 27.

<sup>103</sup> Po aty, fq.28.

<sup>104</sup> LGJK, neni 21.

<sup>105</sup> Rregullorja, neni 9, pika 3.

<sup>106</sup> Kommers, Donald P.; Miller, Russell A.; "The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany", Shtëpia Botuese "Duke University Press", Londër 2012, fq.27.

<sup>107</sup> Sadushi, Sokol, "Drejtësia Kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq.342.

<sup>108</sup> LGJK, neni 22, pika 2.

të gjitha argumentave dhe provave, ka si qëllim që të paraqesë Gjykatën në një drejtim mirëbesimi dhe të një sensi drejtësie të hapur ndaj palëve fituese apo humbëse.<sup>109</sup> Megjithatë vetë LGJK përcakton se ky proces mund të zhvillohet dhe mbi bazë dokumentash. Kjo mënyrë e zhvillimit të procesit nuk cënon të drejtën për t'u dëgjuar dhe mbrojtur e cila në këtë rast realizohet nëpërmjet paraqitjes së dokumentave shkresore. Raporti midis këtyre dy proceseve do të detajohet më tej në vijim të punimit.

**Mbrojtja në gjykimin kushtetues.** Pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues mbrohen vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit, në mënyrën e parashikuar në LGJK.<sup>110</sup> Rregulli që vendoset në këtë rast është mbrojtja vetë e subjekteve kërkuese. Është e kuptueshme që në këtë lloj gjykimi i cili kërkon një specializim dhe njohuri të posaçme, mbrojtja nëpërmjet profesionistëve është me e pranueshme. Organet shtetërore, si rregull, përfaqësohen nëpërmjet juristëve të tyre, ndërsa individët kanë të drejtë të përfaqësohen me avokat që sipas LGJK mund të jenë vetëm ato që janë përcaktuar në listën që ka përgatitur Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

**Paanshmëria e Gjykatës Kushtetuese.** Sipas LGJK, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese në shqyrtimin e çështjeve është i paanshëm dhe bazohet në kryerjen e detyrave të tij vetëm në Kushtetutë dhe në ligj. Në veprimtarinë e tij, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese merr pjesë me cilësinë e tij vetjake dhe nuk përfaqëson asnjë organ shtetëror, organizatë shoqërore, parti ose shoqatë politike, grup etnik ose social.<sup>111</sup> Sipas LGJK gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese është i detyruar të heqë dorë nga shqyrtimi i një çështjeje konkrete kur ka marrë pjesë në hartimin e aktit objekt shqyrtimi, për shkak të lidhjeve fisnore apo lidhjeve të tjera me pjesëmarrësit në gjykim, vihet në dyshim objektiviteti i tij, si edhe në çdo rast tjetër kur vërtetohen arsye serioze njëanshmërie. Heqja dorë miratohet nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, derisa çështja nuk ka kaluar në seancë plenare. Më pas, heqja dorë vendoset me shumicën e votave të gjyqtarëve pjesëmarrës në proces.<sup>112</sup> Megjithatë LGJK nuk e lë vetëm në ndërgjegje të gjyqtarit kushtetues, marrjen apo jo në proces në rast të vërtetimit të njëanshmërisë së tyre. Kështu pjesëmarrësit në gjykim kanë të drejtë të kërkojnë përjashtimin e gjyqtarit në çdo fazë të zhvillimit të gjykimit kur ekziston një nga rastet e parashikuara në LGJK dhe gjyqtari nuk heq dorë nga shqyrtimi i çështjes. Për përjashtimin e gjyqtarit vendos shumica e gjyqtarëve që marrin pjesë në shqyrtimin e çështjes. Gjyqtari, për të cilin kërkohet përjashtimi, pasi dëgjohet nuk merr pjesë në votim. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, gjyqtari quhet i përjashtuar.<sup>113</sup> Qëllimi i këtyre normave nuk është mbrojtja e gjyqtarëve nga pretendimet për njëanshmëri, por mbrojtja e legjitimitetit të Gjykatës Kushtetuese si një organ i paanshëm. Për këtë arsye, dyshimi bindës për paanshmëri duhet të jetë i mjaftueshëm për pranimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit/gjyqtarëve.<sup>114</sup> GJEDNJ ka evidentuar dallimin midis kriterit subjektiv dhe kriterit objektiv të paansisë. Në kuptimin subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet, derisa të provohet e kundërta, kurse në atë objektiv, duhet të provohet, nëse ka fakte bindëse që vënë në dyshim paanshmërinë.<sup>115</sup>

<sup>109</sup> Kommers, Donald P.; Miller, Russell A.; "The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany", Shtëpia Botuese "Duke University Press", Londër 2012, fq.27.

<sup>110</sup> LGJK, neni 24.

<sup>111</sup> LGJK, neni 25.

<sup>112</sup> LGJK, neni 36.

<sup>113</sup> LGJK, neni 37.

<sup>114</sup> Vendimi nr.9, datë 23.3.2010 i Gjykatës Kushtetuese, parag.22.

<sup>115</sup> Anastasi, Aurela, "Gjykatë e paanshme", si parim kushtetues për një gjyqësor të fortë dhe të besueshëm", botuar në Revistën "Avokatia", nr.8, botim i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Tetor 2013, fq.149.

Në lidhje me këtë parim ka pasur diskutim nëse gjyqtari kushtetues mund që të kontrollojë kushtetushmërinë e një ligji kur vetë ai ishte objekt hetimi dhe kontrolli sipas këtij ligji. Madje sipas ligjit nr. 10034, datë 22.12.2008 “Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve”, përcaktohej se “asnjë person, që ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë së funksioneve, sipas nenit 4 të këtij ligji nuk mund të jetë pjesë në trupa gjyqësore që marrin në shqyrtim këtë ligj ose çështje që lidhen me zbatimin e tij.” Por duke qenë se në këtë rast, ligji objekt gjykimi prekte 4 prej gjyqtarëve kushtetues, rezultonte se Gjykata Kushtetuese mund të bllokohej në vendimmarjen e saj, pasi sipas LGJK kjo gjykatë funksionon me të paktën 6 anëtarë të saj. Në këtë drejtim duke vendosur në balancë parimin e paanshmërisë me parimin e funksionalitetit të saj Gjykata Kushtetuese mbajti këtë qëndrim:

*Ligjvënësi, duke përfshirë anëtarët e Gjykatës Kushtetuese në kategorinë e subjekteve që do t'i nënshtrohen verifikimit sipas nenin 3, germa “d” të ligjit për pastërtinë e figurës duhet të konsideronte nevojën për të shmangur bllokimin institucional dhe për këtë arsye duhet të kishte bërë rregullime të veçanta kushtetuese dhe ligjore që do t'i krijonin mundësinë kësaj Gjykate të kontrollonte kushtetutshmërinë e ligjeve. Kuvendi nuk parashikoi një zgjidhje për të tejkaluar një bllokim të tillë të mundshëm, bllokim që krahas të tjerave sjell për pasojë që edhe ligji për pastërtinë e figurës të mos i nënshtrohet gjykimit mbi kushtetutshmërinë e tij. Kjo bie në kundërshtim me nenin 124 të Kushtetutës. Ky qëndrim në parim, për analogji, është shprehur edhe në vendime të mëparshme të kësaj Gjykate (shih vendimet nr 21, datë 01.10.2008 dhe nr.4, datë 02.06.1995). Në këto kushte, gjykimi lidhur me kërkesën për përjashtimin e disa gjyqtarëve duhet të mbështetet në vlerësimin e rëndësisë që ka paanshmëria e gjyqtarëve, por edhe në nevojën për kontrollin e ligjeve të Kuvendit nga Gjykata Kushtetuese.<sup>116</sup>*

Në përfundim Gjykata konstatoi se funksionaliteti i saj ishte më i rëndësishëm se pretendimi për paanshmërinë e trupës gjyqësore. Duke e konsideruar si pretendim të pabazuar, Gjykata, u shpreh në favor të parimit të funksionalitetit.

Një tjetër rast i njëanshmërisë së gjyqtarëve kushtetues që u shtrua për diskutim në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese ishte kur të afërmit e dy prej gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese, ishin të punësuar në një nga institucionet e larta të vendit, institucion i cili kishte paraqitur kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave me një tjetër organ kushtetues. Duke qenë se kërkesat për heqjen dorë u paraqitën mbasi kishte filluar shqyrtimi gjyqësor i çështjes, këto kërkesa u gjykuan nga mbledhja e gjyqtarëve e cila për njërin prej tyre pranoi heqjen dorë, kurse për një tjetër jo, duke zbatuar në këtë rast dy standarde.<sup>117</sup> Në këtë rast, heqja dorë e njërit prej gjyqtarëve nuk solli ligjërisht bllokimin e këtij institucioni pasi trupa gjyqësore përbëhej nga tetë anëtarë dhe për rrjedhojë mundej që të shqyrtonte çështjen. Situata në këtë rast u komplikua pasi trupa gjyqësore u nda në votim katër me katër duke vendosur në përfundim refuzimin e kërkesës. Ky është një shembull që tregon që mospjesëmarrja e gjyqtarëve kushtetues mund të çojë në bllokimin e këtij institucioni në vendimmarje.

Mosmarrja pjesë e gjyqtarëve në gjykimin kushtetues për të respektuar parimin e paanshmërisë, ka gjetur zbatim në disa raste. Megjithatë vetëm në një rast Gjykata Kushtetuese

<sup>116</sup> Po aty, parag.24.

<sup>117</sup> Mendimi në pakicë i gjyqtarit kushtetues, Vladimir Kristo, në vendimin nr.45, datë 25.7.2014 të Gjykatës Kushtetuese, parag.3.



ka mbajtur qëndrim të shprehur për refuzimin e kësaj kërkesë. Në rastet e tjera kur gjyqtari vetë, apo palët kanë kërkuar përjashtimin, në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nuk gjejmë asnjë pasqyrim të kësaj situatë. Në kundërshtim me sa më sipër, kërkesat për pranimin apo refuzimin e përjashtimit, gjejmë pasqyrim të plotë në vendimin përfundimtar të Gjykatës në vende të tjera.<sup>118</sup> Kjo ndihmon edhe në respektimin e parimit të paanshmërisë, si edhe i shërben respektimit të transparencës dhe besimit të opinionit publik ndaj Gjykatës.

**Parimi gjykata njuh ligjin (*Iura novit curia*).** Ky parim i rëndësishëm përcakton se është gjykata ajo e cila përcakton ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Parimi në fjalë është një parim që përshkron të drejtën procedurale civile.<sup>119</sup> Pavarësisht kësaj, këtë parim e gjejmë të zbatueshëm edhe në jurisprudencën kushtetuese. Gjykata Kushtetuese në një vendim të saj in është shprehur se:

*Gjykata e Apelit Vlorë pretendon se neni 329/1 i KPP, pjesa e fjalisë "përveçse kur me vendim është deklaruar se fakti nuk ekziston", bie ndesh me nenin 43 të Kushtetutës, i cili parashikon se kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe.*

*Gjykata Kushtetuese vlerëson se dispozita që kërkohet të shfuqizohet duhet parë fillimisht në kuptimin e nenit 42 të Kushtetutës, duke u ndalur kryesisht në të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit në gjykatë), si element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.*

*Gjykata Kushtetuese vlerëson se dispozita objekt shqyrtimi nuk mund të kontrollohet duke iu referuar përmbajtjes dhe kriterëve të nenit 43 të Kushtetutës.<sup>120</sup>*

Nga pasazhet e mësipërme të vendimit kuptohet se gjykata referuese, si kërkuese, e ka argumentuar antikushtetutshmërinë e një dispozitë të K.Pr.P. duke u bazuar në nenin 43 të Kushtetutës (e drejta për ankim), ndërkohë gjë Gjykata Kushtetuese, ka përcaktuar se parashikimi i kësaj dispozite nuk gjen zbatim në këtë rast dhe e ka zgjidhur çështjen bazuar në nenin 42 të Kushtetutës (e drejta për një proces të rregullt ligjor – e drejta e aksesit në gjykatë). Ky vendim është rasti më tipik i përdorimit të parimit *iura novit curia* nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

**Parimi i disponibilitetit.** Si rregull në një proces gjyqësor vepron parimi i përputhshmërisë së asaj të kërkuar me atë të dhënë. Ky parim i cili e ka bazën e tij në të drejtën procedurale civile<sup>121</sup> gjen zbatim edhe në procesin kushtetues, por për shkak të natyrës së këtij procesi ka edhe përjashtime. Më konkretisht, neni 48 i LGJK-së përcakton se kufijtë e shqyrtimit të çështjes janë brenda objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të dhe vetëm përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të kërkesës dhe akteve të tjera normative, vendos për çdo rast Gjykata Kushtetuese. Pika e parë e dispozitës përcakton rregullin sipas së cilit Gjykata

<sup>118</sup> Kommers, Donald P.; Miller, Russell A.; "The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany", Shtëpia Botuese "Duke University Press", Londër 2012, fq.26.

<sup>119</sup> K.Pr.C., neni 16: Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët.

<sup>120</sup> Vendimi nr.5, datë 6.3.2009 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>121</sup> K.Pr.C., neni 6: Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet.



kufizohet vetëm në kërkimet e palëve në proces pa i tejkaluar ato. Në përgjithësi ky rregull ndiqet edhe nga ana e Gjykatës Kushtetuese.<sup>122</sup> Pika e dytë e dispozitës parashikon mundësinë e Gjykatës, që në rast kur çmohet prej saj, të dalë jashtë objektit të gjykimit. Kjo e drejtë e Gjykatës për të tejkaluar kufijtë e kërkimit, lidhet me natyrën e gjykimit kushtetues. E drejta e Gjykatës Kushtetuese për të dalë jashtë kornizave të objektit të kërkesës, lidhet me efektet *erga omnes* që kanë vendimet e saj. Në këtë mënyrë kur konstatohet se midis dispozitave që po shqyrtohen dhe dispozitave të tjera juridike ka lidhje, atëherë Gjykata Kushtetuese, mund të shqyrtojë edhe kushtetutshmërinë e këtyre të fundit.

Gjykata Kushtetuese këtë mundësi e ka përdorur disa herë, por duke e analizuar në tërësi jurisprudencën e saj rezulton se ajo ka qenë e kujdesshme në përdorimin e kësaj të drejte. Nga një përgjithësim i praktikës gjyqësore rezulton se tejkalimi i objektit dhe shkaqeve nga Gjykata Kushtetuese mund të bëhet në disa drejtime, të cilat mund t'i përkufizojmë në planin vertikal, horizontal dhe kohor.

Në *planin vertikal* kjo mundësi mund të përdoret në ato raste kur subjekti kërkues ka kundërshtuar vetëm ligjin, por jo aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese, duke zbatuar nenin 48 të LGJK e shtrin shqyrtimin gjyqësor dhe vendimmarrjen e saj edhe mbi këto akte.<sup>123</sup>

<sup>122</sup> Vendimi nr.14, datë 22.5.2006 i Gjykatës Kushtetuese: *Është i pabazë pretendimi që ngrihet nga subjektet e interesuara se anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë që zgjidhen nga gjyqësori mund të konsiderohen gjyqtarë edhe pse nuk punojnë efektivisht si të tillë, ashtu siç është vepruar edhe për ata gjyqtarë që punojnë në funksione të ndryshme drejtuese në Ministrinë e Drejtësisë. Ligji nr.8678, datë 02.11.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", në nenin 4 të tij, u jep mundësinë të shërbejnë në disa struktura të Ministrisë së Drejtësisë gjyqtarëve e prokurorëve dhe kjo periudhë u njihet atyre vetëm si vjetërsi pune si gjyqtar ose prokuror për efekt të kërkesave të karrierës profesionale. Mirëpo, pa analizuar kushtetutshmërinë e kësaj norme, pasi është jashtë objektit të shqyrtimit të çështjes, pranimi i një pretendimi të tillë do të vinte në kundërshtim me interpretimin dhe zbatimin e nenit 143 të Kushtetutës, sipas të cilit, qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore.*

<sup>123</sup> Vendimi nr.11, datë 6.4.2010 i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 30: *Në këtë kontekst dhe duke u mbështetur në nenin 48 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", Gjykata vëren lidhjen sine qua non ndërmjet ligjit, objekt shqyrtimi dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1139, datë 24.11.2009, "Për caktimin e numrit të automjeteve dhe të shoferëve në dispozicion të ministrive dhe të institucioneve qendrore", i cili ka dalë në zbatim të tij. Përdërisa baza ligjore mbi të cilën Këshilli i Ministrave ka marrë autorizimin për nxjerrjen e këtij akti nënligjor konsiderohet si antikushtetuese, Gjykata konkludon për papajtueshmërinë me Kushtetutën edhe të Vendimit të sipërcituar të Këshillit të Ministrave, vetëm për sa përfaqëson në fushën e zbatimit të tij Gjykatën Kushtetuese dhe Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor. Gjykata vlerëson se dispozita të veçanta të këtyre dy akteve normative vijjnë ndesh me nenet 7 dhe 144 të Kushtetutës që sanksionojnë standardin kushtetues të administrimit të buxhetit nga vet gjykatat dhe me parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve.*

Vendimi nr.10, datë 18.3.2013 i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 22: *Gjykata konstaton se në rastin objekt shqyrtimi, sipas ligjit nr.8626, datë 22.06.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" dhe VKM-së nr.83, datë 26.02.2001, shërbimi i telefonisë fikse, për personat para dhe tetraplegjikë ka qenë tarifë e favorizuar (tarifë e nivelit të parë) dhe shërbimi i energjisë elektrike konsistonte në pagesën e vetëm 20 % të konsumit të saj, ndërsa pjesa tjetër është kompensuar nga shteti. Aktualisht, VKM-ja nr.404, datë 20.06.2012, e miratuar në zbatim të ligjit objekt kundërshtimi, parashikon, për personat invalidë që kanë nevojë për kujdestarë, masën e kompensimit për energjinë elektrike në 2.000 lekë në muaj (neni 1) dhe për personat që nuk kanë nevojë për kujdestarë, në masën 1.400 lekë në muaj (neni 3). Ndërsa, kompensimi për faturën e telefonisë fikse është caktuar në masën 1.000 lekë në muaj, pa diferencime midis personave që kanë apo jo kujdestarë (neni 4). Në përputhje me nenin 48 të Ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", duke gjykuar se VKM-ja e mësipërme ka një lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e këtij gjykimi, Gjykata çmon se legjitimohet të marrë në shqyrtim edhe dispozitat e këtij vendimi.*

Vendimi nr.14, datë 17.4.2013 i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 19: *Në rastin objekt shqyrtimi, Gjykata konstaton se sipas ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbrit", personat e verbër, të paafte për të lëvizur pa*

Një çështje e diskutueshme në këtë rast është nëse objekti kryesor i gjykimit është kushtetueshmëria e një akti nënligjor normativ, a mundet Gjykata Kushtetuese, që për shkak të koneksitetit të dispozitave të shtrijë kontrollin edhe mbi ligjin, në bazë të së cilës ka dalë akti nënligjor? Megjithëse nuk ka një qëndrim të prerë në këtë rast, në dukje duket sikur Gjykata Kushtetuese e ka pranuar një mundësi të tillë por me kushtin që çështja të jetë brenda afatit 3 vjeçar që kërkon LGJK.<sup>124</sup>

Në *planin horizontal*, Gjykata Kushtetuese, e shtrin gjykimin e saj mbi norma juridike të të njëjtin nivel me aktin juridik që po shqyrton, pavarësisht se ato nuk janë objekt gjykimi në proces. Kjo mundësi është e zbatueshme ndaj akteve ligjore. Ky si rast mund të shfaqet në dy forma. Së pari, në norma të tjera ligjore të cilat janë pjesë e ligjit që është bërë objekt gjykimi<sup>125</sup> dhe së dyti, në norma të tjera ligjore, të cilat gjenden në ligje të tjera, të ndryshme nga ai që është objekt gjykimi.<sup>126</sup>

---

*shoqërues, paguanin tarifë telefonike të nivelit të parë të favorizuar dhe se shërbimi i energjisë elektrike konsistonte në pagesën e vetëm 20 % të konsumit të saj, ndërsa pjesa tjetër kompensohej nga shteti. Aktualisht, VKM-ja nr.404, datë 20.06.2012, e miratuar në zbatim të ligjit objekt kundërshtimi, parashikon për këta persona kompensimin për faturën e telefonisë fikse në masën 1 000 lekë në muaj (neni 5). Ndërsa, masa e kompensimit për energjinë elektrike është 2 000 lekë në muaj për personat e verbër që kanë nevojë për kujdestarë, (neni 2) dhe 1 400 lekë në muaj për personat që nuk kanë nevojë për kujdestarë (neni 3). Në përputhje me nenin 48 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", duke gjykuar se VKM-ja e mësipërme ka një lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e këtij gjykimi, Gjykata çmon se legjitimohet të marrë në shqyrtim edhe dispozitat e këtij vendimi.*

<sup>124</sup> Vendimi nr.12, datë 28.4.2009 i Gjykatës Kushtetuese: *Në datën 9 shtator 2008, Shoqata e Shoqërive të Hidrokarbureve (Sh.Sh.H.), in drejtua Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për të shfuqizuar dhe pezulluar pikën 1 të Udhëzimit nr.18, datë 18.06.2008 të Ministrisë të Financave...Gjykata vlerëson se parashkrimi i subjektit të interesuar se nëse ka kufizim të veprimtarisë së lirisë ekonomike këtë gjë e ka bërë ligji për TVSH, është i drejtë... Neni 50 i ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese" parashikon se kërkesat lidhur me shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare mund të paraqiten brenda tre vjetëve nga hyrja në fuqi e tyre. Gjykata vëren se ligji për TVSH-në ka hyrë në fuqi rreth 14 vjet më parë nga data e depozitimit të kërkesës, objekti i këtij shqyrtimi kushtetues, dhe, në këto kushte, afati tre vjeçar i parashikuar në ligjin e përmendur më sipër ka kaluar. Për rrjedhojë, Gjykata e çmon të bazuar pretendimin e subjektit të interesuar se kërkuesi nuk ka kërkuar kontrollin e kushtetueshmërisë së ligjit për TVSH-në dhe se ky ligj nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga kjo Gjykatë në këtë çështje.*

<sup>125</sup> Vendimi nr.14, datë 21.7.2008 i Gjykatës Kushtetuese: *Gjykata Kushtetuese konstaton, se është e vërtetë sa pretendon subjekti i interesuar, se Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda i është shtruar problemi i verifikimit të ligjshmërisë së pushimit të procedimit penal, në aplikim të nenit 328/1/b të K.Pr.P. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese vlerëson, se në rastin në shqyrtim, kontrollit kushtetues duhet t'i nënshtrohen edhe dispozitat e tjera të kundërshtuara, pasi edhe këto dispozita kanë të bëjnë me kompetencën e prokurorit për pushimin e procedimit penal. Një qëndrim i tillë mbështetet në nenin 48/2 të Ligjit nr.8577, dispozitë, e cila përjashtimisht lejon kontrollin kushtetues edhe të akteve të tjera normative, kur ka lidhje midis objektit të kërkesës dhe këtyre akteve.*

Vendimi nr.47, datë 26.2.2012 i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 50: *Gjykata vëren se plotësimi që iu bë nenit 29 të KP-së nga ligjvënësi me ligjin nr.9086, datë 19.06.2003, lidhur me parashkrimin njëkohësisht të dënimit me burgim dhe atij me gjobë, ka shërbyer si bazë ligjore për të gjitha ndryshimet e ndërmarra më vonë në Pjesën e Posaçme të Kodit Penal për parashikimin e dy dënimeve kryesore në vepra të ndryshme penale përfshirë edhe veprat penale të parashikuara në nenet 190 dhe 191 të KP-së, objekt shqyrtimi. Në përputhje me nenin 48 të Ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", duke gjykuar se dispozita e mësipërme ka një lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e këtij gjykimi, Gjykata çmon se legjitimohet të marrë në shqyrtim edhe këtë nen.*

<sup>126</sup> Vendimi nr.65, datë 10.12.1999 i Gjykatës Kushtetuese: *Gjithashtu meqenëse objekti i kërkesës së paraqitur nga Gjykata e Lartë është papajftueshmëria me Kushtetutën e dënimit me vdekje lidhur me disa dispozita të Kodit Penal, Gjykata Kushtetuese në bazë të nenit 37 të Ligjit nr.8373, datë 15.07.1998 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", duke qenë se ka një lidhje të drejtpërdrejtë midis tyre, vendosi të shqyrtojë tej objektit të kërkesës edhe kushtetueshmërisë e dy dispozitave të Kodit Penal Ushtarak.*

Në *planin kohor*, Gjykata Kushtetuese e ka shtrirë zbatimin e kësaj mundësie, në ato raste kur ka pasur në shqyrtim dispozitat e një ligji, dispozita këto të cilat janë ndryshuar gjatë gjykimit kushtetues, por dispozitat e reja pavarësisht se ndryshojnë në formë, në përmbajtje janë të njëjta me ato të cilat ishin bërë objekt gjykimi.<sup>127</sup>

Parimisht Gjykata Kushtetuese, këtë mundësi e ka zbatuar, pavarësisht faktit se cili ka qenë subjekti i kërkesës. Por se fundmi jurisprudenca e Gjykata Kushtetuese ka pësuar një ndryshim të fortë, përse i përket shfrytëzimit të kësaj të drejtë, kur ligjet janë bërë objekt gjykimi si rezultat i kërkesave të ardhura nga gjykatat e zakonshme. Më konkretisht, Gjykata Kushtetuese në vendimet nr. 65, datë 10.12.1999, nr.14, datë 21.7.2008 dhe nr.47, datë 26.2.2012, në kuadër të një gjykimi incidental të inicuar nga gjykata e zakonshme ka vendosur se ka pasur vend dhe arsye për zbatimin e nenit 48 pika 2 të LGJK dhe për rrjedhojë e ka shtrirë kontrollin e saj edhe në dispozita apo ligje të tjera të cilat nuk ishin objekt shqyrtimi. Por, së fundmi me vendimin nr.50, datë 10.7.2015, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur një qëndrim diametralisht të kundërt, duke u shprehur se:

*20. Gjatë shqyrtimit të çështjes, Gjykata konstatoi gjithashtu se ligji nr. 8663/2000, përveç se në nenin 23, parashikon kundërvajtje penale edhe në disa dispozita të tjera të tij. Ndonëse neni 48/2 i ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i lejon kësaj Gjykate të marrë në shqyrtim edhe akte të tjera normative kur ato kanë lidhje me objektin e kërkesës, në rastin de quo ajo nuk legjitimohet ta bëjë një gjë të tillë. Gjykata është vënë në lëvizje nëpërmjet një gjykimi incidental, objekti i shqyrtimit të të cilit është i kufizuar, pasi kërkon domosdoshmërisht ekzistencën e një lidhjeje të drejtpërdrejtë midis ligjit, antikushtetueshmëria e të cilit çmohet si e tillë nga gjykata, dhe zgjidhjes së çështjes konkrete. Në këto rrethana, Gjykata e sheh me vend t'i rekomandojë ligjvënësit rishikimin e këtyre dispozitave në frymën e këtij vendimi.*

Për fat të keq, në këtë rast, Gjykata Kushtetuese nuk jep asnjë arsye se përse ka pasur një ndryshim të jurisprudencës së saj. Për rrjedhojë nuk mund të thuhet me saktësi përse në vitin 1999, 2008 dhe 2012 në një gjykim incidental mundej që Gjykata të dilte jashtë kërtimeve të gjykatave të zakonshme ndërsa në vitin 2015 jo. Për më tepër, megjithëse vetë Gjykata është shprehur se nuk është shkak,<sup>128</sup> gjyqtarët kushtetues të vitit 2015 janë në shumicën e tyre të njëjtët gjyqtarë që ishin edhe në vitin 2012. Pra, ky ndryshim i jurisprudencës nuk shpjegohet me shkakun e ndryshimit të gjyqtarëve. Duke analizuar argumentat që ka dhënë Gjykata në këtë rast, duket se pengesa është për shkaqe procedurale. Kështu, përderisa dispozitat e tjera nuk kanë

<sup>127</sup> Vendimi nr.27, datë 26.5.2010 i Gjykatës Kushtetuese, parag.59: *Gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin nr. 10207, datë 23.12.2009 "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës" i ndryshuar". Gjykata vëren se neni 2 i këtij ligji, që ndryshon nenin 18 të ligjit objekt shqyrtimi ka parashikuar kompetenca të Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP, për të shqyrtuar vendime të ish-KKKP-ve, kryesisht, ose pas ankimit të shtetasve apo organeve shtetërore, duke disponuar mbi këto vendime të pa ankimuar të KKKP-ve. Gjithashtu, Gjykata konstaton se neni 3 i ligjit të sipërpërmendur, i cili ndryshon nenin 16 të ligjit objekt shqyrtimi, parashikon të njëjtat kompetenca të Drejtorit të Përgjithshëm në lidhje me vendimmarrjen e strukturave të AKKP-ve në nivel lokal. Në përputhje me nenin 48 të Ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", duke gjykuar se dispozitat e mësipërme kanë një lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e këtij gjykimi, Gjykata çmon se legjitimohet të marrë në shqyrtim nenin 2 dhe 3 të ligjit të ri.*

<sup>128</sup> Vendimi nr.21, datë 29.4.2010 i Gjykatës Kushtetuese.



lidhje me çështjen, Gjykata nuk ka përse të shprehet në lidhje me to. Kjo mënyrë e të vepruarit, përveç faktit se bie në kundërshtim me praktikën e mëparshme, pengon edhe Gjykatën Kushtetuese që të “pastrojë” legjislacionin nga norma antikushtetuese. Rekomandimi i saj në këtë rast për Kuvendin, nuk është një mekanizëm efektiv për të vepruar. Kjo pasi, shpesh herë legjislatori ka programin e tij legjislativ për të ndjekur dhe mund të reagojë me shumë vonesë ndaj këtij rekomandimi, siç edhe praktika ka treguar deri tani.

Kjo sjell si pasojë që institucionet shtetërore të investohen më kot në zbatimin e një ligji që më pas mbi bazën e një gjykimi incidental të shfuqizohet në rastin më të parë po nga Gjykata Kushtetuese. Duke e lidhur me çështjen, prokuroria do të vazhdojë të ndjekë penalisht individë të ndryshëm, që bëjnë shkelje të ligjit dhe më pas në gjykim çështja do të pushohet, pasi Gjykata Kushtetuese mbi bazën e kontrollit incidental do t'i shfuqizojë këto norma.

## **2. JURIDIKSIONI I GJYKATËS KUSHTETUESE DHE OBJEKTI I GJYKIMIT KUSHTETUES.**

Gjykimi kushtetues nuk është një gjykim me natyrë të përgjithshme, pasi çështjet të cilat mund të shqyrtohen prej saj janë të përcaktuara në mënyrë të shprehur nga vetë dispozitat kushtetuese të cilat rregullojnë edhe juridiksionin e kësaj Gjykate. Në këtë mënyrë, referuar këtyre dispozitave, rezulton se objekt i gjykit kushtetues mund të jenë norma me karakter kushtetues, akte me karakter legjislativ, akte me karakter normativ apo individual, sjellje, veprime ose mos veprime të organeve me karakter kushtetues, si dhe akte të organeve gjyqësore, të arbitrazhit apo administrative. Kufijtë e shqyrtimit të tyre janë të ndryshueshme në varësi të llojit të gjykit kushtetues që vihet në lëvizje nëpërmjet kërkesës së paraqitur nga subjektet e ndryshme të përcaktuar nga vetë ligji themelor i vendit. Për të krijuar një ide më të qartë në lidhje me objektin e gjykit dhe duke e lidhur me llojin e gjykit që mund të ushtrohet nga Gjykata Kushtetuese, po vijojmë më tej me analizën e tyre.

### **2.1 Procesi i kontrollit të normës kushtetuese.**

Neni 124 i Kushtetutës përcakton se Gjykata Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj. Togfjalëshi i fundit “bën interpretimin përfundimtar të saj”, ka ngjallur jo pak debate në doktrinë dhe jurisprudencë lidhur me kuptimin e tij. Një mendim i shfaqur e lidh kompetencën e Gjykatës Kushtetuese për të bërë interpretimin përfundimtar më një nga gjykimet që mund të realizojë Gjykata Kushtetuese sipas nenit 131 të Kushtetutës.<sup>129</sup> Ndërsa mendimi tjetër e konsideron togfjalëshin në nenin 124, pika 1 e Kushtetutës, si një kompetencë më vetë, të pavarur që jo domosdoshmërisht lidhet me një nga gjykimet që parashikon neni 131 i Kushtetutës. Ky fakt përforcohet më tej edhe nga LGJK e cila në neni 71 të tij parashikon si gjykim të posaçëm pikërisht interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.

Ky detyrim për të “interpretuar” Kushtetutën kur kërkohet nga zyrtarë, zakonisht të njëjtët zyrtarë që mund të kundërshtojnë edhe ligjin, është manifestim i qartë i kompetencave këshillimore të kësaj gjykate dhe të funksionit të saj parësor për të asistuar zyrtarët legjislativë dhe qeveritarë në përputhje me ligjin dhe kushtetutën. Një nga qëllimet është për të shmangur

<sup>129</sup> Mendimi në pakicë i gjyqtarit kushtetues, Petrit Ploçi, në vendimet nr.75, datë 19.4.2002 dhe nr.24, datë 9.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

Sadushi, Sokol, “Drejtësia kushtetuese në zhvillim”, Shtëpia Botuese “Toena”, Tiranë 2012, fq.205-206.



problemet kushtetuese përpara se ato të shfaqen. Autoriteti për të “interpretuar” i ofron Gjykatës Kushtetuese mundësinë për të “krijuar” Kushtetutën, duke zhvilluar një doktrinë kushtetuese edhe kur nuk ka një mosmarrëveshje konkrete.<sup>130</sup>

Duke pasur në konsideratë jurisprudencën e deritanishme të Gjykatës Kushtetuese si edhe qëndrimin e mbajtur në doktrinë,<sup>131</sup> sipas të cilës kemi një qëndrim të konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese për ekzistencën e një gjykimi të tillë të pavaruar nga gjykimet e tjera, atëherë mund të themi se interpretimi përfundimtar i Kushtetutës është një gjykim i posaçëm dhe i veçantë.

Objekti i gjyimit në këtë rast nuk është ndonjë akt por më saktë është kuptimi i normave kushtetuese. Pra, gjatë këtij gjykimi Gjykata Kushtetuese analizon kuptimin e normave kushtetuese, kuptimin që i kanë dhënë atyre organet që i kanë zbatuar dhe keqkuptimin që mund të ketë lindur si pasojë e zbatimit të saj në praktikë. Pikërisht në këtë rast kur kemi interpretime të ndryshme mund t’i kërkohet Gjykatës Kushtetuese të bëjë interpretimin përfundimtar të normës konkrete.

Në këtë aspekt është e rëndësishme të flitet për kushtet procedurale që duhet të plotësohen në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të pranojë të zhvillojë një gjykim të tillë. Pra, cilat janë ato rrethana, vërtetimi i të cilave mundëson që një gjykim i tillë të ketë objekt. Fillimisht, referuar jurisprudencës së saj, mjaftonte që subjektet të paraqisnin një pyetje në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykata jepte një interpretim në lidhje me kuptimin e dispozitës që ishte paraqitur për interpretim përpara saj.<sup>132</sup> Ndërsa subjektet e kushtëzuara duhej vetëm që të justifikonin interesin e tyre për pyetjen që bënin në lidhje me interpretimin përfundimtar të një norme kushtetuese.<sup>133</sup>

Në sistemin Evropian, një kërkesë për një interpretim të tillë, duhet që të marrë një përgjigje edhe në mungesë të një mosmarrëveshje konkrete, të një legjislacioni të kundërshtuar apo të ndonjë referimi nga gjykatat. Çështja është totalisht abstrakte. Vendimi për rrjedhojë bazohet vetëm në tekstin e dispozitave kushtetuese, pa pasur përfitimin për ti parë ato në kontekstin e zbatimit mbi një normë ligjore konkrete dhe në një situatë ekonomike apo shoqërore në të cilin një vendim gjyqësor merret zakonisht. Vendimi i mëvonshëm gjyqësor mund të jetë i ndryshëm nga ajo që mund të sugjerohet bazuar vetëm në formulimin e dispozitës, pasi nëse gjykata sheh se si një normë zbatohet, ajo mund të vendosë në mënyrë të ndryshme nga ajo që ka vendosur bazuar vetëm në formulimin e normës.<sup>134</sup>

Më pas disa vende filluan të kishin një tjetër qasje jurisprudenciale. Kështu, Gjykata Kushtetuese Ruse ka refuzuar që në fillim që të japë një interpretim kushtetues, nëse një interpretim i tillë nuk është i nevojshëm, nëse mjete të tjera janë në dispozicion të palëve dhe nëse nuk ka asnjë mosmarrëveshje konkrete.<sup>135</sup>

Kjo mënyrë veprimi, duke përfshirë në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, të çdo kërkesë, që përmbante pyetje të shtruara për mënyrën se si duhej kuptuar dispozita konkrete

<sup>130</sup> Schwartz, Herman, *“The struggle for constitutional justice in post-communist Europe”*, Shtëpia Botuese “The University of Chicago Press”, Chicago 2000, fq.26.

<sup>131</sup> Sadushi, Sokol, *“Drejtësia kushtetuese në zhvillim”*, Shtëpia Botuese “Toena”, Tiranë 2012, fq.206.

<sup>132</sup> Vendimet nr.77, datë 31.12.1998, nr.8, datë 3.3.2000, nr.37, datë 23.6.2000, nr.38, datë 23.6.2000, nr.39, datë 23.6.2000, nr.6, datë 18.1.2002 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>133</sup> Vendimi nr.49, datë 31.7.2000 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>134</sup> Schwartz, Herman, *“The struggle for constitutional justice in post-communist Europe”*, Shtëpia Botuese “The University of Chicago Press”, Chicago 2000, fq.26.

<sup>135</sup> Po aty, fq.159.

kushtetuese, pa evidentuar ekzistencën e një mosmarrëveshjeje konkrete, sigurisht që e dha ndikimin e vet, për t'i dhënë një orientim tjetër jurisprudencës kushtetuese në vendin tonë.<sup>136</sup>

Në këtë drejtim Gjykata Kushtetuese ndryshoi qëndrimin e saj jurisprudencial duke kërkuar domosdoshmërisht ekzistencën e një mosmarrëveshjeje konkrete për mënyrën e interpretimit dhe kuptimit të një norme kushtetuese. Rasti i parë<sup>137</sup> ku Gjykata Kushtetuese ka mbajtur një qëndrim të tillë ka qenë vendimi nr.75, datë 19.4.2002, ku Gjykata u shpreh se:

*Në këto kushte:*

*- përderisa nga praktikat e mëparshme parlamentare dhe qëndrimet që janë mbajtur rezultoi se dispozitave konkrete të Kushtetutës i janë bërë interpretime që shprehen nëpërmjet vendimeve të Kuvendit;*

*- duke qenë se për këto dispozita ka edhe një qëndrim tjetër të ndryshëm nga i pari, i shprehur në kërkesën e një grupi deputetësh të Kuvendit, të cilët kanë inicuar këtë proces kushtetues,*

*Gjykata Kushtetuese konkludon se kryerja e një interpretimi përfundimtar të neneve 128, 140 dhe 149 pika 2 të Kushtetutës bëhet e domosdoshme pasi krijon mundësinë e mënjanimin të mosmarrëveshjeve apo paqartësive që mund të lindin nga zbatimi në praktikë i tyre.*

Në këtë rast Gjykata Kushtetuese u ndodh përpara faktit kur Kuvendi kishte mbajtur qëndrime të ndryshme në disa procedura për shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, praktika të cilat binin në kundërshtim me njëra – tjetrën. Për këtë arsye, Gjykata konkludoi se ndodhej përpara një mosmarrëveshjeje konkrete për kuptimin e normave kushtetuese.

Ky ndryshim i jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese paraqet një problem parimor. Kështu si në këtë vendim, ashtu edhe në të tjerët që pasuan, Gjykata Kushtetuese nuk ka dhënë asnjëherë arsyet e këtij ndryshimi. Pavarësisht se evoluimi i jurisprudencës është gjithmonë i mirëpritur, Gjykata Kushtetuese duhet që gjithmonë të japë arsye bindëse për ndryshimin e praktikës së saj.

Precedenti i vendosur nga vendimmarrja e mësipërme u përforcua me vendime të tjera. Kështu, në vendimin nr.18, datë 14.5.2003, Gjykata Kushtetuese mbasi konstatoi se kishte praktika të ndryshme nga Kuvendi për mënyrën e ngritjes së komisioneve hetimore, pranoi që të bënte interpretim të nenit 77 të Kushtetutës. Rast tjetër ishte mënyra e ndryshme e interpretimit të neneve 125 dhe 136 të Kushtetutës për emërimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilën Gjykata Kushtetuese e zgjidhi me vendimin nr.2, datë 18.1.2005. Një rast tjetër ishte kur Kuvendi mbajti një qëndrim të ndryshëm për procesin e votimit për dhënie pëlqimi për emërimin e një anëtari të Gjykatës së Lartë. Rasti kishte të bënte me kuptimin që duhet të kishte neni 78 pika 1 e Kushtetutës.<sup>138</sup>

Por vetëm më vonë Gjykata Kushtetuese vendosi që të japë një kuptim jurisprudencial dhe doktrinor të kushteve që duhet të plotësonin subjektet që kërkonin interpretimin përfundimtar

<sup>136</sup> Sadushi, Sokol, "Drejtësia kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq.207.

<sup>137</sup> Në doktrinë përcaktohet si vendimi i parë, vendimi nr.18, datë 14.5.2003 i Gjykatës Kushtetuese, kur u mbajt për herë të parë një qëndrim i tillë. (Sadushi, Sokol, "Drejtësia kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq.207.) Por duke iu referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese rezultoi se ky përcaktim nuk është i saktë.

<sup>138</sup> Vendimi nr.29, datë 21.10.2009 i Gjykatës Kushtetuese.

të një norme kushtetuese. Më konkretisht, në vendimin nr.24, datë 9.6.2011, Gjykata Kushtetuese mbajti këtë qëndrim:

*9. Gjykata, për t'u shprehur për interpretimin e normës kushtetuese, në kuptim të nenit 124 të Kushtetutës, kërkon plotësimin e disa kushteve.*

*9.1 Së pari, kërkohet ekzistenca e një marrëdhënieje të ngushtë ndërmjet fakteve dhe normës konkrete. Gjykata mund dhe duhet të investohet vetëm nëse interpretimi që i kërkohet është i lidhur me një mosmarrëveshje konkrete, që ka lindur si pasojë e zbatimit ose kuptimit të ndryshëm/gabuar të normës kushtetuese. Ajo bën interpretimin e normës kushtetuese vetëm nëse vlerëson se gjendet para një "problemi kushtetues" dhe synon zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje. Nëse do të pranohet një interpretim ad contrario, Gjykata do të gjendej para një situatë ku produkt i interpretimit do të ishin opinione për mënyrën se si duhet të sillen, në të ardhmen, institucionet shtetërore ose do të përfundonte duke ushtruar një kontroll ex ante të veprimtarisë së këtyre institucioneve, pa pasur një mosmarrëveshje konkrete.*

*9.2 Së dyti, kërkohet që organet, të cilat zbatojnë normën kushtetuese, të kenë mbajtur qëndrimin e tyre për kuptimin/interpretimin e kësaj norme. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se qëndrimet e mbajtura nga një organ për interpretimin e normave konkrete të Kushtetutës, që shprehen nëpërmjet vendimeve të këtij organi, janë të njaftueshme për kryerjen e një interpretimi përfundimtar, pasi kjo krijon mundësinë e mënjanimin të mosmarrëveshjeve ose paqartësive që mund të lindin nga zbatimi në praktikë i tyre (shih vendimet nr.75, datë 19.04.2002; nr.18, datë 14.05.2003; nr.2, datë 19.01.2005; nr.29, datë 21.10.2009 të Gjykatës Kushtetuese).*

*9.3 Së treti, Gjykata e ushtron këtë kompetencë nëse vlerëson se problemi kushtetues ka ardhur si pasojë e paqartësive në zbatimin e normës kushtetuese dhe jo nëse për zgjidhjen e tij nevojitet ndryshimi i ligjeve të zakonshëm, sepse në të kundërt ajo do të merrte kompetencat e organeve të tjera, në këtë rast të organit ligjvënës.*

Kushtet e mësipërme duhet që të plotësohen në mënyrë kumulative, pra të gjitha bashkarisht, në mënyrë që të plotësohen kushtet për një gjykim të tillë. Ky qëndrim është mbështetur edhe nga vendime të tjera të Gjykatës Kushtetuese.<sup>139</sup>

## **2.2 Procesi i kontrollit të amendamentit kushtetues.**

Struktura juridike e një shteti ka si bazë dhe themel të tij kushtetutën, e cila konsiderohet si akti juridik me fuqinë më të lartë, rregullim të cilin e ruan edhe Kushtetuta jonë.<sup>140</sup> Për këtë qëndrim ka një konsensus të gjerë në doktrinë. Me qëllim që të sigurohet jetëgjatësia e një kushtetute është e domosdoshme që ajo të rishikohet, të ndryshojë.<sup>141</sup> Por, për të shmangur pasojat negative që mund të vijnë në këto raste, të cilat janë ndryshimi i aktit themelor për arsye të ngushta politike dhe të përfitimit me pushtetin, procedurat për ndryshimin e tyre parashikohen përgjithësisht shumë të përforcuara. Shkalla e vështirësisë së procedurave ndryshon nga njëri vend në tjetrin dhe në këtë drejtim ekzistojnë modele të ndryshme. Por ajo që ngrihet me forcë në kushtetutat aktuale, jurisprudencën kushtetuese dhe doktrinën e vendeve të ndryshme është

<sup>139</sup> Vendimet nr.29, datë 30.6.2011 dhe nr.59, datë 23.12.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>140</sup> Kushtetuta, neni 4, pika 2.

<sup>141</sup> Po aty, fq.35.

ruajtja e një pjesë të Kushtetutës e cila përbën thelbin e saj, ndryshimi i së cilës sjell në vetvete një Kushtetutë të re. Kjo pjesë e Kushtetutës njihet si bërthama e saj. Përsa i përket Kushtetutës sonë, jam i mendimit që pjesa e parë e saj, ku trajtohen parimet themelore dhe pjesa e dytë që trajton të drejtat dhe liritë themelore përbëjnë bërthamën e Kushtetutës dhe si të tilla nuk mundet që të ndryshohen.

Mbrojtja e kësaj bërthame i është lënë si kompetencë, në shumë vende, gjykatave kushtetuese (ose organeve të tjera që ushtrojnë juridiksion kushtetues). Megjithë luhatjet, në doktrinë është shfaqur mendimi se edhe Gjykata jonë Kushtetuese në mungesë të një kompetence të shprehur mund ta ushtrojë një kontroll të tillë.<sup>142</sup> Mundësia që është diskutuar, i referohet të drejtës që ka Gjykata Kushtetuese për të kontrolluar kushtetutshmërinë e çështjeve të shtruara për referendum, referuar nenit 152 të Kushtetutës, ku ndër të tjera përfshihet edhe e drejta e gjykatës të kontrollojë *ex ante* çështjen e shtruar për referendum kushtetues.<sup>143</sup>

Në këndvështrimin tim personal kjo rrugë nuk e arrin qëllimin për të cilin po diskutojmë. Kontrolli kushtetues i referendumeve ka si qëllim që të verifikojë nëse çështja e shtruar për referendum përfshihet në një nga ato raste për të cilat ka ndalim kushtetues që një referendum i tillë të zhvillohet. Këto kufizime në mënyrë të shprehur janë dhënë nga neni 151, pika 2 e Kushtetutës, por Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr.8, datë 8.3.2013 ka përcaktuar se nga dispozita të tjera kushtetuese mund të rrjedhin edhe ndalime të tjera ndaj nismës për zhvillimin e referendumit. Në përfundim të këtij procesi Gjykata Kushtetuese vëren vetëm nëse çështja e shtruar për referendum kushtetues përfshihet në një nga këto ndalime apo jo. Nëse ka ndalim, Gjykata vendos mos mbajtjen e referendumit me pasojë, në rastin tonë, hyrjen në fuqi të amendamentit kushtetues. Në rastin e kundërt, nëse nuk vëren ndalim atëherë shprehet se referendumit mund të mbahet.

Bazuar sa më sipër, vërejmë se Gjykata Kushtetuese nuk mundet të shprehet në lidhje me pajtueshmërinë e amendamentit kushtetues me vetë parimet bazë të Kushtetutës. Një gjykim i tillë nuk mundet që ta ofrojë këtë mundësi pasi në këtë rast Gjykata Kushtetuese nuk gjykon ndonjë akt. Amendamenti vetë duke i'u nënshtruar procedurës së referendumit, nuk ka hyrë në fuqi dhe për rrjedhojë bie jashtë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese. Në mbështetje të këtij argumenti vjen edhe parashikimi i nenit 132 të Kushtetutës sipas të cilit, Gjykata Kushtetuese ka të drejtë që vetëm të shfuqizojë aktet që shqyrton. Duke qenë se në këtë fazë amendamenti nuk ka hyrë në fuqi, rezulton e pamundur për Gjykatën Kushtetuese që ta shfuqizojë atë. Siç e theksuam edhe më sipër, gjykimi kushtetues mbi referendumet është një gjykim i cili ka si qëllim lejimin ose jo të zhvillimit të referendumit dhe jo analizimin e aktit që i nënshtrohet referendumit.

Zgjidhja në këtë rast është referimi në vetë të drejtën që ka Gjykata Kushtetuese për të kontrolluar pajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën sipas nenit 131 shkronja "a" të aktit themelor, e interpretuar bashkarisht me nenin 124 të Kushtetutës, që i njeh Gjykatës, rolin e garantit të aktit themelor të vendit. Është e vërtetë që kjo dispozitë në rradhë të parë i drejtohet ligjeve të tjera, por jam i mendimit se në këtë rast nuk ka asnjë pengesë që kjo dispozitë të zbatohet edhe për amendamentet që sjellin ndryshime në Kushtetutë. Referuar përvojës së deritanishme shqiptare rezulton se, si miratimi i Kushtetutës dhe të gjitha ndryshimet që janë bërë në të janë bërë me "ligje". Kështu, Kushtetuta është miratuar me ligjin nr.8417, datë

<sup>142</sup> Sadushi, Sokol, "Drejtësia kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq.222.

<sup>143</sup> Po aty, fq.223.



21.10.1998 nga Kuvendi Popullor<sup>144</sup> dhe është amenduar me ligjin nr.9675, datë 13.1.2007, me ligjin nr.9904, datë 21.4.2008 dhe së fundmi me ligjin nr.88/2012. Vetë Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka pranuar se amendamenti kushtetues formalisht vishet me formën e një “ligji”.<sup>145</sup> Duke i'u rikthyer nenit 131, shkronja “a” të Kushtetutës, rezulton se kjo dispozitë parashikon të drejtën e Gjykatës Kushtetuese për të kontrolluar pajtueshmërinë e “ligjeve” me Kushtetutën. Pra ky “ligj” në mënyrë të zgjeruar përfshin edhe amendamentet kushtetuese dhe për rrjedhojë këto të fundit mundet që të verifikohen nëse janë në përputhje me parimet bazë të Kushtetutës dhe përkatësisht me bërthamën e saj.

Si referencë mbështetëse për këtë argument mund të përmendim përvojat e vendeve të tjera. Në Itali, Kushtetuta hesht në lidhje me të drejtën e Gjykatës Kushtetuese për të kontrolluar kushtetutshmërinë e ligjeve për rishikimin e Kushtetutës, por kjo e fundit ka mbajtur qëndrimin se:

*Kushtetuta italiane përmban disa parime të larta që nuk mundet që të përmbysen apo të ndryshohen në përmbajtjen e tyre thelbësore nga ligje për rishikimin kushtetues apo nga ligje të tjera kushtetuese. Këto janë vetëm parimet që vetë Kushtetuta në mënyrë të shprehur i parashikon si kufij absolutë të rishikimit kushtetues, si për shembull forma republikane (neni 139 i Kushtetutës), si edhe ato parime që megjithëse nuk citohen shprehimisht si të përjashtuara nga procesi i rishikimit kushtetues, i përkasin pa dyshim thelbit të vlerave të larta mbi të cilat bazohet Kushtetuta Italiane.*

*Për këtë arsye nuk mundet që t'i mohohet kësaj gjykate që të jetë kompetente për të gjykuar në lidhje me pajtueshmërinë e ligjeve për rishikimin e kushtetutës dhe të ligjeve të tjera kushtetuese përkundrejt parimeve të larta të strukturës kushtetuese. Nëse nuk do të ishte kështu, atëherë rezultati do të ishte absurd pasi do të konsiderohej sistemi i garancive kushtetuese si defektos dhe jo efektiv pikërisht në drejtim të normave të saj me vlerë më të lartë.<sup>146</sup>*

Ky deklaram i rëndësishëm i Gjykatës Kushtetuese Italiane u bë gjatë një kontrolli *ex post* të iniciuar nga gjykatat e zakonshme në kuadër të një gjykimi incidental. Kjo përvojë mendoj se vlen edhe për ne duke qenë se jurisprudenca kushtetuese italiane ka shërbyer shpesh si udhërrëfyes për jurisprudencën kushtetuese shqiptare.

Në të njëjtën linjë kanë vepruar edhe gjykata të tjera kushtetuese, ku ajo gjermane, austriake dhe turke i kanë përshtatur një përgjigje pozitive pyetjes nëse amendamentet kushtetuese mund të konsiderohen si “ligje”. Këto gjykata kanë deklaruar se kanë juridiksion në lidhje me amendamentet kushtetuese dhe për rrjedhojë kanë rishikuar përputhshmërinë e tyre me kushtetutën.<sup>147</sup> Rezulton se Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane ka ushtruar një kompetencë të tillë (në mungesë të një parashikimi kushtetues të shprehur por duke i konsideruar amendamentet kushtetuese si ligje) në vendimet e datave 15.12.1970, 23.4.1991, 18.4.1996, 14.5.1996 dhe 3.3.2004. Mbi po të njëjtën llogjikë Gjykata Kushtetuese Austriake ka ushtruar një kompetencë të tillë me vendimet e datave 12.12.1952, 23.6.1988, 29.9.1988 dhe 10.3.2001.

<sup>144</sup> Organi legjislativ përpara Kushtetues së vitit 1998 njihet me termin “Kuvendi Popullor”. Mbas hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute njihet me termin “Kuvendi”.

<sup>145</sup> Vendimi nr.25, datë 24.7.2009 i Gjykatës Kushtetuese, parag.7.

<sup>146</sup> Vendimi nr.1146 i vitit 1988 i Gjykatës Kushtetuese Italiane, marrë nga faqja zyrtare e internetit [www.cortecostituzionale.it](http://www.cortecostituzionale.it).

<sup>147</sup> Gözler, Kemal, “Judicial Review of constitutional amendments”, Shtëpia Botues “Ekin Press”, Bursa – Turqi 2008, fq.22.

Gjykata Kushtetuese e Turqisë me vendimet nr.1970/31, datë 16.6.1970 dhe nr.1971/37, datë 3.4.1971 e deklaroi veten kompetente për të rishikuar kushtetueshmërinë e amendamenteve kushtetuese. Sipas saj, "ligjet e amendamenteve kushtetuese", janë gjithashtu "ligje" të cilat janë objekt i juridiksionit të saj.<sup>148</sup>

Si referencë mund të përmendim edhe vetë jurisprudencën e Gjykatës sonë Kushtetuese e cila të paktën në një rast, ka kontrolluar pajtueshmërinë e një ndryshimi kushtetues me ligjet kushtetuese të kohës.<sup>149</sup> Kjo jurisprudencë kushtetuese, që rezultoi më tepër si një reaktion politik se sa një vendim i drejtësisë kushtetuese, ishte rezultat i një konflikti mjaft të mprehtë të shkaktuar ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe Kuvendit.<sup>150</sup> Thelbi i kësaj vendimmarrjeje lidhet me rotacionin që duhet të kryente Gjykata Kushtetuese në vitin 1995. Sipas parashikimeve kushtetuese të kohës<sup>151</sup> Gjykata Kushtetuese, tre vjet pas krijimit të saj duhej që të kryente zëvendësimin e tre anëtarëve ekzistues me tre anëtarë të rinj. Por në vitin 1994 tre anëtarë të saj dhanë dorëheqjen dhe në janar të vitit 1995 u zëvendësuan me tre anëtarë të tjerë. Këtë zëvendësim të anëtarëve, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.4, datë 2.6.1995, e konsideroi të kryer dhe për të nuk kishte më vend për hedhjen e shortit. Kuvendi Popullor, në vitin 1997, duke mos qenë dakort me këtë rotacion miratoi ligjin kushtetues nr.8257, datë 19.11.1997 "Për një plotësim në ligjin nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", në thelb të të cilit, rotacioni i parë nuk konsiderohej i kryer dhe Gjykata Kushtetuese duhej që ta realizonte atë brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.<sup>152</sup>

Duke e konsideruar këtë ligj si ndërhyrje në pavarësinë dhe fuqinë e vendimeve të saj, Gjykata Kushtetuese, bazuar në të drejtën që kishte për t'u venë në lëvizje kryesisht,<sup>153</sup> vendosi të konstatojë pavlefshmërinë konstitucionale të nenit 2 të ligjit të sipërcituar, pikërisht të dispozitës që e detyronte të kryente rotacionin e parë brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit. Në thelb të arsytimit, Gjykata Kushtetuese shprehej se vendimet e saj kishin fuqi detyruese të përgjithshme dhe nuk mundet që të viheshin në diskutim dhe të shfuqizoheshin nga organet e tjera shtetërore përfshirë edhe Kuvendin Popullor.

Konflikti i mprehtë që u krijua u zgjidh vetëm mbas opinionit *amicus curiae* që dha Komisioni i Venecias.<sup>154</sup> Në thelb të këtij opinionit, Komisioni, megjithëse kritikoi vendimin e parë të Gjykatës Kushtetuese dhe ndërhyrjen e mëvonshme të Kuvendit Popullor, e konsideronte të papërgjegjshme vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese për të shfuqizuar një ligj kushtetues. Konkluzioni i Komisionit bazohej në dy pika kryesore të cilat ishin:

a) Ligji për dispozitat kryesore kushtetuese nuk i njihte shprehimisht të drejtën Gjykatës

<sup>148</sup> Po aty, fq.22-14.

<sup>149</sup> Ligji nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", i ndryshuar dhe plotësuar disa herë më ligje të tjera kushtetuese.

<sup>150</sup> Sadushi, Sokol, "Drejtësia kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq.223.

<sup>151</sup> Ligji kushtetues nr.7561, datë 29.04.1992, "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", neni 18.

<sup>152</sup> Referuar përmbatjes së vendimit nr.57, datë 5.12.1997 të Gjykatës Kushtetuese rezultoi se shkaqet që çuan ligjvënësin kushtetues në miratimin e këtij ligji ishin moskryerja e rotacionit dhe shfuqizimi i një ligji për kontrollin e firmave piramidave që kishin vepruar në atë kohë. Sipas ligjvënësist kushtetues këto tregonin karakterin politik të veprimtarisë së Gjykatës Kushtetuese në atë kohë.

<sup>153</sup> Ligji kushtetues nr.7561, datë 29.04.1992, "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", neni 25.

<sup>154</sup> Opinioni i datës 17 prill 1998, CDL-INF (98) 9, i Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), format elektronik "pdf", fq.11, paragrafi 43, marrë nga faqja zyrtare e internetit të Komisionit <http://www.venice.coe.int/webforms/documents/?opinion=54&year=all>. (parë për herë të fundit me datë 16.7.2014)

Kushtetuese për të kontrolluar pajtueshmërinë e ndryshimeve kushtetuese me ligjin kushtetues;

b) Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese nuk është shkak pengues për ligjvënësin kushtetues që të miratojë ndryshime kushtetuese edhe pse këto ndryshime heqin bazën kushtetuese të vendimmarrjes më të hershme të kësaj gjykate.

Megjithatë, pavarësisht konotacionit politik që pati dhe pavarësisht faktit se kjo praktikë ka ndodhur përpara se të hynte në fuqi Kushtetuta aktuale, rezulton se ky kontroll kushtetutes ndoqi pikërisht të njëjtat parime që po diskutojmë në këtë punim. Kontrolli i realizuar në këtë rast ka qenë *aposteriori*, në mungesë të një parashikimi të qartë nga ligjet kushtetuese të kohës që i jepte të drejtë Gjykatës që ta ushtronte këtë kompetencë.

Edhe pse Komisioni i Venecias u shpreh në parim kundër të drejtës së Gjykatës Kushtetuese për të kontrolluar kushtetutshmërinë e ndryshimeve të ligjit për dispozitat kryesore kushtetuese, përsëri Komisioni e la të hapur këtë mundësi duke u shprehur me tej se "*Gjykata Kushtetuese, për rrjedhojë nuk mundet që të kundërshtojë amendamente kushtetuese të cilat në asnjë mënyrë nuk çënojnë parimet themelore.*"<sup>155</sup> Pikërisht kjo shprehje në mendimin tim, e legjitimon Gjykatën Kushtetuese në kontrollin dhe analizën e amendamenteve kushtetuese nëse pretendohet cënim i bërthamës kushtetuese, e cila pikërisht përbëhet nga parimet themelore. Për këtë arsye jam i mendimit që ky vendim mund të shërbejë si precedent edhe për kohët e sotme.

Objekt i kontrollit në një gjykim kushtetues mund të jetë vetëm amendamenti kushtetues në formën e tij finale, pra i miratuar dhe në fuqi. Duke qenë një kontroll *aposteriori*, Gjykata Kushtetuese është e autorizuar që të kontrollojë rishikimin e Kushtetutës, por vetëm mbasi procedura për rishikimin e saj ka përfunduar.<sup>156</sup> Në këtë pikë nuk ka rëndësi nga pikëpamja juridike nëse amendamenti kushtetues është miratuar në Kuvend apo nëpërmjet referendumit sipas rasteve të parashikuara nga pikat 4 dhe 5 të nenit 177 të Kushtetutës. Ky kontroll nuk mundet që të shtrihet në arsyet apo motivet e zgjedhjes së ligjvënësit kushtetues.<sup>157</sup> Kufijtë e kontrollit kushtetues në këtë rast shtrihen në faktin nëse amendamentet kushtetuese të miratuara prekin apo jo bërthamën e kushtetutës.<sup>158</sup> Pra, qëllimi mbetet që amendamentet kushtetuese të mos ndryshojnë strukturën thelbësore të Kushtetutës.<sup>159</sup>

Janë jashtë kontrollit kushtetues, kontrolli i akteve me natyrë kushtetuese të cilat janë pjesë e formimit të shtetit si akti i shpalljes së pavarësisë dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat kanë përcaktuar kufijtë e shtetit shqiptar.<sup>160</sup> Ky lloj sqarimi është i rëndësishëm pasi në bazë të nenit 180 të Kushtetutës marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara përpara hyrjes në fuqi të Kushtetutës, mund të bëhen objekt konflikti në Gjykatën Kushtetuese, por duke qenë se vendimet e Konferencës së Ambasadorëve të Londrës dhe të Parisit si edhe protokollat e Firences të viteve 1914 dhe 1925, që kanë përcaktuar kufijtë e territorit të shtetit tonë, në këtë

<sup>155</sup> Po aty.

<sup>156</sup> Vendimi nr. U-II-603/2001, datë 28.03.2001 i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë, marrë nga përmbledhja elektronike "CODICES" e Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), me numër referimi CRO-2001-1-004.

<sup>157</sup> Vendimi nr. 90/94, datë 22.12.1994 i Gjykatës së Arbitrazhit të Belgjikës, marrë nga përmbledhja elektronike "CODICES" e Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), me numër referimi BEL-1994-3-021.

<sup>158</sup> Vendimi 2 BvR 1938/93, 2 BvR 2315/93, datë 14.05.1996 i Senatit të Dytë të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane, marrë nga përmbledhja elektronike "CODICES" e Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), me numër referimi GER-1996-2-014.

<sup>159</sup> Vendimi nr. G 103/00, datë 28.06.2001 i Gjykatës Kushtetuese të Austrisë, marrë nga përmbledhja elektronike "CODICES" e Komisionit Demokraci përmes ligjit (Komisioni i Venecias), referuar me numrin AUT-2001-2-004.

<sup>160</sup> Shih për analogji vendimin nr. U-I-332/94, datë 11.04.1996 të Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë, marrë nga përmbledhja elektronike "CODICES" e Komisionit Demokraci përmes ligjit (Komisioni i Venecias), me numër referimi SLO-1996-S-004.



rast kanë natyrë kushtetuese, atëherë ato janë edhe pjesë e bërthamës së saj. Përkundrazi, në praktikë situata mund të shfaqet e tillë ku mund të kemi amendamente kushtetuese të cilat mund të kontrollohen nëse janë në përputhje me këto marrëveshje.

Një tjetër aspekt që vlen për diskutim është pajtueshmëria e normave kushtetuese me normat e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Konventa për shkak të parashikimit të nenit 17, pika 2 e Kushtetutës përcakton standardet minimum që duhet të ketë në konsideratë Shteti Shqiptar në kufizimin e të drejtave themelore të njeriut. Duke qenë se më sipër përmendëm faktin se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë pjesë e bërthamës së Kushtetutës atëherë është mëse e qartë se detyrimi i respektimit të standardeve të Konventës bie edhe mbi ligjvënësin kushtetues. Pra, kontrolli kushtetues mbi amendamentet kushtetuese shtrihet vetiu edhe mbi përputhshmërinë e amendamenteve të propozuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ky rregull nuk vlen për normat kushtetuese ekzistuese. Pra, nuk mundet që të kërkohet sot përpara Gjykatës Kushtetuese kontrolli i pajtueshmërisë së një norme kushtetuese me Konventën. Gjykata Kushtetuese duhet që gjithmonë të bazohet në tekstin e Kushtetutës, e cila në këtë rast nuk e lejon atë që të ushtrojë juridiksionin e saj në atë mënyrë që të shprehet mbi pajtueshmërinë e pjesëve të Kushtetutës me standarde të tjera, bazuar në detyrimin e Gjykatës për të garantuar respektimin e Kushtetutës.<sup>161</sup>

Kontrolli kushtetues, mundet dhe duhet që të shtrihet mbi çdo amendament kushtetues. Rishikimi i Kushtetutës mund të prekë disa pjesë të kushtetutës dhe për rrjedhojë prekja e bërthamës së Kushtetutës mund të jetë e drejtpërdrejtë ose indirekte. Në rastin e parë amendamenti kushtetues prek pikërisht parashikime të cilat konsiderohen si të pacënueshme dhe për rrjedhojë çënon strukturën e parimeve në Kushtetutë. Në rastin e dytë, rishikimi i Kushtetutës prek pjesë të tjera që në pamje të parë nuk kanë të bëjnë me bërthamën e saj. Megjithatë, përvoja e vendeve të tjera ka treguar se këto ndryshime mund të sjellin cenim të bërthamës së kushtetutës. Nëse një amendament kushtetues prek përmbajtjen e një dispozite të parëvokueshme të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese ka kompetencë të kontrollojë përputhshmërinë me Kushtetutën të këtij ndryshimi. Shembuj të tilla gjejmë në Turqi, ku amendamenti i propozuar për lejimin e mbajtjes së shamisë në institucionet arsimore u konsiderua nga Gjykata Kushtetuese si një cenim indirekt i parimit të laicitetit që përshkon Kushtetutën Turke.<sup>162</sup> Një tjetër shembull i ngjashëm vjen nga Kosova, ku Gjykata Kushtetuese, deklaroi si antikushtetuese amendamentet kushtetuese që kishin të bënin me ndërprerjen e mandatit të Presidentit, kufizimin e kompetencave të Kryetarit të Kuvendit si ushtrues i detyrës së Presidentit, për emërimin e gjyqtarëve, prokurorëve, të ushtrimit të së drejtës së faljes apo shpalljes së gjendjes së luftës dhe të jashtëzakonshme, si cënime indirekte të të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kreu II i Kushtetutës së Kosovës.<sup>163</sup>

Kontrolli kushtetues në këtë rast realizohet nëpërmjet krahasimit të amendamenteve

<sup>161</sup> Vendimi nr. U-5/04, datë 31.03.2006 i Gjykatës Kushtetuese të Bosnje-Herzegovinës, marrë nga përmbledhja elektronike "CODICES" e Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), me numër referimi BIH-2006-1-003.

<sup>162</sup> Vendimi nr. E.2008/16, K.2008/116, datë 05.06.2008 i Gjykatës Kushtetuese të Turqisë, marrë nga përmbledhja elektronike "CODICES" e Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), me numër referimi TUR-2008-3-007.

<sup>163</sup> Akgjykimi në rastet K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12, datë 20.7.2012 i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, marrë nga faqja zyrtare e internetit [www.gjk-ks.org](http://www.gjk-ks.org).



kushtetuese me dispozitat dhe parimet kushtetuese në fuqi.<sup>164</sup> Pra kemi të bëjmë me një kontroll abstrakt të normave.

### 2.3 Ligjet, si objekt i gjykimit kushtetues.

Kontrolli i ligjeve nga Gjykata Kushtetuese, është një nga kompetencat më të rëndësishme të këtij institucioni. Në fakt arsyeja kryesore për të cilën u ngrit një institucion i tillë ishte pikërisht mbrotja e parimeve dhe parashikimeve kushtetuese nga miratimi i ligjeve të cilat e kundërshtonin atë. Duke lënë mënjanë marrëveshjet ndërkombëtare, për shkak të natyrës së tyre të veçantë, në piramidën juridike shtetërore, ligjet janë aktet më të rëndësishme që vijnë mbas Kushtetutës dhe nëpërmjet të cilave si rregull shumicat parlamentare qeverisin vendin dhe synojnë realizimin e qëllimeve të tyre politike.

Duke iu referuar formulimit kushtetues, rezulton se objekt kontrolli sipas nenit 131 gërma "a" e Kushtetutës mund të jetë vetëm ligji. Kuptimi i termit ligj është përkufizuar nga Fjalori i Gjuhës Shqipe si normë a rregull që pranohet e që zbatohet si diçka e detyrueshme.<sup>165</sup> Fjalori Enciklopedik Shqiptar e përkufizon si akt normativ i organit më të lartë të pushtetit shtetëror, me të cilin rregullohen marrëdhëniet më të rëndësishme të shoqërisë dhe vihen rregulla të detyrueshme për institucionet, organizatat dhe shtetasit.<sup>166</sup> Një tjetër fjalor e konsideron si akt juridik të cilin e miraton Parlamenti (Kuvendi) me të cilin rregullohet sjellja e njerëzve në shoqëri dhe u garantohet shtetasve ndonjë e drejtë, ndalohej ndonjë sjellje apo veprim, ose u urdhërohet që të veprojnë në mënyrë të caktuar.<sup>167</sup> Duke iu referuar fjalorëve të huaj rezulton se ligji konsiderohet regjimi që rregullon aktivitetin dhe marrëdhëniet njerëzore, nëpërmjet zbatimit sistematik të një force politikisht të organizuar, apo nëpërmjet presionit shoqëror të mbështetur nga forca, në atë shoqëri.<sup>168</sup>

Nga analiza e dy fjalorëve tanë shkencorë rezulton se ai i Fjalorit Enciklopedik është me i plotë. Kështu ky fjalor e vë theksin tek karakteri normativ i ligjit, objekti i rregullimit të tij dhe detyrueshmëria për zbatim. Megjithatë Fjalori Enciklopedik paraqet një gabim në formulim. Ai e konsideron si akt të organit më të lartë të pushtetit shtetëror. Në fakt siç është përcaktuar edhe nga jurisprudenca kushtetuese, Kuvendi nuk është organi më i lartë i pushtetit shtetëror. Bazuar në parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, Kushtetuta jonë nuk njuh më organe të larta dhe të ulta, por njuh parimin e ndarjes dhe të balancimit midis pushteteve, duke mos i vendosur domosdoshmërisht në raporte hierarkike organet kushtetuese. Për këtë arsye përkufizimi që jepet nga fjalori tjetër duket si më i saktë. Ndërsa fjalori i huaj i jep shumë rëndësi garantimit të zbatimit të këtij akti.

Sipas doktrinës sonë juridike rezulton se termi që përdor neni 131 i Kushtetutës i referohet konceptit ligj, në kuptimin formal të tij duke përjashtuar aktet e tjera juridike që nuk kanë këtë emërtim. Bazuar në këtë kuptim doktrinor dhe duke e lidhur me përkufizimet që japin fjalorët tanë rezulton se ligj mund të konsiderohet akti normativ i miratuar nga Kuvendi, që sjell

<sup>164</sup> Hasani, Enver, "Kontrolli abstrakt dhe preventiv (paraprak) i amendamenteve kushtetuese dhe mbrotja nga shkakimi i shefit të shtetit: rasti i Kosovës.", botuar në Revistën "E Drejta – Pravo – Law", nr.1/2013, botim i USAID dhe Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, fq.56.

<sup>165</sup> "Fjalori i Gjuhës Shqipe", botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 2006, fq.556.

<sup>166</sup> Akademia e Shkencave të Shqipërisë, "Fjalori Enciklopedik Shqiptar", Shtypshkronja "Kristalina – KH", Vëllimi II, Tiranë 2008, fq.1520.

<sup>167</sup> Uka, Njazi, "Fjalori i Drejtësisë", Shtëpia Botuese "Iliar" P.F., Tiranë 2011, fq.411.

<sup>168</sup> "Black's Law Dictionary", botimi i nëntë, Shtëpia Botuese "West Publishing Co", Dallas 2009, fq.962.

rregulla të detyrueshme sjelljeje për institucionet, personat juridike dhe fizikë. Parimisht vetëm ky lloj akti mund të jetë objekt kontrolli në Gjykatën Kushtetuese. Terminologjia që përdor Kushtetuta në këtë rast qartazi përjashton projektligjet nga shqyrtimi kushtetues. Pra në këtë rast duhet që të kemi një akt ligjor i cili është miratuar nga Kuvendi dhe ka kaluar edhe procedurat e shqyrtimit nga Presidenti i Republikës, të publikimit dhe të hyrjes në fuqi.

Një tjetër kategori ligjesh që mund të përdoren në këtë rast janë edhe ligjet që kanë qenë miratuar nga organi legjislativ shqiptar përpara miratimit të Kushtetutës sonë. Parimisht këto norma, referuar nenit 178 të Kushtetutës, janë në fuqi deri sa nuk janë shfuqizuar nga Kuvendi. Në këtë drejtim ato mund të bëhen objekt kontrolli në Gjykatën Kushtetuese. Pavarësisht se në doktrinë është shfaqur mendimi që kushtetueshmëria e ligjeve që kanë të bëjnë me shpronësimet dhe konfiskimet e pronave të miratuara përpara hyrjes në fuqi të Kushtetutës, mund të bëhet nga gjykata e zakonshme në kuadër të një gjykimi të një mosmarrëveshje konkrete,<sup>169</sup> Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrim se një mënyrë veprimi e tillë do të cënonte kompetencat e saj kushtetuese, si i vetmi organ që mund të ushtrojë një kontroll të tillë kushtetues. Më konkretisht qëndrimi i Gjykatës është ky:

*Në nenin 8/2 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", që ka qenë në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes, përcaktohet se kur gjatë shqyrtimit të çështjes gjykata arrin në përfundimin se akti normativ nuk pajtohet me ligjin "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe me ligjet, ajo pezullon gjykimin dhe ia dërgon materialet e çështjes Gjykatës Kushtetuese. Për rëndësinë që ka kjo normë kushtetuese, e cila përcakton qartë kufirin e kompetencave, është sanksionuar edhe në nenin 145 të Kushtetutës. Në fakt, duke u shprehur për papajtueshmërinë me dispozitat kryesore kushtetuese të ligjit nr.355, datë 21.11.1946, gjykatat kanë tejkaluar kompetencat e tyre, duke ndërlyrë në kompetencat e Gjykatës Kushtetuese, prandaj vendimet e tyre janë antikushtetuese dhe procesi gjyqësor i parregullt.*

*...*  
*Për më tepër, në nenin 178/1 të Kushtetutës është sanksionuar parimi i rëndësishëm se ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të Kushtetutës, do të zbatohen derisa nuk janë shfuqizuar. Në interpretimin që i ka bërë kësaj dispozite Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.77, datë 31.12.1998, arsyeton se ky rregull do të zbatohet edhe për ato ligje apo akte normative që në tërësi apo pjesë të veçanta vijnë në kundërshtim me dispozita konkrete të Kushtetutës. Në këtë kuptim, arsyetimi i Kolegjit Civil se shfuqizohet çdo dispozitë ligjore që vjen në kundërshtim me frymën e këtyre ligjeve, është antikushtetues jo vetëm për shkak të tejkalimit të kompetencës, siç u përmend më lart, por edhe të qëndrimit në kundërshtim me sa parashikon dispozita kushtetuese.*

*...*  
*Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese duke iu rikthyer edhe një herë analizës që përbën thelbin e çështjes lidhur me qëndrimin e gjykatave ndaj ligjit nr.355, datë*

<sup>169</sup> Rado, Klodian, "Kontrolli incidental në Shqipëri", botuar në Revistën "Studime Juridike", Nr.2, i vitit 2006, botim i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Shtëpia Botuese "Pegi", fq.168: *Kjo mënyrë rregullimi e Kushtetutës shqiptare të 1998-ës, ku për ligjet që kanë hyrë në fuqi përpara Kushtetutës dhe që janë miratuar para hyrjes në fuqi të saj, gjykatat e zakonshme shqiptare kanë të drejtë ta vlerësojnë vetë kushtetueshmërinë e ligjit, duket se është frymëzuar nga Kushtetuta gjermane, e cila bën të njëjtin rregullim, por për të gjitha ligjet.*

21.11.1946, thekson se ky qëndrim është antikushtetues, sepse gjykata nuk ka të drejtë të mos e zbatojë një ligj që sipas saj ka karakter të theksuar politik. Në rast se gjykata çmon se ligji nuk pajtohet me Kushtetutën, ajo është e detyruar të pezullojë gjykimin dhe t'ia dërgojë çështjen Gjykatës Kushtetuese. Çdo qëndrim tjetër e bën procesin gjyqësor të parregullt.<sup>170</sup>

Një tjetër kategori ligji që mund të bëhet objekt kontrolli në Gjykatën Kushtetuese janë ligjet e shfuqizuara, por në këtë rast ndodhemi përballë dy situatave të ndryshme. Situata e parë e cila është shfaqur në praktikë lidhet me rastin kur një ligj që është në fuqi dhe objekt i gjykimit kushtetues, shfuqizohet apo zëvendësohet nga Kuvendi me norma të tjera ligjore. Në këtë rast, referuar edhe jurisprudencës kushtetuese të huaj, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur dy qëndrime. Sipas qëndrimit të parë, nëse normat e reja janë me përmbajtje të ndryshme nga normat e shfuqizuara të cilat u bënë objekt kontrolli kushtetues, Gjykata vendos pushimin e çështjes.<sup>171</sup>

Në qëndrimin e dytë, nëse dispozitat e ligjit të ri janë në përmbajtje të njëjta apo të ngjashme me ligjin e shfuqizuar, Gjykata Kushtetuese nuk e pushon gjykimin por duke shfrytëzuar mundësinë që i jep neni 48 i LGJK e shtrin gjykimin edhe në normat e reja. Më konkretisht Gjykata Kushtetuese ka mbajtur këtë qëndrim:

*Gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin nr. 10207, datë 23.12.2009 "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës" i ndryshuar".*

*Gjykata vëren se neni 2 i këtij ligji, që ndryshon nenin 18 të ligjit objekt shqyrtimi ka parashikuar kompetenca të Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP, për të shqyrtuar vendime të ish-KKKP-ve, kryesisht, ose pas ankimit të shtetasve apo organeve shtetërore, duke disponuar mbi këto vendime të pa ankimuara të KKKP-ve. Gjithashtu, Gjykata konstaton se neni 3 i ligjit të sipërpërmendur, i cili ndryshon nenin 16 të ligjit objekt shqyrtimi, parashikon të njëjtat kompetenca të Drejtorit të Përgjithshëm në lidhje me vendimmarrjen e strukturave të AKKP-ve në nivel lokal.*

*Në përputhje me nenin 48 të Ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", duke gjykuar se*

<sup>170</sup> Vendimi nr.97, datë 27.7.2001 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>171</sup> Vendimi nr.9, datë 19.3.2008 i Gjykatës Kushtetuese: *Gjatë fazës së diskutimit të kësaj çështjeje, Gjykata Kushtetuese konstatoi se Kuvendi, me ligjin nr.9832, datë 12.11.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", ka ndryshuar plotësisht pikën 1 të nenit 23 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", ndryshim i cili ka hyrë në fuqi me kalimin e afatit 15-ditor të botimit në Fletoren Zyrtare. E ndodhur para një fakti të tillë, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se nuk mund të shprehet për pretendimet e kërkuarve lidhur me pajtueshmërinë me Kushtetutën të fjalisë së tretë, pika 1, të nenit 23 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, pasi kjo dispozitë në momentin e vendimmarrjes nuk ekziston, sepse është ndryshuar tërësisht.*

Vendimi nr.3, datë 5.2.2010 i Gjykatës Kushtetuese: *Për këtë qëllim u miratua Ligji nr.10091, dt.05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i cili në nenin 61 të tij ("Dispozitat kalimtare") ka parashikuar se VKM nr.150, dt.31.03.2000 shfuqizohet me hyrjen në fuqi të ligjit. Për këtë arsye, Gjykata çmon se një akt, i cili nuk është më në fuqi dhe nuk sjell asnjë efekt juridik, nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga kjo Gjykatë.*

Vendimi nr.4, datë 12.2.2010 i Gjykatës Kushtetuese: *Nga analiza e mësipërme, Gjykata vlerëson, se për të gjitha pretendimet në lidhje me nenin 1, 8 dhe 12, për të cilat ligji i ri ka sjellë shtesa dhe ndryshime, çështja mbetet pa objekt, e për rrjedhojë, duhet të pushohet.*

*dispozitat e mësipërme kanë një lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e këtij gjykimi, Gjykata çmon se legjitimohet të marrë në shqyrtim nenet 2 dhe 3 të ligjit të ri.*<sup>172</sup>

Situata e dytë kur një ligj i shfuqizuar mund të bëhet objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese është kur ligji është shfuqizuar shumë kohë më parë por ende prodhon pasoja në marrëdhënie të caktuara juridike. Më konkretisht Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin e mëposhtëm:

*Megjithatë, në disa raste, këtij kontrolli i nënshtrohen edhe norma juridike të shfuqizuara, kur këto, si pjesë e të drejtës pozitive, duhet të zbatohen për rregullimin e pasojave juridike, që zgjasin në kohë dhe janë të lidhura me ekzekutimin periodik ose me afat të detyrimeve juridike civile, që rrjedhin nga marrëdhënie juridike të krijuara në kohën e ligjit të shfuqizuar.*<sup>173</sup>

Gjykata Kushtetuese në këtë rast i referohet marrëdhënieve juridike civile. Është parim i njohur që për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të natyrës juridike civile zbatohet gjithmonë ligji i kohës,<sup>174</sup> pavarësisht se ky ligj mund të jetë shfuqizuar në momentin kur bëhet objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese. E njëjta gjendje rezulton edhe për marrëdhëniet trashëgimore sipas të cilave zbatohet ligji i kohës kur është çelur trashëgimia.<sup>175</sup> Në po të njëjtin bazë arsyetimi janë edhe mosmarrëveshjet administrative. Kështu sipas LGJA-së, gjykatat administrative i zgjidhin mosmarrëveshjet duke zbatuar ligjin material dhe procedural që ishte në fuqi në momentin kur veprimi administrativ është kryer.<sup>176</sup> Mbi këtë bazë, ligjet megjithëse mund të jenë shfuqizuar janë ende bazë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes nga gjykatat e zakonshme. Në këtë drejtim nëse këto gjykata binden për antikushtetutshmërinë e pasojave që këto ligje sjellin, kanë të drejtë t'i bëjnë objekt kontrolli në Gjykatën Kushtetuese. Një qëndrim i tillë gjendet edhe në jurisprudencën kushtetuese të vendeve të tjera si për shembull në Austri.<sup>177</sup>

Një tjetër akt i cili bëhet objekt kontrolli në këtë gjykim janë edhe aktet normative me fuqinë e ligjit që miratohen nga Këshilli i Ministrave nën kushtet e nenit 101 të Kushtetutës. Këto akte, siç vetë Kushtetuta dhe jurisprudenca kushtetuese e kanë përcaktuar, kanë fuqinë e ligjit dhe barazohen me to. Për këtë arsye ato mund të jenë objekt gjykimi vetëm në këtë lloj gjykimi.

#### **2.4 Ometimi ligjor, si objekt i mundshëm në gjykimin kushtetues.**

Në praktikë janë shfaqur situata dhe raste kur fusha të caktuara kanë mbetur pa rregullim ligjor. Në këtë rast flasim për ometim legjislativ. Ometimi mund të jetë i pjesshëm, pra kur legjislacioni e rregullon pak ose në mënyrë të pamjaftueshme situatën, si edhe ometimi mund të jetë i plotë, kur marrëdhënia juridike nuk rregullohet aspak nga e drejta.

Mungesa e një rregullimi juridik mund të sjellë si pasojë cënim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, por mund të sjellë edhe të meta në funksionimin e strukturës shtetërore. Në

<sup>172</sup> Vendimi nr.27, datë 26.5.2010 i Gjykatës Kushtetuese, paragraf 59.

<sup>173</sup> Vendimi nr.2, datë 31.1.2003 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>174</sup> Vendimi nr.11, datë 23.4.2009 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>175</sup> K.C., neni 318.

<sup>176</sup> LGJA, neni 37, pika 1.

<sup>177</sup> D'Orlando, Elena, "La giustizia costituzionale in Austria", botuar në "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova, 2009, fq.121.



këtë situatë në disa raste ometimi legjislativ mund të shfaqë edhe probleme juridike me natyrë kushtetuese. Për këtë arsye, në disa gjykata kushtetuese shqyrtohet si pjesë e juridiksionit kushtetues edhe çështjet që kanë të bëjnë me ometimin legjislativ.

Me e njohura për këtë mundësi është Gjykata Kushtetuese e Portugalisë, e cila ka një kompetencë të shprehur, për të analizuar antikushtetueshmërinë që rrjedh nga ometimi legjislativ. Por ajo që duhet theksuar është se në këtë situatë Gjykata jep vetëm një vendim deklarativ, pasi nuk mundet që të krijojë vetë norma. Mbasi informohet nga Gjykata, organi legjislativ është i detyruar që të miratojë ligjet e duhura.<sup>178</sup> Është e kuptueshme që zbatimi i shpejtë ose i vonët i këtij detyrimi buron nga vullneti politik i ligjvënësit. Pra, në këtë rast ngrihen probleme të zbatueshmërisë së vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Legjislatori mund të refuzojë që të bindet ose, siç ka ndodhur në Hungari, e ka të veshtirë politikisht që të veprojë. Pamundësia e ligjvënësit për t'iu bindur Gjykatës, mund të çënojë prestigjin e kësaj të fundit.<sup>179</sup> Në këtë situatë Gjykata vihet në një pozicion që kërkon një legjislacion specifik si edhe afatin për miratimin e tij. Nga ana tjetër Gjykata nuk ka asnjë pushtet për ta detyruar parlamentin që të kalojë ligjin që Gjykata e çmon si kushtetueshmërisht të nevojshëm. Nëse parlamenti vendos ta injorojë Gjykatën, kjo e fundit nuk ka asnjë kompetencë për ta detyruar Parlamentin që të veprojë.<sup>180</sup>

Doktrina, në Shqipëri, ka përcaktuar se në mungesë të parashikimeve të shprehura kushtetuese, Gjykata Kushtetuese nuk mund të marrë në shqyrtim çështje që kanë të bëjnë me ometimin legjislativ. Por pavarësisht kësaj rezulton se në disa raste Gjykata është marrë me këtë problematikë, por pa konkluduar asnjëherë në lidhje me kushtetueshmërinë e këtij problemi. Në përgjithësi Gjykata Kushtetuese, i rekomandon Kuvendit që të mbulojë boshllëkun ligjor.<sup>181</sup>

Ky qëndrim i doktrinës është në përgjithësi i bazuar, nesë i referohemi qëndrimit fillestar të Gjykatës, e cila është shprehur se:

*Përsa i përket përcaktimit tjetër të këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese që diferenca e masës së qirasë të përballohet nga shteti, neni 4 i ligjit nuk bën fjalë dhe pikërisht për këtë kërkuesi pretendon se ai është antikushtetues. Por, fakti i mospërmendjes së detyrimit që shteti do të marrë përsipër të realizojë, nuk e bën përmbajtjen e këtij neni antikushtetues. Kjo dispozitë përcakton masën e qirasë që do të paguajnë qytetarët e pastrehë si qiramarrës, por nuk rregullon masën në tërësi të qirasë për këto banesa dhe pjesën e kontributit të shtetit. Përballimi nga shteti i diferencës së masës së qirasë, e cila nuk përcaktohet në nenin objekt kërkese, mund të bëhet me dispozita të tjera. Vetë ligji nr.8647, datë 24.7.2000 në nenin 5, përcakton se ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë akte nënligjore për procedurat e veprimeve që do të kryhen nga Enti Kombëtar i Banesave, si dhe për sigurimin e burimeve financiare.*

*E parë çështja në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese, e cila vepron në rolin e ligjvënësit negativ, nuk mund ta pranojë kërkesën për shfuqizimin e nenit 4 si antikushtetues, por ajo, me këtë rast, konfirmon edhe njëherë qëndrimin e mbajtur me vendimin e saj nr.5, datë 27.2.1997 që për këto banesa ligjvënësi të caktojë një masë*

<sup>178</sup> Carlassare, Lorenza, "Interlocutory Review – Abstract Review", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15", botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998, fq. 135.

<sup>179</sup> Schwartz, Herman, "The struggle for constitutional justice in post-communist Europe", Shtëpia Botuese "The University of Chicago Press", Chicago 2000, fq.27.

<sup>180</sup> Po aty, fq.80.

<sup>181</sup> Sadushi, Sokol, "Drejtësia kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq.242.

qiraje duke theksuar që diferenca do të përballohet nga shteti. Në këtë mënyrë do të zgjidhet plotësisht problemi i qirasë së këtyre banesave, i cili do të vazhdojë deri në zgjidhjen e strehimit për qytetarët e pastrehë, por pa dëmtuar asnjërën palë. Neni 4 i ligjit nuk ka kufizim ose cenim të të drejtave kushtetuese të ish-pronarëve, siç pretendohet në kërkesë. **Për qiranë e këtyre banesave ka një ometim (boshllëk ligjor) sepse në asnjë akt normativ nuk përcaktohet mënyra e përballimit të diferencës së qirasë.** Por, ky nen nuk bëhet pengesë që ligjvënësi të nxjerrë një dispozitë tjetër për të plotësuar këtë boshllëk dhe për të përmbushur edhe detyrimin kushtetues të parashikuar në nenin 181/1 të Kushtetutës.<sup>182</sup>

Nga pasazhet e mësipërme të këtij vendimi rezulton se Gjykata Kushtetuese, nga njëra anë i rekomandon ligjvënësit që të bëjë plotësime në ligj, nga ana tjetër shprehet se mungesa e një rregullimi ligjor nuk e bën antikushtetues dispozitën. Ky qëndrim është mbajtur edhe në vendime të tjera, ku Gjykata, përveç rekomandimit ndaj ligjvënësit, i'u kërkon organeve të tjera që të zbatojnë në këto raste parimet e përgjithshme të së drejtës.<sup>183</sup>

Pra si rregull, ometimi legjislativ nuk mund të jetë objekt i një vendimi kushtetues. Sipas doktrinës, rishikimi gjyqësor i ometimit mund të ndodhë vetëm nëse ometimi e bën një tjetër dispozitë në kundërshtim me Kushtetutën.<sup>184</sup> Bazuar në këtë mundësi të fundit, Gjykata Kushtetuese, duket sikur ka hapur një mundësi tjetër në këtë drejtim. Kështu në një vendim të saj gjegjë këtë qëndrim:

*Gjykata, për sa më sipër, arrin në përfundimin se neni 34/8 i KP-së ka probleme kushtetutshmërie për shkak të ometimit legjislativ. Legjislacioni nuk ka parashikuar fuqi të plota për gjyqtarin edhe gjatë momentit të konvertimit të dënimit. Në këtë kuptim, neni 3/2 i KPP-së përbën një dispozitë me karakter të përgjithshëm, parashikimet e së cilës nuk mund të anashkalohen në asnjë rast.*

*Gjykata vlerëson se gjyqtari, gjatë konvertimit, duhet të ketë mundësinë të hetojë në lidhje me shkaqet që kanë çuar në mos shlyerjen e gjobës dhe, çka është më e*

<sup>182</sup> Vendimi nr.43, datë 18.5.2001 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>183</sup> Vendimi nr.26, datë 13.6.2007 i Gjykatës Kushtetuese: *Prandaj, duke qenë në kushtet e një ometimi ligjor që mund të sjell dhe antikushtetutshmëri, Gjykata Kushtetuese çmon, se mbetet në vullnetin e ligjvënësit, që në përmbushje të detyrimeve kushtetuese, por dhe të jurisprudencës së saj, të garantojë në të gjitha hapësirat e nevojshme ligjore të drejtën e gjyqtarëve për t'u drejtuar gjykatës për shqyrtimin e masave të tjera me karakter disiplinor.*

Vendimi nr.22, datë 9.3.2010 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese: *Gjykata Kushtetuese vlerëson se, mënyra e duhur për rivënie në vend të së drejtës së shkelur të aplikantit do të ishte rihapja e çështjes për të konsideruar vendimin e datës 14 Dhjetor 1998 të Gjykatës Europiane. Gjykata Kushtetuese konstaton se, për t'u ekzekutuar ky vendim, duhet të ekzistojnë mjetet procedurale në legjislacionin e brendshëm procedural penal, të cilat aktualisht mungojnë. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese e gjen me vend të theksojë domosdoshmërinë e plotësimin nga Kuvendi të boshllëkut ligjor për këtë problem të rëndësishëm. Veç kërkesës për plotësimin e legjislacionit Gjykata Kushtetuese vlerëson se edhe Gjykata e Lartë, si organi tek i cili është konstatuar shkelja nga Gjykata Europiane, duhet të gjejë zgjidhjen për të vënë në vend të drejtën e shkelur të kërkuarit duke aplikuar, nëse e çmon të nevojshme edhe analogjinë me zgjidhjen konkrete për këtë problem në Kodin e Procedurës Civile. Pra, Gjykata Kushtetuese çmon se është Gjykata e Lartë organi kompetent për gjykimin e kësaj çështjeje.*

<sup>184</sup> Carlassare, Lorenza, "Interlocutory Review – Abstract Review", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15", botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998, fq. 134.

*rëndësishme, duhet të ketë mundësinë të caktojë dënimin më të përshtatshëm për secilin shkelës, në përputhje me funksionin riedukues të sipërpërmendur.*

*Gjykata vëren se gjyqtari, që bën konvertimin e gjobës, duhet të ketë mundësinë që të caktojë të gjitha llojet e dënimit të parashikuara nga legjislati në fuqi dhe, mbi të gjitha, të ketë mundësinë të përdorë masat alternative të dënimit me burgim.<sup>185</sup>*

Nga analiza e këtij vendimi, rezulton se sipas Gjykatës, mungesa e parashikimeve ligjore që i japin të drejtë gjykatës së zakonshme për të konvertuar dënimin me gjobë në dënime të tjera alternative sjell si pasojë, boshllëk legjislativ dhe për rrjedhojë antikushtetueshmërinë e dispozitës.

Ky ndryshim jurisprudencial hapi rrugën edhe për shqyrtimin e kushtetueshmërisë së ometimit legjislativ. Ajo që duhet theksuar është se në rastin e mësipërm kishim të bënim me ometim relativ dhe jo absolut. Në këtë rast nëse ankohe mi në Gjykatën Kushtetuese, do të ndiqen të njëjtat rregulla që parashikohen për gjykimin kushtetues të ligjeve. Por rezulton se rruga është e hapur momentalisht vetëm për rastet e ometimit relativ legjislativ. Për të shfrytëzuar këtë mundësi, kërkuesi duhet të argumentojë antikushtetueshmërinë e dispozitës në mënyrë të kujdesshme për të mos e kaluar Gjykatën Kushtetuese si një ligjvënës pozitiv, pra të krijojë normat. Por në këtë rast kërkesa kundër mosveprimit të ligjvënësit për të vepruar mund të jetë e pranueshme vetëm nëse tregohet qartësisht një detyrim i përcaktuar i legjislatorit për të miratuar një ligj.<sup>186</sup>

Për sa i përket organeve kushtetuese, personalisht jam i mendimit që çështjet e ometimit legjislativ mund t'i adresojnë shumë mirë, në kuadër të një tjetër gjykimi kushtetues. Rezulton se sipas jurisprudencës sonë kushtetuese, mosmarrëveshja e kompetencave mund të jetë me natyrë normative por edhe individuale. Në rastin kur jemi përpara një mosmarrëveshjeje me natyrë normative, rezulton që kjo mosmarrëveshje bazohet në kuadrin normativ ligjor dhe nënligjor. Nga ana tjetër mosmarrëveshja e kompetencave mund të jetë *pozitive* apo *negative*. Në rastin e mosmarrëveshjes *negative*, konflikti qëndron pikërisht kur organi cënues, nëpërmjet mosveprimit të tij ka cënuar ushtrimin e kompetencave të një tjetër organi kushtetues. Pra, në rastin tonë ligjvënësi nëpërmjet mosmiratimit të ligjeve ka lejuar boshllëk legjislativ dhe për rrjedhojë cënim të kompetencave të një tjetër organi.

## **2.5 Marrëveshjet ndërkombëtare.**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë të drejtës ndërkombëtare i ka lënë një vend të veçantë dhe disi të privilegjuar. Sipas nenit 5 të Kushtetutës, Shqipëria zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të, ndërsa sipas nenit 116 rezulton se marrëveshjet ndërkombëtare janë një ndër aktet normative të cilat gjejnë zbatim në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në Kreun II, të Pjesës së Shtatë të Kushtetutës, nenet 121-123, gjen një rregullim të detajuar statusi i marrëveshjeve ndërkombëtare, i akteve që nxjerrin organizatat ndërkombëtare si edhe i procedurave në bazë të të cilave jepet pëlqimi nga Republika e Shqipërisë për të qenë e

<sup>185</sup> Vendimi nr.19, datë 1.6.2011 i Gjykatës Kushtetuese. Në dispozitivin e vendimit Gjykata është shprehur: *Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën, të paragrafit 8 të nenit 34 të Kodit Penal.*

<sup>186</sup> Scibert, Helga, "Admissibility requirements for constitutional complaints and mechanisms for avoiding an excessive case load", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15", botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998, fq. 145.

lidhur me këto detyrime. Dhe së fundmi në nenin 180 të Kushtetutës gjen rregullim statusi i marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat janë ratifikuar nga Shteti ynë përpara hyrjes në fuqi të Kushtetutës aktuale, pra përpara datës 28.11.1998.

Ky status i rëndësishëm që i është dhënë të drejtës ndërkombëtare në sistemin tonë juridik shtron për diskutim një tjetër aspekt dhe pikërisht, raportin midis Kushtetutës dhe së drejtës ndërkombëtare. Kushtetuta jonë megjithëse i jep një status të privilegjuar të drejtës ndërkombëtare, nëpërmjet një sërë dispozitash të saj parashikon supremacinë e saj mbi të drejtën ndërkombëtare. Nëse i referohemi nenit 4 pika 2 të aktit themelor rezulton se Kushtetuta është ligji më i lartë në vend. Për të ruajtur këtë status Kushtetuta ka parashikuar edhe një sistem kontrolli mbi të drejtën ndërkombëtare, megjithëse ka shtete që nuk e njohin një kontroll të tillë, si Kroacia<sup>187</sup> apo Kosova.<sup>188</sup>

Më konkretisht, Kushtetuta në nenin 131 shkronja "b" dhe në nenin 180, pika 2 parashikon kompetencën e Gjykatës Kushtetuese për të kontrolluar pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën. Ky parashikim, në këto dy dispozita përveç se përforcon idenë e supremacisë së Kushtetutës mbi të drejtën ndërkombëtare, tregon se kemi të bëjmë edhe me dy gjykime të veçanta të cilat ndryshojnë midis tyre për shkak të objektit, natyrës së gjykimit dhe subjekteve të cilat mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Në këtë drejtim, sipas nenit 131 shkronja "b" e Kushtetutës, Gjykata ushtron një kontroll paraprak *apriori*, mbi marrëveshjet ndërkombëtare, ndërsa sipas nenit 180 pika 2, Gjykata ushtron një kontroll represiv, *aposteriori*, mbi marrëveshjet ndërkombëtare të cilat janë ratifikuar nga Shteti Shqiptar përpara hyrjes në fuqi të Kushtetutës aktuale. Duke zbatuar këtë autoritet, organi i drejtësisë kushtetuese ka një funksion të dyfishtë, nga njëra anë të sigurojë supremacinë e Kushtetutës në raport me marrëveshjet ndërkombëtare dhe nga ana tjetër, të informojë parlamentin për dispozitat e Kushtetutës, të cilat çënohen nga dispozitat e një traktati.<sup>189</sup>

### 2.5.1 Marrëveshjet ndërkombëtare të paratifikuar.

Duke iu referuar rastit të parë, gjykimit *apriori*, rezulton se jo të gjitha burimet e së drejtës ndërkombëtare janë objekt i këtij gjykimi. E drejta ndërkombëtare përbëhet nga disa burime. Këto burime janë e drejta zakonore ndërkombëtare si edhe e drejta e traktateve. Pra e drejta ndërkombëtare mund të shfaqet në formë të pashkruar, zakoni, si edhe në formë të shkruar, traktati (i cili mund të marrë emërtime të ndryshme).

Në lidhje më burimin e parë, jo çdo zakon i së drejtës ndërkombëtare gjen zbatim në Shqipëri. Në këto raste flitet vetëm për ato norma ndërkombëtare të quajtur *jus cogens* ose normat e gjithëpranuara të së drejtës ndërkombëtare, zbatimi i të cilave është njohur edhe nga

<sup>187</sup> Pistan, Carna, "The implementation of International/European Law in the Republic of Croatia", botuar në "International Constitutional Law", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "G.Giappichelli Editore", Torino 2014, fq.39.

<sup>188</sup> Aktgjykimi në rastin KO 95/13, datë 9.9.2013 i Gjykatës Kushtetuese së Kosovës, parag.101: Gjykata konkludon se nuk është brenda juridiksionit të saj *ratione materiae* të vlerësojë kushtetutshmërinë e Marrëveshjes së pare ndërkombëtare. Rrjedhimisht, Gjykata refuzon kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Marrëveshjes së pare ndërkombëtare.

<sup>189</sup> M. Kampo, Volodymyr; V. Savchyn, Mykhaylo; "Ukraine: International Treaties and European Acts in National Courts Practice", botuar në "International Constitutional Law", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "G.Giappichelli Editore", Torino 2014, fq.434.



jurisprudenca, bazuar në nenin 5 të Kushtetutës.<sup>190</sup> Këto norma për nga vetë natyra e tyre dhe mënyrës së si është formuluar dispozita kushtetuese, janë jashtë juridiksionit kushtetuese dhe nuk mund t'i nënshtrohen asnjë kontrolli nga Gjykata, konkluzion i cili është pranuar përgjithësisht edhe nga doktrina.<sup>191</sup>

Kushtetuta jonë njih dy lloje marrëveshjesh ndërkombëtare. Lloji i parë janë marrëveshjet ndërkombëtare të cilat i nënshtrohen një procedure ratifikimi nga ana e Kuvendit dhe më konkretisht marrëveshjet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me a) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake; b) të drejtat dhe liritë e njeriut, si edhe detyrimet e shtetasve, siç parashikohen në Kushtetutë; c) anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare; ç) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga Republika e Shqipërisë; d) miratimin, ndryshimin, plotësimin ose shfuqizimin e ligjeve.<sup>192</sup> Përveç këtyre rasteve, Kuvendi mund të vendosë që t'i nënshtrojë procesit të ratifikimit edhe marrëveshje të tjera që nuk janë përmendur shprehimisht në Kushtetutë.<sup>193</sup> Duke iu rikthyer formulimit të nenit 131, shkronja "b" të Kushtetutës, rezulton se janë pikërisht këto lloj marrëveshjes ndërkombëtare, për të cilat shteti shqiptar jep pëlqimin e tij nëpërmjet ratifikimit, të cilat mund t'i nënshtrohet kontrollit nga Gjykata Kushtetuese. Në këto raste ushtrimi i kontrollit paraprak kërkon domosdoshmërisht ekzistencën e një projekt marrëveshjeje konkrete të nënshkruar nga përfaqësuesit e shteteve, por që nuk ka arritur ende të ratifikohet.<sup>194</sup> Pra kur vetë teksti është përcaktuar përfundimisht, por Shteti nuk ka dhënë ende pëlqimin e tij.<sup>195</sup>

Lloji tjetër i marrëveshjeve ndërkombëtare janë ato të cilat miratohen me vendim nga ana e Këshillit të Ministrave. Në këtë rast detyrimi i vetëm bie mbi Kryeministrin për të njoftuar Kuvendin për lidhjen e marrëveshjeve të tilla.<sup>196</sup> Këto lloj marrëveshjesh bien jashtë juridiksionit Kushtetues. Kështu rezulton se vetë marrëveshja duke mos u ratifikuar me ligj, nuk mund të jetë pjesë e kontrollit nga Gjykata Kushtetuese. Nga ana tjetër edhe akti më anë të së cilit jepet pëlqimi nga Këshilli i Ministrave, është një akt i cili shfaq karakteristikat e një akti administrativ individual. Ky akt rregullon një çështje konkrete, miratimin e një marrëveshjeje, i drejtohet një subjekti të përcaktuar, shtetit apo organizatës me anë të së cilës lidhet kjo marrëveshje, si dhe vlen vetëm për një rast, pra për lidhjen e kësaj marrëveshjeje. Për rrjedhojë edhe vendimi i Këshillit të Ministrave nuk mund që të kontrollohet nga Gjykata Kushtetuese, pasi në bazë të nenit 131, shkronja "c" të Kushtetutës, objekt gjykimi mund të jenë vetëm aktet me karakter normativ.

<sup>190</sup> Vendimi nr.186, datë 23.9.2002, i Gjykatës Kushtetuese: *Me këtë rast, Gjykata Kushtetuese e sheh të nevojshme të shprehet se përderisa në bazë të Kushtetutës rregullat e gjithëpranuara të së drejtës ndërkombëtare janë pjesë e së drejtës së brendshme, atëherë dhe mungesa e imunitetit në proceset penale ndërkombëtare për krime të caktuara me rrezikshmëri të lartë, bëhet pjesë e sistemit juridik shqiptar. Nga ana e saj, jurisprudenca ndërkombëtare ka përpunuar një sërë zakonesh të qëndrueshme nisur nga synimi kryesor, që autorëve të këtyre veprave penale, t'u hiqet mundësia që të mbrohen për to duke i konsideruar si akte të kryera në ushtrimin e pushtetit (acta iure imperii).*

<sup>191</sup> Duarte, Maria Luisa; Gomes, Carla Amado; "Portogallo", botuar në "Giustizia Costituzionale e Unione Europea – Una comparazione tra Austria, Francia, Germania, Italia, Spagna e Portogallo", nën kujdesin e Alfonso Celotto, Javier Tajadura, Josu De Miguel Barcena, përkthimi në italisht, Shtëpia Botuese "Editoriale Scientifica srl", Napoli 2011, fq.305.

<sup>192</sup> Kushtetuta, neni 121, pika 1.

<sup>193</sup> Kushtetuta, neni 121, pika 2.

<sup>194</sup> Sadushi, Sokol, "Drejtësia kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq.175.

<sup>195</sup> Ruiz, Gerardo Ruiz-Rico, "Il Tribunale Costituzionale Spagnolo", botuar në "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova, 2009, fq.265.

<sup>196</sup> Kushtetuta, neni 121, pika 3.

Pavarësisht kësaj, jam i mendimit që i vetmi rast kur një vendim i tillë i Këshillit të Ministrave mund të bëhet objekt i gjykimit në Gjykatën Kushtetuese është kur, nga ana e Kuvendit mund të pretendohet një mosmarrëveshje kompetencash midis tij dhe Këshillit të Ministrave, pra nëse do të pretendohet se Këshilli i Ministrave kishte dhënë pëlqimin për një marrëveshje e cila në fakt duhej t'i nënshtrohej procesit të ratifikimit në Kuvend. Në këtë rast sipas LGJK, objekt shqyrtimi mund të bëhen edhe aktet administrative individuale.<sup>197</sup> Por objekt i kontrollit nuk bëhet vetë marrëveshja por vetëm akti miratues i saj.

Qëndrimin që objekt gjykimi janë vetëm marrëveshjet që i nënshtrohen procesit të ratifikimit e gjejmë edhe në jurisprudencën e hershme të Gjykatës Kushtetuese e cila duke bërë analizën e marrëveshjeve që lidheshin nga organet e ndryshme kushtetuese sipas LDKK dhe se cila prej tyre mund t'i nënshtrohej kontrollit kushtetues është shprehur se:

*Sipas pikës 4 të nenit 24 të ligjit "Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", Gjykata Kushtetuese "vendos për pajtueshmërinë me Kushtetutën të marrëveshjeve ndërkombëtare, që lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë para ratifikimit të tyre si dhe për përputhjen e ligjeve me normat e gjithëpranuara të së drejtës ndërkombëtare si dhe me marrëveshjet në të cilat Republika e Shqipërisë është palë".*

*Gjykata konstaton se sipas pikës 5 të nenit 16 të Ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese" nr.7491, datë 29.04.1991, Kuvendi Popullor ratifikon dhe denoncon traktatet me karakter politik; traktatet ose marrëveshjet me karakter ushtarak; traktatet dhe marrëveshjet që kanë të bëjnë me kufijtë e Republikës së Shqipërisë; traktatet ose marrëveshjet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrat themelore të shtetasve; traktatet që kanë si rrjedhim detyrime financiare për shtetin; traktatet ose marrëveshjet e tjera me të cilat parashikohet që ratifikimi ose denoncimi i tyre të bëhet nga Kuvendi Popullor.*

*Po ashtu sipas pikës 10 të nenit 28 të këtij ligji, Presidenti i Republikës lidh traktate ose marrëveshje ndërkombëtare; ratifikon dhe denoncon ato që nuk i shqyrton vetë Kuvendi Popullor.*

*Gjithashtu, sipas pikës 6 të nenit 36 të këtij ligji dhe Këshilli i Ministrave lidh marrëveshje ndërkombëtare, miraton dhe denoncon ato që nuk i nënshtrohen ratifikimit.*

*Nga të gjitha këto traktate e marrëveshje objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese bëhen vetëm ato që lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë para ratifikimit të tyre, kusht ky që është përcaktuar shprehimisht në pikën 4 të nenit 24 të ligjit kushtetues.<sup>198</sup>*

Pavarësisht se ky vendim është dhënë duke interpretuar dispozitat e vjetra kushtetuese, duke pasur në konsideratë edhe formulimin aktual të ligjit themelor të vendit, rezulton se ai vlen edhe për këtë kohë. Bazuar në analizën e mësipërme i bashkohemi mendimit të shfaqur në doktrinë, sipas së cilit rezulton se objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese, në kuptimin e kontrollit *ex ante*, nuk bëhet çdo marrëveshje ndërkombëtare, por vetëm ato marrëveshje, të cilat përfshihen në procesin e ratifikimit nga Kuvendi. Kjo është një veçori e kontrollit kushtetues *ex ante*.<sup>199</sup>

<sup>197</sup> LGJK, neni 54, pika 4 dhe neni 56, pika 2.

<sup>198</sup> Vendimi nr.16, datë 3.6.1998 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>199</sup> Sadushi, Sokol, "Drejtesia kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq.181.

## 2.5.2 Kontrolli i ligjit ratifikues. A është i mundur kontrolli *aposteriori* i marrëveshjes ndërkombëtare?

Shpesh herë është hedhur për diskutim mendimi që pavarësisht parashikimit të nenit 131, shkronja "b" të Kushtetutës, ekziston mundësia që Gjykata Kushtetuese mund të ushtrojë edhe një kontroll *aposteriori* të marrëveshjes tashmë të ratifikuar, duke kontrolluar kushtetutshmërinë e ligjit ratifikues të marrëveshjes bazuar në nenin 131, gërma "a" të Kushtetutës. Duke qenë se një arsyetim i tillë nuk është plotësisht pa baza mendoj se është e nevojshme një analizë e kujdesshme e kësaj mundësie.

Sipas nenit 131, gërma "a" e Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vendos për pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare. Nga pikëpamja e teknikës legjislative si rregull ligji ratifikues përbëhet nga dy nene, ku neni 1 përcakton ratifikimin e një marrëveshjeje, ndërsa neni 2 parashikon hyrjen në fuqi të ligjit ratifikues, si rregull 15 ditë mbas botimit në Fletoren Zyrtare. Në ndonjë rast mund të kemi edhe disa dispozita të tjera të cilat në përgjithësi parashikojnë organet e administratës publike të ngarkuara për zbatimin e marrëveshjes që ratifikohet. Më pas ligjit i bashkëlidhet teksti i plotë i marrëveshjes në gjuhën shqipe sipas kërkesave të nenit 122 pika 1 e Kushtetutës. Nëse e konsiderojmë tekstin e marrëveshjes ndërkombëtare si pjesë integrale të ligjit ratifikues atëherë mund të ngrihet pretendimi se duke kontrolluar kushtetutshmërinë e ligjit vetiu kontrollohet edhe në kuptimin formal dhe material edhe vetë marrëveshja ndërkombëtare. Një rast të tillë e gjejmë për shembull në Austri ku Gjykata Kushtetuese kontrollon marrëveshjen por efektet e vendimit të saj bien mbi legjislacionin që ka dalë për zbatimin e saj. Kështu në rast të konstatimit të antikushtetutshmërisë së traktatit, do të pushojnë efektet ligji apo rregullorja që i japin asaj zbatimin në të drejtën e brendshme.<sup>200</sup> E njëjta gjë ndodh edhe në Itali ku Gjykata Kushtetuese është shprehur se duke kontrolluar kushtetutshmërinë e një ligji për zbatimin e një traktati, është e mundur që të përcaktosh edhe përputhshmërinë me Kushtetutën të kësaj të fundit dhe eventualisht të arrish antikushtetutshmërinë e ligjit të zbatimit, aty ku dhe në atë pjesë ku ai fut në të drejtën e brendshme të pajtueshme me Kushtetutën.<sup>201</sup> Në Poloni mbi bazën e kërkesës së ombudsmen, Tribunali Kushtetues, pranoi që ka të drejtë të kontrollojë kushtetutshmërinë e ligjit ratifikues dhe për rrjedhojë edhe të vetë marrëveshjes.<sup>202</sup> Të njëjtin qëndrim mban edhe jurisprudenca kushtetuese e Sllovenisë, ku Gjykata Kushtetuese e këtij vendi është shprehur se mund ta ushtrojë një kontroll të tillë në këtë formë, megjithëse ende nuk ka pasur raste praktikë në këtë drejtim.<sup>203</sup> Edhe në Francë doktrina pranon një mundësi të tillë kur shprehet se duke qenë kontrolli paraprak fakultativ, në rast se procedura sipas nenit 54, nuk është zbatuar, mund të hyjë në lojë neni 61.2 që duke hapur kontrollin kushtetues të ligjit ratifikues, kushtëzon hyrjen në fuqi

<sup>200</sup> D'Orlando, Elena, "La giustizia costituzionale in Austria", botuar në "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova, 2009, fq.123-124.

<sup>201</sup> Vendimi nr.71 i vitit 2001 i Gjykatës Kushtetuese Italiane, referuar nga Mezzetti, Luca dhe Polacchini Francesca, "Primacy of Supranational Law and Supremacy of the Constitution in the Italian Legal System", botuar në "International Constitutional Law", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "G.Giappichelli Editore", Torino 2014, fq.154.

<sup>202</sup> Schwartz, Herman, "The struggle for constitutional justice in post-communist Europe", Shtëpia Botuese "The University of Chicago Press", Chicago 2000, fq.63.

<sup>203</sup> Sovdat, Jaradanka, "Human Rights between the Constitution, Treaties, and EU Law. The Case of Slovenia", botuar në "International Constitutional Law", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "G.Giappichelli Editore", Torino 2014, fq.332, si edhe referenca nr.4.



të traktatit me verifikimin e përputhshmërisë së ligjit ratifikues me ligjin themelor.<sup>204</sup> Në rast se ky ligj hyn në fuqi, atëherë si ligji ratifikues edhe marrëveshja ndërkombëtare gëzojnë një lloj “imuniteti” kushtetues pasi ato nuk mund të kundërshtohen më.<sup>205</sup>

Personalisht nuk jam me këtë mendim. Kështu neni 131 gërma “b” e Kushtetutës përcakton shprehimisht që kontrolli i një marrëveshje mund të bëhet vetëm përpara ratifikimit të saj. Kjo mënyrë kontrolli është zgjedhur pikërisht për të respektuar parimin *pacta sunt servanta* sipas të cilit nuk mund të përdoret si justifikim e drejta e brendshme për të mos respektuar detyrimet e marra përsipër në bazë të një marrëveshje ndërkombëtare. Për më tepër publikimi i marrëveshjes në Fletoren Zyrtare është një detyrim që buron nga neni 122, pika 1 e Kushtetutës. Fakti që nga pikëpamja e teknikës legjislative, është zgjedhur që marrëveshja të botohet si lidhje e ligjit ratifikues, nuk do të thotë që marrëveshja është pjesë integrale e këtij ligji. Ligji ratifikues është një akt i brendshëm i Shtetit tonë i cili shpreh pëlqimin e tij për të qenë i lidhur me një marrëveshje ndërkombëtare, kurse vetë marrëveshja nuk është akt i brendshëm por i përket të drejtës ndërkombëtare dhe për rrjedhojë sipas sistemit tonë kushtetues nuk mundet që t’i nënshtrohet kontrollit në rast se është ratifikuar nga ana e Kuvendit.

Edhe përsa i përket jurisprudencës kushtetuese të krahasuar e të cituar, një analizë e kujdesshme e saj tregon të kundërtën e konkluzioneve të arritura më sipër. Në rastet e Austrisë dhe Italisë, rezulton se këto dy vende kanë përzgjedhur sistemin dualist të së drejtës ndërkombëtare. Për rrjedhojë, këto Gjykata nuk mundet kurrsesi që të kontrollojnë një marrëveshje ndërkombëtare e cila konsiderohet si një akt i huaj dhe jo pjesë e sistemit juridik. Në këto dy vende kontrolli mund të ushtrohet vetëm nëpërmjet kontrollit mbi aktin juridik të brendshëm i cili bën të mundur zbatimin brenda këtyre vendeve të marrëveshjeve ndërkombëtare. Edhe në France situata paraqitet përsëri në formën e një kontrolli *apriori*. Kështu vërtet atje marrëveshja mund të kontrollohet edhe nëpërmjet kërkesës për kontroll kushtetutshmërie të ligjit ratifikues, por përsëri në sistemin francez një kontroll i tillë është *apriori*, pra para se ratifikimi i marrëveshjes të hyjë në fuqi. I vetmi rast i diskutueshëm mbetet ai polak dhe ai slloven, por në këtë drejtim mund të gjejmë plot raste të kundërta edhe në vende të tjera. Kështu në Kroaci, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin se është kompetente që të kontrollojë kushtetutshmërinë e një akti ratifikues të një marrëveshje ndërkombëtare, por jo vetë marrëveshjen ndërkombëtare, pra përmbajtjen materiale e cila është pjesë e aktit të ratifikimit.<sup>206</sup> Një tjetër shembull është edhe Kosova.<sup>207</sup>

### 2.5.3 Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara.

Siç e cituam edhe më sipër, Kushtetuta jonë parashikon edhe një lloj tjetër kontrolli kushtetues mbi marrëveshjet ndërkombëtare dhe kontretisht atë *aposteriori*. Një kontroll i tillë që parashikohet nga neni 180 i Kushtetues është një kontroll i cili ushtrohet si rast përjashtimor dhe dallon nga kontrolli *apriori* për sa i përket objektit të kontrollit, subjektit kërkuar, afatit etj.

<sup>204</sup> Specchia, Marina Calamo, “La giustizia costituzionale in Francia”, botuar në “Sistemi e modelli di giustizia costituzionale”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “Cedam”, Padova, 2009, fq.211.

<sup>205</sup> Alberton, Ghislaine, “Francia”, botuar në “Giustizia Costituzionale e Unione Europea – Una comparazione tra Austria, Francia, Germania, Italia, Spagna e Portogallo”, nën kujdesin e Alfonso Celotto, Javier Tajadura, Josu De Miguel Barcena, përkthimi në italisht, Shtëpia Botuese “Editoriale Scientifica srl”, Napoli 2011, fq.210.

<sup>206</sup> Vendimi nr.U-I/1583/2000, datë 24 mars 2010 i Gjykatës Kushtetuese Kroate, referuar nga Pistan, Carna, “The implementation of International/European Law in the Republic of Croatia”, botuar në “International Constitutional Law”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “G.Giappichelli Editore”, Torino 2014, fq.45.

<sup>207</sup> Aktgjykimi në rastin KO 95/13, datë 9.9.2013 i Gjykatës Kushtetuese së Kosovës, parag.101.



Objekt i këtij kontrolli janë marrëveshjet ndërkombëtare të cilat tashmë janë ratifikuar nga Shteti Shqiptar, në momentin e hyrjes në fuqi të Kushtetutës aktuale, pra, përpara datës 28 nëntor 1998. Që në këtë moment ekziston dallimi i parë midis kësaj forme kontrolli dhe kontrollit *apriori* që ushtron Gjykata Kushtetuese sipas nenit 131, shkronja "b" të Kushtetutës. Arsyet e këtij ndryshimi lidhen me vetë ekzistencën e shtetit Shqiptar. Kështu Shqipëria u shpall shtet i pavaruar më 28 nëntor 1912, ndërsa sipas vendimit të datës 29 korrik 1913 të Konferencës së Ambasadorëve të Londrës, u njoh edhe ndërkombëtarisht, pra iu njoh e drejta për të marrë përsipër detyrime ndërkombëtare. Madje një nga marrëveshjet e para me karakter ndërkombëtar të kohës ka qenë Akti i konçensionit ndërmjet Qeverisë së përkohshme të Vlorës dhe përfaqësuesve të Bankës Tregëtare të Milanos dhe "Wiener Bank" të Vienës, mbi krijimin e Bankës Kombëtare Shqiptare.<sup>208</sup> Statuti Organik i vitit 1914, parashikonte ruajtjen në fuqi të marrëveshjeve të ratifikuara nga Perandoria Osmane dhe veçanërisht marrëveshjet që përcaktonin regjimin e kapitulacioneve.<sup>209</sup>

Pra, që në fillim të ekzistencës së tij Shteti Shqiptar ka dalë si subjekt në marrëdhëniet ndërkombëtare. Megjithatë është e kuptueshme që jo të gjitha marrëveshjet e lidhura përpara Kushtetutës së vitit 1998 janë ende në fuqi. Nëse i referohemi burimeve zyrtare nga Ministria e Punëve të Jashtme rezulton se marrëveshja më e vjetër e ratifikuar nga shteti ynë dhe që është ende në fuqi është Marrëveshja e ekstradimit midis Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut e vitit 1926.<sup>210</sup> Gjatë kësaj kohe nga Shteti ynë janë ratifikuar dhe denoncuar një sërë marrëveshje ndërkombëtare. Është e kuptueshme që objekt kontrolli në këtë rast janë vetëm marrëveshjet ndërkombëtare të cilat janë në fuqi. Mundësia që neni 180 pika 2 e Kushtetutës lejon kontrollin *aposteriori* të marrëveshjeve ndërkombëtare prodhon edhe një lloj kontradikte me LDKK-në. Kështu sipas nenit 24, pika 4 e ligjit nr. 7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese", rezulton se Gjykata Kushtetuese në atë kohë kishte të drejtë që të kontrollonte kushtetutshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare përpara ratifikimit të tyre nga Kuvendi Popullor. Për rrjedhojë përjashtoj çdo lloj kontrolli tjetër kushtetues *aposteriori*. Marrëveshjet e lidhura midis viteve 1992 dhe 1998 në emër të Republikës së Shqipërisë mund të kontrollohen edhe *aposteriori*, pasi Kushtetuta e vitit 1998 e parashikon një mundësi të tillë, pavarësisht se nuk janë kontrolluar më parë nga Gjykata Kushtetuese sipas LDKK. Ky parashikim megjithëse mund të jetë i justifikuar për marrëveshjet e lidhura përpara vitit 1992 kur nuk parashikohej asnjë lloj kontrolli juridik mbi to, duket sikur çënon sigurinë juridike në këtë rast për marrëveshjet e lidhura mbas vitit 1992.

## 2.6 Aktet normative të organeve qendrore.

Aktiviteti normativ i një shteti, përveç Kuvendit ku miratohen normat juridike me karakter ligjor, është i përqendruar edhe në organet ekzekutive. Kështu Kushtetuta jonë parashikon se Këshilli i Ministrave nxjerr vendime dhe udhëzime,<sup>211</sup> ndërsa ministrat nxjerrin

<sup>208</sup> "Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj", Botim i Drejtorisë së Përgjithëshme të Arkivave Shtetërore të R.P.Sh., Shtëpia Botuese "Mihal Duri", Tiranë 1963, Dok. nr.348 fq.279 – 285.

<sup>209</sup> Luarasi, Aleks, "Akte Juridike për Historinë e Shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri – Pjesa II", Shtëpia Botuese Luarasi, Tiranë 1999, fq.31-32.

<sup>210</sup> Marrë nga adresa e internetit:

[http://www.punetejashtme.gov.al/files/userfiles/Marreveshjet\\_Dypaleshe\\_me\\_te\\_gjitha\\_vendet.pdf](http://www.punetejashtme.gov.al/files/userfiles/Marreveshjet_Dypaleshe_me_te_gjitha_vendet.pdf) (parë për herë të fundit me datë 11.6.2015)

<sup>211</sup> Kushtetuta, neni 100, pika 5.

urdhëra dhe udhëzime.<sup>212</sup> Po kështu siç e kemi përmendur Kushtetuta jonë njeh edhe një sërë organesh të tjera qendore, si Banka e Shqipërisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë etj., të cilët mbi bazën e autorizimeve ligjore kanë të drejtë që të nxjerrin akte nënligjore me karakter normativ.

Kohët e fundit është vënë re një rritje e rolit prodhues të normave nënligjore në raport me atë ligjvënës të Kuvendit. Madje disa autorë, theksojnë se në këtë rast mund të flasim për pushtet "legjislativ të administratës".<sup>213</sup> Arsyet e një zhvillimi të tillë mund të gjenden në disa argumenta, si koha e kufizuar që ka në dispozicion parlamenti për realizimin e funksionit legjislativ, bllokimi i këtij mekanizmi, karakteri teknik i çështjeve etj.<sup>214</sup> I gjithë ky aktivitet legjislativ megjithëse me karakter nënligjor mund të jetë shkak për cënimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të parimeve kushtetuese, mënyrës së organizimit të organeve kushtetuese dhe institucioneve të parashikuara prej saj, apo sferen e kompetencave të tyre. Për këtë arsye ligjvënësi kushtetues ka parashikuar edhe kontrollin e këtyre akteve si pjesë e juridiksionit kushtetues.<sup>215</sup>

E drejta e Gjykatës Kushtetuese për të kontrolluar edhe aktet normative nënligjore ka qenë parashikuar që në Kushtetutën Austriake të vitit 1920. Pra, që në fillimit e saj, drejtësia kushtetuese e tipit kelzenian e kishte të parashikuar një kompetencë të tillë. Kelzeni e justifikonte këtë zgjidhje kushtetuese për t'i dhënë juridiksionit kushtetues edhe kontrollin mbi rregulloret<sup>216</sup> në interes të unitetit dhe qartësisë substanciale të së drejtës për shkak të rëndësisë dhe dimensioneve që ka marrë aktiviteti rregullues nënligjor bazuar kjo edhe në sistemin e burimeve normative.<sup>217</sup> Një kontroll i tillë njihet në shumicën e vendeve që zbatojnë sistemin kushtetues të centralizuar veçanërisht ato të vendeve lindore që dolën nga sistemi komunist ku në këtë rast mund të përmendim Kroacinë, Slloveninë, Hungarinë,<sup>218</sup> Rusinë<sup>219</sup> etj.

Kushtetuta në nenin 131, gërma "c" të saj parashikon se Gjykata Kushtetuese kontrollon kushtetutshmërinë e *akteve normative të organeve qendrore*. Pra, në këtë rast duhet që të plotësohen dy kushte ku **së pari** akti duhet të ketë natyrë normative dhe **së dyti** duhet të jetë miratuar nga organe qendrore. Le ti analizojmë me rradhë.

Kuptimin e aktit normativ, deri vonë e ka dhënë doktrina,<sup>220</sup> dhe vetëm shumë kohë më vonë u dha nga legjislacioni ynë. Kështu LGJA, në nenin 2 pika 3 të tij e përkufizon si çdo vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje dhe që nuk

<sup>212</sup> Kushtetuta, neni 102, pika 4.

<sup>213</sup> Sadushi, Sokol, "Pushteti legjislativ i administratës", botuar në Revistën "Avokatia", Nr.6, Botim i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Shtypshkronja "Dea Print", Tiranë, Prill 2013, fq.53-76.

<sup>214</sup> Po aty, fq.55-76.

<sup>215</sup> Kushtetuta, neni 131, gërma "c": *Gjykata Kushtetuese vendos për: ...c) pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore ... me Kushtetutën...*

<sup>216</sup> Me rregullore sipas Kushtetutës Austriake kuptohen përveç rregulloreve në kuptim të ngushtë edhe dekretet, urdhëresat, si edhe akte të tjera nënligjore të parashikuara nga Kushtetuta. D'Orlando, Elena, "La giustizia costituzionale in Austria", botuar në "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova, 2009, fq.123.

<sup>217</sup> D'Orlando, Elena, "La giustizia costituzionale in Austria" botuar në "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova, 2009, fq.122.

<sup>218</sup> Pistan, Carna, "La giustizia costituzionale nell'Europa Centro-Orientale: Le esperienze di Croazia, Slovenia, Polonia e Ungheria", botuar në "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova, 2009, fq.419-420.

<sup>219</sup> Di Gregorio, Angela, "La corte costituzionale della Russia", botuar në "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova, 2009, fq.457.

<sup>220</sup> Sadushi, Sokol, "E Drejta Administrative 2, Teoria e aktit administrativ", Shtëpia Botuese "ORA", Tiranë 2005.

shteron në zbatimin e tij. Edhe Kodi i ri i Procedurave Administrative me shumë pak ndryshime ruan të njëjtin përkufizim.<sup>221</sup> Elementët e aktit normativ janë shqyrtuar edhe nga jurisprudenca Kushtetuese e cila ka mbajtur qëndrimin se:

*Në vlerësimin e Gjykatës, tri kritere përcaktojnë ndarjen e aktit nëligjor në individual ose normativ: (i) **Subjektet të cilave akti u drejtohet** - subjekte individualisht të përcaktuara të së drejtës/një grup personash të përcaktueshëm në bazë të karakteristikave të përgjithshme, ose subjekte të papërcaktuara të së drejtës; (ii) **Objekti** - krijimi, ndryshimi ose shuarja e një marrëdhënieje juridike konkrete të së drejtës administrative, ose përcaktimi i normave të përgjithshme të sjelljes, me karakter abstrakt; (iii) **Karakterit shterues/jo shterues** - efektet shtrihen tek subjekte të përcaktuara dhe në mënyrë të njehershme, ose tek subjekte të papërcaktuara të së drejtës, në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njehershme.<sup>222</sup>*

Në këtë drejtim mund të themi se në kuptim të nenit 131 gërma “c” të Kushtetutës rezulton se karakteri normativ i aktit të kundërshtuar është elementi përcaktues që ndan juridiksionin kushtetues nga ai i gjykatave të zakonshme. Vetëm aktet normative mund të jenë objekt i kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës, që ushtrohet nga Gjykata Kushtetuese, ndërkohë që aktet individuale i nënshtrohen kontrollit të sistemit të zakonshëm gjyqësor.<sup>223</sup>

Përsa i përket kriterit të dytë, atë të organit miratues, rezulton se Kushtetuta përdor vetëm termin *organ qendror*, pa e shtjelluar atë, nëse duhet të kuptohen vetëm organet qendore me natyrë kushtetuese apo edhe organet e tjera që krijohen në bazë të ligjeve të veçanta. Për këtë aspekt në doktrinë është mbajtur qëndrimi se në nocionin “*organe qendrore*” përfshihen jo vetëm Këshilli i Ministrave por edhe institucionet e tjera qendrore që, sipas ligjit, identifikohen si të tillë. Këtë kuptim të organeve qendrore e jep edhe neni 117, pika 1, i Kushtetutës që parashikon botimin në Fletoren Zyrtare, si një kusht për marrjen e fuqisë juridike krahas ligjeve dhe akteve normative të Këshillit të Ministrave e të ministrave, edhe aktet e institucioneve të tjera qendrore. Norma kushtetuese e sipërcituar, duke mos përfshijtur institucionet e tjera qendrore nga nocioni “organ qendror”, në të njëjtën mënyrë ka pranuar juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese edhe në drejtim të kontrollit të kushtetueshmërisë së akteve normative që ato nxjerrin.<sup>224</sup> Po kështu edhe një tjetër grup autorësh ka mbajtur qëndrimin se janë edhe një kategori aktesh që dalin nga organe administrative të pavarura, si ILDKPKI, RTSH, KKRTSH, Autoriteti i Konkurrencës, etj, që nëse janë normative dhe për sa kohë kanë çenuar interesat e subjekteve kushtetues të legjitimuar për t’i kundërshtuar, mendojnë se mund të bëhen objekt të një gjykimi kushtetues.<sup>225</sup>

Qëndrimi i mësipërm doktrinor duket se nuk është pranuar nga Gjykata Kushtetuese. Kështu në një rast kur kërkesa ishte paraqitur kundër rregullores së Shkollës së Lartë të Magjistraturës, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin e mëposhtëm:

<sup>221</sup> Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, neni 3 pika 2.

<sup>222</sup> Vendimi nr.14, datë 21.3.2014 i Gjykatës Kushtetuese, parag.22.

<sup>223</sup> Vendimi nr.14, datë 21.3.2014 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>224</sup> Sadushi, Sokol, “Drejtësia kushtetuese në zhvillim”, Shtëpia Botuese “Toena”, Tiranë 2012, fq.213.

<sup>225</sup> Dobjani, Ermir; Toska, Elsa; Puto, Erlir; Dobjani, Erajd; “E drejta administrative – Kontrolli mbi Administratën Publike”, Shtëpia Botuese “EMAL”, Tiranë 2013, fq.286.



*Kolegji, bazuar në shkronjat "a", "b" dhe "c" të nenit 131 të Kushtetutës, vëren se, Gjykata Kushtetuese ka juridiksion për të vendosur për kushtetutshmërinë e akteve normative që paraqiten në formën e ligjit, të marrëveshjeve ndërkombëtare, si dhe akteve normative të organeve qendrore dhe vendore. Kolegji, referuar objektit të kësaj kërkesë, i cili përcakton edhe lëndën e shqyrtimit kushtetues, çmon se akti që kërkohet të bëhet objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese, edhe pse është një akt normativ, nuk përfshihet në llojet e akteve të mësipërme normative për të cilat ka juridiksion kjo gjykatë. Si rrjedhim, Kolegji vlerëson se Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për shqyrtimin e kësaj kërkesë.*<sup>226</sup>

Në këtë vendim, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese ka bërë një dallim midis akteve normative. Kështu ajo pranon se ka edhe akte normative për të cilat Gjykata nuk ka juridiksion. Në këtë drejtim rezulton se objekt gjykimi mund të jenë vetëm aktet normative të cilat miratohen nga organet kushtetuese por jo ato që miratohen nga organe të tjera qendrore. Vetiu këto akte janë objekt gjykimi pranë gjykatave administrative.

Nga sa më sipër rezulton se objekt gjykimi mund të jenë vetëm aktet normative të organeve kushtetuese apo institucioneve të parashikuara prej saj. Pra, objekt janë aktet e Këshillit të Ministrave, ministrave, Bankës së Shqipërisë, Këshillit të Lartë të Drejtësisë etj. Ajo që duhet theksuar në këtë rast është se nuk është objekt i kontrollit kushtetues në këtë lloj gjykimi ometimi i organeve qendrore për të miratuar akte normative nënligjore megjithëse janë të autorizuar nga ligji për ta bërë diçka të tillë. Ky lloj qëndrimi mbahet nga të gjitha sistemet e kontrollit kushtetues, përfshirë edhe ato që parashikojnë një kontroll mbi ometimin legjislativ.<sup>227</sup>

Një tjetër akt që përfshihet si juridiksion i Gjykatës Kushtetuese në këtë rast është edhe rregullorja e Kuvendit. Por në këtë rast rregullorja e Kuvendit paraqet një veçanti. Kështu sipas jurisprudencës kushtetuese rezulton se:

*Nisur nga karakteri normativ i saj dhe referuar nenit 131, gërma "c" të Kushtetutës, Rregullorja, mund të jetë vetëm objekt i kontrollit kushtetues në rastet kur dispozita të nivelit kushtetues, të përfshira në të, janë të papajtueshme me Kushtetutën.*<sup>228</sup>

Nga pasazhi i mësipërm rezulton se rregullorja e Kuvendit mund që të bëhet objekt i kontrollit kushtetues vetëm pjesërisht dhe konkretisht vetëm normat juridike të rregullores të cilat detajojnë parashikimet kushtetuese për organizimin dhe funksionimin e Kuvendit. Rëndësia e këtij kontrolli qëndron në faktin për të evituar që Kuvendi të mundet, nëpërmjet ndryshimeve të rregullores, të tejkalojë kufijtë që Kushtetuta i ka vendosur pushtetit legjislativ.<sup>229</sup>

Megjithëse parashikohet nga Kushtetuta, rezulton që për shkak të natyrës së tij, *urdhëri*, është një akt që nuk i nënshtrohet kontrollit kushtetues. Karakteristikat e urdhërit mund të përmbliken në i) janë të brendshme, ii) janë të detyrueshme për njësitë administrative që varen prej organeve që i nxjerrin ato; iii) nuk i drejtohen individëve, iv) dalin për zbatim të akteve me

<sup>226</sup> Vendimi nr.30, datë 2.3.2012 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>227</sup> Belletti, Michele, "Il sistema costituzionale portoghese", botuar në "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova, 2009, fq.283.

<sup>228</sup> Vendimi nr.29, datë 21.10.2009 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>229</sup> Spechia, Marina Calamo, "La giustizia costituzionale in Francia", botuar në "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova, 2009, fq.209.



fuqi të përgjithshme.<sup>230</sup> Në këtë aspekt, si një akt me natyrë individuale, urdhëri, është jashtë juridiksionit kushtetues.

## 2.7 Aktet normative të organeve vendore.

Kushtetuta në nenin 131, gërma "c" të saj parashikon gjithashtu edhe kompetencën e Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar kushtetueshmërinë e akteve nënligjore të organeve vendore.

Kushtetuta parashikon se Këshilli i Qarkut ka të drejtë të nxjerrë urdhëresa dhe vendime me fuqi detyruese të përgjithshme për qarkun. Organet e njësisve të qeverisjes vendore nxjerrin urdhëresa, vendime dhe urdhëra. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe. Karakteri normativ i këtyre akteve del edhe nga fakti se edhe pse me shtrirje territoriale të kufizuara, nëse grupi i subjekteve është i papërcaktuar si edhe nëse ato janë jo shteruese, pra bëhen burim për nxjerrjen e akteve të karakterit individual, aktet e pushtetit vendor do të konsiderohen normative. Gjithsesi *expressis verbis* Kushtetuta e përcakton karakterin e tyre normativ në nenin 131, gërma "c" të saj. Në këtë kontekst akte të tilla janë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese për shqyrtim.<sup>231</sup>

Në përgjithësi për këtë lloj gjykimi vlen i njëjti trajtim që kemi bërë përsa i përket kontrollit të akteve normative të organeve qendrore. Bazuar në këtë trajtim rezulton se objekt gjykimi mund të jenë vetëm aktet e organeve vendore që parashikohen nga Kushtetuta, bashkitë, komunat dhe qarqet. Aktet normative të organeve të tjera vendore që mund të krijohen me ligj,<sup>232</sup> nuk mund të jenë objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese.

## 2.8 Aktet, veprimet dhe mosveprimet si shkak i lindjes së mosmarrëveshjes së kompetencave midis organeve qendrore.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon si pjesë të juridiksionit të saj edhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave midis organeve qendrore dhe midis organeve qendrore dhe atyre vendore. Por me përjashtim të nenit 131, gërma "ç" të Kushtetutës, në asnjë rast nuk përmend shkaqe apo situata për shkak të të cilave mund të lindë një mosmarrëveshje kompetencash. Në këtë lloj gjykimi nuk është në plan të parë kontrolli i kushtetueshmërisë mbi aktet e paligjshme. Objekt i këtij gjykimi është shpërndarja e kompetencave, jo duke i analizuar në mënyrë abstrakte, por në lidhje me mënyrën e veprimit të organeve dhe enteve kushtetuese. Gjykimi mbi mosmarrëveshjet në këtë rast nuk analizon fillimisht kushtetueshmërinë e akteve, por përkatësinë e kompetencave kushtetuese.<sup>233</sup> Për këtë arsye i referohemi LGJK, i cili në nenin 54 pika 4 të tij, në mënyrë të përgjithshme parashikon se shkak për lindjen e një mosmarrëveshjeje kompetencash mund të jetë çdo akt ligjor, nënligjor, veprim apo mosveprim i organeve të ndryshme. Po kjo dispozitë parashikon dy lloje të mosmarrëveshjeve të kompetencave, ***konfliktin pozitiv***, që lind kur dy apo më shumë organe e kanë konsideruar veten kompetente për një çështje konkrete dhe ***konfliktin negativ*** që lind kur asnjëri prej organeve nuk

<sup>230</sup> Dobjani, Ermir; Toska, Elsa; Puto, Erlir; Dobjani, Erajd; "E drejta administrative – Kontrolli mbi Administratën Publike", Shtëpia Botuese "EMAL", Tiranë 2013, fq.302.

<sup>231</sup> Dobjani, Ermir; Toska, Elsa; Puto, Erlir; Dobjani, Erajd; "E drejta administrative – Kontrolli mbi Administratën Publike", Shtëpia Botuese "EMAL", Tiranë 2013, fq.303.

<sup>232</sup> Kushtetuta, neni 108, pika 1: *Njësitë e qeverisjes vendore janë komunat ose bashkitë dhe qarqet. Njësi të tjera të qeverisjes vendore rregullohen me ligj.*

<sup>233</sup> Zagrebelesky, Gustavo; Marceno, Valeria, "Giustizia costituzionale", Shtëpia Botuese "Il Mulino", Bologna 2012, fq.422.

e ka konsideruar veten kompetent për të vendosur për një çështje të caktuar, duke bllokuar në këtë mënyrë veprimtarinë e një organi tjetër. Duke përgjithësuar të dyja raste e mësipërme të mosmarrëveshjes së kompetencave mund të pohojmë se një mosmarrëveshje kompetencash mes pushteteve mund të lind kur një akt ose një sjellje që supozohen e paligjshme i shkaktojnë një dëm kërkuesit, qoftë sepse ndërhyjnë në sferën e kompetencës që i është rezervuar atij plotësisht ose pjesërisht, qoftë sepse mungon ushtrimi i kompetencave të veta ose pengon efektet e akteve të tij, qoftë në fund sepse në një farë mënyre prek pavarësinë e tij në planin strukturor si pushtet i shtetit.<sup>234</sup>

Për të kuptuar nëse ndodhemi apo jo përpara një mosmarrëveshje kompetencash doktrina e huaj,<sup>235</sup> ajo shqiptare<sup>236</sup> dhe vetë jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese<sup>237</sup> kanë përcaktuar se duhet që të ekzistojnë në mënyrë kumulative këto kushte:

- *mosmarrëveshja, duhet të lindë ndërmjet organeve që u përkasin pushteteve të ndryshme;*

- *mosmarrëveshja duhet të lindë ndërmjet organeve kompetente që deklarojnë përfundimisht vullnetin e pushtetit të cilit i përkasin;*

- *mosmarrëveshja duhet të lindë për përcaktimin e sferës së kompetencave të përcaktuara nga normat kushtetuese për pushtete të ndryshme.*

Këto kritere, në vija të përgjithshme, janë pranuar në të gjitha vendet që i kanë caktuar drejtësisë kushtetuese kompetencën që të zgjidhë këto lloje mosmarrëveshjes.<sup>238</sup> Megjithatë jo çdo mosmarrëveshje kompetencash është pjesë e juridiksionit kushtetuese. Kështu doktrina e huaj<sup>239</sup> dhe ajo shqiptare<sup>240</sup> theksojnë se mbeten jashtë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet organeve që i përkasin juridiksioneve të ndryshme gjyqësore (konflikte të juridiksionit) dhe ndërmjet organeve që i përkasin të njëjtin pushtet, p.sh. ndërmjet dy ministrave (konflikte të kompetencës).

Duke i'u referuar përsëri ligjit organik të Gjykatës, vërejmë se përdorimi i termave të tillë si *çdo akt ligjor, nënligjor, veprim apo mosveprim*, të çon në përfundimin se mosmarrëveshja për kompetencë mund të jete *normative* - kur rrjedh nga ligji; ose *individuale* - kur rrjedh nga veprimet e organeve, që shfaqet në formën e nxjerrjes së akteve individuale.

Nga tërësia e akteve të mësipërme përjashtohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese për arsye të tilla që kanë të bëjnë me natyrën juridike të tyre. Duke qenë ato të pakundërshtueshme<sup>241</sup> nuk mund të jenë origjina e një mosmarrëveshjeje. Si rregull në gjykimin për mosmarrëveshje

<sup>234</sup> Martines, Temistocle, "E drejta kushtetuese", botim në gjuhën shqipe, Shtëpia Botuese "UET Press", Tiranë 2011, fq. 367.

<sup>235</sup> Ruggeri, Antonio; Spadaro, Antonino, "Lineamenti di giustizia costituzionale", Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2009, fq.240.

Martines, Temistocle, "E drejta kushtetuese", botim në gjuhën shqipe, Shtëpia Botuese "UET Press", Tiranë 2011, fq. 364.

<sup>236</sup> Sadushi, Sokol, "Drejtësia kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq. 508.

<sup>237</sup> Vendimi nr. 26, datë 4.12.2006 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>238</sup> Fanotto, Luca "La giustizia costituzionale negli ordinamenti asiatici", botuar në "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova 2009, fq.751. Rasti i Indonezisë.

<sup>239</sup> Martines, Temistocle, "E drejta kushtetuese", botim në gjuhën shqipe, Shtëpia Botuese "UET Press", Tiranë 2011, fq. 364.

<sup>240</sup> Sadushi, Sokol, "Drejtësia kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq. 509.

<sup>241</sup> Neni 132, pika e Kushtetutës, i përcakton ato si përfundimtare dhe me fuqi detyruese të përgjithshme.

kompetencash njihet mundësia e shfuqizimit të aktit që ka cënuar kompetencën e një organi tjetër, por kjo mundësi është inekzistente përse i përket vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.<sup>242</sup>

Fakti se cili mund të jetë shkaku i mosmarrëveshjes ka ngjallur debat edhe në doktrinën tonë, veçanërisht përse i përket ligjit si akt juridik i aftë për të shkaktuar një mosmarrëveshje kompetencash. Si rregull kushtetutshmëria e ligjit kontrollohet në rrugë abstrakte nga Gjykata Kushtetuese, kompetencë kjo e parashikuar nga neni 131, gërma "a" e Kushtetutës. Për rrjedhojë duke qenë se gjykimi për mosmarrëveshjen e kompetencës është një gjykim konkret parimisht ligji nuk mund të jetë objekt në këtë lloj gjykimi.

Edhe në doktrinën e huaj, parimi që ndiqet është që si rregull në këtë lloj gjykimi, ligji nuk mundet që të jetë objekt i gjykimit përderisa kushtetutshmëria e tij zgjidhet nëpërmjet një gjykimi tjetër që është gjykim i abstrakt i kontrollit të pajtueshmërisë së ligjit me kushtetutën. Përjashtimisht një gjë e tillë mund të lejohet nëse akti që ka shërbyer si shkak për lindjen e mosmarrëveshjes bazohet në ligj dhe për të goditur këtë ligj nuk ekziston mundësia e subjektit për të hapur një gjykim tjetër për të kontrolluar kushtetutshmërinë e këtij ligji.<sup>243</sup> Praktika italiane në këtë rast lidhet me mundësinë që ka Gjykata Kushtetuese për të nisur një kontroll incidental, klasik, ku si gjykatë referuese është po vetë Gjykata Kushtetuese. Gjykimi për mosmarrëveshjen e kompetencave qëndron i pezulluar deri në përfundimin e këtij procesi. Në këtë rast të dyja këto gjykime ruajnë autonominë e tyre të plotë.<sup>244</sup>

Në kundërshtim me këto qëndrime, e ndikuar edhe nga mënyra se si është formuluar neni 54 i LGJK që në vendimet e saj të para Gjykata jonë Kushtetuese e ka njohur mundësinë që mosmarrëveshja e kompetencave mund të lindë si nga akte ligjore, nënligjore normative por edhe individuale. Kështu në vendimin nr.29, datë 21.12.2006, ky institucion ndër të tjera është shprehur se:

*Duke iu referuar doktrinës dhe jurisprudencës kushtetuese, Gjykata Kushtetuese vlerëson se mosmarrëveshja e kompetencës mund të paraqitet në formën e konfliktit "normativ" kur kompetenca që përbën objektin e mosmarrëveshjes parashikohet në ligje, ashtu si edhe në formën e konfliktit "individual", kur institucionet në konflikt nxjerrin aktet përkatëse të zbatimit të ligjit konkret.*

*Mosmarrëveshjet e kompetencës mund të shkaktohen kur një ligj u atribuon të njëjtën kompetencë dy a më shumë institucioneve, kur e njëjta kompetencë u atribuohet sipas ligjesh të ndryshëm dy institucioneve, si edhe kur ligji parashikon kompetencën, por*

<sup>242</sup> Zagrebelesky, Gustavo; Marceno, Valeria, "Giustizia costituzionale", Shtëpia Botuese "Il Mulino", Bologna 2012, fq.439.

<sup>243</sup> Giovannetti, Tommaso, "I "soggetti esclusi" nei conflitti di attribuzione", botuar në "Le zone d'ombra della giustizia costituzionale – I giudizi sui conflitti di attribuzione e sull'ammisibilità del referendum abrogativo", botuar nga "Quaderni del "Gruppo di Pisa", nën kujdesin e Roberto Pinardi, Shtëpia Botuese "G.Giappichelli Editore", Torino 2007, fq.47.

Parisi, Stefania, "Parametro e oggetto nei conflitti di attribuzione", botuar në "Le zone d'ombra della giustizia costituzionale – I giudizi sui conflitti di attribuzione e sull'ammisibilità del referendum abrogativo", botuar nga "Quaderni del "Gruppo di Pisa", nën kujdesin e Roberto Pinardi, Shtëpia Botuese "G.Giappichelli Editore", Torino 2007, fq.88

Ruggeri, Antonio; Spadaro, Antonino, "Lineamenti di giustizia costituzionale", Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2009, fq.255.

<sup>244</sup> Parisi, Stefania, "Parametro e oggetto nei conflitti di attribuzione", botuar në "Le zone d'ombra della giustizia costituzionale – I giudizi sui conflitti di attribuzione e sull'ammisibilità del referendum abrogativo", botuar nga "Quaderni del "Gruppo di Pisa", nën kujdesin e Roberto Pinardi, Shtëpia Botuese "G.Giappichelli Editore", Torino 2007, fq.90-91.

*nuk ka saktësuar organin që duhet ta ushtrojë. Zgjidhja e çështjeve të kësaj natyre nuk mund të bëhet me kontroll kushtetues in abstracto dhe duke abstraguuar nga rasti konkret. Prandaj, fakti se cilit organ i takon një kompetencë e debatuar përcaktohet duke u nisur nga një çështje konkrete, kur organi e ka zbatuar ligjin konfliktual dhe, mbi këtë bazë, ka nxjerrë aktin individual të zbatimit.*

*Në praktikë, një konflikt i tillë mund të lindë si pasojë e nxjerrjes së një akti juridik, por që përmban një shprehje të qartë të vullnetit, me të cilën pohohet e drejta e ushtrimit të pushtetit. Pavarësisht nga shprehja ose jo e kundërshtimeve për përkatësinë e pushtetit, mund të konsiderohet se konflikti është i pranueshëm për t'u gjykuar edhe në rast se nga ushtrimi abuziv i pushtetit pakësohen ose pengohen ushtrimi i kompetencave që Kushtetuta ia atribuon subjektit ankues.*

Qëndrimi i mësipërm i Gjykatës Kushtetuese është pasqyruar më tej edhe në doktrinën juridike.<sup>245</sup>

Në lidhje me aktet administrative doktrina në këtë rast ka identifikuar një sërë aktesh apo veprimesh të cilat janë bërë shkak për lindjen e një mosmarrëveshje kompetencash. Kështu akti, si shkaktar i konfliktit mund të jetë një akt përfundimtar por edhe edhe një veprim administrativ i cili nuk vishet në formën e një akti tjetër.

Kërkesa që duhet plotësuar që akti apo veprimi të konsiderohet përfundimtar konsiston në kompetencën për të nxjerrë akte apo për të kryer veprime të afta që përfshijnë të gjithë organin në tërësinë e tij dhe nuk janë të anulueshme apo të ndryshueshme me nismë të një organi që i përket të njëjtut pushtet apo të një pushteti tjetër. Në thelb veprimi përfundimtar i aftë për të përfshirë pushtetin, është ai i cili nuk pranon ndërhyrje nga ana e subjekteve të tjera.<sup>246</sup>

Si shkak të mosmarrëveshjes mund të jenë edhe akte që të paktën teorikisht kanë natyrë të brendshme, por që sjellin edhe efekte të jashtme. Kështu në dy raste që Kuvendi ka refuzuar kërkesën e jo më pak se një të katërtës së deputetëve për ngritjen e një komisioni hetimor. Në këtë rast, vendimi i Kuvendit si akt ka natyrë të brendshme. Ai nuk i drejtohet organeve të tjera kushtetuese dhe nuk çënon kompetencat e tyre. Megjithatë duke qenë se Kushtetuta, i ka njohur personalitet juridik, këtij grupimi deputetësh<sup>247</sup> ky akt është konsideruar i mjaftueshëm për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues.<sup>248</sup>

Po kështu akte administrative me natyrë të brendshme por që kanë sjellë lindjen e një mosmarrëveshje kompetencash janë konsideruar vendimet e Kuvendit për ngritjen e një komisioni hetimor, duke ndërhyrë në këtë mënyrë në fushëveprimin e kompetencave që u përkasin organeve të tjera kushtetuese (konkretisht prokurorisë).<sup>249</sup>

Përsa i përket akteve gjyqësore pra vendimeve të ndërmjetme, jopërfundimtare dhe ato përfundimtare qëndrimi që është mbajtur është se në mënyrë që një kërkesë kundër një vendimi gjyqësor të konsiderohet si e pranueshme duhet që kundërshtimi ndaj tij të jetë i tillë që të argumentojë se ky vendim tejkalon kufijtë e vendosura mbi funksionet gjyqësore dhe me qëllim për të mbrojtur funksionet e pushteteve të tjera. Por në këtë rast kundërshtimi i argumentave

<sup>245</sup> Sadushi, Sokol, "Drejtesia kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq. 511.

<sup>246</sup> Cecamore, Francesca, "L'autorità indipendente come parte nel conflitto di attribuzione fra poteri dello Stato", botuar në "Le zone d'ombra della giustizia costituzionale – I giudizi sui conflitti di attribuzione e sull'ammisibilità del referendum abrogativo", botuar nga "Quaderni del "Gruppo di Pisa", nën kujdesin e Roberto Pinardi, Shtëpia Botuese "G.Giappichelli Editore", Torino 2007, fq.143.

<sup>247</sup> Vendimi nr.18, datë 14.5.2003 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>248</sup> Vendimet nr.20, datë 4.5.2007 dhe nr.30, datë 16.5.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>249</sup> Vendimet nr.26, datë 4.12.2006 dhe nr.12, datë 20.5.2008 të Gjykatës Kushtetuese.



ligjorë dhe sugjerimi për një tjetër zgjidhje ligjore nuk është shkak i mjaftueshëm që të jemi përpara një mosmarrëveshje kompetencash midis pushteteve, pasi ky lloj gjykimi nuk mundet që të transformohet në një mjet tjetër për apelimin e vendimeve gjyqësore.<sup>250</sup>

Sidoqoftë duhet të kemi parasysh se jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka trajtuar dhe ka përcaktuar kritere kushtetuese vetëm për situatën kur jemi përpara një mosmarrëveshjeje kompetencash të karakterit pozitiv, pra kur organet përkatëse e kanë konsideruar veten kompetentë për zgjidhjen e një situatë të caktuar.

Për konfliktin negativ të kompetencave, Gjykata është shprehur vetëm në një rast ku ajo ka konkluduar se:

*...bazuar në doktrinën kushtetuese, konflikti mund të lindë edhe kur një organ nuk kërkon për vete kompetencën për të përmbushur një akt të caktuar, por pretendon që sjellja mosvepruese e një organi tjetër ose një akt i tij kanë zvogëluar kompetencat e tij ose e kanë penguar në ushtrimin e tyre...<sup>251</sup>*

Në një mosmarrëveshje negative kompetencash analizohet mosveprimi i organit i cili në këtë mënyrë çënon pikërisht kompetencën e një organi tjetër kushtetues. Një shembull i këtij konflikti ishte rasti kur Kuvendi refuzoi të shprehej në lidhje me dekretet e Presidentit të Republikës për emërimin e disa ministrave. Megjithatë Presidenti në atë kohë iu drejtua Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për interpretim përfundimtar të nenit 98 të Kushtetutës dhe jo për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave.<sup>252</sup>

Ajo që vihet re në jurisprudencën e huaj kushtetuese por së fundmi edhe në jurisprudencën tonë kushtetuese është fakti që këto mosmarrëveshje duket sikur janë kthyer në zgjidhjen e një konflikti që më shumë bazohet në legjislacion se në Kushtetutë. Është ky ai proces që njihet dekonstitucionalizimi i mosmarrëveshjes, ku norma me karakter nën kushtetutë marrin rëndësi kushtetuese dhe shërbejnë për zhvillimin e gjykimit.<sup>253</sup> Për këtë arsye për të bërë një dallim midis gjykimi kushtetues dhe atij administrativ të zakonshëm është e nevojshme që mosmarrëveshja duhet që të jetë përcaktuar nga norma kushtetuese. Për rrjedhojë me tej mosmarrëveshja mund të zgjidhet edhe mbi bazën e legjislacionit ekzistues por me kusht që këto norma të jenë integruese dhe detajuese të dispozitave kushtetuese. Në fakt shumë rrallë Kushtetuta ka dispozita analitike dhe ezauruese për sa i përket kompetencave të organeve kushtetuese. Si rregull, atributet me karakter kushtetues të një organi të parashikuar nga Kushtetuta janë të përcaktuara nga norma të tjera ligjore. Kushti thelbësor në këto raste është që ky lloj ligji duhet të jetë kushtetushmërisht i nevojshëm, në kuptimin që një shfuqizimin apo mungesa e tij e mundshme do të sillte një bllokim të funksionimit të organit, të institucioneve kushtetuese apo me rëndësi kushtetuese.<sup>254</sup> Shembuj të tillë mund të përmendin gjykimet që kanë pasur si qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave midis Kuvendit, i cili veprimi nëpërmjet komisioneve hetimore dhe Prokurorisë. Dispozitat kushtetuese në këtë rast bëjnë fjalë

<sup>250</sup> Vendimi nr.334, i vitit 2008 i Gjykatës Kushtetuese Italiane, marrë nga faqja zyrtare e internetit [www.cortecostituzionale.it](http://www.cortecostituzionale.it).

<sup>251</sup> Vendimi nr.22, datë 5.5.2010 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>252</sup> Vendimi nr.6, datë 18.1.2002 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>253</sup> Teresi, Francesco, "I giudizi della Corte Costituzionale", Shtëpia Botuese "Cacucci Editore", Bari 2010, fq.186.

<sup>254</sup> Cecamore, Francesca, "L'autorità indipendente come parte nel conflitto di attribuzione fra poteri dello Stato", botuar në "Le zone d'ombra della giustizia costituzionale – I giudizi sui conflitti di attribuzione e sull'ammisibilità del referendum abrogativo", botuar nga "Quaderni del "Gruppo di Pisa", nën kujdesin e Roberto Pinardi, Shtëpia Botuese "G.Giappichelli Editore", Torino 2007, fq.137-138.

vetëm për të drejtën e Kuvendit për të ngritur komisione hetimore dhe kompetencën e Prokurorisë për të ushtruar ndjekjen penale. Për të arritur në një konkluzion të drejtë dhe në funksion të kuptimit të ndjekjes penale, Gjykata Kushtetuese iu referua gjerësisht parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, duke vendosur përfundimisht në favor të Prokurorisë.<sup>255</sup>

Në këtë kuptim thjesht fakti që autoritetet e shtetit janë përfshirë në një mosmarrëveshje nuk do të thotë që kjo mosmarrëveshje bie në fushëveprimin e kompetencave të Gjykatës Kushtetuese nëse kjo mosmarrëveshje nuk ngre çështje në nivel kushtetues.<sup>256</sup>

## **2.9 Aktet, veprimet dhe mosveprimet si shkak i lindjes së mosmarrëveshjes së kompetencave midis organeve qendrore dhe njërive të qeverisjes vendore.**

Kushtetuta i njeh kompetencën Gjykatës Kushtetuese që të zgjidhë edhe mosmarrëveshjen e kompetencave që mund të lindë midis pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore. Një konflikt i tillë mund të lindë kur një organ i qeverisjes vendore shkel me një akt të tij sferën e kompetencës që i është dhënë pushtetit qendror nga Kushtetuta ose, anasjelltas kur pushteti qendror shkel me një akt të tij sferën e kompetencave kushtetuese të një organi të qeverisjes vendore. Edhe në këtë rast duhet të bëhet fjalë për kompetenca (qendrore ose vendore) të përkufizuara nga Kushtetuta.<sup>257</sup>

Në thelb edhe në këtë gjykim, kushtet janë po të njëjta si edhe në gjykimin e mosmarrëveshjeve midis organeve të pushtetit qendror. Mosmarrëveshja mund të jetë me karakter normativ apo individual, pozitiv apo negativ. Po kështu edhe kushtet e tjera për lindjen e mosmarrëveshjes së kompetencave duhet që të jenë të pranishme edhe në këtë rast. Në këtë trajtim do të ndalemi vetëm në karakteristikat që e bëjnë atë të dallueshme nga gjykimi kushtetues për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencave midis organeve të pushtetit qendror.

Ajo që duhet theksuar në këtë pjesë është se Gjykata Kushtetuese nuk ka të drejtë të zgjidhë mosmarrëveshjet e kompetencës që mund të lindin midis dy apo më shumë njërive të qeverisjes vendore, pavarësisht se këto njësi kanë personalitet juridik të garantuar nga Kushtetuta. Në rast të një mosmarrëveshje kompetencash midis qarqeve të ndryshme apo midis një qarku dhe një bashkie që është njësi përbërëse e vetë atij qarku, kompetenca për zgjidhjen e tyre nuk i përket Gjykatës Kushtetuese por gjykatave administrative.

Në lidhje me aktet apo veprimet që mund të jenë shkak për lindjen e kësaj mosmarrëveshjes së kompetencave doktrina dhe jurisprudenca kushtetuese e huaj dhe shqiptare kanë mbajtur qëndrime të ndryshme në kohë të ndryshme. Kështu në doktrinën dhe jurisprudencën e huaj, ligjet dhe aktet që barazohen me to janë të përjashtuara si objekt i një gjykimi të tillë pasi kjo justifikohet me faktin se kontrolli i Gjykatës mbi këto akte mund të realizohet nëpërmjet një rruge tjetër dhe se pranimi i kundërshtimit të tyre në këtë lloj gjykimi do të sillte një kontroll të tepërt.<sup>258</sup> Në këtë drejtim nëse mosmarrëveshjet lindin si rezultat i miratimit të një norme me fuqinë e ligjit, mekanizmi që duhet përdorur për fillimin e gjyqimit kushtetues është kërkesa për antikushtetutshmëri në rrugë abstrakte. Kurse kur objekt i konfliktit

<sup>255</sup> Vendimet nr.26, datë 4.12.2006 dhe nr.12, datë 20.5.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>256</sup> Vendimi nr. U 17/07, datë 4.10.2008 i Gjykatës Kushtetuese të Bosnje-Hercegovinës, marrë nga CODICES e Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), me numër referimi BIH-2008-S-001.

<sup>257</sup> Sadushi, Sokol, "Kontrolli kushtetues", Shtëpia Botuese "Botimpex", Tiranë 2004, fq.120.

<sup>258</sup> Ruggeri, Antonio; Spadaro, Antonino, "Lineamenti di giustizia costituzionale", Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2009, fq.270.

është një normë që nuk ka fuqinë e ligjit apo një akt i miratuar nga shteti apo nga një komunitet autonom përdoret mosmarrëveshja e kompetencave.<sup>259</sup> Ky qëndrim ka gjetur fillimisht mbështetje edhe në doktrinën tonë, e cila është shprehur se ajo që ka rëndësi të nënvizohet këtu është që, ngaqë mund të lindë konflikt kompetencash ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore, çënimi i sferës nuk duhet të kryhet nga një ligj ose nga një akt që ka forcën e ligjit, sepse në një rast të tillë, hyjmë në kontrollin e kushtetueshmërisë së ligjit që zgjidhet nga Gjykata Kushtetuese nëpërmjet një rruge tjetër. Akti që i ka lënë shteg konfliktit mund të jetë një akt çfarëdo që nuk është një ligj formal ose një akt që ka forcën e ligjit, por një akt formalisht administrativ dhe thelbësisht normativ (një vendim, urdhëresë, udhëzim etj).<sup>260</sup>

Pavarësisht kësaj, në mënyrë të konsoliduar Gjykata Kushtetuese ka mbajtur gjithmonë qëndrimin se edhe në këtë lloj gjykimi konflikti mund të jetë normativ, pra objekt i gjykimit si shkak i lindjes së mosmarrëveshjeve mund të jetë edhe ligji apo akte që barazohen me të. Ky qëndrim është pasqyruar edhe në vazhdim në doktrinën tonë.<sup>261</sup>

Aktet e tjera me karakter normativ apo individual të cilat në formë janë akte përfundimtare dhe tek të cilat shfaqet qartë vullneti për të ushtruar një kompetencë të caktuar, janë akte të cilat mund të jenë objekt i kontrollit kushtetues. Kështu, nëse i referohemi jurisprudencës sonë rezulton që janë konsideruar si akte të mjaftueshme për të shkaktuar lindjen e një mosmarrëveshje kompetencash, vendimi i Kuvendit për ngritjen e një komisioni hetimor për kontrollin dhe verifikimin e akteve në një njësi vendore si edhe vendimi i Kuvendit për miratimin e konkluzioneve të hetimit të këtij komisioni.<sup>262</sup> Akte të tjera janë konsideruar edhe vendimet e Këshillit Kombëtar të Territorit si organ që funksionon pranë Këshillit të Ministrave dhe që rregullojnë aspekte të ndryshme në fushën e urbanistikës.<sup>263</sup>

Një çështje tjetër e diskutueshme lidhet me akte të tjera me natyrë të brendshme por që tregojnë qartazi qëndrimin e një organi kushtetues për të ushtruar një kompetencë e cila pretendohet nga një organ tjetër. Doktrina ka pranuar se edhe këto akte, si për shembull një shkresë, një telegram apo një qarkore mund të jetë objekt i një gjykimi të tillë por vetëm me kusht që në këto akte të shfaqet një formë e qartë e shprehjes së vullnetit të organit përkatës.<sup>264</sup> Jurisprudenca jonë ka mbajtur një qëndrim tjetër, duke mos i konsideruar akte të tilla si të mjaftueshme për të provokuar një mosmarrëveshje kompetencash. Kështu, në rastin e gjykimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave midis Bashkisë Tiranë dhe Kuvendit, Gjykata Kushtetuese, ngritjen e një komisioni të brendshëm nga ana e Kuvendit i cili e trajtonte mënyrën se si duhej që të ngrihej kompleksi i ri parlamentar, nuk e konsideroi si akt i cili çenonte kompetencat e bashkisë në fushën e planifikimit urban.<sup>265</sup> Pra, janë të papranueshme konflikte që

<sup>259</sup> Ruiz-Rico Ruiz, Gerardo, "Il tribunale costituzionale spagnolo", botuar në "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova 2009, fq.257.

<sup>260</sup> Sadushi, Sokol, "Kontrolli kushtetues", Shtëpia Botuese "Botimpex", Tiranë 2004, fq.120-121.

<sup>261</sup> Sadushi, Sokol, "Drejhtësia kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq. 511.

<sup>262</sup> Vendimi nr.22, datë 5.5.2010 i gjykatës Kushtetuese.

<sup>263</sup> Vendimi nr.29, datë 21.12.2006 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>264</sup> Ruggeri, Antonio; Spadaro, Antonino, "Lineamenti di giustizia costituzionale", Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2009, fq.270.

<sup>265</sup> Vendimi nr.48, datë 8.11.2011 i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 11: *Në çështjen konkrete, Gjykata vlerëson se vendimi nr. 66, objekt shqyrtimi, është një akt individual, i cili është nxjerrë nga organi kompetent, Kuvendi i Shqipërisë, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit. Në bazë të nenit 106/1 të Rregullores së Kuvendit, Kuvendi, si pushtet ligjvënës, përveç miratimit të ligjeve, nxjerr edhe vendime, rezoluta dhe deklarata. Vendimi nr. 66 është shprehje e iniciativës së ligjvënës për ndërtimin e një Kompleksi të Ri Parlamentar. Ndër të tjera, ky vendim, parashikon miratimin e një ligji të veçantë, për sa i përket procedurës që do të ndiqet për ndërtimin e Kompleksit të ri Parlamentar. Nisur nga teksti i vendimit nr. 66, Gjykata çmon se nuk rezulton ndonjë shmangie e rolit dhe*



pretendohet se rrjedhin nga akte apo sjellje të brendshme administrative që nuk kanë asnjë pasojë të jashtme.<sup>266</sup>

Janë të përjashtuara nga një gjykim i tillë aktet konfirmuese apo ekzekutuese të akteve të tjera të cilat nuk janë shqyrtuar më parë apo kundërshtuar brenda afateve.<sup>267</sup> Në këtë mënyrë nëse një organ kushtetues ka cënuar kompetencat e një organi të qeverisjes vendore i cili nuk është ankuar në kohë atëherë organi i qeverisjes vendore nuk mund që të kundërshtojë aktet zbatuese që dalin për zbatimin e aktit kryesor.

Një çështje tjetër e diskutueshme është nëse organet qendrore cënojnë kompetencat që ato vetë u kanë deleguar njësive të qeverisjes vendore. Sipas Kushtetutës këto kompetenca mund të delegohen me ligj ose në bazë të një marrëveshjeje.<sup>268</sup> Duke iu referuar rastit të parë, pra delegimit të kompetencave nëpërmjet ligjit mund të jemi përpara situatës kur përsëri organet qendrore pa shfuqizuar ligjin delegues ndërhyjnë në kompetencat që u kanë deleguar njësive të qeverisjes vendore. Edhe në këto raste çështja mund të bëhet objekt i gjyqimit kushtetues vetëm nëse plotësohen dy kushte: a) delegimi i kompetenca të jetë i plotë dhe i qëndrueshëm dhe shteti të mos mbajë kompetenca konkurruese në këtë fushë dhe b) të ketë një lidhje të fortë midis kompetencave ekskluzive të njësive vendore dhe atyre të deleguara në mënyrë që cënimi i kompetencave të deleguara të sjellë si pasojë edhe cënimin e kompetencave ekskluzive të njësive vendore.<sup>269</sup> Edhe në rastin tjetër kur delegimi rrjedh nga një marrëveshje përsëri nëse plotësohen dy kushtet e sipërcituara çështja mund të bëhet objekt i mosmarrëveshjes mbi bazën e kërkesave të palëve në marrëveshje.<sup>270</sup>

Në disa juridiksione kushtetuese, përsa i përket mosmarrëveshjes së kompetencave për shkak të mosveprimit të organit kushtetues, rezulton se ky lloj gjykimi mund të përdoret vetëm nga shteti, kundrejt organeve vendore të cilat nuk kanë vepruar në përputhje me kompetencat e tyre, por jo e kundërta, pra një organ i qeverisjes vendore të kundërshtojë mosveprimin e organeve të pushtetit qendror.<sup>271</sup> Duke e përjashtuar këtë praktikë me rastin shqiptar jam i mendimit se kjo jurisprudencë mund të përdoret vetëm në rastin e kompetencave të deleguara. Në këtë rast konflikti negativ duhet të jetë vetëm në një krah, pra, vetëm organet qendrore mund të kundërshtojnë në Gjykatën Kushtetuese mosveprimin e organeve vendore për kompetencat që ai u ka deleguar, në rast se plotësohen kushtet e cituara më sipër, pra një kompetencë e lidhur me funksionet kushtetuese të organeve në mosmarrëveshje.

---

*kompetencave të Bashkisë së Tiranës, në lidhje me procedurat përkatëse për kërkim lejesh, miratim të projektit të zbatimit, të shesheve dhe lejeve të ndërtimit, apo shqyrtim të kërkesave për prishje objektesh. Në asnjë pikë të vendimit nr. 66, nuk parashikohet përjashtimi i Bashkisë së Tiranës nga ushtrimi i kompetencave të lartpërmendura, të cilat ligji nr. 8652, datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" dhe ligji nr. 8405, datë 17.09.1998, "Për urbanistikën", i ndryshuar, ja kanë atribuar. Në vijim të këtij arsyetimi, Gjykata vlerëson se vendimi nr. 66 nuk krijon efekte juridike në drejtim të uzurpimit të kompetencave të pushtetit vendor në fushën e planifikimit urban dhe menaxhimit të territorit. Për pasojë, Kuvendi i Shqipërisë, me vendimin nr. 66, nuk ndërhyr në kompetencat e Bashkisë së Tiranës, dhe pretendimet e subjektit kërkues për cenim të nenit 7 dhe 13 të Kushtetutës, janë haptazi të bazuara.*

<sup>266</sup> Teresi, Francesco, "I giudizi della Corte Costituzionale", Shtëpia Botuese "Cacucci Editore", Bari 2010, fq.189.

<sup>267</sup> Ruggeri, Antonio; Spadaro, Antonino, "Lineamenti di giustizia costituzionale", Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2009, fq.271.

<sup>268</sup> Kushtetuta, neni 112.

<sup>269</sup> Ruggeri, Antonio; Spadaro, Antonino, "Lineamenti di giustizia costituzionale", Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2009, fq.272.

<sup>270</sup> D'Orlando, Elena, "La giustizia costituzionale in Austria", botuar në "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova 2009, fq.130.

<sup>271</sup> Ruiz-Rico Ruiz, Gerardo, "Il tribunale costituzionale spagnolo", botuar në "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova 2009, fq.258.



Në gjykimin e mosmarrëveshjeve të kompetencave midis pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore është pranuar që kjo mosmarrëveshje mund të lindë edhe në rast se me akt apo veprime cënohet një kompetencë e cila u është dhënë një organi tjetër nga akte normative të Bashkimit Evropian. Për këtë arsye nëse pretendohet cënimi i një kompetence që është dhënë dhe garantohet nga një akt normativ komunitar, që ka rregulluar fushën në mënyrë të ndryshme nga norma kushtetuese e brendshme, procesi për mosmarrëveshje kompetencash mund të konsiderohet i pranueshëm nëse janë të pranishme edhe kërkesat e tjera të rendit kombëtar.<sup>272</sup> Kuptohet që kjo situatë mund të shfaqet vetëm në të ardhmen, me aderimin tonë në BE.

## **2.10 Aktet për krijimin dhe veprimtaria e partive politike dhe organizatave me karakter politik.**

Jeta politike e një vendi modern dhe bashkëkohor organizohet gjithmonë rreth grupeve të caktuara politike të cilat në varësi të qëllimit që kanë në lidhje me pushtetin mund t'i ndajmë në parti politike, të cilat kanë si qëllim marrjen e pushtetit, si edhe në organizata politike të cilat kanë si qëllim ndikimin në vendimmarrje por jo marrjen e pushtetit.

Ekzistenca e tyre në një shoqëri demokratike është thelbësore pasi ajo ndihmon në ekzistencën e pluralizmit. Pluralizmi nënkupton që grupet e organizuara dhe institucionet të mos varen nga qeveria për ekzistencën, përligjjen dhe autoritetin e tyre. Partitë politike si element i qartë i pluralizmit mbledhin anëtarët e tyre, organizojnë fushata për zgjedhjen e zyrtarëve shtetërorë, hartojnë programe politike për qeverinë nëse përbëjnë shumicën, bëjnë kritika dhe paraqesin alternativa politike në qoftë se janë në politikë, sigurojnë mbështetje për politikë të përbashkët midis grupeve të interesit, mësojnë njerëzit si t'i kuptojnë problemet politike, paraqesin struktura dhe rregulla për zhvillimin e debateve në gjirin e shoqërisë.<sup>273</sup> Pra, mund të themi se mes formacioneve sociale ku individit merr pjesë në shoqëri, partitë politike zënë një vend të veçantë.<sup>274</sup>

Por, përvoja botërore ka treguar se kur partitë politike kanë arritur të mbisundojnë shtetin, demokracia ka humbur dhe ka dalë në pah diktatura. Kjo dukuri ka qenë e pranishme si në diktaturat e majta, ashtu edhe në ato të djathta. Kur forca të caktuara politike, mbështetur në ideologjinë që mbrojnë e propagandojnë, nuk respektojnë parimet themelore të demokracisë dhe me programin e qëndrimit e tyre rrezikojnë vetë ekzistencën e saj, atëherë sigurisht që duhet të flitet për kapërcim të kufijve të tolerancës demokratike. Është krejt e natyrshme, madje e domosdoshme që atje ku cënohet seriozisht vetë ekzistenca e demokracisë, mbijetesa e saj të ketë përparësi mbi tolerancën. Në këtë drejtim del roli i shtetit, i cili nëpërmjet mekanizmave të tij reagon ndaj aktorëve të tillë të rrezikshëm për demokracinë. Gjykatat kushtetuese kanë rolin kryesor në kontrollin e kushtetutshmërisë së veprimtarive të partive politike e organizatave të tjera me karakter politik, të cilat ushtrojnë misionin e tyre në kundërshtim me konceptet dhe parimet kushtetuese. Përgjithësisht, ky është një ndër funksionet dhe parimet kushtetuese në shumicën e vendeve demokratike. Varianti i pranuar në Kushtetutën Gjermane, që konsiderohet si një ndër sistemet më të arrira të modelit kushtetues, është i huazuar nga shumica e vendeve

<sup>272</sup> Vendimi nr.399, i vitit 1987 i Gjykatës Kushtetuese Italiane, referuar nga Cavalieri, Paolo, "Diritto Regionale", Shtëpia Botuese "Cedam", Padova 2006, fq.263-264.

<sup>273</sup> Sadushi, Sokol, "Kontrolli Kushtetuese", Shtëpia Botuese "BOTIMPEX", Tiranë 2004, fq.122-123.

<sup>274</sup> Leskoviku, Migena; Leskoviku, Dorian, "Partitë politike në Shqipëri. Roli i tyre si organizime kushtetuese dhe formacione individuale të lira", botuar në Revistën "Jus & Justicia", Nr.6, botim i Fakultetit Juridike të Universitetit Evropian të Tiranës, Shtëpia Botuese "UET Press" Tiranë 2011.

postkomuniste.<sup>275</sup> Në thelb të këtij sistemi qëndron detyrimi i deklarimit antikushtetues të partive politike që synojnë të dëmtojnë apo eliminojnë rendin demokratik ose vetë ekzistencën e shtetit të tyre. Ndalimi i veprimtarisë apo deklarimi antikushtetues i tyre bëhet vetëm me vendim të posaçëm të Gjykatës Kushtetuese të shtetit përkatës.<sup>276</sup>

Eliminimi i partive/organizatave politike në rast se ato shfaqin rrezik për regjimin demokratik dhe rendin kushtetues njihet edhe nga jurisprudenca e GJEDNJ-së e cila ka mbajtur qëndrimin se nuk mundet që të përjashtohet mundësia që një parti politike, duke mbrojtur të drejtat e përcaktuara në nenet 11 dhe gjithashtu në nenet 9 dhe 10 të Konventës mund të përpiqet që kryejë aktivitete që kanë si qëllim të shkatërrojnë të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Konventë dhe në këtë mënyrë të sjellë shkatërrimin e demokracisë. Në Shqipëri një kompetencë e tillë i është dhënë Gjykatës Kushtetuese.<sup>277</sup>

Duke pasur në konsideratë sa më sipër, atëherë është e nevojshme që të ndalemi në trajtimin e objektit të këtij lloj kontrolli kushtetues. Siç e kemi cituar më sipër, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 9 të saj parashikon parimet mbi bazën e së cilës ngrihet pluralizmi politik në vend. Nga ana tjetër shkronja “d” e nenit 131 përcakton kompetencën lëndore të GJK-së për të kontrolluar kushtetueshmërinë e partive dhe të organizatave të tjera politike, si dhe të veprimtarisë së tyre. Kjo kompetencë lëndore rezulton të jetë detajuar më tej në nenet 57-60 të LGJK-së.

Nga tërësia e këtyre dispozitave rezulton se objekt i kontrollit përpara Gjykatës Kushtetuese janë dy organizma, së pari partitë politike dhe së dyti organizatat politike. Grupimi i parë, partitë politike, siç e kemi sqaruar edhe më sipër kanë si qëllim marrjen dhe ushtrimin e pushtetit. Ky lloj grupimi është lehtësisht i identifikueshëm pasi partitë politike formalisht krijohen nëpërmjet regjistrimit në regjistrin e partive politike që administrohet nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë. Përsa i përket grupit të dytë, kemi të bëjmë me organizata të cilat kanë si qëllim formalisht ndikimin në vendimmarrjen në pushtet. Këto lloj grupimesh të cilat konsiderohen si grupe interesi, formalisht mund të klasifikohen në organizata jofitimprurëse (shoqata, fondacione, qendra), sindikata dhe dhoma tregtie. Këto tre lloje të ndryshme organizatash krijohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.<sup>278</sup> Megjithatë në këto raste kemi të bëjmë me parti/organizata politike të cilat veprojnë në mënyrë të hapur. Historia na ka njohur edhe me shembuj sipas të cilave kemi pasur parti/organizata politike që kanë vepruar në mënyrë të fshehur, pra të paregjistruara dhe të padeklaruar përpara autoriteteve shtetërore.

Nga analiza e mësipërme rezulton se objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese mund të jetë një program apo veprimtari e një partie politike, si edhe e një organizate politike. Në rastin e këtyre të fundit është e nevojshme që nga subjekti kërkues të provohet që organizata e kundërshtuar prej tij, ushtron një aktivitetit të mirëfilltë politik, dhe se progami apo veprimtaria e saj klasifikohet si një nga shkaqet që parashikon Kushtetuta për deklarimin si antikushtetues.

<sup>275</sup> Sadushi, Sokol, “*Kontrolli Kushtetuese*”, Shtëpia Botuese “BOTIMPEX”, Tiranë 2004, fq.126-127.

<sup>276</sup> Zaganjori, Xhezair, “*Roli i partive politike në shtetin demokratik*”, botuar në Revistën “*Studime Juridike*”, Nr.1 botimi Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranë, Shtëpia Botuese “Luarasi”, Tiranë 2001, fq.86.

<sup>277</sup> Kushtetuta, neni 131, gërma “d”: *Gjykata Kushtetuese vendos për...d) kushtetutshmërinë e partive dhe të organizatave të tjera politike, si dhe të veprimtarisë së tyre, sipas nenit 9 të kësaj Kushtetute;*

<sup>278</sup> Ligji nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”. Ligji nr. 8789, datë 7.5.2001 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse. Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Ligji nr.9640, datë 9.11.2006 “Për dhomat e tregtisë dhe të industrisë”, i ndryshuar.

## 2.11 Vendimet e Kuvendit për statusin e Presidentit të Republikës, si objekt i gjykimit kushtetues.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka përcaktuar formën e republikës parlamentare të qeverisjes. Pavarësisht kësaj si kryetar shteti Kushtetuta ka përcaktuar Presidentin e Republikës, i cili megjithëse nuk ka kompetenca të gjera si në një republikë presidenciale apo gjysëmpresidenciale, përsëri nga ligji themelor i njihen një sërë kompetencash të konsiderueshme. Këto kompetenca i japin mundësi Presidentit që të ndërhyjë, brenda kufijve kushtetues, në të tre pushtetet tradicionale, atë legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Për këtë arsye pozicioni i tij është mjaft i rëndësishëm në strukturën shtetërore, për më tepër që ligji themelor i njeh edhe atributin e të qenit përfaqësues i unitetit të popullit.

Duke pasur në konsideratë këtë rol, Kushtetuta ka përcaktuar një sërë rregullash dhe procedurash që lidhen me zgjedhjen e tij, mënyrën e ushtrimit të detyrës, përgjegjësinë e tij dhe shkarkimin e tij. Parashikimi i kushteve materiale dhe procedurale për zgjedhjen nuk do të kishte kuptim nëse nuk do të shoqërohej edhe me mekanizmat juridiksionalë të cilat duhet të shërbejnë për garantimin e tyre. Duke qenë se në këtë rast kemi të bëjmë me kreun e shtetit dhe pozitën e tij kushtetuese, natyrshëm që një kompetencë e tillë i është njohur Gjykatës Kushtetuese.

Dispozitat kushtetuese dhe ato të LGJK në këtë rast janë shumë të përgjithshme dhe synojnë të bashkojnë procedurat e ndryshme në dispozita të njëjta. Kështu në Kushtetutë flitet për procedurat në lidhje me Presidentin në nenet 90, 91, 131, shkronjat “dh” dhe “e”. Ndërsa në LGJK kemi nenet 61 – 63 që trajtojnë procedurën për shkarkimin apo pamundësinë e ushtrimit të detyrës nga Presidenti dhe nenet 64 – 65 që trajtojnë procedurat për çështjet e zgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë së ushtrimit të funksionit të Presidentit. Pra, në përgjithësi LGJK synon që të bashkojë me njëra – tjetrën procedurat duke aplikuar norma të njëjta për gjykime që në fakt janë të ndryshme përsa i përket objektit dhe shkakut të tij.

Duke analizuar në tërësi bazën kushtetuese dhe ligjore përkatëse rezulton se objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese në këto raste janë:

- a) Vendimi i Kuvendit për zgjedhjen e Presidentit të Republikës.
- b) Vendimi i Kuvendit për konstatimin e papajtueshmërisë së ushtrimit të detyrës nga Presidenti i Republikës.
- c) Vendimi i Kuvendit për shkarkimin e Presidentit të Republikës.
- ç) Vendimi i Kuvendit për vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të detyrës nga ana e Presidentit të Republikës.

Në rastin e parë dhe të dytë Gjykata Kushtetuese vihet në levizje me kërkesë të subjekteve përkatëse. Ndërsa në dy rastet e tjera Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje *ipso lege* nga ana e Kuvendit dhe në mënyrë të detyrueshme. Pra, ndërsa në rastin e parë gjykimi kushtetues është fakultativ, në rastet e tjera është vazhdim i detyrueshëm i procedurave parlamentare.

Nga tërësia e këtyre gjykimeve, për shkak edhe të natyrës delikate dhe të parashikimeve të ndryshme kushtetuese e shoh me vend që të ndalem në trajtimin e veçantë të analizës së juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar vendimin e Kuvendit për shkarkimin e Presidentit të Republikës nga detyra.

Në lidhje me përgjegjësinë e Presidentit të Republikës, Kushtetuta na jep dy parashikime. Kështu nga njëra anë Kushtetuta mban qëndrimin se Presidenti nuk ka përgjegjësi për aktet e kryera në ushtrim të detyrës së tij, nga ana tjetër na rezulton se kjo mospërgjegjësi nuk vlen nëse



kemi të bëjmë me shkelje të rëndë të Kushtetutës apo kryerjen e një krimi të rëndë.<sup>279</sup>

Në vende të ndryshme ka modele të ndryshme në lidhje me ngritjen e akuzës dhe gjykimin e Presidentit. Kështu në Rumani, Gjykata Kushtetuese jep mendim vetëm për pezullimin e Presidentit nga detyra mbasi parlamenti ka ngritur akuzën por është Gjykata e Lartë ajo që e gjykon atë. Në Ukrainë, Gjykata Kushtetuese jep mendimin në lidhje me mënyrën se si janë ndjekur procedurat nga Parlamenti kundër Presidentit, por jo ta gjykojë atë e cila i përket si kompetencë Parlamentit. Në Moldavi, Gjykata Kushtetuese shprehet vetëm në lidhje me ekzistencën e kushteve të pezullimit nga detyra të Presidentit por ngritja e gjykimin dhe akuza e tij janë kompetencë e parlamentit. Në Kazakistan ka një procedurë disi më interesante. Kështu Parlamenti merr vendimin përfundimtar vetëm mbasi ka marrë mendimin e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me procedurat hetuese që ka ndjekur ajo, si edhe mendimin e Gjykatës së Lartë në lidhje me veprimtarinë e paligjshme të Presidentit. Në Armeni, Gjykata Kushtetuese përcakton nëse ekzistojnë shkaqet për shkarkimin e Presidentit por vendimi përfundimtar merret nga parlamenti. Në Azerbajxhan akuza paraqitet nga Gjykata Kushtetuese dhe është Parlamenti që e gjykon më tej Presidentin. Në Gjeorgji, është e kundërta, ku parlamenti ngre akuzën dhe gjykimi bëhet nga Gjykata Kushtetuese.<sup>280</sup>

Pavarësisht këtyre parashikimeve kushtetuese, që në forma të ndryshme gjenden edhe në shumë kushtetuta të tjera, ka autorë që mendojnë se një gjykim i tillë është i tepërt në republikat parlamentare. Kështu një gjykim i tillë është mëse i justifikuar në republikat presidenciale dhe gjysëm presidenciale, ku presidenti ka përgjegjësi ekzekutive dhe drejtuese. Për rrjedhojë sipas këtyre autorëve aty ku ka pushtet ka edhe përgjegjësi. Por në republikat parlamentare ku kompetencat e kreut të shtetit janë më shumë garantuese dhe kontrolluese ndaj organeve të tjera ky lloj gjykimi i veçantë nuk ka asnjë vlerë.<sup>281</sup> Konkretisht, sipas këtyre autorëve natyra në thelb garantuese dhe jo e drejtimit politik të Kreut të Shtetit në sistemin tonë dhe mundësia pothuaj e pamundur që ai të konsumojë shkeljet kushtetuese, e bëjnë këtë institut gjykimi një lloj "fosili" të drejtësisë kushtetuese.<sup>282</sup> Ekzistenca e këtij lloj gjykimi justifikohet me domosdoshmërinë për të garantuar mbajtjen e Kushtetutës në strukturën dhe në parimet e saj edhe për subjektet që janë të ngarkuara për këtë lloj ruajtje, siç është edhe Presidenti i Republikës. Një mekanizëm i aftë i regjimeve parlamentare për të proceduar kundrejt organeve garantuese të parashikuara prej saj për vepra veçanërisht të rënda që kryhen prej tyre dhe të tilla që godasin të gjithë skemën politike juridike të parashikuar nga Kushtetuta.<sup>283</sup> Ky lloj sistemi i drejtësisë kushtetuese i njohur ndryshe edhe si drejtësia politike ka njohur historikisht dhe njeh edhe sot forma të shumta të realizimit që dallohen nga drejtësia e zakonshme përsa i përket subjektit dhe fakteve të paligjshme, natyrës së organit gjykues dhe procedurave të gjykimin.<sup>284</sup>

Duke u rikthyer në parashikimet e Kushtetutës sonë rezulton se, Presidenti i Republikës përgjigjet për shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe për kryerjen e një krimi të rëndë. Fillimisht,

<sup>279</sup> Kushtetuta, neni 90: 1. Presidenti i Republikës nuk ka përgjegjësi për aktet e kryera në ushtrim të detyrës së tij. 2. Presidenti i Republikës mund të shkarkohet për shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe për kryerjen e një krimi të rëndë.

<sup>280</sup> Pistan, Carna, "I sistemi di giustizia costituzionale nei paesi dell'Europa centro-orientale e dell'area post-sovietica", botuar në "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale - Tomo II", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova 2011, fq.260-261.

<sup>281</sup> Ruggeri, Antonio; Spadaro, Antonino, "Lineamenti di giustizia costituzionale", Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2009, fq.295.

<sup>282</sup> Po aty, fq.297.

<sup>283</sup> Teresi, Francesco, "I giudizi della Corte Costituzionale", Shtëpia Botuese "Cacucci Editore", Bari 2010, fq.217.

<sup>284</sup> Zagrebesky, Gustavo; Marceno, Valerio; "La giustizia costituzionale", Shtëpia Botuese "Il Mulino", Bologna 2012, fq.508.



sipas rregullimit tonë kushtetues, shkeljet e pretenduara shqyrtohen nga Kuvendi dhe është më pas Gjykata Kushtetuese, e cila shqyrton nga pikëpamja e kushtetutshmërisë, ligjshmërisë dhe fakteve nëse Presidenti i Republikës ka kryer shkelje të rëndë të Kushtetutës apo një krim të rëndë. Që në fillim duhet sqaruar që janë jashtë juridiksionit kushtetues aktet apo veprimet e Presidentit të Republikës që nuk kanë të bëjnë me detyrat e tij Kushtetuese. Ato i përkasin personit fizik të titullarit të detyrës, që ruan të drejtat e tij subjektive dhe sferën e tij të raporteve juridike pa u konfunduar me organin, detyrat që ai përkohesisht ushtron.<sup>285</sup>

Pavarësisht se në pamje të parë çështja nuk përbën asnjë problem përse i përket gjykimit për shkelje të rëndë të Kushtetutës, gjykimi për kryerjen e një krimi të rëndë është tepër problematik. Kjo pasi sipas nenit 141 të Kushtetutës është edhe Gjykata e Lartë që në kuadër të juridiksionit të saj fillestar gjykon akuzat penale kundër Presidentit të Republikës.

Kjo përplasje juridiksionesh do të ishte shmangur nëse Komisioni Parlamentar për hartimin e projektkushtetutës do të kishte ruajtur variantin fillestar të propozuar, sipas të cilit Presidenti ishte përgjegjës për shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe të ligjeve,<sup>286</sup> përgjegjësi kjo e cila parashikohet edhe nga Ligji Themelor Gjerman<sup>287</sup> apo Kushtetuta e Sllovenisë.<sup>288</sup> Nëse do të ruhej ky formulim atëherë edhe natyra e këtyre dy gjykimeve do të ishte e ndryshme dhe për rrjedhojë nuk do të kishte përplasje të juridiksioneve.

Por Kushtetuta është shkruar në këtë mënyrë dhe në këtë aspekt duhet gjetur një zgjidhje midis këtyre dy parashikimeve kushtetuese. Sipas mendimit të shfaqur në doktrinën tonë rezulton se vërtetimi i fajësisë nuk duhet konfunduar me fajësinë në aspektin penal, për arsye se një e drejtë e tillë sipas nenit 141 të Kushtetutës i është lënë Gjykatës së Lartë, e cila ka juridiksion fillestar në raste të kësaj natyre. Fajësia që duhet të vërtëtojë Gjykata Kushtetuese është e natyrës kushtetuese, në kuptimin që shkaqet që ka përdorur Kuvendi për shkarkimin e Presidentit të Republikës nga detyra të jenë në përputhje me Kushtetutën pasi ajo nuk jep vendim të aspektit penal.<sup>289</sup> Ky qëndrim i autorit, nuk bën megjithatë dallimin në planin praktik dhe konkretisht cili gjykim do të ndiqet i pari, ai kushtetues dhe më pas gjykimi penal në Gjykatën e Lartë apo fillimisht kjo e fundit dhe me pas procedurat parlamentare dhe ato kushtetuese. Një përgjigje në lidhje me këtë situatë e gjejmë të referuar diku tjetër. Kështu, në doktrinë është shfaqur mendimi se pas shkarkimit të Presidentit të Republikës, kur atij i është hequr imuniteti që i sigurohej nga pozita e tij kushtetuese në rast se akuzat ndaj tij kanë karakter penal, mund të kryhen hetime të plota kundër tij. Në këtë rast, nga pikëpamja juridike, janë të vlefshme vetëm hetimet e kryera nga organi i prokurorisë dhe nëse akuza vërtetohet nga Gjykata e Lartë, që është gjykata kompetente për gjykimin ndaj ish-Presidentit, ky i fundit merr dënimin në bazë të dispozitave të Kodit Penal. Pra, duhet pasur parasysh se të gjitha institucionet e përfshira në shqyrtimin e akuzave ndaj Presidentit (siç janë Kuvendi ose Gjykata Kushtetuese) mund të bëjnë hetime përpara se të marrin vendimin përkatës, por këto hetime nuk kanë kurrësi vlerën e hetimeve të kryera nga Prokuroria, që është organi i vetëm i caktuar nga Kushtetuta për ndjekjen penale.<sup>290</sup>

Pra, të dyja këto mendime të shprehura në doktrinë qartazi tregojnë se ka një dallim midis

<sup>285</sup> Teresi, Francesco, *"I giudizi della Corte Costituzionale"*, Shtëpia Botuese "Cacucci Editore", Bari 2010, fq.219.

<sup>286</sup> *"Debati kushtetues"*, Vëllimi I, botim i pranisë së OSBE në Shqipëri, Shtëpia Botuese "P.S.H. 2015", Tiranë 2006, fq.343.

<sup>287</sup> Palermo, Francesco *"La giustizia costituzionale in Germania"*, botuar në *"Sistemi e modelli di giustizia costituzionale"*, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova 2009, fq.167.

<sup>288</sup> Pistan, Carna, *"Le esperienze di Croazia, Slovenia, Polonia e Ungheria"*, botuar në *"Sistemi e modelli di giustizia costituzionale"*, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova 2009, fq.439.

<sup>289</sup> Sadushi, Sokol, *"Kontrolli kushtetues"*, Shtëpia Botuese "Botimpex", Tiranë 2004, fq. 132.

<sup>290</sup> Omari, Luan; Anastasi, Aurela; *"E drejta kushtetuese"*, Shtëpia Botuese "ABC", Tiranë 2010, fq.323.

parashikimeve kushtetuese dhe atyre të Kodit Penal, pra në këtë aspekt kryerja e një krimi të rëndë në kuptim të nenit 90 të Kushtetutës nuk është e njëjta gjë me veprat penale të parashikuara në Kodin Penal. Për rrjedhojë hetimi parlamentar dhe gjykimi kushtetues nuk kanë të bëjnë me hetimin penal dhe gjykimin që mund të bëjë Gjykata e Lartë. Parashikimi kushtetues në këtë rast ka një kuptim autonom nga normat penale. Në fakt edhe në doktrinën e huaj ka një debat në lidhje me këtë aspekt ku disa autorë veprat penale në kushtetutë i lidhin vetëm me normat penale të parashikuara në legjislacionin penal,<sup>291</sup> ndërsa disa autorë të tjerë i identifikojnë shkeljet e Presidentit vetëm me normat kushtetuese dhe për rrjedhojë nuk ka asnjë lidhje me normat penale.<sup>292</sup> Për këtë arsye ka autorë që mendojnë që në këtë rast duhet domosdoshmërisht të miratohet një ligj penal për zbatimin e normave kushtetuese,<sup>293</sup> siç ka dhe autorë që e kundërshtojnë këtë pikëpamje me arsyetimin se nuk i takon legjislatorit të rregullojë dispozitat kushtetuese që janë të vetëzbatueshme.<sup>294</sup> Por kjo doktrinë mbështet edhe në faktin që Gjykata Kushtetuese në këto raste ka të drejtë që të vendosë denime të ndryshme kushtetuese, penale, civile dhe administrative mbi Presidentin e Republikës<sup>295</sup> dhe jo vetëm deklarimin e shkarkimit të tij nga detyra siç përcakton Kushtetuta jonë. Për më tepër në çdo rast qëndrimi që mbahet është se përgjegjësia e Presidentit në këto raste është penale.<sup>296</sup>

Pavarësisht këtyre qëndrimeve në doktrinë personalisht jam i një qëndrimi tjetër. Kështu në vetë doktrinën që mban qëndrimin e mësipërm mbahet edhe qëndrimi tjetër, se krimet e tjera të rënda mund të konsiderohen ato për të cilat legjislacioni penal parashikon dënime vetëm me burgim.<sup>297</sup> Pra, ka një lidhje midis nocionit “krim i rëndë” i parashikuar nga Kushtetuta dhe normave penale parashikuar nga Kodi Penal. Në fakt jam i mendimit që nocionit krim i rëndë që parashikohet nga Kushtetuta nuk mundet që ti jepet asnjë kuptim tjetër veçse duke e lidhur me dispozitat përkatëse të K.P. Një fakt tjetër që përforcon këtë argument është se ndryshe nga sa pretendohet në doktrinën e sipërcituar rezulton se Kushtetuta përcakton se Gjykata e Lartë gjykon Presidentin e Republikës dhe jo ish-presidentin.<sup>298</sup> Në rast se do të ndodheshim përpara ish-presidentit atëherë gjykimi për kompetencë do të fillonte nga gjykata e shkallës së parë, siç ndodh normalisht me të gjithë gjykimet e tjera penale. Pra, që Presidenti të gjykohej nga Gjykata e Lartë duhet që ai të jetë në funksionin e Presidentit dhe jo të jetë hequr prej tij. Për më tepër sipas Kushtetutës, ndjekja penale dhe përfaqësimi i akuzës në emër të shtetit në gjyq është kompetencë kushtetuese dhe ekskluzive e prokurorisë dhe jo e Kuvendit. Po kështu edhe konkluzioni se Gjykata Kushtetuese vërteton fajësinë jo penale por atë kushtetuese të Presidentit duket se ka kuptim në rastin e verifikimit të shkeljes së rëndë të Kushtetutës, por të flasësh për dy fajësi të ndryshme (kushtetuese dhe penale) për krimin e rëndë, në këndvështrimin tim nuk ka asnjë kuptim nga pikëpamja juridike. Krimi është krim, pavarësisht nëse është shkruar në Kushtetutë apo në Kodin Penal. Një tjetër aspekt që shtrohet për diskutim është ç’farë do të

<sup>291</sup> Teresi, Francesco, “*I giudizi della Corte Costituzionale*”, Shtëpia Botuese “Cacucci Editore”, Bari 2010, fq.222-223.

<sup>292</sup> Po aty, fq.223.

<sup>293</sup> Po aty, fq.223.

<sup>294</sup> Zagrebelesky, Gustavo; Marceno, Valerio; “*La giustizia costituzionale*”, Shtëpia Botuese “Il Mulino”, Bologna 2012, fq.518.

<sup>295</sup> Teresi, Francesco, “*I giudizi della Corte Costituzionale*”, Shtëpia Botuese “Cacucci Editore”, Bari 2010, fq.228.

<sup>296</sup> Zagrebelesky, Gustavo; Marceno, Valerio; “*La giustizia costituzionale*”, Shtëpia Botuese “Il Mulino”, Bologna 2012, fq.519.

<sup>297</sup> Omari, Luan; Anastasi, Aurela; “*E drejta kushtetuese*”, Shtëpia Botuese “ABC”, Tiranë 2010, fq.321.

<sup>298</sup> Kushtetuta, neni 141, pika 1: *Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar dhe rishikues. Ajo ka juridiksion fillestar kur gjykon akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, deputetëve, gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.*

ndodhte, bazuar në sugjerimet e mësipërme të doktrinës nëse Presidenti do të shkarkohej nga Kuvendi dhe nga Gjykata Kushtetuese për kryerjen e një krimi të rëndë, ndërsa Gjykata e Lartë do ta shpallte të pafajshëm. Në këtë rast do të ishte shumë e sforcuar të pretendonim që kushtetutshmërisht Presidenti ka konsumuar një krim të rëndë dhe penalisht jo. Për më tepër siç pranohet edhe në doktrinë veprimet e Presidentit në planin kushtetues të cilat do të përbënin “krim të rëndë” i nënshtrohen kontrollit të Gjykatës Kushtetuese në kuadër të gjykimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave e ngritur nga organet që preken nga kjo kompetencë. Për këtë arsye nuk është e lehtë të imagjinohet një përgjegjësi jo penale të cilat nuk marrin një rëndësi të tyre në sistemin e drejtësisë kushtetuese.<sup>299</sup>

Aspekte të tjera që shtrohen për diskutim lidhen edhe me pamundësinë e Gjykatës Kushtetuese, për të gjykuar bashkëpunëtorët e Presidentit, bashkimin e çështjeve penale dhe akuzat e reja. Kështu siç me të drejtë theksohet në doktrinë, është e pamundur që Presidenti i Republikës, në kryerjen e një krimi të rëndë të veprojë krejt i vetëm.<sup>300</sup> Në këtë rast në Itali, autoritetet e tjera gjyqësore duhet që t’ia kalojnë aktet Gjykatës Kushtetuese. Ndërsa në rastin e akuzave të reja rinjoftohet parlamenti për rivlerësimin e kësaj akuze të re dhe nëse do të ndërmerri hapat procedurale për shkarkimin e Presidentit edhe për këto akuza. Për të mos zvarritur gjykimin, Gjykata Kushtetuese mundet që të vendosë edhe ndarjen e këtyre çështjeve.<sup>301</sup> Në Hungari, Gjykata Kushtetuese e këtij vendi zbaton për këtë lloj gjykimi dispozitat e K.Pr.P. dhe në rast fajësie dënimin e parashikuar nga K.P.<sup>302</sup> Në këndvështrim tim këto mundësi nuk gjejnë pasqyrim në legjislacionin shqiptar. Kështu LGJK ka parashikimet e veta në lidhje me gjykimin e Presidentit, për rrjedhojë në kuptim të nenit 1, pika 2 të po këtij ligji, nuk mundet që të kemi referime në ligjet e tjera. Por edhe dispozitat e K.Pr.P. për bashkimin e procedimeve për shkak të kompetencës lëndore, nuk mundet që të zbatohen në këtë rast. Ato ekskluzivisht i referohen Gjykatës së Lartë. Për më tepër Gjykata jonë Kushtetuese vendos vetëm për deklarimin e shkarkimit të Presidentit kurse për bashkëpunëtorët e tij nuk mund që të shprehet kurrsesi nëse janë fajtorë apo jo siç ndodh në disa sisteme të tjera. Po kështu në gjykimin kushtetues nuk mundet që të ngrihen akuza të reja në kuptim të dispozitave të K.Pr.P.

Për këto arsye jam i mendimit që procedurat parlamentare për shkarkimin e Presidentit të Republikës në rastin e kryerjes së një krimi të rëndë duhet të fillojnë vetëm mbasi prokuroria dhe Gjykata e Lartë kanë përfunduar respektivisht hetimin dhe gjykimin penal dhe në përfundim të tij është shpallur fajtor. Më pas është detyrë e hetimit parlamentar dhe i Gjykatës Kushtetuese për të përcaktuar nëse vepra penale për të cilin është dënuar Presidenti i Republikës përbën apo jo krim të rëndë. Pavarësisht se një hetim parlamentar dhe gjykimi kushtetues mbas vendimit të fajësisë të Gjykatës së Lartë do të duket si një procedurë formale, shembuj të përafërt gjejmë edhe në praktikën kushtetuese të huaj. Kështu sipas shembullit të vetëm që na vjen nga Italia, megjithëse shumica e doktrinës nuk është dakort me të, rezulton se komiteti parlamentar për procedimin e akuzës kundër Presidentit të Republikës, urdhëroi arkivimin e një kërkesë për shkak se ishte “haptazi e pabazuar”, bazuar në tezën sipas të cilës shkeljet e Presidentit sipas nenit 90 të Kushtetutës duhej që të lidheshin me rastet e veprave të parashikuara nga normat e së drejtës

<sup>299</sup> Zagrebesky, Gustavo; Marceno, Valerio; “*La giustizia costituzionale*”, Shtëpia Botuese “Il Mulino”, Bologna 2012, fq.520.

<sup>300</sup> Po aty, fq.317.

<sup>301</sup> Martinez, Temistocle, “*E drejta kushtetuese*”, botim në gjuhën shqipe, Shtëpia Botuese “UET Press”, Tiranë 2011, fq. 370.

<sup>302</sup> Pistan, Carna, “*Le esperienze di Croazia, Slovenia, Polonia e Ungheria*”, botuar në “*Sistemi e modelli di giustizia costituzionale*”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “Cedam”, Padova 2009, fq.437.



penale të zakonshme apo ushtarake.<sup>303</sup> Në një tjetër shembull i cili mund të merret me analogji, Gjykata Kushtetuese e Rusisë mund të gjykojë akuzat kundër Presidentit të Republikës vetëm nëse akuza është ngritur nga dhoma e ulët e Parlamentit, Duma, dhe Gjykata e Lartë ka dhënë mendimin e saj në lidhje me praninë në veprimet e Presidentit të elementëve që përbëjnë vepër penale.<sup>304</sup> Vetëm duke e interpretuar situatën në këtë mënyrë mund të kuptohet juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese në këtë rast dhe për rrjedhojë edhe objekti i gjykimit.

## **2.12 Vendimet e Kuvendit për shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese.**

Sipas neneve 128 dhe 140 të Kushtetutës, Kuvendi ka të drejtë që të vendosë shkarkimin e anëtarëve të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese me dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve të tij. Në këtë rast procedura është e njëjtë me atë që ndiqet në lidhje me shkarkimin e Presidentit të Republikës nga detyra të trajtuar më sipër në këtë punim. Objekti i gjykimit në këtë rast është vendimi i Kuvendit. Duhet theksuar se aktivizimi i procesit kushtetues në këtë rast bëhet nga Kuvendi *ipso lege* dhe është detyrues.

## **2.13 Kërkesat për ndalimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë.**

Kushtetuta, në nenet 126 dhe 137, pika 1 të saj përcakton se gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë gëzojnë imunitet, nga ndalimi, arrestimi, kontrolli vetjak dhe i banesës. Në të dyja rastet dispozitat kushtetuese përcaktojnë se dhënia e autorizimit bëhet nga Gjykata Kushtetuese.

Duke analizuar me kujdes këto dy dispozita arrijmë në konkluzionin se në këto lloj gjykimesh bëhet fjalë për dy kërkesa të veçanta. Rasti i parë ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës që vjen nga organi i akuzës për dhënie leje për arrestimin, ndalimin apo kontrollin vetjak dhe të banesës së anëtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë. Paraqitja e kësaj kërkesë dhe dhënia e përgjigjes nga Gjykata Kushtetuese, nuk lidhet me asnjë afat.

Rasti i dytë ka të bëjë me situatën kur gjyqtari arrestohet në kushtet e flagrancës. Në këtë rast organi i akuzës paraqet menjëherë kërkesën në Gjykatën Kushtetuese e cila duhet që të japë pëlqimin e saj brenda 24 orëve.

## **2.14 Vendimet që kanë të bëjnë me mandatin e deputetëve.**

Kushtetuta në nenin 2 të saj ka rregulluar çështjen e sovranitetit ku përcakton se ky sovranitet i përket popullit i cili kryesisht e ushtron atë nëpërmjet përfaqësuesve të tij dhe përjashtimisht drejtpërsëdrejti. Çdo qytetar konsiderohet si mbajtës i një copëze të barabartë të sovranitetit, i cili, i marrë në shumën totale të tij, bën të mundur marrjen e vendimeve nga mbajtësi i sovranitetit që është populli, nëpërmjet përfaqësimit të tij nga deputeti.<sup>305</sup> Për këtë

<sup>303</sup> Ruggeri, Antonio; Spadaro, Antonino, "Lineamenti di giustizia costituzionale", Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2009, fq.300.

<sup>304</sup> Di Gregorio, Angela, "La Corte Costituzionale della Russia", botuar në "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova 2009, fq.467.

<sup>305</sup> Vendimi nr.44, datë 7.10.2011 i Gjykatës Kushtetuese, parag.17. Vetë Gjykata në këtë rast referohet tek *Jean Jacques Rousseau*, The Social Contract, Libri II, Nëntitulli: Sovereignty is indivisible (1762, i ribotuar).



arsye Kushtetuta në një sërë dispozitash të saj ka përcaktuar kushtet pozitive për të qenë deputet dhe kushtet negative, pra cilësitë që nuk duhet të ketë personi në mënyrë që të zgjidhet deputet. Për më tepër në Kushtetutë ka edhe kushte të tjera që lidhen me funksionin dhe mënyrën e ushtrimit të mandatit nga deputetët. Tërësia e këtyre kushteve shërben për ushtrimin sa më të rregullt të së drejtës së përfaqësimit të sovranitetit popullor. Me qëllim ruajtjen e këtyre kushteve, Kushtetuta ka parashikuar si garanci juridiksionale Gjykatën Kushtetuese për kontrollin e tyre. Për këtë arsye në Kushtetutë rezulton se Gjykata ka kompetencë për të verifikuar zgjedhshmërinë e deputetëve, papajtueshmërinë e funksioneve të tyre si edhe verifikimin e zgjedhjes së tyre.<sup>306</sup> Është e kuptueshme që secila prej këtyre kompetencave në vetvete realizohet nëpërmjet një gjykimi të posaçëm që kryen Gjykata Kushtetuese, respektivisht për çdo rast. Nga formulimi i dispozitës kushtetuese kuptojmë se në këtë rast bëhet fjalë për tre lloje të ndryshme gjykimesh dhe konkretisht:

- a) zgjedhshmëria e deputetëve
- b) papajtueshmëria në ushtrimin e funksioneve të deputetëve
- c) verifikimi i zgjedhjes së deputetëve

Ky parashikim kushtetues gjen rregullim të mëtjshëm edhe në nenet 66 dhe 67 të LGJK. Nga formulimi i këtyre dispozitave në ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese, nuk rezulton qartë dallimi midis gjykimit që ka të bëjë me zgjedhshmërinë e deputetëve dhe gjykimit që ka të bëjë me verifikimin e zgjedhjes së deputetëve. Po nga mënyra se si janë formuluar pikat 1 dhe 2 të nenit 66 të LGJK, parashikimi i subjekteve të ndryshme që mund të vënë në lëvizje Gjykatën në këto raste si edhe mënyrës së formulimit të dispozitës kushtetuese i qëndrojmë idesë se këto janë dy procese të ndara.

Në rastin e gjykimit të parë, zgjedhshmërinë e deputetëve, rezulton se objekt gjykimi në këtë rast është vendimi i KQZ, i cili ka shpallur fitues si deputet një person të caktuar, që sipas kërkesit është zgjedhur në kundërshtim me parashikimet kushtetuese. Në rastin e gjykimit të dytë, objekt gjykimi është vendimi i Kuvendit, i iniciuar mbi bazën e kërkesës së Kryetarit të Kuvendit apo të një grupi prej të paktën 10 deputetësh, për të shqyrtuar nëse deputeti ka ushtruar ose jo funksione të tjera shtetërore, ose ka përfituar nga fondet e buxhetit të shtetit apo të njërive të qeverisjes vendore.

Në lidhje me gjykimin e tretë, verifikimin e zgjedhjes së deputetëve rezulton se kjo kompetencë e Gjykatës, është më kontradiktorja e saj dhe legjislacioni përkatës ka ecur në drejtime diametralisht të kundërta.

Kështu Kodi Zgjedhor i vitit 2000<sup>307</sup> parashikonte se ankimi kundër vendimeve të KQZ për secilën zonë zgjedhore, mund të bëhej nga çdo subjekt zgjedhor drejtpërsëdrejti në Gjykatën Kushtetuese. Kjo solli si pasojë që Gjykata Kushtetuese të mbingarkohej me çështje të tilla dhe doktrina vuri në diskutim rolin dhe funksionin e kësaj Gjykate, e cila shpesh herë, vendoste edhe për çështje ligjshmërie, fakti dhe provueshmërie, në lidhje me procesin zgjedhor, e cila sipas disa autorëve, nuk përputhej me konceptin e juridiksionit kushtetues që duhet të kishte kjo gjykatë. Kështu sipas disa autorëve dhënia e një kompetencë të tillë Gjykatës Kushtetuese e shmangte atë nga funksioni i saj i kontrollit të kushtetutshmërisë së normës që asaj i buron nga Kushtetuta.<sup>308</sup>

<sup>306</sup> Kushtetuta, neni 131, shkronja "e": *Gjykata Kushtetuese vendos për:... e) çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës dhe të deputetëve, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre.*

<sup>307</sup> Ligji nr.8609, datë 8.5.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".

<sup>308</sup> Ruço, Noela; Pajo (Bala), Valbona; *Standardet zgjedhore në fokusin e jurisprudencës kushtetuese shqiptare*, botuar në "Aspekte të ndryshme të sistemeve zgjedhore dhe roli i tyre në zhvillimin e demokracisë", Tiranë 2015, fq.32.

Kodi Zgjedhor i viti 2003,<sup>309</sup> kaloi në ekstremin tjetër. Kështu, tani ankimet kundër vendimeve të KQZ bëheshin pranë një gjykate *ad hoc*, Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë. Kodi përcaktonte gjithashtu se kundër vendimeve të kësaj gjykate nuk lejohej rekurs në Gjykatën e Lartë, por nuk bënte asnjë parashikim për ankimin në Gjykatën Kushtetuese. Edhe Kodi Zgjedhor i vitit 2008 aktualisht në fuqi, në vija të përgjithshme ka të njëjtin rregullim. Për sa trajtuam më sipër, Gjykata Kushtetuese që pas rregullimeve zgjedhore të vitit 2003, nuk është përfshirë më në proceset ankimore në një proces zgjedhor dhe dispozita kushtetuese, praktikisht ka ngelur e pazbatuar në praktikë.

Në një vështrim historik rezulton se paketa kushtetuese e viteve 1991 – 1998, parashikonte një kompetencë të përafërt për Gjykatën Kushtetuese në atë kohë. Neni 24, pika 7 e Ligjit nr. 7561, datë 29.4.1992, parashikonte se Gjykata Kushtetuese zgjidhte dhe *çështjet për ligjshmërinë e zgjedhjes së Presidentit të Republikës, të deputetëve, si edhe të referendumit popullor, duke shpallur rezultatet përfundimtare*. Formulimi i kësaj dispozite pavarësisht se është shumë i ngjashëm me formulimin aktual të nenit 131 gërma “e” të Kushtetutës, në thelb nuk është i njëjtë. Kjo dispozitë i jepte shprehimisht të drejtë Gjykatës Kushtetuese që të shqyrtonte *ligjshmërinë e zgjedhjes ... së deputetëve ... duke shpallur rezultatet përfundimtare*.

Nga ky formulim rezulton qartësisht se Gjykata Kushtetuese në atë kohë kishte të drejtë të kontrollonte ligjshmërinë e rezultateve për çdo zonë zgjedhore dhe për rrjedhojë juridiksioni që ajo ka ushtruar në atë kohë duke pranuar për shqyrtim ankesat nga të gjitha subjektet zgjedhore ishte mëse i justifikuar. Formulimi aktual kushtetues, nuk përmend mundësinë për shqyrtimin e ligjshmërisë së zgjedhjeve për deputet dhe as shpalljen e rezultateve përfundimtare. Ajo bën fjalë vetëm për verifikimin e zgjedhjes së deputetëve. Ky parashikim kushtetues ka ngjallur një debat të fortë doktrinor, por jo jurisprudencial. Çuditërisht me gjitha traditën shqiptare të kontestimit të zgjedhjeve, pas vitit 2003 asnjë prej subjekteve zgjedhore nuk e ka çuar çështjen deri në Gjykatën Kushtetuese, por janë kufizuar me vendimin e Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë. Përjashtim, bën vetëm një rast i vitit 2010, por që përfundoi që në fazat e para pasi Kolegji i Gjykatës Kushtetuese nuk e legjitimoi partinë politike, në kërkimet e saj.

Personalisht jam i mendimit që qëndrimet e shprehura shpesh herë nga doktrina për mungesën e kontrollit të Gjykatës Kushtetuese mbi zgjedhjet është i pabazuar. Ata autorë që pretendojnë se ky lloj kontrolli e devijon Gjykatën Kushtetuese nga natyra e saj dhe se kjo Gjykatë kontrollon vetëm kushtetushmërinë e normës, nuk marrin në konsideratë apo harrojnë gjykime të tjera të cilat janë në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese. Kështu juridiksioni kushtetues njeh kompetencën e kësaj gjykate për procedurat kundrejt individëve të veshura me funksione të larta (Presidenti, gjyqtarët kushtetues, gjykatësit e lartë), procedurat për shpërndarjen dhe shkarkimin e organeve të qeverisjes vendore. Edhe në këto raste Gjykata Kushtetuese ushtron kontrole konkrete, interpreton dhe zbaton ligjin si edhe administron prova. Pra, po sipas Kushtetutës ka edhe gjykime të tjera kushtetuese të cilat nuk kanë të bëjnë detyrimisht me kontrollin kushtetues të normës. Për këtë arsye jam i mendimit se një kompetencë e tillë mund dhe duhet të ushtrohet nga Gjykata Kushtetuese, si një kompetencë e parashikuar shprehimisht prej aktit themelor të vendit. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese nuk mund të

<sup>309</sup> Ligji nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

menjanohet ose të tejkalohet, duke i dhënë përparësi akteve juridike që duhet të dalin në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës.<sup>310</sup>

Në këndvështrimin tim, një proces i tillë para Gjykatës Kushtetuese, nuk mund të bëhet për vendimmarrjen për çdo rajon zgjedhor. Në këtë rast në Gjykatën Kushtetuese mund të ankimohet vetëm vendimi përfundimtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kjo për faktin se Gjykata Kushtetuese, do të shqyrtojë kushtetutshmërinë e vendimmarrjes së KQZ në tërësi, por jo ligjshmërinë e tij. Edhe jurisprudenca kushtetuese duket sikur e pranon këtë teori. Kështu në Vendimin e Kolegjit nr. 100, datë 20.10.2010 Gjykata Kushtetuese është shprehur ndër të tjera se:

*Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet në kërkimet e tij për shpalljen e pavlefshme të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, pasi nuk arrin të argumentojë interesin e tij të drejtpërdrejt, vetjak dhe real.*

Nga ky pasazh kuptojmë se Gjykata Kushtetuese e ka konsideruar veten si kompetente për të shqyrtuar vetëm pavlefshmërinë e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Ky vendim pavarësisht se nuk është dhënë nga gjykata në seancë plenare, duke qenë i vetmi që trajton një situatë të tillë, mendojmë se duhet të merret në konsideratë.

Subjekti që bën kërkesën duhet të argumentojë që rezultati përfundimtar i zgjedhjeve ka dalë në shkelje të parimeve kushtetuese për zgjedhje të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike.<sup>311</sup> Po kështu pretendim mund të ngrihet edhe në rastin e shkeljes së parimit të votës vetjake, dhe të fshehtë.<sup>312</sup> Këto lloj pretendimesh të shoqëruara me argumentat përkatëse, do të përfshinin çështjen e ngritur brenda juridiksionit kushtetues.

## **2.15 Çështjet e shtruara për referendum.**

Ligjvënësi kushtetues shqiptar, në hartimin dhe miratimin e kushtetutës është kujdesur për të rregulluar edhe çështje të tilla si sovraniteti dhe mënyra e ushtrimit të tij. Kështu në pikat 1 dhe 2 të nenit 2 të Kushtetutës parashikohet se sovraniteti i përket popullit dhe mënyra e ushtrimit të tij, si rregull nëpërmjet përfaqësuesve dhe përjashtimisht drejtëpërsëdrejti. Pra, Kushtetuta, sovranitetin popullor nuk e njeh si një sovranitet të pakufizuar, sepse në një shtet kushtetues, ideja e një pushteti, i cili nuk përballlet me detyrime dhe kufizime që burojnë nga kushtetuta, nuk mund të pranohet.<sup>313</sup>

Forma e ushtrimit të drejtpërdrejtë të sovranitetit popullor është edhe referendumi, formë kjo e cila kushtëzohet, siç u theksua dhe më sipër me respektimin e disa rregullave të veçanta. Pra, krahas të drejtës për të ushtruar referendum, Kushtetuta ka parashikuar njëkohësisht disa kufizime që në varësi të çështjeve konkrete nuk lejojnë zhvillimin e referendumit.<sup>314</sup> Respektimi i procedurave dhe kufizimeve kushtetuese që janë vendosur kundrejt referendumit, Kushtetuta ja ka lënë si kompetencë Gjykatës Kushtetuese. Ky lloj pushteti është mëse i justifikuar pasi në këtë rast kemi të bëjmë me një nga format e ushtrimit të sovranitetit popullor dhe për rrjedhojë dhënia

<sup>310</sup> Dobjani, Erajd; Toska, Elsa; "Neni 131/e i Kushtetutës dhe kodet zgjedhore". A është kolegji zgjedhor instancë e fundit ankimi për verifikimin e zgjedhshmërisë së kandidatëve për deputetë?, botuar në "Aspekte të ndryshme të sistemeve zgjedhore dhe roli i tyre në zhvillimin e demokracisë", Tiranë 2015, fq.142.

<sup>311</sup> Kushtetuta, neni 1, pika 3.

<sup>312</sup> Kushtetuta, neni 45, pika 4.

<sup>313</sup> Vendimi nr. 25, datë 24.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>314</sup> Sadushi, Sokol, "Drejtesia kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq.183



e këtyre kompetencave një organi tjetër, mbi të gjitha me natyrë politike, mund të përbënte një ndërhyrje të pajustificuar në ushtrimin e demokracisë së drejtpërdrejtë. Përkundrazi, Gjykata Kushtetuese e veshur me garancitë përkatëse dhe mbi të gjitha mbrojtja dhe garantja e ligjit themelor të vendit është insitucioni më i përshtatshëm për realizimin e këtij kontrolli dhe si i vetmi me autoritetin e duhur për të vendosur një kufizim ndaj një kërkesë për referendum që mban nënshkrimet e një numri të konsiderueshëm zgjedhësish.<sup>315</sup>

Kushtetuta në lidhje me kontrollin kushtetues mbi referendimet ka vetëm dy parashikime të cilat në thelb na tregojnë edhe kufijtë e këtij kontrolli, duke përcaktuar lëndën të cilën do ta shqyrtojë Gjykata Kushtetuese.<sup>316</sup> Nga formulimi i këtyre dispozitave qartazi duket se kemi të bëjmë me dy lloje gjykimesh të veçanta të cilat ushtrohen nga Gjykata Kushtetuese.

Gjykimi i parë i parashikuar nga neni 131 shkronja "ë" e Kushtetutës është një kontroll *aposteriori*, i cili bëhet vetëm mbasi të jetë mbajtur një referendum dhe subjekte të ndryshme të përfshirë në të, kanë ankesa në lidhje me procesin e votimit dhe rezultatin e dalë nga ky proces. Në këtë rast objekt gjykimi përpara Gjykatës Kushtetuese është vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shpalljen e rezultatit përfundimtar të referendumit. Ky lloj gjykimi është fakultativ dhe mund të ushtrohet vetëm mbi bazën e kërkesave të subjekteve të ndryshme.

Ndërsa gjykimi tjetër i parashikuar nga neni 152 i Kushtetutës, është një kontroll *apriori*, i cili bëhet nga Gjykata Kushtetuese paraprakisht, pra përpara mbajtjes së referendumit dhe ka si synim që të verifikojë nëse çështja e shtruar për referendum është në përputhje me kërkesat kushtetuese apo jo. Në këtë rast objekt gjykimi, në varësi të llojit të referendumit që kërkohet të zhvillohet është vendimi i Kuvendit për kalimin e një çështje të rëndësishme se veçantë në referendum, miratimi i një projektligji me referendum, ose miratimi apo shqyrtimi i një amendamenti kushtetues në referendum. Nuk është objekt gjykimi vendimi i Kuvendit për miratimin me referendum të një marrëveshje ndërkombëtare për delegimin e kompetencave shtetërore një organizate ndërkombëtare, sipas nenit 123 të Kushtetutës, Pamundësia e Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar një vendim të tillë, lidhet me parashikimin e nenit 152, pika 1 e Kushtetutës e cila nuk ia njeh këtij institucioni këtë kompetencë.

Një tjetër akt objekt gjykimi është edhe vendimi i KQZ për miratimin e kërkesave për referendum me nismë popullore, të iniciuara nga një grup nismëtarësh, për një çështje të rëndësishme se veçantë apo për shfuqizimin e një ligji, në mënyrë të plotë ose të pjesshme.

## **2.16 Aktet gjyqësore, të arbitrazhit, administrative dhe veprimet apo mosveprimet e organeve të administratës publike.**

Kushtetuta e vitit 1998, u njeh të drejtën individëve që të ankoheshin në Gjykatën Kushtetuese vetëm për një proces të rregullt ligjor, duke sjellë, në këtë mënyrë një ndryshim nga paketa e mëparshme kushtetuese, e cila i lejonte individët që të ankoheshin për të gjitha të drejtat

<sup>315</sup> Nicotra, Ida, "Le zone d'ombra nel giudizio di ammissibilità del referendum abrogativo", botuar në "Le zone d'ombra della giustizia costituzionale – I giudizi sui conflitti di attribuzione e sull'ammissibilità del referendum abrogativo", Aktet e seminarit të Modena, mbajtur më 13 tetor 2006, botuar nga "Quaderni del "Gruppo di Pisa", nën kujdesin e Roberto Pindari, Shtëpia Botuese "G. Giappichelli", Torino 2007, fq. 231.

<sup>316</sup> Kushtetuta, neni 131, gërma "ë": *Gjykata Kushtetuese vendos për...ë) kushtetutshmerinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij;*

Kushtetuta, neni 152, pika 1 dhe 2: *1. Gjykata Kushtetuese shqyrton paraprakisht kushtetutshmerinë e çështjeve të shtruarra për referendum sipas nenit 150 paragrafët 1 e 2, neni 151 paragrafët 2 e 3 edhe sipas nenit 177 paragrafët 4 e 5 brenda 60 ditëve. 2. Rëndësia e çështjeve të veçanta, të parashikuara në nenin 150 paragrafët 1 e 2 nuk është objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese.*



e tyre kushtetuese. Ky ndryshim është konsideruar si një kthim prapa, në raport me ankimin e drejtpërdrejtë që parashikohej në ligjin “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, të vitit 1992. Nga tërësia e sferës së lirive dhe të drejtave themelore, mbrojtja gjyqësore e individit kufizohet vetëm në një prej tyre.<sup>317</sup> Kështu, nga jurisprudenca e kësaj Gjykate nuk janë pranuar për shqyrtim kërkesat në të cilin ngriheshin pretendime për cënim të së drejtës së pronës,<sup>318</sup> parimit të barazisë,<sup>319</sup> apo i së drejtës për punë.<sup>320</sup>

Përsa i përket fillesave të këtij instituti ka një debat në doktrinë. Kështu pretendohet se ky mjet ankimi i ka fillesat në *common law* në Angli.<sup>321</sup> Një tjetër pretendim i lidh fillesat e këtij mjeti procedural me ligjet e Aragonit të shekujve të XIII, XVI dhe më pas në Gjermani në shekullin e XV, ndërsa Zvicra e ka përfshirë si një ankim të veçantë në Kushtetutën e vitit 1874 dhe në Statutin e viteve 1874 dhe 1893.<sup>322</sup> Një tjetër autor pretendon se kjo e drejtë i ka rrënjët në vendet gjermanishtfolëse ku njihen tre modele ankimesh përpara modelit që njihet Kushtetuta aktuale e Gjermanisë dhe më konkretisht: e drejta e ankimit kundër të drejtave të njohura nga Kushtetuta e Perandorisë (1849), ankimi kushtetues bavarez (1818), si edhe ankimi kushtetues, sipas kushtetutës bavareze të mëvonshme.<sup>323</sup> Një tjetër referim në doktrinë të çon në Meksikë, fillimisht me Kushtetutën e shtetit të Yucatan në vitin 1841 dhe me Kushtetutën Federale të vitit 1857.<sup>324</sup> Dukshëm ky qëndrim i fundit nuk gjen bazë shkencore, pasi referimet më të hershme i përkasin kontinentit evropian. Sado e çuditshme që mund të duket, ky lloj ankimi nuk parashikohej në Gjykatën e parë Kushtetuese ndërtuar sipas modelit kelzenian në Austri. Kelzeni e konceptoi gjykatën kushtetuese si një instrument për mbrojtjen e kushtetutës përmes shqyrtimit abstrakt të kushtetueshmërisë së ligjit, duke përjashtuar nga juridiksioni i saj shqyrtimin e ankesave individuale.<sup>325</sup> Pra, parashikimi i mundësisë së ankimit të drejtpërdrejtë përfaqëson largimin më të madh nga modeli i Hans Kelzen si ligjvënës negativ ndaj procesit ligjvënës, veçanërisht kur në të janë përfshirë pretendime për cënim të të drejtave dhe lirive themelore.<sup>326</sup>

Në lidhje me kuptimin doktrinor të kuptimit ankim individual duke përshtatur kuptimin e dhënë nga doktrina gjermane<sup>327</sup> mund ta përkufizojmë si të drejtën e çdo individi apo grupi shoqëror për të kundërshtuar akte të administratës publike dhe të autoriteteve gjyqësore, kur ato

<sup>317</sup> Sadushi, Sokol, “Drejtësia kushtetuese në zhvillim”, Shtëpia Botuese “Toena”, Tiranë 2012, fq.324.

<sup>318</sup> Vendimi nr.67, datë 15.7.2009 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>319</sup> Vendimi nr.102, datë 22.9.2011 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>320</sup> Vendimi nr.74, datë 15.6.2012 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>321</sup> Matscher, Franz, “The right to a fair trial in the case law of the organs of the European Convention on Human Rights”, botuar në “The right to a fair trial”, Koleksioni “Shkenca dhe teknika të demokracisë”, nr.28, botim i Komisionit Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias), Gjermani 2000, fq. 10.

<sup>322</sup> Mavcic, Arne, “The protection of fundamental rights by the Constitutional Court and the practice of the Constitutional Court of the Republic of Slovenia”, botuar në “The protection of fundamental rights by the constitutional court”, Koleksioni “Shkenca dhe teknika të Demokracisë”, botim i Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) Nr.15, ribotim 1998, fq.208.

Sadushi, Sokol, “Drejtësia kushtetuese në zhvillim”, Shtëpia Botuese “Toena”, Tiranë 2012, fq.311.

<sup>323</sup> Vorpsi, Arta, “Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë”, botim i Fondacionit Konrad Adenaur, Shtëpia Botuese “Maluka”, Tiranë 2011, fq.18.

<sup>324</sup> Sulko, Ervin, “Ankimi individual në këndvështrimin kushtetues krahasimor”, botuar në Revistën “Studime Juridike”. Nr.2/2014, botim i Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Shtëpia Botuese “Europrint”, Tiranë 2014, fq.135-136.

<sup>325</sup> Sadushi, Sokol, “Drejtësia kushtetuese në zhvillim”, Shtëpia Botuese “Toena”, Tiranë 2012, fq.309.

<sup>326</sup> Schwartz, Herman, “The struggle for constitutional justice in post-communist Europe”, Shtëpia Botuese “The University of Chicago Press”, Chicago 2000, fq.34.

<sup>327</sup> Vorpsi, Arta, “Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë”, botim i Fondacionit Konrad Adenaur, Shtëpia Botuese “Maluka”, Tiranë 2011, fq.18.

cënojnë elementët e së drejtës për një proces të rregullt ligjor të njohura nga Kushtetuta. Nga ky përkufizim del edhe veçantia e këtij mjete ankimor e cila mund të ushtrohet vetëm në rast të cënimit të të drejtave të garantuara nga dispozitat kushtetuese dhe jo nga ligjet e thjeshta.<sup>328</sup>

Ky lloj ankimi është mjete i vetëm i drejtpërdrejtë që ka individ i për t'u ankuar në Gjykatën Kushtetuese, duke u dalluar nga mjetet e tjera indirekte që ka në dispozicion për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese nëpërmjet Avokatit të Popullit dhe gjykatave të zakonshme. Në kuptimin procedural ankimi i drejtpërdrejtë me anë të kërkesës është një akt procedural nëpërmjet të cilit personi fizik ose juridik vë në lëvizje gjyqtarin kushtetues, pa ndërmjetës, me qëllim të ushtrimit të kontrollit të kushtetueshmërisë së aktit.<sup>329</sup> Po ky duhet të jetë një mjet i jashtëzakonshëm. Kushtetuta është ligji më i lartë dhe duhet që të respektohet nga të gjitha gjykatat. Për rrjedhojë Gjykata Kushtetuese mund të përdoret vetëm si mjet i fundit dhe vetëm nëse mjetet e tjera kanë dështuar në mbrojtjen e të drejtave.<sup>330</sup>

Shqyrtimi i këtyre kërkesave individuale zë pjesën më të madhe të punës në këtë gjykatë, por pavarësisht kësaj, mundësia për t'u drejtuar Gjykatës Kushtetuese, me qëllim dëgjimin e pretendimeve për shkeljen e një procesi të rregullt ligjor, nuk është e pakufizuar. Kushtetuta, ligji organik i Gjykatës Kushtetuese, por mbi të gjitha jurisprudenca e kësaj gjykate, kanë vendosur dhe sqaruar shumë koncepte dhe momente të rëndësishme procedurale të cilat duhet të merren në konsideratë nga individët me qëllim që çështja e tyre të mos mbesë e pashqyrtuar. Gjithashtu shkaqet për të cilat mund të kërkohej një rishikim kushtetues i procedurave të mëparshme, qoftë gjyqësore, qoftë administrative, nuk janë të pafundme.

E drejta për një proces të rregullt ligjor, në praktikën gjyqësore shqiptare përgjithësisht është kufizuar vetëm në të drejtën për një proces të rregullt ligjor në aspektin procedural, pavarësisht se në disa raste ka pasur edhe vendimmarrje të Gjykatës Kushtetuese të cilat kanë të bëjnë edhe me procesin e rregullt ligjor substancial. Në Shqipëri, ankimi kushtetues është i kufizuar, pasi ankimet individuale mund të drejtohen kryesisht kundër vendimeve gjyqësore dhe në raste mjaft specifike edhe ndaj akteve të tjera të pushtetit publik, kur pretendohet se çënohet e drejta për proces të rregullt ligjor dhe individ nuk ka mjet ankimi ndaj aktit.<sup>331</sup> Megjithatë në këtë pjesë si doktrina ashtu gjetjet e jurisprudencës kushtetuese nuk kanë asnjë dyshim që e drejta themelore për një proces të rregullt ligjor zbatohet në të gjitha procedurat të një rendi juridik, si në procesin civil, në procesin e kontrollit gjyqësor të veprimtarisë administrative, në procesin penal dhe në procesin administrativ.<sup>332</sup>

Nga sa më sipër rezulton se jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese e mohon kategorikisht hipotezën e ankimit të individit për cënimin e të drejtave të tjera përveç atyre me karakter procedural. Nga ky konstatim mund të konkludohet se individ mund të ketë akses vetëm indirekt në një gjykim kontrolli të kushtetueshmërisë së një ligji ose akti normativ nënlidjor që mund të

<sup>328</sup> Po aty, fq.19.

<sup>329</sup> Pirdeni, Adea, "Vështrim i shkurtër mbi aksesin e individit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", botuar në "Sistemi kushtetues dhe sfidat e tij", Revista "Studime Juridike", botim i Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Shtëpia Botuese "Adelprint", Tiranë 2009, fq.119.

<sup>330</sup> Seibert, Helga, "Admissibility requirements for constitutional complaints and mechanisms for avoiding an excessive case load", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15", botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998, fq. 147-148.

<sup>331</sup> Zaganjori, Xhezair; Anastasi, Aurela; Çani (Met'hasani), Eralda; "Shteti i së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë", Botim i Fondacionit Konrad Adenauer, Shtëpia Botuese "Adelprint", Tiranë 2011, fq.88.

<sup>332</sup> Hollander, Pavel, "The right to a fair trial in the Czech Republic", botuar në "The right to a fair trial", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të demokracisë", nr.28, botim i Komisionit Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias), Gjermani 2000, fq. 35.

cënojnë të drejtat e tij themelore, kur ky gjykim është kërkuar nga gjyqtari referues në bazë të nenit 145, pika 2 e Kushtetutës, nga Avokati i Popullit apo nga një organizatë që ka si objektiv statutor mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore.<sup>333</sup>

Duke bërë një analizë të legjislacioni në fuqi mund të themi se aktet që mund të jenë objekt kontrolli në Gjykatën Kushtetuese në kuadër të pretendimit për shkelje të procesit të rregullt ligjor janë në rradhë të parë **vendimet e gjykatave të zakonshme**. Këto vendime mund të jenë në çdo shkallë të gjyqësorit, në varësi të rastit nëse lejohen ankim apo jo kundër tyre, pra nëse ekzistojnë apo jo mjete ankimore për kundërshtimin e tyre.

Kështu rregulli është që në një çështje civile vendimi gjyqësor mund të kundërshtohet mbasi janë ezauruar të gjitha shkallët e pushtetit gjyqësor, përfshirë si shkallë e fundit edhe Gjykatën e Lartë. Po e njëjta gjë mund të thuhet edhe për çështjet penale. Në këtë rast objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese, në varësi të situatës ku ka ndodhur shkelja e pretenduar mund të bëhet objekt kundërshtimi, vendimet e të treja shkallëve të gjyqësorit, vendimet e gjykatës së apelit dhe asaj të lartë, vendimi i Gjykatës së Lartë dhe për çështje juridiksioni vendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe vendimi i Gjykatës së Lartë.

Përsa i përket çështjeve gjyqësore me natyrë administrative duhet theksuar se LGJA parashikon kufizim të së drejtës së ankimit. Kështu në varësi të vlerës së çështjes, për vendime të gjykatës administrative, legjislacioni përkatës ndalon ankimin<sup>334</sup> në gjykatën e apelit ose rekursin<sup>335</sup> në Gjykatën e Lartë. Në këtë rast objekt ankimi do të jetë respektivisht vendimi i gjykatës administrative të shkallës së parë, nëse nuk lejohet ankim dhe vendimi i gjykatës administrative të apelit nëse nuk lejohet rekurs.

Në të gjitha rastet e mësipërme (civile, penale, administrative) e përbashkëta është që ky lloj vendimi duhet që të jetë përfundimtar. Në këtë këndvështrim nga Gjykata Kushtetuese janë konsideruar si vendime përfundimtare edhe vendimet që japin gjykatat e zakonshme dhe gjykata për krimet e rënda në lidhje me masat e sigurisë. Kështu këto vendime megjithëse në kuptimin e ngushtë procedural janë të ndërmjetme, përderisa kanë të bëjnë me lirinë e personit, Gjykata Kushtetuese i ka konsideruar si vendime përfundimtare në kuptim të nenit 42 dhe 131, shkronja "f" e Kushtetutës dhe për rrjedhojë mund të kundërshtohen si akte në këtë Gjykatë.<sup>336</sup>

Një tjetër vendim i kësaj natyre, që nga pikëpamja procedurale është i ndërmjetëm por që për nga natyra e tij *sui generis* konsiderohet si vendim përfundimtar janë edhe vendimet e gjykatave të zakonshme të cilat zgjidhin çështjet që i përkasin fazës së parë të pjesëtimit gjyqësor. Duke qenë se kundër këtyre vendimeve K.Pr.C. parashikon ankim të veçantë (5 ditor) atëherë rezulton se gjatë fazës së dytë të pjesëtimit nuk mundet që të bëhet ankim për çështje që i përkasin kësaj faze. Në këtë drejtim mbasi janë shteruar të gjitha mjetet ankimore një vendim i tillë i gjykatës mund të bëhet objekt ankimi në Gjykatën Kushtetuese.<sup>337</sup>

Për shkak të natyrës së veçantë të vendimit që merret në këtë rast objekt gjykimi bëhet edhe vendimi i Gjykatës së Lartë që ka shqyrtuar kërkesat për rishikim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Ky lloj gjykimi që zhvillohet në Gjykatën e Lartë, pavarësisht ndikimit që ka, është një gjykim autonom në raport me gjykimin që është bërë për themelin e çështjes. Në këtë drejtim duke qenë se një vendimarrje e tillë prek një mosmarrëveshje që është zgjidhur me

<sup>333</sup> Pirdeni, Adea, "Vështrim i shkurtër mbi aksesin e individit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", botuar në "Sistemi kushtetues dhe sfidat e tij", Revista "Studime Juridike", botim i Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Shtëpia Botuese "Adelprint", Tiranë 2009, fq.120.

<sup>334</sup> LGJA, neni 45.

<sup>335</sup> LGJA, neni 56.

<sup>336</sup> Vendimi nr.28, datë 23.6.2011 i Gjykatës Kushtetuese, parag.8.

<sup>337</sup> Vendimi nr.24, datë 12.11.2008 i Gjykatës Kushtetuese.



vendim gjyqësor të formës së prerë dhe që jepet nga instanca më e lartë gjyqësore në vend, atëherë ky vendim bëhet objekt gjykimi në Gjykatën e Kushtetuese.<sup>338</sup>

Akte të tjera që mund të kundërshtohen në Gjykatën Kushtetuese në kuadër të këtij gjykimi janë edhe **vendimet e gjykatave të arbitrazhit**. Por në fillim duhet që të bëjmë një dallim midis arbitrazhit kombëtar dhe atij të huaj. Cilësimi i një vendimi të arbitrazhit si "kombëtar", apo "i huaj" është i diskutueshëm. Në legjislacionin modern kombëtar dhe ndërkombëtar dy kriteret prevalojnë të cilat përcaktojnë se cilës kategori i përket një vendim dhe nëse duhet klasifikuar si kombëtar apo i huaj dhe konkretisht kriteri i vendit ku vendimi është marrë dhe kriteri i autonomisë së vullnetit të palëve.<sup>339</sup>

Parimisht është i kundërshtueshëm në gjykimin kushtetues vendimi i gjykatës së arbitrazhit kombëtar. Nëpërmjet një ankimi kushtetues mund të kundërshtohet jo vetëm vendimet e gjykatave të arbitrazhit të përhershëm por edhe vendimet e gjykatave të arbitrazhit të përkohëshme.<sup>340</sup> Pavarësisht se gjykata e arbitrazhit formohet mbi bazën e vullnetit të palëve, ai është një gjykim i cili zgjidh një mosmarrëveshje midis palëve dhe për rrjedhojë edhe në këtë rast, ky lloj gjykimi, pavarësisht karakteristikave të veta, duhet që të respektojë elementët për një proces të rregullt ligjor.

Në këtë kuadër mund të shtrohet për diskutim edhe një tjetër aspekt i gjykimin të arbitrazhit. Sipas legjislacionit tonë procedural civil rezulton se mund të gjykohet me procedurë arbitrazhi vetëm në qoftë se ekziston një marrëveshje e palëve, me anë të së cilës ato pranojnë t'ia nënshtrojnë arbitrazhit mosmarrëveshjet që kanë lindur ose mund të lindin nga një kontratë e lidhur ndërmjet tyre.<sup>341</sup> Në këtë pikë nëse njera nga palët pretendon se kjo marrëveshje është e pavlefshme, a mund të bëhet ky pretendim, objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese? Në pamje të parë ky pretendim është jashtë juridiksionit kushtetues për këtë lloj gjykimi. Kështu si rregull vlefshmëria e marrëveshjeve të lidhura midis palëve janë objekt shqyrtimi në gjykatat e zakonshme. Megjithatë jam i mendimit që pas një analize të kujdesshme edhe në këtë rast dhe për këtë lloj marrëveshje, Gjykata Kushtetuese ka juridiksion për shqyrtimin e saj. Marrëveshja për arbitrazh është një marrëveshje e cila përcakton gjykatën kompetente që do të shqyrtojë çështjen. E drejta për tu gjykuar nga gjykata kompetente përfshihet brenda konceptit të procesit të rregullt ligjor për tu gjykuar nga gjykata e caktuar me ligj.<sup>342</sup> Për pasojë pavarësisht qëndrimit që mund të kenë mbajtur gjykatat në lidhje me vlefshmërinë apo pavlefshmërinë e marrëveshjes për arbitrazh, Gjykata Kushtetuese, duke kontrolluar bazueshmërinë e këtyre vendimeve, analizon vetë nëse kaluzola e arbitrazhit është apo jo e vlefshme.

Janë objekt kontrolli në Gjykatën Kushtetuese edhe **vendimet e gjykatës së apelit dhe asaj të lartë që trajtojnë çështje të njohjes së vendimeve të gjykatave të huaja apo të arbitrazheve të huaja**, sipas K.Pr.C. Këto janë gjykime që megjithëse nuk shqyrtojnë mosmarrëveshjen në themel synojnë që të garantojnë rendin juridik shqiptar. Nëse gjatë këtyre gjykimeve janë shkelur të drejtat procedurale kushtetuese të palëve në gjykim, atëherë nga Gjykata Kushtetuese mund të bëhen objekt kontrolli prej saj mbi kërkesën e palëve në proces. Bazuar në të njëjtin arsyetim janë objekt kontrolli në Gjykatën Kushtetuese edhe vendimet e

<sup>338</sup> Vendimi nr.17, datë 18.7.2005 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>339</sup> Momcinovic, Hrvoje, "Contesting the arbitration decision in the proceedings before the Constitutional Court according to the Croatian law", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të Demokracisë", botim i Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) Nr.15, ribotim 1998, fq.83.

<sup>340</sup> Po aty, fq.86.

<sup>341</sup> K.Pr.C., neni 403.

<sup>342</sup> Kushtetuta, neni 42, pika 2.



gjykatave shqiptare me objekt njohjen e vendimeve të gjykatave të huaja të dhëna në fushën penale.<sup>343</sup> Në këtë rast flasim për pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga gjykatat shqiptare gjatë procesit të njohjes së vendimeve të huaja.

Përsa i përket **vendimeve që japin gjykatat e huaja, arbitrazhet e huaja apo ato ndërkombëtare** dhe që sjellin pasoja në Shqipëri, parimisht duket sikur janë jashtë kontrollit kushtetues. Këto vendime të dhëna nga gjykata që krijohen në vende të tjera nuk mundet që t'i nënshtrohen kontrollit kushtetues në mënyrë të drejtpërdrejtë. Por pavarësisht kësaj në mënyrë jo të drejtpërdrejtë këto vendime i nënshtrohen këtij kontrolli. Kështu një vendim i tillë duhet që t'i nënshtrohen procedurës së njohjes nga gjykata e apelit e vendit ku do të bëhet ekzekutimi i vendimit. Gjykata e apelit megjithëse nuk i hyn shqyrtimit në themel të çështjes, përsëri ka të drejtë të mos i japë fuqi juridike në vendin tonë nëse nuk janë plotësuar disa kushte që parashikohen nga K.Pr.C.<sup>344</sup> Në përgjithësi këto kushte procedurale që kërkon legjislacioni shqiptar si edhe për më tepër kriteri që të pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar sjell si pasojë që gjykimi i zhvilluar jashtë vendit duhet që të jetë në përputhje me parimet e procesit të rregullt ligjor. Nëse shkeljet e ketyre parimeve nuk merren në konsideratë nga gjykata e apelit dhe mbi bazën e rekursit nga as Gjykata e Lartë atëherë çështja mund të bëhet objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese mund të shfuqizojë vendimet e gjykatave shqiptare duke u kërkuar që të analizojnë edhe pretendimet për proces të parregullt ligjor të zhvilluara në gjykatat jashtë vendit tonë. Në këtë drejtim, pra në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, mund të kundërshtohen edhe vendime të tilla.

Objekt ankimi në Gjykatën Kushtetuese janë edhe **vendimet me natyrë administrative** si rregull të organeve kushtetuese të cilat nuk mundet që të kundërshtohen në rrugën e juridiksionit të zakonshëm. Kështu Gjykata Kushtetuese ka legjitimuar ankesat e Prokurorit të Përgjithshëm për tu ankuar kundër procedurës së ndjekur nga Kuvendi dhe nga Presidenti për shkarkimin e tij nga detyra.<sup>345</sup>

Janë objekt ankimi në Gjykatën Kushtetuese edhe **mosveprimet e subjekteve të ndryshme**, debitore, publike apo private të cilat nëpërmjet mosveprimit të tyre nuk zbatojnë vendimet e formës së prerë, gjyqësore apo administrative. Në kuptim të këtij parashikimi që personat të kenë mundësi të ankohen duhet që vendimi i gjykatës apo i administratës të jetë përfundimtar. Në rast se një vendim nuk është i tillë, pasi ndaj tij është ushtruar ankim me efekt pezullues, atëherë çështja në Gjykatën Kushtetuese është pa objekt.<sup>346</sup>

Nuk janë objekt i kontrollit kushtetues në këtë lloj gjykimi aktet me natyrë të përgjithshme si ligjet, apo aktet nënligjore normative të Këshillit të Ministrave si edhe ato të organeve të tjera qendrore.<sup>347</sup>

Janë jashtë kontrollit kushtetues vendimet e Gjykatës së Lartë për pezullimin e ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë të marra nga gjykata e apelit. Ky lloj vendimi nuk është përfundimtar edhe për rrjedhojë është jashtë juridiksionit kushtetues.<sup>348</sup>

Po jashtë këtij juridiksioni janë edhe vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë për verifikimin e mandatit të anëtarëve të zgjedhur nga organet e emërtesës, Kuvendi apo

<sup>343</sup> Vendimi nr.13, datë 12.7.2004 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>344</sup> K.Pr.C., neni 394.

<sup>345</sup> Vendimi nr.76, datë 25.4.2002 i Gjykatës Kushtetuese. Shih edhe vendimin nr.21, datë 1.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>346</sup> Vendimi nr.31, datë 25.3.2011 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>347</sup> Vendimi nr.82, datë 20.07.2011 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>348</sup> Vendimi nr.51, datë 9.7.2010 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

Konferenca Kombëtare Gjyqësore, për shkak se u mungon karakteri përfundimtar si akte.<sup>349</sup> Në rast të një konstatimi se personi i zgjedhur nuk i plotëson kërkesat përkatëse ligjore atëherë u kërkohej këtyre dy institucioneve që të zgjedhin anëtarë të tjerë.

Jashtë kontrollit kushtetues janë edhe vendimet e gjykatave të zakonshme për marrjen e masave për sigurimin e padisë. Këto janë vendime të ndërmjetme të cilat ndjekin fatin e themelut të çështjes dhe janë të varura nga vendimi përfundimtar i gjykatës.<sup>350</sup>

### 2.16.1 Aktet normative dhe procesi i rregullt ligjor substancial.

Specializimi i punës së degëve të qeverisjes ka çuar në ndarjen në dy pjesë të së drejtës: në materiale dhe procedurale. Rrjedhoja kryesore e kësaj, në dritën e doktrineve të kaluara, forcës së madhe të inercisë, është reduktimi i procesit të rregullt thjesht në elementin procedural. Këtu ka ndihmuar jo pak edhe vetë emërtimi “proces i rregullt”, i cili, nga ana e vetë, është produkt i arsytimit në qark vicioz, të ndikuar pikërisht nga këto doktrina. Pra, procesi ka krijuar produktin, kurse produkti nga ana e vet, ngjyros terminologjikisht procesin.<sup>351</sup>

Në lidhje me zbatimin e procesit të rregullt ligjor substancial në praktikën e Gjykatës sonë Kushtetuese, doktrina ka mbajtur qëndrimin se ende në jurisprudencën kushtetuese shqiptare nuk ka ndonjë rast që të jetë analizuar koncepti i procesit të rregullt ligjor substancial.<sup>352</sup>

Ky pohim nuk është plotësisht i vërtetë. Kështu, pavarësisht se Gjykata Kushtetuese në përgjithësi, ka ndjekur procesin e rregullt ligjor në kuptimin procedural të tij, bazuar në një analizë të kujdesshme të vendimmarrjes të këtij institucioni vërejmë se ka pasur disa raste kur kjo Gjykatë ka zbatuar edhe gjykimin substancial të procesit të rregullt ligjor.

Kështu në jurisprudencën e hershme të kësaj Gjykate gjejmë këtë vendimmarrje:

*Gjykata e Lartë, në vendimin e saj, është bazuar kryesisht në nenet 41 dhe 42 të ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", nga del se personi i tatueshëm duhet të paguajë TVSH-në, pavarësisht nëse ka kërkuar shqyrtimin e apo është ankuar kundër vlerësimit tatimor. Për më tepër, këto dispozita përcaktojnë detyrimin e Ministrisë së Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave) që të mos shqyrtojë ankimin e personave pa u paguar më parë nga ata gjithë TVSH-ja e përlllogaritur dhe e pagueshme prej tyre.*

*Gjykata e lartë, në shqyrtimin e çështjes dhe vendimin e saj, nuk ka marrë në konsideratë faktin se dispozitat ligjore ku mbështetet kushtëzojnë dhe kufizojnë të drejtën e ankimit. Ky fakt nuk mund të anashkalohet nga Gjykata Kushtetuese, edhe pse ato (dispozitat) kanë pasur ndryshime e përmirësime në këto drejtime.*

*Gjykata e Lartë ka vendosur pushimin e gjykimit në një kohë kur kanë kaluar afatet e ankimit administrativ dhe afati i ankimit gjyqësor, parashikuar nga nenet 42 dhe 43 të ligjit "Për tatimin mbi vlerën e shtuar". Në këtë mënyrë, paditësi është vënë plotësisht në pamundësi për të ushtruar të drejtën kushtetuese të ankimit në gjykatë, parashikuar nga neni 42/2 i Kushtetutës. Sipas vendimit, duke iu referuar edhe*

<sup>349</sup> Vendimi nr.5, datë 11.3.2004 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>350</sup> Vendimi nr.103, datë 25.9.2012 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese, parag.9.

<sup>351</sup> Traja, Kristaq, "Procesi i rregullt ligjor", Revista "Studime Juridike", nr.1 i vitit 2005, botim i Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Shtëpia Botuese "Adelprint", Tiranë 2005, fq.50.

<sup>352</sup> Sadushi, Sokol, "Drejtësia kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq.322.

*dispozitave ligjore të lartpërmendura, me "pushimin e gjykimit", pala paditëse nuk mund të ngrejë padi në gjykatë, duke sjellë si pasojë të pashmangshme "shuarjen e padisë" në kundërshtim edhe me nenin 300 të Kodit të Procedurës Civile.*

*Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese e gjen vendimin nr. 607, datë 14.06.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë antikushtetuese, rezultat i një procesi të parregullt, në kuptim të nenit 42/1 të Kushtetutës.*

*Ashtu siç u analizua më lart antikushtetutshmëria e këtij vendimi lidhet së pari, me shtrirjen e procedurave që zbatojnë organet e administratës në veprimtarinë gjyqësore dhe së dyti, në mohimin në mënyrë të kundërligjshme të së drejtës për të ngritur padi.<sup>353</sup>*

Nga sa më sipër rezulton se Gjykata Kushtetuese e ka orientuar Gjykatën e Lartë që të moszbatojë dispozitat e legjislacionit përkatës pasi, siç shprehet ajo, kufizojnë dhe kushtëzojnë të drejtën për ankim. Tërheq vemendjen fakti se teknika e ndjekur në këtë rast nga Gjykata Kushtetuese është ajo e tipit amerikan, ku Gjykata sugjeron në thelb moszbatimin e ketyre dispozitave dhe për rrjedhojë shmangien e tyre.

Gjithsesi Gjykata e Lartë, bazuar edhe në nenin 145, të Kushtetutës, ku pika 1 e detyron që përveç aktit themelor të vendit të bazohet edhe në ligjet në fuqi, nuk u tërhoq në këtë ide për të shmangur zbatimin e ligjit, por nëpërmjet kontrollit incidental (neni 145, pika 2) i kërkoi Gjykatës Kushtetuese kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të normave që kushtëzonin dhe kufizonin të drejtën për ankim të subjekteve tregtare. Ndërsa parimisht rezultati, të paktën në teori duhej që të ishte i pritshëm, pra shfuqizimi i këtyre dispozitave, Gjykata Kushtetuese befasoi me vendimmarrjen e saj duke mbajtur qëndrimin se:

*Megjithatë, për shkaqet që ka parashtruar kërkuesi Gjykata Kushtetuese nuk arrin në përfundimin se dispozitat objekt kërkese janë antikushtetuese.*

*- Nga përmbajtja e dispozitave në shqyrtim rezulton se ligjvënësi synon ta detyrojë subjektin e tatuar që krahas me kërkesën për rishqyrtim në organet më të larta tatimore, të paguajë vlerësimin tatimor që i detyrohet shtetit. Kjo pagesë paraprake bëhet në përputhje me politikën shtetërore të grumbullimit të të ardhurave të ligjshme, me qëllim që shteti të përmbushë funksionet e veta ndaj shoqërisë në përgjithësi e shtetasve në veçanti, pra është në interes publik.*

*- Gjykata Kushtetuese konstaton se nenet 41/4, 42/5 e 43/1 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", për aq sa parashtrohet në kërkesë, gjithashtu nuk cenojnë parimin kushtetues të përpjesëtimit midis kufizimit që i bëhet ankimit të subjektit të tatuar me gjendjen që e ka diktuar atë masë. Ligji ruan balancin midis të drejtës së individit dhe të mirës së përgjithshme, duke mbajtur një qëndrim të arsyeshëm në përcaktimin e vlerës që merret paraprakisht. Nga përmbajtja e ligjit del se organet tatimore jo vetëm që vlerësimin tatimor e bëjnë zakonisht kur personi i kontrolluar nuk respekton kushtet e ligjit për pagimin e TVSh-së, por dhe se ky vlerësim përfaqëson vetëm një pjesë të detyrimit tatimor që përfshin në vetvete edhe gjobën e interesin. Vetë vlerësimi tatimor përfaqëson shumën që i takon shtetit nga fitimi i subjektit që ushtron veprimtari tregtare.*

*Pagimi paraprak i vlerësimit tatimor është i nevojshëm për shkak të vështirësive që ndeshin organet shtetërore në vjeljen e detyrimeve nga subjektet e detyruara. Në*

<sup>353</sup> Vendimi nr.18, datë 1.2.2002 i Gjykatës Kushtetuese.

*kushtet e një ekonomie informale të vendit dhe kur transaksionet financiare janë në hapat e para, nga mosvjelja në kohë e detyrimeve mund të vijnë pasoja të tilla që do të dëmtonin rëndë interesat publike dhe do të prishnin balancin midis të mirës së përgjithshme dhe të drejtës së individit në favor të këtij të fundit.*

*Kufizimi është i përligjur edhe se qëllimi i ligjit është që shteti t'i marrë paraprakisht shumat që i takojnë, pa mohuar kthimin e tyre në rast se gjykata anulon aktin administrativ të organeve tatimore. Vetë ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të konceptit të shtetit ligjor e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë, prandaj neni 1 paragrafi i dytë i protokollit nr.1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, u jep të drejtë shteteve që duke respektuar parimin e ligjshmërisë dhe të legjitimitetit të kufizimeve "të venë në fuqi ligjet që ato i quajnë të domosdoshme për të siguruar pagesën e taksave ose të kontributeve të tjera, ose të gjobave".*

*- Kufizimi i së drejtës së ankimit në ligjin "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", nuk tejkalon as kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës. Në nenin 13, Konventa përcakton të drejtën e ankimit efektiv pa u shprehur në këtë nen për kufizimin e kësaj të drejte, siç vepron për disa të drejta të tjera, por neni 1, paragrafi 2 i protokollit nr.1 të Konventës pranon të drejtën e shteteve të nxjerrin ligje për të siguruar pagesën e kontributeve. Nga ana tjetër, Konventa parashikon vetëm qëllimin e kufizimit që është siguri i pagesave nga subjektet, duke i lënë shteteve hapësirë vlerësimi për rrugët e mjetet efektive të realizimit të këtij qëllimi. Vetë ligji objekt kërkese ka përcaktuar rrugët e mjetet e domosdoshme që sigurojnë pagesat e kontributeve pa cenuar thelbin e të drejtës, duke parashikuar edhe disa mjete të tjera që mbrojnë thelbin e të drejtës, pra që i japin mundësi subjektit të tatuar që ka vështirësi financiare të ushtrojë ankimin. Kështu, ligji nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore" parashikon edhe zgjatjen e afatit të pagesës ose ndarjen e saj në këste, kur tatimpaguesi nuk mund të paguajë menjëherë të gjithë detyrimin tatimor. Jo vetëm kaq, por sipas udhëzimit nr.5, datë 11.2.2002 të Ministrit të Financave, tatimpaguesi mund të paraqesë edhe garanci të tjera të nevojshme para se të paraqitet për apelim.<sup>354</sup>*

Nga tërësia arsyetimit të mësipërm duket qartazi që Gjykata Kushtetuese kundërshton vendimmarrjen e saj të mëparshme dhe shprehet tashmë që këto kufizime të së drejtës për ankim nuk bien ndesh me të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Madje ironikisht, Gjykata duket sikur është totalisht indiferente ose hiqet sikur nuk ka dijeni në lidhje me vendimmarrjen e mëparshme të saj për këtë çështje. Në këtë pikë nga arsyetimi i saj, duke përdorur shprehjen "për shkaqet që ka parashtruar kërkuesi", ia kalon përgjegjësinë Gjykatës së Lartë për mosarsyetim të saktë të vendimit të saj për iniciimin e këtij procesi. Pavarësisht kësaj, inkoherenca e Gjykatës Kushtetuese vihet në dukje nga mendimi paralel që shoqëron këtë vendim.<sup>355</sup>

Është e tepërt të themi që kjo mënyrë vendimmarrje e Gjykatës Kushtetuese nuk është aspak normale dhe për më tepër çorodit edhe praktikën gjyqësore. Duke u gjendur përballë dy vendime që kundërshtonin njëri – tjetrin Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë mbajti qëndrimin e mëposhtëm:

<sup>354</sup> Vendimi nr.9, datë 2.4.2003 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>355</sup> Mendimi paralel i gjyqtarit kushtetues, Zija Vuci, në vendimin nr.9, datë 2.4.2003 të Gjykatës Kushtetuese.



*Mirëpo vendimi nr.607, datë 14.06.2001 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është shfuqizuar si antikushtetues me vendimin nr.18, datë 01.02.2002 të Gjykatës Kushtetuese për shkelje të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë...*

...

*Gjithësesi, ky vendim i Gjykatës Kushtetuese, sado i pambështetur, i ka lënë pa fuqi efektet e vendimit nr.607, datë 14.06.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe ka imponuar rishqyrtimin e çështjes në këtë gjykatë.*

...

*Për Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë arsyetimi i mësipërm i Gjykatës Kushtetuese të vendos përpara dilemës: të zbatosh dispozitat e ligjit sipas kuptimit dhe përmbajtjes që u ka dhënë ligjvënësi, apo të mos i zbatosh (t'i anashkalosh) ato sepse Gjykata Kushtetuese i konsideron ato në mënyre implicite antikushtetuese, megjithëse nuk i shfuqizon ato si të tilla, ndonëse një gjë e tillë është prerogativë ekskluzive e saj.*

*Për të kapërcyer këtë non sens juridik Kolegji Civil ka gjetur si rrugëzgjdhje vënien përsëri në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese, në bazë të nenit 145/2 të Kushtetutës, duke kërkuar në mënyrë të shprehur shfuqizimin si antikushtetuese të dispozitave përkatëse të ligjit "Për T.V.SH".*

*Pas shqyrtimit të çështjes në një këndvështrim të ri, Gjykata Kushtetuese, me vendimin e saj nr.9, datë 11.09.2002, shprehet përfundimisht se nenet 41, 42 e 43 të Ligjit nr.7928, date 27.04.1995 "Per tatim mbi vleren e shtuar" janë në pajtim me Kushtetutën.*

*Si përfundim, Gjykata Kushtetuese me vendimin e dytë, në mënyrë eksplicite mohoi tërësisht përfundimet që kishte parashtruar në mënyrë implicite në vendimin e saj të parë, që i përkiste së njëjtës çështje.*

*Si përfundim, duke u nisur nga sa me lart, Kolegji Civil arrin në përfundimin që në zgjidhjen e kësaj çështjeje gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit kanë pranuar për gjykim e zgjidhur një padi, që nuk mund të ngrihej pa u ezauruar paraprakisht procedura e shqyrtimit administrativ sipas ligjit per T.V.SH. Duke qenë se në kohën e shqyrtimit të kësaj çështjeje mungonte juridiksioni gjyqësor, gjykatat nuk mund të procedonin më tej për shqyrtimin e saj në themel në pikëpamje të faktit e të ligjit.<sup>356</sup>*

Nga arsyetimi i mësipërm kuptohet lehtësisht situata e dyzuar në të cilën gjendej trupa e Gjykatës së Lartë në zgjidhjen e kësaj çështjeje. Kështu ajo ndodhej përpara dy vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të cilat preknin vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë në lidhje me këtë çështje. Duke zbatuar me analogji parimin *lex posteriori derogat priori* Gjykata e Lartë u bazua në vendimmarrjen e dytë të Gjykatës Kushtetuese duke vendosur për rrjedhojë si në rastin e parë pushimin e gjykimit të çështjes. Kjo vendimmarrje e Gjykatës Kushtetuese, njëkohesisht mbylli edhe rrugën për shqyrtimin e procesit të rregullt ligjor nga ana substanciale.

Megjithatë kjo formë e kontrollit kushtetues u rishfaq përsëri edhe më vonë. Kështu referuar nenit 589 të K.Pr.C rezulton se mënyra e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit përcaktohet me udhëzim të Këshillit të Ministrave. Bazuar në këtë autorizim Këshilli i Ministrave ka miratuar Udhëzimin nr. 2, datë 18.08.2011 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit". Ndër të tjera sipas këtij udhëzimi rezulton se sekuestro mbi llogaritë e thesarit hiqej nga dega e thesarit në çastin e paraqitjes së një grafiku të pagesës së vendimit gjyqësor dhe shlyerjes

<sup>356</sup> Vendimi nr.1138, datë 19.6.2003 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

pjesore të detyrimit, nëse njësia debitore nuk kishte fonde të mjaftueshme në zërin e shpenzimeve operative të vitit buxhetor.<sup>357</sup> Ky grafik nga praktika rezultoi se shpesh herë përmbante këste pagese me vlera shumë të vogla të cilat nuk realizonin në thelb të drejtën e subjekteve të fituar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Për më tepër, në këto raste përmbushja e plotë e detyrimit do të duhej të realizohej për një kohë shumë të gjatë. Pavarësisht kësaj, ky akt nënligjor normativ i Këshillit të Ministrave ka dalë në bazë të një autorizimit të shprehur të ligjit, K.Pr.C., dhe për rrjedhojë është i detyrueshëm për zbatim për të gjitha institucionet për aq kohë sa është në fuqi.

Megjithatë, Gjykata Kushtetuese në rastin e gjykimit të kërkesave për proces të parregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm ka mbajtur këtë qëndrim:

*19. Gjykata në lidhje me këtë çështje çmon të theksojë se, bazuar në nenet 4 dhe 116 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë dhe se dispozitat e saj zbatohen drejtpërdrejt, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe. Gjithashtu, bazuar në nenin 142/3 të Kushtetutës, organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.*

*20. Në vijim të këtyre referimeve, Gjykata vlerëson se prej parashikimeve dhe urdhërimeve të këtyre dispozitave kushtetuese rezulton se, detyrimi i organeve të shtetit për të ekzekutuar vendimet gjyqësore të formës së prerë, buron drejtpërdrejt jo vetëm nga Kushtetuta, por edhe se dispozita kushtetuese (neni 142/3 i saj) në këtë aspekt është e vetëzbatueshme nga organet e shtetit.*

*21. Si rrjedhim, organet e shtetit nuk mund t'i shmangen përmbushjes së këtij detyrimi të drejtpërdrejtë kushtetues me pretendimin se ekzekutimi i vendimit gjyqësor është bërë i pamundur ose/dhe është vonuar thjesht dhe vetëm për shkak të akteve të tjerave normative që në hierarkinë e akteve, të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, vijnë pas Kushtetutës sepse një gjë e tillë do të çonte në cenimin e parimit kushtetues të shtetit të së drejtës, të ndarjes dhe balancimit të pushtetit dhe të së drejtës kushtetuese për një gjykim të drejtë. Për pasojë, asnjë organ i administratës publike nuk mundet që duke ushtruar autoritetin e tij publik, qoftë edhe për realizimin e një qëllimi të ligjshëm publik, të pengojë apo vonojë ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, të dhënë në një gjykim në të cilin ai ka qenë palë. Përkundrazi, këto organe, si çdo subjekt tjetër palë e një gjykimi, kanë të drejtë që të kundërshtojnë në gjykatë ekzekutimin e detyrueshëm të një vendimi gjyqësor nëpërmjet ushtrimit të mjeteve mbrojtëse të parashikuara nga legjislacioni kombëtar në fuqi, e drejtë kjo që në rastin konkret nuk rezulton që të jetë ushtruar prej subjektit të interesuar Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.*

...

*26. Pavarësisht se ky detyrim ka filluar të ekzekutohet prej subjektit të interesuar, në vlerësimin e kësaj Gjykatemënyra dhe masa e ekzekutimit të këtij detyrimi për vitin 2012 e në vazhdim, i caktuar në mënyrë të njëanshme prej këtij organi të pushtetit publik, është jo proporcionale, e paarsyeshme dhe e pajustificuar në raport me*

<sup>357</sup>Udhëzimi nr. 2, datë 18.08.2011 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit", i Këshillit të Ministrave, pika 7, shkronja "d".

*vetë masën e plotë të vlerës së detyrimit në favor të kërkueses, gjë e cila cenon në vetvete thelbin e kësaj të drejte.*<sup>358</sup>

Qëndrimi i mësipërm, në lidhje me kontrollin substancial, është konfirmuar edhe me tej nga Gjykata Kushtetuese edhe në një tjetër vendim të saj in ku është shprehur se:

*Në vijim të arsytimit të mësipërm, edhe pse pala debitore, METE, ka shfaqur vullnetin të plotësojë detyrimin ndaj kreditorit duke urdhëruar pagesën e një pjese të tij, Gjykata konsideron se shumica e përcaktuar në mënyrë të njëanshme, në kuotën prej 10.000 lekë në muaj duke filluar që prej muajit gusht 2011 deri në muajin dhjetor 2012, për një total prej 180.000 lekë, është jo proporcionale, e paarsyeshme dhe e pajustificuar në raport me masën e plotë të vlerës së detyrimit në favor të kërkuetit (prej 5.833.952 lekë), gjë e cila cenon në vetvete thelbin e kësaj të drejte dhe shlyen afatin e arsyeshem në ekzekutimin e vendimit. Gjykata vlerëson se debitori i kishte të gjitha mundësitë që gjatë gjithë periudhës nga dita e marrjes formë të prerë të vendimit nr.4894, datë 14.06.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e në vazhdim t'i paguante kërkuetit shumën që i detyrohej sipas këtij vendimi dhe se nuk rezultojnë arsye të bazuara që kanë çuar në mosrealizimin e të drejtës së kërkuetit.*<sup>359</sup>

Duke analizuar vendimmarrjet e mësipërme të Gjykatës Kushtetuese vërejmë se ajo duke përdorur si argument fuqinë juridike të Kushtetutës, vendin e saj në hierarkinë e normave është shprehur se detyrimi i palës debitore, në këtë rast i organeve shtetërore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore buron drejtëpërsëdrejti nga Kushtetuta dhe për rrjedhojë nuk mundet që të kufizohet me akte të tjera nënligjore, akte të cilat në hierarkinë e përgjithshme të normave janë shumë më poshtë se Kushtetuta. Për më tepër që Gjykata, mënyrën e veprimit të tyre të njëanshme në përcaktimin e kësteve të pagesës, i ka konsideruar si jo proporcionale dhe të paarsyeshme. Në këtë drejtim lehtësisht mund të arrijmë në konkluzionin që Gjykata Kushtetuese në këtë rast ka zbatuar procesin e rregullt ligjor substancial, duke përdorur të njëjtën teknikë, atë të shmangies së zbatimit të normave që kushtëzojnë dhe kufizojnë të drejtat e individëve. Kjo mënyrë veprimi nga Gjykata Kushtetuese është bërë shumë kohë përpara se ajo përfundimisht ta shfuqizonte këtë parashikim të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave.<sup>360</sup>

Një tjetër rast i zbatimit të parimeve të procesit të rregullt ligjor substancial e gjejmë edhe në lidhje me parashkrimin apo jo të titujve ekzekutivë. Nëse i referohemi parashikimeve të K.Pr.C. rezulton se në këtë ligj nuk ka asnjë parashikim përpara u përket faktit nëse titujt ekzekutivë parashkruhen apo jo. Megjithatë në këtë rast duhet që ti referohemi edhe parashikimeve të K.C., ligji i cili në nenin 113, paragrafi i fundit parashikon se nuk parashkruhen edhe kërkesat për ekzekutimin e detyrueshem të vendimeve që janë të lidhura me padi, për të cilat nuk zbatohet parashkrimi. Bazuar në këtë parashikim ligjor praktika gjyqësore ka mbajtur këtë qëndrim:

*Gjykatat kanë zbatuar e interpretuar drejt nenin 113, 115/dh të K.Civil, duke arsyetuar parashkrimin e ekzekutimit të titujve ekzekutive që lidhen me padi për të cilat zbatohen afate parashkrimi.*

<sup>358</sup> Vendimi nr.42, datë 19.7.2012 i Gjykatës Kushtetuese

<sup>359</sup> Vendimi nr.48, datë 26.7.2012 i Gjykatës Kushtetuese, parag.28.

<sup>360</sup> Vendimi nr.20, datë 4.4.2014 i Gjykatës Kushtetuese.

*Neni 113, paragrafi i fundit i K.Civil ka parashikuar se:*

*“Nuk parashkruhen dhe kerkesat për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimeve që janë të lidhura me padi, për të cilat nuk zbatohet parashkrimi”.*

*Në mungesë të një norme juridike të shprehur në K.Civil apo në K.Pr.Civile, më të cilën të jetë rregulluar parashkrimi i ekzekutimit të titujve ekzekutive, gjë që nuk mund të pengojë gjykatën të zgjidhë çështjen, ajo duke interpretuar drejt normat juridike të tjera të K.Civil, nenin 113 dhe 115 të K.Civil, i ka dhënë zgjidhje çështjes.*

*Kështu me të drejtë gjykatat kanë konkluduar se neni 113/“dh” ka lidhur mungesën e parashkrimit të ekzekutimit të detyrueshëm të vendimeve të formës së prerë, vetëm për ato vendime që janë të lidhura me padi, për të cilat nuk zbatohet parashkrimi, pra vetëm për këto lloj padi Kodi ka parashikuar parashkrimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, siç nuk mund të ndodhë e njëjta gjë (për shkak të këtij rregullimi), në ato raste që lidhen me ekzekutimin e vendimit gjyqësor (tituj ekzekutivë), të lidhura me padi që parashkruhen.<sup>361</sup>*

Megjithatë pavarësisht këtij qëndrimi të Gjykatës së Lartë, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur një tjetër qëndrim. Më konkretisht ajo është shprehur si më poshtë:

*Gjithashtu nuk qëndron edhe pretendimi tjetër i debitorit se kërkuesja e ka rivënë në lëvizje pas një kohe të gjatë përmbarimin për ekzekutimin e detyrimit për kthimin e saj në punë dhe pagimin e pagës. Legjislacioni procedural civil nuk përmban afate prekluzive lidhur me ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë duke mos e lidhur kreditorin me asnjë afat shues sa i takon realizimit të së drejtës së tij të fituar gjyqësisht. Rrjedhimisht, kërkueses, pavarësisht kohës që mund të ketë kaluar nga kerkesat e bëra prej saj dhe zyrës së përmbarimit lidhur me ekzekutimin e vendimit të formës së prerë, të cilat kanë qenë të vazhdueshme, nuk i është shuar e drejta për të kërkuar ekzekutimin e plotë të vendimit të formës së prerë nga pala debitore, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.<sup>362</sup>*

Edhe në këtë rast Gjykata Kushtetuese megjithëse i referohet vetem legjislacionit procedural civil përsëri praktikisht ka lënë pa fuqi normat e K.C. që trajtojnë parashkrimin e titujve ekzekutivë. Pra, edhe në këtë rast Gjykata Kushtetuese me ose pa dashje ka zbatuar procesin e rregullt ligjor substancial.

Por pavarësisht këtyre rasteve të izoluar të cilat janë për t'u përgëzuar, përsëri rezulton se Gjykata Kushtetuese në përgjithësi nuk zbaton procesin e rregullt ligjor substancial në rastin e kerkesave të individëve. Kjo mund të sjellë si pasojë (në disa raste ka prodhuar pasoja të tilla) që çështja nga ana procedurale është në rregull por nga ana substanciale jo dhe Gjykata Kushtetuese nuk e ka konsideruar veten kompetente për të ndërhyrë në raste të tilla. Për të zgjidhur këtë situatë në doktrinë është ngritur pretendimi se në këtë drejtim, mund të na ndihmojë analiza dhe përmbajtja e nenit 48, pika 2 e ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, sipas të cilit Gjykata Kushtetuese nuk ndalohet që të vlerësojë edhe kushtetutshmërinë e një ligji ose akti normativ, kur bindet për ekzistencën e lidhjes së tyre me çështjen objekt shqyrtimi. Një çështje e filluar përpara Gjykatës Kushtetuese për antikushtetueshmërinë e një vendimi gjyqësor, që ka cënuar të drejtën për një

<sup>361</sup> Vendimi Nr.00-2008-481 (160), date 28.4.2009 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

<sup>362</sup> Vendimi nr.47, datë 30.7.2014 i Gjykatës Kushtetuese, parag.36.



proces të rregullt ligjor, nuk përjashton shqyrtimin kushtetues edhe ndaj ligjit, i cili rezulton të ketë qenë shkak për çenimin e kësaj të drejte.<sup>363</sup> Personalisht ndaj një tjetër qëndrim. Ndjekja e një rruge të tillë do të sillte probleme me ndërëgjyqësinë në gjykimin kushtetues. Siç e kemi sqaruar edhe më sipër në ato raste kur shqyrtohet kushtetueshmëria e një akti ligjor apo nënligjor me karakter normativ duhet që sipas LGJK të thirret edhe organi i cili ka nxjerrë aktin. Në rastin e një gjykimi për proces të parregullt ligjor i cili është një gjykim konkret për nga natyra nuk mundet që duke u bazuar në dispozitën e mësipërme, ky gjykim të kalojë në një gjykim me natyrë abstrakte, siç e kërkojnë shkronjat "a" dhe "c" të nenit 131 të Kushtetutës dhe për më tepër pa thirrur Kuvendin apo Këshillin e Ministrave si subjekte të interesuara. Personalisht jam i mendimit që për të dalë nga kjo situatë Gjykata Kushtetuese duhet që të ndjekë një rrugë tjetër dhe pikërisht atë të kontrollit incidental me referim që do ta trajtojmë në vijim të këtij punimi. Pabarazia në trajtimin e këtyre të drejtave, ku njera (procesi i rregullt procedural) ka mbrojtje kushtetuese dhe tjetra jo, është, nga çdo anë e papërligjor.<sup>364</sup>

## **2.17 Vendimet e Këshillit të Ministrave për shkarkimin apo shpërndarjen e organeve vendore të zgjedhura drejtpërsëdrejti.**

Kushtetuta në pjesën e saj të gjashtë, konkretisht nenet 108 – 115 rregullon në nivel kushtetues organizimin dhe funksionimin e njësive të qeverisjes vendore. Sipas këtij parashikimi këto njësi janë bashkitë ose komunat dhe qarqet, ku dy të parat janë njësi bazë, ndërsa njësia e qarkut shfaqet si njësi e nivelit të dytë. Pavarësisht kësaj me ligj mundet që të krijohen edhe njësi të tjera vendore.

Sipas nenit 109 të Kushtetutës organet përfaqësuese dhe ekzekutive të njësive bazë zgjidhen nga populli me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë. Duke pasur këtë status, pra si organe të zgjedhura, njësitë vendore gëzojnë një legjitimitet të fortë pasi konsiderohen si përfaqësuese të popullit. Si organe të tilla, kushtetuta u njeh atyre një sërë kompetencash të cilat ato i ushtrojnë në bazë të parimit të decentralizimit dhe të autonomisë vendore.<sup>365</sup>

Pavarësisht kësaj, neni 1 i Kushtetutës e përcakton Republikën e Shqipërisë si një shtet unitar dhe të pandashëm. Kjo do të thotë që pavarësisht autonomisë që këto njësi kanë, ushtrimi i saj duhet që të jetë në përputhje me parimet kushtetuese dhe rregullimet ligjore përkatëse.

Për të mos lejuar abuzimin e këtyre njësive ligjvënësi kushtetues ka përcaktuar se ato kontrollohen nga Këshilli i Ministrave, i cili cakton prefektin si përfaqësuesin e tij në qark<sup>366</sup> dhe se mund të marrë edhe masën ekstreme të shkarkimit apo shpërndarjes së njësive vendore, mundësi kjo e Këshillit të Ministrave që rregullohet nga neni 115 i Kushtetutës.<sup>367</sup>

<sup>363</sup> Sadushi, Sokol, "Drejtësia kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq.622-623.

<sup>364</sup> Traja, Kristaq, "Procesi i rregullt ligjor", Revista "Studime Juridike", nr.1 i vitit 2005, botim i Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Shtëpia Botuese "Adelprint", Tiranë 2005, fq.78.

<sup>365</sup> Kushtetuta, neni 13.

<sup>366</sup> Kushtetuta, neni 114.

<sup>367</sup> Kushtetuta, neni 115: *1. Organi i zgjedhur drejtpërdrejt i njësive qeverisëse vendore mund të shpërndahet ose të shkarkohet nga Këshilli i Ministrave për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve. 2. Organi i shpërndarë ose i shkarkuar mund të ankohet në Gjykatën Kushtetuese brenda 15 ditëve; dhe në këtë rast vendimi i Këshillit të Ministrave pezullohet. 3. Në rastin e mosushtrimit të së drejtës së ankimit brenda 15 ditëve, ose në rastin e lënies në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nga Gjykata Kushtetuese, Presidenti i Republikës cakton datën e zgjedhjeve në njësine vendore përkatëse.*

Kjo kompetencë është një ndërhyrje e pastër e Këshillit të Ministrave në qeverisjen vendore, madje nuk mund të mos vihet në dukje që këtu ka një problem në lidhje me parime e koncepte të rëndësishme të organizimit të një shteti. Një organ i zgjedhur drejtpërdrejt ka gjithmonë më shumë legjitimitet se një organ i zgjedhur nga organe të tjera të cilat janë ose jo të zgjedhura drejtpërdrejt nga populli. Në këtë këndvështrim, organet e qeverisjes vendore të zgjedhura drejtpërdrejt gëzojnë shumë më tepër legjitimitet se Këshilli i Ministrave, i cili zgjidhet në mënyrë të përzier nga Presidenti dhe Kuvendi. Duket se Kushtetuta pavarësisht se pranon decentralizmin, për hir të unitetit të vendit dhe një qëndrimi të njëjtë të qeverisjes qendrore me atë vendore, ka pranuar edhe të “deformojë” parimin e ushtrimit të sovranitetit duke na lënë të mendojmë se jo gjithmonë sovraniteti i drejtpërdrejtë është më legjitimi.<sup>368</sup>

Pavarësisht kësaj mundësie të Këshillit të Ministrave, duke respektuar parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, por edhe në mënyrë që edhe kjo kompetencë e ekzekutivit të mos kthehet në një mjet abuziv, Kushtetuta jonë duke ndjekur edhe modele të tjera<sup>369</sup> parashikon mundësinë e organeve vendore për t’u ankuar në Gjykatën Kushtetuese. Kjo bëhet me qëllim që që t’u japë garanci më të mëdha në ushtrimin e detyrës këtyre organeve.<sup>370</sup> Në fakt në këtë rast kemi të bëjmë me një kompetencë të veçantë, pasi Gjykata Kushtetuese si organ kontrolli për të çmuar shkëljen e rëndë të Kushtetutës apo ligjit heton dhe gjykon në themel çështjen, ashtu siç do vepronte një gjykatë e sistemit gjyqësor të zakonshëm.<sup>371</sup>

Neni 115 i Kushtetutës cituar më sipër parashikon mundësinë e Këshillit të Ministrave për të shkarkuar ose shpërndarë vetëm organet e zgjedhura në mënyrë të drejtpërdrejtë. Referuar nenit 109 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, rezulton se organet e zgjedhura në mënyrë të drejtpërdrejtë janë organi ekzekutiv (kryetari) dhe organi përfaqësues (këshilli), i njësive bazë të qeverisjes vendore (Bashkia ose Komuna). Do të kemi shkarkim të organit vetëm në rastin e organeve ekzekutive, pra të kryetarit të bashkisë/komunës, pasi është organ monokratik me natyrë ekzekutive. Në rastin e këshillave bashkiakë/komunale të cilat janë organe kolegjiale dhe me natyrë përfaqësuese, ndaj tyre zbatohet vetëm masa e shpërndarjes.

Nga kjo analizë rezulton se qarqet, si njësi të nivelit të dytë të qeverisjes vendore janë të përjashtuara nga procedura disiplinore që mund të ushtrojë ndaj tyre Këshilli i Ministrave. Për rrjedhojë të vetmet akte të Këshillit të Ministrave që mund të bëhen objekt kontrolli në një gjykim kushtetues janë vendimi i shkarkimit të kryetarit të bashkisë/komunës apo i shpërndarjes së këshillit të bashkisë/komunës. Këto janë akte administrative me natyrë individuale, kushtetutshmëria dhe ligjshmëria e të cilëve shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese. Ky është një rast i veçantë dhe përjashtim nga rregulli për gjykimin kushtetues, sipas të cilit në këtë lloj gjykimi gjykohen vetëm akte normative. Ky përjashtim, i cili është bërë në mënyrë të shprehur nga vetë kushtetutbërësi, ka si qëllim që të garantojë pavarësinë e këtyre organeve.

Përsa i përket qarqeve Këshilli i Ministrave nuk mundet që ta shpërndajë organin e saj, këshillin. Në këtë rast nëse nga ana e këshillit të qarkut ka shkëlje kushtetuese apo ligjore me pasoja të rënda atëherë janë vetë këshillat bashkiakë/komunalë që duhet të veprojnë duke revokuar përfaqësuesit e tyre në qark. Në rast se nuk veprohet prej këtyre këshillave atëherë

<sup>368</sup> Zaganjori, Xhezair; Anastasi, Aurela; Çani, Eralda; “Shteti i së drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”, Shtëpia Botuese “Adelprint”, Tiranë 2011, fq.283

<sup>369</sup> Crnic, Jadanko, “What rights can be duly protected by a constitutional complaint”, botuar në “The protection of fundamental rights by the constitutional court”, Koleksioni “Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15”, botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998, fq. 72.

<sup>370</sup> Vendimi nr. 15, datë 08.06.2009 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>371</sup> Vendimet nr.37, datë 29.12.2005, nr.39, datë 29.12.2005, nr.22, datë 7.10.2008, nr.15, datë 8.6.2009, nr.29, datë 27.06.2013 të Gjykatës Kushtetuese.

mundet që Këshilli i Ministrave të shpërndajë këshillat e bashkive/komunave që janë pjesë e qarkut (ku shkelja e rëndë do të konsiderohej mosveprimi i tyre) si edhe shkarkimin e kryetarve të bashkive/komuna që përbëjnë qarkun, duke qenë se ato për shkak të parashikimeve kushtetuese janë pjesë e këshillit të qarkut. Duke vepruar në këtë mënyrë shkarkimi dhe shpërndarja e organeve të zgjedhura drejtpërsëdrejti, do të sillte vetiu edhe rënien e këshillit të qarkut pasi anëtarët e saj nuk do të gëzonin mandatet si kryetar apo këshilltar në bashki/komuna dhe për rrjedhojë nuk mundet që të jenë anëtar të qarkut pasi nuk kanë më tagra përfaqësimi.

Sidoqoftë, në një rast hipotetik, nëse Këshilli i Ministrave do të vepronte për shpërndarjen e këshillit të qarkut, atëherë ky akt do të bëhej objekt gjykimi në gjykatat e zakonshme<sup>372</sup> por jo pjesë e një gjykimi kushtetues, pasi referuar përmbajtjes së nenit 115 të Kushtetutës, qartësisht në këtë rast Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për zgjidhjen e saj.

Një tjetër element në këtë procedurë e cila nuk mundet që të kontrollohet nga Gjykata Kushtetuese është edhe diskrecioni i Këshillit të Ministrave për të shkarkuar apo shpërndarë organin e zgjedhur drejtpërsëdrejti. Kështu nga përmbajtja e nenit 115 të Kushtetutës rezulton se dispozita përdor termin “mund”.<sup>373</sup> Përdorimi i këtij termi do të thotë se Këshilli i Ministrave nuk është i detyruar në çdo rast që të procedojë menjëherë për shkarkimin apo shpërndarjen e këtyre organeve, por ai vlerëson rast pas rasti dobishmërinë e një mase të tillë. Ky interpretim i normës kushtetuese është konsoliduar edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese e cila ka mbajtur këtë qëndrim:

*Detyra e kësaj Gjykate është të vlerësojë nëse shkakun që ka shërbyer për shkarkimin nga detyra të organit të zgjedhur të qeverisjes vendore, përbën ose jo shkelje të rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve, dhe jo oportunitetin e masës së marrë. Të drejtën për të vlerësuar marrjen ose jo të masës së shkarkimit nga detyra, kur janë të pranishme kushtet e përcaktuara në nenin 115 të Kushtetutës, kushtetutëbërësi e ka lënë në çmimin e Këshillit të Ministrave kur shprehet se ky i fundit mund të shpërndajë ose të shkarkojë organin e zgjedhur drejtpërdrejt të qeverisjes vendore, për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve.*<sup>374</sup>

Nga pasazhi i mësipërm rezulton se nuk është objekt i kontrollit kushtetues fakti nëse Këshilli i Ministrave duhej apo jo të kishte ndërhyrë për shkarkimin apo shpërndarjen e një organi vendor, pasi qartësisht përdorimi i termit “mund” nga dispozita kushtetuese e nxjerr këtë çështje jashtë juridiksionit kushtetues.

## KONKLUZIONE.

Parimet që përshkrojnë procesin kushtetues janë të një rëndësie të veçantë. Ato drejtojnë procesin kushtetues brenda vlerave të rëndësishme. Shumë prej këtyre parimeve megjithëse nuk janë përpunuar nga jurisprudenca kushtetuese, zbatohen prej saj në mënyrë të vetëdijshme dhe të përherëshme. Kështu për parimin e kolegjalitetit deri më sot Gjykata Kushtetuese nuk është se ka

<sup>372</sup> Normalisht një gjykim i tillë do të sillte si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit të Këshillit të Ministrave bazuar në nenin 116, gërma “b” të K.Pr.A., duke qenë se ky organ nuk ka kompetencë që të shpërndajë këshillin e qarkut.

<sup>373</sup> Neni 115, pika 1 e Kushtetutës: *Organin e zgjedhur drejtpërdrejt i njësisë qeverisëse vendore mund të shpërndahet ose të shkarkohet nga Këshilli i Ministrave për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve.*

<sup>374</sup> Vendimi nr.37, datë 25.7.2013 i Gjykatës Kushtetuese, parag.34.



bërë një përpunim jurisprudencial dhe doktrinor të tij. Por nga ana tjetër në çdo fazë të vendimmarrjes së saj Gjykata Kushtetuese udhëhiqet nga ky parim. Kështu ajo vendos me trupa gjyqësore si në Kolegi, në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe në seancë plenare. Por specializimi gjithmonë e më i madh që kërkohet në fusha të ndryshme të së drejtës duket sikur e vë në diskutim këtë parim. Kjo pasi është e kuptueshme që njohja e thelluar në fusha të së drejtës kërkon edhe profesionistë të specializuar. Kjo sjell një problematikë në vendimmarrjen kolegjiale pasi gjyqtarët e tjerë të cilët janë të specializuar në fusha të tjera janë në një farë mënyrë të lidhur me mendimin e gjyqtarit të specializuar për atë fushë. Ky fakt duket sikur përforcohet më tej edhe nga mënyra e caktimit të relatorit të çështjes, mbi bazën e diskrecionit të Kryetarit të Gjykatës, i cili normalisht do t'i ngarkojë çështjen pikërisht gjyqtarit i cili ka profilin e njëjtë ose të përafërt me natyrën e çështjes së paraqitur në gjykim. Por nga ana tjetër shmangia e përvojave të ndryshme nuk është një rrugëzgjdhje. Kështu nuk mundet që të kemi luksin në emërimin si gjyqtarë kushtetues vetëm të personave me një profil apo specializim të caktuar. Është e kuptueshme që diversiteti në këtë rast ka përparësitë e veta dhe ndihmon në zhvillimin e jurisprudencës kushtetuese. Për këtë arsye është e këshillueshme që caktimi i çështjeve, të bëhet në mënyrë të rregullt tek të gjithë gjyqtarët, pavarësisht fushës së specializimit të tyre. Kjo do të ndihmojë që gjyqtarët kushtetues të ambjentohen më një shumëllojshmëri çështjesh dhe të jenë më pak të varur nga mendimi që ka gjyqtari i specializuar për atë lloj çështje. Nga ana tjetër kjo mundësi veprimi nuk e përjashton kontributin e gjyqtarit të specializuar i cili do të japë mendimin dhe sugjerimet e tij gjatë diskutimeve midis kolegëve në marrjen e vendimit përfundimtar.

Parimi i publicitetit, si një parim i rëndësishëm synon që të garantojë transparencën në vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese dhe të rrisë besimin e publikut për këtë institucion. Ky parim merr një rëndësi të posaçme kohët e fundit për shkak të rritjes së përdorimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të gjykimit mbi bazë dokumentash. Për këtë arsye është e këshillueshme, duke e lidhur edhe me parimin e publikimit të vendimeve, që në këto raste, Gjykata Kushtetuese, menjëherë pas marrjes së vendimit, pavarësisht se ai nuk është arsyetuar ende, të shpallë dispozitivin e vendimit për t'u bërë me dije pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues disponimin e saj mbi çështjen. Këtë mënyrë veprimi Gjykata, e ka përdorur për disa lloje gjykimesh, zakonisht për kërkesat për kontroll incidental nga gjykata e zakonshme ose për kërkesat që vijnë nga subjektet kërkuese që kanë edhe natyrë politike. Është mirë që një praktikë e tillë të ndiqet edhe për gjykimet e tjera.

Përdorimi i gjuhës shqipe, përveçse detyrimit kushtetues dhe kombëtar ndihmon në rritjen e aksesit të individëve për mbrojtjen e të drejtave të tyre pranë kësaj gjykate. Por krahas këtyre momenteve, përdorimi i gjuhës shqipe ndihmon edhe në zhvillimin e gjuhës juridike të vendit. Duhet të kemi në konsideratë faktin se cilësia e arsyetimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është nga më të lartat në vend dhe që duhet të ndiqet si shembull edhe nga gjykatat e tjera.

Njëkohësisht si parim i rëndësishëm është edhe mbrojtja në gjykimin kushtetues. Në përgjithësi zgjedhja e një përfaqësuesi të specializuar në këtë fushë rrit shanset për sukses të kërkesës që paraqitet për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese. Por duhet pranuar që sigurimi i këtij përfaqësuesi është njëkohësisht edhe e kushtueshme. Për këtë arsye LGJK ka përzgjedhur edhe rrugën tjetër, atë të mbrojtjes nga vetë kërkuesi. Është e kuptueshme që në këto raste Gjykata Kushtetuese duhet të jetë më tolerante në shqyrtimin e kërkesave të individëve që mbrohen vetë dhe të cilët nuk gëzojnë, si rregull, aftësinë e duhur artikuluese për të parashtruar argumentat në



formën e duhur. Në këto raste Gjykata Kushtetuese duhet që të udhëhiqet nga interesi për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individit.

Gjykata Kushtetuese duhet që në mënyrë të padiskutueshme të ofrojë garancitë gjatë veprimtarisë së saj. Një nga këto garanci është edhe ushtrimi i funksioneve nga gjyqtarët kushtetues në mënyrë të paanshme. Ky parim merr një rëndësi të jashtëzakonshme për gjykimin kushtetues. Duke qenë se shpesh herë, kësaj Gjykate i kërkohet që të gjykojë edhe çështje që kanë një qasje të fortë politike, e vetmja mënyrë që ajo të ruajë imazhin e saj është që të sillet në mënyrë të paanshme. Në përgjithësi Gjykata e ka respektuar me korrektësi këtë parim, madje duke vënë në diskutim edhe vendimmarrjen e saj për shkak të mbetjes së saj me 8 anëtarë. Vetëm në raste ekstreme nga ana e saj është refuzuar kërkesa për përjashtimin e disa gjyqtarëve kushtetues, kur numri i atyre që kërkohet të përjashtoheshin vinte në diskutim funksionimin e vetë Gjykatës Kushtetuese. Në këtë rast ajo i ka dhënë përparësi parimit të funksionalitetit.

Parimi tjetër, i njohjes së ligjit nga Gjykata, ka në thelb të tij lirinë e veprimit të Gjykatës Kushtetuese. Pra, Gjykata në asnjë rast nuk e konsideron vetën të lidhur me përcaktimet që pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues u bëjnë fakteve apo normave juridike. Ajo që duhet theksuar është se Gjykata Kushtetuese devijimin nga përcaktimet e palëve e ka bërë rrallë. Kjo mënyrë e të vepruarit lidhet me ruajtjen e parimit të paanshmërisë nga ana e vetë Gjykatës Kushtetuese.

Parimi i disponibilitetit është një parim shumë delikat. Siç e kemi theksuar edhe më sipër Gjykata Kushtetuese, megjithëse si rregull kufizohet nga pretendimet e ngritura nga pjesëmarrësit, ka mundësinë që të dalë edhe tej këtyre kërtimeve dhe të kontrollojë kushtetueshmërinë e normave të tjera. Gjykata këtë mjet e ka përdorur për të kontrolluar akte të cilat kanë pasur fuqi juridike më të ulët ose të njëjtë me aktin që ishte objekt shqyrtimi. Madje në disa raste e ka përdorur edhe për të shfuqizuar akte të cilat kanë qenë më të vonshme në kohë në raport me aktin objekt gjykimi. Kjo mundësi ka përparësitë e veta, pasi lejon një ekonomi gjyqësore duke shmangur mbingarkesën e Gjykatës Kushtetuese me çështje të ngjashme. Nga ana tjetër mundëson edhe një eliminim më të shpejtë të normave të cilat çenojnë rendin kushtetues, duke garantuar në këtë mënyrë këtë rend dhe parimin e sigurisë juridike. Por nga ana tjetër përdorimi i tepërt i kësaj mundësie sjell edhe një ndërhyrje jo proporcionale të Gjykatës Kushtetuese mbi pushtetin legjislativ. Në përgjithësi përdorimi i kësaj mundësie nga Gjykata Kushtetuese ka qenë i kufizuar dhe korrekt.

Juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese nuk është një juridiksion i përgjithshëm. Megjithëse mund të duket shumë i larmishëm ai është i kufizuar vetëm në disa gjykime specifike të përcaktuara shprehimisht nga normat kushtetuese. Synimi i këtij juridiksioni është që të mbrojë supremacinë e Kushtetutës dhe sferën e veprimit të të drejtave dhe lirive themelore të individëve. Kufijtë e juridiksionit përcaktojnë njëkohësisht edhe objektin e gjykimit në procesin kushtetues. Shpesh herë ky objekt gjykimi del i qartë ndërsa në disa raste i nënkuptuar, siç është rasti për kontrollin kushtetues të ndryshimeve kushtetuese.

Duke iu referuar mundësisë që ka Gjykata Kushtetuese për të bërë interpretimin përfundimtar të normave kushtetuese, jam i mendimit se ky lloj gjykimi nuk duhet që të ekzistojë. Kështu Gjykata Kushtetuese nuk mundet që të bëjë një interpretim abstrakt të normave kushtetuese pa e lidhur atë me një mosmarrëveshje apo çështje konkrete. Kjo i heq mundësinë Gjykatës Kushtetuese që të analizojë mënyrën e zbatimit të normës në praktikë. Duket se është kjo arsyeja themelore se përse Gjykata Kushtetuese, ndryshoi qëndrimin e saj duke kërkuar si kushte për të bërë interpretimin përfundimtar të një norme vetëm nëse ndodhet përpara një mosmarrëveshje konkrete midis pjesëmarrësve të ndryshëm për kuptimin e një norme të caktuar

kushtetuese. Duke qenë se Gjykata Kushtetuese mbajti këtë qëndrim, atëherë nuk ka asnjë kuptim që ta ruajë këtë gjykim si një gjykim të pavaruar nga gjykimet e tjera. Është me e saktë shkencërisht që Gjykata Kushtetuese të bëjë interpretimin përfundimtar të një norme kushtetuese në kuadër të një gjykimi tjetër që parashikohen nga normat kushtetuese, veçanërisht ato të nenit 131 të Kushtetutës. Vetë jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka treguar se kuptimi i normave kushtetuese është bërë më i qartë kur interpretimi i tyre është bërë në kuadër të një gjykimi kushtetues të mirëfilltë.

Kontrolli i amendamenteve kushtetuese, është një tjetër çështje e diskutueshme e juridiksionit kushtetues. Në përgjithësi mohohet që Gjykata Kushtetuese të këtë një juridiksion të tillë, për rrjedhojë edhe këto amendamente nuk mund të bëhen objekt gjykimi në procesin kushtetues. Megjithatë duket theksuar se Kushtetuta është ligji themelor i një vendi dhe mbi bazën e saj ndërtohet e gjithë superstruktura juridike e shtetit. Për ta mbajtur këtë strukturë sa më të qëndrueshme, vetë kushtetutat parashikojnë në përgjithësi norma procedurale të cilat e bëjnë ndryshimin e tyre të vështirë, por jo të pamundur. Themi jo të pamundur pasi kushtetutat në momente të caktuara kanë nevojë që të rishikohen me qëllim që t'i përshtaten kushteve të reja shoqërore që kalon një vend. Megjithatë këto ndryshime në asnjë rast nuk duhet që prekin atë pjesë të kushtetutës e cila konsiderohet si bërthama e saj. Këto dispozita ruajnë identitetin kushtetues të një vendi dhe në rast se ato do të ndryshohen atëherë kemi të bëjme me një kushtetutë re dhe jo me ndryshime kushtetuese normale.

Për të ruajtur bërthamën e kushtetutës shumica e vendeve i kanë njohur Gjykatës Kushtetuese (ose organeve të tjera që ushtrojnë juridiksion të ngjashëm) të drejtën për të kontrolluar nga pikëpamja procedurale por edhe materiale pajtueshmërinë e ndryshimeve kushtetuese me dispozitat që përbëjnë bërthamën e një kushtetute, pra me pjesën e pandryshueshme të saj.

Në Shqipëri, siç u përpoqëm ta trajtonim në këtë punim, Kushtetuta jonë megjithëse jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, parashikon parimet dhe dispozitat të cilat janë pjesa e pandryshueshme e saj. Kryesisht këto janë dispozitat e pjesës së parë dhe të dytë të Kushtetutës që trajtojnë parimet e përgjithshme të organizimit dhe funksionimit shtetëror, si dhe të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Përsëri po në mënyrë jo të drejtpërdrejtë Kushtetuta jonë i njeh të drejtën Gjykatës Kushtetuese që të ushtrojë një kontroll *aposteriori* mbi amendimet kushtetuese, në rast se ndonjë kërkesë e tillë paraqitet sipas rregullave përkatëse procedurale. Ky lloj gjykimi është i natyrës abstrakte dhe përgjithësisht zbatohen rregullat procedurale për kontrollin kushtetues ndaj ligjeve.

Ky lloj kontrolli ka vetëm një të metë, që në këndvështrimin tim, është e metë thelbësore. Në rast se Gjykata Kushtetuese shfuqizon një amendament kushtetues si në kundërshtim me parimet bazë të Kushtetutës, atëherë fusha përkatëse që rregullohej prej saj do të mbesë e parregulluar. Pra, do të kemi një boshllëk kushtetues, një ometim. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, i cili duhet që të respektoje funksionin e ligjvënësit negativ që Kushtetuta ja ka njohur Gjykatës, nuk mundet që të sjellë në fuqi normat juridike tashmë të shfuqizuara. Në këtë pikë do të duhej një konsensus midis forcave politike në Kuvend për të miratuar një tjetër amendament kushtetues në përputhje me vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese. Por për shkak të kuorumit të lartë vendimmarrës që kërkohet në Kuvend, të paktën dy të tretat e të gjithë anëtarëve, kjo shumicë edhe mundet që të mos arrihet menjëherë, ose në rastin më të keq të mos arrihet asnjëherë.

Përsa i përket kontrollit kushtetues të ligjeve, por edhe akteve të tjera normative me karakter nënligjor, rezulton se Gjykata Kushtetuese ka një juridiksion të plotë. Në fund të fundit

ushtrimi i këtij kontrolli është edhe qëllimi kryesor se përse lindi drejtësia kushtetuese e centralizuar. Objekt kontrolli në këto raste janë ligjet në fuqi, ligjet e shfuqizuara por që prodhojnë ende pasoja, aktet nënligjore normative të organeve kushtetuese si Këshilli i Ministrave, ministrave, institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta si edhe të njësisve të qeverisjes vendore me natyrë kushtetuese. Nuk janë objekt gjykimi aktet e institucioneve qendrore dhe vendore të cilat janë të krijuara me ligj. Ky përcaktim është mjaft i rëndësishëm pasi shërben edhe për të ndarë juridiksionin kushtetues nga juridiksioni gjyqësor administrativ.

Shqyrtimi i ometimit ligjor është një tjetër fushë në të cilën duket sikur po shtrihet juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese, mbas një periudhe mbylljeje në fillimet e saj. Megjithatë duhet theksuar se Gjykata Kushtetuese vetëm në një rast të izoluar ka pranuar të shfuqizojë një dispozitë ligjore për shkak të boshllëkut legjislativ. Në këtë rast ndodheshim përballë ometimit ligjor relativ. Mesa duket Gjykata Kushtetuese nuk ka kompetencën lëndore për të shqyrtuar një ometim ligjor absolut, duke pasur në konsideratë dhe faktin se ajo nuk ka asnjë mjet për të detyruar ligjvënësin për të miratuar një ligj.

Objekt kontrolli janë gjithashtu edhe marrëveshjet ndërkombëtare. Synimi i këtij kontrolli është ruajtja e supremacisë së Kushtetutës mbi të drejtën ndërkombëtare. Kjo formë kontrolli siç është detajuar më sipër, mund të jetë paraprake për marrëveshjet që ratifikon vendi ynë, si edhe represive për marrëveshjet të cilat janë ratifikuar përpara hyrjes në fuqi të Kushtetutës nga ana e Shtetit Shqiptar. Janë jashtë këtij kontrolli normat zakonore ndërkombëtare dhe marrëveshjet ndërkombëtare të cilat miratohen nga Këshilli i Ministrave dhe nuk i nënshtrohen procesit të ratifikimit. Ky lloj gjykimi është përdorur mjaft rrallë. Kjo lidhet shpesh herë me qëndrimin tonë për të pranuar gjithçka të huaj dhe me mentalitetin për të mos e kundërshtuar ratifikimin e këtyre marrëveshjeve pasi do të konsiderohej si kundër proceseve integruese. Por në këtë rast duhet të merret në konsideratë fakti që ky lloj gjykimi ka si qëllim mbrojtjen e aktit themelor të vendit si një nga vlerat më të rëndësishme. Për më tepër një lloj gjykimi i tillë padiskutim do e shmangte Shtetin Shqiptar nga situata të sikletshme nëse në të ardhmen do të rezultonte se një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar është në kundërshtim me ligjin themelor të vendit.

Po kështu sistemi shtetëror i përzgjedhur nga Kushtetuta jonë lë vend për krijimin e situatave ku mund të gjendemi përballë një mosmarrëveshje kompetencash. Ekzistenca e organeve të ndryshme kushtetuese të ndara nga njëri – tjetri, por me pika kontakti midis tyre ofron gjithmonë një mundësi që të ndodhemi përballë një situatë të tillë, ku një organ mund të tejkalojë kompetencat e tij dhe për pasojë të çënojë fushën e veprimtarisë së një organi tjetër.

Për të shmangur këtë situatë të papëlqyeshme në Kushtetutë dhe në akte të tjera ligjore është përcaktuar organi dhe mekanizimi i duhur procedural përkatës. Në jurisprudencën e saj Gjykata Kushtetuese ka përpunuar si nga pikëpamja doktrimore dhe jurisprudenciale shkaqet, rastet, palët, si edhe shumë elementë të tjerë proceduralë që lidhen më këtë lloj gjykimi të posaçëm. Kontributi i saj në këtë drejtim është vërtet domethënës. Ky lloj gjykimi nxjerr në pah edhe rolin delikat të Gjykatës Kushtetuese në ruajtjen e ekuilibrave midis pushteteve kushtetuese, ekuilibër ky, mese i domosdoshëm për mirëfunksionimin e të gjithë strukturës shtetërore në përgjithësi. Është e kuptueshme që kjo temë nuk mundet që të sqarohet në mënyrë shteruese, të gjithë problematikën, megjithatë disa përfundime mund të nxirren. Këto përfundime konsistojnë në faktin që mosmarrëveshja e kompetencave, mund të ketë si shkak çdo akt ligjor, nënligjor, veprim apo mosveprim të organeve shtetërore të njohura nga Kushtetuta. I vetmi institucion që mund të zgjidhë këtë mosmarrëveshje është vetëm Gjykata Kushtetuese. Subjektet që mund ta venë në lëvizje këtë Gjykatë janë vetëm ato organe/institucione të njohura nga Kushtetuta dhe kompetenca, shkak i mosmarrëveshjes duhet të jetë me natyrë kushtetuese. Në gjykim duhet të



thirren edhe organet që me aktet e tyre kanë shkaktuar mosmarrëveshje kompetencash midis organeve të ndryshme, pavarësisht se nuk janë përfshirë drejtpërsëdrejti në konflikt.

Objekt gjykimi tjetër në Gjykatën Kushtetuese janë edhe një sërë aktesh që sipas rastit kanë të bëjnë me zgjedhjen, papajtueshmërinë, shkarkimin, apo verifikimin e zgjedhjes së Presidentit, deputetëve, anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë. Objekt i këtij gjykimi janë vendimet e KQZ por shpesh herë vendimi objekt gjykimi është vendimi i Kuvendit. Qëllimi i këtij juridiksioni të Gjykatës Kushtetuese është që të garantojë një përfaqësim kushtetues të sovranitetit popullor si edhe të garantojë pavarësinë e institucioneve të rëndësishme me karakter kushtetues.

Në kuadër të këtij qëllimi duhet kuptuar edhe juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese për të kontrolluar vendimet e Këshillit të Ministrave për shpërndarjen apo shkarkimin e organeve vendore të zgjedhura drejtpërsëdrejti. Synimi në këtë rast është që të garantojë që organet përfaqësuese vendore të mos eliminohen në mënyrë abuzive nga Këshilli i Ministrave, si organi përfaqësues tipik i pushtetit ekzekutiv.

Objekt gjykimi janë edhe aktet administrative, gjyqësore dhe arbitrazhit të cilët kundërshtohen nga individët në kuadër të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Ky ankim, megjithëse jo i parashikuar në fillesat e drejtësisë kushtetuese, po merr rol gjithmonë e më të madh në zhvillimin e jurisprudencës kushtetuese dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Sistemi shqiptar këtë mjet ankimor e ka kufizuar vetëm në mbrojtjen e një të drejte, atë për proces të rregullt ligjor, duke përjashtuar mbrojtjen e të drejtave të tjera kushtetuese nëpërmjet ankimit individual. Ky parashikim ka anën pozitive pasi mundëson mbajtjen nën kontroll të ngarkesës në Gjykatën Kushtetuese, por nga ana tjetër kufizon garancitë kushtetuese për individin. Për më tepër Gjykata Kushtetuese e ka kufizuar përgjithësisht këtë ankim vetëm në aspektet procedurale të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Por në disa raste objekt gjykimi, në këtë lloj procesi, janë bërë edhe akte me karakter normativ, duke zbatuar në këtë mënyrë edhe procesin e rregullt ligjor substancial. Por këto janë raste të izoluara në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.



## KREU III

### PJESËMARRËSIT NË GJYKIMIN KUSHTETUES

#### Hyrje.

Gjykimi kushtetues është një gjykim kontradiktor dhe si i tillë ai zhvillohet midis palëve të ndryshme, të cilat LGJK i ka quajtur si pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues. Referencën e parë për pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues e gjejmë në formulimin që kanë gërmat “a” dhe “b” të nenit 28, pika 1 të LGJK-së, nga ku rezulton se këto palë titullohen *kërkuesi* dhe *subjektet e interesuara*. Më tej në nenin 39 të LGJK-së jepet një pasqyrë më e plotë në lidhje me kuptimin e termit “kërkues” dhe “subjekte të interesuara”.<sup>375</sup> Nga përmbajtja e kësaj dispozite shohim si pjesëmarrës në gjykimin kushtetues kërkuesin i cili konsiderohet pala që ka paraqitur kërkesën, ndërsa subjekte të interesuara janë subjektet kundër të cilëve është paraqitur kërkesa, subjektet që kanë interes të drejtpërdrejtë për çështjen që shqyrtohet, organi që ka nxjerrë aktin dhe organet shtetërore që janë në mosmarrëveshje kompetence. Ndërsa pikat 2, 3 dhe 4 të kësaj dispozite rregullojnë problemin e përfaqësimit të pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues. Më tej po vijojmë me një analizë më të detajuar për secilin prej këtyre pjesëmarrësve.

#### 1. Kërkuesi.

Neni 28 dhe neni 39 i LGJK-së kufizohen vetëm në përcaktimin e kësaj pale si “kërkues”, pra, si subjekt i cili ka paraqitur kërkesën në Gjykatën Kushtetuese duke e vënë në lëvizje atë dhe tërë mekanizmin procedural. Në fakt këto janë dy dispozita që në radhë të parë të referojnë në ligjin themelor të vendit, në Kushtetutë, ku përcaktohen subjektet të cilat kanë zotësinë juridike për të inicuar një proces kushtetues.

Të tilla subjekte janë të përcaktuara në nenin 134 të Kushtetutës dhe janë a) Presidenti; b) Kryeministri; c) jo më pak se një e pesta e deputetëve; ç) Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit; d) çdo gjykatë; dh) Avokati i Popullit; e) organet e qeverisjes vendore; ë) organet e bashkësive fetare; f) partitë politike dhe organizata të tjera; g) individët. Përveç këtyre subjekteve në Kushtetutë për kategori të caktuara gjykimesh kushtetuese gjejmë edhe subjekte të tjera si Kuvendi në raste të procedurave *impeachment* ndaj Presidentit, gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, gjykimet mbi papajtueshmërinë e mandatit të deputetëve dhe Presidentit etj. Subjekt tjetër i përmendur nga Kushtetuta është edhe Këshilli i Ministrave në rastin e kontrollit të pajtueshmërisë me Kushtetutën të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute. Po kështu një tjetër subjekt është edhe Prokurori i Përgjithshëm i cili vë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar rastet e arrestimit në flagrancë të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

<sup>375</sup> LGJK, neni 39: 1. Pjesëmarrës në gjykimin kushtetues janë: a) Subjekti që ka paraqitur kërkesën ose përfaqësuesi i tij. b) Subjektet kundër të cilëve është paraqitur kërkesa ose që kanë interes të drejtpërdrejtë për çështjen që shqyrtohet. c) Organi që ka nxjerrë aktin. ç) Organet shtetërore që janë në mosmarrëveshje për kompetencë. 2. Në rastet kur pjesëmarrës në gjykimin kushtetues janë organe shtetërore, ato përfaqësohen nga drejtuesit e tyre dhe në mungesë nga persona të autorizuar me shkrim. 3. Përfaqësues të pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues mund të jenë avokatët, të cilët pajisen me prokurë ose caktohen si të tillë me deklaram në seancë plenare. 4. Dhoma Kombëtare e Avokatisë cakton listën e avokatëve që mund të marrin pjesë në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën Kushtetuese.

Zotësia juridike e këtyre subjekteve për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese përcaktohet nga fakti se janë parashikuar si të tillë nga vetë Kushtetuta, pra kanë fituar personalitet juridik kushtetues. Gjithsesi vetë Kushtetuta përmban kritere të shprehura ose të nënkuptuara mbi bazën e të cilave këto subjekte mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Kështu, Kuvendi, Këshilli i Ministrave dhe Prokurori i Përgjithshëm janë subjekte të kushtezuara. Ato mund ta vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese vetëm në raste dhe për gjykime të përcaktuara në mënyrë të shprehur në Kushtetutë.

Për sa i përket subjekteve që parashikon neni 134 i Kushtetutës, ato mund t'i ndajmë në disa kategori. Nga mënyra se si është formular dispozita kushtetuese, rezulton se kemi disa kategori subjektesh dhe më konkretisht subjektet e pakushtëzuar, subjektet e kushtëzuar, gjykatat dhe individët. Le t'i analizojmë me rradhë.

## **2. Subjektet e pakushtëzuar.**

Subjektet e pakushtëzuara sipas Kushtetutës janë, Presidenti i Republikës, Kryeministri, jo më pak se një e pesta e deputetëve dhe Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit. Konsiderohen si subjekte të pakushtëzuara, pasi mbrojnë një interes publik dhe për rrjedhojë nuk kanë asnjë arsye për të justifikuar një interes vetjak për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues. Për më tepër, këto subjekte janë të legjitimuar për të ngritur pretendime si për të metat procedurale ashtu edhe për të metat materiale që mund të ketë ligji objekt gjykimi

Pavarësisht kësaj mundësie rezulton se Presidenti i Republikës e ka vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për të kërkuar interpretimin e normave kushtetuese, si edhe për të kundërshtuar ligje apo akte të Kuvendit të cilat i kanë prekur në këndvështrimin e tij, kompetencat kushtetuese të Presidentit. Megjithatë LGJK për disa lloje gjykimesh nuk e parashikon Presidentin si një subjekt për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Kështu për sa i përket kërkesave për të kontrolluar zgjedhjen e Presidentit të Republikës LGJK parashikon nga tërësia e subjekteve kushtetuese vetëm dy të tillë, jo më pak se një e pesta e deputetëve dhe partitë politike.<sup>376</sup> Përjashtimi i Presidentit të Republikës në detyrë, duket sikur është i justifikuar me faktin se ai është në fund të mandatit dhe kundërshtimi i zgjedhjes së pasardhësit të tij do të paraqiste një konflikt interesi të qartë. Personalisht nuk bashkohem me këtë qëndrim. Presidenti i Republikës që nga momenti që ka bërë betimin dhe për rrjedhojë ka filluar detyrën, e deri në ditën që mbaron mandatin, ka si detyrë funksionale të tij mbrojtjen e ligjit themelor të vendit. Për më tepër, Kushtetuta nuk parashikon asnjë kufizim të kompetencave të tij gjatë periudhës tranzitore midis zgjedhjes së Presidentit të ri dhe mbarimit të mandatit të Presidentit në detyrë. Në këtë rast pavarësisht se jemi përballë një gjykimi konkret, mbrojtja e kushtetutshmërisë për sa i përket zgjedhjes së kreut të shtetit i jep të drejtë Presidentit në detyrë që të kërkojë kontrollin e zgjedhshmërisë së Presidentit të ri.

Për sa i përket subjektit tjetër Kryeministrit, rezulton se pavarësisht karakterit të pakushtëzuar të tij, në praktikë e ka të vështirë që të shfaqet si një subjekt aktiv. Normalisht shumica e ligjeve që miratohen nga Kuvendi vijnë si rezultat i propozimeve që vijnë nga Këshilli i Ministrave. Për rrjedhojë Kryeministri mund të kundërshtojë vetëm ato ligje të cilat miratohen nga Kuvendi dhe që nuk kanë ardhur si nismë e Këshillit të Ministrave. Këtë duket sikur e sugjeron edhe jurisprudenca e deritanishme e Gjykatës Kushtetuese, në ato pak raste që është

<sup>376</sup> LGJK, neni 64, pika 1: *Për çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë e Presidentit të Republikës dhe për pajftueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të tij, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të jo më pak se një të pestës së deputetëve ose të partive politike.*

vënë në lëvizje nga Kryeministri.<sup>377</sup> Edhe kjo situatë përsëri shfaq disa problematika në planin politik, pasi një Kryeministër që është në "luftë" me Kuvendin për ligjet që miratohen prej tij, rezulton që të mos ketë më mbeshtetjen e shumicës së deputetëve. Për këtë arsye, kërkesat e këtij subjekti janë të pakta dhe kohët e fundit nuk rezultojnë që të jetë përdorur më. Edhe për këtë subjekt LGJK për disa lloje gjykimesh parashikon kufizime. Sipas LGJK edhe Kryeministri është subjekt i përjashtuar për të kërkuar kontrollin e zgjedhjes së Presidentit të Republikës. Bazuar në argumentat e dhëna më sipër për Presidentin në detyrë si edhe fakti se Kushtetuta e ka njohur si subjekt të pakushtëzuar jam i mendimit se edhe ky subjekt legjitimohet në këto raste.

Në lidhje me subjektin tjetër, jo më pak se një e pesta e deputetëve, rezultojnë se ka qenë subjekti me aktiv për kundërshtimin e akteve të ndryshme. Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese për këtë subjekt ka qenë e konsoliduar në legjitimitimin e pakushtëzuar me përjashtim të një rasti kur vendosi moslegjitimitimin e tij.<sup>378</sup> Ky vendim paraqet disa vështirësi për t'u analizuar, pasi është një vendim pa shumicë absolute të anëtarëve të saj, por ka një shumicë relative. Më konkretisht katër gjyqtarë u shprehën për moslegjitimitimin e këtij subjekti pasi ndodheshin përpara një mosmarrëveshje kompetencash dhe ky subjekt duhet që të ketë një nxitje për të vënë në lëvizje një gjykim të tillë kushtetues. Një gjyqtar megjithëse e konsideroi të sforcuar këtë arsyetim të kolegëve të tij përsëri shprehej për moslegjitimitimin të këtij subjekti, por për arsye të tjera. Kështu sipas tij, deputetët që i ishin drejtuar Gjykatës Kushtetuese, nuk kishin marrë pjesë në votimin që ishte zhvilluar në Kuvend dhe për rrjedhojë nuk mundej që ta ushtronin këtë të drejtë. Katër gjyqtarë të tjerë, por që mbetën në pakicë, u shprehën për legjitimitimin e subjektit.

Nisur nga ndarja e mësipërme e votimit në gjykatë po ndalemi në analizën e argumentave që kanë dhënë gjyqtarët kushtetues për moslegjitimitimin e këtij subjekti. Më konkretisht katër gjyqtarët që përbëjnë edhe shumicën relative të vendimmarrjes së Gjykatës u shprehën se:

*...Gjykata, duke iu referuar natyrës dhe thelbit të pretendimeve të parashtruara gjatë gjykimit, vëren se kërkuesi kërkon zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet një organi të pushtetit qendror, Kuvendit të Shqipërisë dhe një organi të qeverisjes vendore, Bashkisë Tiranë...*

*...Në rastin në shqyrtim, duke pasur parasysh pretendimet e kërkuetit, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk është as subjekt në konflikt e as subjekt i cenuar drejtpërdrejt nga konflikti. Në rastin konkret, grupi i deputetëve është përqëndruar në mbrojtjen e sferës së veprimtarisë së pushtetit vendor dhe jo të të drejtave të veta si pakicë parlamentare. Situata ku ndodhet kërkuesi nuk e legjitimon atë të kërkojë nga kjo Gjykatë zgjidhjen e një konflikti të mundshëm kompetencash. Kërkuesi duhet të paraqiste argumente që të provonin pretendimin se moszgjidhja ose ekzistenca e këtij konflikti ka sjellë mosfunksionimin ose pengimin e funksionimit normal të Kuvendit, pjesë e të cilit është kërkuesi, duke cenuar statusin e tij dhe rrjedhimisht ushtrimin e të drejtave dhe kompetencave të njohura nga Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit...*

*...Gjykata nuk e gjen të bazuar qëndrimin e kërkuetit se 1/5 e deputetëve nuk ka detyrim për të justifikuar interesin, sepse ka legjitimitet të pakushtëzuar. Gjykata vlerëson se 1/5 e deputetëve bën pjesë te subjektet e posaçme të parashikuara nga neni 134/1, shkronja "c" të Kushtetutës, por ky subjekt duhet të ketë një qëllim dhe nxitje*

<sup>377</sup> Vendimet nr.61, datë 22.11.1999, nr.171, datë 30.7.2002 dhe nr.212, datë 29.10.2002 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>378</sup> Vendimi nr.25, datë 8.5.2012 i Gjykatës Kushtetuese.

*konkrete për të kërkuar interpretimin e dispozitave të veçanta të Kushtetutës ose kontroll konkret të normës juridike, pasi e kundërta do t'i jepte kësaj Gjykate funksion këshillimor...*<sup>379</sup>

Nga analiza e mësipërme e këtyre pasazheve rezulton se Gjykata Kushtetuese, kërkesën e jo më pak se një të pestës së deputetëve që kishte për objekt shfuqizimin e një ligji, e ka interpretuar duke e nënkuptuar si një kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave midis pushtetit qendror, Kuvendit dhe pushtetit vendor, Bashkisë Tiranë. Sipas Gjykatës Kushtetuese, ky subjekt duhet që të ketë një interes vetjak në mënyrë që të legjitimohet për të kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave midis këtyre dy organeve. Pra të justifikojë cënimin e kompetencave të veta kushtetuese si pakicë parlamentare.

Qëndrimi tjetër i cili ishte edhe përcaktues në mënyrën e zgjidhjes së kësaj çështjeje që qëndrimi i një gjyqtari tjetër kushtetues, për të cilin megjithëse arsyetimi i mësipërm ishte i sforcuar<sup>380</sup> përsëri siç e përmendëm më sipër argumentonte moslegjitimimin e këtij subjekti por duke u bazuar në të tjera argumenta dhe më konkretisht:

*5. Siç rezulton nga materialet e administruara në seancë plenare, më datë 14.07.2011, kur ligji është diskutuar dhe miratuar në Kuvend, grupi parlamentar në të cilin bëjnë pjesë edhe deputetët që kanë nënshkruar kërkesën drejtuar kësaj Gjykate, kanë bojkotuar punimet e Kuvendit.*

*15. Në këtë kuptim është e domosdoshme të bëhet dallimi midis bojkotit si pjesë e luftës politike me bojkotin e institucioneve kushtetuese, në rastin konkret Kuvendit. Ndërsa e para është një praktike normale në veprimtarinë me karakter politik të partive politike, përkundrazi, bojkoti i Kuvendit për çfarëdolloj arsye është një praktikë antikushtetuese, e papramueshme për një shtet të së drejtës. Nga momenti i certifikimit të zgjedhjeve politike dhe konstituimit të Kuvendit pjesëmarrja e deputetëve në veprimtarinë ligjvënëse të tij është e detyrueshme në kuptimin kushtetues për të formuar atë që quhet "mandati kolektiv i parlamentit" si dhe vullnetin politik të zgjedhësve.*

*20. Nisur nga sa më sipër mendoj se në çështjen konkrete jo më pak se një e pesta e deputetëve nuk legjitimohen të vënë në lëvizje një gjykim kushtetues. Duke bojkotuar punimet e Kuvendit, ditën që do të merrej në shqyrtim ligji objekt kundërshtimi, në zbatim të një mandati detyrues që buron nga qenia e grupit të deputetëve anëtarë të një partie politike, ata kanë vepruar në kundërshtim me detyrimet kushtetuese dhe në këtë kuptim nuk mund të përfitojnë nga e drejta që ju njihet nën 134/1/c i Kushtetutës. Nuk mund të ketë dy standarde në qëndrimin ndaj Kushtetutës.*

*21. Në rrethanat e mësipërme kërkuarit mund t'i drejtoheshin kësaj Gjykate në kuadrin e germës "f", të nenit 134/1 të Kushtetutës, që i njihet të drejtën partive politike*

<sup>379</sup> Vendimi nr.25, datë 8.5.2012 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>380</sup> Mendimi paralel i gjyqtarit kushtetues Vladimir Kristo në vendimin nr.25, datë 8.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese, paragraf 2: *Jam i mendimit se kërkesa nuk ka për objekt konfliktin e kompetencave midis organeve të pushtetit qendror dhe atyre vendor por i referohet dispozitave konkrete të ligjit të sipërpërmendur që sipas kërkuarit bien ndesh me Kushtetutën. Pavarësisht nga përmbajtja e dispozitave në fjalë, Gjykata është e detyruar t'i japë përgjigje me vendim pretendimeve lidhur me papajtueshmërinë ose jo të tyre me Kushtetutën. Argumentet e shumicës për ta rrëzuar kërkesën me arsyet e mësipërme më duken të sforcuara.*



*për të iniciuar një gjykim kushtetues, me kusht që të argumentonin interesin e tyre për çështjen, detyrim ky që buron nga pika 2 e nenit 134 të Kushtetutës.*

Argumentat e mësipërm lidhen me qëndrimin politik që kishin mbajtur deputetët për të mos qenë të pranishëm në votimin që u zhvillua në Kuvend, pikërisht për miratimin e ligjit që u kundërshtua më pas si antikushtetues prej tyre. Ky qëndrim në këtë rast duket sikur do që të adresojë problematikën e bojkotit parlamentar që mund të bëhen nga grupe të ndryshme politike. Në këtë rast, po sipas këtij qëndrimi, këta deputetë e kanë humbur tagrin kushtetues për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese dhe mund të drejtoheshin vetëm si një tjetër subjekt, parti politike, por duke justifikuar interesin.

Qëndrimet e mësipërme më duken të gabuara. Kështu, përsa i përket qëndrimit të parë, nga objekti i kërkesë rezultoi se ky subjekt kishte kërkuar shfuqizimin e ligjit si antikushtetues. Fakti që një ligj, i kundërshtuar në formën e kontrollit abstrakt mund të sjelle edhe mosmarrëveshje kompetencash midis organeve të ndryshme, nuk është shkak për të moslegjitimuar këtë subjekt. Për më tepër, ky subjekt si mbartës i interesit publik, ka të drejtë që të mbrojë parimet e rëndësishme kushtetuese si shteti i së drejtës dhe ai i ndarjes dhe balancimit të pushtetit.

Në lidhje me qëndrimin tjetër, atë të moslegjitimitit për shkak të bojkotimit, rezultoi se në këtë rast, arsytimi ka shkuar në vlerësimin e konsideratave dhe qëndrimeve politike, e cila është jashtë misionit dhe juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese. Kushtetuta për asnjë moment nuk e lidh legjitimitimin e këtij grupi, me pjesëmarrjen në votim apo kryerjen e një veprimtarie tjetër. Akti themelor e lidh këtë të drejtë vetëm me qënien e këtyre individëve si deputetë të Kuvendit. Në këtë kontekst, nuk ka rëndësi fakti nëse këta deputetë kanë marrë apo jo pjesë në votim.

Megjithatë qëndrimi i mësipërm i Gjykatës Kushtetuese përbën një rast të izoluar, madje që në rastin më të parë vetë Gjykata Kushtetuese nuk e mori atë në konsideratë.<sup>381</sup> Këtë largim nga precedenti i saj i mëparshëm Gjykata Kushtetuese e bëri jo në mënyrë të shprehur por indirekt, duke argumentuar se ndodhej përpara rasteve të ndryshme.<sup>382</sup> Por në thelb, siç me të drejtë është konstatuar edhe nga një gjyqtar kushtetues në mendimin e tij paralel, Gjykata, duhej të shprehej qartazi për rrëzimin e precedentit të saj të mëparshëm.<sup>383</sup>

<sup>381</sup> Vendimi nr.5, datë 5.5.2014 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>382</sup> Po aty, parag.15: *Gjykata, në asnjë rast, nuk e ka vënë në dyshim legjitimitimin e një të pestës së deputetëve kur ata i janë drejtuar kësaj Gjykate për kontrollin abstrakt të normës juridike. Në këtë kuptim, referimi nga ana e subjektit të interesuar, Këshilli i Ministrave, në vendimin nr.25, datë 08.05.2012, të Gjykatës Kushtetuese, është i gabuar, pasi, në atë vendim, Gjykata ka marrë në shqyrtim kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të ligjit nr. 10 449, datë 14.7.2011 "Për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të kompleksit të ri parlamentar të Kuvendit të Shqipërisë", që kishte për objekt përcaktimin e rregullave dhe procedurave, të drejtat, detyrimet dhe afatet në dispozicion të institucioneve respektive për ndërtimin e kompleksit të ri parlamentar. Gjykata arriti në përfundimin se ndodhej përpara një mosmarrëveshjeje kompetencash ndërmjet një organi të pushtetit qendror, Kuvendit të Shqipërisë, dhe një organi të qeverisjes vendore, Bashkisë Tiranë, dhe, për këtë arsye, nuk e legjitimoi një të pestën e deputetëve.*

<sup>383</sup> Mendimi paralel i gjyqtarit kushtetues, Sokol Berberi, në vendimin nr.5, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese: *...nuk bie dakord me argumentin që ka dhënë shumica për të kundërshtuar pretendimin e subjektit të interesuar; Këshilli të Ministrave, për moslegjitimitimin e kërkuarit, referuar në vendimin nr. 25, datë 08.05.2012, të Gjykatës Kushtetuese (nr. 25/2012), në të cilin Gjykata ka kontrolluar kushtetutshmërinë e ligjit nr. 10 449, datë 14.7.2011 "Për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të kompleksit të ri parlamentar të Kuvendit të Shqipërisë"... Për arsyet e mësipërme, shumica duhet të ishte shprehur se nuk i qëndron standardit të mbajtur nga Gjykata në vendimin nr.25/2012, duke rikonfirmuar qëndrimin e konsoliduar në jurisprudencën e saj se, një e pesta e deputetëve përfaqëson një subjekt me legjitimitet të pakushtëzuar dhe, si i tillë, ka të drejtë të kërkojë kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve normative.*

Në lidhje me subjektin tjetër, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, rezulton që nga formulimi kushtetues edhe ky të jetë një subjekt i pakushtëzuar. Praktika e deritanishme ka treguar se ky subjekt e ka venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, vetëm dy herë dhe në ato raste kur ka pasur interesin e tij.<sup>384</sup> Pavarësisht parashikimit kushtetues, LGJK në disa raste e kufizon këtë mundësi të Kryetarit të KLSH për të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Në këtë këndvështrim duket i pajustificuar kufizimi që LGJK<sup>385</sup> i bën Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për të kontrolluar kushtetutshmërinë e partive apo organizatave politike, ndërkohë që subjektet e tjera të pakushtëzuara i njeh një legjitimitet të plotë për këtë lloj gjykimi. Në këtë situatë ligji duket sikur i është afruar, si koncept, rastit gjerman, duke e kufizuar vetëm në aktorët politike. Por Kryetari i KLSH, duke qenë një subjekt i pakushtëzuar i përcaktuar si i tillë nga Kushtetuta, nuk mundet që ligji të dalë kundër një parashikimi të tillë.<sup>386</sup>

Për më tepër, e drejta e Kryetarit të KLSH, për të venë në lëvizje një gjykim të tillë kushtetues, rezulton edhe nga natyra e këtij organi. Sipas neni 162, pika 1 të Kushtetutës, Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar. Për rrjedhojë është në detyrën e tij që të kontrollojë financat e partive politike. Në këtë pikë dëshirojmë të theksojmë se neni 9, pika 3 e Kushtetutës përcakton se burimet financiare të partive, si dhe shpenzimet e tyre bëhen kurdoherë publike. Sipas jurisprudencës kushtetuese lidhja e këtyre dy dispozitave (nenet 9, pika 3 dhe 162 pika 1) është evidente dhe sipas saj:

*...nga raportimi që Kontrolli i Lartë i Shtetit bën përpara Kuvendit lidhur me zbatimin e Buxhetit të Shtetit nga subjektet që kanë përfituar prej tij, ku përfshihen edhe partitë politike, buron edhe e drejta e këtij organi të specializuar, për të ushtruar kontrollin financiar mbi pjesën e buxhetit të partive që sigurohen nga fondet publike.<sup>387</sup>*

Duke qenë se në këtë rast KLSH ka të drejtën e kontrollit të mënyrës së përdorimit të fondeve që partitë politike përfitojnë nga buxheti i shtetit, atëherë nëse ky subjekt vëren përdorime të ndaluara dhe me qëllime antikushtetuese të këtyre fondeve, ka detyrimin kushtetues për të inicuar një gjykim kushtetues me qëllim deklarimin antikushtetues të veprimtarisë së partisë apo organizatës politike dhe për rrjedhojë ndalimin e mëtejshëm të kësaj veprimtarie.

Një tjetër rast të kufizimit të aksesit të këtij subjekti LGJK e parashikon edhe në rastin e zgjedhjes së Presidenit të Republikës. Megjithëse nuk mund të gjejmë argumenta bindëse për përfshirjen e tij në këtë proces për shkak edhe të natyrës së funksioneve të Kontrollit të Lartë të Shtetit që nuk kanë të bëjnë me zgjedhjen e Presidenit të Republikës, fakti që vetë Kushtetuta e ka përcaktuar atë si subjekt të pakushtëzuar rezulton që ligji nuk mundet që ta ndryshojë këtë parashikim.

Përsa i përket gjykimeve të tjera pavarësisht mendimit që ekziston në doktrinë se përsa i përket subjekteve të pakushtëzuara ato mund të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për të

<sup>384</sup> Vendimet nr.33, datë 9.5.2001 dhe nr.19, datë 3.5.2007 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>385</sup> LGJK, neni 57; *Për shqyrtimin e kushtetueshmërisë së partive dhe të organizatave të tjera politike, si dhe të veprimtarisë së tyre, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të Presidentit të Republikës, të Kryeministrit dhe të jo më pak se një të pestës së deputetëve.*

<sup>386</sup> Në vendimin nr.212, datë 29.10.2002, Gjykata Kushtetuese ndër të tjera është shprehur edhe se *...atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta nuk mund ta bëjë ligji...*Në këtë kontekst nëse vetë Kushtetuta nuk e ka përjashtuar mundësinë e subjekteve të tjerë të parashikuara nga neni 134, për të kërkuar kontrollin kushtetues të partive/organizatave politike, atëherë nuk mundet kurrësesi që ta bëjë ligji.

<sup>387</sup> Vendimi nr.33, datë 9.5.2001 i Gjykatës Kushtetuese

gjitha çështjet që përfshihen në juridiksionin e saj,<sup>388</sup> duke nënkuptuar të gjitha gjykimet me natyrë konkrete, personalisht jam i mendimit se në këto raste këto subjekte nuk janë gjithmonë të legjitimuara për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Secili prej këtyre subjekteve duhet që të justifikojë interesin e tij në rastin e gjykimeve të mosmarrëveshjeve të kompetencave dhe nuk mundet që të mbrojë interesat apo kompetencat e organeve të tjera kushtetuese.<sup>389</sup> E njëjta gjë mund të thuhet edhe për gjykimin kushtetues për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste është e kuptueshme që këto subjekte mund të jenë palë në një gjykim të tillë vetëm nëse e kanë pasur cilësinë procedurale të palës në gjykimet e zhvilluara pranë gjyqësorit të zakonshëm në të gjitha shkallët e tij. Në rast të kundërt ato nuk mundet që të iniciohen për të vënë në lëvizje një gjykim të tillë. Gjithashtu subjektet e pakushtëzuara nuk mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për çështje të cilat Kushtetuta ka përcaktuar vetë subjektin në mënyrë të shprehur si Kuvendi apo Këshilli i Ministrave.

### 3. Gjykatat.

Kushtetuta, në nenin 134, pika 1, gërma "d" të saj, ka parashikuar si subjekt të aftë për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese edhe gjykatat. Mundësia që gjykatat e zakonshme të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese është parashikuar për herë të parë në një amendim që i'u bë Kushtetutës Austriake në vitin 1929. Duhet theksuar se kjo e drejtë i'u njoh vetëm gjykatave më të larta të vendit,<sup>390</sup> model që u ruajt fillimisht edhe në vendet e tjera të Evropës Lindore kur u krijuan për herë të parë gjykatat kushtetuese.<sup>391</sup>

Gjykatat, si pushtet më vetë rregullohen nga pjesa e nëntë e Kushtetutës dhe konkretisht nenet 135 – 149. Më tej ky rregullim është detajuar dhe konkretizuar nga ligje të posaçme,<sup>392</sup> të cilat përcaktojnë organizimin dhe funksionimin e organeve të ndryshme që ushtrojnë pushtetin gjyqësor. Duke iu referuar këtij rregullimi, jurisprudencës kushtetuese shqiptare, por veçanërisht edhe jurisprudencës kushtetuese të huaj, rezulton se në konceptin "gjykatë" përfshihen: gjykatat e zakonshme, gjykatat e arbitrazhit, organet *quasi* gjyqësore si edhe vetë Gjykata Kushtetuese. Le t'i trajtojmë me radhë.

#### 3.1 Gjykatat e zakonshme.

Referuar dispozitave kushtetuese dhe atyre ligjore në fuqi, sistemi gjyqësor në Republikën e Shqipërisë ushtrohet nga gjykatat e përgjithshme të shkallës së parë dhe të apelit, gjykata për krimet e rënda të shkallës së parë dhe të apelit, gjykatat administrative të shkallës së parë dhe të apelit, si edhe Gjykata e Lartë. Kushtetuta në nenin 134, pika 1 gërma "d" e cila flet për gjykatat, si subjekt kërkues, rezulton që të jetë një dispozitë me natyrë referuese. Më

<sup>388</sup> Sadushi, Sokol. "Drejtësia Kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq.277

<sup>389</sup> Vendimi nr.29, datë 21.10.2009 i Gjykatës Kushtetuese dhe vendimi nr.34, datë 08.04.2011 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>390</sup> Schwartz, Herman. "The struggle for constitutional justice in post-communist Europe", Shtëpia Botuese "The University of Chicago Press", Chicago 2000, fq.33.

<sup>391</sup> Po aty, Polonia, fq.53, Bullgaria, fq.170.

<sup>392</sup> Ligji nr.8588, datë 15.3.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Ligji nr.9110, datë 24.7.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda", Ligji nr.9877, datë 18.2.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Ligji nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".



konkretisht ajo të referon në nenin 145, pika 2 Kushtetutës, dispozitë e cila përcakton kushtet procedurale mbi bazën e së cilës një gjykatë mundet që të verë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.

Duke i'u referuar terminologjisë së përdorur nga Kushtetuta rezulton se neni 134 përdor termin "gjykatë",<sup>393</sup> ndërsa neni 145 përdor termin "gjyqtarët",<sup>394</sup> si subjekte që mund të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Nga ana tjetër LGJK në nenin 68, pika 1 të saj përdor të dyja termat "gjykata" dhe "gjyqtari" si subjekte kushtetuese.<sup>395</sup> Terminologjia e ndryshme që përdoret në këto raste ndoshta mund të krijojë konfuzion në lidhje me faktin në çfarë mënyre mundet që gjykatat të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Pra, nëse për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese duhet që të marrin vendim të gjithë gjyqtarët që përbëjnë një gjykatë, duke u bazuar në termin "gjykata" apo gjyqtari që gjykon çështjen, duke u bazuar në termin "gjyqtarët". Për t'i dhënë përgjigje kësaj situate duhet që të kemi në konsideratë faktin se gjykatat e zakonshme e ushtrojnë pushtetin e tyre nëpërmjet trupave gjyqësore. Këto trupa gjyqësore sipas ligjeve procedurale përbëhen nga një gjyqtar, tre gjyqtarë, pesë gjyqtarë dhe me nga trembëdhjetë deri në nëntëmbëdhjetë gjyqtarë.<sup>396</sup> Në thelb pra rezulton se përfaqësues i pushtetit gjyqësor, i cili jep vendime në emër të Republikës së Shqipërisë, janë trupat gjyqësore, të formuara sipas kërkesave të ligjit përkatës procedural. Në këtë kuptim rezulton se kur përdoret termi "gjyqtar", ligjvënësi ka pasur në konsideratë trupën gjyqësore të përbërë me nga një gjyqtar dhe kur përdoret termi "gjykatë", ligjvënësi ka pasur në konsideratë trupat gjyqësore të formuara nga tre apo më shumë gjyqtarë. Në planin praktik, në çdo rast, secili prej tyre mund të verë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe doktrina.<sup>397</sup>

Gjykata e zakonshme një vendim të tillë mund ta marrë vetë kryesisht ose mbi bazën e kërkesës së palëve në proces. Në rastin e parë, ajo duhet që fillimisht t'i marrë mendim palëve për këtë mundësi, megjithëse në fund është ajo që vendos pavarësisht qëndrimin të palëve. Në rastin e dytë duke përjashtuar pak modeleve të huaja, si Rumania,<sup>398</sup> gjykata nuk është e detyruar që ta pranojë kërkesën e paraqitur nga palët por duhet që ta vlerësojë atë dhe në rast se e rrëzon të japë argumentat përkatëse. Kjo nuk duhet kuptuar si një e drejtë e gjykatave të zakonshme për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, bazuar në diskrecionin e tyre. Ato e kanë detyrim kontrollin paragjykimor të kushtetutshmërisë së ligjeve. Për rrjedhojë nëse nga palët ka një kërkesë ato duhet që ta shqyrtojnë me seriozitet dhe të japin argumentat përkatëse dhe bindëse se përse vendosën ta rrëzojnë atë. Pra, gjykata ka të drejtë që të çmojë në vlerësimin e saj, nëse ligji

<sup>393</sup> Kushtetuta, neni 134, pika 1, gërma "d": 1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të:... d) çdo gjykatë sipas rastit të nenit 145 pika 2 të kësaj Kushtetute;

<sup>394</sup> Kushtetuta, neni 145, pika 2: Kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjitha gjykatat.

<sup>395</sup> LGJK, neni 68, pika 1: Kur gjykata ose gjyqtari gjatë një procesi gjyqësor dhe në çdo kohë, kryesisht ose me kërkesë të palëve, çmon se ligji është antikushtetues dhe kur ka lidhje të drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, nuk e zbaton atë, duke vendosur pezullimin e shqyrtimit të mëtejshëm të çështjes dhe dërgimin e materialeve të saj Gjykatës Kushtetuese, për t'u shprehur për kushtetutshmërinë e ligjit.

<sup>396</sup> K.Pr.C., neni 35; K.Pr.P., neni 13; LGJA, neni 12; Ligji nr. 8588, datë 15.3.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë", neni 16.

<sup>397</sup> Rado, Klodian, "Kontrolli incidental në Shqipëri", botuar në Revistën "Studime Juridike", Nr.2, i vitit 2006, botim i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, Shtëpia Botuese "Pegi", fq.153, 155.

<sup>398</sup> Carlassare, Lorenza, "Interlocutory Review – Abstract Review", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15", botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998, fq. 130.



vjen ose jo në kundërshtim me Kushtetutën, por nga ana tjetër ka edhe detyrime.<sup>399</sup> Ky moment i rëndësishëm lidhet me elementët e një procesi të rregullt ligjor, veçanërisht me parimin e gjykimit të një gjykate të caktuar me ligj, pasi sipas neneve 124 dhe 131, shkronja “a” të Kushtetutës rezultoi se kontrolli i pajtueshmërisë së ligjeve me Kushtetutën është në juridiksionin dhe kompetencën lendore të Gjykatës Kushtetuese dhe jo të gjykatave të zakonshme. Për këtë arsye kur ka argumenta bindëse për antikushtetutshmërinë e ligjit, gjykatat e zakonshme janë të detyruara që të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Theksoj se sipas nenit 145, pika 1 e Kushtetutës, gjykatat e zakonshme i nështrohen Kushtetutës dhe ligjeve. Në zbatim të drejtë të kësaj dispozite dhe të nenit 4, pika 2, si edhe 116 të Kushtetutës nga ku përcaktohet supremacia e saj mbi aktet e tjera, rezultoi se ushtrimi i kontrollit incidental nuk është një e drejtë e gjykatave të zakonshme, por përkundrazi një detyrim i tyre.

Një qëndrim të ngjashëm gjejmë edhe në jurisprudencën kushtetuese të krahasuar. Kështu sipas Gjykatës Kushtetuese Çeke rezultoi se:

*Gjykata Kushtetuese ka për detyrë që të shqyrtojë çështjen bazuar në dispozitat vijuese. Nenet 83, 95.1 dhe 95.2 të Kushtetutës rregullojnë konceptin e rishikimit kushtetues i cili është përqëndruar në vetëm një institucion, pra Gjykata Kushtetuese. Për këtë arsye një gjykatë e distriktit nuk ka asnjë zgjidhje tjetër por të përmbushë detyrimet e saja kushtetuese dhe ta referojë çështjen në Gjykatën Kushtetuese, për të vlerësuar kushtetutshmërinë e normave të zbatueshme të ligjit.*<sup>400</sup>

Pra, gjykatat duhet që të jenë të kujdesshme në shqyrtimin e ketyre kërkesave të paraqitura nga palët dhe jo t'i trajtojnë ato me indiferentizëm siç ndodh shpesh në praktikë.<sup>401</sup> Në këtë rast duhet që të mbahet në konsideratë edhe jurisprudenca e GJEDNJ e cila e ka konsideruar shkelje të së drejtës së aksesit në gjykatë, refuzimin e gjykatave të zakonshme për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, në rast se e vetmja mundësi që kishin ankuesit për të realizuar të drejtat e tyre ishte vetëm kundërshtimi kushtetues ndaj ligjit.<sup>402</sup>

Akti procedural që përdorin gjykatat për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese është vendimi. Vendimi që përdoret në këtë rast është një vendim me natyrë të ndërmjetme pasi nuk synon përfundimin e procesit gjyqësor. Për me tepër ky lloj vendimi gjyqësor është i një natyre të veçantë. Duke qenë një e drejtë kushtetuese e gjykatës, ndaj këtij vendimi nuk lejohet ankim i veçantë siç parashikohet në legjislacionin procedural në këto raste. Për këtë arsye, në rast se një

<sup>399</sup> Rado, Klodian, “Kontrolli incidental në Shqipëri”, botuar në Revistën “Studime Juridike”, Nr.2, i vitit 2006, botim i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, Shtëpia Botuese “Pegi”, fq.162.

<sup>400</sup> Vendimi nr. Pl. US 33/00, datë 10-01-2001, i Gjykatës Kushtetuese të Çekisë, marrë nga CODICES e Komisionit Demokratik përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), referuar me numrin CZE-2001-C-001.

<sup>401</sup> Vendimi nr. 00-2014-1797, datë 03.06.2014, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë: *Në bazë të nenit 145/2 të Kushtetutës së R.SH-së janë gjyqtarët ata që e çmojnë nëse ligji vjen në kundërshtim me Kushtetutën dhe se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk e ka vlerësuar të tillë, gjithashtu dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk e gjen me vend këtë kërkesë të parashtruar në ankimin e veçantë.*

<sup>402</sup> GJEDNJ, vendimi i Dhomës së Madhe, çështja “Ruiz-Mateos kundër Spanjës”, datë 23 qershor 1993, aplikimi nr. 12952/87, paragrafi 59: *Gjykata vëren se ka në të vërtetë një lidhje të ngushtë midis themelit të të dyja llojeve të procedimit. Anullimi nga Gjykata Kushtetuese, i dispozitave të kundërshtuara, do të kishte drejtuar gjykatat civile që të lejonin padmë e familjes Ruiz Mateos (shih paragrafët 15-16, 20, 22-24, 27 dhe 37 më sipër). Në këtë çështje procedurat civile dhe kushtetuese shfaqen në mënyrë aq të ndërlidhura sa që të merrësh me to në mënyrë të ndarë do të ishte artificiale dhe në mënyrë të konsiderueshme do të dobësonte mbrojtjen e garantuar për të drejtat e kërkuarve. Gjykata vëren se duke ngritur çështjen e kushtetutshmërisë, kërkuarët po përdornin mjetin e vetëm dhe indirekt të mundshëm për ta që të ankohen për ndërhyrjen në të drejtën e tyre të pronësisë.*

gjykatë e zakonshme e shkallës së parë merr një vendim të tillë, palët nuk mundet që të bëjnë ankim të veçantë në gjykatën e apelit.

Vendimi në çdo rast duhet që të jetë i plotë dhe të tregojë ligjin apo dispozitat ligjore që kundërshtohen si edhe normat kushtetuese që pretendohet se shkelin.<sup>403</sup> Kjo është shumë e rëndësishme pasi është vetëm gjykata ajo që ka të drejtë të formulojë objektin me anë të të cilit do t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese. Madje edhe palët në proces nuk kanë të drejtë që të kërkojnë ndryshimin e tij.<sup>404</sup> Një vendim i tillë i gjykatës së zakonshme mund të merret vetëm gjatë kohës që është çelur hetimi gjyqësor. Nëse ky hetim është mbyllur dhe gjykata e zakonshme është tërhequr për vendim atëherë ajo duhet të dalë vetem me vendimin përfundimtar ose jopërfundimtar në lidhje me mosmarrëveshjen dhe jo për pezullimin e çështjes dhe dërgimin në Gjykatën Kushtetuese.<sup>405</sup>

Gjykata Kushtetuese në këtë rast bazuar në parashikimet kushtetuese dhe ato të LGJK ka përpunuar kriteret mbi bazën e së cilës gjykatat e zakonshme mund të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Kështu sipas Gjykatës Kushtetuese:

*Gjykata është shprehur vazhdimisht për aspektet e legjitimitetit të gjykatave, të cilat e vënë në lëvizje atë nëpërmjet kontrollit incidental. Sipas saj, gjykata ose gjyqtari i cili kërkon kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit përpara Gjykatës Kushtetuese, duhet të respektojë disa kriteret; së pari, gjykata ose gjyqtari, gjatë një procesi gjyqësor duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete; së dyti, duhet të parashtrijë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e këtij ligji (të një ose të disa dispozitave të ligjit), duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; së treti, të ketë krijuar bindjen se gjykimi nga gjykata ose gjyqtari nuk mund të përfundojë*

<sup>403</sup> Vendimi nr.94, datë 10.12.2010 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese: *Bazuar në nenin 68 të po këtij ligji, në vendimin e saj gjykata apo gjyqtari duhet të përcaktojë dispozitat e ligjit që ata çmojnë se janë të papajtueshme me normat konkrete ose parimet e tjera të Kushtetutës, të cilat ligji nuk i ka respektuar ose i ka cenuar, si dhe shkaqet për të cilat kërkohet shfuqizimi i tij. Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, gjatë shqyrtimit paraprak, çmoi se gjykata iniciuese nuk ka përcaktuar dispozitat ligjore që çmon si të papajtueshme me Kushtetutën dhe as dispozitën përkatëse kushtetuese me të cilën ato bien në kundërshtim. Objekti dhe shkaqet e kësaj kërkesë janë të paqarta, çka e bën këtë kërkesë të paplotë nga pikëpamja formale, prandaj kërkesa duhet të kthehet për të plotësuar të metat e mësipërme.*

<sup>404</sup> Carlassare, Lorenza, "Interlocutory Review – Abstract Review", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15", botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998, fq. 131.

<sup>405</sup> Vendimi nr.61, datë 16.5.2012 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese: *Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se gjykata referuese nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 145/2 të Kushtetutës dhe nenit 68 të ligjit nr.8577/2000. Këto dispozita kërkojnë si parakusht që "gjykata gjatë një procesi gjyqësor" mund të vendosë pezullimin e çështjes dhe jo pas përfundimit të tij. Për sa kohë që procesi vazhdon domethënë vazhdon edhe hetimi gjyqësor. Në rastin konkret, gjykata referuese ka thirrur palët për pretendimet përfundimtare, ka deklaruar përfundimin e hetimit gjyqësor dhe është tërhequr për vendim. Pas këtij momenti gjykata referuese ka vendosur pezullimin e çështjes dhe dërgimin e saj në Gjykatën Kushtetuese, pa patur mundësi t'i pyesë palët dhe të dëgjojë pretendimet e tyre për këtë çështje. Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se pavarësisht se gjykata nuk lidhet me pretendimet e palëve për të dërguar ose jo çështjen në Gjykatën Kushtetuese, ajo ka detyrimin që t'i pyesë ato dhe të dëgjojë parashtrimet e tyre lidhur me çështjen ku ata janë palë. Për më tepër, në rastin konkret asnjëra nga palët nuk i është referuar dispozitës që gjykata mendon se është ligji i zbatueshëm në rastin konkret. Gjykata referuese nuk mund të vendosë për pezullimin e çështjes pa ua njoftuar atë paraprakisht palëve, kur këto të fundit ishin në pritje të vendimit përfundimtar për zgjidhjen e çështjes në themel, për shkak se gjykata e kishte mbyllur hetimin gjyqësor. Neni 305 i KPC parashikon se "pasi palët kanë parashtruar përfundimet e kërkesat e tyre, gjykata deklaroi tërheqjen e saj në dhomën e këshillimit për të dhënë vendimin përfundimtar". Në këtë kuptim, nga gjykata, në këtë fazë, pritjet vendimi përfundimtar dhe jo pezullimi i çështjes pasi ka përfunduar hetimi gjyqësor.*

*në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese dhe se kjo gjykatë/ky gjyqtar nuk kishte mundësi ta zgjidhte çështjen, edhe pa iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese; së katërti, të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar ligjin në përputhje me Kushtetutën; së pesti, të argumentojë nëse ka pasur mundësi për interpretim të dispozitës në pajtim me Kushtetutën.<sup>406</sup>*

Detajimi i mëtejshëm i këtyre kriterëve është bërë vetë nga Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj, e cila do të na shërbejë për t'i analizuar ato në vijim. Në lidhje me kriterin e parë Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin se:

*"... Para marrjes së vendimit të pezullimit gjyqtari apo gjykata duhet të kenë parasysh që gjykimi që ata kanë nisur nuk mund të përfundojë pa i dhënë përgjigje çështjes së antikushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Pra, gjyqtari duhet të krijojë mendimin se ligji që ai vlerëson si antikushtetues do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes... Në mënyrë që të ekzistojë lidhja e drejtpërdrejtë duhet të ketë një raport të domosdoshëm mes vendimit të Gjykatës Kushtetuese (zgjidhjes së çështjes së antikushtetutshmërisë së ligjit nga kjo gjykatë) dhe zgjidhjes së çështjes kryesore nga gjyqtari apo gjykata, subjekt iniciues i gjykimit incidental, në kuptimin, që gjykimi nga gjykata e zakonshme nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese".<sup>407</sup>*

Nga analiza e mësipërme rezulton se sipas kriterit të parë gjykatat e zakonshme duhet që të jenë përpara rastit kur ligji që ato duan të zbatojnë për zgjidhjen e një mosmarrëveshje konkrete shfaq në këndvështrimin e tyre probleme kushtetutshmërie. Në të gjitha ato raste kur Gjykata Kushtetuese ka konsultuar të kundërtën, pra ligji i kundërshtuar nuk ka pasur lidhje të drejtpërdrejtë me çështjen ajo ka vendosur sipas rastit moskalimin e çështjes në seancë plenare ose rrezimin e kërkesës.<sup>408</sup>

<sup>406</sup> Vendimet nr.52, datë 5.12.2012, nr.30, datë 17.6.2010, nr.18, datë 23.4.2010, nr.12, datë 14.4.2010, nr.2, datë 3.2.2010, nr.13, datë 4.5.2009, nr.5, datë 6.3.2009, nr.14, datë 21.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese. Vendimi nr.142, datë 1.12.2011, i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>407</sup> Vendimet nr.13, datë 4.5.2009 dhe nr.11, datë 5.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese

<sup>408</sup> Vendimi nr.13, datë 4.5.2009 i Gjykatës Kushtetuese: *Në çështjen e paraqitur për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, kërkuesi nuk e ka vlerësuar siç duhet këtë kriter të rëndësishëm, pasi për rastin në shqyrtim, kjo lidhje nuk është e evidente, sepse i pandehuri është akuzuar për veprën penale "kundërshtim i punonjësve të policisë së rendit", akuzë që kërkuesi duhet ta shqyrtojë mbi bazën e verifikimit të elementëve të kësaj figure të veprës penale, sanksionuar nga neni 236 i Kodit Penal. Nëse do të kërkohej antikushtetutshmëria e kësaj dispozite, atëherë mund të thuhet se mund të ekzistonte lidhja e drejtpërdrejtë mes ligjit, për të cilin kërkohet antikushtetutshmëria, dhe zgjidhjes së çështjes konkrete. Gjykata Kushtetuese vlerëson, se nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë edhe për arsyen se në cilësinë e të pandehurit ka qenë babai i dy djemve, të cilët ishin subjektë të ligjit nr.9047, datë 10.07.2003 "Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë".*

*Pra, në rastin konkret, kërkuesi nuk pengohet nga verifikimi i kushtetutshmërisë së nenit në fjalë, për të zgjidhur me themel çështjen, pasi edhe nëse hipotetikisht do të shpallej antikushtetuese dispozita e ligjit, objekt i kërkesës, kjo nuk do të pengonte për një vendim lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit. Në asnjë rast kundërshtimi i punonjësit të policisë, gjatë përmbushjes së detyrës së tij në bazë të një ligji, nuk mund të konsiderohet si veprim i justifikueshëm nga pikëpamja ligjore.*

*Për rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese e konsideron si të padrejtë pretendimin e kërkuesit, sepse nuk ekziston lidhja e drejtpërdrejtë mes nenit 36/1 të ligjit nr.9487, datë 06.03.2006 "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9047, datë 10.07.2003 "Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë" dhe zgjidhjes së çështjes konkrete.*



Kriteri tjetër që kërkohet, parashtrimi i arsyeve serioze të antikushtetushmërisë, përbën edhe thelbin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme. Në disa vende si në Itali dhe Austri, gjyqtarët mund ta venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese kur ata kanë dyshime në lidhje me antikushtetutshmërinë e ligjit, kurse në Gjermani, gjyqtarët mund të bëjnë vetëm nëse janë të bindur për antikushtetutshmërinë e tij.<sup>409</sup> Në këtë vendim gjykata referuese, duhet që të parashtojë argumentat e saj përse ligji, apo dispozita konkrete të tij, janë antikushtetuese. Në këtë rast gjykata referuese nuk duhet që të kufizohet në përmendjen e disa parimeve kushtetuese, por përkundrazi duhet të argumentojë mënyrën se si normat e kundërshtuara i çenojnë këto parime. Në rast të kundërt Gjykata Kushtetuese vendos për moskalimin e çështjes në seancë gjyqësore.<sup>410</sup>

Kriteri i tretë, bindja sipas të cilës mosmarrëveshja që gjykata referuese ka në gjykim nuk mund të zgjidhet pa pasur me parë vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese, paraqitet mjaft delikat. Sipas doktrinës së huaj gjyqtarët nuk janë të detyruar të procedojnë nëse nuk janë absolutisht të bindur që ky është ligji që do të zbatohet por është e mjaftueshme që ato ta konsiderojnë atë të mundshëm, në këndvështrimin e materialeve që kanë në dispozicion kur referojnë çështjen në Gjykatën Kushtetuese.<sup>411</sup> Pra, mund të dërgojnë dhe një ligj i cili ata mendojnë se gjen zbatim në çështjen konkrete. Në Shqipëri, Gjykata jonë Kushtetuese ka imponuar një tjetër rregull, sipas të cilit, gjykata referuese duhet që të argumentojë se nuk ekzistojnë dispozita të tjera ligjore të cilat mund të zbatohen për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje. Pikërisht këtu qëndron dhe delikatesa e këtij kriteri. Në thelb është gjykata referuese ajo që identifikon ligjin që do të zbatohet në një çështje të caktuar. Për këtë arsye nëse gjykata referuese ka dështuar në gjetjen e normave të tjera të cilat mund të gjejnë zbatim në çështjen konkrete, Gjykata Kushtetuese vihet në pozitë disi të vështirë pasi duke vendosur moskalimin e çështjes apo rrëzimin e kërkesës për këtë shkak, i tregon gjykatën referuese edhe ligjet e tjera që ajo duhet të zbatohet në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Nga kjo mënyrë të vepruari duket sikur Gjykata Kushtetuese del jashtë funksionit të saj pasi, përveç aspektit kushtetues, e përfshin vetën e saj edhe në aspekte të ligjshmërisë së çështjes. Pavarësisht kësaj, Gjykata Kushtetuese, duke e konsideruar si teje të rëndësishme këtë kriter kushtetues, nuk ka ngurruar që të mos pranojë kërkesa për shqyrtim në rast se ekzistonin dispozita të tjera ligjore të cilat mund të zbatoheshin në zgjidhjen e çështjes konkrete.<sup>412</sup>

<sup>409</sup> Carlassare, Lorenza, "Interlocutory Review – Abstract Review", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15", botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998, fq. 129.

Schwartz, Herman, "The struggle for constitutional justice in post-communist Europe", Shtëpia Botuese "The University of Chicago Press", Chicago 2000, fq.34.

<sup>410</sup> Vendimi nr.20, datë 6.3.2009 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese: ...në kërkesën e Gjykatës së Apelit Shkodër, pretendohet se dispozita e kundërshtuar cenon parimin e sigurisë juridike, por nuk paraqiten argumente kushtetuese për të mbështetur këtë pretendim.

Vendimi nr.50, datë 15.4.2013 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese: Ndonëse gjykata referuese përpigjet ta argumentojë antikushtetutshmërinë e ligjit organik, sipas kësaj Gjykate nuk janë argumente bindëse se pse ky ligj, dhe pikërisht nën 27/b i tij, është antikushtetues, duke e bërë të pamundur zgjidhjen në themel të çështjes konkrete.

<sup>411</sup> Carlassare, Lorenza, "Interlocutory Review – Abstract Review", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15", botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998, fq. 127.

<sup>412</sup> Vendimi nr.103, datë 20.11.2009 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese: Kërkuësja, (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec) gjatë gjyimit nuk ka qënë në pamundësi për të zgjidhur çështjen konkrete, duke zbatuar dispozitat përkatëse ligjore.

Vendimi nr.2, datë 3.2.2010 i Gjykatës Kushtetuese: Gjykata e çmon të nevojshme të theksojë se, në bazë të nenit 145 të Kushtetutës, gjyqtarët iu nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve, duke respektuar hierarkinë e burimeve të së



Kriteri i katërt dhe i pestë në thelb janë të njëjtë me njëra – tjetrën. Në thelb të këtyre kriterëve Gjykata Kushtetuese duhet që të bëjë çmos që ligjin ta interpretojë në mënyrë të tillë që të jetë në përputhje me normat kushtetuese. Për këtë arsye në vendimin e saj për dërgimin çështjes në Gjykatën Kushtetuese, gjykata referuese duhet që të argumentojë pamundësinë e saj për të bërë një interpretim pajtues, pra që të gjitha mënyrat e mundshme të interpretimit ligjit sjellin cenim të parimeve kushtetuese. Në rast se ekziston një mundësi e tillë dhe gjykata referuese nuk ka bërë tentativa për të bërë interpretim pajtues, Gjykata Kushtetuese vendos sipas rastin moskalimin e çështjes për gjykim ose rrëzimin e kërkesës. Vetë Gjykata Kushtetuese në këtë rast ka shtjelluar kushtet mbi bazën e së cilit duhet që të përbushen kriteret e interpretimit pajtues dhe konkretisht:

*Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se: (i) në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve, gjykata duhet të nisët nga prezumimi i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën; (ii) për zgjidhjet ligjore të aplikuara duhet të ketë argumente pse shkelin normat dhe vlerat kushtetuese, (iii) interpretimi pajtues është i mundur kur një ligj apo dispozitë ligjore mund të interpretohet në mënyrë se një mënyrë, njëra nga të cilat është në pajtim me Kushtetutën; (iv) metoda e interpretimit pajtues kërkon efektet kushtetuese të rezultateve të ndryshme dhe përzgjedh rezultatin që është në pajtim me vlerat kushtetuese, duke marrë parasysh këtu të drejtat themelore të individëve.<sup>413</sup>*

Një çështje tjetër e diskutueshme lidhet me formulimin e nenit 181, pika 2 e Kushtetutës, sipas së cilës:

*Ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute dhe që kanë të bëjnë me shpronësimet dhe konfiskimet, do të zbatohen kur nuk vijnë në kundërshtim me të.*

Sipas mendimit të shfaqur në doktrinë,<sup>414</sup> kjo dispozitë i njeh të drejtën gjykatës së zakonshme për të ushtruar kontrollin kushtetues mbi këto ligje vetë, pa i referuar këtë Gjykatës Kushtetuese, duke ushtruar në këtë mënyrë vetë drejtësi kushtetuese. Kësaj mundësie të ngritur nga doktrina, Gjykata Kushtetuese i ka dhënë përgjigje negative në jurisprudencën e saj, kur ka mbajtur qëndrimin se:

---

*drejtës, si detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës (neni 4 i Kushtetutës). Në këtë kuptim, nëse gjyqtari gjatë një gjykimi, arrin në përfundimin se ligji dhe akti nënligjor, të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me zgjidhjen e çështjes, bien në kundërshtim me njëri tjetrin, ai është i detyruar të bazohet në ligj. Gjyqtarët duhet të kenë parasysh dhe raportet ndërmjet ligjeve që miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit (ligje të përforcuara), sipas nenit 81/2 të Kushtetutës dhe ligjeve që miratohen sipas rregullit të përgjithshëm të parashikuar nga neni 78 i Kushtetutës. Kushtetuta i jep ligjeve të përforcuara fuqi të veçantë juridike në krahasim me aktet e zakonshme të ligjvënësit. Për këtë arsye, në hierarkinë e akteve, ato renditen para ligjeve të zakonshme të Kuvendit (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 03.05.2007). Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Për rrjedhojë, në rastet e konflikteve ndërmjet normave me fuqi të ndryshme juridike, norma me fuqi më të lartë ka epërsi në raport me normën tjetër (lex superior derogat inferiori). Parimet, se norma specifike ka përparësi nga norma e përgjithshme (lex specialis derogat generalis) dhe se norma që ka hyrë në fuqi më vonë ka përparësi nga norma e mëparshme, nuk veprojnë në raste të tilla.*

<sup>413</sup> Vendimi nr.142, datë 1.12.2011 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, parag.17.

<sup>414</sup> Rado, Klodian, "Kontrolli incidental në Shqipëri", botuar në Revistën "Studime Juridike", Nr.2, i vitit 2006, botim i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, Shtëpia Botuese "Pegi", fq.167-168.

*Në nenin 8/2 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", që ka qenë në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes, përcaktohet se kur gjatë shqyrtimit të çështjes gjykata arrin në përfundimin se akti normativ nuk pajtohet me ligjin "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe me ligjet, ajo pezullon gjykimin dhe ia dërgon materialet e çështjes Gjykatës Kushtetuese. Për rëndësinë që ka kjo normë kushtetuese, e cila përcakton qartë kufirin e kompetencave, është sanksionuar edhe në nenin 145 të Kushtetutës. Në fakt, duke u shprehur për papajtueshmërinë me dispozitat kryesore kushtetuese të ligjit nr.355, datë 21.11.1946, gjykatat kanë tejkaluar kompetencat e tyre, duke ndërlyrë në kompetencat e Gjykatës Kushtetuese, prandaj vendimet e tyre janë antikushtetuese dhe procesi gjyqësor i parregullt.*

*Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese duke iu rikthyer edhe një herë analizës që përbën thelbin e çështjes lidhur me qëndrimin e gjykatave ndaj ligjit nr.355, datë 21.11.1946, thekson se ky qëndrim është antikushtetues, sepse gjykata nuk ka të drejtë të mos e zbatojë një ligj që sipas saj ka karakter të theksuar politik. Në rast se gjykata çmon se ligji nuk pajtohet me Kushtetutën, ajo është e detyruar të pezullojë gjykimin dhe t'ia dërgojë çështjen Gjykatës Kushtetuese. Çdo qëndrim tjetër e bën procesin gjyqësor të parregullt.<sup>415</sup>*

Qëndrimi i mësipërm i Gjykatës Kushtetuese është mëse i drejtë, duke pasur në konsideratë se ligjvënësi kushtetues ka përzgjedhur sistemin e centralizuar të ushtrimit të kontrollit kushtetues. Për rrjedhojë asnjë gjykatë apo institucion tjetër nuk mundet që ta ushtrojë atë.

### **3.2 Gjykatat e Arbitrazhit.**

Gjykatat e zakonshme nuk janë të vetmet instanca për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis subjekteve të ndryshme të së drejtës. Legjislacioni ynë procedural civil njih edhe një tjetër mundësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që kanë të bëjnë me çdo pretendim pasuror ose kërkesë që rrjedh nga një marrëdhënie pasurore, nëpërmjet gjykatave të arbitrazhit.<sup>416</sup>

Gjykatat e arbitrazhit, formohen në bazë të marrëveshjeve që lidhin palët, në të cilën përcaktohet që mosmarrëveshjet e tyre t'i zgjidhin në këto forume. Vetë gjykata e arbitrazhit mund të jetë e përhershme, pra, qendra të cilat ushtrojnë vazhdimisht një funksion të tillë, ose të përkohshme, që formohet vetëm mbi bazën e një marrëveshje dhe më pas me zgjidhjen e saj shpërndahet. Gjithashtu një gjykatë arbitrazhi mund të jetë kombëtare ose ndërkombëtare. Cila prej këtyre formave zgjidhet, përbërja e trupit gjykues, kriteret dhe procedurën për zgjidhjen e tyre, si edhe ligjin e zbatueshëm, përcaktohen në marrëveshjen që lidhet midis palëve.

Edhe në një gjykim arbitrazhi mund të rezultojë që ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes të shfaqë probleme kushtetutshmërie. Në këtë drejtim jam i mendimit që edhe gjykata e arbitrazhit, mundet që të pezullojë gjykimin e çështjes dhe të verë në lëvizje gjykimin kushtetues për të kontrolluar kushtetutshmërinë e ligjit që shërben për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në fakt, pavarësisht se formohet mbi bazën e vullnetit të palëve të formalizuar

<sup>415</sup> Vendimi nr.97, datë 27.7.2001 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>416</sup> K.Pr.C. neni 402.

në një marrëveshje, gjykata e arbitrazhit mund të konsiderohet si gjykatë në kuptim të normave kushtetuese dhe ligjore. Kështu neni 135 i Kushtetutës përcakton ndër të tjera se pushteti gjyqësor përbehet edhe nga gjykata të shkallës së parë të cilat krijohen me ligj. Aktualisht rregullat për krijimin dhe funksionimin e gjykatave të arbitrazhit kombëtar rregullohet nga Pjesa e Dytë, Titulli IV, i K.Pr.C., nenet 400 – 438. Pra, në këtë rast rezulton se kriteri i krijimit të gjykatës me ligj plotësohet. Po kështu këto dispozita rregullojnë mënyrë e krijimit të saj, zgjedhjen e arbitrave, rregullat procedurale etj. Po sipas nenet 432, rezulton se vendimi i saj është i formës së prerë dhe mund të bëhet i ekzekutueshëm mbi bazën e një urdhëri ekzekutimi të lëshuar nga gjykata e zakonshme. Ky moment përforcohet edhe nga parashikimi i nenet 510 të K.Pr.C i cili i konsideron këto vendime si tituj ekzekutivë. I njëjti arsytim vlen edhe për gjykatat e arbitrazhit ndërkombëtar, të cilat njihen nga marrëveshje të ndryshme ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë<sup>417</sup> dhe të cilat funksionojnë mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura midis palëve, subjekte të ndryshme të së drejtës.

Në favor të këtyre argumentave dhe në mungesë të një qëndrimi deri më sot nga Gjykata jonë Kushtetuese, mund të përmendim jurisprudencën kushtetuese italiane e cila është shprehur se:

*Bazuar vetëm në kufijtë që i interesojnë kësaj çështjeje dhe pa u përfshirë në problematikën komplekse që ka të bëjë me natyrën juridike të procedurave të arbitrazhit, mjafton që të vërejmë që arbitrazhi përbën një procedim të parashikuar dhe rregulluar nga kodi i procedurës civile për zbatimin objektiv të së drejtës në një çështje konkrete, me qëllim zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje, me garancitë e kontradiktorialitetit dhe të paanshmërisë, tipike të juridiksionit civil të zakonshëm. Bazuar në këtë aspekt, gjykimi i arbitrazhit nuk dallon nga ai që zhvillohet përpara organeve shtetërore të juridiksionit edhe për sa i përket kërkimit dhe interpretimit të normave që zbatohen në atë çështje.*

*Dyshimi mbi legjitimitetin kushtetues të ligjit që do të zbatohet nuk është i ndryshëm, në parim, nga problemet e tjera që i shtrohen në intenerarin llogjik vendimmarrësit me qëllim për të marrë një vendim juridikisht korrekt. Edhe normat kushtetuese, me efektet e tyre të cilat cënohen nga normat ligjore të zakonshme dhe që bien në kundërshtim me to, janë pjesë e së drejtës që duhet të zbatohen nga arbitrat, të cilët, si çdo gjyqtar, janë të detyruar që të interpretojnë ligjet sipas Kushtetutës.*

*Në një rend kushtetues në të cilin i ndalohet çdo organi gjyqësor si pushteti për të moszbatuar një ligj, si edhe pushteti për të zgjidhur një gjykim duke zbatuar ligje me dyshime kushtetuese, ashtu edhe arbitrat, gjykimi i të cilëve është potencialisht i njëjtë me ato të organeve të juridiksionit, duhet të përdorin sistemin e gjykimit incidental mbi ligjet.*

...

*Si përfundim, pra, duhet të afirmohet, që bazuar në jurisprudencën e cituar të kësaj Gjykate, edhe arbitrat mundet dhe duhet të ngrajnë incidentalisht çështje të legjitimitetit kushtetues të normave ligjore dhe që duhet t'i zbatojnë, kur rezulton e pamundur mënjanimi i dyshimit nëpërmjet interpretimit.<sup>418</sup>*

<sup>417</sup>Konventa e Kombeve të Bashkuara "Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit" Nju Jork, 10 qershor 1958, aderuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr.8688 datë 09.11.2000.

<sup>418</sup> Vendimi nr.376, datë 22 – 28 nëntor 2001 i Gjykatës Kushtetuese Italiane, marrë nga adresa zyrtare e internetit [www.cortecostituzionale.it](http://www.cortecostituzionale.it)

Si përfundim për këtë pjesë mund të themi se edhe gjykata e arbitrazhit, qofshin këto të përhershme apo të përkohshme, janë të detyruara që të zbatojnë parimet kushtetuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete që është shfaqur përpara tyre. Në këtë drejtim ato nuk mund të japin zgjidhjen e një çështjeje bazuar në ligje të cilat mund të kenë probleme kushtetutshmërie.

Bazuar në këto argumenta rezulton se edhe kushtet e tjera të cilat duhet që të plotësojnë gjykatat e zakonshme për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, vlejnë edhe për gjykatat e arbitrazhit.

### 3.3 Organet *quasi* gjyqësore.

Përveç gjykatave të zakonshme dhe gjykatave të arbitrazhit të cilat ndjekin një procedurë të pastër gjyqësore, struktura institucionale e Shtetit Shqiptar njih edhe organe administrative të cilat në ushtrimin e funksioneve të tyre kryejnë veprimtari të ngjashme me ato gjyqësore. Doktrina dhe jurisprudenca kanë përdorur në këto raste termin “organe *quasi* gjyqësore”. Duke iu referuar jurisprudencës së Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese, rezulton se shprehimisht prej tyre janë njohur si organe të tilla Komisioni i Shërbimit Civil<sup>419</sup> dhe Komisionet e Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave.<sup>420</sup> Nga analiza e këtyre vendime rezulton që të jemi përpara një organi administrativ *quasi* gjyqësor duhet që të plotësohen disa kushte. Ato duhet që të zgjidhen në mënyrë të pavaruar nga organet ekzekutive, të kenë mandat dhe garanci në mënyrë që funksionet e tyre t’i ushtrojnë në mënyrë të pavaruar dhe se procedura që ndjekin duhet të respektojë parimet për një proces të rregullt ligjor.

Pavarësisht se dy organet e përmendura më sipër nuk ekzistojmë më, shumë institucione të tjera plotësojnë kriteret të tilla për t’u konsideruar si organe *quasi* gjyqësore. Si shembull mund të përmendim Autoritetin e Konkurrencës, Urdhërin e Mjekevë, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë etj.

Në këtë drejtim lind diskutimi nëse këto organe gjatë procedurave të tyre, a kanë të drejtë të pezullojnë çështjen që janë duke gjykuar dhe t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për të kontrolluar kushtetutshmërinë e ligjit që ato duhet të zbatojnë? Doktrina jonë i ka dhënë përgjigje

<sup>419</sup> Vendimi unifikues, nr.3, datë 24.1.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë: *i veshur me tiparet e një organi administrativ të pavaruar dhe të ngarkuar me zgjidhjen e ankimeve ndaj vendimeve lidhur me nëpunësin civil, Komisioni i Shërbimit Civil ka tiparet e një arbitri administrativ apo të një trupe (organi) me funksion dhe kompetenca quasi gjyqësore”.*

<sup>420</sup> Vendimi nr.27, datë 26.5.2010 i Gjykatës Kushtetuese, parag.46: *Sipas të drejtës administrative shqiptare, për të pasur një akt administrativ i cili të shprehë vullnetin e organit administrativ nevojitet një interes i ligjshëm publik. Kërkesa e një personi para organeve të kthimit dhe kompensimit të pronave synon njohjen e të drejtës së pronës mbi një send të caktuar. Kjo e drejtë e pretenduar nga subjekti para një organi shtetëror është një e drejtë subjektive dhe jo një interes i ligjshëm i tij, në kuptim të nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo do të thotë, nga ana tjetër, se vendimet e K.K.K.P dispononin drejtpërsëdrejti mbi të drejta subjektive, të cilat janë ekskluzive të titullarëve të caktuar dhe jo të shtetasve apo publikut në tërësi siç janë interesat publike. Ky fakt mund të konstatohet nga Gjykata pasi e drejta e një personi për tu njohur si pronar i një sendi rregullohet nga Kodi Civil, si rrjedhim Gjykata çmon se jemi jashtë fushës së veprimit të së drejtës publike e cila rregullon veprimet e organeve shtetërore në mbrojtje të interesave publike. Për sa më sipër, vendimet e organeve administrative, që kanë pasur si kompetencë kthimin dhe kompensimin e pronave, në vite, nuk mund të konsiderohen akte administrative, në kuptimin normal juridik të termit (strictu sensu), por akte sui generis të nxjerra nga një organ sui generis, për të cilin Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka përdorur termin e ri leksikor, quasi gjykatë.*



negative kësaj mundësie, duke arsyetuar se me termin “gjqqtarë” duhen kuptuar ato subjekte që ushtrojnë këtë funksion ekskluzivisht nëpër gjykata dhe jo funksionarët e tjerë quasi gjyqësorë.<sup>421</sup>

Nëse i referohemi jurisprudencës kushtetuese dhe doktrinës italiane rezulton se në këtë vend këto organe janë konsideruar si plotësisht të afta për të kërkuar zhvillimin e një gjykimi incidental pranë Gjykatës Kushtetuese. Qëndrimi kryesor mbështetet në një interpretim të zgjeruar që Gjykata Kushtetuese Italiane u ka bërë termave “gjykatës” dhe “proces gjyqësor”. Në këtë kuptim është konsideruar i tillë çdo organ juridiksional që ushtron funksione juridiksionale. Në këto koncepte përfshihen dhe organet *quasi* gjyqësore. Për këtë arsye Gjykata Kushtetuese Italiane, ka legjitimuar si “gjykata”, seksionet disiplinore të Këshillit të Lartë të Magjistraturës, komisarët regjionalë për likuidimin e përdorimeve civile, intendentët e financave, komisionet për shqyrtimin e ankesave në lidhje me patentat, këshillat komunalë kur shqyrtojnë mosmarrëveshje zgjedhore, komandatët e porteve, këshillat e prefekturave dhe juntave regjionale administrative kur ushtrojnë funksione juridiksionale, si edhe komisionet për ankesat në lidhje me tatimet qendrore dhe vendore.<sup>422</sup>

Personalisht bashkohem me qëndrimin e dytë. Është e vërtetë që Kushtetuta jonë përdor termin gjykatë/gjqqtar si subjekt i aftë për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, por ky term duhet interpretuar në mënyrë të zgjeruar për të përfshirë edhe organet administrative kur veprojnë me procedura *quasi* gjyqësore. Qëllimi i kontrollit incidental është që gjykatat gjatë shqyrtimit të një çështje konkrete të mos japin një vendim që mund të jetë në përputhje me ligjin, por në kundërshtim me parimet kushtetuese. Janë normat kushtetuese ato që duhet të orientojnë veprimtarinë e çdo institucioni shtetëror. Në këtë kuptim edhe organet administrative kur veprojnë me procedura *quasi* gjyqësore, duke qenë se janë të detyruara që t'i binden ligjit, nuk mundet kurrësesi që të japin zgjidhje antikushtetuese, për faktin e thjeshtë se Kushtetuta është ligji me fuqinë më të lartë në vend.

### 3.4 Gjykata Kushtetuese.

Më sipër përmendëm se edhe vetë Gjykata Kushtetuese mundet si “gjykatë” të verë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për të kontrolluar kushtetushmërinë e një ligji. Le ta trajtojmë më gjerë këtë mundësi.

Kontrolli incidental i ligjeve është një kontroll i cili inicohet nga gjykatat të cilat kur plotësojnë kërkesat e Kushtetutës, ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe çmojnë se ligji është antikushtetues, vendosin pezullimin e çështjes dhe dërgimin e saj Gjykatës Kushtetuese për t’u shprehur në lidhje me pajtueshmërinë e ligjit të kundërshtuar me Kushtetutën.

Kjo e drejtë e gjykatave për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, parashikohet fillimisht nga neni 134, pika 1 gërma “d” e Kushtetutës, dispozitë e cila parashikon mundësinë për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese nga **çdo gjykatë**.<sup>423</sup>

Nga dispozita e mësipërme rezultojnë dy elementë të rëndësishëm:

1. kërkesa mund të bëhet nga **çdo gjykatë**;

<sup>421</sup> Rado, Klodian, “Kontrolli incidental në Shqipëri”, botuar në Revistën “Studime Juridike”, Nr.2, i vitit 2006, botim i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, Shtëpia Botuese “Pegi”, fq.152.

<sup>422</sup> Teresi, Francesco, “I giudizi della corte costituzionale”, Shtëpia Botuese “Cacucci Editore”, Bari 2010, fq.72–73.

<sup>423</sup> Kushtetuta, neni 134, pika 1, gërma “d”: 1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të...d) çdo gjykate sipas rastit të nenit 145 pika 2 të kësaj Kushtetute;

2. kërkesa duhet të plotësojë kushtet e nenit 145 pika 2 të Kushtetutës.

Bazuar në elementin e parë, rezulton se vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese mund të realizohet nga çdo gjykatë. Duke i'u referuar rregullave të interpretimit gramatikor, vërejmë se në këtë dispozitë përdoret përemri i pacaktuar "çdo". Përdorimi i këtij përemri në këndvështrimin tonë tregon qartësisht se Kushtetuta ka autorizuar të gjitha gjykatat e krijuara dhe të normuara prej saj që të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.

Nga ana tjetër Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë pavarësisht se ka një rregullim të veçantë në Kushtetutë, është përsëri "gjykatë" në kuptim të Kushtetutës. Për këtë argument i referohemi jurisprudencës së kësaj Gjykate e cila ka mbajtur qëndrimin se:

*11. Subjektet e interesuara pretendojnë se Gjykata Kushtetuese nuk përfshihet në listën e gjykatave, që mund të mbrohet në këtë gjykim kushtetues nga Unioni, pasi ekzistenca, organizimi dhe funksionimi i saj është parashikuar në pjesën e tetë të Kushtetutës dhe jo në pjesën e nëntë, që ka parashikuar gjyqësorin. Gjykata thekson se, pavarësisht nga mos parashikimi në Kushtetutë i Gjykatës Kushtetuese në pjesën ku janë vendosur "Gjykatat", ky nuk është argument i mjaftueshëm për të konkluduar se ky autoritet kushtetues **nuk është gjykatë**. Ekzistenca e dy pjesëve të dallueshme në Kushtetutë: Pjesa VIII - "Gjykata Kushtetuese" dhe Pjesa IX - "Gjykatat", nuk mohon faktin që Gjykata Kushtetuese, e cila është ngarkuar të ushtrojë kontrollin gjyqësor kushtetues, është gjykatë, por përkundrazi thekson statusin e saj të posaçëm në krahasim me gjykatat e tjera, qëllimin dhe veçoritë e saj. **Është vetë Kushtetuta që, nëpërmjet kompetencave me të cilat ka pajisur organin që realizon drejtësinë kushtetuese, e ka njohur atë si gjykatë.***

...

*13. Gjykata çmon se shkronja "f" e nenit 131 të Kushtetutës, që parashikon një nga kompetencat e Gjykatës Kushtetuese, përbën, në të njëjtën kohë, edhe pikëtakimin kryesor të veprimtarisë së saj me gjykatat e juridiksioneve të tjera. Sipas kësaj dispozite "Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave". Kjo dispozitë e Kushtetutës i jep të drejtë Gjykatës të kontrollojë vendimet e të gjitha gjykatave të sistemit të zakonshëm. Pra, përsa i përket mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit "për një proces të rregullt ligjor", **Kushtetuta e vendos Gjykatën Kushtetuese si trupën më të lartë të kontrollit në hierarkinë e gjykatave në Republikën e Shqipërisë.***

...

*15. Kushtetuta dhe ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" përcaktojnë procedurat e formimit, bazat dhe garancitë e ushtrimit të kompetencave të Gjykatës Kushtetuese, si edhe statusin e gjyqtarëve të saj. **Emërtimi "gjykatë" i organit të drejtësisë kushtetuese që ka si mision të tij ushtrimin e kontrollit gjyqësor kushtetues është dhënë expressis verbis nga vetë Kushtetuta. Nga kjo pikëpamje, Gjykata nënvizon se ky institucion i pushtetit shtetëror, i cili është quajtur "gjykatë" nga vetë Kushtetuta, nuk mund të konsiderohet nga subjektet e interesuara si një institucion jo-gjyqësor. Gjithashtu, si në Kushtetutë edhe në ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese, anëtarët e saj emërtohen "gjyqtarë", ndërsa veprimtaria e saj quhet "gjykim". Paga e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese përlllogaritët në referencë me pagën e Kryetarit të Gjykatës së***

Lartë dhe ai ka të njëjtat papajtueshmëri në ushtrimin e detyrës, sikundër edhe çdo gjyqtar i juridiksioneve të tjera.

17. Gjykata thekson se shfuqizimi që Gjykata Kushtetuese i bën vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm është në ushtrim të funksioneve të saj gjyqësore. Kjo kompetencë, të cilën Gjykata e gëzon në bazë të rregullimit të parashikuar nga nenet 42 dhe 131, shkronja "f", të Kushtetutës është në funksion jo vetëm të rregullit të njohur se **"vendimi i një gjykate mund të prishet vetëm nga një gjykatë tjetër,"** por edhe të faktit se, subjektet e interesuara, duke u paraqitur para saj për të parashtruar pretendimet e tyre, e kanë njohur dhe pranuar atë si një gjykatë. Edhe nga referimi në aktet ndërkombëtare, Gjykata vlerëson se rekomandimi që bëhet mbi pavarësinë, eficientën dhe rolin e gjyqtarëve "është i zbatueshëm për të gjithë personat që ushtrojnë funksione gjyqësore, ku përfshihen ata që trajtojnë çështje kushtetuese, penale, civile, tregtare dhe administrative" (shih Rekomandimin nr. R(94) të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës "Mbi pavarësinë, eficientën, dhe rolin e gjyqtarëve).<sup>424</sup>

Nga citimi i jurisprudencës kushtetuese rezulton qartësisht se Gjykata Kushtetuese është "gjykatë" dhe për rrjedhojë në bazë të nenit 134, pika 1, gërma "d" e Kushtetutës, është e autorizuar nga Kushtetuta që në kuadër të një gjykimi tjetër me natyrë konkrete, kur ekzistojnë edhe kushtet e duhura të vendosë pezullimin e çështjes dhe të iniciojë një kontroll incidental mbi normat juridike që pretendohen se janë antikushtetuese.

Gjykimet konkrete që janë në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese, janë mosmarrëveshja e kompetencës, gjykimi në lidhje me kushtetushmërinë e partive dhe organizatave politike, procedurat *impeachment* dhe për përfundimin para kohe të mandatit për disa funksionarëve të lartë të vendit, procedurat në lidhje me zgjedhjen e deputetëve dhe të Presidentit të Republikës, procedurat në lidhje me shkarkimin apo shpërndarjen e organeve të njësisve vendore të zgjedhura drejtpërsëdrejti, si edhe procedurat për shqyrtimin e kërkesave të individëve për cënimin e së drejtës së tyre për një proces të rregullt ligjor.

Në këtë lloje gjykimesh Gjykata Kushtetuese mund të interpretojë edhe ligjin. Ky fakt është pranuar edhe nga jurisprudenca kushtetuese, veçanërisht në gjykimet për një proces të rregullt ligjor, ku është mbajtur qëndrimi se:

*Gjykata Kushtetuese e çmon të domosdoshme të theksojë se interpretimi i ligjeve nuk është funksion kushtetues ekskluziv i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm...*

*...Interpretimi i ligjit është e drejtë e çdo organi që merret me zbatimin e tij...*

*...Kushtetutshmërinë e këtij interpretimi në vendimin gjyqësor konkret, kur lidhet me të drejtat themelore të shtetasve në aspektin e procesit të rregullt ligjor, e kontrollojnë vetëm Gjykata Kushtetuese...*

*...Interpretimi i ligjit nuk duhet kuptuar thjeshtë si njohje aparente e një dispozite konkrete, por në thelb ai përbën vlerësimin e kuptimeve të ndryshme që norma juridike merr, kur ajo do të zbatohet, për të konkluduar në arritjen e një kuptimi të vetëm dhe në përputhje me Kushtetutën... Përderisa Gjykata Kushtetuese bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës dhe ushtron kontrollin kushtetues të normës juridike, **asaj nuk mund t'i ndalohej të bëjë interpretim të ligjeve.**<sup>425</sup>*

<sup>424</sup> Vendimi nr.11, datë 6.4.2010 i Gjykatës Kushtetuese

<sup>425</sup> Vendimi nr.5, datë 7.2.2001 i Gjykatës Kushtetuese.



Bazuar sa më sipër jam i mendimit se për shkak të natyrës konkrete të këtyre gjykimeve kushtetuese, vetë Gjykata Kushtetuese nuk mundet që ta shqyrtojë kërkesën për antikushtetutshmëri në këtë fazë, por duhet ta pezullojë gjykimin dhe të hapë një proces tjetër si kontrolli incidental ku mund të thirren organet që janë përfshirë në miratimin e ligjit, si vetë Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave për të argumentuar kushtetutshmërinë e ligjit objekt gjykimi. Më pas në përfundim të atij procesi mund të vijohet me gjykimin kushtetues me natyrë konkrete.

Përdorimi i kësaj teknike mundëson zgjidhjen e çështjeve në përputhje me parimet kushtetuese, veçanërisht për mbrojtjen e të drejtave të individëve. Kjo pasi në jurisprudencën e saj Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin konstant se një individ në kuadër të kërkesave për një proces të rregullt ligjor nuk mundet që të verë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për të kontrolluar kushtetutshmërinë e akteve normative (ligje ose akte nënligjore).<sup>426</sup>

Kjo mënyrë veprimi e Gjykatës Kushtetuese duket sikur ngjan me të drejtën që ajo ka pasur më parë për t'u vënë në lëvizje kryesisht, me qëllim kontrollin e normave juridike që mund të kishin probleme kushtetuese. Sipas ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", që rregullonte organizimin e drejtësisë dhe të Gjykatës Kushtetuese, në nenin 25 të tij parashikohej edhe e drejta e Gjykatës Kushtetuese për t'u vënë në lëvizje edhe me nismën e saj. Me Kushtetutën e vitit 1998, kjo e drejtë e Gjykatës u hoq. Megjithëse mund të krijohet përshtypja se mundësia për pezullimin e gjykimin nga vetë Gjykata Kushtetuese dhe inicimin e një procesi të ri, si gjykim incidental, për të vlerësuar kushtetutshmërinë e një ligji, është e njëjtë me të drejtën që ka pasur dikur Gjykata Kushtetuese për t'u vënë në lëvizje me nismën e saj, këto dy raste janë totalisht të ndryshme.

Konkluzioni i mësipërm bazohet në faktin se Gjykata Kushtetuese në këtë rast nuk po vihet në lëvizje me nismën e saj. Ajo është vënë në lëvizje më kërkesë të subjekteve të ndryshme për shqyrtimin e një kërkesë për një gjykim konkret. Duke qenë se në këtë lloj gjykimi siç e argumentuam më sipër Gjykata Kushtetuese interpreton edhe ligjin në frymën e Kushtetutës, ajo mund të konstatojë se ligji është në kundërshtim me normat kushtetuese. Bazuar në kërkesat e neneve 134, pika 1, shkronja "d", 145 pika 2 e Kushtetutës dhe të nenit 68 të LGJK, Gjykata Kushtetuese, si çdo gjykatë, duke e bazuar në të drejtën që ka edhe pala në proces për të bërë një kërkesë të tillë (pra kërkesë për inicimin e një gjykimi incidental), mundet që ta pezullojë çështjen dhe në një gjykim tjetër me palë Kuvendin dhe Këshillin e Ministrave të vlerësojë kushtetutshmërinë e ligjit që dyshohet se shfaq probleme kushtetutshmërie.

Pra, si konkluzion mund të themi Gjykata Kushtetuese nuk vihet në lëvizje me nismën e saj. Ajo është vënë në lëvizje nga subjektet për një gjykim konkret dhe mbi kërkesën e pjesëmarrësve në proces, apo kryesisht (dhe kur ekzistojnë kushtet) hap gjykimin incidental mbi normën e kundërshtuar si antikushtetuese.

Në mungesë të një qëndrimi të Gjykatës sonë Kushtetuese në lidhje me këtë çështje, por edhe për të mbështetur me tej argumentat që trajtuam e shohim me interes që t'i referohemi edhe jurisprudencës së gjykatave kushtetuese të huaja por edhe të GJEDNJ. Në fakt konkluzionet që argumentuam nuk janë një risi në jurisprudencën kushtetuese të huaj. Kështu ka pasur raste kur gjykatat kushtetuese të vendeve të ndryshme në kuadër të një gjykimi konkret kanë pezulluar çështjen dhe kanë shqyrtuar kushtetutshmërinë e ligjit që duhet të zbatonin në atë çështje konkrete. Pra, janë bërë vetë nismëtare të shqyrtimit të kushtetutshmërisë së një norme ligjore

<sup>426</sup> Vendimi nr.24, datë 9.3.2010 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.



nëpërmjet një kontrolli incidental. Me vendimin nr.140 të vitit 1970, Gjykata Kushtetuese Italiane ka mbajtur qëndrimin e mëposhtëm:

*Nuk ka dyshim që Gjykata mund të ngrejë përpara vetes së saj, në një gjykim për mosmarrëveshje kompetencash, një gjykim kushtetues incidental të ligjit mbi të cilin bazohet akti i kundërshtuar.*

Ky qëndrim i Gjykatës Kushtetuese Italiane është ruajtur dhe konsoliduar në vazhdimësi. Me Urdhëresën nr.343, datë 13-25 nëntor 2003 Gjykata Kushtetuese Italiane ndër të tjera është shprehur se:

*Që kjo Gjykatë ka njohur që konflikti i kompetencave midis pushteteve të Shtetit mund të shkaktohet edhe në lidhje me akte të rangut ligjor, nëse nga këto mund të derivojnë çënime të drejtpërdrejta të rendit kushtetues të kompetencave, por vetem nëse nuk ekziston një gjykim i cili këto do të mund të zbatohet dhe për këtë arsye mund të ngrihet pretendimi për kontrollin kushtetues në rrugë incidentale.*

Nga pasazhet e mësipërme kuptojmë se Gjykata Kushtetuese Italiane pranon gjykimin incidental të bërë nga vetë ajo nëse nga akti ligjor ka çënime të rendit kushtetues dhe nuk është e mundur që kjo antikushtetutshmëri të zgjidhet me gjykime të tjera. Një rast tjetër i ngjashëm vjen edhe nga jurisprudenca kushtetuese turke, ku Gjykata Kushtetuese e këtij vendi ka mbajtur qëndrimin e mëposhtëm:

*Sipas nenit 152.1 të Kushtetutës, nëse një gjykatë gjatë shqyrtimit të një çështje vëren se ligji apo dekreti që ka fuqinë e ligjit që do të aplikohet është antikushtetues, apo nëse është e bindur për bazueshmërinë e pretendimeve për antikushtetutshmëri të paraqitura nga njëra nga palët, ajo do të pezullojë shqyrtimin e çështjes derisa Gjykata Kushtetuese të vendosë mbi këtë çështje. Ndërsa Gjykata po shqyrtonte çështjen për ndalimin e Partisë së Vlerave, e gjeti vetë nga ana e saj një parashikim në Ligjin për Partitë Politike si antikushtetues. Prandaj, Gjykata Kushtetuese goditi këtë parashikim përpara saj **“si gjykatë që po shqyrton një çështje”**. Gjykata vlerësoi se parashikimet e kundërshtuara ishin në kundërshtim me nenet 68 dhe 69 të Kushtetutës (mbi partitë politike).<sup>427</sup>*

Siç mund të kuptohet qartazi, Gjykata Kushtetuese Turke, ka bërë kontroll incidental pranë saj, duke kontrolluar kushtetutshmërinë e një ligji që duhet të zbatonte (madje edhe duke e shfuqizuar atë). Kjo lloj vendimmarrje e Gjykatës Kushtetuese Turke është kontrolluar edhe nga GJEDNJ e cila është shprehur se:

*Ngelet për të vendosur nëse aplikanti ka qenë në dijeni të mundësisë së aplikimit direkt të Kushtetutës në rastin e tyre dhe nëse këta mund të kishin parashikuar rrezikun që të përballeshin përmes aktiviteteve anti-laike të partisë së tyre ose përmes refuzimit për të distancuar veten nga ai lloj aktiviteti, pa ndjekur procedurat e parashikuara nga seksioni 103 (2) i ligjit për rregullimin e partive politike.*

<sup>427</sup> Vendimi nr. K.2000/50, datë 12.12.2000 i Gjykatës Kushtetuese Turke, marrë nga “CODICES” e Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) me numër referimi TUR-2001-1-004.

*Me qellim që të mund t'i përgjigjemi kësaj pyetje. Gjykata duhet së pari të konsiderojë si me rëndësi të veçantë sfondin ligjor në të cilën ndodhën faktet e çështjes, siç është pasqyruar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese Turke dhe jo të kundërshtuar nga palët. Kushtetuta Turke nuk mund të amendohet nga legjislacioni i zakonshëm dhe ka precedencë mbi ligjet statutores; një konflikt mes parashikimeve të Kushtetutës dhe atyre të legjislacionit të zakonshëm, përcaktohet në favor të Kushtetutës. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese ka të drejtën dhe detyrën të kontrollojë kushtetutshmërinë e legjislacionit. Kur në një çështje të veçantë ka një mospërputhje mes parashikimeve të ligjit statutor të zbatueshëm dhe atyre të Kushtetutës, siç ka ndodhur në rastin konkret, Gjykata Kushtetuese në mënyrë të qartë i kërkohej që t'i japë precedencë parashikimeve të Kushtetutës, duke mos marrë parasysh parashikimet antikushtetuese të legjislacionit përkatës.<sup>428</sup>*

Qëndrimi i mësipërm konfirmues i GJEDNJ, ndaj vendimmarrjes së mëparshme të Gjykatës Kushtetuese Turke për këtë lloj gjykimi, tregon se një veprim i tillë, i ngjashëm i Gjykatës sonë Kushtetuese nuk është në kundërshtim me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Duke vepruar në këtë mënyrë Gjykata jonë Kushtetuese mbron këto të drejta që pretendohen se janë shkelur dhe Kushtetutën si akti me fuqinë më të lartë në vend.

Pranimi nga Gjykata jonë Kushtetuese i kësaj mundësie, pra që mbi bazën e kërkesës së palëve të pezullojë gjykimin konkret dhe të zhvillojë një gjykim për kontroll incidental për të vlerësuar kushtetutshmërinë e një ligji, sjell vetiu një risi në jurisprudencën kushtetuese dhe një sërë avantazhesh. Kështu në doktrinë por edhe në vetë vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese është ngritur pretendimi se Gjykata Kushtetuese ka qenë e detyruar që të zbatojë norma ligjore të cilat binin në kundërshtim me parashikimet e Kushtetutës. Raste të tilla mund të përmendim rastin e shqyrtimit të kërkesave/ankesave për parregullsitë e zhvillimit të zgjedhjeve për disa zona zgjedhore në përfundim të procesit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2001. Sipas qëndrimit të mbajtur në doktrinë dhënia e një kompetence të tillë Gjykatës Kushtetuese me ligj, në atë kohë në plan të parë binte në kundërshtim me parashikimet kushtetuese duke zgjeruar në mënyrë antikushtetuese kompetencat e kësaj Gjykate. Pavarësisht kësaj duke qenë se asnjë subjekt nuk e ankimoi këtë ligj në Gjykatën Kushtetuese ajo u detyrua që ta zbatonte.<sup>429</sup> Po kështu, në jurisprudencën kushtetuese nga gjyqtarë të ndryshëm është shfaqur mendimi se shpeshherë ligje të caktuara që rregullonin aspekte të veprimtarisë së Gjykatës Kushtetuese binin në kundërshtim me vetë Kushtetutën. Një rast i tillë u shfaq gjatë gjykimit për kushtetutshmërinë e çështjes së shtruar për referendum ku njëri nga gjyqtarët kushtetues u shpreh se:

*Nga sa më lart, mendoj se kushtetutëbërësi shqiptar, në mënyrë të vullnetshme, ka qenë i orientuar në drejtim të njohjes së të drejtës së popullit për referendum shfuqizues të të gjithë ligjit, në tërësinë e tij, dhe jo të dispozitave të veçanta të ligjit. Si përfundim, çmuj se kriteret e përcaktuara nga Kodi Zgjedhor në lidhje me të drejtën për referendum, edhe për një pjesë të ligjit, janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe përtej kufijve të*

<sup>428</sup> Vendimi i Dhomës së Madhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, çështja Refah partisi kundër Turqisë, aplikimet nr. 41340/98, 41342/98, 41343/98 dhe 41344/98, datë 13 shkurt 2003, paragraf.61.

<sup>429</sup> Sadushi, Sokol, "Kontrolli kushtetues", Shtëpia Botuese "Botimpex", Tiranë 2004, fq.138-139.

*autorizuar prej saj. Për rrjedhojë, si të tilla, në mbështetje dhe të nenit 124/2 të Kushtetutës, ato nuk duhet të merren në konsideratë nga kjo Gjykatë.*<sup>430</sup>

Pra, edhe në praktikën e Gjykatës Kushtetuese mund të themi se janë shfaqur raste kur Gjykata, ka qenë vënë përballë ligjeve që ajo duhet t'i zbatonte por nga ana tjetër shfaqnin dyshime për kushtetutshmërinë e tyre. Duke pranuar kontrollin incidental të realizuar nga vetë kjo Gjykatë, atëherë do të ishte e mundur që ajo të zbatonte drejtpërsëdrejti Kushtetutën, duke nxjerrë jashtë rendit juridik normat me karakter kushtetues.

Në rast se një mundësi e tillë do të refuzohej, atëherë duke përdorur vetë argumentat e Gjykatës Kushtetuese të dhëna në një vendim të saj in mund të themi se "shteti është i pafuqishëm të zgjidhë konfliktet e brendshme dhe se ai nuk ka asnjë mundësi të shpëtojë nga funksionimi antikushtetues i tij. Arsyeja qëndron në faktin se veprimtaria shtetërore nuk mund të lihet të devijojë në mënyrë antikushtetuese".<sup>431</sup>

Një mënyrë e tillë interpretimi bën të mundur edhe përputhshmërinë e mjeteve ankimore të sistemit tonë të brendshëm me KEDNJ, veçanërisht me nenin 13. Ky nen kërkon që shtetet të cilat kanë ratifikuar Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut të parashikojnë mjete ankimore efektive për individët që pretendojnë shkeljen e të drejtave materiale të parashikuara në Konventë.<sup>432</sup> Një argument tjetër në favor të kësaj teze do të ishte që në kuptim të nenit 13 të KEDNJ, kjo mënyrë veprimi e Gjykatës sonë Kushtetuese do ta kthente atë në një mjet efektiv ankimi për të drejtat dhe liritë themelore të individit. Për pasojë shteti nuk do të penalizohej nga GJEDNJ, për arsyen se Gjykata jonë Kushtetuese gjatë gjykimeve konkrete por veçanërisht në gjykimin për një proces të rregullt ligjor nuk kishte juridiksion për të shqyrtuar kushtetutshmërinë e normave që zbatoheshin në rastin konkret.

Duke qenë se Gjykata Kushtetuese do të realizonte një gjykim incidental vetëm nëse vihej në lëvizje nga subjektet e ndryshme për një nga gjykimet konkrete, ajo ka mundësinë që të bëjë shqyrtimin paraprak të pretendimeve dhe për rrjedhojë të kalojë vetëm ato kërkesa që kanë një bazueshmëri në pretendimet që ngrihen. Kjo mënyrë veprimi shmang frikën për mbingarkesë të Gjykatës që mund të krijohet në këto raste.

Duke i'u referuar Gjykatës sonë Kushtetuese rezulton se aktualisht pranë saj është duke u shqyrtuar një çështje e ngjashme. Më konkretisht më datë 9 korrik 2015 Gjykata Kushtetuese ka marrë në shqyrtim, mbi bazë dokumentash, çështjen me kërkuar, Komanda e Forcave Ajrore (Reparti Ushtarak nr.3001, Rinas) dhe me subjekte të interesuara Kuvendi, Këshilli i Ministrave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Doganës Rinas. Objekti i këtij gjykimi inicuar nga kërkuar është: **1. Shfuqizimi si i papajtuashëm me Kushtetutën dhe me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut të Vendimit Nr.00-2014-1797, datë 03.06.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; Vendimit nr.1650, datë 15.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. 2. Pezullimi i gjykimit kushtetues për një proces të rregullt ligjor dhe zhvillimi i gjykimit incidental për shfuqizimin si të papajtuashëm me Kushtetutën dhe me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut të pikës 3 të nenit 289 të**

<sup>430</sup> Mendimi në pakicë i gjyqtarit kushtetues Vladimir Kristo, në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae* të kërkuarit (KQZ) në vendimin nr.8, datë 8.3.2013 i Gjykatës Kushtetuese, parag.14.

<sup>431</sup> Pasazh nga vendimi nr.29, datë 21.12.2006 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>432</sup> Alimehmeti, Evis, "Neni 13 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave e Lirive Themelore të Njeriut dhe kuadri ligjor shqiptar", Shtëpia Botuese "Geer", Tiranë 2012, fq.27.

*Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë. 3. Kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*<sup>433</sup>

Bazuar në këtë objekt rezulton se ka qenë vetë Gjykata Kushtetuese që me nismën e saj ka thirrur si subjekte të interesuar edhe Kuvendin së bashku me Këshillin e Ministrave. Ajo që tërheq vëmendjen në këtë rast është edhe fakti që Gjykata Kushtetuese, duke thirrur edhe dy organet shtetërore si subjekte të interesuara në thelb ka bashkuar të dyja gjykimet, atë për një proces të rregullt ligjor dhe kontrollin e kushtetutshmërisë së dispozitave të Kodit Doganor. Megjithatë deri me sot nuk rezulton që Gjykata Kushtetuese të ketë marrë një vendim përfundimtar në lidhje me këtë çështje.

Si një moment i fundit që vlen të trajtohet jam i mendimit se vendimmarrja nga ana e Gjykatës Kushtetuese për të inicuar një kontroll incidental, mund të merret nga Kolegji/Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese në fazën e seleksionit, ose nga Gjykata në seancë plenare nëse çështja ka kaluar për gjykim. Po kështu Gjykata Kushtetuese, për iniciimin e këtij gjykimi duhet që domosdoshmërisht të respektojë të njëjtat kushte të cilat i trajtuam më sipër për gjykatat e zakonshme.

### **3.5 Gjykatat dhe kontrolli konvencional.**

Një çështje e diskutueshme në doktrinë por edhe në praktike është situata nëse gjykatat (gjykatat e zakonshme, gjykata e arbitrazhit, organet *quasi* gjyqësore apo Gjykata Kushtetuese) kur ndodhen përpara situatës që ligji që do të zbatohet bie në kundërshtim me një marrëveshje ndërkombëtare duhet që ta zgjidhin vetë këtë konflikt apo t'ia referojnë Gjykatës Kushtetuese. Në doktrinë por edhe në disa vendime të Gjykatës Kushtetuese, bazuar në formulimin e nenit 122, pikës 2 të Kushtetutës që parashikon se një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të, është mbajtur qëndrimi se gjykatat në një rast konflikti midis një ligji dhe një marrëveshje ndërkombëtare kanë të drejtë që të zbatohet drejtpërsëdrejti marrëveshjen ndërkombëtare duke shmangur zbatimin e ligjit. Kështu doktrina shprehet se padyshim, që ata janë të lirë të zbatohet drejtpërsëdrejti nenet e marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat kanë superioritet mbi ligjet e brendshme. Të mos harrojmë se, gjykatat janë ato që kanë gjithmonë të drejtën e zgjedhjes midis ligjeve që ata i mendojnë si të përshtatshëm për t'i zbatuar. Çështja e zbatimit të marrëveshjes ndërkombëtare në vend të një ligji të brendshëm të vendit që nuk përputhet me të, nuk është çështje e gjyqimit nga Gjykata Kushtetuese. Ajo mbetet një çështje e thjeshtë e interpretimit gjyqësor, pra një çështje e gjyqësorit të zakonshëm. Nëse ndeshet me një rast të tillë, gjyqtari nuk mund të zbatohet nenin 145 të Kushtetutës, por nenin 122/1.<sup>434</sup>

Pra, nga ky arsyetim duket sikur kundërshtitë midis një ligji dhe një marrëveshje ndërkombëtare, duhet të konsiderohen nga gjykatat, në një farë mënyre si kundërshti midis dy ligjeve dhe për rrjedhojë i takon gjykatave që të identifikojnë ligjin e zbatueshëm, duke respektuar në këtë rast parimin e hierarkisë së akteve. Në këtë mënyrë nga ana e tyre nuk kërkohet që të ushtrojnë kontrollin incidental përpara Gjykatës Kushtetuese për të ushtruar kontrollin konvencional mbi ligjin, por përkundrazi duhet të shmangin zbatimin e tij, bazuar në nenin 122 të Kushtetutës.

<sup>433</sup> Informacion i marrë nga faqja zyrtare e internetit të Gjykatës Kushtetuese: [http://www.gjk.gov.al/web/Seanca\\_gjyqesore\\_Korrik\\_2015\\_1022\\_1.php](http://www.gjk.gov.al/web/Seanca_gjyqesore_Korrik_2015_1022_1.php) (parë për herë të fundit me datë 18.7.2015)

<sup>434</sup> Omari, Luan; Anastasi, Aurela; "E drejta kushtetuese", Shtëpia Botuese "ABC", Tiranë 2010, fq. 60.



Një orientim të ngjashëm duket sikur mban edhe jurisprudenca kushtetuese, e cila është shprehur se:

*Në këtë drejtim, Gjykata thekson se, në kuptim të rregullimeve të parashikuara në nenin 122 të Kushtetutës, interpretimi i konceptit kushtetues të vetzbatueshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat kanë epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të, është në vlerësimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili ka në juridiksionin e vet zgjidhjen përfundimisht të çështjes konkrete.<sup>435</sup>*

Ky konkluzion i Gjykatës Kushtetuese, ecën në të njëjtën linjë arsyetimi me qëndrimin e mbajtur nga doktrina, duke qenë se në këtë rast, bazuar në nenin 122 i lë në dorë Gjykatës së Lartë, një gjykatë e zakonshme, që të vendos për raportin midis marrëveshjes ndërkombëtare dhe ligjit kombëtar. Gjykata e Lartë e mori për bazë këtë orientim të Gjykatës Kushtetuese në vendimmarrjen e saj të mëpasshme.<sup>436</sup>

Në një tjetër vendim të Gjykatës Kushtetuese, përparësisë dhe së drejtës ndërkombëtare duket sikur i jepet një tjetër rëndësi më të madhe dhe jo thjesht si një orientim si në rastin e parë. Kështu sipas Gjykatës Kushtetuese:

*Posaçërisht për sa i përket vendimeve të GJEDNJ-së për procedime penale, për legjislativin lind nevoja që të marrë masa për të harmonizuar legjislativonin e brendshëm me dispozitat e KEDNJ-së. Nëse nuk ka harmonizim pra, nëse jemi në rastet e vakumit legjislativ, ose kur parashikimet ligjore bien në kundërshtim me dispozitat e Konventës, atëherë gjyqtarët e çdo niveli zbatojnë drejtpërsëdrejti vendimet e GJEDNJ-së në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës dhe nenet 19 dhe 46 të KEDNJ-së. Neni 122 i Kushtetutës përcakton shprehimisht se dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare kanë epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.<sup>437</sup>*

Nga qëndrimi doktrinor<sup>438</sup> dhe jurisprudenca e mësipërme rezultojnë se gjykatat e zakonshme nuk ushtrojnë kontrollin incidental për t'i kërkuar Gjykatës Kushtetuese kontrollin konvencional midis pajtueshmërisë së ligjit me marrëveshjen ndërkombëtare, por vendosin vetë duke shmangur zbatimin e ligjit dhe duke zbatuar drejtpërsëdrejti marrëveshjet ndërkombëtare bazuar në nenin 122 të Kushtetutës.

Personalisht, nuk jam dakort me qëndrimet e mësipërme. Për të argumentuar të kundërtën i referohemi edhe njëherë përmbajtjes së nenit 131, gërma "a" të Kushtetutës, dispozitë e cila parashikon se ndër të tjera, Gjykata Kushtetuese vendos për pajtueshmërinë e ligjit me marrëveshjet ndërkombëtare, siç parashikohet në nenin 122 të Kushtetutës.

<sup>435</sup> Vendimi nr.21, datë 29.4.2010 i Gjykatës Kushtetuese, parag.22.

<sup>436</sup> Vendimi nr. 00-2010-1362 (812), datë 17.9.2010 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon të nënvizojë se nisur nga përmbajtja e dispozitave të neneve 116/1, 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku njihet hierarkia e normave juridike dhe parashikohet epërsia e normativës së marrëveshjeve ndërkombëtare mbi ligjet e vendit, nenit 2 të Konventës së Këshillit të Europës për Ekstradimin dhe të Dy Protokolleve Shtesë, si dhe ligjit nr.10193, datë 03.12.2009, në rastet e dhënies së garancisë nga ana e shtetit shqiptar, subjektit të ekstraduar do të duhet t'i krijohet mundësia procedurale për të ushtruar të drejtën e mbrojtjes përballë akuzave të ngritura nga ana e organit procedues.

<sup>437</sup> Vendimi nr.20, datë 1.6.2011 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>438</sup> Rado, Klodian, "Kontrolli incidental në Shqipëri", botuar në Revistën "Studime Juridike", Nr.2, i vitit 2006, botim i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, Shtëpia Botuese "Pegi", fq.169.

Nga formulimi i mësipërm dalin në pah dy karakteristika, ku **së pari** është Gjykata Kushtetuese ajo që vendos për pajtueshmërinë e ligjit me marrëveshjet ndërkombëtare dhe **së dyti**, këtë vendimmarrje ajo e bazon në nenin 122 të Kushtetutës. Në këndvështrimin tim personal dispozita nuk mund të mos ishte më shumë se qartë. Pra, kundërshtinë midis një marrëveshje ndërkombëtare dhe një ligji, sipas parashikimeve të nenit 122 të Kushtetutës (ku përcaktohet vetëzbatueshmëria e marrëveshjes dhe superioriteti i saj mbi ligjet e vendit), e kontrollon dhe e zgjidh Gjykata Kushtetuese. Për pasojë gjykatat e zakonshme nuk mundet që të marrin një kompetencë të tillë të Gjykatës Kushtetuese. Çdo lloj vendimmarrje e tyre në këtë drejtim çënon parimet kushtetuese për një proces të rregullt ligjor dhe konkretisht parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj.

Edhe rastet e mësipërme të sjella nga jurisprudenca kushtetuese, nëse analizohen me kujdes tregojnë një lloj vendimmarrje tjetër të Gjykatës Kushtetuese dhe jo një autorizim nga ana e saj për të ushtruar gjykatat e zakonshme një kompetencë të cilën nuk e kanë. Nëse i referohemi rastit të parë, duke e analizuar me kujdes atë, nuk duket sikur kemi një kundërshti midis marrëveshjes ndërkombëtare<sup>439</sup> dhe ligjeve tona.<sup>440</sup> Më saktë, në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare shtohet një rast tjetër për të cilin Gjykata e Lartë mund të vendoste rishikimin e vendimeve të formës së prerë tej atyre të parashikuara nga neni 450 i K.Pr.P. dhe më konkretisht dhënia e garancisë nga Ministri i Drejtësisë për rishikimin e vendimit të të gjykuarit në mungesë, fakt ky i cili pranohet edhe nga arsyetimi i Gjykatës së Lartë.<sup>441</sup>

E njëjta situatë paraqitet edhe në rastin e dytë. Madje në këtë rast, Gjykata Kushtetuese në arsyetimin e saj shprehet se në legjislacionin tonë ka vakum ligjor. Pra edhe në këtë rast vendimmarrja e GJEDNJ konsiderohet si një tjetër rast për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë tej atyre rasteve që parashikon neni 450 i K.Pr.P. Pra edhe në këtë rast kemi plotësim të legjislacionit por jo kundërshti midis një norme ndërkombëtare dhe asaj të brendshme.

Thënë sa më sipër e shoh të nevojshme të ndalem në një tjetër aspekt me natyrë procedurale. Neni 145, pika 2 e Kushtetutës përcakton se gjykatat e zakonshme kanë të drejtë që të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, pra të ushtrojnë një kontroll incidental, kur ato çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën. Ky formulim i kësaj dispozite kushtetuese duket sikur paraqet një pengesë për gjykatat e zakonshme që të ushtrojnë një kontroll incidental, kur çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me marrëveshjet ndërkombëtare, duke qenë se dispozita përmend vetëm Kushtetutën. Por në këtë rast, duke të kemi në konsideratë edhe nenin 5 të Kushtetutës e cila përcakton se Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të. Në kuptim të drejtë të kësaj dispozite çdo kundërshtim i një ligji me një marrëveshje ndërkombëtare është edhe kundërshti e ligjit me Kushtetutën bazuar në formulimin e nenit 5 të saj.

Për të plotësuar më qartë këtë qëndrim është e nevojshme të analizojmë nëse Gjykata jonë Kushtetuese, ka pranuar nga gjykatat e zakonshme një kërkesë në formën e kontrollit incidental për të analizuar pajtueshmërinë e ligjit me një marrëveshje ndërkombëtare. Përgjigja edhe në këtë rast është pozitive. Kështu në vendimin nr.3, datë 11.2.2004 të Gjykatës

<sup>439</sup> Konventës së Këshillit të Europës për Ekstradimin dhe të Dy Protokolleve Shtesë, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr.8322, datë 02.04.1998.

<sup>440</sup> K.Pr.P.

<sup>441</sup> Vendimi nr. 00-2010-1362 (812), datë 17.9.2010 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: *Nisur nga formulimi i kësaj dispozite, është e qartë se çdo subjekti të ekstraduar, përpos rasteve të parashikuara nga dispozita përkatëse e K.Pr.Penale, i njihet e drejta e rishikimit të vendimit, kur Ministri i Drejtësisë i ka dhënë këtë garanci shtetit të cilit iu kërkua ekstradimi, bazuar në dispozitat e Konventës së lartpërmendur.*

Kushtetuese me kërkues Gjykatën e Lartë dhe me objekt shfuqizimin e neneve 86 dhe 87 të Kodit Penal, rezulton se Gjykata, ka mbajtur qëndrimin e mëposhtëm:

*Duke iu referuar pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi për antikushtetutshmërinë e dispozitave të sipërcituara, nuk rezulton të jetë arsyetuar se në cilat drejtime është prekur apo kundërshtuar formulimi i sanksionuar në nenin 25 të Kushtetutës. Në kontekstin kushtetues, mosnënshtrimi ndaj torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjërzor apo poshtërues është përfshirë si një garanci kushtetuese në kreun e lirive dhe të drejtave vetjake të individit. Ndërkohë, nenet 86 dhe 87 të Kodit Penal, të cilat janë vendosur në seksionin e III-të, ku përfshihen edhe vepra të tjera që drejtohen ndaj shëndetit të shtetasve, sigurojnë zbatimin e këtij koncepti kushtetues përmes sanksioneve në rast të konsumimit të veprës penale të torturës. Parë nga ky këndvështrim, këto dispozita penale rezultojnë të jenë rrjedhojë e drejtpërdrejtë e formulimit kushtetues. Vendosja që ligjvënësi u ka bërë këtyre dy dispozitave në këtë seksion mund të jetë objekt i përpunimit nga pikëpamja e teknikave legjislativë, por për jurisprudencën kushtetuese nuk përbën në vetvete çështje antikushtetutshmërie.*

...  
*Neni 1 i Konventës kundër torturës dhe dënimeve e trajtimeve të tjera mizore, çnjërzore ose degraduese i ka dhënë një kuptim sqarues dhe orientues këtij termi. Kjo dispozitë përfshin disa elementë të rëndësishëm që duhen vlerësuar në rastet kur ndodhemi përpara konsumimit të kësaj vepre penale. Meqenëse Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë orientohet pikërisht nga kjo dispozitë e Konventës, çështja objekt shqyrtimi mbetet për t'u analizuar nga Gjykata Kushtetuese si në drejtim të personave që nuk duhet t'i nënshtrohen torturës, ashtu edhe të subjekteve që janë përgjegjëse për kryerjen e kësaj vepre penale.*

...  
*Duke e analizuar çështjen në shqyrtim nga ky këndvështrim, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të theksojë se për të konkluduar mbi pajtueshmërinë ose jo të dispozitave të Kodit Penal me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara duhet të interpretohet neni 1 i Konventës kundër torturës në kuptimin e tij të gjerë në harmoni edhe me paragrafin e dytë të tij. Sipas këtij paragrafi, kuptimi i dhënë në paragrafin e parë të nenit 1 të Konventës nuk mund të cenohet asnjë instrument ndërkombëtar ose asnjë ligj kombëtar që të përmbajë dispozita të një karakteri më të gjerë.*

Nga mënyra e arsyetimit të këtyre pasazheve rezulton se Gjykata e Lartë i kishte bazuar pretendimet për antikushtetutshmërinë e neneve 86 dhe 87 të K.P. në kundërshtin e tij me nenin 25 të Kushtetutës dhe me nenin 1 të Konventës kundër Torturës. Pretendimi i parë është kontroll kushtetues, i dyti është kontroll konvencional. Gjykata Kushtetuese që në fillim të analizës së saj konstatoi se nuk kishte asnjë kundërshti midis neneve përkatëse të K.P. dhe Kushtetutës. Për rrjedhojë nëse Gjykata Kushtetuese nuk mundet që të ushtrojë kontroll konvencional kur një kërkesë e tillë bëhet nga gjykatat e zakonshme nëpërmjet gjykimit incidental atëherë ajo duhej që ta mbyllte këtu arsyetimin e saj, pa analizuar më tej pajtueshmërinë e K.P. me marrëveshjen ndërkombëtare. Por pikërisht mënyra e kundërt e të vepruarit të Gjykatës Kushtetuese duke arsyetuar për pajtueshmërinë e neneve 86 dhe 87 të K.P. me Konventën kundër Torturës tregon se ajo në këtë rast zbatoi kontrollin konvencional mbi bazën e kërkesës së gjykatës së zakonshme.

Argumenti bazë që mendoj se kjo kompetencë mund të ushtrohet vetëm nga Gjykata Kushtetuese lidhet me parimin e sigurisë juridike. Sistemi gjyqësor në Shqipëri, si në çdo vend tjetër, është një sistem i shpërndarë, me shumë gjykata të shkallës së parë dhe të apelit në të gjithë vendin. Në këtë drejtim mundet që çështje të ngjashme që kanë për bazë kundërshtinë e një marrëveshje ndërkombëtare me ligjet e vendit, mund të zgjidhet ndryshe në një gjykatë dhe ndryshe në një gjykatë tjetër. Është e vërtetë që kjo mund të zgjidhet në shkallë të fundit nga Gjykata e Lartë, në rastin më të mirë edhe nëpërmjet një vendimi unifikues, si një e drejtë që i njeh nenin 141, pika 2 e Kushtetutës, por nga formulimi i nenit 131 gërma “a”, ligjvënësi kushtetues ka zgjedhur sistemin e centralizuar të kontrollit konvencional të ligjeve, kontroll i cili mund të ushtrohet vetëm nga Gjykata Kushtetuese. Kjo mënyrë e të vepruarit garanton sigurinë juridike, pasi sjell shfuqizimin e normave ligjore të vendit që bien në kundërshtim me një marrëveshje ndërkombëtare dhe jo lënien e tyre në fuqi, duke i lënë diskrecion gjyqtarit të zakonshëm që nëpërmjet teknikave të shumta interpretuese të japë për raste të ngjashme vendime të ndryshme.

Edhe po t'i referohemi shembujve të huaj rezulton se në Itali, gjykatat e zakonshme dhe administrative, nuk mundet që të zbatojnë rregullat për zgjidhjen e konflikteve midis ligjeve por duhet t'ia referojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese e cila ka kompetencën për një kontroll konvencional mbi legjislacionin.<sup>442</sup> I njëjti qëndrim mbahet edhe nga Tribunali Kushtetues Polak<sup>443</sup> dhe Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë.<sup>444</sup> Janë të rralla rastet kur juridiksionet kushtetuese nuk e ushtrojnë një kompetencë të tillë, si për shembull në Francë.<sup>445</sup> Por rasti francez duhet kuptuar në kontekstin e këtij sistemi të drejtësisë kushtetuese ku mund të ushtrohet vetëm *apriori*.

Si argument të fundit në favor të kësaj teze dua të jap edhe qëndrimin që ka mbajtur vetë Gjykata kushtetuese në lidhje me këtë kompetencë të saj. Me vendimin nr.29, datë 21.12.2006 ajo është shprehur se:

*Në këtë drejtim, është për t'u theksuar se Gjykata Kushtetuese, sipas nenit 131 shkronja “a” të Kushtetutës, ka jo vetëm të drejtën, por edhe detyrimin që, për arsye të ratifikimit të një marrëveshjeje ndërkombëtare, të jetë e lirë dhe të mos pengohet në ushtrimin e kompetencës së saj për të vendosur për pajtueshmërinë e ligjit me këtë marrëveshje ndërkombëtare.*

Duke iu referuar jurisprudencës së huaj një kontroll i tillë mund të ushtrohet vetëm kur nuk ka mundësi të tjera për të shmangur konfliktin apo kur nevojitet nga parimi i sigurisë

<sup>442</sup> Mezzetti, Luca; Polacchini, Francesca; “*Primacy of supranational law and supremacy of the Constitution in the Italian legal system*”, botuar në “*International Constitutional Law*”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “G. Giappichelli Editore”, Torino 2014, fq.165.

<sup>443</sup> Banaszak, Boguslaw; Jorsz-Zukowska Sylwia; Zukowski, Lukas; “*International and European Law in the polish legal system*”, botuar në “*International Constitutional Law*”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “G. Giappichelli Editore”, Torino 2014, fq.241.

<sup>444</sup> Sovdat, Jadranka, “*Human rights between the constitution, treaties, and European union law. The case of Slovenia*”, botuar në “*International Constitutional Law*”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “G. Giappichelli Editore”, Torino 2014, fq.333.

<sup>445</sup> Alberton, Ghislaine, “*Francia*”, botuar në “*Giustizia Costituzionale e Unione Europea – Una comparazione tra Austria, Francia, Germania, Italia, Spanga e Portogallo*”, në kujdesin e Alfonso Celotto, Javier Tajadura, Josu De Miguel Barcena, Shtëpia Botuese “Editoriale Scientifica srl”, Napoli 2011, fq.235.



juridike. Në parim përparësia për të pajtuar konfliktet midis normave kombëtare dhe ndërkombëtare duhet t'i atribuohet nivele ku zbatohet ligji.<sup>446</sup>

#### 4. Subjektet e kushtëzuara.

Kategoria tjetër e subjekteve janë ato subjekte që parashikohen nga gërma "dh" deri në gërmën "f" të nenit 134 të Kushtetutës dhe përkatësisht Avokati i Popullit, organet e qeverisjes vendore, organet e bashkësive fetare, partitë politike dhe organizatat e tjera. Këto subjekte bazuar në nenin 134, pika 2 e Kushtetutës, janë të detyruar që për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, të justifikojnë interesin e tyre në atë çështje. Interesi si element i kërkesës paraqet rëndësi të veçantë studimi për shkak se ekzistenca ose jo e tij kushtëzon plotësinë e kërkesës si dhe përbën parakushtin kryesor në vlerësimin e legjitimitetit.<sup>447</sup> Tradicionalisht në doktrinë me interes kuptohet, *latu sensu*, një konsideratë e karakterit moral ose ekonomik që një çështje ose proces i përket një personi, ose ka rëndësi për të, e tërheq e shqetëson ose e cënon personin në fjalë. Ndërsa, *strictu sensu*, interesi për të paraqitur kërkesë është *causa petendi*, pra arsyeja e paraqitjes së kërkesës. Interesi do të konsiderohet si parakushti primar i cili përcakton legjitimitetin *ratione materiae* të subjektit që detyrohet të justifikojë atë përpara Gjykatës Kushtetuese.<sup>448</sup> Pra interesi, lidhet me aksesin e subjektit për të kërkuar nëpërmjet Gjykatës Kushtetuese njohjen ose rivendosjen e një të drejte që garantohet nga Kushtetuta dhe që rezulton e mohuar ose e cënuar prej normës konkrete.<sup>449</sup> Interesi nuk merret si i mirëqenë, por përkundrazi kërkuesi ka barrën e provës për të provuar interesin në çështjen konkrete. Nga sa më sipër mund të pohohet se nuk mjafton që kërkuesi të provojë se dispozita e pretenduar si antikushtetuese është e zbatueshme ndaj tij, por duhet që ai të provojë se ajo e prek atë, i shkakton atij rrjedhoja të pafavorshme që cënojnë atë vetë ose funksionet e tij në mënyrë të pafavorshme ose, me fjalë të tjera rrezikon t'i shkaktojë dëm atij ose interesave që ai përfaqëson.<sup>450</sup>

Interesi në kuptimin kushtetues ka këto karakteristika:

a) Interesi duhet të jetë i ligjshëm, pra, ai duhet që të jetë juridikisht i mbrojtur dhe në rastin e një kërkesë para Gjykatës Kushtetuese interesi duhet që të paraqesë rëndësi nga pikëpamja kushtetuese pra duhet të lidhet me një dispozitë të caktuar kushtetuese ose të një marrëveshje ndërkombëtare sipas rastit.<sup>451</sup>

b) Interesi duhet të jetë i drejtpërdrejtë, pra të ekzistojë një lidhje e drejtpërdrejtë midis të drejtës kushtetuese që subjekti pretendon se i është cënuar dhe objektit të kontrollit kushtetues nga ana tjetër.<sup>452</sup>

<sup>446</sup> Vendimi nr.K 18/04, datë 11.5.2005 i Tribunalit Kushtetues Polak, referuar në: Banaszak, Boguslaw; Jorsz-Zukowska Sylwia; Zukowski, Lukas; "International and european law in the polish legal system", botuar në "International Constitutional Law", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2014, fq.241.

<sup>447</sup> Pirdeni, Adea, "Justifikimi i interesit në gjykimin kushtetues: Vështrim mbi praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", botuar në Revistën "Studime Juridike", Nr.2, i vitit 2011, Botim i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, Shtëpia Botuese "Pegi", Tiranë 2011, fq.281.

<sup>448</sup> Po aty, fq. 283.

<sup>449</sup> Sadushi, Sokol, "Drejtësia Kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq.283

<sup>450</sup> Pirdeni, Adea, "Justifikimi i interesit në gjykimin kushtetues: Vështrim mbi praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", botuar në Revistën "Studime Juridike", Nr.2/2011, Botim i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, Shtëpia Botuese "Pegi", Tiranë 2011, fq.284.

<sup>451</sup> Po aty fq.285.

<sup>452</sup> Po aty fq.286.

c) Interesi duhet që të jetë vetjak, pra akti i pretenduar si jokushtetues duhet të çënojë kërkuesin dhe interesat e tij në mënyrë të individualizuar. Me fjalë të tjera e drejta e kërkesës i njihet vetëm atij që është titullar i një të drejte kushtetuese e cila pretendohet se mohohet ose çënohet. Gjykata nuk vihet në lëvizje me kërkesë të paraqitur nga një person që ngre pretendime për shkelje të të drejtave kushtetuese të një subjekti tjetër.<sup>453</sup>

Nëse i shohim individualisht si subjekte vërejmë se **Avokati i Popullit**, pavarësisht lëkundjeve që janë shfaqur fillimisht në jurisprudencën kushtetuese duke e kufizuar legjitimitetin e tij vetëm për aktet normative nënligjore,<sup>454</sup> sipas jurisprudencës aktuale, rezulton se objekt i kundërshtimit sot në Gjykatën Kushtetuese mund të jenë edhe ligjet.<sup>455</sup> Por këtu duhet theksuar se Avokati i Popullit mund të kundërshtojë akte ligjore ose nënligjore në Gjykatën Kushtetuese vetëm për të drejtat materiale kushtetuese të subjekteve që ankohen tek ai. Nuk është në interesin e tij kontrolli i akteve ligjore dhe nënligjore nga pikëpamja formale apo mbrojtja e pavarësisë së organeve të tjera kushtetuese.

E njëjta situatë rezulton edhe me **organet e qeverisjes vendore**. Me termin organ sipas Kushtetutës, duhet kuptuar si organi ekzekutiv<sup>456</sup> ashtu edhe organi përfaqësues.<sup>457</sup> Pra të dyja këto organe në mënyrë të pavarur nga njëri – tjetri kanë të drejtë të marrin dhe të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për çështje që i përkasin organizimit, funksionimit, decentralizimit dhe autonomisë vendore mbasi kanë justifikuar dhe provuar përpara Gjykatës, interesin e tyre në çështjen përkatëse.

LGJK edhe për këtë lloj subjekti parashikon disa kufizime në lidhje me gjykime të caktuara. Sipas nenit 57, organet e qeverisjes vendore janë të përjashtuara nga e drejta për të kërkuar deklarimin antikushtetues të një partie/organizate politike. Ky lloj kufizimi nuk më duket i arsyeshëm. Njësitë e qeverisjes vendore përveç fushës së veprimit që përcaktohet në Kushtetutë dhe në ligjin e tyre organik, kanë si qëllim edhe mbrojtjen e parimit të unitetit të shtetit, përcaktuar në nenin 1, pika 2 e Kushtetutës. Po kështu neni 9, pika 2 e Kushtetutës ndër të tjera ndalon partitë apo organizatat politike të cilat duan të marrin dhe/apo të ndikojnë në politikën shtetërore me dhunë, ku në këtë rast përfshihen edhe organet vendore. Në këtë rast, interesi i tyre është mëse i justifikueshëm për të kërkuar deklarimin antikushtetues të një partie/organizate politike e cila synon çënimin e unitetit të Republikës, ose kërkon të ndikojë me dhunë në vendimmarrjen e organeve vendore. Për më tepër duke qenë se këto organe duhet që të mbrojnë edhe pakicat kombëtare dhe komunitetet fetare që mund të përfshihen nën juridiksionin e tyre, ato kanë detyrimin që t'i mbrojnë nga grupime të tilla që nxisin urrejtje fetare, krahinore apo racore.

Organet e njësisive të qeverisjes vendore të zgjedhura drejtpërsëdrejti janë subjekte të parashikuara shprehimisht për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, në rast se shkarkohen apo shpërndahen nga Këshilli i Ministrave. Referuar parashikimit të pikës 2 të nenit 115 të Kushtetutës, rezulton se vetë akti themelor parashikon si subjekt kërkues organin e shpërndarë (këshillin bashkiak/komunal) apo të shkarkuar (kryetari i bashkisë apo komunës). Pra vetëm organi përfaqësues apo ekzekutiv ndaj të cilit ka vepruar Këshilli i Ministrave duke e shpërndarë apo shkarkuar ka legjitimitetin dhe interesin për të vepruar në mënyrë që të venë në lëvizje

<sup>453</sup> Po aty fq.289

<sup>454</sup> Vendimet nr.178, datë 08.11.2001 dhe nr.2, datë 03.02.2004 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>455</sup> Vendimi nr.40, datë 16.11.2007 i Gjykatës Kushtetuese. Ky qëndrim është konsoliduar më tej me Vendimet nr. 17, datë 23.04.2010; nr. 27, datë 26.05.2010; nr. 29, datë 31.05.2010 dhe nr. 33, datë 24.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>456</sup> Vendimi nr.2, datë 25.01.1999 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>457</sup> Vendimi nr.19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese.

Gjykatën Kushtetuese për të shqyrtuar kushtetutshmërinë, ligjshmërinë dhe bazueshmërinë në fakte të vendimmarrjes së Këshillit të Ministrave.

Në ndryshim nga procedurat e tjera "impeachment", vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese nuk është automatike, si në rastin e shkarkimit të Presidenit të Republikës, të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë. Në këtë rast vënia në lëvizje e gjyqimit kushtetues është në disponibilitetin e organit të shpërndarë apo të shkarkuar.

Në këtë lloj gjykimi, për shkak të vetë specifikës që ka dhe parashikimit të drejtpërdrejtë që bën dispozita kushtetuese, subjektet e tjerë të parashikuar në nenin 134 të Kushtetutës janë të përjashtuara *ipso jure* nga vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese.

Përsa i përket **organeve të bashkësive fetare**, duhet pranuar se deri më sot nuk ka pasur raste të vënies në lëvizje të gjykatës nga të tillë subjekte. Por që një subjekt të konsiderohet si bashkësi fetare duhet që të bazohemi në nenin 10, pika 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pra, janë bashkësi fetare vetëm ato subjekte të cilat kanë lidhur një marrëveshje me Këshillin e Ministrave dhe që është ratifikuar më pas në Kuvend. Këto subjekte mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese vetëm për çështje të besimit fetar, për cënim të organizimit të tyre të brendshëm si edhe duke qenë se marrëveshjet fetare konsiderohen në të njëjtin rang me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara edhe për cënimin e këtyre të fundit.

Edhe për këtë lloj subjekti LGJK parashikon kufizime për të kërkuar vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me gjykime të caktuara. Në përgjithësi ky kufizim është i arsyeshëm. Por përsa i përket kufizimit të legjitimitetit të këtij subjekti në raport me kërkesën për të deklaruar një parti apo organizatë politike si antikushtetuese, ndaj një tjetër qëndrim. Duke i'u referuar nenit 9, pika 2 të Kushtetutës mendoj se ky subjekt justifikon plotësisht interesin e tij në rast se kërkon të deklarojë antikushtetues një parti apo organizatë politike e cila nxit urrejtje fetare në vend, veçanërisht kundër një bashkësie fetare të caktuar.

Subjekt tjetër kushtetues janë partitë politike. Këto subjekte mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për çështje që prekin rolin e tyre kushtetues si faktorë qendrorë të formimit të vullnetit politik të zgjedhësve<sup>458</sup> si edhe për çështjet të cilat ndërhyjnë në organizimin e tyre të brendshëm. Në këtë kuptim partitë politike nuk janë të legjitimuara për të paraqitur kërkesë përpara Gjykatës Kushtetuese për çështje që lidhen me interesat e anëtarëve apo simpatizantëve të tyre<sup>459</sup> pasi duke qenë se këto interesa janë shumëplanëshe dhe të përgjithshme atëherë kjo do t'u jepte atyre praktikisht rolin e një subjekti të pakushtëzuar. Megjithatë, në një çështje të diskutueshme Gjykata Kushtetuese për të kontrolluar një marrëveshje ndërkombëtare të kërkuar nga një grup partish politike, legjitimoi vetëm një prej tyre me justifikimin se:

*21. Gjykata, për shqyrtimin e marrëveshjeve ndërkombëtare para ratifikimit, sipas nenit 52 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese, vihet në lëvizje edhe nga një ose disa parti politike, me kusht që çështja të lidhet me interesin e saj/tyre. Gjykata, për të vlerësuar interesin në çështjen në gjykim, nuk mbështetet vetëm në dokumentet e themelimit dhe statutin e partive politike, por edhe në shtrirjen e anëtarësisë, veprimtarinë dhe shkallën e përfaqësimit politik të tyre në organet e zgjedhura. Në këtë vështrim, si kriter referues, merret dhe e drejta që i është njohur nga kushtetutbërësi jo më pak se një të pestës së deputetëve për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese të pakondicionuar me një interes të veçantë.*

<sup>458</sup> Vendimet nr.1, datë 07.01.2005, nr. 32, datë 21.06.2010; nr.28, datë 09.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>459</sup> Vendimi nr.113, datë 13.10.2011 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.



22. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se PSSH është një subjekt politik që në zgjedhjet e fundit parlamentare të 28 qershorit 2009 arriti të siguronte 65 mandate në Kuvendin e Shqipërisë. **Ky fakt e bën atë një subjekt të posaçëm midis partive të tjera politike.** Bazuar në këtë nivel përfaqësimi, duke patur parasysh karakterin dhe rëndësinë e veçantë të marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë "Për delimitimin e zonave të tyre përkatëse, të shelfit kontinental dhe zonave të tjera detare që u përkasin në bazë të së drejtës ndërkombëtare", Gjykata çmon se PSSH ka interes legjitim në kuptim kushtetues për të kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së kësaj marrëveshjeje.<sup>460</sup>

Nga pasazhet e mësipërme mund të konkludohet se arsyeja se përse Gjykata Kushtetuese ka legjitimuar vetëm njërin prej tyre pasi kjo parti në ndryshim nga të tjerat përfaqësohej nga 65 deputetë dhe për rrjedhojë ajo kishte edhe numrin e mjaftueshëm për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese edhe nëpërmjet subjektit tjetër "jo më pak se një e pesta e deputetëve". Pra, në këtë rast Gjykata bëri një dallim midis partive politike bazuar në nivelin e tyre të përfaqësimit në Kuvend. Në këtë rast ajo vuri shenjën e barazimit midis partisë politike si forcë dhe numrit të deputetëve që ajo kishte për ta konsideruar atë si subjekt të pakushtëzuar.

Ky qëndrim i Gjykatës Kushtetuese, duke argumentuar që Partia Socialiste është partia më e madhe opozitare dhe si e tillë përfaqëson një pjesë të madhe të popullit në parlament dhe prandaj mund të kërkojë mbrojtjen e interesave kombëtarë edhe në rrugën e kontrollit paraprak të një marrëveshje ndërkombëtare është kritikuar nga doktrina si i sforcuar.<sup>461</sup> Edhe në këndvështrimin tim ky dallim midis partive të ndryshme politike është i diskutueshëm. Kështu Kushtetuta nuk bën një dallim midis partive politike si njësi organizimi dhe për rrjedhojë nuk duhet që ta bëjë Gjykata Kushtetuese. Për me tëpër në arsyetimin e Gjykatës nuk gjendet asnjë argument se përsë ky subjekt nuk erdhi nëpërmjet deputetëve por erdhi nëpërmjet partisë, si subjekt kërkuar përpara Gjykatës Kushtetuese. Arsyeja në këtë rast lidhet me argumenta të natyrës politike dhe jo asaj juridike, ku rezultonte se deputetët e kësaj force politike nuk kishin pranuar që të futeshin në Kuvend dhe për rrjedhojë nuk kishin bërë betimin.<sup>462</sup> Për këtë arsye ata nuk mundej që të vinin në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Arsyet e nje veprimi të tillë, pra e mungesës në Kuvend, vetëm mbi një vit më vonë, kur u shqyrtuan veprimet e një deputeti të kësaj force politike, u konsideruan nga Gjykata Kushtetuese si të pajustificuara juridikisht.<sup>463</sup> Në këtë drejtim mund të themi se shenja e barazisë që ka vënë Gjykata Kushtetuese midis forcës politike dhe nivelit të përfaqësimit të saj në Kuvend, paraqitet e sforcuar në planin juridik.

LGJK në disa raste bën kufizim të këtij subjekti për disa gjykime kushtetuese. Nëse i referohemi nenit 57 të LGJK rezulton se partitë politike nuk parashikohen si subjekt për të kërkuar deklarimin si antikushtetues të një partie apo organizate politike. Duke pasur në konsideratë jurisprudencën më të fundit të Gjykatës Kushtetuese rezulton se partitë politike mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese vetëm për çështjet që prekin rolin e tyre kushtetues si faktorë qendrorë të formimit të vullnetit politik të zgjedhësve.<sup>464</sup> Në këtë kuptim,

<sup>460</sup> Vendimi nr.15, datë 15.4.2010 i Gjykatës Kushtetuese, parag.21 dhe 22.

<sup>461</sup> Zaganjori, Xhezair; Vorpsi, Arta; Biba, Denar; "Parime kushtetuese dhe të drejta themelore në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese", botim i Fondacionit "Konrad Adenauer", Shtëpia Botuese "Adelprint", Tiranë 2012, fq.95.

<sup>462</sup> Kushtetuta, neni 72: Para fillimit të ushtrimit të mandatit deputetët bëjnë betimin në Kuvend.

<sup>463</sup> Vendimi nr.44, datë 7.10.2011 i Gjykatës Kushtetuese, parag.41: "...mosbërja e betimit nga ana e tij nuk mund të paraqitet si shkak i ligjshëm, pasi ky veprim ishte rezultat i vendimmarrjes personale të tij bazuar mbi motive politike të bëra publike pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

<sup>464</sup> Vendimi nr.113, datë 13.10.2011 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.



nëse një parti apo organizatë politike, ka si qëllim përdorimin e dhunës, në mënyrë të hapur apo të fshehtë për të ndaluar veprimtarinë e një tjetër partie politike atëherë rezultojnë se preket roli i saj si faktor i vullnetit politik të zgjedhësve. Në këtë situatë justifikohet interesi i saj për të vënë në lëvizje këtë gjykim kushtetues.

Në një tjetër gjykim kushtetues, atë të kontrollit të zgjedhjes së Presidentit të Republikës, LGJK i përcakton partitë politike si një nga dy subjektet që kanë të drejtë të bëjnë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese. Në lidhje me këtë situatë të parashikuar nga ligji, çështja shfaqet më komplekse. Mesa duket, duke pasur në konsideratë konotacionin politik të zgjedhjes së Presidentit, ligjvënësi ka menduar edhe përfshirjen e këtyre grupimeve të cilat kanë qëllime politike klasike. Nga ana tjetër, duke pasur mundësi të gjitha partitë politike që të të ankohen për zgjedhjen e Presidentit të Republikës, kjo krijon një situatë të paqëndrueshme e lidhur edhe me faktin se kundërshtimi i zgjedhjes së tij, nuk ka ndonjë afat. Nëse i referohemi jurisprudencës kushtetuese rezultojnë se partitë politike kanë si interes të tyre çështje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e tyre në zgjedhjet politike dhe me organizimin e tyre të brendshëm.<sup>465</sup> Dukshëm zgjedhja e Presidentit të Republikës nuk përfshihet në këto dy raste. I vetmi interpretim pajtues që mund të bëhet në këto raste sipas mendimit tim lidhet me zbatimin me analogji të legjitimitetit që ka njohur Gjykata Kushtetuese për partitë politike parlamentare.<sup>466</sup> Në këtë drejtim do të mundet të ankohen në Gjykatën Kushtetuese vetëm ato parti politike që kanë një përfaqësim në Kuvend por gjithmonë më e vogël se njëzet e tetë deputetë. Duke qenë se edhe kjo parti politike është përfshirë në procesin e zgjedhjes së Presidentit (pra, kanë marrë pjesë në procedurat e votimit të kandidatëve), atëherë ky subjekt mund të legjitimohet për një gjykim të tillë.

LGJK, sipas nenit 66, pika 2, i parashikon partitë politike si subjekt për t'u ankuar në Gjykatën Kushtetuese me qëllim verifikimin e zgjedhjes së deputetëve. Nga analiza e jurisprudencës, kushti që një parti politike duhet të plotësojë për t'u legjitimuar në këtë gjykim është pjesëmarrja në zgjedhje. Sipas vendimit nr.100, datë 20.10.2010 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese rezultojnë se:

*Ligji kërkon që interesi të jetë i drejtpërdrejt nga kërkuesi, pra ai vetë të jetë prekur nga parregullsia gjatë procesit zgjedhor. Qëllimi i ligjit nuk është t'i njohë të drejtën për ankim çdo subjekti që mund ose duhet të kishte marrë pjesë në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, por vetëm atyre që kanë konkurruar realisht.*

Subjekti i fundit i kësaj kategorie janë **organizatat e tjera**. Termi "organizatë" në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë është përmendur në disa konotacione, në analizë literale-gramatikore të të cilave rezultojnë se kushtetutbërësi me *organizatë*, në kuptimin e përgjithshëm, ka kuptuar ato *politike* (neni 131, shkronja "d"), *etnike, kulturore, fetare, gjuhësore* (neni 20, pika 2), *sindikale* (neni 50), *shoqërore, ekonomike, tregtare* (neni 61, pika 4) dhe *tjera* (neni 9, pika 2).

Pra, Kushtetuta e ka lënë të hapur kuptimin që i duhet dhënë termit "organizatë" edhe për grupime me qëllime të tjera të organizimit të individëve (shtetas shqiptarë a të huaj), me kushtin që organizimi i tyre të përputhet me parimet demokratike, ndërsa programet dhe veprimtaria e tyre të mos mbështeten në metoda totalitariste, që nxitin e përkrahin urrejtjen racore, fetare, krahinore ose etnike, që përdorin dhunën për marrjen e pushtetit ose për të ndikuar në politikën

<sup>465</sup> Vendimi nr.113, datë 13.10.2011 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>466</sup> Vendimi nr.15, datë 15.4.2010 i Gjykatës Kushtetuese.

shtetërore, si dhe të mos jenë me karakter të fshehtë (neni 9 pika 2 e Kushtetutës).<sup>467</sup> Gjykata është shprehur se vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të veprimtarisë së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, tek dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit. Vetëm fakti që dispozitat e kundërshtuara mund të kenë ose kanë pasur një efekt çfarëdo mbi kërkuesin, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ai legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që janë qëllimi i veprimtarisë së kërkuesit, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut.<sup>468</sup>

Megjithatë Gjykata Kushtetuese së fundmi është shprehur se organizata që të ketë zotësi juridike për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese duhet të jetë një organizatë me anëtarësi. Organizatat pa anëtarësi janë përjashtuar nga mundësia për të inicuar një proces kushtetues.<sup>469</sup> Vlen të theksohet se ky qëndrim i Gjykatës Kushtetuese bie në kundërshtim me vendimmarrjen e saj të mëparshme, sipas të cilës, legjitimitimi i organizatave pa anëtarësi është lejuar nga jurisprudenca kushtetuese.<sup>470</sup> Me konkretisht Gjykata Kushtetuese në disa raste ka mbajtur këtë qëndrim në lidhje me organizatat pa anëtarësi:

*Qendra "Forumi i Mendimit të Lirë" është një organizatë jofitimprurëse, që ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit në fuqi. Objekti i veprimtarisë së kësaj organizate, i parashikuar në statut, është dhe nxitja e zhvillimit të legjislacionit në fushën e arsimit, mbrojtja e interesave të ndryshme të institucioneve arsimore të çdo niveli, respektimi i parimit të autonomisë universitare si dhe promovimi i edukimit shoqëror e individual, bazuar në vlerat e demokracisë liberale.*

*Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se objekti i veprimtarisë së kësaj organizate jofitimprurëse lidhet me çështjet kushtetuese të ngritura prej saj në kërkesën për gjykim, çka e legjitimon edhe këtë subjekt për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e kërkesës.*<sup>471</sup>

Rasti i mësipërm është rasti kur Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrim të shprehur në lidhje me legjitimitimin e një organizate pa anëtarësi, por në praktikën e saj të mëparshme ka pasur plot raste të tilla. Në kundërshtim me këtë jurisprudencë të konsoliduar, Gjykata Kushtetuese në vitin 2013 befasisht ndërron qëndrim duke u shprehur:

*Duke e vlerësuar legjitimitimin e QNLQ-së në vështrim të standardeve të mësipërme, Gjykata çmon se kjo qendër nuk legjitimohet për vënien në lëvizje të këtij gjykimi abstrakt kushtetues, për arsye se nuk ka arritur të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë*

<sup>467</sup> Vendimi nr.17, datë 25.07.2008 i Gjykatës Kushtetuese

<sup>468</sup> Vendimet nr.43, datë 6.10.2011, nr.4, datë 23.2.2011, nr.31, datë 18.06.2010 dhe nr.16, datë 25.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>469</sup> Vendimi nr.13, datë 27.02.2013 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>470</sup> Vendimet nr.20, datë 11.7.2006 dhe nr.9, datë 19.3.2008 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>471</sup> Vendimi nr.9, datë 19.3.2008 i Gjykatës Kushtetuese.

*midis misionit për të cilin është krijuar apo veprimtarisë që ajo kryen dhe pasojave që rrjedhin nga dispozitat, të cilat kërkon të shpallen si të papajtueshme me Kushtetutën. Gjithashtu, në vlerësimin e Gjykatës, ajo nuk ka arritur të provojë një interes të drejtpërdrejtë, të sigurt dhe vetjak në çështjen konkrete. Referuar statusit të saj juridik, si një qendër së cilës i mungon anëtarësia, ajo nuk përfaqëson interesa të anëtarëve të saj, por, në cilësinë e organizatës jofitimprurëse, ndjek një qëllim në të mirë dhe interes të publikut duke ofruar, ndër të tjera, ndihmë ligjore falas (pro bono) për disa shtresa të caktuara të popullsisë, të cilat nuk kanë mundësi të përballojnë financiarisht shërbimet e një mbrojtësi ligjor apo shpenzimet gjyqësore.<sup>472</sup>*

Arsyetimi i mësipërm i Gjykatës Kushtetuese, është i kritikueshëm në shumë aspekte. Kështu Kushtetuta përdor termin “organizatë”, pa e kufizuar atë me llojet e ndryshme të organizimit të shoqërisë. Në këtë drejtim rezulton se edhe “qendra”, është një organizatë në kuptim të legjislacionit përkatës. Duhet theksuar se në këtë rast Gjykata Kushtetuese ka shtuar kriteret e tjera të cilat nuk janë pjesë e standardeve kushtetuese apo ligjore. Për më tepër në kundërshtim edhe me qëndrimin e saj<sup>473</sup> Gjykata Kushtetuese ka ndryshuar jurisprudencën pa dhënë asnjë argument për këtë ndryshim.

## **5. Individët.**

Subjekti i fundit që parashikon neni 134, pika 1, gërma “g” e Kushtetutës janë individët. Me termin “individ” në kuptimin kushtetues, janë së pari personat fizikë, por duke i'u referuar edhe neni 16, pika 2 të Kushtetutës, rezulton se përfshihen edhe personat juridikë. Duke u bazuar në formulimin që ka pika 2 e nenit 134 të Kushtetutës, duket sikur edhe individët kanë të drejtë që të kundërshtojnë norma ligjore në Gjykatën Kushtetuese, nëse arrijnë të justifikojnë interesin e tyre. Por në fakt, bazuar në parimet e interpretimit sistematik, pra, duke e interpretuar këtë normë kushtetuese të lidhur me norma të tjera rezulton se interesi i individit është përcaktuar nga vetë Kushtetuta dhe më konkretisht nga neni 131, gërma “f” e saj. Për këtë arsye rezulton se individit mund të ankohet vetëm për shkeljen e së drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor nga organet administrative dhe gjyqësore dhe vetëm pasi ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese në këtë drejtim ka qenë gjithmonë e qëndrueshme duke mos e legjitimuar, si rregull, individin për të kundërshtuar ligjet. E vetmja mundësi për individin në këndvështrimin tim është që krahas kërkesës për një proces të rregullt ligjor të kërkojë edhe zhvillimin e një gjykimi incidental nga vetë Gjykata Kushtetuese, bazuar në argumentat që kemi trajtuar më sipër. Pra, në këtë rast interesi i individit është vetëm pretendimi i tij për shkeljen e të

<sup>472</sup> Vendimi nr.7, datë 27.2.2013 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>473</sup> Vendimi nr.21, datë 29.4.2010 i Gjykatës Kushtetuese, parag.17: *Çdo ndryshim i “precedentëve të Gjykatës Kushtetuese apo korigjim i doktrinë kushtetuese zyrtare nuk mund të bëhet mbi bazën e faktorëve të rastit, siç mund të jetë edhe ndryshimi i përbërjes së saj” (shih më gjerë vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë të datës 28 Mars 2006). Sigurimi i vazhdimësisë së jurisprudencës kushtetuese përbën një detyrim për Gjykatën, por nga ana tjetër, në mënyrë të natyrshme jurisprudenca nuk mund të mos i nënshtrohet edhe evoluimit të saj. Nga kjo pikëpamje, ekziston përherë mundësia që jurisprudenca duke u plotësuar përmes konkluzioneve të reja interpretuese, edhe të ndryshohet, por Gjykata thekson se një ndryshim i praktikës mund të realizohet nëse ekzistojnë arsye të forta që do ta justifikojnë një ndërmarrje të tillë dhe vetëm në rastet kur kjo është e paevitueshme, objektivisht e domosdoshme, si dhe kushtetutshëmrisht e bazuar dhe e arsyetuar. Duke vendosur në kundërshtim me një praktikë të konsoliduar dhe pa dhënë argumente në lidhje me këtë fakt, Gjykata shmanget nga korniza e rregullave të një procesi të drejtë e të ndërsjellë, duke i mohuar mbrojtjen gjyqësore kërkuar në kuptim të asaj se çfarë ky i fundit priste, bazuar në jurisprudencën e vetë Gjykatës.*



drejtave për një proces të rregullt ligjor.

Fillimisht duhet të sqarohet se çfarë duhet të kuptojmë me termin “individ” të parashikuar nga neni 134 shkronja “g” dhe 131, shkronja “f” të Kushtetutës. Në rradhë të parë me “Individë” do të kuptojmë personat fizikë të cilët gëzojnë personalitet juridik të plotë. Duke qenë se dispozita kushtetuese nuk përmban ndonjë rezervë lidhur me shtetasit e huaj ose ato pa shtetësi, Gjykata Kushtetuese ka legjitimuar edhe këta të fundit.<sup>474</sup>

Një ankim kushtetues nuk mund të paraqitet në emër të të tjerëve. Vetëm personi të cilit i është cënuar e drejta kushtetuese mundet që të veprojë si kërkues.<sup>475</sup> Kërkesa mund të paraqitet vetë ose nëpërmjet një avokati. Autorizimi i avokatit duhet që të bazohet në një prokurë të posaçme.<sup>476</sup> Ky akt duhet që të përmbajë në mënyrë të shprehur tagrin e përfaqësuesit për t’u ankuar në Gjykatën Kushtetuese dhe jo referime me natyrë të përgjithshme.<sup>477</sup> Kjo prokurë duhet që të jetë lëshuar nga vetë personi i interesuar dhe jo nga persona të tjerë të cilët nuk kanë tagër për të vepruar në emër dhe për llogari të tij, qofshin këta edhe familjarët e personit të interesuar.<sup>478</sup>

Por termi individë nuk duhet marrë në kuptimin e tij të ngushtë. Kështu neni 16, pika 2 e Kushtetutës parashikon se të drejtat dhe liritë themelore, vlejnë edhe për personat juridikë. Siç rezulton nga kjo dispozitë, personat juridikë, janë subjekte të cilat gëzojnë dhe përfitojnë nga të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, për aq sa përputhen me qëllimin e veprimtarisë së tyre. Kështu personat juridikë gëzojnë ndër të tjera lirinë ekonomike, lirinë e organizimit, të drejtën e pronës, etj. Për më tepër në bazë të nenit 45 të Kodit Penal dhe ligjit nr.9754, datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”, rezulton se këta subjekte mund edhe të dënohen penalisht. Për këto arsye duke qenë se personat juridikë kanë një pozicion të rëndësishëm në jetën ekonomike, sociale të një vendi dhe veprojnë me pasurinë e tyre, atëherë është e kuptueshme që në bazë të nenit 16, pika 2 dhe 42 të Kushtetutës të gëzojnë edhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor në mënyrë që të mbrojnë të drejtat e tyre pasurore dhe jopasurore. Pavarësisht faktit se e drejta për një proces të rregullt ligjor konsiston në mbrojtjen e të drejtave të individëve nga vendimmarrja e organeve shtetërore, kjo nuk do të thotë që nga e drejta për tu ankuar për një proces të rregullt ligjor përjashtohen personat juridike publikë. Në fakt neni 16, pika 2 përcakton vetëm persona juridikë pa bërë një dallim midis personave juridikë publikë<sup>479</sup> apo privatë,<sup>480</sup> si dy subjekte të ndryshme të parashikuara në këtë mënyrë nga Kodi Civil.

Në jurisprudencën kushtetuese vihet re se në disa raste Gjykata Kushtetuese ka legjitimuar persona juridikë publikë (si Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Avokaturën e Shtetit etj), për t’u dëgjuar në lidhje me pretendimet e tyre për një proces të rregullt ligjor. E drejta për akses në gjykatë, si një e drejtë e natyrës procedurale, duhet të respektohet dhe të përdoret nga çdo subjekt që konsiderohet palë në një proces, dhe që preket në mënyrë të

<sup>474</sup> Vorpsi, Arta, “Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë”, botim i Fondacionit Konrad Adenaur, Shtëpia Botuese “Maluka”, Tiranë 2011, fq.80.

<sup>475</sup> Momcinovic, Hrvoje, “Contesting the arbitration decision in the proceedings before the Constitutional Court according to the Croatian law”, botuar në “The protection of fundamental rights by the constitutional court”, Koleksioni “Shkenca dhe teknika të Demokracisë”, botim i Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) Nr.15, ribotim 1998, fq.76.

<sup>476</sup> Po aty, fq.77.

<sup>477</sup> Vendimi nr.152, datë 21.12.2011 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>478</sup> Vendimi nr.91, datë 10.12.2010 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>479</sup> Kodi Civil, neni 25.

<sup>480</sup> Kodi Civil, neni 26.



drejtpërdrejtë prej tij. Prandaj dhe ankimi në Gjykatën Kushtetuese për shkeljen e të drejtës për një proces të rregullt ligjor nuk mund të kufizohet për asnjë subjekt, përfshirë këtu edhe personat juridikë publikë.<sup>481</sup> Ky konkluzion bazohet në argumentin se *“nisma për një gjykim kushtetues nuk kushtëzohet nga karakteri i personit juridik, publik a privat, por nga natyra e pretendimeve që parashtrihen.”*<sup>482</sup> Në këtë rast autoritetet publike mund të përfitojnë nga e drejta për një proces të rregullt ligjor vetëm nëse ato nuk veprojnë si organe të autoritetit publik por si subjekte të tjera kërkojnë mbrojtje për të drejtat e tyre,<sup>483</sup> pra marrin pjesë në qarkullimin civil e çënohen njëllor si të ishin qytetarë të thjeshtë.<sup>484</sup>

Pavarësisht, se në rastet e shfaqura deri tani kemi të bëjmë me konflikte të një natyre civile dhe administrative, mënyra se si gjykata është shprehur, duke e kushtëzuar nismën për një gjykim kushtetues të kësaj natyre me pretendimet që ngrihen, atëherë nuk përjashtohet mundësia që edhe në ato raste kur kemi të bëjmë me gjykime penale të bëjë një kërkesë të tillë për shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor edhe organi i prokurorisë.

Gjithashtu nga praktika gjyqësore janë pranuar si subjekte brenda nocionit individë edhe funksionarë të ndryshëm të shtetit, si prokurorë, gjykatës,<sup>485</sup> këshilltarë qarku etj. Kjo linjë e ndjekur thekson bindjen se nuk mund të prezumohet *a priori* rregullsia e procedurave të ndjekura nga organet kompetente në rastet e shkarkimit nga detyra ose marrjes së masave të tjera ndaj funksionarëve publikë.<sup>486</sup>

Si subjekt i interesuar është padyshim pala fituese në procesin gjyqësor, të cilit në opinionin tonë duhet që domosdoshmërisht t'i njoftohet kërkesa dhe t'i kërkohet që të paraqesë parashtrimet e tij. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për procedurat përpara gjykatës së arbitrazhit.<sup>487</sup> Kjo nuk përjashton që të thirren edhe palë të tjera që kanë qenë pjesë e procesit gjyqësor të kundërshtuar. Në rastin kur kërkesa është paraqitur kundër një vendimi administrativ atëherë subjekt i interesuar është organi administrativ që ka nxjerrë aktin apo ka kryer veprimin si edhe palët e tjera që mund të jenë përfshirë.

Kërkesa e individëve për tu ankuar për shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, shqyrtohen fillimisht nga Kolegji i Gjykatës Kushtetuese. Shqyrtimi paraparak në Kolegji ka si qëllim të shmangë problematikën që shoqëron gjykatat kushtetuese dhe pikërisht mbingarkesën e tyre e cila sjell pasoja negative lidhur me kohëzgjatjen e procedurave dhe

<sup>481</sup> Vendimi nr.22, datë 26.7.2006 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>482</sup> Po aty.

<sup>483</sup> Oniszczyk, Jerzy, *“The right to a fair trial in the decisions of the Polish Constitutional Tribunal”*, botuar në *“The right to a fair trial”*. Koleksioni *“Shkenca dhe teknika të demokracisë”*, nr.28, botim i Komisionit Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias), Gjermani 2000, fq. 146.

<sup>484</sup> Pirdeni, Adea, *“Vështrim i shkurtër mbi aksesin e individit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”*, botuar në *“Sistemi kushtetues dhe sfidat e tij”*, Revista *“Studime Juridike”*, botim i Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Shtëpia Botuese *“Adelprint”*, Tiranë 2009, fq.121.

<sup>485</sup> Rasti i parë është përcaktuar me vendimin nr. 8, datë 3.11.1994 të Gjykatës Kushtetuese, dhe më pas ka pasur një jurisprudencë të vazhdueshme për sa i përket gjyqtarëve të cilët domosdoshmërisht duhet të kishin ezauruar rrugët e tjera juridike.

<sup>486</sup> Pirdeni, Adea, *“Vështrim i shkurtër mbi aksesin e individit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”*, botuar në *“Sistemi kushtetues dhe sfidat e tij”*, Revista *“Studime Juridike”*, botim i Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Shtëpia Botuese *“Adelprint”*, Tiranë 2009, fq.122.

<sup>487</sup> Momcinovic, Hrvoje, *“Contesting the arbitration decision in the proceedings before the Constitutional Court according to the croatian law”*, botuar në *“The protection of fundamental rights by the constitutional court”*, Koleksioni *“Shkenca dhe teknika të demokracisë”*, nr.15”, botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998, fq. 89.

cilësinë e praktikës vendimmarrëse.<sup>488</sup> Prandaj, shumë gjykata kushtetuese e kanë përshtatur organizimin e punës nëpërmjet dhomave të specializuara për ankimet kushtetuese.<sup>489</sup> Disa vende kanë përpunuar rregulla të ndryshme procedurale mbi bazën e të cilave gjykata bën vlerësimin paraprak të kërkesave. Kështu në Gjermani, ankimi kushtetues kalon për shqyrtim vetëm nëse: a) ankimi paraqet rëndësi sa i përket aspektit kushtetues, pra është një çështje e re e pavendosur më parë nga ajo Gjykatë, ose b) ankimi është i rëndësishëm për zbatimin e së drejtës themelore për të cilin bëhet ky ankim, gjë e cila pohohet edhe nëse nuk merret vendim pozitiv lidhur me kërkesën dhe kërkuetit mund t'i vijin pasoja negative të rënda nga ky fakt dhe c) ankimi ushtrohet brenda afatit.<sup>490</sup>

Në parim, një përjasje normative e rregullt kërkon që aspektet thelbësore të ankimit kushtetues të përcaktohen sa më të detajuara që të jenë të mundur në Kushtetutë.<sup>491</sup> Nga Kushtetuta, LGJK dhe jurisprudenca e kësaj Gjykate rezultojnë në vija të përgjithshme këto kushte procedurale, të nevojshme në mënyrë që kërkesa e një individi të ketë sukses dhe të pranohet për shqyrtim nga Kolegji apo Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

**Kriteri i parë** i cili përmendet nga neni 134, pika 2 dhe nga jurisprudenca e Gjykatës është interesi i drejtpërdrejtë i kërkuetit. Nga formulimi i kësaj dispozite por edhe nga parashikimet e nenit 131 shkronja "f" të Kushtetutës rezulton se "*Interesi*" për të paraqitur kërkesën është marrëdhënia që krijohet ndërmjet *situatës së paligjshme që denoncohet* i ardhur si pasojë e vendimeve gjyqësore apo administrative dhe *vendimit gjyqësor që duhet të merret* nga Gjykata Kushtetuese për të riparuar këtë paligjshmëri.

Këto dispozita Kushtetuese dhe qëndrimi i mbajtur nga jurisprudenca tregojnë se *interesi* për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor duhet të ekzistojë në mënyrë të saktë tek ai që paraqet kërkesën, pasi vetëm titullari i një të drejte mund ta ushtrojë në mënyrë të vlefshme këtë mjet për të kërkuar mbrojtjen juridike që ai ofron. Të provuarit të interesit në çështjen në shqyrtim është një element i detyrueshëm për ankimin kushtetues, pavarësisht se në shumicën e sistemeve nuk vendosen pengesa shumë të forta për legjitimitimin e individit.<sup>492</sup>

Më tej Gjykata Kushtetuese e ka bërë të qartë se neni 131, shkronja "f" e Kushtetutës i ka dhënë të drejtë individit të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese vetëm për shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese për një proces të rregullt ligjor dhe jo për pretendime për cënimin e të drejtave të personave të tjerë.<sup>493</sup> Nga sa më sipër Gjykata Kushtetuese nuk ka marrë në shqyrtim kërkesat e paraqitura pranë saj nga subjekte të cilat kanë kundërshtuar vendimet gjyqësore edhe pse këto vendime kanë qenë në favor të tyre, me arsyetimin se në këtë rast këtyre subjekteve u mungon interesi për të iniciuar një gjykim të tillë kushtetues.<sup>494</sup> Po nga Gjykata si mungesë

<sup>488</sup> Vorpsi, Arta, "Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë", botim i Fondacionit Konrad Adenaur, Shtëpia Botuese "Maluka", Tiranë 2011, fq.31.

<sup>489</sup> Sadushi, Sokol, "Drejtësia kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq.316.

<sup>490</sup> Vorpsi, Arta, "Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë", botim i Fondacionit Konrad Adenaur, Shtëpia Botuese "Maluka", Tiranë 2011, fq.31.

<sup>491</sup> Castro, J.L. Cascajo, "Rights suitable for protection by constitutional appeal procedures", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të Demokracisë", Nr.15, ribotim 1998, fq.17.

<sup>492</sup> Sadushi, Sokol, "Drejtësia kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq.318.

<sup>493</sup> Vendimi nr.44, datë 26.12.2007 i Gjykatës Kushtetuese. Shih edhe vendimin nr.58 datë, 3.6.2011 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>494</sup> Vendimi nr.141, datë 25.11.2011 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese, parag.7.

interesi është konsideruar edhe kundërshtimi i vendimeve gjyqësore, ku subjekti kërkues nuk ka qenë palë në të.<sup>495</sup>

**Kriteri i dytë** rezulton nga formulimi i nenit 131, gërma “f” e Kushtetutës i cili parashikon takstativisht që një subjekt të legjitimohet për t’iu drejtuar gjykatës kushtetuese është e domosdoshme që të ketë ezauruar paraprakisht të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij. Ky është një kusht paraprak, i cili nuk mundet që të anashkalohej. Ezaurimi i këtyre mjeteve është i nevojshëm vetëm nëse ato janë efektive. Instanca e ankimit sipas nenit 13 të KEDNJ, duhet të shqyrtojë jo vetëm nga ana substanciale çënimet e të drejtave të garantuara nga Konventa, por edhe të garantojë dhe mbrojtje juridike të përshtatshme.<sup>496</sup> Ezaurimi i kësaj rruge nuk kërkon vetëm që formalisht palët të ezaurojnë ankimet pranë organeve përkatëse, gjyqësore apo administrative, por kërkon domosdoshmërisht që pretendimet të jenë ngritur në çdo shkallë të gjyqimit. Shterimi i mjeteve ka një kuptim më të gjerë se vetëm paraqitja e çështjes nëpër sistemin gjyqësor. Pala e cila mendon se e drejta e tij/saj është çënuar duhet të tërheqë vëmendjen e gjykatës së zakonshme mbi çënimin e pretenduar dhe të kërkojë rivendosjen e së drejtës prej saj.<sup>497</sup> Kjo kërkesë është e nevojshme duke pasur parasysh natyrën e gjyqësorëve që zhvillon pushteti gjyqësor në bazë të kodeve të procedurave civile, penale dhe LGJA-së. Në këto legjislacione përcaktohet se gjykatat kanë si rregull rol pasiv (bën disi përjashtim gjykata administrative por edhe në këtë rast roli i saj mbetet kryesisht pasiv). Në këto raste, e drejta e disponimit i takon palëve në proces të cilat kanë liri të plotë në paraqitjen e pretendimeve. Nëse palët nuk i paraqesin këto pretendime atëherë gjykata nuk mundet që t’i shqyrtojë ato kryesisht. Kjo vlen veçanërisht në momentin e paraqitjes së ankimit apo të rekursit si mjete procedurale – ankimore të zakonshme të njohura nga legjislacioni procedural. Kështu neni 459 i K.Pr.C. parashikon se kur kërkesat dhe pretendimet e pamarra parasysh në vendimin e shkallës së parë nuk përsëriten në ankim, konsiderohet sikur është hequr dorë prej tyre, ndërsa neni 478 i K.Pr.C. parashikon se nuk pranohet depozitimi i akteve dhe dokumenteve që nuk janë paraqitur në shkallën e mëparshme të gjyqimit, përveç atyre që kanë të bëjnë me vendimin e ankimit dhe pranimin e rekursit ose të kundërrekursit.

Pra siç rezulton qartësisht nga këto dispozita procedurale, gjykatat e apelit dhe Gjykata e Lartë e kanë të ndaluar nga ligji që të marrin në shqyrtim pretendime të tilla të pangritura më parë në ankim apo rekurs dhe për rrjedhojë nuk mund t’i japin përgjigje atyre. Në këto raste duke qenë se funksioni i Gjykatës Kushtetuese është subsidiar, nuk mundet që kjo gjykatë të zëvendësojë organet e zakonshme të pushtetit gjyqësor dhe të dëgjojë palët në lidhje me pretendime të cilat nuk ishin ngritur më parë, duke vënë në këtë mënyrë në pozitë të disfavourshme edhe palën gjyqësore e cila do të gjendej përballë disa argumentave për të cilat nuk kishte pasur mundësinë që t’i kundërshtonte para shkallëve të tjera.

Nëse i referohemi jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, shterimi i mjeteve si në kuptimin formal dhe material mund të marrë disa kuptime dhe forma të ndryshme. Përsa i përket kërkesave që vijnë në Gjykatën Kushtetuese dhe që kanë për bazë mosmarrëveshjet civile, për

<sup>495</sup> Vendimi nr.33, datë 4.3.2013 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese. Shih edhe vendimet nr.87 datë 12.7.2013 dhe nr.123, datë 4.11.2011 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>496</sup> Vorpsi, Arta, “Ankimi individual në Gjykatën Kushtetuese Shqiptare – Mjet juridik efektiv?”, botuar në “Mekanizmat mbrojtës të të drejtave të individëve në kuadër të procesit të rregullt ligjor”, Shtëpia Botuese “Pegi”, Tiranë 2012, fq. 105.

<sup>497</sup> Scibert, Helga, “Admissibility requirements for constitutional complaints and mechanisms for avoiding an excessive case load”, botuar në “The protection of fundamental rights by the constitutional court”, Koleksioni “Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15”, botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998, fq. 148.



nga natyra e tyre, disa pretendime duhet që të ngrihen që në fillim, që në gjykimin në shkallë të parë. Kështu për shembull nga Gjykata Kushtetuese bazuar në rregullat procedurale, pretendimet për mënyrën e formimit të trupit gjykues duhet që të ngrihen menjëherë që gjykimin në shkallë të parë.<sup>498</sup> Në lidhje me paanshmërinë e trupit gjykues në përputhje me nenin 74 të K.Pr.C. duhet që të ngrihet që në momentin që palët janë në dijeni të shkakut ligjor dhe të përsëritet në shkallët e tjera të gjyimit.<sup>499</sup> Duke u bazuar në të njëjtin argument edhe pretendimi për respektimin e parimit të sigurisë juridike si rezultat i respektimit të parimit të gjësë së gjykuar, duhet që të ngrihet përpara gjyimit që zhvillohet përpara gjykatave të zakonshme.<sup>500</sup> Nëse një gjykim në shkallë të parë është zhvilluar në mungesë të tij, atëherë individi duhet që të përdorë mjetin procedural të rivendosjes në afat dhe jo të ankimimit drejtpërsëdrejti në Gjykatën Kushtetuese.<sup>501</sup> Përsa i përket mënyrës së marrjes së provave apo kundërshtimit për marrjen e tyre, si edhe ndaj aktit të ekspertimit, duhet që edhe këto pretendime të ngrihen në të gjitha shkallët ankimore, në mënyrë që të merren në konsideratë nga Gjykata Kushtetuese.<sup>502</sup> Në këtë drejtim në rast se gjykata e shkallës së parë i ka mohuar një palë të drejtën e paraqitjes apo të marrjes së një prove të rëndësishme, pala nuk duhet që të kufizohet që këtë pretendim ta ngrejë vetëm në ankim por në përputhje me nenin 465 të K.Pr.C. duhet që të kërkojë përpara gjykatës së apelit edhe riçeljen e hetimit gjyqësor me qëllim marrjen e provës së mohuar në shkallën më të ulët.<sup>503</sup> Po kështu për çdo shkelje të konstatuar në gjykatën e apelit si paanshmëria e trupit gjykues, parimi i sigurisë juridike, ndryshimi i shkakut dhe i objektit të padisë në gjykimin në apel etj., palët duhet që fillimisht t'i ngrenë në rekursin që paraqesin përpara Gjykatës së Lartë.<sup>504</sup> I vetmi pretendim që mund të ngrihet në këtë rast lidhet me cënimin e të drejtës së kërkuesve për ankim apo akses në Gjykatën e Lartë. Në këtë prizëm, Gjykata Kushtetuese do t'i duhet që të analizojë nëse palët janë penguar për shkaqe që nuk varen nga vullneti i tyre për të paraqitur një rekurs të plotë në Gjykatën e Lartë.<sup>505</sup> Nëse janë penguar atëherë pretendimet e tyre do të merren në konsideratë dhe nëse rezultojnë se nuk janë penguar, atëherë kërkesa do të rrëzohet për shkak të mos shterimit të mjeteve juridike.

Për rrjedhojë mosparashtrimi i pretendime, bën që kërkesa të konsiderohet e papranueshme për shkak të mos ezaurimit të mjeteve juridike, pavarësisht se formalisht të gjitha shkallët mund të jene ezauruar nëpërmjet mjeteve ankimore të parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Kjo kërkesë është e domosdoshme për shkak se ngritja e pretendimeve të ndryshme në një

<sup>498</sup> Vendimi nr.9, datë 9.5.2005 i Gjykatës Kushtetuese. Shih edhe vendimin nr.1, datë 16.1.2006 të Gjykatës Kushtetuese. Shih edhe vendimin nr. 43, datë 19.05.2009 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>499</sup> Vendimi nr.27, datë 27.7.2009 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>500</sup> Vendimi nr.1, datë 25.1.2010 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>501</sup> Vendimi nr.35, datë 13.3.2012 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Shih edhe vendimin nr.25 datë 16.3.2010 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>502</sup> Vendimi nr.3, datë 23.1.2014 i Gjykatës Kushtetuese, par.29. Shih edhe vendimin nr.92, datë 19.7.2012 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, par.16. Shih edhe vendimin nr. 41, datë 15.05.2009 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>503</sup> Vendimi nr.16, datë 19.4.2013 i Gjykatës Kushtetuese, par.16. Shih edhe vendimin nr.107 datë, 26.9.2011 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>504</sup> Vendimi nr.2, datë 16.2.2006 i Gjykatës Kushtetuese. Shih edhe vendimet nr.16, datë 24.2.2009, nr.9, datë 15.3.2013, par.15, nr.56, datë 5.12.2014, par.7, nr.28, datë 15.5.2014, par.11, nr.31, datë 10.7.2013, par.24, dhe vendimi nr.38, datë 30.6.2014, par.32 të Gjykatës Kushtetuese. Shih edhe vendimet nr.49, datë 1.6.2009, nr.69, datë 11.10.2010, nr.89, datë 16.10.2009, nr.58, datë 3.6.2011, nr.7 datë 21.1.2013, nr. 24 datë 8.2.2013, nr.25, datë 1.3.2012, nr.53, datë 20.4.2012, nr.60, datë 17.5.2013, nr.69 datë 1.6.2012, nr.74, datë 07.06.2013, nr.76 datë 28.6.2013 dhe nr.80, datë 4.7.2013 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>505</sup> Vendimi nr.37, datë 30.6.2014, i Gjykatës Kushtetuese, par.23.



shkallë tjetër gjyqësore përbën cënim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor pasi u mohon palëve mundësinë e kontradiktorialitetit dhe të barazisë së armëve. Në lidhje me këtë pikë Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin se:

*Në jurisprudencën e Gjykatës është pranuar se gjykimi kushtetues synon të vlerësojë nëse procesi si i tërë ka qenë i rregullt, duke u ndaluar në ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të palëve në proces. Në vendimet e veta Gjykata nuk ka pranuar cënimin e parimit për një proces të rregullt ligjor në rastet kur gjykata e shkallës më të lartë, duke u bazuar në kompetencat që i jep Kodi i Proçedurës, ka plotësuar apo ka korrigjuar mangësitë dhe gabimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor (Shih vendimin nr.21, datë 1.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese). Por, në rastin në shqyrtim, nuk rezultoi që gjykatat e sistemit gjyqësor të kenë plotësuar standardet e gjykimit, sidomos në dhënien e mundësive Avokaturës së Shtetit për të siguruar mbrojtjen e interesave publikë. Kjo e fundit nuk është njoftuar e nuk i janë dërguar aktet për gjykimin në shkallë të parë dhe në këtë mënyrë i është mohuar një shkallë gjykimi për të paraqitur prova, për të dëgjuar pretendimet e palës tjetër e për të bërë prapësimet e duhura ndaj aktit të ekspertimit. Sipas pretendimit të përfaqësuesit të Avokaturës së Shtetit, kjo e fundit nuk kishte dijeni as për gjykimin në apel dhe, pjesëmarrja e punonjësës së saj në këtë gjykim ishte rastësore. Por, edhe sikur të ishin dërguar rregullisht kopjet e akteve të gjykimit dhe të ishte njoftuar rregullisht për gjykimin në apel, pjesëmarrja e Avokaturës së Shtetit nuk do të mund të realizonte një mbrojtje efektive, të riparonte mangësitë themelore proçedurale që kishin të bënin me mosnjoftimin e pjesëmarrjen e palëve, mosrespektimin e juridiksionit dhe kompetencën etj., të cilat gjykata e apelit, sipas nenit 467 të Kodit të Proçedurës Civile, nuk mund t'i korrigjojë vetë, dhe për këtë arsye është e detyruar të prishë vendimin e gjykatës së shkallës së parë e ta dërgojë çështjen për rigjykim.<sup>506</sup>*

Gjykata Kushtetuese ka refuzuar për të pranuar pretendimet për cënimin e parimit kushtetues për një proces të rregullt ligjor, në rastet kur gjykata e shkallës më të lartë ka plotësuar apo korrigjuar mangësitë e gjykatës më të ulët në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor.<sup>507</sup> Pra, e drejta për një proces të rregullt ligjor mbulon të gjitha fazat e një procesi, që nga inicimi deri në vendimin përfundimtar. Kjo për më tepër zbatohet në të gjitha shkallët e gjykimit.<sup>508</sup>

Mjetet juridike konsiderohen se nuk janë shteruar edhe në ato raste kur gjykata me e lartë ka prishur vendimin e gjykatës më të ulët dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim. Në këtë rast ende nuk ka një vendim përfundimtar për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe për rrjedhojë çështja

<sup>506</sup> Shih Vendimin Nr. 27, datë 27.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>507</sup> Vorpsi, Arta, "Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë", botim i Fondacionit Konrad Adenaur, Shtëpia Botuese "Maluka", Tiranë 2011, fq.76.

<sup>508</sup> Freixes, Teresa, "The right to a fair trial in Spain", botuar në "The right to a fair trial", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të demokracisë", nr.28, botim i Komisionit Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias), Gjermani 2000, fq. 70.

është ende pjesë e juridiksionit gjyqësor. Në këtë drejtim edhe ndonjë shkelje e së drejtës për një proces të rregullt ligjor mundet që të riparohet nga gjykata e zakonshme.<sup>509</sup>

Në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese fillimisht ndodhte që shpeshherë palët i drejtoheshin Gjykatës Kushtetuese mbasi i kishin ezauruar rrugët e tjera, por shkalla e fundit e gjyqësorit, Gjykata e Lartë, kishte vendosur mosshqyrtimin e çështjes për shkak se sipas saj nuk ndodheshim përballë rasteve të parashikuara nga dispozitat përkatëse të kodeve të procedurave civile dhe penale. Këtë moment fillimisht Gjykata Kushtetuese e konsideronte si mosezaurim të rrugëve të brendshme dhe nëse konstatonte shkelje, atëherë ajo prishte vendimin e kolegjeve të Gjykatës së Lartë dhe i detyronte që fillimisht të ishte kjo gjykatë që të shprehej në lidhje me pretendimet e palës kërkuese, dhe pastaj kjo palë mund të ankohej në Gjykatën Kushtetuese. Kështu në vendimin e saj nr.41, datë 29.12.2005 Gjykata Kushtetuese është shprehur se

*Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese vlerëson se pretendimet e parashtruara si në Gjykatën e Lartë, ashtu edhe në këtë Gjykatë janë të rëndësishme për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme. Gjykata e Lartë duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me to, sepse kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, e aq më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj.*

Kjo lloj praktike duket sikur e ktheu Gjykatën Kushtetuese në një lloj kolegji seleksionues për llojin e çështjeve që duhet të gjykonte Gjykata e Lartë. Më vonë kjo praktikë u ndryshua përsëri dhe pavarësisht se Gjykata e Lartë ishte shprehur për mosshqyrtimin e një çështjeje, përsëri është konsideruar se pala kërkuese i ka ezauruar rrugët juridike dhe tashmë mund t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë përsëri kjo praktikë nuk mundet që të konsiderohet e konsoliduar. Mbas një periudhe disa vjeçare Gjykata Kushtetuese i'u rikthye përsëri praktikës së vjetër duke mos e zgjidhur vetë çështjen por duke ia kthyer Gjykatës së Lartë pasi rekursi përmbante shkaqe për të cilat ajo duhej të shprehej.<sup>510</sup> Ky qëndrim duket se është përforcuar edhe me një tjetër standard që ka përcaktuar Gjykata Kushtetuese, kundrejt Gjykatës së Lartë për respektimin e saj të procesit të rregullt ligjor. Kështu sipas Gjykatës Kushtetuese:

*23. Gjykata ka theksuar se, bazuar në nenin 480 të KPC-së, është në kompetencë të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) të analizojë dhe të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Në rast se Kolegji, në dhomën e këshillimit, krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Megjithatë,*

<sup>509</sup> Vendimi nr.63, datë 29.5.2013 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, parag.8. Shih edhe vendimet nr.12, datë 13.2.2009, nr.72, datë 22.10.2010, nr.73, datë 18.9.2009, nr.95, datë 6.11.2009, nr.23, datë 24.2.2012 dhe nr.23, datë 8.2.2013 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>510</sup> Shih vendimet nr.4, datë 28.2.2006, nr.19 datë 2.4.2012, nr.21 datë 16.04.2012, nr.58 datë 24.12.2012, nr.36 datë 25.7.2013, nr.42 datë 7.7.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

*Gjykata ka theksuar se kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit, për mospranimin e rekursit, vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor.*

*24. Sa më sipër, Gjykata vlerëson se, nisur nga natyra e pretendimeve të paraqitura në rekurs nga kërkuesit, mungesa e arsytimit të argumenteve në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), përbën një mangësi në përmbajtjen dhe në arsytimin e vendimit të asaj gjykate.<sup>511</sup>*

Ky lloj argumenti i Gjykatës Kushtetuese, i cili bazuar në forcën e precedentit, i detyron tashmë kolegjet e Gjykatës së Lartë që edhe kur gjykojnë në dhomë këshillimi, janë të detyruara të mbajnë një qëndrim të shprehur dhe të arsyetuar në lidhje me mospranimin e rekursit për shqyrtim, në rast se në këtë rekurs janë paraqitur shkaqe që pretendojnë proces të parregullt ligjor. Në këtë mënyrë pra, praktikisht bazuar edhe në këtë standard të ri Gjykata Kushtetuese mund të vendosë rikthimin e çështjes në Gjykatën e Lartë vetëm pse kjo gjykatë nuk ka mbajtur gjykim të shprehur.

Personalisht jam i mendimit se rikthimi i kësaj praktike është i gabuar. Gjykata Kushtetuese nuk ka kompetencën që t'i thotë Gjykatës së Lartë se cilat çështje duhet të marrë në shqyrtim. Gjykata e Lartë me marrjen e vendimit të mospranimin të rekursit e ka mbajtur qëndrimin e saj, atëherë Gjykata Kushtetuese nuk mund ta urdhërojë atë të mbajë një tjetër qëndrim. Edhe standardi i ri i arsytimit të vendimeve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi që kërkon Gjykata Kushtetuese, në rast se në rekurs ka pretendime për proces të parregullt, është një barrë e rëndë për Gjykatën e Lartë. Kështu formalisht tashmë palët që ushtrojnë të drejtën e rekursit do të ngrejë qoftë edhe formalisht pretendime të tilla dhe në këtë rast Gjykata e Lartë do e kishte më të lehtë që çështjen ta kalonte për gjykim sesa ta vlerësonte në dhomë këshillimi.

Mesa duket ky standard i ri i kërkuar nga Gjykata Kushtetuese ka pasur si qëllim që ta shkarkojë atë nga ngarkesa e çështjeve për proces të parregullt ligjor, ngarkesë e cila po vjen duke u rritur gjithmonë e më shumë. Megjithatë kjo përpjekje e Gjykatës Kushtetuese nuk duhet të shkojë në drejtim të kundërt, pra të rrisë artificialisht barrën e çështjeve në Gjykatën e Lartë. Për me tepër që edhe sipas jurisprudencës së GJEDNJ, arsytimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomë këshillimi, në mënyrë të nënkuptuar evidenton se aplikanti nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës. GJEDNJ ka vërejtur se, kur Gjykatë e Lartë ka refuzuar të pranojë një çështje, për arsye se mungojnë shkaqet ligjore për ngritjen e çështjes, një arsytim shumë i kufizuar mund të përmbushë kriterin e nenit 6 të Konventës.<sup>512</sup>

Një tjetër aspekt që ka të bëjë me shterimin e mjeteve është edhe lloji i padisë që mund të ngrejë individi në gjykatat e zakonshme. Nëse individi ka mundësi të tjera juridike atëherë ai duhet që t'i përdorë ato në tërësi. Kështu në rast se një organ administrativ nuk vepron atëherë

<sup>511</sup> Vendimi nr.3, datë 23.1.2014 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>512</sup> GJEDNJ, vendimi i Dhomës së Katërt, ankimi nr. 3738/02, çështja "Marini kundër Shqipërisë", datë 18.12.2007, paragraf.105-106; GJEDNJ, vendimi i Dhomës së Katërt, ankimi nr. 18381/05, çështja "Mishgjonit kundër Shqipërisë", datë 07.12.2010, paragraf. 51.

individui ka mundësinë që t'i drejtohet gjykatës me padi për detyrimin e organit administrativ të nxjerrë aktin përkatës.<sup>513</sup>

Në lidhje me gjykimet për pjestimin e pasurive, personi ka të drejtë që të ankohet edhe kundër vendimit të fazës së parë të pjestimit i cili si vendim *sui generis* konsiderohet përfundimtar.<sup>514</sup> Por individët mbasi kanë përfunduar edhe fazë e dytë të pjestimit nuk mundet që të ngrenë pretendime për fazën e parë të tij.<sup>515</sup>

Në lidhje me shterimin e mjeteve përsa i përket ekzekutimit të vendimeve gjyqësore apo edhe administrative të formës së prerë, jurisprudenca kushtetuese ka përcaktuar se edhe në këtë rast individui duhet që të jetë aktiv në përputhje me të gjitha rregullat procedurale në kërkimin e ekzekutimit të këtyre akteve. Pasiviteti i tij për të ndjekur procedurat ligjore sjell si pasojë mungesën e shterimit të mjeteve juridike në dispozicion të tij dhe për rrjedhojë mungesë të juridiksionit kushtetues.<sup>516</sup>

Përsa i përket kërkesave për gjykimin e pretendimeve, për gjykimin e çështjeve tej afatit të arsyeshëm, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrime të kundërta. Fillimisht ajo nuk ka pranuar për shqyrtim këto kërkesa me arsyetimin se në fillim duhej që të përfundonte procesi gjyqësor në tërësinë e tij, duke u bazuar në rregullin klasik sipas të cilit duhet që të ezaurohen të gjitha shkallët e gjyqësorit.<sup>517</sup> Kjo situatë ndryshoi më pas ku Gjykata Kushtetuese, duke mbajtur një qëndrim diametralisht të kundërt u shpreh:

*Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese konstaton se sistemi juridik i vendit nuk parashikon ndonjë mjet juridik të veçantë, të cilin mund ta përdorte kërkuesja për të kërkuar riparimin e zgjatjes së tepruar të procesit gjyqësor. Një gjë e tillë është konstatuar edhe nga GJEDNJ-ja, në vendimin dt.23.10.2007, Gjonboçari kundër Shqipërisë, apl. Nr.10508/02, par.77, - në të cilin është shprehur se, duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se Qeveria pranoi, veç ankesës kushtetuese, se sistemi juridik shqiptar nuk parashikonte një mjet të veçantë juridik, të tillë si ato të cilëve u referohet Gjykata në Kudla (cituar më sipër), të cilin aplikanti mund ta kishte përdorur për riparimin e zgjatjes së tepruar të procesit. Të njëjtën gjë GJEDNJ-ja e ka konstatuar edhe në vendimin Marini kundër Shqipërisë, datë 7.7.2008, apl. Nr.3738/02, par. 154; në vendimin Hamzaraj kundër Shqipërisë, datë 3.2.2009, par.30, apl. nr.45264/04, në të cilin shprehet se Gjykata rikujton konstatimin në vendimin e saj datë 23.10.2007, Gjonboçari kundër Shqipërisë, apl. Nr.10508/02, par.77, ku ka konstatuar se në sistemin e brendshëm juridik nuk ka pasur mjete juridike efektive lidhur me te zgjatjen e procesit; për pasojë, aplikanti shkarkohet nga shterimi i mjeteve të brendshme.<sup>518</sup>*

Pra, shikohet lehtësisht se jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka arritur në përfundimin se sistemi juridik shqiptar nuk ofron asnjë mjet tjetër që ndihmon në zgjidhjen e këtyre pretendimeve. Madje në vendimin e sipërcituar Gjykata analizon një sërë mjeteve procedurale

<sup>513</sup> Vendimi nr.36, datë 7.3.2013 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, parag.12. Shih edhe vendimet nr.69, datë 1.7.2011, nr.74, datë 14.7.2011, nr.75, datë 14.7.2011, nr.78, datë 18.7.2011, nr.79, datë 18.7.2011, nr.68, datë 18.5.2012, nr.87, datë 12.7.2013 dhe nr.112 datë 8.10.2012 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>514</sup> Vendimi nr.24, datë 12.11.2008 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>515</sup> Vendimi nr.36, datë 3.4.2009 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>516</sup> Vendimi nr.105, datë 24.12.2010 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>517</sup> Vendimi nr.27, datë 25.3.2009 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>518</sup> Vendimi nr.12 datë 5.3.2012 i Gjykatës Kushtetuese



dhe i konsideron ato si jo efektive.<sup>519</sup> Ajo që vihet re në këtë rast është edhe fakti që Gjykata Kushtetuese, ka hequr dorë nga kërkimi që ngritja e këtij pretendimi mund të bëhet vetëm në ato raste kur kanë shteruar të gjitha mjetet juridike dhe për rrjedhojë kemi një vendim përfundimtar. Tashmë sipas kësaj jurisprudence këto kërkesa mund të paraqiten edhe nëse procesi në gjykatat e zakonshme është duke vazhduar, mjafton që kërkesa të jetë e bazuar.

Një tjetër rast që na është ofruar nga praktika gjyqësore lidhet me mosshkrimin e mjeteve, ka të bëjë me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për pensionet e ushtarakeve. Në rastin konkret me miratimin e ligjit të ri për pensionet e ushtarakëve, ishte përcaktuar që të gjitha pensionet do të rillojariten. Duke i dhënë fuqi prapavepruese këtij ligji, vetiu ekzekutimi i vendimeve gjyqësore pezullohej. Në këtë rast individit nuk mundet që të ankohet drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese por duhet që t'i drejtohet juridiksionit të gjykatave të zakonshme dhe më pas Gjykatës Kushtetuese.<sup>520</sup>

Një tjetër element që duhet të merret në konsideratë lidhet me faktin se pavarësisht se vendimi i formës së prerë konsiderohet ai i gjykatës së apelit, Gjykata Kushtetuese nuk i merr në shqyrtim kërkesat që pretendojnë cënim të së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mos ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, nëse kundër vendimit të gjykatës së apelit është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. Edhe në këtë rast sipas Gjykatës ndodhemi në kushtet e mos shërimit të mjeteve juridike.<sup>521</sup>

Në çështjet me natyrë penale, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur të njëjtin qëndrim. Kështu pretendimet për shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor (të ngritura të paktën substancialisht) që nuk janë ngritur në ankim<sup>522</sup> apo në rekurs<sup>523</sup> nuk merren në konsideratë nga Gjykata Kushtetuese.

Duke qenë se gjykimi i veprave penale është i ndarë midis kompetencës lëndore të gjykatave të zakonshme dhe të gjykatës për krimet e rënda, atëherë rezultojnë që pretendimi që duhet të kenë kërkuesit në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatës, para së cilës janë paraqitur për gjykim, duhet që të ngrihet që në fillim dhe në rast përgjigjeje negative duhet që të ngrihet në ankim dhe rekurs. Në këtë drejtim nuk quhet shterim i mjeteve juridike nëse ky pretendim është ngritur nga bashkë të pandehur të tjerë.<sup>524</sup>

<sup>519</sup> Pretendimi për shterimin e këtyre mjeteve ishin ngritur nga Avokatura e Shtetit dhe kishin të bënin me mungesën e një vendimi përfundimtar, ngritja e një padie në gjykatën e zakonshme në bazë të ligjit nr. 8510 datë 15.07.1999 "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore", kërkimi për zbatimin e drejtpërdrejtë të neneve 15/2 e 44 të Kushtetutës, kërkuesja mund të invokonte edhe nenin 467/a të Kodit të Procedurës Civile ("Gjykata e apelit, kur prish vendimin, nuk mund ta kthejë çështjen për rigjykim për të dytën herë, por e shqyrton vetë si gjykatë e shkallës së parë. Kur vendimi prishet për shkak të moszbatimit të detyrave të caktuara nga gjykata më e lartë, pa u marrë vendim i veçantë sipas nenit 467 të këtij Kodi, gjykata e apelit, me kërkesë të palëve, ngarkon trupin gjyqësor përkatës me shpenzimet e bëra për këtë shkak"), ankimi në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Të gjitha këto pretendime u konsideruan nga Gjykata Kushtetuese se nuk ofronin një zgjidhje efektive për rivendosjen e së drejtës së kërkueses.

<sup>520</sup> Vendimi nr.14, datë 31.1.2012 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>521</sup> Vendimi nr. 97, datë 13.11.2009 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>522</sup> Vendimi nr.21, datë 16.4.2012 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>523</sup> Vendimi nr.17, datë 16.5.2011 i Gjykatës Kushtetuese. Shih edhe vendimet nr.45, datë 23.7.2012 dhe nr.58, datë 24.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>524</sup> Vendimi nr.26, datë 8.5.2012 i Gjykatës Kushtetuese, parag.12.Shih edhe vendimin nr.33, datë 24.5.2012, i Gjykatës Kushtetuese, parag.12.

Edhe në rastin kur çështja kthehet për rigjykim jemi në mungesë të një vendimi përfundimtar dhe për rrjedhojë nuk mundet që të themi se jemi përpara shterimit të mjeteve juridike.<sup>525</sup>

Përsa i përket çështjeve gjyqësore me natyrë administrative shterimi i mjeteve përfundon në varësi të llojit të vendimit. Kështu nenet 45 dhe 54 të LGJA përcaktojnë taksativisht që për kategori të caktuara çështjesh nuk mundet që të ushtrohet ankimi për në gjykatën administrative të apelit apo rekursi për në Gjykatën e Lartë. Në këto raste mjetet juridike do të konsiderohen të shteruara respektivisht në gjykatën administrative të shkallës së parë nëse kundër këtij vendimi nuk lejohet ankimi, apo në gjykatën administrative të apelit nëse kundër këtij vendimi nuk lejohet rekursi. Përsa i përket elementëve të tjerë vlejné përgjithësisht ato që u thanë edhe për shterimin e mjeteve në gjykimin civil.

Përsa i përket vendimeve të dhëna nga gjykata e arbitrazhit vendas, kërkohet që fillimisht të ezaurohet rruga e ankimit në gjykatën e apelit.<sup>526</sup> Duke iu referuar shkaqeve të ankimit rezultojné se ato në thelb kanë të bëjnë pretendime që përfshihen në kuadër të procesit të rregullt ligjor. Pra, në këtë rast gjykata e apelit analizon nëse nga gjykata e arbitrazhit janë zbatuar apo jo rregullat e procesit të rregullt ligjor. Në rast se jo atëherë kjo gjykatë ndryshon vendimin e gjykatës së arbitrazhit dhe e zgjidh vetë çështjen në themel. Duke qenë se sipas legjislacionit në fuqi kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs<sup>527</sup> atëherë palët që pretendojné se ndaj tyre është zhvilluar një gjykim i parregullt në gjykatën e arbitrazhit, në gjykatën e apelit apo tek të dyja këto gjykata, ka të drejtën që të bëjë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, brenda afatit përkatës. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese duhet që detyrimisht të tërheqë dosjen dhe nëse kemi pasur gjykatë arbitrazhi të përkohshme duhet që dosja të tërhiqet nga gjykata shtetërore që mban këtë dosje.<sup>528</sup>

Për vendimet që marrin organet administrative dhe për të cilat nuk ka ankimi në gjykatën e zakonshme, parimi është po i njëjtë. Kështu vendimi i organit administrativ duhet që të jetë përfundimtar, dhe nëse ka ndonjë organ ankimi administrativ duhet që të jetë shteruar edhe ky i fundit.

**Kriteri i Tretë**, ka të bëjë me natyrën e kontrollit kushtetutes dhe del përsëri nga mënyra se si është formuluar neni 131 gërma "f" e Kushtetutës. Kështu individët mund të ngrejné pretendime vetëm për sa i përket shkeljeve me natyrë kushtetutese, por kurrësesi nuk mundet që të ngrejné pretendime për mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme, ose për mënyrën e vlerësimit të provave nga ana e tyre. Në parim Gjykata Kushtetuese nuk pranon ato ankime të cilat nën pretekstin e pretendimeve për shkeljen e të drejtave të mbrojtura nga Kushtetuta, në fakt nuk kanë lidhje me shkeljet kushtetutese por përfshin cënimin e parimeve dhe të drejtave jashtë sferës së mbrojtur nga ankimi kushtetutes.<sup>529</sup> Në këtë rast Gjykata Kushtetuese nuk rishikon nëse ligjet janë zbatuar në mënyrë korrekte nga

<sup>525</sup> Vendimi nr.112, datë 13.10.2011 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>526</sup> K.Pr.C., neni 434.

<sup>527</sup> K.Pr.C., neni 437: *Kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.*

<sup>528</sup> Momcinovic, Hrvoje, "Contesting the arbitration decision in the proceedings before the Constitutional Court according to the Croatian law", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të Demokracisë", botim i Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) Nr.15, ribotim 1998, fq.90.

<sup>529</sup> Castro, J.L. Cascajo, "Rights suitable for protection by constitutional appeal procedures", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të Demokracisë", botim i Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) Nr.15, ribotim 1998, fq.23.

gjykatat, me përjashtim të rastit kur një moszbatim korrekt i ligjit ka sjellë një cënim të së drejtës së mbrojtur kushtetutshëm.<sup>530</sup>

Këtë qëndrim Gjykata Kushtetuese e ka shprehur qartë në vendimin e saj nr.106, datë 1.8.2001 në të cilin ka përcaktuar se

*...mënyra e vlerësimit të provave është atribut vetëm i gjykatave të zakonshme që zgjidhin çështjen konkrete dhe nuk i nënshtrohet kontrollit të saj kushtetues.*

*Sfera e kompetencave të kësaj Gjykate për shqyrtimin e ankesave të individëve është e kufizuar. Në vështrim të nenit 131 shkronja "f" të Kushtetutës ajo gjykon çështje të kësaj natyre, por kurdoherë kërkohet që shkëlja e së drejtës kushtetuese të jetë e lidhur detyrimisht me një proces të parregullt ligjor, ku nuk përfshihet as mënyra e zbatimit të ligjit material, as mënyra e vlerësimit të provave nga ana e gjykatave të zakonshme...*

Ky vendim përbën bazën e veprimtarisë së Gjykatës Kushtetuese dhe jurisprudencë të vazhdueshme në vendimmarrjen e saj.

Gjithsesi, nga ky rregull ka përjashtime të caktuara, të cilat lidhen me vetë natyrën e kontrollit kushtetues në këto raste. Kështu pavarësisht se interpretimi dhe zbatimi i ligjit është si rregull pjesë e juridiksionit të gjykatave të zakonshme, Gjykata Kushtetuese në ushtrimin e kompetencave të saj nuk përjashtohet që ta bëjë edhe ajo vetë një interpretim të ligjeve. Por ky interpretim i ligjit bëhet në raste shumë specifike dhe gjithmonë në funksion të kompetencave kushtetuese që ky organ ka. Këtë raport dhe të drejtë për të interpretuar ligjet Gjykata Kushtetuese e ka arsyetuar në vendimin e saj nr. 5, datë 7.2.2001 në të cilin është shprehur se:

*...Përderisa Gjykata Kushtetuese bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës dhe ushtron kontrollin kushtetues të normës juridike, asaj nuk mund t'i ndalohej të bëjë interpretim të ligjeve. Gjykata Kushtetuese shqyrton pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën dhe me qëllim që të arrijë në një konkluzion përfundimtar për kushtetutshmërinë e tij është e qartë se ligjit konkret i duhet dhënë një kuptim, duke u interpretuar në të gjitha aspektet, si literal, gjyqësor, doktrinar, gramatikor, logjik, sistematik, historik, në interpretim të gjerë apo të ngushtë etj. Pikërisht, interpretimi që i bëhet ligjit në funksion të parimeve kushtetuese përbën juridiksion kushtetues dhe merr vlerën e një interpretimi përfundimtar dhe të detyrueshëm për të gjithë. Në këtë drejtim vendimi i Gjykatës Kushtetuese bëhet i detyrueshëm edhe për Gjykatën e Lartë. Prandaj jurisprudencë kushtetuese përbën çdo vendim i Gjykatës Kushtetuese, aq më tepër shqyrtimi i rastit konkret që lidhet me shkëljen e të drejtave dhe lirive themelore të individit dhe konkretisht me të drejtën e mbrojtjes dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor...<sup>531</sup>*

Qëndrim të ngjashëm mban edhe jurisprudenca kushtetuese e huaj sipas të cilit uniteti i ligjit dhe supremacia e kushtetutës nuk na lejon neve që t'i konsiderojmë këto dy plane sikur janë

<sup>530</sup> Momcinovic, Hrvoje, "Contesting the arbitration decision in the proceedings before the Constitutional Court according to the Croatian law", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të Demokracisë", botim i Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) Nr.15, ribotim 1998, fq.75.

<sup>531</sup> Ky qëndrim është mbajtur më tej edhe në Vendimin nr. 20, datë 29.09.2009 dhe nr. 23, datë 23.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese.

botë të ndryshme pa një komunikim midis tyre. Kur interpretojnë dhe zbatojnë ligjin gjykatat e zakonshme nuk mundet që të injorojnë ekzistencën e Kushtetutës. Ashtu si edhe Gjykata Kushtetuese nuk mundet që të injorojë mënyrën se si gjykatat e zakonshme zbatojnë ligjin kur është e nevojshme për të përcaktuar nëse është cënuar apo jo ndonjë nga të drejtat themelore apo liritë për të cilat jemi përgjegjës për t'i mbrojtur.<sup>532</sup>

Në lidhje me provat, Gjykata Kushtetuese mund të marrë dhe të vlerësojë prova që kanë të bëjnë me pretendimet e ngritura në kërkesë (p.sh. për të provuar fallsitetin e një nënshkrimi në njoftimin për marrjen dijeni të rekursit), por me kusht që këto prova të mos kenë të bëjnë me themelin e çështjes. Rast tjetër përjashtimor konsideroj kur kemi të bëjmë me rastin kur palët nuk ngrejnë pretendime në lidhje me mënyrën e vlerësimit të provave nga gjykatat e zakonshme por për mënyrën e marrjes dhe të administrimit të tyre. Kjo mundësi lejohet për shkak të parashikimit të nenit 32, pika 2 të Kushtetutës që parashikon se askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese nuk vlerëson provën por mënyrën e marrjes së saj për shkak të këtij standardi kushtetues të vendosur nga ligjvënësi.<sup>533</sup>

## **6. Subjektet që mund të nisin një proces për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave.**

Një situatë të veçantë në lidhje me subjektet kërkuese paraqet gjykimi kushtetues për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave. Nga mënyra e formulimit të nenit 131, gërma "ç", Kushtetuta përcakton se mosmarrëveshja mund të lindë ndërmjet pushteteve si edhe midis pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore, ndërsa neni 54, pika 3 i LGJK përcakton se subjekte në këtë procedim kushtetues mund të jenë subjektet në konflikt ose subjektet që preken drejtpërsëdrejti nga konflikti.

Kushtetuta përdor termin pushtet kryesisht në nenin 7 të saj ku përcaktohet se "sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor". Nga kjo dispozitë, mund të rezultojë se mosmarrëveshja e kompetencave mund të zhvillohet vetëm ndërmjet këtyre tre pushteteve në rrafshin horizontal si edhe në rrafshin vertikal midis organeve qendrore dhe atyre vendore, duke përjashtuar në këtë mënyrë pushtetet e tjera. Por ky interpretim megjithëse i cituar edhe në ndonjë vendim gjyqësor,<sup>534</sup> nuk ka gjetur mbështetje në jurisprudencë.

Një pjesë e doktrinës së huaj<sup>535</sup> e ndjekur nga ajo shqiptare<sup>536</sup> ka përcaktuar se me termin "pushtet" kuptohet një figurë organizatore e përbërë nga një organ ose shumë organe të lidhur në mënyrë funksionale ndërmjet tyre dhe së cilës i referohet një sferë e caktuar kompetencash e garantuar nga Kushtetuta. Ky kuptim i termit "pushtet" ka sjellë tendencën që të konsiderohen si pushtete edhe organe të cilat nuk mund t'u atribuohen drejtpërdrejtë asnjë nga të treja këto

<sup>532</sup> Vendimi nr.STC 50/84 i Gjykatës Kushtetuese të Spanjës referuar nga Castro, J.L. Cascajo, "Rights suitable for protection by constitutional appeal procedures", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të Demokracisë", Nr.15, ribotim 1998, fq.20.

<sup>533</sup> Vendimet nr.19, datë 18.9.2008, nr.95, datë 27.7.2001, nr.7, datë 27.4.2005 dhe nr.23, datë 23.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese

<sup>534</sup> Mendimi në pakicë i gjyqarit kushtetues, Vladimir Kristo, në vendimin nr.12, datë 20.5.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>535</sup> Martines, Temistocle, "E drejta kushtetuese", botim në gjuhën shqipe, Shtëpia Botuese "UET Press", Tiranë 2011, fq. 364.

<sup>536</sup> Sadushi, Sokol, "Kontrolli kushtetues", Shtëpia Botuese "Botimpex", Tiranë 2004, fq. 116.



funksiione tradicionale, duke u lënë si pasojë subjekteve të cilat legjitimohen rast pas rasti, një hapësirë më të gjerë të cilat nuk do ta kishin nëse do të njiheshin si pushtete të shtetit vetëm organet që ushtrojnë funksione legjislativë, ekzekutive dhe gjyqësore.<sup>537</sup> Pra, mund ta paraqesin kërkesën për këtë lloj gjykimi çdo subjekt i përfshirë në mosmarrëveshje.<sup>538</sup> Kjo përfaqëse nuk është gjithmonë e pranuar në vende të tjera të cilat preferojnë që subjektet që mund të venë në lëvizje drejtësinë kushtetuese për këtë lloj gjykimi janë të mirëpërcaktuar.<sup>539</sup> Në doktrinën shqiptare ka gjetur më shumë mbështetje qëndrimi i parë. Për këtë arsye është përcaktuar se Kushtetuta parashikon përveç tre pushteteve klasike edhe pushtete të tjera të cilat janë pjesë përbërëse dhe thelbësore e sistemit qeverisës së Republikës së Shqipërisë. Duke i parashikuar si pushtete, Kushtetuta i ka veshur ato me një sërë kompetencash për të realizuar detyrat e tyre funksionale. Për rrjedhojë është e pashmangshme që edhe këto subjekte të përfshihen në një mosmarrëveshje të mundshme kompetencash. Në këtë drejtim ka evoluar edhe praktika kushtetuese e cila ka përcaktuar se:

*Dispozita e shkronjës "ç" të nenit 131 të Kushtetutës përfshin mosmarrëveshjet që lindin në sferën e ndarjes së pushteteve në rrafsh horizontal (ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor), si dhe në rrafsh vertikal (pushtet qendror-qeverisje vendore). Veç këtyre, mbështetur në jurisprudencën kushtetuese, kjo dispozitë përfshin edhe një gamë tjetër mosmarrëveshjesh, siç janë ato që mund të lindin midis organesh a subjektesh që nuk bëjnë pjesë, në mënyrë të përcaktuar e kategorike, në këtë ose atë pushtet, siç janë Presidenti, Gjykata Kushtetuese, prokuroria dhe organe të tjera kushtetuese.<sup>540</sup>*

Në vijimësi të jurisprudencës së saj kjo gjykatë në një tjetër vendim është shprehur se:

*Një mosmarrëveshje kompetence që paraqitet për zgjidhje para Gjykatës Kushtetuese duhet të ketë natyrë kushtetuese, në kuptimin që subjektet e përfshira në konflikt të jenë nga ato që i njeh Kushtetuta dhe që kompetenca e pretenduar të parashikohet si e tillë.<sup>541</sup>*

Nga tërësia e vendimeve të mësipërme rezulton se një mosmarrëveshje kompetencash duhet që pikësepari të ketë natyrë kushtetuese, në kuptimin që subjektet e përfshira në konflikt të jenë nga ato që i njeh Kushtetuta, si edhe kompetenca e pretenduar të parashikohet si e tillë prej saj.<sup>542</sup>

<sup>537</sup> Cecamore, Francesca, "L'autorità indipendente come parte nel conflitto di attribuzione fra poteri dello Stato", botuar në "Le zone d'ombra della giustizia costituzionale – I giudizi sui conflitti di attribuzione e sull'ammisibilità del referendum abrogativo", botuar nga "Quaderni del "Gruppo di Pisa", nën kujdesin e Roberto Pinardi, Shtëpia Botuese "G.Giappichelli Editore", Torino 2007, fq.134.

<sup>538</sup> Di Gregorio, Angela, "La Corte Costituzionale della Russia", botuar në "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova 2009, fq.463.

<sup>539</sup> Pistan, Carna, "Le esperienze di Croazia, Slovenia, Polonia e Ungheria", botuar në "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova 2009, fq.436. Sipas autores në Poloni subjektet për një gjykim të tillë janë vetëm Presidenti i Republikës, Kryetari i Sejm-it, Kryetari i Senatit, Kryeministri, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Kryetari i Gjykatës së Lartë Administrative dhe Kryetari i Gjykatës së Llogarive.

<sup>540</sup> Vendimi nr.29, datë 21.12.2006 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>541</sup> Vendimi nr.20, datë 4.5.2007 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>542</sup> Sadushi, Sokol, "Drejtësia kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq. 509

Në fakt, Kushtetuta përmend një sërë organesh, të cilat jurisprudenca kushtetuese<sup>543</sup> i ka klasifikuar në tre kategori:

1. *Organe Kushtetuese*. Këto janë organe të cilat i shërbejnë funksionimit të shtetit dhe janë thelbësore për ekzistencën e tij. Në këtë kategori përfshihen organe të tilla si Kuvendi, Presidenti, Këshilli i Ministrave, Pushteti Gjyqësor.

2. *Institucione të parashikuara nga Kushtetuta*. Këto janë institucione të cilat shërbejnë për funksionimin e organeve kushtetuese dhe janë ndihmëse ndaj tyre. Kusht për ekzistencën e tyre është fakti se kushtetuta duhet t'u njohë atyre personalitet juridik si edhe t'i pajisë me kompetenca të parashikuara shprehimisht. Në këtë kategori përfshihen, deputetët,<sup>544</sup> Avokati i Popullit, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Banka e Shqipërisë, Konferenca Kombëtare Gjyqësore, jo më pak se një e katërta e deputetëve, etj. Përdorimi i këtij gjykimi nga deputetët apo nga një grup i tyre tregon se ky lloj gjykimi kthehet në një mjet për mbrojtjen e pakicave. Ky lloj gjykimi shërben si një garanci e pluralizmit.<sup>545</sup>

3. *Organe të përmendura nga Kushtetuta*. Këto janë organe që përmenden nga Kushtetuta si rezultat i kompetencës që kanë organet kushtetuese për të emërtuar titullarët e këtyre institucioneve por nuk mundet që të klasifikohen në dy kategoritë e mësipërme sepse Kushtetuta nuk u njeh atyre asnjë personalitet juridik si edhe nuk parashikon asnjë kompetencë për to.

Nga tërësia e organeve të mësipërme, organet të cilat gëzojnë legjitimitet për të vënë në lëvizje një gjykim kushtetues, duhet që të plotësojnë katër karakteristika:

- a) të jenë organe të cituara në Kushtetutë dhe për rrjedhojë kanë rëndësi kushtetuese;
- b) gëzojnë, qoftë edhe pjesërisht një sferë të caktuar kompetencash kushtetuese;
- c) vendimet e tyre i marrin në mënyrë autonome ose të pavarur;
- ç) aktet e tyre janë akte shtetërore.<sup>546</sup>

Në referim të konkluzioneve të mësipërme, mund të arrijmë në përfundimin se vetëm organet/institucionet e parashikuara në dy kategoritë e para mund të jenë subjekte të një gjykimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencave, pasi janë vetëm këto organe të parashikuara në Kushtetutë dhe cilat janë të pajisura me kompetenca kushtetuese. Kompetencat e organeve të tjera, të cilat rregullohen me ligj, kurrësi nuk mundet që të legjitimohen, pasi mosmarrëveshjet midis tyre zgjidhen nga gjykatat administrative.

Për të bërë një trajtim sa më ezaures të këtyre subjekteve po i citojmë ato, duke ndjekur radhën që ka përcaktuar vetë Kushtetuta për to.

*Avokati i popullit*, është një organ i cili është i përmendur nga Kushtetuta,<sup>547</sup> që ka për qëllim të mbrojtë të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike. Për këtë qëllim neni 63 i Kushtetutës i rendit këtij institucioni një sërë kompetencash të cilat janë edhe mjetet e tij të reagimit për të realizuar misionin e tij. Konkretisht këto kompetenca janë paraqitja e një raporti vjetor ose të posaçëm të Kuvendi, të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike, si edhe të kërkojë informacione dhe të dhëna nga organet publike të cilat janë të detyruar që të përgjigjen.

<sup>543</sup> Vendimi nr.25, datë 05.12.2008 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>544</sup> Harberle, Peter, "La verfassungsbeschwerde nel sistema della giustizia costituzionale tedesca", botimi në italisht, Shtëpia Botuese "Giuffrè Editore", Milano 2000, fq.11.

<sup>545</sup> Po aty, fq.11.

<sup>546</sup> Ruggeri, Antonio; Spadaro, Antonino, "Lineamenti di giustizia costituzionale", Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2009, fq.244.

<sup>547</sup> Kushtetuta, nenet 60-63.

Në rast se organet shtetërore ia kufizojnë këto kompetenca me veprime aktive apo edhe duke mos vepruar në marrjen e masave të propozuara apo në mosdhënien e informacionit të kërkuar atëherë Avokati i Popullit ka të drejtë që të drejtohet në Gjykatën Kushtetuese. Kjo mënyrë veprimi është e duhura pasi pavarësisht faktit se këto situata detajohen më tej në ligjin organik të Avokatit të Popullit, ato janë detajim i kompetencave kushtetuese që i takojnë këtij institucioni. Pavarësisht kësaj deri më sot nuk ka pasur raste praktike kur ky institucion të jetë vënë në lëvizje për një gjykim të tillë.

*Kuvendi*, i cili në Kushtetutë vjen i dyti për nga radha,<sup>548</sup> është organi legjislativ i vendit dhe nga më të rëndësishmit në strukturën shtetërore. Ky institucion është i pajisur me kompetenca të rëndësishme në fushën legjislative dhe mund të kërkojë mbrojtjen e këtyre kompetencave në rast se ato do të cënoheshin nga institucione të tjera. Megjithatë duke pasur parasysh pozicionin e këtij institucioni dhe kompetencën që ai ka për të miratuar ligje vështirë se ky institucion mund të gjendet në një pozicion ku i cënohen kompetencat e tij. Kështu çdo lloj vendimmarrje të institucioneve të tjera, të cilat do të cënonin sferën e tij të kompetencave, Kuvendi mund ta mënjanojë dhe ta bëjë *nil* nëpërmjet miratimit të ligjeve. Kjo do të detyronte çdo lloj organi tjetër që të vepronte në përputhje me legjislacionin e ri. Për më tepër Kuvendi është edhe institucioni i cili ka të drejtën që të nisë procedurat *impeachment* ndaj çdo lloji tjetër organi kushtetues që do të cënonte kompetencat kushtetuese të Kuvendit.

Pavarësisht këtij pushteti të gjerë, jam i mendimit që në këtë rast gjithsesi e drejta e Kuvendit për të kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave nëpërmjet gjyimit kushtetues nuk mundet që të përjashtohet si mundësi. Një rast që vjen nga jurisprudenca kushtetuese e huaj ishte rasti kur të dyja dhomat e parlamentit italian pretenduan se pushteti gjyqësor (përkatësisht Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë e Kasacionit), duke vendosur për lejimin e eutanazisë për një person të caktuar, në fakt kishte miratuar, nëpërmjet vendimmarrjes së tyre një ligj, kompetencë kjo e cila është ekskluzive e Parlamentit.<sup>549</sup> Ky rast megjithëse nuk pati sukses pranë Gjykatës Kushtetuese, në fakt tregon që kompetencat e Kuvendit edhe mund të cënohen nga organet e tjera kushtetuese.

Rregulli tradicional që do të çonte Kuvendin si subjekt kërkues në Gjykatën Kushtetuese do të ishte një vendimmarrje e tij në seancë plenare, sipas rregullave dhe kuorumit përkatës, vendim ky i cili do të sillte edhe fillimin e një gjykimi të tillë. Megjithatë siç do të analizohet më poshtë ky rregull edhe mund të shmanget.

*Komisionet hetimore* megjithëse janë pjesë e Kuvendit, janë gjithashtu të parashikuara shprehimisht nga Kushtetuta.<sup>550</sup> Në këtë mënyrë ky organ, duke ushtruar kompetenca hetimore të Kuvendit, brenda kornizave që i njihen nga Kushtetuta, mundet që ta zëvendësojë atë në një gjykim kushtetues në rast se subjekte të tjera kushtetuese do të pengonin funksionimin e këtij organi.<sup>551</sup>

Edhe *Kryetari* i Kuvendit, mund të jetë një subjekt kushtetues në mosmarrëveshje. Kështu ai parashikohet shprehimisht nga Kushtetuta si i tillë edhe gëzon një serë kompetencash kushtetuese, të cilat konsistojnë në të drejtën për të paraqitur mocion për të konstatuar papajtueshmërinë e ushtrimit të funksioneve të deputetit, për të thirrur sesionet e jashtëzakonshme të Kuvendit, për të kryesuar debatin, drejtuar punimet, sigurimin dhe

<sup>548</sup> Kushtetuta, nenet 64-85.

<sup>549</sup> Vendimi nr.334, i vitit 2008 i Gjykatës Kushtetuese Italiane, marrë nga faqja zyrtare e internetit [www.cortecostituzionale.it](http://www.cortecostituzionale.it).

<sup>550</sup> Kushtetuta, neni 77.

<sup>551</sup> Teresi, Francesco, "*I giudizi della Corte Costituzionale*", Shtëpia Botuese "Cacucci Editore", Bari 2010, fq.167.

respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe të anëtarëve të tij, për të përfaqësuar Kuvendin në marrëdhëniet me të tjerët, si edhe zë vendin dhe ushtron kompetencat e Presidentit në rast të pamundësisë së përkohëshme të tij apo kur vendi i tij mbetet vakant.<sup>552</sup> Është e kuptueshme që një cënim i këtyre kompetencave do ta legjitimonte këtë subjekt për të inicuar një gjykim kushtetues për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave.

*Jo më pak se 10 deputetë*, janë një grupim i cili sipas Kushtetutës kanë të drejtë që të paraqesin një mocion në Kuvend në mënyrë që organi legjislativ t'i dërgojë çështjen për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese, nëse një deputet ka ushtruar funksione të tjera ose ka përfituar fonde shtetërore.<sup>553</sup> Kërkesën e tyre Kuvendi e vlerëson vetëm nga pikëpamja formale por nuk ka të drejtë që të shqyrtojë në themel bazueshmërinë e pretendimeve të këtij grupimi deputetësh. Në rast se Kuvendi refuzon ta dërgojë çështjen në Gjykatën Kushtetuese, atëherë ky grupim ka të drejtë që t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave.

*Një e pesta e deputetëve të Kuvendit*, është një tjetër pushtet kushtetues që njihet nga Kushtetueta dhe për më tepër parashikohet si subjekt që mund të verë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.<sup>554</sup> Pavarësisht se ky subjekt konsiderohet i pakushtëzuar në të drejtën e tij për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, kjo e drejtë e tij vlen vetëm në rastin e gjykimeve abstrakte që zhvillon Gjykata Kushtetuese. Në rastin e gjykimit të mosmarrëveshjes së kompetencave, duke qenë ky një gjykim konkret, Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka mbajtur qëndrimin e konsoliduar që ky subjekt ka legjitimitet të kufizuar dhe duhet të justifikojë interesin e tij në këtë lloj gjykimi. Në justifikimin e këtij lloj qëndrimi, Gjykata Kushtetuese është shprehur se:

*Kushtetuta nuk i njuh një të pestës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit të drejtën e materializimit veçmas, të vullnetit në lidhje me këtë vendimmarrje, pasi kjo e drejtë i takon ekskluzivisht organit ligjvënës si një i tërë. Kërkuesi nuk mund të pretendojë kufizimin apo mohimin e një të drejte, përse kohë e drejta nuk buron nga normat kushtetuese. Në këtë vështrim, kërkuesi nuk legjitimohet në kërkimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës.*<sup>555</sup>

Konkluzioni i mësipërm i Gjykatës Kushtetuese na duket i drejtë. Konkretisht në Kushtetutë nuk gjejmë asnjë dispozitë që t'i njohë ndonjë kompetencë të caktuar këtij grupimi deputetësh (jo më pak se një e pesta e deputetëve), cënimi i të cilës do të sillte edhe legjitimitetin e këtij subjekti në një gjykim të tillë.

Pavarësisht kësaj, në jurisprudencën e mëtejshme të saj Gjykata e ka njohur të drejtën e këtij grupimi për të kërkuar zgjidhjen e një mosmarrëveshje kompetencash por gjithmonë në mbrojtje të interesit të Kuvendit si organ dhe jo për të dalë kundër vendimmarrjes e tij dhe për të mbrojtur institucione të tjera. Konkretisht në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese gjejmë këto përfundime:

*...kërkuesi duhet të paraqesë argumente se moszgjidhja ose ekzistenca e këtij konflikti ka sjellë mosfunksionimin ose pengimin e funksionimit normal të Kuvendit, pjesë*

<sup>552</sup> Kushtetuta, neni 70, pika 4, neni 74, pika 3, neni 76, pika 1, neni 91, pika 1.

<sup>553</sup> Kushtetuta, neni 70, pika 4.

<sup>554</sup> Kushtetuta, neni 134, pika 1, gërma "c".

<sup>555</sup> Vendimi nr.29, datë 21.10.2009 i Gjykatës Kushtetuese.



*e të cilit është kërkuesi, duke cenuar statusin e tij dhe, rrjedhimisht, ushtrimin e të drejtave dhe kompetencave të njohura me Kushtetutë dhe Rregulloren e Kuvendit.*

*Në rastin konkret, duke u nisur nga përmbajtja e kërkesës, del se grupi i deputetëve është përqëndruar në mbrojtjen e sferës së veprimtarisë së Prokurorisë dhe jo të organit, pjesë e të cilit ai është. Nëse kërkuesi pretendon se ka një konflikt, i cili nuk është pengues në ushtrimin e funksioneve të tij por mund të jetë në kundërshtim me normat kushtetuese, atëherë ai nuk mund t'i drejtohet Gjykatës në rrugën e kërimit të konstatimit të konfliktit të kompetencave midis dy organeve. Mbrojtja e kushtetutshmërisë, si qëllimi final i kontrollit kushtetues, është një e drejtë/detyrë e subjekteve të përcaktuara qartë në dispozitat kushtetuese, në të cilat përcaktohen edhe rastet konkrete kur ata mund të venë në lëvizje Gjykatën për mbrojtje të kushtetutshmërisë gjatë veprimtarisë së tyre...<sup>556</sup>*

Nga pasazhet e mësipërme rezulton qartë se ky grupim deputetësh mund të vejë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave vetëm në rast se ai mbron interesin e Kuvendit pjesë e të cilit janë edhe grupimi i deputetëve, por jo të dalë në mbrojtje të organeve të tjera kushtetuese kundër Kuvendit. Këto subjekte mund të mbrohen vetë për kompetencat e tyre përpara Gjykatës Kushtetuese. Rasti se përse kjo pakicë parlamentare do të vihej në lëvizje për të mbrojtur Kuvendin do të ishte kur ky organ në tërësinë e tij për shkak edhe të shumicave parlamentare që mund të jenë formuar në kohë të caktuara dhe karakterit politik të çështjes të mos vihej në lëvizje për të mbrojtur sferën e kompetencave të Kuvendit. Një rast i tillë do të ishte kur Këshilli i Ministrave do të cënonte kompetencat ligjvënëse të Kuvendit dhe shumica parlamentare që është e njëjtë me përkatësinë politike të anëtarëve që përbëjnë Këshillin e Ministrave do të refuzonte fillimin e një gjykimi kushtetues. Atëherë në këtë rast kjo pakicë parlamentare legjitimohet që të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.

*Jo më pak se një e katërta e deputetëve, është një tjetër grupim deputetësh por që Kushtetuta dhe jurisprudenca kushtetuese i kanë njohur statusin e pushtetit kushtetues. Ky rezultat është pasojë e parashikimit kushtetues për këtë pakicë parlamentare në nenin 77 të Kushtetutës, dispozitë e cila e ka pajisur edhe me kompetencën për të kërkuar ngritjen e komisioneve hetimore. Ngritja e këtij komisioni është e pakushtëzuar nga qëndrimi i shumicës tjetër parlamentare. Kjo do të thotë që në çdo rast nëse plotësohen kërkesat e nenit 77 të Kushtetutës (çështja e veçantë dhe numri i deputetëve), ngritja e këtyre komisioneve është e detyrueshme.<sup>557</sup>*

*Deputetët, janë një tjetër subjekt kushtetues që mund të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Kështu deputetët janë të parashikuar nga Kushtetuta në një sërë dispozitash të saj të cilat kanë të bëjnë me kushtet për zgjedhjen e tyre,<sup>558</sup> kandidimi, kushtet ndaluese, rastet e papajueshmërisë, fillimi dhe pavlefshmëria e mandatit, betimi, imuniteti parlamentar.<sup>559</sup> Veçanërisht interesante është e drejta e deputetit për të shprehur mendimin dhe votën e tij. Në rast se këto mundësi të tij do të kufizoheshin në mënyrë antikushtetuese atëherë ai ka të drejtë që çështjen ta bëjë konflikt në Gjykatën Kushtetuese, si mosmarrëveshje kompetencash. Kështu sipas jurisprudencës kushtetuese është konsideruar si cënim i kompetencave të deputetit mohimi i së*

<sup>556</sup> Vendimi nr.34, datë 8.4.2011 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>557</sup> Vendimet nr.20, datë 4.5.2007 dhe nr.30, datë 16.5.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>558</sup> Neni 45 i Kushtetutës.

<sup>559</sup> Nenet 68-73 të Kushtetutës.

drejtës së tij për të marrë pjesë dhe shprehur mendimin e tij nëpër komisione parlamentare, pavarësisht se nuk ishte anëtar i tyre.<sup>560</sup>

Një tjetër kompetencë e tij e rëndësishme e njohur nga Kushtetuta është edhe e drejta që ai ka për të propozuar ligje.<sup>561</sup> Edhe në këtë rast nëse propozimet e tij ligjore do të shpërfillshin dhe nuk do të futeshin në procedurën normale parlamentare, ose ai do të pengohej për ta ushtruar këtë të drejtë, deputeti i cënuar në këtë rast do të mund ta paraqiste këtë mosmarrëveshje për gjykim dhe zgjidhje në Gjykatën Kushtetuese.

*20.000 zgjedhës me të drejtë vote*, parashikohen nga Kushtetuta në nenin 81, pika 2 e saj. Kompetenca e vetme me natyrë kushtetuese që ligji themelor u njuh është ajo për të propozuar projektligje për miratim në Kuvend. Në rast se Kuvendi do të refuzonte ta merrte në shqyrtim një nismë të tillë atëherë grupi nismëtar i cili përfaqëson 20.000 zgjedhësit ka të drejtë që t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për të zgjidhur këtë mosmarrëveshje kompetencash. Duke analizuar jurisprudencën kushtetuese rezultoi se në fillimet e saj Gjykata Kushtetuese ka pranuar të marrë në shqyrtim një kërkesë të tillë, por që përfundoi pa sukses për kërkuessit pasi Kuvendi me fillimin e gjykimit kushtetues vendosi t'i kalojë ato për shqyrtim në seancë plenare.<sup>562</sup>

*Presidenti i Republikës* është një tjetër organ me natyrë kushtetuese i cili është i pajisur nga ligji themelor më një sërë kompetencash. Natyra e kompetencave të tij është e tillë që ai ndërhyt në të treja pushtetet tradicionale, legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Megjithatë fillimisht Presidenti i Republikës, në ato raste kur ka pretenduar cënim të kompetencave të tij, i është drejtuar gjykatës me kërkesë për interpretim përfundimtar të normave kushtetuese dhe jo për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave. Kjo situatë ka rezultuar kur Kuvendi nuk është shprehur për dekretet e Presidentit për shkarkimin dhe emërimin e ministrave të caktuar,<sup>563</sup> apo në mosdhënien e pëlqimit nga Kuvendi për emërimin e një anëtari të Gjykatës Kushtetuese.<sup>564</sup> Vetëm së fundi nga Presidenti i Republikës, ka filluar përdorimi i gjykimit kushtetues për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave, ku rasti i parë kishte të bënte pikërisht me kthimin pa u votuar të tre dekreteve të Presidentit të Republikës për emërimin në Gjykatën Kushtetuese.<sup>565</sup>

Nga jurisprudenca kushtetuese e huaj shfaqet edhe një rast disi i rrallë por që për shkak të formulimit të njëjtë të normave kushtetuese, mund të shfaqet edhe në Shqipëri. Kështu Gjykata Kushtetuese Italiane ka legjitimuar si subjekt edhe ish-presidentit të Republikës, i cili ankohej kundër vendimeve të gjykatave të zakonshme që kishin gjykuar veprimet apo sjelljet e bëra prej tij në kohën kur kishte qenë në detyrën e presidentit. Në këtë rast nga Gjykata në proces u thirrën si ish-presidenti ashtu edhe presidenti që ishte në detyrë. Në thelb të ankimit, ish-presidenti pretendonte mbrojtjen që i jepte Kushtetuta, sipas të cilit ai nuk mbante përgjegjësi për mendimet e shprehura prej tij në krye të detyrës. Pra, në këtë rast ai pretendonte cënimin e kompetencës së tij kushtetuese për t'u shprehur.<sup>566</sup> Mosmarrëveshja në këtë rast midis ish-presidentit dhe autoriteteve gjyqësore mbi veprimet e Presidentit për të ruajtur prerogativat presidenciale në lidhje me deklaratat që ai ka bërë ndërkohë që ishte në detyrë dhe mbi të cilat janë bazuar

<sup>560</sup> Vendimi nr. 2 BvE 1/88, datë 13.6.1989 i Senatit të Dytë të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane, marrë nga CODICES e Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), me numër referimi GER-1989-S-001.

<sup>561</sup> Neni 81, pika 1 e Kushtetutës.

<sup>562</sup> Vendimi nr.13, datë 22.11.1993 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>563</sup> Vendimi nr.6, datë 18.1.2002 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>564</sup> Vendimi nr.2, datë 18.1.2005 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>565</sup> Vendimi nr. 41, datë 19.07.2012 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>566</sup> Ruggeri, Antonio; Spadaro, Antonino, "Lineamenti di giustizia costituzionale", Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2009, fq.253.

vendimet e mëvonshme kanë karakter kushtetues sepse ngrenë çështje për të përcaktuar kompetencat respektive të vendosura në Kushtetutë të Presidentit dhe të gjyqësorit.<sup>567</sup>

*Këshilli i Ministrave* është një tjetër subjekt kushtetues mënyra e formimit të cilit parashikohet nga neni 96 i Kushtetutës. Si kompetenca të rëndësishme kushtetuese për këtë organ është përcaktuar e drejta e tij për të përcaktuar drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore.<sup>568</sup> Kjo kompetencë e rëndësishme e cila detajohet më tej nëpërmjet ligjeve, shërben për të mbrojtur kushtetutshmërisht sferën e kompetencave të këtij organi kushtetues.

*Kryeministri* është një tjetër organ kushtetues që gëzon edhe një sërë kompetencash të parashikuara nga ligji themelor. Ato konsistojnë në të drejtën e tij për të thirrur Kuvendin në sesion të jashtëzakonshëm, për të kërkuar zhvillimin e mbledhjeve me dyer të mbyllura të Kuvendit, për ti propozuar Presidentit, emërimin dhe lirimin e përfaqësuesve të plotfuqishëm të Republikës së Shqipërisë në shtetet e tjera dhe në organizatat ndërkombëtare, si edhe emërimin e drejtorit të shërbimit informativ të shtetit, ti propozojë Presidentit kandidaturat për ministra, të përfaqësojë Këshillin e Ministrave dhe të kryesojë mbledhjet e tij, të konceptojë dhe të paraqesë drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe të përgjigjet për to, të sigurojë zbatimin e legjislacionit dhe të politikave të miratuara nga Këshilli i Ministrave, të bashkërendojë dhe të kontrollojë punën e anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe të institucioneve të tjera të administratës qendrore të shtetit, të zgjidhë mosmarrëveshjet ndërmjet ministrave, të ushtrojë drejtimin e Forcave të Armatosura në kohë paqeje sëbashku me Presidentin dhe Ministrin e Mbrojtjes, t'i propozojë Presidentit, kandidaturën për Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe në kohë lufte kandidaturën për Komandant të Forcave të Armatosura.<sup>569</sup> Për të mbrojtur tërësinë e këtyre kompetencave Kryeministri mund ti drejtohet Gjykatës Kushtetuese.

Përsa i përket *ministrave*, Kushtetuta përmend vetëm dy prej tyre dhe konkretisht Ministrin e Drejtësisë dhe Ministrin e Mbrojtjes. Nga këta të dy, vetëm Ministri i Mbrojtjes mund të shfaqet si subjekt në këtë lloj gjykimi. Kjo sepse Ministri i Drejtësisë parashikohet nga Kushtetuta vetëm si anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, por nuk i njihet asnjë kompetencë me karakter kushtetues. Përkundrazi Ministri i Mbrojtjes përveçse parashikohet nga Kushtetuta, gëzon edhe kompetenca me karakter kushtetues të cilat konsistojnë në drejtimin e Forcave të Armatosura në kohë paqe sëbashku me Presidentin dhe Kryeministrin, si edhe për t'i propozuar Presidentit kandidaturat nga rradhët e oficerëve madhore për të kryer funksionet e komandantit të forcave tokësore, detare dhe ajrore.<sup>570</sup>

*Pushteti gjyqësor*, është edhe ai një pushtet kushtetues, i përmendur nga Kushtetuta dhe i pajisur me kompetenca kushtetuese.<sup>571</sup> Për rrjedhojë edhe ky pushtet të paktën teorikisht mundet që të shfaqet si kërkues në një mosmarrëveshje kompetencash. Ajo që krijon një problematikë në këtë rast është fakti se pushteti gjyqësor është një pushtet i shpërndarë midis disa gjykatave si në planin horizontal, gjykata me kompetenca lëndore të ndryshme, ashtu edhe në planin vertikal, gjykata të niveleve të ndryshme. Kësaj situatë i shtohet edhe fakti tjetër, ku përjashtim bën vetëm Gjykatën e Lartë kur mblidhet në Kolegje të Bashkuara, që asnjëherë asnjë prej gjykatave nuk

<sup>567</sup> Vendimi nr.455 i vitit 2002 i Gjykatës Kushtetuese Italiane, marrë nga faqja e internetit [www.cortecostituzionale.it](http://www.cortecostituzionale.it).

<sup>568</sup> Neni 100, pika 1 e Kushtetutës.

<sup>569</sup> Nenet 74, 79, 92, 98, 102, dhe 169 të Kushtetutës.

<sup>570</sup> Neni 169, pikat 1 dhe 3 të Kushtetutës.

<sup>571</sup> Nenet 135-146 të Kushtetutës.



funksionon në përbërje të plotë, por përkundrazi secili prej gjyqtarëve ka pavarësi të plotë në vendimmarrje. Për këtë arsye në pamje të parë përfaqësimi i këtij pushteti duket problematik. Por pavarësisht kësaj situatë në doktrinë është shfaqur mendimi se duke pasur në konsideratë strukturën jo hierarkike të pushtetit gjyqësor mund të shprehemi në mënyrë të zgjeruar se “cilido gjyqtar” në ushtrimin e funksioneve të tij është i legjitimuar materialisht dhe proceduralisht për t’u konsideruar si pushtet i shtetit, një lloj mikro-pushteti.<sup>572</sup> Kushti i vetëm është që gjyqtarët, këtë të drejtë ta shfrytëzojnë gjatë kohës që ushtrojnë një aktivitet juridiksional dhe jo funksion administrativ apo për aspekte të tjera të organizimit gjyqësor. Është gjithashtu një mundësi e përjashtuar që gjyqtari i cili nuk është duke kryer funksionet e tij do të mund të iniciojë një gjykim të tillë, duke qenë se nuk është më pjesë e procesit.<sup>573</sup>

Personalisht bashkohem me qëndrimin e mësipërm. Duke pasur parasysh natyrën e funksioneve që ushtrojnë gjyqtarët, të vetëm, në trup gjykues apo në kolegje, ata janë të pavaruar në ushtrimin e këtij funksioni dhe vendimmarrja e tyre përfaqëson në çdo rast një vendimmarrje të pushtetit gjyqësor në tërësi. Për rrjedhojë edhe një gjyqtar i vetëm në ushtrimin e funksioneve të tij kur mendon se një kompetencë funksionale e pushtetit gjyqësor është cënuar nga veprime apo mosveprime të organeve të tjera shtetërore, mund të kërkojë në Gjykatën Kushtetuese zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave. Në realitetin shqiptar raste të tilla deri më sot nuk ka pasur, megjithëse mundësi të tilla kanë ekzistuar. Për të kuptuar më mirë këtë situatë po i referohemi jurisprudencës kushtetuese italiane, nga ku rezulton se gjykatat e zakonshme janë shfaqur si palë kërkuese pranë Gjykatës Kushtetuese, në një proces për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave. Në këto raste ato kanë kërkuar të gjykojnë deputetët dhe senatorët për deklaratimet e tyre, ndërkohë që si dhoma e përfaqësuesve, ashtu edhe ajo e senatit në parlamentin italian, deklaratimet e anëtarëve të tyre i kanë konsideruar si funksione parlamentare dhe për rrjedhojë nuk mundet që të shqyrtoheshin nga gjykatat.

Pikërisht ky qëndrim i kundërt i këtyre dy pushteteve ka sjell shpeshherë edhe fillimin e gjykimeve kushtetuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, gjykime të cilat përgjithësisht janë zgjidhur nga Gjykata Kushtetuese në favor të pushtetit gjyqësor. Përkundrazi në Shqipëri, në të gjitha rastet kur në Gjykatën e Lartë ka pasur gjykime për deputetët, Kuvendi në përgjithësi nuk ka ndërhyrë. Ky lloj respekti i veçantë i Kuvendit ndaj pushtetit gjyqësor ka sjellë si pasojë që të mos kemi mosmarrëveshje kompetencash.

Një shembull tjetër i mosmarrëveshjes së kompetencave mund të jetë kur legjislativi vendos të deklarojë nëpërmjet legjisllacionit fajtor<sup>574</sup> ose jo fajtor<sup>575</sup> persona të caktuar. Në këtë rast dukshëm janë cënuar kompetencat e pushtetit gjyqësor i cili mund të kërkojë mbrojtjen kushtetuese.

*Këshilli i Lartë i Drejtësisë* gëzon personalitet juridik të garantuar nga Kushtetuta dhe ka të drejtë që nëse cënohen kompetencat e tij për emërimin, transferimin, karrierën dhe procedimin disiplinor të gjyqtarëve të ankohet në Gjykatën Kushtetuese për të mbrojtur sferën e tij të kompetencave. Në këtë rast vendimmarrja e KLD duhet që të jetë kolegjiale e cila duhet që

<sup>572</sup> Ruggeri, Antonio; Spadaro, Antonino, “Lineamenti di giustizia costituzionale”, Shtëpia Botuese “G. Giappichelli Editore”, Torino 2009, fq.246.

<sup>573</sup> Teresi, Francesco, “I giudizi della Corte Costituzionale”, Shtëpia Botuese “Cacucci Editore”, Bari 2010, fq.170.

<sup>574</sup> Vendimi nr. 2/1998, datë 19.1.1998 i Gjykatës Kushtetuese Moldave marrë nga CODICES e Komisionit të Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), referuar me numër MDA-1998-1-001.

<sup>575</sup> Vendimi nr. 972/2012, datë 21.12.2012 i Gjykatës Kushtetuese Rumune, marrë nga CODICES e Komisionit të Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), referuar me numër ROM-2012-3-007.



gjithashtu të tregojë edhe personin/funksionarin që i ka deleguar të drejtën për ta përfaqësuar këtë institucion në gjykimin kushtetues.<sup>576</sup>

*Prokuroria* është një tjetër institucion i parashikuar nga Kushtetuta.<sup>577</sup> Duke qenë se ajo funksionon si një organ i centralizuar atëherë legjitimohet që të kundërshtojë në Gjykatën Kushtetuese, cënimin e funksioneve të saj, kushtetutshmërisht të mbrojtura siç janë ushtrimi i ndjekjes penale dhe përfaqësimi i akuzës në gjyq në emër të shtetit. Jurisprudenca kushtetuese shqiptare ka njohur raste të gjykimeve të tilla veçanërisht të Prokurorisë kundër Kuvendit.<sup>578</sup> Në këto raste Kuvendi nuk ka të drejtë që të hetojë ligjshmërinë e hetimit, pushimit apo të dërgimit të çështjes në gjykatë, pasi këto janë prerogative ekskluzive të Prokurorisë dhe mund të kontrollohen vetëm nga gjykatat.

*Kontrolli i Lartë i Shtetit*, është një tjetër institucion i parashikuar nga Kushtetuta,<sup>579</sup> i cili drejtohet nga Kryetari. Në këtë drejtim edhe ky institucion shfaq një natyrë monokratike. Për rrjedhojë i takon këtij titullari që të venë në lëvizje gjykimin kushtetues. Edhe në këtë rast ky organ mbron kompetencat e tij kushtetuese që kanë të bëjnë me ushtrimin e kontrollit mbi veprimtarinë ekonomike të institucioneve shtetërore dhe shoqërive tregtare që kontrollohen nga shteti, si edhe përdorimin e fondeve prej tyre. Në Shqipëri raste praktike me kërkues këtë institucion nuk ka, por në vende të tjera një mjet i tillë është përdorur nga organe analoge gjithmonë e në rritje për të kufizuar tendencën e qeverisë për t'iu shmangur kontroleve nga këto organe.<sup>580</sup>

*Gjykata Kushtetuese* është një tjetër organ që parimisht mund të jetë një nga subjektet në një mosmarrëveshje kompetencash. Ky institucion është i parashikuar drejtpërdrejtë nga Kushtetuta dhe e ushtron veprimtarinë në mënyrë të pavaruara nga organet e tjera duke iu nënshtruar vetëm ligjit themelor të vendit. Për rrjedhojë të paktën në teori edhe ky institucion mund të jetë palë kërkuese në një mosmarrëveshje kompetencash me organe të tjerë të nivelit kushtetues. Ky qëndrim duket sikur gjen mbështje edhe në doktrinën tonë juridike.<sup>581</sup>

Por, nga ana tjetër, dukshëm Gjykata Kushtetuese në këtë rast shfaqet në një pozicion të vështirë, pasi është po vetë ky institucion që duhet të shqyrtojë kërkesën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave. Në këtë situatë Gjykata do të vepronte kundër parimit të famshëm të së drejtës natyrore *nemo iudex sine causa sua*.<sup>582</sup> Për këtë arsye deri më sot Gjykata jonë Kushtetuese ka treguar një vetëpërmbytje në këtë drejtim, duke mos pasur asnjë rast kur ajo vetë të jetë vënë në lëvizje për zgjidhjen e një mosmarrëveshje të tillë. Pavarësisht kësaj në doktrinë ka mendime që një qëndrim i tillë i gjykatës është i gabuar pasi do të ishim përpara situatës paradoksale kur Gjykata nga njëra anë mbron pushtetet e tjera të shtetit dhe nga ana tjetër, në një situatë emergjente nuk mbron veten e saj.<sup>583</sup> Në vazhdim të kësaj teorie, Gjykata

<sup>576</sup> Vendimi nr.50, datë 20.04.2012 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>577</sup> Nenet 148-149 të Kushtetutës.

<sup>578</sup> Vendimi nr.26, datë 4.12.2006 dhe vendimi nr.12, datë 20.5.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>579</sup> Nenet 162-165 të Kushtetutës

<sup>580</sup> Ruggeri, Antonio; Spadaro, Antonino, "Lineamenti di giustizia costituzionale", Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2009, fq.250.

<sup>581</sup> Sadushi, Sokol, "Kontrolli kushtetues", Shtëpia Botuese "Botimpex", Tiranë 2004, fq. 116: *Në këtë kuptim, ndërmjet pushteteve hyjnë, përveç tri pushteteve tradicionale (pra legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor), edhe Presidenti i Republikës dhe Gjykata Kushtetuese.* Autori në këtë rast i referohet doktrinës së huaj dhe pikërisht Martines, Temistocle, në librin e tij "Diritto Costituzionale".

<sup>582</sup> Shprehje Latinisht, në shqip: Nuk mund të jesh gjyqtar në çështjen tënde.

<sup>583</sup> Ruggeri, Antonio; Spadaro, Antonino, "Lineamenti di giustizia costituzionale", Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2009, fq.251.

duhet që të vihet në lëvizje kur cënohet detyrueshmëria e vendimeve të saj, si edhe në një rast hipotetik kur nëpërmjet akteve të caktuara cënohen kompetencat e këtij institucioni.

Duke analizuar praktikën gjyqësore shqiptare rezulton se janë shfaqur raste të tilla kur është vënë në diskutim përbërja e Gjykatës Kushtetuese, si edhe vendimmarrja e saj.

Përsa i përket rastit të parë, nëpërmjet një ligji kushtetues,<sup>584</sup> organi legjislativ,<sup>585</sup> duke mos njohur një vendimmarrje të mëparshme të Gjykatës Kushtetuese<sup>586</sup> përsa i përket mënyrës së zëvendësimit të gjyqtarëve i kërkonte Gjykatës që të zhvillonte përsëri rotacionin e anëtarëve të saj. Gjykata Kushtetuese duke e konsideruar këtë ligj kushtetues një ndërhyrje në pavarësisë së saj vendosi ta shfuqizojë atë.<sup>587</sup> Megjithatë, nëse analizojmë këtë çështje vërejmë se Gjykata Kushtetuese në atë kohë veproi me nismën e saj bazuar në të drejtën që i jepte ligji kushtetues i kohës për t'u vënë vetë në lëvizje.<sup>588</sup> Ndërsa këtë çështje e zgjidhi jo si mosmarrëveshje kompetencash por si një rast tipik të kontrollit abstrakt të pajtueshmërisë së ligjit me kushtetutën.

Një rast tjetër ku Gjykata Kushtetuese ka konstatuar cënim të kompetencave të saj ka qenë kur gjykatat e zakonshme janë shprehur për antikushtetutshmërinë e një ligji të miratuar përpara hyrjes në fuqi të Kushtetutës aktuale.<sup>589</sup>

Rasti tjetër i shfaqur nga praktika jonë ka qenë situata kur Gjykata e Lartë ka refuzuar të njohë fuqinë detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Këtu kemi të bëjmë me qëndrimin e Gjykatës së Lartë për të mosnjohur vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me:

- legjitimitimin e avokatëve të caktuar kryesisht nga gjykata për të bërë ankim;<sup>590</sup>
- duke e konsideruar rekursin e paraqitur nga palët në proces si jashtë afatit megjithëse Gjykata Kushtetuese e kishte konsideruar si brenda afatit;<sup>591</sup>

- duke mos konsideruar si shkak për rishikim të vendimeve të formës së prerë vendimmarrjen e GJEDNJ-së, pavarësisht qëndrimit të prerë që kishte mbajtur Gjykata Kushtetuese.<sup>592</sup>

Në të gjitha këto situata Gjykata Kushtetuese, duke përdorur parashikimin kushtetues për detyrueshmërinë e vendimeve të saj,<sup>593</sup> i ka shfuqizuar vendimet e Gjykatës së Lartë,<sup>594</sup> duke mbajtur qëndrimin e prerë se:

*Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i tillë që iu imponon të gjithë organet shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsytimit të vendimit të saj. Arsyetimi që përdor Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën*

<sup>584</sup> Ligji nr.8257, datë 19.11.1997 "Për një plotësim në ligjin nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491 datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese"".

<sup>585</sup> Kuvendi Popullor, sic emërtohej në atë kohë.

<sup>586</sup> Vendimi nr.4, datë 2.6.1995 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>587</sup> Vendimi nr.57, datë 5.12.1997 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>588</sup> Ligji nr. 7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese"", neni 25, paragrafi i parë: *Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë ose edhe me nismën e saj.*

<sup>589</sup> Vendimi nr.97, datë 27.7.2001 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>590</sup> Vendimi nr.371, datë 27.10.2000 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

<sup>591</sup> Vendimi nr.00-2007-1470 (1181), datë 18.10.2007, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

<sup>592</sup> Vendimi nr.1042, datë 9.7.2010 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

<sup>593</sup> Neni 132, pika 1 e Kushtetutës: *Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare.*

<sup>594</sup> Përkatesisht vendimet nr.5, datë 7.2.2001, nr.14, datë 3.6.2009 dhe nr.20, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale.

Siç ka theksuar Gjykata edhe në vendimin e sipërcituar, veçanërisht në rastet kur bëhet fjalë për të drejtat themelore të njeriut, interpretimi përfundimtar i normës kushtetuese është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese. Nëse kjo e fundit, me vendim, përcakton se një proces gjyqësor i ka cenuar shtetasit të drejtat themelore, duke caktuar edhe detyra për gjykatat gjatë rigjyimit të çështjes konkrete, moszbatimi i këtyre detyrave automatikisht sjell një cenim të të drejtave themelore, në rastin konkret të të drejtës për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.<sup>595</sup>

Pavarësisht vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese dhe qëndrimit të saj të mësipërm përsëri këto mosmarrëveshje kompetencash janë zgjidhur në kuadër të një gjykimi tjetër dhe konkretisht të gjykimit të kërkesave për një proces të rregullt ligjor, ku Gjykata Kushtetuese është vënë në lëvizje mbi bazën e kërkesës së bërë nga subjektet që ishin pjesëmarrëse në gjykimin e zakonshëm.

Pra, me gjithë rastet e shfaqura në praktikë përsëri Gjykata Kushtetuese ka treguar vetëpërmbatje, duke mos u vënë vetë në lëvizje. Ky qëndrim i Gjykatës Kushtetuese më duket më i drejti. Duke vepruar në këtë mënyrë Gjykata Kushtetuese ka mbrojtur në rradhë të parë paanshmërinë e saj e cila padiskutim do të vihej në dyshim në rast se ajo të vihej në lëvizje me nismën e saj. Edhe në rastin më ekstrem kur nëpërmjet normave ligjore do të kufizohen kompetencat e saj, Gjykata Kushtetuese do të mundej që ta zgjidhte atë në çfarëdolloj gjykimi pranë saj, duke përdorur teknikën e gjykimit incidental siç u sqarua më sipër në këtë punim.

Një çështje që mund të ketë diskutim në lidhje me subjektet kushtetuese në një konflikt janë edhe *partitë politike*. Pra, nëse këto subjekte mund të konsiderohen me natyrë kushtetuese dhe për rrjedhojë nëse pretendojnë cënim të kompetencave të tyre kushtetuese do të mund të kërkojnë pranë Gjykatës Kushtetuese mbrojtjen e tyre. Për këtë arsye është e nevojshme që të analizojmë nëse partitë politike, janë subjekte kushtetuese dhe nëse gëzojnë kompetenca të njohura nga akti themelor i vendit. Partitë politike përmenden shprehimisht nga Kushtetuta në nenin 9 të saj.<sup>596</sup> Pra, në këtë rast mund të flasim për një subjekt i cili merr personalitet juridik nga vetë akti themelor. Njohjen e tyre si organe kushtetuese e ka përmendur edhe vetë Gjykata Kushtetuese.<sup>597</sup> Pavarësisht kësaj, një parti politike mund të quhet si e tillë, vetëm nëse është rregjistruar rregullisht në gjykatë sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.<sup>598</sup> Pra mund të themi se kushti i parë plotësohet. Në lidhje me kompetencat kushtetuese të njohur për këtë lloj organi, Kushtetuta i jep të drejtën partive politike që të paraqesin kandidatë për deputetë<sup>599</sup> si edhe t'i propozojnë Presidentit, kandidaturën për Kryeministër, në fillim të legjislaturës ose kur posti i tij

<sup>595</sup> Vendimi nr.20, datë 1.6.2011 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>596</sup> Kushtetuta, neni 9: 1. *Partitë politike krijohen lirisht. Organizimi i tyre duhet të përputhet me parimet demokratike.* 2. *Partitë politike dhe organizatat e tjera, programet dhe veprimtaria e të cilave mbështeten në metoda totalitariste, që nxitin e përkrahin urrejten racore, fetare, krahinore ose etnike, që përdorin dhunën për marrjen e pushtetit ose për të ndikuar në politikën shtetërore, si edhe ato me karakter të fshehtë janë të ndaluara sipas ligjit.* 3. *Burimet financiare të partive, si dhe shpenzimet e tyre bëhen kurdoherë publike.*

<sup>597</sup> Vendimi nr.15, datë 15.4.2010 i Gjykatës Kushtetuese, parag.14: *Gjykata vlerëson se partitë politike janë organe kushtetuese në kuptim të nenit 9 të Kushtetutës shqiptare.*

<sup>598</sup> Ligji nr.8580, dt.17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar.

<sup>599</sup> Neni 68, pika 1 e Kushtetutës: *Kandidatët për deputetë paraqiten në nivel zone zgjedhore nga partitë politike, koalicionet zgjedhore të partive politike, si dhe nga zgjedhësit.*



mbetet vakant, nëse si subjekt kanë shumicën e vendeve në Kuvend.<sup>600</sup> Pra, duket sikur edhe kushti i dytë plotësohet. Pavarësisht kësaj në doktrinë është mbështetur ideja se Kushtetuta nuk u jep partive politike kompetenca kushtetuese por vetem funksione që kanë rëndësi kushtetuese.<sup>601</sup> Në këndvështrimin e këtij mendimi edhe e drejta e partive politike për të paraqitur kandidatë apo për të propozuar kryeministrin, nuk është kompetencë kushtetuese e tyre por një funksion me rëndësi kushtetuese. Pra, ata nuk janë titullarë të një kompetence specifike nga ana e Kushtetutës.<sup>602</sup>

Personalisht bashkohem pjesërisht me këtë pikëpamje. Kështu përse i përket të drejtës për të paraqitur kandidatë ky është një funksion i partive politike brenda të drejtës që ato kanë për të marrë pjesë në zgjedhje. Nëse kjo e drejtë do të çenohej rezulton se nuk do të bëhej nga një organ kushtetues por nga një organ i krijuar me ligj, pasi, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve megjithëse fillimisht parashikohej si organ kushtetues,<sup>603</sup> mbas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2008 iu hoq ky status dhe tashmë rregullimi dhe funksionimi i tij përcaktohet me ligj.<sup>604</sup> Po kështu, është legjislacioni përkatës i zgjedhjeve që rregullon edhe të drejtën e ankimit për këto raste dhe specifikisht në një gjykatë të posaçme që është Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit Tiranë.<sup>605</sup> Në këtë kuptim funksionet që kanë partitë politike, për të paraqitur lista alternative zgjedhore dhe përzgjedhja e kandidatëve në funksione zgjedhore nuk lejojnë të konkludosh ekzistencën e kompetencave kushtetuese por tregojnë mënyrën se si ligjvënësi ka menduar për të zbatuar të drejtën e njohur kushtetutshëmrisht shtetasve, për t'u organizuar në një pluralitet partish me përfaqësim politik dhe i nevojshëm për të konkuruar në një proces zgjedhor. Nga kjo rrjedh që partitë politike konsiderohen si organizime të mirëfillta të shoqërisë civile, të cilave u janë njohur nga legjislacioni funksione publike por nuk janë pushtete të shtetit. Për këtë arsye atyre nuk mundet që t'u njihet natyra e një organi kushtetues, i aftë për të deklaruar përfundimisht vullnetin e një prej pushteteve të shtetit si edhe për të përcaktuar sferën e tyre të kompetencave të vendosura nga norma kushtetuese.<sup>606</sup>

Përse i përket rastit të dytë, pra të drejtën që ka partia fituese për të propozuar emrin e Kryeministrit tek Presidenti i Republikës, jam i mendimit që në këtë rast kemi të bëjme me një kompetencë të mirëfilltë kushtetuese. Kështu në rast se Presidenti do të vendoste të emëronte një tjetër Kryeministër i cili nuk vjen nga partia politike që ka shumicën e vendeve në Kuvend, kjo parti ka të drejtë të kundërshtojë dekretin e Presidentit (i cili është një akt me natyrë individuale)

<sup>600</sup> Neni 96, pika 1 e Kushtetutës: *Presidenti i Republikës, në fillim të legjislaturës, si dhe kur vendi i Kryeministrit mbetet vakant, emëron Kryeministrin me propozim të partisë ose koalicionit të partive, që ka shumicën e vendeve në Kuvend.*

<sup>601</sup> Giovannetti, Tommaso, "I "soggetti esclusi" nei conflitti di attribuzione", botuar në "Le zone d'ombra della giustizia costituzionale – I giudizi sui conflitti di attribuzione e sull'ammisibilità del referendum abrogativo", botuar nga "Quaderni del "Gruppo di Pisa", nën kujdesin e Roberto Pinardi, Shtëpia Botuese "G.Giappichelli Editore", Torino 2007, fq.48.

<sup>602</sup> Cecamore, Francesca, "L'autorità indipendente come parte nel conflitto di attribuzione fra poteri dello Stato", botuar në "Le zone d'ombra della giustizia costituzionale – I giudizi sui conflitti di attribuzione e sull'ammisibilità del referendum abrogativo", botuar nga "Quaderni del "Gruppo di Pisa", nën kujdesin e Roberto Pinardi, Shtëpia Botuese "G.Giappichelli Editore", Torino 2007, fq.137.

<sup>603</sup> Nenet 153-154 të Kushtetutës.

<sup>604</sup> Kodi Zgjedhor, nenet 12 – 26.

<sup>605</sup> Kodi Zgjedhor nenet 145 – 151.

<sup>606</sup> Urdhëresa nr.79 e vitit 2006 e Gjykatës Kushtetuese Italiane, referuar nga Teresi, Francesco, "I giudizi della Corte Costituzionale", Shtëpia Botuese "Cacucci Editore", Bari 2010, fq.174.



në Gjykatën Kushtetuese, si shkak për lindjen e mosmarrëveshjes së kompetencave. Në këtë rast partia politike vepron për të garantuar statusin e vetë Kushtetutes.<sup>607</sup>

*Individi* nga ana e tij ka një rol të rëndësishëm në sistemin kushtetues. Në aktin themelor të vendit parashikohen një sërë dispozitash materiale që njohin të drejtat dhe liritë e tij themelore, si edhe një sërë dispozitash procedurale që synojnë garantimin e tyre. Megjithatë gjykimi për mosmarrëveshje të kompetencave nuk mundet që të përdoret si një mekanizëm i përgjithshëm i mbrojtjes së të drejtave kushtetuese, tej atyre që ofron sistemi aktual.<sup>608</sup>

*Organet e qeverisjes vendore* janë gjithashtu institucione të parashikuara nga Kushtetuta. Për këtë arsye çdo organ i qeverisjes vendore i cili pretendon se është cënuar në kompetencat e tij nga veprimet apo mosveprimet e një organi të pushtetit qendror me natyrë kushtetuese ka të drejtë që të vejë në lëvizje gjykimin kushtetues. Si organ i qeverisjes vendore në pozicionin e kërkuesit mund të shfaqet si organi ekzekutiv (kryetari), ashtu edhe organi përfaqësues (këshilli), të njëjtit të qeverisjes vendore të njohura nga Kushtetuta. Në këtë kuptim parashikimi i nenit 32 të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar sipas të cilit fillimin e proceseve gjyqësore për çështje të kompetencës së vetë e vendos këshilli dhe i pretenduar disa herë nga subjektet e interesuar për mungesë legjitimitimi të kryetarit në një gjykim kushtetues, nuk qëndron. Kjo pasi, kryetari i njësisë vendore është organ i parashikuar nga Kushtetuta. Madje ai parashikohet edhe si subjekt i aftë për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues sipas nenit 134, shkronja "e" të ligjit themelor. Ajo që duhet sqaruar në këtë pikë është fakti që këto subjekte mund të ankohen vetëm nëse kompetencat e tyre janë të prekura drejtpërsëdrejti. Ankesa e këtyre organeve nuk ka atributet e një *actio popularis*.<sup>609</sup>

Janë të përjashtuara nga e drejta për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, organet e tjera vendore të cilat krijohen me ligj. Këto organe megjithëse janë të qeverisjes vendore nuk janë të krijuara nga Kushtetuta dhe për rrjedhojë nuk mundet që t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese.<sup>610</sup> Mbrojtjen e interesave dhe të kompetencave të tyre ato duhet ta realizojnë përpara gjykatave administrative.

Një praktikë interesante që mund të merret në konsideratë në rastin e mosmarrëveshjes së kompetencave midis pushtetit qendror dhe njësisë të qeverisjes vendore është praktika spanjolle, ku rezulton se individi ka të drejtë që t'i ankohet Gjykatës Kushtetuese nëse si nga organi qendror ashtu edhe nga organi vendor ka marrë përgjigje negative në lidhje me moskompetencën e tyre mbi një çështje të caktuar. Në këtë rast individi mbasi ka ezauruar rrugët administrative pranë njësive vendore dhe atyre qendrore dhe ka marrë përgjigje negative ka të drejtë që t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, vendimi i së cilës përcakton se cili institucion ka të drejtën dhe kompetencën për t'iu përgjigjur kërkesave të individit.<sup>611</sup>

Për të kuptuar dobishmërinë e kësaj zgjidhjeje mjafton të kujtojmë çështjen e famshme Qufaj *kundër* Shqipërisë, ku shoqëria harxhoi disa vite kohë midis Bashkisë Tiranë dhe

<sup>607</sup> Palermo, Francesco, "La giustizia costituzionale in Germania", botuar në "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova 2009, fq.157.

<sup>608</sup> Teresi, Francesco, "I giudizi della Corte Costituzionale", Shtëpia Botuese "Cacucci Editore", Bari 2010, fq.162.

<sup>609</sup> Vendimi nr. US 265/07, datë 6.6.2007 i Dhomës së Dytë të Gjykatës Kushtetuese Çeke, marrë nga CODICES e Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), me numër referimi CZE-2007-2-006.

<sup>610</sup> Di Giacomo Russo, Bruno, "La difesa costituzionale delle autonomie locali", botuar në "Le zone d'ombra della giustizia costituzionale - I giudizi sui conflitti di attribuzione e sull'ammisibilita del referendum abrogativo", botuar nga "Quaderni del "Gruppo di Pisa", nën kujdesin e Roberto Pinardi, Shtëpia Botuese "G.Giappichelli Editore", Torino 2007, fq.156.

<sup>611</sup> Ruiz-Rico Ruiz, Gerardo, "Il tribunale costituzionale spagnolo", botuar në "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova 2009, fq.258.

Ministrisë së Financave për të përcaktuar se cili institucion duhej që të përmbushte të drejtën e tij të fituar me vendim gjyqësor. Megjithatë duke pasur në konsideratë sistemin juridik shqiptar dhe zgjidhja që ofrohet pranë gjykatave administrative në bazë të ligjit të tyre organik jam i mendimit që këto lloje çështjesh duhet që të zgjidhen përpara gjyqësorit të zakonshëm, duke shmangur në këtë mënyrë edhe mbingarkesën me çështje të tilla të Gjykatës Kushtetuese. Për ta bërë më të qartë krahasimin, një çështje e tillë në Spanjë do t'i duhen deri në 10 vjet që të merret në shqyrtim.

## 7. Subjekte të tjera.

Kushtetuta, për gjykime të caktuara, ka përcaktuar vetë edhe subjektin i cili ka të drejtë që të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Këto janë gjykime specifike dhe dallohen nga gjykimet e përgjithshme të përcaktuara nga neni 131 i Kushtetutës. Në këtë rast subjektet e parashikuara nga neni 134 i Kushtetutës, nuk e kanë të drejtën për të venë në lëvizje një gjykim të tillë. Këto subjekte që parashikohen në mënyrë të posaçme nga vetë Kushtetuta janë Kuvendi, Këshilli i Ministrave dhe Prokuroria. Në këtë rast duhet theksuar se këto gjykime janë të ndryshme nga gjykimi kushtetues për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave. Kjo është edhe arsyeja se përse po i analizojmë në mënyrë të veçantë.

### 7.1 Kuvendi.

Kuvendi si një subjekt kërkues parashikohet në disa dispozita të Kushtetutës. Më konkretisht vetëm Kuvendi ka të drejtë që të verë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për të konstatuar papajtueshmërinë e ushtrimit të detyrës nga deputetët, shkarkimin dhe vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të detyrës nga Presidenti, shkarkimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë.

Përsa i përket kërkesës për **konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit të deputetit**, procedura parlamentare vihet në lëvizje me kërkesë të jo më pak se dhjetë deputetëve ose me kërkesë të Kryetarit të Kuvendit. Më pas, mbas diskutimeve në Këshillin për Rregulloren Mandatet dhe Imunitetin çështja diskutohet në seancë plenare. Nëse Kuvendi vendos sipas rregullave të nenit 78, pika 1 të Kushtetutës pozitivisht atëherë çështja dërgohet për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese. Ajo që duhet theksuar në këtë rast është se Kuvendi nuk ka të drejtë që të vlerësojë në themel nëse deputeti kundër të cilit është paraqitur mocioni është e bazuar apo jo. Kuvendi në këtë rast vlerëson vetëm plotësimin e kriterëve formale. Kompetenca për vlerësimin përfundimtar i takon Gjykatës Kushtetuese. Në rast të kundërt, Kryetari apo grupi i deputetëve që ka paraqitur mocionin ka të drejtë që të ankohet në Gjykatën Kushtetuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave, siç e përmendëm edhe më sipër.

Në lidhje me **procedurat e shkarkimit të Presidentit të Republikës**, rezulton se sistemi ynë ndryshon nga shumë sisteme të tjera. Kështu siç është pranuar edhe nga doktrina e huaj rasti shqiptar prezantohet si jotipik, përderisa parlamentit i takon si ngritja e akuzës ashtu edhe shqyrtimi i saj, megjithëse vendimi përfundimtar i kërkohet gjyqtarëve kushtetues të cilët duhet të vërtetojnë ekzistencën e rrethanave për dënimin dhe për pasojë për të deklaruar shkarkimin e kreut të shtetit.<sup>612</sup>

<sup>612</sup> Pistan, Carna, "I sistemi di giustizia costituzionale nei paesi dell'Europa centro-orientale e dell'area post-sovietica", botuar në "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale – Tomo II", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova 2011, fq.260.

Procedurat që ndjek Kuvendi i Shqipërisë në shkarkimin e Presidentit është një procedurë në thelb administrative. Sipas rregullores kërkesa nga jo më pak se një e katërta e deputetëve i paraqitet me shkrim Kryetarit të Kuvendit. Kjo kërkesë duhet që të përmbajë në mënyrë të motivuar dhe konkrete shkëlqen e rëndë të Kushtetutës ose kryerjen e një krimi të rëndë. Për të garantuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, me paraqitjen e propozimit, Kryetari i Kuvendit vë menjëherë në dijeni Kuvendin dhe Presidentin e Republikës. Procedura e mëtejshme parlamentare kërkon që materialet përkatëse të referohen Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Ky komision vlerëson kërkesën dhe materialet shoqëruese, dëgjon Presidentin në mënyrë të detyrueshme nëse kërkohet nga ai, dhe duhet që brenda 15 ditëve të përgatisë një raport që i drejtohet seancës plenare ku komisioni shpreh qëndrimin e tij nëse duhet të ngrihet apo jo një komision hetimor nga Kuvendi për të hetuar në lidhje me faktet e pretenduar nga nismëtarët dhe veprimet konkrete të Presidentit të Republikës.

Ky vlerësim paraprak i këtij Komisioni është i nevojshëm pasi duke qenë se kemi të bëjmë me figurën e Kreut të Shtetit, nuk mundet që të fillosh procedura të tilla pa një bazë të paktën *prima facie*, të besueshme që tregojnë së paku për një aktivitet të dyshimtë të Presidentit. Në rast se kjo bazë nuk është e mjaftueshme atëherë normalisht që duhet të rekomandohet që të mos ngrihet një komisioni hetimor. Nuk ka asnjë kuptim zhvillimi i procedurave parlamentare kundër kreut të shtetit, bazuar thjesht në konsiderata politike.

Pavarësisht se mendimi i Komisionit nuk është detyrues për Kuvendin, qëndrimi i tij vetiu ka rëndësi thelbësore. Në rast se propozimi i tij për mos ngritjen e Komisionit Hetimor miratohet ose propozimi për ngritje rrëzohet, çështja në kuptim të rregullores së Kuvendit, konsiderohet gjë e gjykuar, *res judicata*, dhe këto pretendime nuk mundet që të paraqitet më në Kuvend qoftë edhe nga një grup tjetër deputetësh. Në rast se përcaktohet që ka bazë për hetimin e Presidentit të Republikës, atëherë vendoset brenda 2 ditëve ngritja e Komisionit Hetimor. Ky komision vepron sipas rregullave për komisionet hetimore parlamentare dhe ka të drejtë që të marrë prova e të pyes dëshmitarë. Gjithashtu komisioni ka detyrimin që të thërrasë dhe dëgjojë Presidentin e Republikës. Në përfundim të hetimit, komisioni hetimor duhet t'i paraqesë Kuvendit në mënyrë të arsyetuar nëse ekzistojnë shkaqet për shkarkimin e Presidentit të Republikës.

Kuvendi shqyrton raportin e komisionit hetimor në një seancë të veçantë brenda 20 ditëve nga paraqitja e tij. Konferenca e Kryetarëve përcakton datën e votimit në Kuvend të kërkesës për shkarkim të Presidentit të Republikës dhe kohën e debatit. Në rast se kërkohet nga Presidenti i Republikës për t'u dëgjuar në seancë plenare, Kuvendi është i detyruar ta dëgjojë atë. Kuvendi vendos për shkarkimin e Presidentit të Republikës me jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij, me votim të fshehtë.

Siç dihet në këtë rast, vendimi i Kuvendit për shkarkimin e Presidentit të Republikës, nuk është një vendim i formës së prerë. Vendimi i dërgohet Gjykatës Kushtetuese nga Kryetari i Kuvendit brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Parashikimi i rregullores është reflektim i parashikimit kushtetues. Në këtë rast Kuvendi nuk ka të drejtë që të vlerësojë nëse mund ta dërgojë vendimin e shkarkimit nga detyra e Presidentit në Gjykatën Kushtetuese. Vendimi i Kuvendit për shkarkimin e tij nga detyra luan në të njëjtën kohë edhe rolin e një kërkesë për fillimin e gjyqimit kushtetues.<sup>613</sup>

Rregullorja e Kuvendit, nuk jep asnjë referim në lidhje me formën e këtij vendimi, megjithatë është LGJK e cila përcakton se Vendimi i Kuvendit duhet të përmbajë një përshkrim

<sup>613</sup> Sadushi, Sokol, "Kontrolli kushtetues", Shtëpia Botuese "Botimpex", Tiranë 2004, fq. 133-134.



të argumentuar të shkeljes së rëndë të Kushtetutës ose të krimit të rëndë.<sup>614</sup> Pavarësisht këtij parashikimi, duke qenë se vendimi i Kuvendit në thelb është një akt administrativ, jam i mendimit që në këtë rast bazuar në rregullimet e nenit 109 të K.Pr.A. mund të vlejnjë si arsyetim referimi në arsyetimin dhe konkluzionet e raportit të komisionit hetimor, në tërësinë e tij ose për pjesët që janë pranuar.

Bazuar në të njëjtin rregullim ligjor, vendimi duhet që të shoqërohet me provat përkatëse.<sup>615</sup> Për një gjykim sa më të drejtë jam i mendimit që në kuptim të këtij parashikimi duhet që të gjitha aktet, që kanë të bëjnë me propozimin fillestar, qëndrimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, qëndrimin e seancës plenare, qëndrimin e komisionit hetimor, vendimmarrja e Kuvendit, procesverbalet e mbledhjes së këtyre organeve, aktet që janë administruar si gjatë hetimit dhe procedurat parlamentare në tërësinë e tyre, duhet që të shoqërojnë vendimin final të Kuvendit që i dërgohen Gjykatës Kushtetuese. Është e kuptueshme që kopjet e këtyre akteve duhet t'i jepen edhe Presidentit të Republikës. Me përmbylljen e kësaj faze hapet procedura gjyqësore.

Procedura tjetër që parashikohet nga Kushtetuta në nenin 91 është ajo e **vërtetimit të pamundësisë së ushtrimit të funksioneve nga Presidenti i Republikës**. Teorikisht kjo procedurë duhet të detajohet me tej nga Rregullorja e Kuvendit dhe LGJK. Por që të dyja këto akte parashikojnë që zbatohen të njëjta procedura, *mutatis mutandis*, që zbatoheshin edhe për procedurën e shkarkimit të Presidentit të Republikës. Për këtë arsye do të ndalemi vetëm në dallimet që ekzistojnë midis procedurës së shkarkimit dhe kësaj procedure që po shqyrtojmë në këtë pjesë.

Dallimi i parë që ekziston lidhet me nismëtarët për një procedurë të tillë. Kushtetuta në nenin 91 nuk parashikon asnjë kuorum propozimi. Për pasojë teorikisht mjafton që propozimi të vij dhe nga vetëm një deputet. Kërkesa e shoqëruar sëbashku me materilet përkatëse i paraqitet Kryetarit të Kuvendit i cili ia kalon Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Ky i fundit mbasi ka dëgjuar edhe Presidentin përgatit raportin për Kuvendin ku shprehet në lidhje me ngritjen ose jo të Komisionit Hetimor përkatës. Në rast se vendoset për ngritjen e këtij Komisioni, atëherë hetimi vazhdon më tej. Rregullorja përcakton se komisioni hetimor ngre një grup prej pesë mjekësh specialistë të cilët bëjnë kontrollin mjekësor të Presidentit. Pavarësisht se të dhënat mjekësore janë konsideruar si shumë të ndjeshme nga Gjykata Kushtetuese,<sup>616</sup> fakti që kemi të bëjmë me aftësinë ose jo të Presidentit për të qenë i përgjegjshëm tregon se jemi përpara një interesi publik të rëndësishëm, i cili bën të mundur kufizimin e mbrojtjes së të dhënave personale në këtë rast. Për me tepër ky kufizim është bërë me ligj, konkretisht nga vetë Kushtetuta. Për rrjedhojë nuk mundet që Presidenti i Republikës të refuzojë kryerjen e kontrollit mjekësor të kërkuar nga Kuvendi.

Raporti i komisionit hetimor të cilit i bashkëlidhet edhe mendimi i mjekëve ekspertë i dërgohet Kuvendit i cili vendos në seancë plenare. Në rast se me dy të tretat e votave vendoset që Presidenti i Republikës është i pamundur për të ushtruar funksionet e tij, atëherë vendimi i Kuvendit dhe materialet shoqëruese i dërgohen Gjykatës Kushtetuese.

Sipas neneve 128 dhe 140 të Kushtetutës, Kuvendi ka të drejtë që të vendosë **shkarkimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë** me dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve të tij. Në këtë rast procedura është e njëjtë me atë që ndiqet në lidhje me shkarkimin e Presidentit të Republikës nga detyra të trajtuar më sipër. Dallimet e pakta lidhen me

<sup>614</sup> LGJK, neni 61, pika 2.

<sup>615</sup> Po aty.

<sup>616</sup> Vendimi nr.16, datë 11.11.2004 i Gjykatës Kushtetuese.



të drejtën e propozimit të nismës për shkarkim. Vetë Kushtetuta nuk e jep këtë shumicë, por kjo rregullohet nga vetë LGJK, e cila në nenin 10 pika 2 të saj përcakton se ky proces përpara Kuvendit fillon me kërkesë të motivuar të jo më pak se gjysmës së të gjithë anëtarëve të organit legjislativ. Në ndryshim nga ky rregullim ligji nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, nuk e parashikon asnjë shumicë për ndërmarrjen e kësaj nisme. Për rrjedhojë bazuar në rregullimet e përgjithshme, mjafton edhe propozimi i një deputeti. Në të dyja rastet kërkesa, mbasi ka kaluar procedurën përkatëse në Kuvend duhet që të votohet nga dy të tretat e të gjithë anëtarëve.

Megjithëse Kushtetuta nuk e parashikon më Kuvendin si një subjekt për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese rezulton se vetë LGJK në nenin 66 të tij e parashikon këtë organ si subjekt që ka të drejtë të kërkojë në Gjykatën Kushtetuese **kontrollin e zgjedhshmërisë së deputetëve**. Por ky parashikim nuk duket se ka një bazë kushtetuese. Kështu Kuvendi, nuk është subjekt i aftë për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese sipas përcaktimeve të nenit 134 të Kushtetutës. Në ato raste ku ligjvënësi kushtetues e ka përcaktuar Kuvendin si subjekt që mund të vërë në lëvizje gjykatën e ka bërë shprehimisht atë, si në rastin e neneve 70, pika 4, 90, pika 3, 91, pika 2, 128 dhe 140 të kushtetutës. Këtë parashikim në mënyrë të shprehur nuk e gjejmë në rastin e kontrollit të zgjedhshmërisë së deputetëve. Mesa duket zgjedhja e legjislatorit bazohet në faktin e traditës parlamentare e cila ka gjetur pasqyrim edhe në Rregulloren e Kuvendit, ku është vetë ky institucion që bën verifikimin e mandatit të deputetëve të zgjedhur që në mbledhjet e tij të para. Por këtu krijohet edhe një tjetër problem juridik. Duke qenë se dispozita ligjore bën fjalë për Kuvendin, atëherë rezulton se për dërgimin e çështjes ky organ duhet të vendosë në seancë plenare. Referuar rregullimit të nenit 78, pika 1 të Kushtetutës, duke qenë se nuk parashikohet ndonjë shumicë e cilësuar, atëherë kërkohet një vendimmarrje me shumicë të thjeshtë të votave. Ky lloj konkluzioni bie në kundërshtim me parimin e balancimit midis pushteteve, parashikuar nga neni 7 i Kushtetutës, pasi një shumicë parlamentare, për çështje të oportunitetit politik, nuk mundet që të pretendohet se do të çojë deputetët e saj që mund të kenë fituar mandatin në kundërshtim me parashikimet e nenit 69 të Kushtetutës, vetëm nëse këta deputetë i përkasin pakicës parlamentare.

Për këtë arsye jam i mendimit se në rast se kërkues shfaqet Kuvendi, për këtë lloj gjykimi, Gjykata, nuk duhet ta legjitimojë atë. Ky konkluzion bazohet në parashikimin e nenit 124, pika 2 të Kushtetutës, dispozitë e cila parashikon se Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës. Pra, ky institucion nuk duhet që të marrë në konsideratë ligjin por duke zbatuar kontrollin incidental, të shfuqizojë këtë parashikim ligjor dhe të zbatojë drejtpërsëdrejti Kushtetutën.

## 7.2 Këshilli i Ministrave.

Këshilli i Ministrave shfaqet si subjekt i aftë për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese vetëm për të kundërshtuar marrëveshjet ndërkombëtare të cilat janë ratifikuar përpara hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, sipas nenit 180, pika 2. Duke qenë se ky është një parashikim i drejtpërdrejtë i normës kushtetuese dhe bazuar në parimin *lex specialis derogat lex generalis*,<sup>617</sup> rezulton se subjektet e tjera të parashikuara nga neni 134 i Kushtetutë janë vetiu të përjashtuar nga një mundësi e tillë. Parashikimi kushtetues përforcohet më shumë edhe nga formulimi i dispozitës përkatëse të LGJK e cila përdor një gjuhë më detyruese duke përdorur përemërin

<sup>617</sup> Norma e posaçme prevalon ndaj normës së përgjithshme.

“vetëm”<sup>618</sup>

Përzgjedhja e këtij subjekti justifikohet me faktin se vetë Kushtetuta i ka njohur këtij organi të drejtën për të përcaktuar drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore.<sup>619</sup> Duke qenë që deklarimi si antikushtetues i një marrëveshje ndërkombëtare tashmë të ratifikuar, madje prej shumë kohësh, sjell implikime në të drejtën ndërkombëtare, si në planin juridik ashtu edhe në atë politik, atëherë është mëse e kuptueshme që mbajtja e një përgjegjësie të tillë i takon pikërisht Këshillit të Ministrave.

Por nga ana tjetër, referuar sistemit parlamentar të qeverisjes që ka zgjedhur vendi ynë<sup>620</sup> dhe mënyrës së formimit të Këshillit të Ministrave i cili patjetër duhet që të ketë mbështetjen e një shumice parlamentare, rezulton se ky subjekt ka edhe një rrugë tjetër më të thjeshtë për të. Kështu, sipas Kushtetutës,<sup>621</sup> marrëveshjet ndërkombëtare ratifikohen dhe denoncohen me ligj nga Kuvendi. Duke qenë se Këshilli i Ministrave ka të drejtën e nismës ligjvënëse<sup>622</sup> dhe si rregull gëzon edhe mbështetjen e shumicave parlamentare në Kuvend, atëherë mjafton që ky organ t'i kërkojë Kuvendit denoncimin e një marrëveshje të caktuar pa qenë e nevojshme kundërshtimi në Gjykatën Kushtetuese.

Pra, kufizimi i subjektit kërkues në vetëm Këshillin e Ministrave dhe mundësia që ky ka për t'iu drejtuar edhe Kuvendit shpjegon deri në një farë shkalle mungesën e një praktike kushtetuese për këtë lloj gjykimi.

### 7.3 Kandidati i pavarur për deputet.

LGJK në nenin 66, pika 2 parashikon edhe kandidatin e pavarur për deputet si subjekt i cili mund të kërkojë në Gjykatën Kushtetuese verifikimin e zgjedhjes së deputetëve. Personalisht mendoj se ky parashikim nuk ka bazë kushtetuese. Kandidati i pavarur për deputet është një individ. Individu megjithëse është një subjekt i përcaktuar nga neni 134 gërma “g” e Kushtetutës, gëzon një legjitimitet të kufizuar dhe vetëm për të drejtën për një proces të rregullt ligjor sipas parashikimit të nenit 131 gërma “f” të Kushtetutës. Në këtë drejtim ky parashikim i ligjit del jashtë kontekstit kushtetues. Mesa duket qëllimi i ligjvënësist në hartimin e ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese, ka qenë që të sjellë një barazi midis subjekteve të ndryshme zgjedhore, por rruga që ka gjetur mendoj se është e gabuar, pasi atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta, nuk mundet që ta bëjë ligji.<sup>623</sup>

### 8. Subjektet e interesuara.

Në lidhje me subjektet e interesuara, LGJK-ja ndjek një teknikë tjetër. Kështu për çdo gjykim të veçantë ajo kujdeset që të parashikojë vetë subjektet kërkuese, ndonjëherë duke dalur edhe tej parashikimeve kushtetuese. LGJK-ja në nenin 28 të tij dhe jurisprudenca kushtetuese, subjektet e tjera që nuk kanë pozitën procedurale të kërkuesit, i konsideron si subjekte të interesuara. Neni 39 i LGJK këto subjekte i ndan në a) subjektet kundër të cilëve është paraqitur kërkesa; b) subjektet që kanë interes të drejtpërdrejtë për çështjen që shqyrtohet, c) organin që ka

<sup>618</sup> LGJK, neni 53, pika 1: *Marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat janë ratifikuar para hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe që janë të papajtueshme me të, mund të paraqiten në Gjykatën Kushtetuese vetëm nga Këshilli i Ministrave.*

<sup>619</sup> Kushtetuta, neni 100, pika 1.

<sup>620</sup> Kushtetuta, neni 1, pika 1.

<sup>621</sup> Kushtetuta, neni 121, pika 1.

<sup>622</sup> Kushtetuta neni 81, pika 1.

<sup>623</sup> Referuar sipas vendimit nr.212, datë 22.10.2002 i Gjykatës Kushtetuese.

nxjerrë aktin dhe ç) organet shtetërore që janë në mosmarrëveshje kompetence.

Pozita procedurale e këtyre subjekteve përcaktohet si rregull që në fillim në kërkesën e paraqitur nga kërkuesi ku ndër të tjera ai ka edhe detyrimin që të përcaktojë edhe subjektin e interesuar në këtë çështje. Një tjetër mundësi është që këto subjekte të thirren nga vetë Gjykata me nismën e saj, fakt që është pranuar edhe në jurisprudencë.<sup>624</sup> Në këtë rast ajo ka diskrecion të plotë që të vendosë në lidhje me subjektet që mund të thërrasë në gjykimin kushtetues. Një të drejtë të tillë gjykata shprehimisht ja ka njohur vetes edhe në rregulloren e saj të brendshme duke ja lënë këtë vendimmarrje, në varësi të situatës procedurale, Kolegjit apo Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.<sup>625</sup> Jam i mendimit se kjo e drejtë e Gjykatës për thirrjen e këtyre personave gjen mbështetje edhe në nenin 193 të K.Pr.C.<sup>626</sup> Duke u bazuar tek ky formulim, i cili në rastin e gjykimit kushtetues zbatohet *mutatis mutandis* pasi neni 1 pika 2 e LGJK lejon zbatimin e ligjeve të tjera procedurale, atëherë e drejta e Gjykatës Kushtetuese për të thirrur edhe subjekte të tjera tej atyre të përcaktuara nga palët gjen mbështetje të plotë juridike. Madje, referuar kësaj dispozite, pavarësisht se LGJK, apo rregullorja nuk e përcakton thirrjen e subjektit të interesuar nga gjykata në seancë plenare, për mendimin tim thirrja e një subjekti të tillë mund të bëhet edhe në këtë fazë të gjykimit, me vendim të ndërmjetëm, nëse gjatë shqyrtimit gjyqësor del i nevojshëm një veprim i tillë procedural.

Një tjetër mundësi për legjitimimin e një subjekti të interesuar është që ai të kërkojë të marrë vetë pjesë në gjykimin kushtetues, duke paraqitur përpara gjykatës argumentat dhe provat përkatëse në mbështetje të kërkesës së tij.<sup>627</sup> Një kërkesë e tillë mund të bëhet në çdo fazë të gjykimit kushtetues.

Duke ruajtur të njëjtën renditje të përcaktuar nga ligji më poshtë po i analizojmë më tej këto subjekte sipas kategorive përkatëse:

a) *subjektet kundër të cilëve është paraqitur kërkesa*; këto subjekte përfshihen si rregull në gjykimet konkrete që zhvillohen përpara Gjykatës Kushtetuese. Kështu, në rastin e procedurave që zhvillohen përpara kësaj gjykate për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së partive dhe të organizatave të tjera politike, një subjekt i tillë është partia/organizata politike e cila kërkohet që të deklarohej si antikushtetuese. Një tjetër subjekt që përfshihet në këtë kategori është edhe Presidenti i Republikës në rastin e procedurave për shkarkimin e tij, vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të funksioneve prej tij, apo në rastin e gjykimeve të tjera për konstatimin e papajtueshmërisë së funksionit të tij ose të kontrollit të zgjedhshmërisë së tij. Edhe deputeti është një tjetër subjekt i cili përfshihet në këtë kategori në rastin e gjykimeve për zgjedhshmërinë apo për papajtueshmërinë e funksioneve të tij. Subjekti i fundit që mund të përmendim në këtë rast janë palët e ndryshme private në rastin e gjykimeve për proces të rregullt ligjor. Këto janë subjekte të cilët kanë fituar gjykimet në shkallët e tjera të gjyqësore dhe të cilat gjyqumbësi i kundërshton nëpërmjet një gjykimi kushtetues. Në këto raste këto subjekte thirren në mënyrë që të japin argumentat e tyre mbi pabazueshmërinë e pretendimeve të palës kërkuese.

b) *subjektet që kanë interes të drejtpërdrejtë për çështjen që shqyrtohet*. Këto janë subjekte të cilët mund të thirren në çdo gjykim kushtetues që zhvillohet, mjafton që të justifikojnë faktin se kanë interes në zgjidhjen e një çështjeje përpara Gjykatës Kushtetuese. Në

<sup>624</sup> Vendimi nr.29, datë 21.10.2009 i Gjykatës Kushtetuese

<sup>625</sup> Rregullorja, neni 6, pika 2 dhe neni 8, pika 1.

<sup>626</sup> K.Pr.C., neni 193: *Gjykata, kur çmon se procesi gjyqësor duhet të zhvillohet në prani të një personi të tretë, i cili rezulton se ka interes në çështje, e thërret atë dhe për këtë qëllim shtyn seancën gjyqësore. Sekretari njofton atë me letërthirrje.*

<sup>627</sup> Vendimi nr.43, datë 06.10.2011 i Gjykatës Kushtetuese dhe vendimi nr.101, datë 25.09.2012 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.



gjykimet për interpretimin përfundimtar të një norme kushtetuese LGJK përcakton se në këtë rast thirret organi që pretendohet se e ka interpretuar gabim Kushtetutën.<sup>628</sup> Ndërsa nga vështrimi i jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese në lidhje me këtë gjykim rezulton se në të janë thirrur edhe subjekte të tjera të interesat e të cilëve mund të preken nga interpretimi që mund të japë Gjykata Kushtetuese.<sup>629</sup> Në gjykimet mbi ligjet rezulton se si rregull thirren gjithmonë edhe subjekti që ka propozuar ligjin në Kuvend. I njëjti arsyetim mund të ndiqet edhe për gjykimet e tjera, duke u vlerësuar pozita e kësaj kategorie subjektësh rast pas rasti.

Po kështu subjektet propozuese të një akti ligjor ose nënligjor nëse nuk janë thirrur si të tillë nga kërkuesi apo nga gjykata kanë të drejtë që të bëjnë vetë një kërkesë të tillë pranë Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar që të ndërhyjnë në proces.<sup>630</sup>

Në këtë kategori përfshihen edhe subjekte të cilët jo vetëm që mund të kenë interes në çështjen që po shqyrtohen nga gjykata por nga ana tjetër mund të kontribuojnë në vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese, pra thirrja e tyre paraqet interes dhe domosdoshmëri për gjykimin kushtetues. Thirrja e këtyre subjekteve është në diskrecion të vetë gjykatës e cila vendos rast pas rasti për thirrjen dhe legjitimin e tyre, në varësi të natyrës së çështjes.<sup>631</sup>

Nuk përfshihen në këtë kategori dhe për rrjedhojë nuk mundet që të bëjnë kërkesë subjektet të cilët interesat e tyre i mbrojnë në një gjykim kushtetues i cili për nga lloji dhe nga natyra është i ndryshëm me gjykimin kushtetues që është duke u zhvilluar.<sup>632</sup>

c) *organi që ka nxjerrë aktin*, është një tjetër subjekt, thirrja e të cilit është e detyrueshme në gjykimet kushtetuese. Kështu në gjykimin e ligjeve, duhet që të thirret Kuvendi, ndërsa në gjykimet për aktet normative nënligjore thirren respektivisht organi që ka nxjerrë aktin që mund të jetë Këshilli i Ministrave apo ministri, në varësi të aktit i cili është bërë objekt gjykimi. Po kështu thirren edhe organet vendore (kryetari apo këshilli) në raste kur objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese është një akt normativ i tyre.

<sup>628</sup> LGJK, neni 71, pika 4.

<sup>629</sup> Vendimet nr.75, datë 19.4.2002 dhe nr.18, datë 14.5.2013 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>630</sup> Vendimi nr.43, datë 06.10.2011 i Gjykatës Kushtetuese: *Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në datën 28.02.2011, shqyrtoi kërkesën paraprake të deputetit E.A. për t'u legjitimuar si subjekt i interesuar në këtë gjykim. Në vështrim të nenit 39/1/b të ligjit "Për Organizimin e Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", vlerësoi se ushtrimi i iniciativës ligjvënëse nga ana e deputetit, sipas nenit 81 paragrafi 1 të Kushtetutës për ligjin objekt kundërshtimi, justifikon interesin e drejtpërdrejtë, dhe e legjitimoi atë si subjekt të interesuar në interes të gjyimit kushtetues.*

<sup>631</sup> Vendimi nr.29, datë 21.10.2009 i Gjykatës Kushtetuese: *Gjykata thekson, se është në diskrecionin e saj të vendosë mbi kategoritë e subjekteve që thirren si subjekte të interesuara në çështje me interes publik. Ligji për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, në nenin 39, shkronja "b", "c" dhe "ç" nuk i parashikon subjektet e interesuara në mënyrë shteruese, por përcakton kriterin e "interesit të drejtpërdrejtë" që duhet të ketë subjekti për çështjen që shqyrtohet. Në vlerësimin e interesit të kërkuesit për të vënë në lëvizje Gjykatën dhe interesit të drejtpërdrejtë të subjektit të interesuar, respektohen kriteret e ndryshme. Në çështjet me interes publik, interesi i drejtpërdrejtë i subjekteve të interesuara duhet kuptuar dhe si interes për të kontribuar në vendimmarrjen e kësaj Gjykate për çështjen që shqyrtohet. Kështu, vlerësimi i legjitimitetit të subjektit të interesuar bazohet jo vetëm në interes të subjektit, por dhe të gjyimit kushtetues. Në këtë vështrim, në gjykimet kushtetuese legjitimohen si subjekte të interesuara ato subjekte që, për shkak të veprimtarisë apo rrethanave, mund të kontribuojnë në shqyrtimin e çështjes që po gjykohej, pavarësisht nëse thirren në gjykim me kërkesën e kërkuesit apo dhe kryesisht nga Gjykata. Në përfundim, ndonëse subjektet e interesuara kanë status të ndryshëm, në çështjen objekt gjykimi, Gjykata vlerëson se, në interes të gjyimit, ata legjitimohen të marrin pjesë në gjykim si subjekte të interesuara.*

<sup>632</sup> Vendimi nr.101, datë 25.09.2012 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese: *Në vështrim të nenit 39/1/b të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", dhe të jurisprudencës së mësipërme, në rastin konkret Kolegji çmon se kërkuesi nuk e justifikon interesin e drejtpërdrejtë në këtë çështje. Interesi i tij është një interes subjektiv, që lidhet me procesin e rregullt ligjor, ndërkohë që çështja konkrete ka të bëjë me kontrollin abstrakt të ligjit dhe mbart interes publik.*



I vetmi rast përjashtimor është në gjykimin kushtetues të procesit të rregullt ligjor ku pavarësisht se objekt gjykimi bëhen vendimet e gjykatave të zakonshme, këto gjykata nuk janë pjesë e procesit kushtetues. Për rrjedhojë rezultojnë se termi “akt” në këtë rast përfaqëson akt ligjor ose nënligjor me karakter normativ.

ç) *organet shtetërore që janë në mosmarrëveshje për kompetencë*. Kjo pikë e nenit 39 të LGJK përfshin në thelb një rreth të gjërë subjektësh. Organet shtetërore në këtë rast kanë si cilësinë e kërkuarit ashtu edhe cilësinë e subjektit të interesuar. Ajo që vlen të theksohet është se neni 54 i LGJK parashikon se Gjykatës Kushtetuese në këtë rast vihet në lëvizje nga subjektet në konflikt ose nga subjektet e cënuara drejtpërdrejt nga konflikti. Kjo do të thotë se është pranuar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese se mosmarrëveshja e kompetencës mund të lindë, *së pari*: me të gjitha organeve kushtetuese, *së dyti*: ndërmjet organesh ose subjektësh që nuk bëjnë pjesë në mënyrë të përcaktuar, në këtë ose atë pushtet, si p.sh., prokuroria nga njëra anë dhe Kuvendi nga ana tjetër dhe *së treti*: ndërmjet organit kushtetues nga njëra anë dhe një pjesë të organit kushtetues nga ana tjetër, si p.sh., jo më pak se një e katërta deputetëve të Kuvendit.<sup>633</sup>

Duke qenë se pozitën e kërkuarit në një mosmarrëveshje kompetencash e analizuar me sipër, rezultojnë se në pozitën e *subjektit të interesuar* duhet të jetë organi/institucioni i cili pretendohet se ka kryer cënimin, ose që nuk realizojnë detyrimet e tij kushtetuese duke cënuar në këtë mënyrë kompetencat e organeve të tjera. Subjekte të interesuar në këto raste do të shfaqeshin respektivisht organet vendore dhe ato qendrore në varësi të llojit të subjektit që paraqet kërkesën. Në këtë rast duhet të kemi në konsideratë që cënimin e kompetencës kushtetuese të këtyre organeve mund ta bëjnë vetë organet kushtetuese por edhe organet e tjera me natyrë ligjore që janë krijuar dhe funksionojnë pranë tyre. Kështu Gjykata Kushtetuese ka pranuar për gjykim edhe kërkesa për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave kur akti apo veprimi administrativ që është bërë shkak për lindjen e mosmarrëveshjes nuk është miratuar nga vetë organi kushtetues por nga organe që funksionojnë pranë tij. Si shembuj mund të përmendim, rastin kur si palë në mosmarrëveshje është thirrur Këshilli i Ministrave për akte të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit, Policia e Ndërtimit, Këshilli Kombëtar i Territorit etj. Po kështu është vepruar edhe me Kuvendin kur veprimet në fakt janë kryer nga një komision i ngritur pranë tij.

Në praktikën gjyqësore është shfaqur një situatë e diskutueshme, për sa i përket ndërgjyqësisë, kur gjykata shqyrtoi mosmarrëveshjen e kompetencave ndërmjet organeve të qeverisjes vendore dhe atyre qendrore.<sup>634</sup> Në atë rast Gjykata u shpreh se ndodhemi përpara një konflikti normativ midis institucioneve për shkak se të njëjtat kompetenca që lidheshin me planifikimin urban, u ishin dhënë në bazë të ligjeve të ndryshme, si organeve të qeverisjes vendore, ashtu edhe organeve të pushtetit qendror.

Kërkuar, në këtë gjykim, ishte Bashkia Tiranë, e cila pretendonte se ishte cënuar kompetenca e saj, dhe me cilësinë e subjekteve të interesuara u thirrën organet qendrore të pushtetit ekzekutiv, për të cilat pretendohet se kishin tejkaluar kompetencat e tyre. Gjykata Kushtetuese duke konkluduar se konflikti buronte nga ligje të ndryshme shqyrtoi kushtetutshmërinë e tyre dhe zgjidhi mosmarrëveshjen midis këtyre palëve, duke shfuqizuar aktet ligjore që kishin shërbyer si shkak për lindjen e mosmarrëveshjes së kompetencave.

Në këtë rast mendoj se nuk është zgjidhur drejt ndërgjyqësia. Pavarësisht se organet e përfshira në atë mosmarrëveshje kompetencash kishin vepruar aktivisht me anë të akteve të

<sup>633</sup> Sadushi, Sokol, “Drejtesia Kushtetuese në zhvillim”, Shtëpia Botuese “Toena”, Tiranë 2012, fq.509-510 si edhe vendimet nr.26, datë 04.12.2006; nr.20, datë 04.05.2007 dhe nr.12, datë 20.05.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>634</sup> Vendimi nr.29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese

ndryshme individuale, siç me të drejtë konkludoi gjykata, këto akte ishin ndërmarrë në bazë të kompetencave që ligje të ndryshme u jepnin këtyre organeve, të drejtën për të ndërhyrë në planifikimin e territorit. Për rrjedhojë, duke qenë se shkaku thellesor i kësaj mosmarrëveshjeje nuk ishin aktet e nxjerra nga organet palë në gjykim, por nga organe të tjera shtetërore, në këtë rast nga Kuvendi, atëherë mendoj se me cilësinë e subjektit të interesuar duhet të ishte thirrur edhe ky i fundit, me qëllim që t'i jepej mundësia për të dhënë shpjegimet e tij, në lidhje me aktet ligjore që ai kishte miratuar dhe që kishin shkaktuar këtë situatë.

Është e vërtetë se neni 39 gërma "ç" e LGJK parashikon se duhet të thirren organet që janë në konflikt, por përderisa gjykata, gjykoj se për ta zgjidhur këtë mosmarrëveshje duhet të shqyrtonte kushtetutshmërinë e shkakut të mosmarrëveshjes, atëherë duke zbatuar nenin 39 gërma "c" të po të njëjtit ligj, duhet të ishte thirrur edhe organi që kishte nxjerrë aktin.

Pavarësisht rastit klasik të mësipërm në praktikat e vendeve të tjera është pranuar edhe mundësia që si subjekte të interesuara të ndërhyjnë në gjykim kur vendimi është i rëndësishëm edhe për përcaktimin e kompetencave të tyre.<sup>635</sup> Në këtë rast çështja e diskutueshme dhe që i përket subjekteve të interesuar do të ishte nëse nga zgjidhja e mosmarrëveshjes preken edhe subjekte të tjera, kushtetuese ose jo, të cilat janë të interesuar për zgjidhjen që do të japë gjykata në një gjykim të tillë. Në jurisprudencën kushtetuese shqiptare ka pasur vetëm një rast kur Gjykata jonë Kushtetuese ka përfshirë një palë private në proces si subjekt të interesuar.<sup>636</sup> Në këtë lloj gjykimi me natyrë mikse, një grup deputetësh të Kuvendit, kishin kërkuar interpretimin e nenit 78 të Kushtetutës dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave, krijuar sipas tyre, midis Kuvendit dhe Presidentit. Në këtë rast Kuvendi kishte mbajtur një qëndrim të dyzuar në lidhje me dhënien e pëlqimit për një kandidaturë për në Gjykatën e Lartë të emëruar nga Presidenti. Gjatë procedurës së dhënies së pëlqimit, Kuvendi në fillim u shpreh se pëlqimi ishte dhënë dhe më pas u shpreh se ky pëlqim nuk ishte dhënë. Për t'i dhënë përgjigje çështjes Gjykata vendosi të thërrasë si subjekt të interesuar edhe vetë personin që kishte kandiduar për në Gjykatën e Lartë, me justifikimin se thirrja e tij do të ndihmonte Gjykatën për të arritur një zgjidhje sa më të drejtë. Pavarësisht kësaj, në përfundim të gjykimit, Gjykata Kushtetuese e legjitimoi grupin e deputetëve vetëm për kërkesën për interpretim të nenit 78 të Kushtetutës dhe jo për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave. Për rrjedhojë edhe thirrja e kësaj pale private si subjekt i interesuar në këtë gjykim mbeti pa vlerë.

Duke mbetur në të njëjtën temë rezulton se doktrina e huaj ka mbajtur qëndrimin se pavarësisht ndonjë hapje që vërehet në raste të caktuara në gjykimin kushtetues, si rregull kontradiktorialiteti zhvillohet vetëm nëpërmjet organeve kushtetuese që përfshihen në një mosmarrëveshje kompetencash.<sup>637</sup>

## 9. Përfaqësimi në gjykimin kushtetues.

Neni 39 i LGJK, në pikat 2, 3 dhe 4 të tij, synon që të rregullojë edhe përfaqësimin e subjekteve të ndryshme në gjykimin kushtetues. Kështu LGJK, ndjek rregullin e përgjithshëm që personat juridikë publikë përfaqësohen nga drejtuesit e tyre. Megjithatë është e ditur që drejtuesit e një institucioni në përgjithësi, nuk janë juristë të aftë për të realizuar një përfaqësim të rregullt

<sup>635</sup> Harberle, Peter, "La verfassungsbeschwerde nel sistema della giustizia costituzionale tedesca", botimi në italisht, Shtëpia Botuese "Giuffrè Editore", Milano 2000, fq.39.

<sup>636</sup> Vendimi nr.29, datë 21.10.2009 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>637</sup> Ruggeri, Antonio; Spadaro, Antonino, "Lineamenti di giustizia costituzionale", Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2009, fq.265-266.

dhe efektiv në Gjykatën Kushtetuese. Për këtë arsye LGJK parashikon mundësinë që të autorizohen persona të tjerë për këtë qëllim, por pa dhënë asnjë kriter apo kusht për këta persona. Për këtë arsye është e nevojshme që t'i drejtohem edhe akteve të tjera juridike. Parimisht institucionet e administratës shtetërore përfaqësohen nga Avokatura e Shtetit.<sup>638</sup> Avokatura e Shtetit gjithsesi është e përjashtuar nga përfaqësimi në rastin kur në gjykim si palë kundërshtarë janë disa institucione shtetërore.<sup>639</sup> Megjithatë edhe në rastet e tjera, në praktikë ka ndodhur rrallë që Avokatura e Shtetit të marrë pjesë si përfaqësues në një gjykim kushtetues. Në përgjithësi organet shtetërore përfaqësohen nga nëpunësit e strukturave juridike që funksionojnë pranë tyre.

Përsa i përket subjekteve të tjera, ata mund të zgjedhin që të përfaqësohen me avokat. Për të garantuar një përfaqësim cilësor dhe efektiv, LGJK përcakton se Dhoma Kombëtare e Avokatisë cakton listën e avokatëve që mund të marrin pjesë në shqyrtimin e këtyre çështjeve. Megjithatë duke iu referuar formulimit të nenit 39, pika 3 të LGJK, e cila përdor termin "mund", rezulton se përfaqësimi me avokat nuk është i detyrueshëm në gjykimin kushtetues. Ky është një dallim nga gjykimi në Gjykatën e Lartë ku përfaqësimi me avokat është detyrues.

Përfaqësimi detyrues me avokat ka avantazhet dhe disavantazhet e veta. Kështu detyrimi për të pasur avokat do të sillte si pasojë kërkesa më cilësore dhe largimin e individëve për të sjellë kërkesa të tepërta në Gjykatë. Por nga ana tjetër kjo do të kufizonte aksesin në këtë Gjykatë dhe do të nxiste paraqitjen e kërkesave për ndihmë ligjore falas nga ana e Gjykatës Kushtetuese, e cila do të humbiste shumë kohë për shqyrtimin e tyre.<sup>640</sup> Për këtë arsye jam i mendimit që zgjidhja e ofruar nga LGJK është mëse e kënaqshme.

## KONKLUZIONE.

Një tjetër element i rëndësishëm që karakterizon procesin gjyqësor në përgjithësi dhe procesin kushtetues në veçanti janë palët, të cilët LGJK i njeh me emërtimin pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues. Si rregull këta pjesëmarrës ndahen në dy kategori të mëdha, kërkuesi dhe subjektet e interesuara. Në pozitën e kërkuetit është kujdesur vetë Kushtetuta që të na përcaktojë subjektet që kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese. Për këtë aspekt duhet të theksojmë se Kushtetuta jonë është shumë liberale në këtë drejtim pasi njeh një numër të madh subjektetesh që kanë të drejtë që t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese. Këto subjekte janë në rradhë të parë subjektet e pakushtëzuara, të cilat konsiderohen se mbrojnë një interes të përgjithshëm dhe për rrjedhojë nuk kanë nevojë që të justifikojnë interesin e tyre. Por nga këto subjekte rezulton se Presidenti i Republikës i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese vetëm për mbrojtjen e kompetencave të tij kushtetuese. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Përsa i përket Kryeministrit ai nuk ka qenë shumë aktiv në këtë drejtim. Kjo justifikohet me pozitën e tij politike që si rregull është drejtues i një shumice parlamentare. I vetmi subjekt aktiv në këto raste ka qenë vetëm grupimi i deputetëve, ose jo më pak se një e pesta e deputetëve siç e përmend dhe ligji themelor. Në përgjithësi me ndonjë rast të izoluar, Gjykata Kushtetuese ka qenë e qëndrueshme në legjitimitetin e këtyre subjekteve.

<sup>638</sup> Ligji nr.10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit", neni 2, pika 2 dhe neni 5.

<sup>639</sup> Po aty, neni 5.

<sup>640</sup> Scibert, Helga, "Admissibility requirements for constitutional complaints and mechanisms for avoiding an excessive case load", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15", botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998, fq. 150.



Përsa i përket subjekteve të kushtëzuara, Gjykata Kushtetuese ka treguar gjithmonë një evoluim. Në disa raste për mirë, dhe në disa raste në sens të kundërt. Kështu, megjithëse është treguar mbyllëse në fillim ndaj Avokatit të Popullit, duke ia mohuar aksesin për të kundërshtuar aktet ligjore, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese më pas u ndryshua duke e lejuar këtë subjekt që të ankohet edhe për ligjet, në rast se pretendohet se ato çenojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka qenë e qëndrueshme në lidhje me legjitimitetin e organeve të qeverisjes vendore si edhe inekzistente përsa i përket bashkësive fetare. Kjo e fundit është e kuptueshme që nuk ka qenë për faj të Gjykatës, pasi pranë saj në asnjë moment nuk janë paraqitur kërkesa nga këto subjekte. Përsa i përket partive politike, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka treguar një lloj objektiviteti duke i përkufizuar interesin e tyre vetëm në ato kategori aktesh të cilat çenojnë pjesëmarrjen e tyre në zgjedhje, si një pjesë e procesit politik për formimin e vullnetit të zgjedhësve, si edhe në ato akte të cilat çenojnë organizimin e tyre të brendshëm. Por jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka treguar edhe luhajtje të forta duke vendosur shenjën e pabarazisë midis një partie politike dhe nivelit të saj të përfaqësimit në Kuvend. Për shkak të këtij niveli përfaqësimi ajo e ka konsideruar një parti politike të barabartë me një tjetër subjekt kushtetues që për nga natyra e tij është i pakushtëzuar, jo më pak se një e pesta e deputetëve.

Po kështu e paqëndrueshme është jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me subjektin tjetër, organizata të tjera, nga ku rezultonte se në fillim Gjykata Kushtetuese i legjitimonte organizatat pa anëtarësi dhe më pas vendosi të mos i legjitimojë ato. Ky ndryshim i jurisprudencës u bë nga Gjykata Kushtetuese pa arsyetuar nëse ekzistojnë arsye të forta që e justifikonin një ndërmarrje të tillë, rastet se përse kjo ishte e paevitueshme, objektivisht e domosdoshme, si dhe kushtetutshmërisht e bazuar dhe e arsyetuar. Theksoj se këto kërkesa janë përcaktuar nga vetë Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj.<sup>641</sup> Gjykata Kushtetuese duhet ta kuptojë që arsyet që ajo jep në lidhje me një çështje, në rastin konkret me legjitimin apo jo të një subjekti, nuk janë arsye që argumentojnë apo justifikojnë ndryshimin e jurisprudencës.

Subjekt tjetër i rëndësishëm janë edhe gjykatat e zakonshme. Në vende të tjera këto institucione janë mjaft aktive kurse në Shqipëri ushtrimi i kontrollit incidental nga ana e gjykatave të zakonshme është një mundësi që ndodh jo shumë shpesh. Kjo lidhet më shumë me një mungesë të njohjes së gjyqtarëve të zakonshëm të procedurave të gjykimit kushtetues dhe veçanërisht të procedurave për të ushtruar këtë formë kontrolli. Në përgjithësi gjyqtarët e zakonshëm nuk kanë njohurinë e duhur për kërkesat procedurale mbi bazën e të cilave ata mundet që të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Po kështu shumë pak ose aspak njihet mundësia për të ushtruar kontroll incidental edhe nga gjykatat e arbitrazhit apo organet quasi gjyqësore, megjithëse siç u analizua më sipër një mundësi e tillë ekziston. Akoma me e çuditshme në përgjithësi duket edhe mundësia që Gjykata Kushtetuese të ushtrojë kontroll incidental pranë saj megjithëse kjo procedurë njihet nga gjykatat e tjera kushtetuese, aplikohet prej shumë kohësh dhe madje është konfirmuar si procedurë e rregullt edhe nga GJEDNJ.

Individët janë një tjetër subjekt i parashikuar nga Kushtetuta, megjithëse është vetë akti themelor i cili gjithashtu ja kufizon të drejtën e tyre për akses pranë Gjykatës Kushtetuese, vetëm në kërkesat për një proces të rregullt ligjor, si edhe me kushtin e shterimit të mjeteve juridike të cilat për shkak të procedurave të shumta gjyqësore, shfaqen edhe shume komplekse. Por plotësimi i këtyre kushteve është i domosdoshëm për të garantuar aksesin pranë Gjykatës Kushtetuese. Në këtë pikë është ironike situata kur Gjykata Kushtetuese duhet që të jetë

<sup>641</sup> Vendimi nr.21, datë 29.4.2010 i Gjykatës Kushtetuese.



autoriteti që duhet të garantojë të drejtat dhe liritë themelore të individëve por ndërkohë aksesin pranë saj është disi i komplikuar nga pikëpamja procedurale. Kjo vjen si rezultat i garantimit të parimit të funksionalitetit të kësaj Gjykate, duke mos lejuar mbingarkesën e saj me çështje. Por nga ana tjetër Gjykata Kushtetuese duhet parë si një mjet i fundit ankimor dhe mund të përdoret vetëm në ato raste kur të gjitha mekanizmat e tjerë juridiksionalë kanë dështuar.

Kushtetuta, parashikon edhe disa subjekte specifike vetëm për disa lloje gjykimesh. Njëri prej tyre është Kuvendi, ku në bazë të vendimit të tij mund të nisin një sërë gjykimesh kushtetuese, si ai për shkarkimin e Presidentit, vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të funksioneve prej tij, vërtetimin e papajtueshmërisë së ushtrimit të funksionit të deputetëve etj. Një tjetër subjekt i tillë është edhe Këshilli i Ministrave, i cili parashikohet si subjekt i vetëm që mund të kërkojë antikushtetutshmërinë e një marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar nga vendi ynë përpara hyrjes në fuqi të Kushtetutës.

Në disa raste LGJK, del jashtë parashikimeve të Kushtetutës, duke parashikuar subjekte të ndryshme nga ato që parashikojnë normat kushtetuese, siç është rasti i kandidatëve të pavarur. Është e kuptueshme që një situatë e tillë duhet të rregullohet, për të qenë në përputhje me ligjin themelor të vendit.

Për të garantuar procesin e rregullt ligjor, edhe në gjykimin kushtetues, LGJK parashikon si subjekt procedural edhe subjektet e interesuara. Prania e këtyre subjekteve ndihmon që palët të kenë mundësinë e paraqitjes së mbrojtjes dhe të argumentave të tyre në funksion të saj. Kjo gjithashtu ndihmon edhe Gjykatën Kushtetuese që të ketë një pasqyrë më të plotë të çështjes dhe për pasojë vendimmarrja e saj të jetë më objektive. Bazuar në parimin e kontradiktorialitetit, duke ballafaquar argumentat e pjesëmarrësve në proces, Gjykata Kushtetuese ka një këndvështrim më të plotë dhe të gjithëanshme, duke e mundësuar atë që të arrijë në një vendimmarrje sa më të drejtë. Nuk duhet pretenduar që një çështje mund të zgjidhet drejtë bazuar vetëm në profesionalizmin e trupës gjyqësore dhe në mbështetjen teknike të stafit të saj. Është fakt i ditur që shpeshherë dhe profesionalizmi i përfaqësuesve të palëve në gjykim ka një ndikim të madh në mënyrën e paraqitjes të çështjes.

Përfaqësimi i palëve rregullohet pak nga LGJK. Në thelb ky ligj rregullon përfaqësimin e institucioneve si edhe parashikon që në rastin e avokatëve mund të jenë vetëm ato të cilët janë përcaktuar si të tillë nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Kjo e fundit ka vendosur si kriter vetëm vjetërsinë në ushtrimin e profesionit të avokatit, pra vetëm për ato avokatë që kanë ushtruar për 10 vite këtë profesion. Megjithëse është një periudhë relativisht e gjatë kohore, një avokat që do të merret më çështje të natyrës kushtetuese duhet që domosdoshmërisht të ketë një profilizim në këtë fushë. Kjo duket qartazi ku shumë kërkesa të avokatëve, megjithëse me përvojë të gjatë në këtë profesion, për shkak se janë profilizuar në degë të tjera të së drejtës, kanë dështuar në procesin kushtetues. Nga ana tjetër avokatët e profilizuar në fushën e së drejtës kushtetuese, në përgjithësi kanë edhe tarifa të larta për ofrimin e shërbimeve të tyre. Për këtë arsye LGJK lejon mundësinë e mbrojtjes vetë përpara Gjykatës Kushtetuese. Megjithëse kjo situatë krijon në dukje akses para kësaj Gjykate, rregullat e komplikuar procedurale dhe niveli i lartë i dajës që kërkohet për procesin kushtetues dhe të drejtën materiale kushtetuese, bëjnë që shpeshherë këto kërkesa të dështojnë.

## KREU IV

### AFATET, AKTET PROCEDURALE DHE PROVAT NË GJYKIMIN KUSHTETUES

#### Hyrje

Në mënyrë që pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues të ushtrojnë të drejtat e tyre për të kundërshtuar aktet, veprimet ose mosveprimet që janë objekt i gjykimit kushtetues, duhet që të respektojnë edhe afatet që parashikohen në përgjithësi nga LGJK. Ushtrimi i të drejtave dhe procedurave gjyqësore brenda afateve ka si qëllim garantimin e parimit të sigurisë juridike dhe zhvillimin e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm. Për këtë arsye në këtë kre si nënçështje të parë do të trajtojmë afatet procedurale, llojet e tyre si edhe mundësinë e rivendosjes në afat për subjekte të ndryshme.

Pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues dhe Gjykata Kushtetuese, mund të veprojnë vetëm nëpërmjet akteve procedurale. Për këtë qëllim, nënçështja e rradhës adreson llojet e ndryshme të akteve procedurale që gjejnë zbatim në një gjykim kushtetues. Po kështu palët kanë mundësi që të përdorin në gjykimin kushtetues, në mbështetje të pretendimeve të tyre prova të ndryshme të cilat njihen nga LGJK dhe që do të trajtohen në vijim.

#### 1. AFATET PROCEDURALE

Afati është një moment i caktuar në kohë që sjell efekte juridike në lidhje me lindjen, ndryshimin apo shuarjen e një marrëdhënie juridike. Afati mund të jetë edhe një periudhë brenda apo me kalimin e së cilës, duhet të kryhet një veprimtari procedurale e caktuar. Pra afati nënkupton një distancë kohore brenda së cilës duhet të kryhet një veprim procedural i caktuar. Afati është gjithashtu edhe një interval kohe gjatë së cilës mund të ndërmerren disa veprime në proces.<sup>642</sup>

Si çdo gjykim i zakonshëm edhe gjykimi në Gjykatën Kushtetuese disiplinohet nga afate të caktuara procedurale. Qëllimi i këtyre afateve është realizimi i një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, si një nga elementët e procesit të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës. Ky parim kërkon zhdërvjellësinë e procesit gjyqësor. Për të vlerësuar nëse zgjatja e procesit në një çështje konkrete ka qenë “e arsyeshme”, si element përcaktues janë shkalla e komplikimit të çështjes, sjellja e vetë gjykatës, veprimet e subjekteve pjesëmarrëse dhe rëndësia e çështjes për vetë kërkuesin. Sistemi i drejtësisë kushtetuese nuk mund të zhvillohet me vonesa, të cilat çojnë në dobësimin e rolit, por edhe të besimit të Gjykatës Kushtetuese.<sup>643</sup>

Por përveç respektimit të parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, afatet procedurale janë të lidhura ngushtë edhe me respektimin e parimit të sigurisë juridike. Kështu, subjektet që veprojnë në fushën e së drejtës kushtetuese nuk duhet që të rrinë vazhdimisht të shqetësuar në lidhje me ndryshimin e situatës juridike në të cilën ndodhen. Për këtë arsye subjektet që kundërshtojnë akte juridike të caktuara, duhet që të veprojnë brenda një afati të përcaktuar përndryshe e humbasin këtë të drejtë.

<sup>642</sup> Uka, Njazi, “Fjalori i Drejtësisë”, Shtëpia Botuese “Iliar” P.F., Tiranë 2011, fq.15.

<sup>643</sup> Sadushi, Sokol, “Drejtësia Kushtetuese në zhvillim”, Shtëpia Botuese “Toena”, Tiranë 2012, fq.349.

## 1.1 Natyra e afatit.

Legjislacioni shqiptar si shumica e legjislacioneve nga pikëpamja e natyrës njih dy lloje afatesh, që janë: parashkrimi shues dhe prekluziviteti (dekadenca). Parashkrimi shues nënkupton mosshtrimin e mjetit procedural brenda afatit të caktuar në ligj. Ky mosveprim nuk shuan të drejtën subjektive por ajo nuk mund të realizohet më nëpërmjet gjykatës ose të organit tjetër kompetent.<sup>644</sup> Afati i parashkrimit është koha e caktuar nga ligji brenda së cilës, pala e interesuar duhet të kërkojë me anë të padive etj, mbrojtjen e të drejtës subjektive që i është shkelur ose kundërshtuar.<sup>645</sup> Pra në rastin e tejkalimit të afatit të parashkrimit, palës i humbet e drejta për t'iu drejtuar gjykatës por jo vetë e drejta subjektive.

Ndërsa në rastin e prekluzivitetit të së drejtës kemi të bëjmë më shuarjen e vetë së drejtës subjektive.<sup>646</sup> Këto janë afate të caktuara nga ligji të cilat janë të prera, nuk mund të shkurtohen ose të shtyhen qoftë edhe me pëlqimin e palëve.<sup>647</sup>

Çështja që shtrohet për diskutim është nëse afatet procedurale që disiplinojnë veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese janë afate parashkrimi apo afate prekluzive. Në jurisprudencën e saj Gjykata Kushtetuese i përcakton afatet procedurale të saj, si afate parashkrimi.<sup>648</sup>

Mendoj se terminologjia e përdorur në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, e cila i ka konsideruar afatet e saj procedurale si afate parashkruese, është e gabuar. Si rregull afatet procedurale janë afate prekluzive. Me kalimin e tyre shuhet e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, pra në këtë rast shuhet e drejta e aksesit në gjykatë. Pala së cilës i ka kaluar afati nuk mund të paraqesë më kërkesë përpara Gjykatës Kushtetuese, pasi kjo e drejtë e saj tashmë u shua.

Duke vazhduar më tej arsyetimin, rezulton se afati i parashkrimit mund të pezullohet<sup>649</sup> ose të ndërpritet<sup>650</sup> në rastet e përcaktuara shprehimisht nga ligji. Për afatet prekluzive ligji nuk parashikon raste për pezullimin apo ndërprerjen e tyre.<sup>651</sup> Nëse analizojmë dispozita mbi afatet të LGJK-së dhe të K.Pr.C. si ligji plotësues që rregullon veprimtarinë procedurale të gjykimit kushtetues, konstatojmë se në asnjë rast nuk parashikohet mundësia e ndërprerjes apo pezullimit të afateve procedurale, argument ky që shkon në favor të tezës se afatet e saj procedurale kushtetuese, nuk janë afate parashkruese por janë afate prekluzive.

Si argument të fundit të këtij arsyetimi i duhet dhënë përgjigje pyetjes nëse kalimi i afateve procedurale kushtetuese mund të konstatohet kryesisht nga Gjykata Kushtetuese, apo kjo e fundit konstatimin e këtij fakti mund t'a bëjë vetëm me kërkesën e palëve pjesëmarrëse në gjykimin kushtetues?

Dallimi kryesor ndërmjet afateve parashkruese dhe afateve prekluzive, është fakti se në rastin e parë parashkrimi i plotësuar nuk mund të merret parasysht nga gjykata ose organi tjetër

<sup>644</sup> Shih *mutatis mutandis* nenin 112 të Kodit Civil.

<sup>645</sup> Uka, Njazi, "Fjalori i Drejtësisë", Shtëpia Botuese "Iliar" P.F., Tiranë 2011, fq.15.

<sup>646</sup> Shih *mutatis mutandis* nenin 137 të Kodit Civil.

<sup>647</sup> Uka, Njazi, "Fjalori i Drejtësisë", Shtëpia Botuese "Iliar" P.F., Tiranë 2011, fq.15.

<sup>648</sup> Vendimi nr. 29, datë 26.12.2006 i Gjykatës Kushtetuese: *Afati trevjeçar i parashkrimit për të kërkuar kontrollin kushtetues të një ligji, që parashikohet në nenin 50 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të RSH", zbatohet në rastet kur subjektet përkatëse kanë kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit në kuptimin abstrakt. Të njëjtën terminologji gjejmë edhe në vendimin nr.212, datë 29.10.2002 të Gjykatës Kushtetuese si edhe në vendimet nr.36, datë 23.04.2010, nr.90, datë 17.12.2010 dhe nr.101, datë 24.12.2010 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.*

<sup>649</sup> Kodi Civil, neni 129.

<sup>650</sup> Kodi Civil, neni 131.

<sup>651</sup> Kodi Civil, neni 137.

kompetent me nismën e vet (kryesisht), por vetëm me kërkesën e palës së interesuar,<sup>652</sup> ndërsa në rastin e dytë afati prekluziv i plotësuar merret parasysh nga gjykata ose arbitrazhi kompetent me nismën e vet, edhe pa u kërkuar nga pala e interesuar.<sup>653</sup>

Duke i'u rikthyer gjykimit kushtetues vërejmë se Gjykata Kushtetuese në mënyrë konstante ka vepruar me nismën e saj për të verifikuar kalimin apo jo të afatit procedural<sup>654</sup> dhe në ato raste kur ka konstatuar kalimin e afateve procedurale ka vendosur moskalimin e kërkesës për shqyrtim në seancë plenare pasi mungon legjitimimi *ratione temporis* i subjektit kërkuar.

Pra, si përfundim mund të themi se afatet procedurale të parashikuara nga Kushtetuta, LGJK-ja dhe legjislacioni tjetër plotësues janë si rregull afate prekluzive.

## 1.2 Llojet e afateve.

Doktrina për efekte studimi ka bërë disa ndarje të llojeve të afateve. Kështu kemi afate vonuese dhe afate përshpejtuese. Afatet vonuese (ose të ndërmjetme) janë ato afate që duhet të mbarojnë përpara se të mund të kryhet një akt i përcaktuar procedural dhe afate përshpejtuese brenda të cilëve duhet të kryhet një akt i caktuar.

Afatet përshpejtuese ndahen në afate të zakonshme dhe afate të prera. Afatet e zakonshme kanë për qëllim të rregullojnë veprimtarinë procedurale sipas nevojave të normave të zhvillimit të procesit, por mosrespektimi i tyre nuk prodhon në vetvete rënien e së drejtës për të kryer aktin më vonë. Afatet e prera, në asnjë rast nuk mund të shkurtohen ose të zgjaten nga gjykata dhe mbarimi i tyre si rregull bashkësjell humbjen e mundësisë për të kryer aktin.<sup>655</sup>

Megjithatë duke analizuar Kushtetutën dhe LGJK-në, vërejmë se në dispozitat e tyre ato parashikojnë një sërë afatesh, që synojnë të disiplinonin aspekte të ndryshme të veprimtarisë procedurale të Gjykatës Kushtetuese. Nga një analizë tërësore e këtyre dispozitave, mund t'i ndajmë edhe në një mënyrë tjetër dhe konkretisht a) në afate procedurale për subjektet dhe b) në afate procedurale për gjykatën.

Si afat procedural për subjektet mund të përmendim afatin 15 ditor që kanë në dispozicion organet vendore të zgjedhura drejtpërsëdrejti, për t'u ankuar në Gjykatën Kushtetuese, kundër vendimit të Këshillit të Ministrave për shkarkimin apo shpërndarjen e tyre.<sup>656</sup> Afatet të tjera për subjektet kushtetuese parashikohen në LGJK-në dhe konkretisht kemi:

a) afati 2 vjeçar për t'u ankuar nga individët në rast se ata pretendojnë cënimin e të drejtës së tyre për një proces të rregullt ligjor;<sup>657</sup> b) afati 3 vjeçar për të kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese aktet normative (ligjet, aktet normative të organeve qendrore dhe atyre vendore);<sup>658</sup> c) afati 6 mujor për të kërkuar shqyrtimin nga Gjykata Kushtetuese të mosmarrëveshjes së kompetencave;<sup>659</sup> ç) afati 6 mujor për të kërkuar konstatimin e shkaqeve të pazgjedhshmërisë në

<sup>652</sup> Kodi Civil, neni 125.

<sup>653</sup> Kodit Civil, neni 140.

<sup>654</sup> Shih Vendimet nr.89, datë 13.07.2012, nr. 84, datë 9.10.2009, nr.6 datë 18.1.2013, nr. 15 datë 5.2.2013 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese për sa i përket kalimit të afatit 3 – vjeçar parashikuar nga neni 50 i LGJK-së. Shih Vendimin nr.100, datë 20.12.2010 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese për sa i përket kalimit të afatit 6 mujor parashikuar nga neni 66, pika 3 e LGJK-së. Edhe për sa i përket afatit 2 vjeçar ka një jurisprudencë të vazhdueshme dhe konstante të Gjykatës Kushtetuese për ta konstatuar vetë kryesisht kalimin e këtij afatit. Shih për këtë qëllim edhe vendimin Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese nr.61, datë 17.5.2013.

<sup>655</sup> Brati, Alban, "Procedura Civile", Botim i Parë, Shtëpia Botuese "Dudaj", Tiranë 2008, fq.219.

<sup>656</sup> Kushtetuta, neni 115.

<sup>657</sup> LGJK, neni 30.

<sup>658</sup> LGJK, neni 50.

<sup>659</sup> LGJK, neni 55.



rastin e zgjedhjes së deputetëve;<sup>660</sup> d) afati 1 muhor për të plotësuar të metat e kërkesës nga gjykata e zakonshme (kur kërkesa është paraqitur prej saj);<sup>661</sup> dh) afati 2 muhor për të kërkuar plotësimin e vendimit, ndreqjes së gabimeve në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në të.<sup>662</sup>

LGJK-ja pranon në një rast si afat procedural për subjektet kushtetuese edhe afatin e pacaktuar. Kështu shqyrtimi i kushtetutshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare duhet që të bëhet përpara ratifikimit të tyre nga Kuvendi.<sup>663</sup> Për rrjedhojë, subjektet për të kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese një marrëveshje ende të pa ratifikuar nga Kuvendi, kanë afat deri në momentin e ratifikimit të këtij akti në Kuvend, moment i cili nuk përcaktohet saktësisht në kohë por dihet që mund të ndodhë.

Me afat të pacaktuar janë edhe gjykimet për procedurat *impeachment* që parashikon Kushtetuta për një sërë funksionarësh të lartë dhe të zgjedhur, siç është rasti i procedurave të tilla kundër Presidenit të Republikës, deputetëve, gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Duke qenë se në këto raste vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese është e lidhur me procedurat që janë zhvilluar më parë në Kuvend atëherë është e kuptueshme që për këto lloje gjykimesh nuk janë përcaktuar afate procedurale, sepse në këto raste Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje automatikisht nga vendimi i Kuvendit dhe roli i saj në këtë procedurë është detyrues dhe i pazëvendësueshëm. Në këto raste është e kuptueshme që kjo procedurë mund të bëhet vetëm brenda mandatit të këtyre funksionarëve dhe jo mbasi mandati i tyre ka përfunduar dhe ato nuk janë më në detyrë.

Në disa lloje të tjera gjykimesh, LGJK-ja nuk përcakton afate, duke u dhënë mundësi subjekteve kushtetuese që ta vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese në çdo kohë. Referuar formulimeve që përmban LGJK-ja, në disa raste ky përjashtim është i shprehur qartë, kurse në disa raste të tjera del i nënkuptuar, për shkak se dispozitat ligjore përkatëse nuk parashikojnë asnjë afat. Kështu, vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese për të bërë interpretimin përfundimtar të Kushtetutës,<sup>664</sup> në rastin e gjykimit incidental me referim,<sup>665</sup> në rastin e kundërshtimit të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara përpara hyrjes në fuqi të Kushtetutës<sup>666</sup> dhe për të proceduar për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së partive dhe të organizatave të tjera politike,<sup>667</sup> nuk i nënshtrohen asnjë kufizimi nga pikëpamja e ndonjë afati procedural.

Ka rezultuar në disa raste, që ndonëse Kushtetuta, LGJK-ja apo ndonjë ligj tjetër nuk kanë caktuar asnjë afat procedural brenda së cilit palët mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, për një gjykim kushtetues të caktuar, vetë kjo gjykatë në jurisprudencën e saj ka zbatuar për analogji afate procedurale që u përkasin gjykimeve të tjera. Shembull tipik i këtij rasti është shtrirja me analogji e afatit 6 muhor, që dispozita ligjore e përmend vetëm për rastin e pazgjedhshmërisë së deputetëve, edhe për gjykimin kushtetues të verifikimit të zgjedhjes së deputetëve.<sup>668</sup>

<sup>660</sup> LGJK, neni 66, pika 3.

<sup>661</sup> LGJK, neni 69, pika 1.

<sup>662</sup> LGJK, neni 80 pika 1 gërma "b".

<sup>663</sup> Kushtetuta, neni 131, gërma "b" dhe LGJK, neni 52, pika 1.

<sup>664</sup> Kushtetuta, neni 124 dhe LGJK, neni 71.

<sup>665</sup> Kushtetuta, neni 145 dhe LGJK, neni 68, pika 1.

<sup>666</sup> Kushtetuta, neni 180 dhe LGJK, neni 53.

<sup>667</sup> LGJK, neni 57, pika 2.

<sup>668</sup> Vendimi nr.100, datë 20.12.2010 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimi nr.53, datë 7.5.2013 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, parag.24 dhe 25.

Për subjektet kushtetuese, ekzistojnë edhe afate të tjera për të cilat LGJK-ja nuk ka përcaktuar kufij kohorë, dhe vetë ligji e le në diskrecionin e Gjykatës Kushtetuese për t'i përcaktuar këto afate. I tillë është rasti kur gjykata konstaton të meta në kërkesë dhe në materialet e paraqitura nga subjektet kërkuese dhe për rrjedhojë u cakton atyre një afat për plotësimin e këtyre të metave.<sup>669</sup>

Një lloji tjetër i afateve janë afatet procedurale për Gjykatën Kushtetuese, të cilat Kushtetuta dhe ligji i ka vënë në ngarkim të saj, për rrjedhim ato ndiqen dhe respektohen nga ky institucion. Si afate të tilla përmendim : a) afatin 60 ditor për të shqyrtuar kërkesën për kushtetutshmërinë e çështjes së shtruar në referendum;<sup>670</sup> b) afatin 2 mujor për të filluar shqyrtimin e kërkesës;<sup>671</sup> c) afatin 1 mujor për shqyrtimin e kërkesës për pajtueshmërinë e marrëveshjes ndërkombëtare me Kushtetutën;<sup>672</sup>

Nga analiza e legjislacionit procedural ku mbështet veprimtaria e Gjykatës Kushtetuese, me përjashtim të një rasti, konstatohet se nuk kemi kufij kohorë brenda së cilës duhet të përfundojë gjykimi i çështjes dhe shpallja e vendimit përfundimtar. Kjo zgjedhje e legjislatorit bazohet në arsyetimin se një nxitim i paarsyeshëm i Gjykatës Kushtetuese, nënkupton nxjerrjen e një vendimi defektoz.<sup>673</sup> Për këtë arsye duhet të mbajmë në konsideratë faktin se fuqia e kësaj gjykate qëndron në forcën argumentuese të vendimeve të saj. E veçanta e një gjykimi kushtetues qëndron në efektet *erga omnes*, të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, të cilat kanë ndikimin e tyre kryesisht në zgjidhjen e konfliktit midis palëve në gjykim, se sa në vendosjen e standardeve kushtetuese për të ardhmen. Prandaj natyra që paraqet gjykimi kushtetues, e përlligj shqyrtimin e çështjes në afate më të gjata se gjykimi i zakonshëm, por jo deri në atë masë sa nëpërmjet shtyrjes së shpalljes së vendimeve, të dëmtohet imazhi i institucionit, që garanton Kushtetutën dhe realizon drejtësinë kushtetuese.<sup>674</sup>

Nëse analizojmë praktikën mbi 20 vjeçare të veprimtarisë së Gjykatës Kushtetuese konstatojmë se afati i përfundimit të një çështje pranë kësaj gjykate, ka shkuar nga njëri ekstrem në tjetrin. Kështu p.sh në një rast Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim brenda 24 orëve nga momenti i shqyrtimit të kërkesës, pra nga momenti i zhvillimit të seancës plenare,<sup>675</sup> ndërsa në një rast tjetër Gjykata Kushtetuese ka dhënë vendim mbas rreth 15 muajve nga momenti që ishte shqyrtuar çështja në seancë plenare.

Duke pasur në konsideratë rëndësinë për procesin kushtetues që paraqesin afatet procedurale, po kalojmë më tej në analizën e elementëve të disa prej afateve kryesore të përcaktuar për gjykimet kushtetuese.

### **1.2.1 Afati 2 vjeçar për kërkesat e individëve për proces të rregullt ligjor.**

Neni 30, pika 2 e LGJK parashikon se “kërkesat e individit për shkeljen e të drejtave kushtetuese paraqiten jo më vonë se 2 vjet nga konstatimi i shkeljes”. Kur në bazë të ligjit individit mund t'i drejtohet një organi tjetër, ai mund të paraqesë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Në

<sup>669</sup> LGJK, neni 31, pika 2.

<sup>670</sup> Kushtetuta, neni 152, pika 1.

<sup>671</sup> LGJK, neni 47.

<sup>672</sup> LGJK neni 52, pika 3.

<sup>673</sup> Sadushi, Sokol. “Drejtësia Kushtetuese në zhvillim”, Shtëpia Botuese “Toena”, Tiranë 2012, fq. 349.

<sup>674</sup> Po aty, fq.351.

<sup>675</sup> Vendimi nr.28, datë 21.02.2001 i Gjykatës Kushtetuese

këtë rast, afati i paraqitjes së kërkesës është 2 vjet nga data e njoftimit të vendimit të organit përkatës shtetëror (administrativ apo gjyqësor).

Vendosja e një afati është kusht i domosdoshëm në një shoqëri demokratike për shkak të sigurimit të qëndrueshmërisë së marrëdhënieve juridike. Afati dy vjeçar i vendosur nga ligjvënësi në vitin 2000, ndoshta ka pasur si qëllim që t'i lidhë efektet e këtij mjetei kushtetues me momentin e hyrjes në fuqi të Kushtetues, me qëllim që asnjë subjekt të mos përjashtohet nga shfrytëzimi i tij për shkak të kalimit të afatit. Pra, u pa si e nevojshme parashikimi i afatit 2 vjeçar, si një periudhë e mjaftueshme për ndërgjegjësimin e publikut lidhur me këtë mjet të veçantë juridik.<sup>676</sup> Ka vende të cilat këtë afat e kanë një mujor si në Kroaci,<sup>677</sup> 60 ditë në Slloveni<sup>678</sup> ndërkohë që sugjerimi i përgjithshëm është që ky afat nuk duhet të jetë më shumë se 6 muaj deri në 1 vit.<sup>679</sup>

Por, në fakt ky afat ka rezultuar tepër i gjatë dhe ka krijuar një lloj pasigurie, për shkak se një person do rrijë në gjendje pritjeje, deri edhe në dy vjet nga moment i shprehjes së shkallës së fundit të gjyqësorit mbi çështjen e tij. Për të pasur një ide më të qartë në lidhje me kalimin ose jo të afatit dy vjeçar në rastin e paraqitjes së kërkesave për shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, po i referohemi vetë praktikës së Gjykatës Kushtetuese, duke i ndarë sipas tematikave.

Në lidhje me kundërshtimin e vendimeve të natyrës civile të dhëna nga gjykatat e zakonshme, Gjykata Kushtetuese i ka konsideruar si jashtë afatit kërkesat të cilat dukshëm janë në tejkalim të këtij afati dhe ku palët kanë pasur dijeni në lidhje më të.<sup>680</sup>

Një dallim që jurisprudenca kushtetuese ka bërë gjithmonë lidhet me autonominë midis gjyqimit në themel të çështjes dhe gjyqimit të kërkesave për rishikimin e vendimeve të formës së prerë. Në këtë rast, nga palët është tentuar gjithmonë që për të kapur afatin për gjykimin kushtetues për një proces të rregullt ligjor, duke bërë një kërkesë për rishikim të vendimit të formës së prerë dhe kur rrëzohen nga Gjykata e Lartë, atëherë i drejtohen Gjykatës Kushtetuese duke kundërshtuar njëkohësisht përveç vendimit për rishikim edhe vendimet e themelit të çështjes. Gjykata Kushtetuese, sipas një jurisprudence të konsoliduar i ka konsideruar pretendimet në lidhje me themelin e çështjes si të paraqitur jashtë afatit dhe më pas ka shqyrtuar pretendimet në lidhje me vendimin në gjykimin e rishikimit që ka marrë Gjykata e Lartë.<sup>681</sup>

<sup>676</sup> Vorpsi, Arta, "Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë", botim i Fondacionit Konrad Adenaur, Shtëpia Botuese "Maluka", Tiranë 2011, fq.88.

<sup>677</sup> Momcinovic, Hrvoje, "Contesting the arbitration decision in the proceedings before the Constitutional Court according to the Croatian law", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të Demokracisë", botim i Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) Nr.15, ribotim 1998, fq.78.

<sup>678</sup> Mavcic, Arne, "The protection of fundamental rights by the Constitutional Court and the practice of the Constitutional Court of the Republic of Slovenia", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të Demokracisë", botim i Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) Nr.15, ribotim 1998, fq.217.

<sup>679</sup> Seibert, Helga, "Admissibility requirements for constitutional complaints and mechanisms for avoiding an excessive case load", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15", botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998, fq. 149.

<sup>680</sup> Vendimi nr.17, datë 3.3.2.2010 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese. Shih edhe vendimet nr.13, datë 22.2.2010, nr.143, datë 19.12.2012, nr.145, datë 16.12.2011, nr. 147 datë 19.12.2011 dhe nr. 45 datë, 02.07.2010 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>681</sup> Vendimi nr. 76, datë 15.06.2012 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese, parag.11. Shih dhe vendimet nr.22, datë 12.3.2009, nr.104, datë 24.12.2010, nr. 79 datë 4.7.2013 dhe nr.114 datë 26.10.2011 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.



Në të njëjtën linjë lidhen edhe ankimet që bëhen përse i përket kërkesave për rivendosje në afat. Shpeshherë kërkesat bëjnë kërkesa të veçanta për rivendosjen në afat të së drejtës së tyre për ankim apo rekurs. Në këtë rast nëse kërkesat e tyre rrëzohen atëherë ato i drejtohen Gjykatës Kushtetuese duke kundërshtuar si gjykimet që u zhvilluan në lidhje me kërkesën e tyre për rivendosje në afat, ashtu edhe kundër vendimeve të themelit. Edhe në këtë rast jurisprudenca kushtetuese ka mbajtur qëndrimin që pretendimet në lidhje me gjykimin e themelit janë në tejkalim të afatit 2 vjeçar dhe për rrjedhojë jashtë kontrollit kushtetues.<sup>682</sup>

Një tjetër situatë lidhet me faktin se cili do të quhej momenti i shterimit të mjeteve ankimore në rast se ka pasur për të njëjtën çështje dy gjykime, civile dhe penale. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin që nga pikëpamja formale këto janë dy gjykime autonome që nuk varen nga njëri – tjetri dhe për rrjedhojë afati dy vjeçar nuk është i lidhur në tërësi me këto dy procedime por është i veçantë për secilin gjykim.<sup>683</sup>

Po i njëjti qëndrim është mbajtur nga Gjykata Kushtetuese edhe në lidhje me kërkesat për ndreqje gabimi material. Kështu, sipas Gjykatës Kushtetuese, afati fillon nga momenti që është shteruar dhe mjeti i fundit ankimor në lidhje me themelin e çështjes. Në këtë rast nuk mundet që të konsiderohet si moment i fundit, vendimi për ndreqje gabimi material, që mund t'i bëjë gjykata e zakonshme vendimeve të saj, pasi këto lloje vendimesh nuk prekin themelin e çështjes dhe zgjidhjen që ka dhënë gjykata për mosmarrëveshjen.<sup>684</sup>

Për të kundërshtuar vendimet e gjykatave të arbitrazhit, afati ankimor fillon të ecë nga momenti që është shprehur edhe gjykata e apelit mbi bazën e ankimit të bërë sipas rregullave të përcaktuara nga K.Pr.C. Kundër vendimeve të njohjeve të gjykatave të huaja, apo të arbitrazheve ndërkombëtare afati ankimor fillon mbasi është shprehur edhe Gjykata e Lartë.

Në lidhje me çështjet penale, Gjykata Kushtetuese i ka konsideruar si jashtë afatit kërkesat e paraqitura tej periudhës 2 vjeçare, periudhë e cila fillon nga momenti që është shprehur Gjykata e Lartë, si shkalla e fundit e sistemit gjyqësor.<sup>685</sup> Në rastin kur çështja është gjykuar në dhomë këshillimi nga Gjykata e Lartë atëherë afati fillon të ecë nga momenti që Gjykata e Lartë ka publikuar shpalljen ku është përcaktuar edhe se për rekursin është vendosur mospranimi i tij.<sup>686</sup>

Përse i përket personave që janë gjykuar në mungesë Gjykata Kushtetuese e ka konsideruar se ato kanë pasur dijeni për procesin nëse në aktet e dosjes gjyqësore ka pasur prokura të lëshuar nga këta persona në emër të një apo disa përfaqësuesve.<sup>687</sup> Po kështu, Gjykata Kushtetuese ka hetuar edhe rrethanat e çështjes për të konkluduar nëse nga këto rrethana por edhe nga vetë sjellja e të pandehurit rezulton se ai ka pasur apo jo dijeni për akuzën dhe gjykimin në ngarkim të tij.<sup>688</sup> Për këta persona afati për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese ka filluar të ecë mbas dhënies së vendimit nga shkalla e fundit e gjyqësorit dhe jo nga momenti që ata janë ndaluar. Një tjetër rrethanë e cila nuk është konsideruar si justifikim nga Gjykata Kushtetuese

<sup>682</sup> Vendimi nr.99, datë 20.12.2010 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>683</sup> Vendimi nr.5, datë 18.1.2013 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>684</sup> Vendimi nr.10, datë 23.1.2012 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese, par.14.

<sup>685</sup> Vendimi nr.18, datë 5.3.2010 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese. Shih dhe vendimet nr.92, datë 30.10.2009, nr.98, datë 13.11.2009, nr.36, datë 23.4.2010, nr.42, datë 23.6.2010, nr.47, datë 2.7.2010, nr.91, datë 10.12.2010, nr.96, datë 17.12.2010, nr.42, datë 22.4.2011, nr.90, datë 22.7.2011, nr.94, datë 16.9.2011, nr.146, datë 19.12.2011, nr.3 datë 13.01.2012, nr.10, datë 21.1.2013 dhe nr.12, datë 25.01.2013; të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>686</sup> Vendimi nr.31, datë 23.4.2010 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>687</sup> Vendimi nr. 20 datë, 10.03.2011 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>688</sup> Vendimi nr.39, datë 26.7.2013 i Gjykatës Kushtetuese, par.18.



për mosmarrje dijëni ka qenë fakti që personi ka qenë duke vuajtur dënimin. Në këtë rast i takonte personit që të provonte se nuk kishte marrë dijëni për vendimin e Gjykatës së Lartë.<sup>689</sup>

Për personat të cilët kanë qenë dënuar nga gjykatat e zakonshme dhe gjykimi është zhvilluar në mungesë të tyre, por njëkohësisht është zhvilluar në të gjitha shkallët e gjykimin mbi bazën e ankimit të subjekteve të tjera (p.sh. ankim mund të jetë bërë nga prokurori, apo bashkë të pandehurit e tjerë), Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin se në këtë rast afati për t'iu drejtuar asaj fillon nga momenti që ky person është ndaluar nga autoritetet policore të cilat normalisht i njoftojnë edhe shkakun e ndalimit.<sup>690</sup> Në këtë rast ky subjekt nuk duhet të ndjekë rrugën e rivendosjes në afat të së drejtës për ankim, pasi tashmë gjykimi është zhvilluar në të gjitha shkallët dhe për rrjedhojë ai nuk ka asnjë shkallë tjetër gjyqësore ku të ankohet.<sup>691</sup>

Shpeshherë nga individët për të kapërcyer problemin e tejkalimit të afatit dy vjeçar është zgjedhur metoda e bërjes së kërkesave për rivendosje në afat. Në këtë rast duke bërë kërkesë për rivendosje në afat, dhe mbasi kanë ezauruar të gjitha shkallët janë ankuar në Gjykatën Kushtetuese duke ngritur pretendime si për gjykimin për rivendosjen në afat ashtu edhe për gjykimin në themel të çështjes. Edhe në këtë rast, Gjykata i ka konsideruar si jashtë afatit dy vjeçar pretendimet në lidhje me gjykimin e themelit,<sup>692</sup> duke mbajtur një qëndrim të konsoliduar sipas të cilit këto janë dy gjykime autonome në lidhje më njëri – tjetrin dhe për rrjedhojë nuk mundet që të konfondohen bashkërisht.<sup>693</sup>

Edhe në lidhje me kërkesat për shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në fushën penale, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur të njëjtin qëndrim se gjykimi i themelit që bëjnë gjykatat e zakonshme janë autonome në lidhje me kërkesat për rishikim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë në fushën penale. Për rrjedhojë në këtë rast afati 2 vjeçar është i veçantë për secilin prej këtyre gjykimeve.<sup>694</sup>

Duke qenë se nga jurisprudenca kushtetuese objekt ankimi janë konsideruar edhe vendimet e gjykatave të zakonshme që lidhen me masat e sigurisë, atëherë edhe ndaj këtyre vendimeve vepron afati ankimor 2 vjeçar i parashikuar nga LGJK. Pra, edhe në këtë rast mbas ezaurimit të shkallës së fundit të gjyqësorit, subjekti kërkues duhet që të paraqesë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese brenda dy vjetëve.<sup>695</sup>

Në lidhje me çështjet gjyqësore administrative ende praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese nuk është zhvilluar pasi edhe vetë gjykatat administrative kanë filluar funksionimin e tyre me datë 4.11.2013. Kjo shpjegon edhe arsyen përse deri më sot nuk kemi shembuj nga praktika kushtetuese. Megjithatë duke u bazuar në rregullimet e LGJA dhe në precedentët e mësipërm mund të shprehemi që afati ankimor për t'u ankuar kundër vendimeve të dhëna nga gjykatat që kanë si kompetencë lëndore gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, është po i njëjtë. Edhe në këtë rast afati fillon të ecë nga momenti që është ezauruar shkalla e fundit

<sup>689</sup> Vendimi nr.80, datë 3.7.2012 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, paragraf 9.

<sup>690</sup> Vendimi nr.40, datë 28.3.2012 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Shih edhe vendimin nr.60, datë 16.5.2012 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>691</sup> Vendimi nr.57, datë 17.5.2013 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese, paragraf 11-13. Shih dhe vendimet nr.11, datë 23.1.2012, nr.118, datë 30.10.2012, nr.140 datë 19.12.2012, nr.83, datë 5.7.2013 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>692</sup> Vendimi nr. 54, datë 23.12.2013 i Gjykatës Kushtetuese, paragraf 11 dhe 17.

<sup>693</sup> Vendimi nr.33, datë 1.4.2011 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese. Shih edhe vendimet nr.42, datë 22.4.2011, nr.115, datë 26.10.2011 dhe nr.135 datë 25.11.2011 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>694</sup> Vendimi nr.28, datë 26.3.2009 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese. Shih edhe vendimet nr.60, datë 3.7.2009, nr.46, datë 2.7.2010, nr.65, datë 1.10.2010, nr.139, datë 25.11.2011, nr. 148, datë 19.12.2011, nr.72, datë 15.6.2012 dhe nr.88 datë 13.7.2012 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>695</sup> Vendimi nr.24, datë 11.3.2011 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

gjqësore. Por, referuar parashikimeve të LGJA mbi kufizimin e së drejtës për të bërë ankim apo rekurs, rezulton se afati ankimor fillon të ecë nga momenti që është shprehur gjykata kompetente. Kështu nëse kundër vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë nuk lejohet ankim, afati fillon të ecë nga momenti që palët kanë marrë dijëni për këtë vendim. Në rast se lejohet ankim por jo rekurs, atëherë afati fillon të ecë nga momenti që palët kanë marrë dijëni për vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit. Ndërsa për rastet e tjera kur lejohet edhe rekursi atëherë duhet ezauruar edhe ky mjet ankimor për në Gjykatën e Lartë.

Përsa i përket kërkesave mbi bazën e së cilës pretendohet cënimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i zhvillimit të një gjykimi, tej një afati të arsyeshëm, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin se një kërkesa e tillë mund të paraqitet në çdo kohë për aq kohë sa vazhdon gjykimi. Por nëse ky gjykim ka përfunduar në të gjitha shkallët e gjykimit, atëherë, për këtë pretendim subjekti duhet që të ankohet brenda afatit 2 vjeçar, nga momenti që është shprehur instanca e fundit.<sup>696</sup>

Afati 2 vjeçar nuk zbatohet në lidhje me kërkesat për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.<sup>697</sup> I njëjti parim ndiqet edhe kundërshtimit të vendimeve administrative që kanë marrë "formë të prerë".<sup>698</sup> Ky konkluzion është rrjedhojë llogjike e këtij procesi. Mosekzekutimi i vendime të formës së prerë është një shkelje e vazhdueshme në kohë dhe për rrjedhojë afati 2 vjeçar në këtë rast nuk mundet që të ecë.

Kundër vendimeve administrative për të cilat ligji parashikon se nuk mundet që të bëhet një ankim në gjykatat e zakonshme, afati fillon të ecë nga momenti që është shprehur organi administrativ me vendim përfundimtar apo në rast se parashikohet një organ ankimor administrativ kur është shprehur ky i fundit.

### **1.2.2 Afati 3 vjeçar për kundërshtimin e ligjeve dhe akteve normative nënligjore.**

Neni 50 i LGJK përcakton një afat 3 vjeçar në favor të subjekteve kushtetuese për të kërkuar kontrollin abstrakt të normave ligjore dhe nënligjore me karakter normativ. Ky është një afat shumë i gjatë dhe një shembull të ngjashëm gjejmë vetëm në Sllovaki.<sup>699</sup> Ky afat vlen për Presidentin, Kryeministrin, jo më pak se një të pestën e deputetëve, Kryetarin e KLSH, Avokatin e Popullit, organet e njësive të qeverisjes vendore, organet e komuniteteve fetare, partitë politike dhe organizatat e tjera. Për gjykatat, LGJK në nenin 68 të tij përcakton se kërkesa prej tyre mund të bëhet në çdo kohë, pra nuk ka afat.

Në lidhje me afatin tre vjeçar është e rëndësishme që të përcaktojmë momentin e fillimit të këtij afati. Sipas Kushtetutës rezulton se ligji, si rregull, mund të hyjë në fuqi me kalimin e jo më pak se 15 ditëve nga botimi i tij në Fletoren Zyrtare.<sup>700</sup> Pavarësisht këtij rregulli praktika ligjore ka treguar që për ligje të cilat bëjnë një reformë apo ndryshim të rëndësishëm, Kuvendi ka parashikuar hyrjen e tyre në një kohë shumë më të vonshme. Kështu si shembull mund të marrim Kodin e Familjes, ku sipas nenit 319 të tij, rezultonte se hynte në fuqi gjashtë muaj mbas botimit në Fletoren Zyrtare. Po kështu ligji nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", në nenin 189 të tij, përcakton hyrjen në fuqi 1 vit mbas botimit në Fletoren Zyrtare.

<sup>696</sup> Vendimi nr.120, datë 27.10.2011 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>697</sup> Vendimi nr.12, datë 16.4.2013 i Gjykatës Kushtetuese, parag.25.

<sup>698</sup> Vendimi nr.105, datë 24.12.2010 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>699</sup> Schwartz, Herman, "The struggle for constitutional justice in post-communist Europe", Shtëpia Botuese "The University of Chicago Press", Chicago 2000, fq.196.

<sup>700</sup> Kushtetuta, neni 84, pika 3.

Në këtë aspekt me të drejtë mund të lindë diskutimi se në cilin moment fillon të ecë afati 3 vjeçar. Si rregull, ligji mund të bëhet i kundërshtueshëm pasi ai ka hyrë në fuqi. Kjo situatë nuk paraqet asnjë problematikë nëse jemi përpara rregullit sipas të cilit ligji hyn në fuqi 15 ditë mbas botimit në Fletoren Zyrtare. Por situata shfaqet më problematike në rast se vetë ligji parashikon një afat më të gjatë për hyrjen e tij në fuqi. Personalisht jam i mendimit që ligji mund të bëhet i kundërshtueshëm nga subjektet kërkuese mbas botimit të tij në Fletoren Zyrtare. Botimi i ligjit në Fletoren Zyrtare prezumon marrjen dijani nga subjektet e ndryshme për hyrjen e tij në fuqi. Për rrjedhojë, subjektet që kanë pretendime për antikushtetutshmërinë e tij nuk kanë përse të kushtëzohen nga hyrja e tij në fuqi, në mënyrë që ta kundërshtojnë atë. Kjo mënyrë veprimi paraqet një avantazh pasi mundëson kundërshtimin e ligjit pa sjellë ende pasojat antikushtetuese. Ky lloj kontrolli njihet edhe nga jurisprudenca e huaj por duket sikur është pranuar edhe nga Gjykata jonë Kushtetuese. Kështu në jurisprudencën e saj rezulton që një ligj<sup>701</sup> është kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese, përpara hyrjes së tij në fuqi.<sup>702</sup> Në fillim nga subjektet e interesuara u paraqit pretendimi se kërkesa ishte paraqitur në mënyrë të parakohshme, pra përpara se ligji të hynte në fuqi, por duke qenë se më pas u hoq dorë prej tij, atëherë Gjykata vendosi që të mos mbajë një qëndrim të shprehur.<sup>703</sup>

Mesa duket, vetë Gjykata nuk donte që të mbante një qëndrim mbi këtë çështje të diskutueshme por duke qenë se çështja e afatit mund të konstatohej edhe kryesisht nga vetë ajo, si edhe fakti tjetër që Gjykata pranoi ta marrë në shqyrtim ligjin, rezulton se kërkesat kundër një ligji mund të bëhen që nga momenti i botimit në Fletoren Zyrtare. Për rrjedhojë atëherë mund të themi se afati 3 vjeçar fillon të ecë, që nga momenti i botimit të ligjit në Fletoren Zyrtare.

Një tjetër situatë që vlen të diskutohet lidhet me ndryshimin që mund t'i bëhen dispozitave ligjore. Normalisht afati për të kundërshtuar një dispozitë të ndryshuar, fillon nga momenti që ajo është ndryshuar. Por një situatë më e ndërlikuar paraqitet në rast se dispozita nuk ndryshohet tërësisht por pjesërisht në përmbajtjen e saj. Në këtë rast nëse antikushtetutshmëria e pretenduar buron nga ajo e pjesë e dispozitës e cila nuk është prekur nga ndryshimet atëherë mund të themi se afati 3 vjeçar ka filluar me herët se sa koha kur janë bërë ndryshimet me ligjin e ri. Një qëndrim i tillë është mbajtur edhe nga jurisprudenca kushtetuese.<sup>704</sup>

<sup>701</sup> Ligji nr. 108, datë 31.07.2014 "Për Policinë e Shtetit".

<sup>702</sup> Sipas nenit 145, ky ligj hyn në fuqi 6 muaj mbas botimit në Fletoren Zyrtare.

<sup>703</sup> Vendimi nr.43, datë 26.6.2015 i Gjykatës Kushtetuese, paragraf 9: *Gjykata, paraprakisht konstaton se në prapësimet me shkrim, subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka pretenduar mungesën e juridiksionit të Gjykatës pasi ligji i kundërshtuar në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk kishte hyrë ende në fuqi. Gjatë seancës gjyqësore, duke qenë se ndërkohë ligji hyri në fuqi, Këshilli i Ministrave hoqi dorë nga ky pretendim. Për pasojë, në vijim, Gjykata do t'u japë përgjigje pretendimeve të palëve mbi themelin e kërkesës.*

<sup>704</sup> Vendimi nr.3, datë 3.2.2012 i Gjykatës Kushtetuese: *Gjykata, në këtë aspekt, bazuar në datën e regjistrimit të kërkesës vlerëson se kompetenca e Gjykatës pengohet "ratione temporis" për të shqyrtuar çështjen e pajtueshmërisë me Kushtetutën të përmbajtjes së normës ligjore të parashikuar në shkronjën "d" të nenit 4 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 "Për dëshmipërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist" me Kushtetutën.*

*Gjykata, bazuar në sa më sipër, pa ju futur themelin të pretendimeve të parashtruara në kërkesë, konstaton se këto pretendime i referohen kriterit të vendosur në shkronjën "d" të nenit 4 të ligjit bazë nr.9831, datë 12.11.2007, "Për dëshmipërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist", dhe jo periudhës kohore, 30.11.1944 deri më 1.10.1991, brenda së cilës do të duhet të veprojë kriteri i dëshmipërblimit, periudhë e përcaktuar nëpërmjet ndryshimeve që shkronja "d" e nenit 4 të ligjit bazë ka pësuar me nenin 3 të ligjit nr. 10111, datë 2.4.2009. Gjithashtu, edhe gjatë gjykimit në seancë plenare përpara Gjykatës Kushtetuese, kërkuiesit ju përmbajtjen të njëjtave pretendime të parashtruara në kërkesë, duke mos ngritur asnjë pretendim në lidhje me këtë periudhë kohore. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkesa nuk mund të merret në shqyrtim, për shkak se është paraqitur tej afatit ligjor.*



Kushtetuta parashikon edhe një tjetër situatë të hyrjes në fuqi të ligjeve dhe më konkretisht në rastet e masave të jashtëzakonshme, si dhe në rast nevoje e urgjence, kur Kuvendi vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve dhe Presidenti i Republikës jep pëlqimin, ligji hyn në fuqi menjëherë, vetëm pasi të jetë njoftuar publikisht. Ligji duhet të botohet në numrin më të parë të Fletores Zyrtare.<sup>705</sup> Në këtë rast është e kuptueshme që afati fillon të ecë në momentin që Presidenti ka dhënë pëlqimin për hyrjen menjëherë në fuqi të ligjit.

Në lidhje me përllogaritjen e afatit, duke qenë se vetë LGJK nuk parashikon procedura për këtë proces, atëherë, bazuar në parashikimet ligjore dhe në jurisprudencën kushtetuese,<sup>706</sup> duhet që t'i referohemi dispozitave përkatëse në K.Pr.C. Për rrjedhojë rezultojnë se sipas nenit 148 të K.Pr.C. në përllogaritjen e afatit nuk do të llogaritet dita në të cilin ligji apo akti nënligjor është botuar në Fletoren Zyrtare, pra ky afat do të fillojë nga e nesërmeja. Duke qenë se në këtë rast afati është i përcaktuar në vite, atëherë afati përfundon në të njëjtën ditë, në të njëjtin muaj të vitit të tretë. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji. Kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit.

### 1.2.3 Afati 6 mujor për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave.

Marrëdhëniet juridike në mënyrë që të jenë sa më të efektshme duhet që të karakterizohen nga qëndrueshmëria dhe siguria. Nga ky parim nuk bëjnë përjashtim edhe marrëdhëniet juridike kushtetuese. Për këtë arsye ligji organik i gjykatës parashikon shprehimisht në nenin 55 të tij, se afati për të iniciuar një proces për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave është vetëm gjashtë muaj. Megjithatë zgjidhja që ofrohet në këto raste është e ndryshme në vende të ndryshme, si për shembull në Slloveni është 90 ditë,<sup>707</sup> ndërsa në Itali<sup>708</sup> dhe Korenë e Jugut<sup>709</sup> është 60 ditë. Nga kjo rezultojnë se afati në përgjithësi është një afat i shkurtër në raport me gjykimet e tjera. Madje duke pasur në konsideratë edhe rëndësinë e këtij gjykimi ka edhe legjislacione që kanë parashikuar edhe afate për përfundimin e tij.<sup>710</sup>

Këto afate në përgjithësi të shkurtra kërkojnë detyrimisht që palët të jenë aktive në mbrojtjen e sferës së kompetencave të tyre. Ky lloj afati është i veçantë dhe qëndron i pavaruar në lidhje me afatin 3 vjeçar të parashikuar nga neni 50 i LGJK. Për rrjedhojë edhe nëse mosmarrëveshja buron nga një akt ligjor apo nënligjor normativ dhe afati 3 vjeçar ka kaluar, përsëri mund të iniciohet një proces i tillë nëse një organ në bazë të këtyre akteve ka cenuar kompetencat e një organi tjetër. Kuptohet që ky cënim duhet të ketë ndodhur brenda afatit 6

<sup>705</sup> Kushtetuta, neni 84, pika 4.

<sup>706</sup> Vendimi nr.25, datë 5.12.2008 i Gjykatës Kushtetuese: *Në nenin 50 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", parashikohet se kërkesat për shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, mund të paraqiten brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e tyre". Në nenin 1, paragrafi 2, të ligjit është sanksionuar rregullisht se "për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj, Gjykata Kushtetuese merr parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes". Në këtë kontekst, neni 149 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se "afati nuk quhet i humbur, kur kërkesa ose akti është dërguar me postë edhe në ditën e fundit të afatit".*

<sup>707</sup> Pistan, Carna, "Le esperienze di Croazia, Slovenia, Polonia e Ungheria", botuar në "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova 2009, fq.438.

<sup>708</sup> Teresi, Francesco, "I giudizi della Corte Costituzionale", Shtëpia Botuese "Cacucci Editore", Bari 2010, fq.195.

<sup>709</sup> Fanotto, Luca "La giustizia costituzionale negli ordinamenti asiatici", botuar në "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova 2009, fq.751.

<sup>710</sup> Po aty, fq.751. Sipas Aktit Kushtetues të Koresë së Jugut kjo çështje duhet që të përfundojë brenda 180 ditëve.



mujor që parashikon ligji. Me kalimin e këtij afati, organi i cënuar nuk mundet që t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, pasi mosmarrëveshja në këtë rast konsiderohet e "shëruar". Në këto konkluzione ka arritur edhe Gjykata Kushtetuese e cila në një vendim të saj, është shprehur se:

*Është i pathemeltë pretendimi i subjektit të interesuar për ta konsideruar çështjen e ngritur nga kërkuesi si të parashkruar duke paraqitur si argument periudhën kohore që ndan lindjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet pushtetit qendror e qeverisjes vendore dhe kohës së hyrjes në fuqi të ligjit burim konflikti. Afati trevjeçar i parashkrimit për të kërkuar kontrollin kushtetues të një ligji, që parashikohet në nenin 50 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të RSH", zbatohet në rastet kur subjektet përkatëse kanë kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit në kuptimin abstrakt. Çështja ndryshon kur dy organe kanë mosmarrëveshje për një kompetencë konkrete, e cila mund të lindë në çdo kohë. Me fjalë të tjera, nëse mosmarrëveshja e kompetencës buron nga ligji, kjo nuk do të thotë se vepron në mënyrë të vetvetishme parashkrimi trevjeçar. Në mosmarrëveshjen me palë kundërshtarë që pretendojnë të njëjtën kompetencë nuk mund të ketë parashkrim në raport me ligjin. Në të kundërt, do të pranohej se shteti është i pafuqishëm të zgjidhë konfliktet e brendshme dhe se ai nuk ka asnjë mundësi të shpëtojë nga funksionimi antikushtetues i tij. Ky lloj qëndrimi brenda shtetit, për shkak të kalimit të afatit, nuk mund të gjejë mbështetje kushtetuese. Arsyeja është sepse veprimtaria shtetërore nuk mund të lihet të devijojë në mënyrë antikushtetuese. Përndryshe, do të ndodheshim para situatave kur mosmarrëveshja e lindur për shkak të ligjit de jure do të parashkruhej brenda tre vjetëve nga miratimi i tij, ndërkohë që mosmarrëveshja e lindur de facto jo.*

*Pikërisht për këtë arsye, në ligjin nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", procedurat që parashikojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës janë formuluar ndryshe nga procedurat e kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve. Afati gjashtëmujor që parashikon neni 55 i këtij ligji lidhet me çastin e lindjes së konfliktit dhe jo me kohën e hyrjes në fuqi të ligjit burim konflikti. Prandaj, argumenti i subjektit të interesuar nuk mund të përbëjë kurrësesi zgjidhje kushtetuese të çështjes.<sup>711</sup>*

Në këtë pikë shfaq interes sqarimi i kuptimit të togfjalëshit nga çasti i lindjes së konfliktit, që përdoret në nenin 55 LGJK. Me fjalë të tjera, merr rëndësi sqarimi i faktit se nga cili moment fillon të ecë afati 6 mujor.

Personalisht mendoj se ky afat fillon të ecë në momentin që një organ ka ndërhyrë në sferën e kompetencave të një organi tjetër, por kjo ndërhyrje është e kufizuar dhe nuk përsëritet më në kohë. Atëherë momenti i fillimit të afatit është shkelja/cënimi i kryer. Por, nëse cënimi është i vazhdueshëm, pra, nuk ndërpritet në kohë, atëherë nuk mundet që të pretendojmë se ka filluar të ecë afati 6 mujor, për shkak se kjo ndërhyrje ende nuk ka përfunduar.

Në interpretim të drejtë të nenit 55 të LGJK, mendoj se afati 6 mujor duhet të fillojë të ecë nga momenti i përfundimit/pushimit të cënimit. Kjo për faktin se cënimi mund të shtrihet gjatë në kohë dhe për rrjedhojë mosmarrëveshja mbetet gjithmonë aktuale. Pra, çasti i lindjes së konfliktit duhet të konsiderohet momenti i përfundimit/pushimit të cënimit të sferës së kompetencave të organit të cënuar. Ky moment nuk e pengon organin e cënuar që të kërkojë

<sup>711</sup> Vendimi nr.29, datë 21.12.2006 i Gjykatës Kushtetuese

gjyqësisht zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave, gjatë kohës që shkelja/cënimi vazhdon, pa pritur përfundimin/pushimin e tij.

#### **1.2.4 Kontrolli i zgjedhshmërisë së deputetëve.**

Afati për këtë lloj gjykimi referuar pikës 3 të nenit 66 të LGJK është gjashtë muaj dhe ky afat fillon nga momenti i konstatimit të faktit të pazgjedhshmërisë. I takon subjektit kërkuar, që të provojë me provat përkatëse momentin e marrjes së tij dijeni për këtë fakt. Duke qenë se në këtë rast kemi të bëjmë me një afat prekluziv për t'iu drejtuar Gjykatës, atëherë, konkludojmë se rasti i pavlefshmërisë së mandatit që parashikon neni 69, pika 2 e Kushtetutës, është një pavlefshmëri relative.

#### **1.2.5 Afati i pacaktuar për të kontrolluar papajtueshmërinë e ushtrimit të funksioneve të deputetëve.**

LGJK përcakton për këtë lloj gjykimi se kërkesa për papajtueshmëri mund të paraqitet në Gjykatën Kushtetuese nga Kuvendi, përsa kohë vazhdon mandati i deputetit.<sup>712</sup> Pra, në këtë rast kërkesa mund të paraqitet vetëm brenda mandatit të Kuvendit. Kuvendi vetë nuk mund të shprehet për këtë kërkesë për legjislaturat e shkuara, pasi me mbarimin e mandatit edhe kërkesa humbet aktualitetin e saj. Nëse i njëjti deputet zgjidhet në legjislaturën e re atëherë ai mund të procedohet për shkeljen që mund të kryejë gjatë kësaj legjislature dhe jo për shkeljen që ka kryer më parë.

#### **1.2.6 Afati për verifikimin e zgjedhjes së deputetëve.**

Në lidhje me këtë afat, LGJK nuk ka asnjë parashikim. Në rastin e vetëm që cituam më sipër kërkuar, pretendoi se afati që duhet të llogaritet në këtë rast ishte afati 6 muajor, i parashikuar nga neni 66 pika 3 e LGJK. Në pjesën e saj arsyetuese Kolegji i Gjykatës Kushtetuese i jep përgjigje këtij pretendimi duke arsyetuar se ky afat ka kaluar. Pavarësisht qëndrimit që ka mbajtur kolegji në këtë rast mendojmë se afati 6 muajor që parashikon neni 66, pika 3 e LGJK, nuk ka të bëjë me këtë lloj gjykimi. Konkretisht dispozita parashikon se “kërkesa për shqyrtimin e zgjedhshmërisë së deputetëve mund të paraqitet brenda 6 muajve nga konstatimi i faktit të pazgjedhshmërisë”.

Nga një analizë e kujdesshme e kësaj norme vërejmë se ky afat ka të bëjë me një tjetër lloj gjykimi kushtetues dhe konkretisht me atë të analizuar më sipër për “zgjedhshmërinë e deputetëve”. Fakti që ky lloj afati nuk ka të bëjë me gjykimin për verifikimin e zgjedhjes së deputetëve, përforcohet edhe nga togfjalëshi i fundit “nga konstatimi i faktit të pazgjedhshmërisë”. Përdorimi i termit pazgjedhshmëri që parashikon dispozita tregon pikërisht se në këtë rast kemi të bëjmë me rastet e parashikuara nga neni 69 i Kushtetutës. Nëse i referohemi pikërisht kësaj dispozite rezulton se pika e parë e saj fillon me togfjalëshin “nuk mund të kandidojnë e as të zgjidhen deputetë, pa hequr dorë nga detyra”. Në këtë drejtim mund të themi se terminologjia e përdorur nga të dyja dispozitat është e njëjtë dhe për rrjedhojë afati 6 muajor që parashikon nenin 66, pika 3 e LGJK ka të bëjë ekskluzivisht me gjykimin kushtetues të kontrollit të zgjedhshmërisë së deputetëve dhe jo me gjykimin kushtetues të verifikimit të zgjedhjes së deputetëve.

<sup>712</sup> LGJK, neni 66, pika 3.

Një tjetër arsye se përse afati 6 mujor nuk ka lidhje me këtë lloj gjykimi kushtetues lidhet edhe me qëndrueshmërinë e mandatit parlamentar. Jam i mendimit që kontrolli i verifikimit të zgjedhjes së deputetëve duhet bërë para konstituimit të Kuvendit, të dalë nga zgjedhjet. Çdo kontroll i mëpasshëm do të sillte cënim të stabilitetit të institucioneve dhe do ta linte gjithmonë në dyshim kohëzgjatjen normale të mandatit parlamentar, nëse një subjekt i caktuar do ta kundërshtonte në çdo kohë zgjedhjen e deputetëve, mjafton që të argumentojë momentin e marrjes dijeni. Pra është e kuptueshme që një arsyetim i tillë nuk mundet që të qëndrojë.

Fakti që ligji nuk parashikon asnjë afat për këtë lloj gjykimi, nuk duhet të konsiderohet si ometim i legjislatorit. Dispozita konkrete në fakt parashikon se “Gjykata Kushtetuese verifikon zgjedhjen e deputetëve...duke zbatuar në këtë rast edhe dispozitat ligjore për zgjedhjet e përgjithshme”. Nga pasazhi i fundit kuptojmë se qëllimi i legjislatorit ka qenë që situatën ta rregullojë më konkretisht në ligjin për zgjedhjet. Megjithëse Kodi Zgjedhor aktual nuk parashikon asnjë afat sepse nuk e parashikon Gjykatën Kushtetuese si shkallë ankimore, mendoj se në këtë rast duhet përdorur me analogji afati 5 ditor i parashikuar nga neni 152 i Kodit Zgjedhor. Pavarësisht se ky afat ka të bëjë më ankimin kundër vendimeve të KQZ, mendojmë se në këtë rast, me analogji, do të jetë i njëjti afat që duhet aplikuar.

### **1.2.7 Afati 60 ditor për shqyrtimin e kërkesave për mbajtjen e një referendumit.**

Kuadri ligjor në fuqi për referendumet nuk parashikon ndonjë afat për venien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese e cila pranon nga institucionet përkatëse kërkesat për mbajtjen e një referendumit të caktuar. Për rrjedhojë nxirret konkluzioni se aktet nga institucionet përkatëse duhet që të dërgohen menjëherë në Gjykatën Kushtetuese, pas marrjes së vendimit për plotësimin e kërkesave për mbajtjen e një referendumit.

Megjithatë, Kushtetuta ka përcaktuar një afat të qartë brenda së cilës Gjykata Kushtetuese duhet që të shprehet për kushtetutshmërinë e mbajtjes së referendumit, afat i cili është 60 ditë. Ky detyrim kushtetues, siç duket, është vlerësuar i domosdoshëm për t’u parashikuar në Kushtetutë për shkak të precedentit të krijuar nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.3, datë 23.2.1995, për kushtetutshmërinë e organizimit të referendumit të Projektkushtetutës së 6 nentorit 1994. Ky vendim që rrëzoi kërkesën për papajtueshmërinë e ligjit “Për referendumet” dhe vendimit të Kuvendit Popullor “Për miratimin e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë me referendum”, u shpall nga Gjykata Kushtetuese pas afro 4 muajsh nga dita që populli nëpërmjet referendumit të organizuar e kishte rrëzuar projektkushtetutën.<sup>713</sup> Pasoja që vjen në këtë rast për moszbatim të këtij afati është fakti se vendimi i Gjykatës, nuk është më detyrues për mbajtjen apo jo të referendumit.<sup>714</sup>

### **1.2.8 Afati 15 ditor për kundërshtimin e vendimit të Këshillit të Ministrave për shkarkimin apo shpërndarjen e organeve vendore të zgjedhura drejtpërsëdrejti.**

Në ndryshim nga afatet e tjera procedurale të parashikuara nga LGJK-ja, në rastin e këtij gjykimi, afati procedural është parashikuar nga vetë Kushtetuta dhe është 15 ditë. Ky afat fillon të ecë jo ditën që merret vendimi nga Këshilli i Ministrave, por ditën që ai i komunikohet njërive

<sup>713</sup> Sadushi, Sokol, “Drejtësia Kushtetuese në Zhvillim”, Shtëpia Botuese “TOENA”, Tiranë 2012, fq. 184.

<sup>714</sup> Neni 152, pika 3 e Kushtetutës.

vendore dhe respektivisht këshillit bashkiak/komunal në rast se është shkarkuar kryetari i bashkisë/komunës dhe anasjelltas.<sup>715</sup>

Fillimi i ecjes së këtij afati në këtë mënyrë lidhet me natyrën që ka vendimi i Këshillit të Ministrave, natyrë e cila në këtë rast për shkak të marrëdhënies konkrete që rregullon dhe subjektit të përcaktuar të cili i drejtohet, bën që akti të jetë një akt administrativ me karakter individual. Referuar në këtë rast parashikimeve të K.Pr.A. rezulton vendimi për të proceduar me ekzekutimin e aktit administrativ i njoftohet palëve të cilave i'u drejtohet akti origjinal, përpara se të fillojë ekzekutimi.<sup>716</sup> Afati 15 ditor në këtë rast ka si synim njohjen nga ana e organit subjektit të cilit i drejtohet me arsyet e shpërndarjes apo të shkarkimit dhe përgatitjen e mbrojtjes nga ana e tij.

Në këtë drejtim kërkuesi paraqitet në një pozicion më të lehtë pasi atij i mjafton që të provojë momentin e regjistrimit të vendimit të Këshillit të Ministrave pranë njësisë vendore. Megjithatë edhe në raste kur ai provon marrjen dijani me mjete të tjera dhe e ushtron ankimin brenda afatit 15 ditor nga marrja dijani përsëri Gjykata e ka konsideruar të mjaftueshëm për ta marrë parasysh kërkesën brenda afatit kushtetues. Kështu në një rast të shfaqur në praktikë u konsiderua si moment i marrjes dijani publikimi i vendimit të Këshillit të Ministrave në Fletoren Zyrtare pavarësisht se ky vendim ende nuk ishte protokolluar në njësinë vendore.<sup>717</sup>

Në të gjitha rastet i takon Këshillit të Ministrave që të provojë të kundërtën, pra datën e marrjes dijani efektivisht nga organi që i drejtohet vendimi i Këshillit të Ministrave. E rëndësishme është që të theksohet se publikimi i vendimit të Këshillit të Ministrave në faqen zyrtare të internetit nuk konsiderohet si njoftim dhe për rrjedhojë marrje dijani.

Referuar parashikimeve të K.Pr.A.<sup>718</sup> dhe K.Pr.C.<sup>719</sup> rezulton se dita në të cilin vendimi i Këshillit të Ministrave është regjistruar në njësinë vendore që i drejtohet nuk do të llogaritet si moment i fillimit të ecjes së afatit ankimor. Përkundrazi ky afat do të fillojë ditën e nesërme. Në rast se dita e fundit e afatit ankimor bie ditë pushimi, atëherë afati do të quhet i përfunduar ditën e punës që bie pas asaj të pushimit. Duke qenë se ky afat ankimor i parashikuar nga Kushtetuta është një afat procedural që ka të bëjë me të drejtën e ankimit në gjykatë, atëherë në këtë drejtim nuk gjen zbatim parashikimi i shkronjës "b" të nenit 62 të K.Pr.A. për pezullimin e afatit ankimor të shtunave, të dielave dhe ditëve të festave zyrtare. Ky moment ka të bëjë me ditë të cilat janë brenda afatit 15 ditor ankimor dhe jo ditë e fundit e këtij afati.

<sup>715</sup> Vendimi nr.15, datë 03.05.2011 i Gjykatës Kushtetuese: *Gjykata është shprehur në jurisprudencë të vazhdueshme se si datë e fillimit të afateve të ankimit ndaj aktit individual që cënon të drejtat e personit objekt i këtij akti do të konsiderohet data e marrjes dijani nga personi për ekzistencën e aktit, pavarësisht formave të tjera të publikimit Për këtë arsye, si datë e marrjes dijani do të llogaritet data e mbërritjes së vendimit të shkarkimit pranë Këshillit të Komunës Kolsh, pra 10.8.2010. Duke iu referuar kësaj date rezulton se kërkuesi ka respektuar afatin 15 ditor të ankimit para kësaj Gjykate dhe për këtë arsye kërkesa e tij është pranuar për gjykim. Shih edhe vendimet nr.39, datë 29.12.2005, nr.30, datë 28.12.2006, nr.22, datë 7.10.2008, nr.15, datë 8.6.2009; nr.29, datë 26.7.2013 dhe nr.32, datë 10.7.2013 të Gjykatës Kushtetuese.*

<sup>716</sup> Neni 133, pika 1 e K.Pr.A.

<sup>717</sup> Vendimi nr.37, datë 25.07.2013 i Gjykatës Kushtetuese, paragraf 16 dhe 18: *Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur në gjykim, rezulton se vendimi i Këshillit të Ministrave nr.159, datë 27.02.2013 "Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Dardhas, Pogradec" është botuar nga Qendra e Botimeve Zyrtare, në Fletoren Zyrtare të datës 18.03.2013. Në çështjen në shqyrtim, në rrethanat kur nuk provohet se kërkuesi mund të jetë vënë në dijeni më parë, si datë e marrjes dijani për vendimin e shkarkimit do të llogaritet data 18.03.2013, e botimit në Fletoren Zyrtare, datë së cilës i referohet dhe kërkuesi. Duke qenë se kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 01.04.2013, rezulton se kërkuesi ka respektuar afatin 15-ditor të ankimit e, për rrjedhojë, legjitimohet racione temporis.*

<sup>718</sup> K.Pr. A. neni 62.

<sup>719</sup> K.Pr.C. neni 148.



### **1.2.9 Afati i pacaktuar për kontrollin *apriori* të marrëveshjeve ndërkombëtare.**

Nëse analizojmë LGJK në pamje të parë duket sikur nuk parashikohet asnjë afat për këtë lloj gjykimi. Megjithatë siç e përmendëm më sipër, bazuar në një analizë të kujdesshme, rezulton se ndodhemi përpara një afati të papërcaktuar. Ky afat fillon në momentin që kemi një tekst përfundimtar të marrëveshjes i nënshkruar por i paratifikuar dhe përfundon në momentin që ligji ratifikues hyn në fuqi. Për këtë arsye duhet të ndalemi në përcaktimin e saktë të këtyre momenteve.

Lidhja e një marrëveshje ndërkombëtare kalon në disa faza të cilat janë iniciativa,<sup>720</sup> negociimi,<sup>721</sup> miratimi dhe ratifikimi. Sipas legjislacionit tonë të brendshëm çdo marrëveshje miratohet në parim nga Këshilli i Ministrave përpara se të nënshkruhet.<sup>722</sup> Pikërisht ky moment, nënshkrimi i saj mbas miratimit nga ana e Këshillit të Ministrave është edhe momenti kur fillon të ecë afati për të kundërshtuar këtë marrëveshje në Gjykatën Kushtetuese.

Në lidhje me momentin e përfundimit të këtij afati, vetë Kushtetuta në nenin 131, shkronja "b" të saj shprehet për kontrollin e tyre përpara ratifikimit. Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare në këtë rast bëhet me ligj.<sup>723</sup> Duke iu referuar rregullave të përgjithshme të miratimit të ligjeve rezulton se në këtë rast mbas miratimit të tij nga Kuvendi, ligji shkon për shpallje tek Presidenti i Republikës i cili brenda 20 ditëve vendos për shpalljen e ligjit apo rikthimin e tij për rishqyrtim në Kuvend vetëm një herë. Nëse ligji shpallet atëherë ai hyn në fuqi 15 ditë mbas botimit në Fletoren Zyrtare. Në kuptim të drejtë të kësaj analize atëherë rezulton se ratifikimi i një marrëveshje ndërkombëtare konsiderohet se ka hyrë në fuqi sipas të drejtës sonë të brendshme ditën që ligji për ratifikimin e saj është botuar në Fletoren Zyrtare. Pra, në këtë moment, konsiderohet se ka përfunduar edhe afati për të kundërshtuar marrëveshjen ndërkombëtare në Gjykatën Kushtetuese.

Kjo do të thotë që kalimi i afatit përcaktohet nga e drejta e brendshme dhe jo ajo ndërkombëtare. E theksojmë këtë moment pasi sipas të drejtës ndërkombëtare një marrëveshje mund të hyjë në fuqi në momente të ndryshme si për shembull me shkëmbinin e instrumentave të ratifikimit, apo me depozitimin e tyre prej një numri të caktuar shtetesh, procedura këto që mund të kërkojnë kohë, ndoshta dhe vite. Por ky është një moment i cili nuk ndërhyt në procedurat për kontrollin kushtetues të një marrëveshje ndërkombëtare.

### **1.2.10 Mungesa e afatit për kontrollin e kushtetutshmërisë së partive dhe organizatave politike.**

Për gjykimin në lidhje me partitë/organizatat politike, mungesës së një afati për këtë lloj gjykimi, doktrina juridike shqiptare e ka justifikuar këtë parashikim me argumentin se paraqitja e kërkesës në çdo kohë është e kuptueshme, për arsye se ekzistenca e një afati parashkrimi do të lejonte antikushtetutshmërinë e veprimtarisë së partive politike dhe do të bënte të pamundur ndalimin e tyre me asnjë formë ligjore.<sup>724</sup>

Mendoj se argument i mësipërm është plotësisht i justifikuar. Shembujt e ndryshëm në histori kanë treguar se një parti politike e cila synon të marrë pushtetin dhe të përmbysë vlerat

<sup>720</sup> Ligji nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", nenet 5-8.

<sup>721</sup> Ligji nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", nenet 9-11.

<sup>722</sup> Ligji nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", neni 11.

<sup>723</sup> Kushtetuta, neni 121, pika 1.

<sup>724</sup> Sadushi, Sokol, "Kontrolli Kushtetuese", Shtëpia Botuese "BOTIMPEX", Tiranë 2004, fq.130.

demokratike në një shtet, nuk është shfaqur që në fillim agresive apo e dhunshme. Madje për shumë kohë ajo e ka fshehur qëllimin e saj të vërtetë. Po kështu ka pasur raste kur parti të ndryshme politike kanë përdorur pikërisht mjete demokratike për të ardhur në pushtet dhe më pas kanë shfaqur hapur qëllimet e tyre.

Përcaktimi i një afati të prerë do të sillte edhe një tjetër pasojë, e cila do të ishte goditja rregullisht përpara GJK-së të partive politike edhe për dyshimin më të vogël që mund të ekzistonte rreth programit politik apo veprimtarisë së tyre. Kjo lloj mënyre veprimi, paraqet pasoja të rënda për demokracinë pasi partitë politike do të ishin objekt sulmi i shpeshtë duke penguar veprimtarinë e tyre normale. Pikërisht pengimi i një veprimtarie normale politike do të sillte si pasojë ekstremizimin e tyre.

Nga ana tjetër vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese në mënyrë të shpeshtë për gjykime të cilat mund të rezultojnë në pjesën më të madhe të pabazuara, do të cënonte edhe autoritetin e këtij institucioni.

Qëndrimi i mësipërm gjen mbështetje edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së. Kjo gjykatë në një sërë vendimesh të saj ka përcaktuar se nuk mund të kërkohej nga një shtet që të presë deri sa një parti të ketë marrë pushtetin dhe të ketë filluar hapa konkrete për të zbatuar një politikë të papajtueshme me standardet e Konventës dhe të demokracisë, edhe pse rreziku i kësaj politike për demokracinë është i mirëpërcaktuar dhe i afërt.<sup>725</sup> Në këtë drejtim nuk mundet të kritikohen subjektet që nuk kanë bërë kërkesë më herët, si pasojë kërkesa do të ishte e parakohshme, pra përpara se rreziku të ishte real dhe i dukshëm. Po kështu nuk mundet që subjektet kërkuese të presin, kur rreziku është bërë mëse i qartë, deri se partia/organizata politike të ndërmarrë hapa konkrete për të vënë në zbatim programin e saj.<sup>726</sup>

### 1.3 Rivendosja në afat.

Kalimi i afatit procedural, mund të ndodhë edhe për shkaqe të pavarura nga vullneti i palëve në gjykim. Kështu, ndonëse palët dëshirojnë ta vënë në lëvizje gjykatën, për arsye objektive ato nuk mund ta ushtrojnë këtë të drejtë. Në gjykimin e zakonshëm, si K.Pr.C<sup>727</sup> ashtu edhe K.Pr.P.<sup>728</sup> parashikojnë mundësinë e palëve që në rast se për shkaqe të arsyeshme kanë humbur afatin ligjor kanë të drejtë të kërkojnë nga gjykatat rivendosjen në afat.

Problemi që shtrohet për diskutim është nëse mund të kërkohej rivendosja në afat për afatet procedurale të përcaktuar për gjykimin kushtetues. Në Gjermani, Gjykata Kushtetuese Federale ka refuzuar që të zbatojë një mundësi të tillë të njohur në kodet e procedurave nëpërmjet analogjisë dhe për shumë kohë ka refuzuar që të përfshijë një dispozitë të ngjashme në ligjin e vetë. Vetëm në fillim të viteve '90 legjislatori ndërhyri në ligjin organik të kësaj gjykate, për të njohur këtë mundësi.<sup>729</sup> Në disa juridiksione të tjera megjithëse pranohet, përsëri vërejmë se në disa raste ka disa kufizime. Kështu këto kërkesa nuk mundet që të paraqiten me kalimin e një afati të caktuar. Sipas modelit kroat kërkesa për rivendosje në afat duhet që të paraqitet

<sup>725</sup> GJEDNJ, Vendimi i Dhomës së Madhe, datë 13 shkurt 2013, Çështja "Refah Partisi dhe të tjerë kundër Turqisë", aplikimet nr. 41340/98, 41342/98, 41343/98 dhe 41344/98, parag. 102.

<sup>726</sup> Po aty, parag. 110.

<sup>727</sup> K.Pr.C. neni 151

<sup>728</sup> K.Pr.P. neni 147

<sup>729</sup> Scibert, Helga, "Admissibility requirements for constitutional complaints and mechanisms for avoiding an excessive case load", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15", botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998, fq. 150.

brenda 15 ditëve nga momenti që është zhdukur shkaku pengues por në çdo rast jo më vonë se 3 muaj mbas përfundimit të afatit ankimor që ka në dispozicion subjekti për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese.<sup>730</sup> Qëllimi i këtij parashikimi është që të garantojë sigurinë juridike duke mos lejuar shfaqjen e kërtimeve në të ardhmen e largët. Në rastin tonë përgjigjja e këtij diskutimi sipas mendimit tim është pjesërisht negative dhe pjesërisht pozitive.

Kështu për gjykimet abstrakte që ushtrohen nga Gjykata Kushtetuese (gjykimi mbi ligjet, aktet normative të organeve qendrore dhe vendore, i marrëveshjeve ndërkombëtare) nuk mund të kemi rivendosje në afat. Gjykimi abstrakt për nga natyra e tij sjell efekte *erga omnes* pra për të gjithë vendin në rast se kërkesa pranohet. Arsyeja pse është vendosur ky afat është që të sigurojë qëndrueshmërinë e marrëdhënieve juridike. Goditja e një akti të tillë mbas shumë kohësh do të sillte si pasojë cënimin e raporteve juridike të krijuara. Këtu duhet shtuar edhe fakti se për kontrollin abstrakt të akteve juridike, afati procedural është 3 vjet, për rrjedhojë ky afat është mëse i mjaftueshëm për të vënë në lëvizje procesin kushtetues. Përrjashtim bëjnë vetëm gjykimi i kërkesave që vijnë nga gjykata e zakonshme në kuadrin e kontrollit incidental me referim. Por ky lloj gjykimi merr shkas nga një mosmarrëveshje konkrete pavarësisht se vendimmarrja e mundshme pozitive e Gjykatës Kushtetuese ka efekte *erga omnes*. Për më tepër që shpallja e antikushtetutshmërisë së normës ligjore në këtë rast zbutet nga efekti shfuqizues (*ex nunc*) që kanë vendimet e Gjykatës Kushtetuese, të cilat nuk prekin marrëdhëniet juridike tashmë të konsoliduara.

Ndërsa në rastin e marrëveshjeve ndërkombëtare, për vetë natyrën e kontrollit kushtetues, i cili është *ex ante*, pra një kontroll paraprak (*apriori*), afati konsiderohet i humbur nga momenti që ratifikimi i marrëveshjes ka hyrë në fuqi. Mbas këtij momenti Gjykata Kushtetuese nuk ka më juridiksion që të shqyrtojë një kërkesë të tillë pavarësisht shkaqeve që mund ta kenë penguar një subjekt për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Këtu merr rëndësi edhe respektimi i parimit të së drejtës ndërkombëtare *pacta sunt servanda*. Për arsyet e mësipërme nuk ekziston mundësia për të kërkuar rivendosjen në afat, për të kundërshtuar ratifikimin e një marrëveshje ndërkombëtare, për faktin e thjeshtë se një marrëveshje e tillë është ratifikuar tashmë.

Përsa i përket afateve procedurale që i përkasin gjykimeve konkrete, mendoj se në këto lloj gjykimesh mund të kërkohet rivendosja në afat, nëse ky afat ka humbur për shkaqe të arsyeshme dhe pavarësisht faktit se nëpërmjet këtyre gjykimeve mund të kontrollohet edhe kushtetutshmëria e akteve juridike me efekte *erga omnes*. Në këtë gjykim, Gjykata Kushtetuese e ka vënë theksin pikërisht tek natyra konkrete e gjykimin të mosmarrëveshjes së kompetencave. Ajo ka përcaktuar se në këto raste afati i përgjithshëm 3 vjeçar nuk gjen zbatim, pasi do të linte një situatë konfliktuale midis organeve kushtetuese, tejet e dëmshme për shtetin. Duke u rikthyer në diskutimin tonë, jam i mendimit se në rastet kur një organi kushtetues i është cënuar kompetenca nga veprimet e një organi tjetër kushtetues, por ky i fundit nuk kishte mundësi për arsye objektive që t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese atëherë ka të drejtë të kërkojë rivendosjen në afat.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për gjykimet e tjera konkrete, për të cilat LGJK-ja ka përcaktuar afate procedurale për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese, ku rëndësi të veçantë merr edhe gjykimi i kërkesave për individët që pretendojnë cënimin e së drejtës së tyre për një proces të rregullt ligjor. Për këtë lloj gjykimi, parimisht Gjykata Kushtetuese ka pranuar

<sup>730</sup> Momcinovic, Hrvoje, "Contesting the arbitration decision in the proceedings before the constitutional court according to the croatian law", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15", botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998, fq. 79.



mundësinë e rivendosjes në afat<sup>731</sup> duke u mbështetur për analogji edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së,<sup>732</sup> pavarësisht se deri më sot nuk ekziston asnjë vendim që ta ketë pranuar një kërkesë të tillë.

Nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese rezulton se shkaqe të arsyeshme janë konsideruar fakte të tilla si gjendja e keqe shëndetësore, mosha e thyer, situata e keqe materiale dhe mungesa e ndihmës juridike, por është e kuptueshme që këto raste nuk janë shteruese por përkundrazi praktika mund të tregojë edhe raste të tjera, të cilat detyrimisht duhet që të justifikohen me prova në mënyrë të bindshme.

Kushtetuta dhe LGJK-ja nuk kanë parashikuar asnjë dispozitë ligjore në lidhje me mundësinë e rivendosjes në afat, atëherë duke i'u referuar nenit 1, pika 2 të LGJK-së i cili lejon mundësinë e referimit edhe në ligje të tjera, Gjykata Kushtetuese ka njohur si plotësisht të zbatueshëm edhe për gjykimin kushtetues parashikimet e neneve 151 dhe 152 të K.Pr.C., të cilat zbatohen *mutatis mutandis* edhe për gjykimin kushtetues.

Duke qenë se Gjykata Kushtetuese nuk është pjesë e pushtetit gjyqësor të zakonshëm, atëherë kërkesat për rivendosje në afat duhet që domosdoshmërisht të paraqiten përpara kësaj Gjykate dhe jo në gjykatat e zakonshme, pavarësisht se siç shpjegova me lart, zbatohen dispozitat e K.Pr.C. Kështu në një rast Gjykata Kushtetuese nuk ka marrë në konsideratë vendimin e një gjykate të zakonshme, e cila kishte rivendosur në afat të drejtën e një individ për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Kjo e fundit mbajti qëndrimin e mëposhtëm:

*Kërkuesi i është drejtuar me kërkesë për rivendosje në afat Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Kurbinit, e cila, me vendimin nr.223/183, datë 19.02.2010 të gjyqtarit të vetëm D.M, vendosi "Pranimin e kërkesës. Rivendosjen në afat të së drejtës për t'iu drejtuar me ankim Gjykatës Kushtetuese lidhur me shqyrtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë nr.1009, datë 10.06.2005". Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 24.02.2010.*

*Gjykata Kushtetuese gjendet përpara një rasti kur një vendim gjyqësor i formës së prerë e ka bërë taslmë fait accompli rivendosjen në afat të së drejtës së kërkuesit për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese.*

*Kolegji vlerëson se kërkuesi duhej t'i drejtohej gjykatës së zakonshme për një kërkesë që lidhej me çështje që përfshihen brenda juridiksionit të zakonshëm gjyqësor dhe jo për çështje të juridiksionit kushtetues. Për rivendosjen në afat të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese ai duhej t'i drejtohej kësaj Gjykate me kërkesë për rivendosjen në afat si gjykata "së cilës duhet t'i paraqiten edhe dokumentet që justifikojnë ose për të cilat kërkohet rivendosja e afatit". Përsa i përket mundësisë për rivendosjen në afat të kërkesës së P.Ll. nga vetë Gjykata Kushtetuese, në respekt të kërkesës nuk ka një pretendim të tillë.<sup>733</sup>*

<sup>731</sup> Vendimi nr.85, datë 09.10.2009 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese: *Nisur dhe nga qëndrimi që mbahet edhe në jurisprudencë, Kolegji vlerëson se në situata të veçanta mund të pranohen ankesa, pavarësisht se ka kaluar afati 2 vjeçar, por vetëm kur paraqiten prova që tregojnë rrethana të jashtëzakonshme, si gjendja e keqe shëndetësore, mosha e thyer, situata e keqe materiale dhe mungesa e ndihmës juridike, frika e arsyeshme nga represioni, etj.*

<sup>732</sup> Vendimi nr.40, datë 11.06.2010 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese: *Kolegji vlerëson se për analogji, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, në situata të veçanta, ka vendosur pranimin e kërkesës edhe kur ka kaluar afati i 6-mujve, pasi janë paraqitur prova që tregojnë rrethana të jashtëzakonshme si "gjendja tepër e keqe shëndetësore e kërkuesit", "mosha e thyer", "situata e keqe materiale dhe mungesa e ndihmës juridike", të cilat, në pajtim me parimet e njohura gjerësisht të së drejtës, përjashtojnë nga detyrimi i mbajtjes së afatit.*

<sup>733</sup> Vendimi Nr.40, datë 11.06.2010 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese



Nga sa më sipër rezulton se kërkesa për rivendosje në afat, duhet që t'i paraqitet vetë Gjykatës Kushtetuese, e cila e shqyrton faktin nëse kërkuesi ka qenë në pamundësi objektive për t'iu drejtuar gjykatës dhe për rrjedhojë e rivendos në afat kërkesën ose jo. Pranimi i kërkesës për rivendosje në afat nuk do të thotë që kërkuesi fillon t'i ecë sërish një tjetër afat, si për shembull në rastin e kërkesave për një proces të parregullt ligjor, një afat tjetër 2 vjeçar. Kjo do të ishte në kundërshtim të hapur me parimin e sigurisë juridike, sepse krijon edhe për dy vjet të tjera një gjendje pasigurie, që lidhet me faktin nëse subjekti do të paraqesë ose jo kërkesë në Gjykatën Kushtetuese. Për të nxjerrë një kuptim të saktë të kësaj situate përcaktuar sipas neneve 151 dhe 152 të K.Pr.C., jam i mendimit se duhet t'i referohemi edhe jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, e cila në lidhje me kuptimin e këtyre dispozitave ka mbajtur këtë qëndrim:

*Përsa i përket pretendimit se ankimi në gjykatën e apelit edhe pas rivendosjes në afat është paraqitur përsëri jashtë afatit, Kolegji Civil e gjen me vend të sqarojë se vendimi i gjykatës për rivendosjen në afat nuk i krijon mundësinë ankuesit për të pasur në dispozicion një afat të ri ankimi. Ky vendim, në të kundërt, rivendos në afat ankimin, d.m.th. e konsideron atë si të kryer brenda afatit ligjor, kur vërtetohet se kanë ekzistuar shkaqe nga ato që gjykata i vlerëson të tilla e që nuk e kanë lënë ankuesin të ushtrojë të drejtën e tij, si p.sh. hospitalizimi në gjendje komatoze, etj.*

*Në këtë vështrim rivendosja në afat e ankimit presupozon dhe ekzistencën paraprake të një ankimi në kuptimin material, i cili për arsye të jutfikueshme nuk është ushtruar, e për këtë shkak rivendoset në afat, konsiderohet si i paraqitur brenda afatit. Ky ankim duhet, si rregull, t'i bashkëngjitet kërkesës për rivendosje në afat (nenet 154 e 156 të K.Pr.Civile).<sup>734</sup>*

Duke zbatuar këtë arsyetim *mutatis mutandis* edhe për procesin e rivendosjes në afat në gjykimin kushtetues, rezulton se kërkuesi në çdo rast duhet që kërkesën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, ta shoqërojë edhe me kërkesën për rivendosje në afat duke i bashkalidhur edhe argumentat dhe provat përkatëse. Kërkesa për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese dhe kërkesa për rivendosje në afat, mund të jenë dy kërkesa të veçanta të cilat i bashkëlidhen njëra-tjetrës, por të dy kërkimet mund të jenë të pasqyruar formalisht edhe në të njëjtin akt.

Nëse Gjykata Kushtetuese rrëzon kërkesën për rivendosje në afat, ky vendim tregon se ajo nuk e ka legjitimuar kërkuenin *ratione temporis* dhe për rrjedhojë ka disponuar me moskalimin e çështjes në seancë plenare. Duke qenë se Gjykata Kushtetuese është e vetme në llojin e saj, është e kuptueshme që ndaj këtij vendimi nuk mund të ushtrohet ankim dhe për rrjedhojë parashikimi i nenit 152, pika 2 e K.Pr.C. nuk gjen zbatim.

Një tjetër problem që mund të shtrohet për diskutim është respektimi i parimit të kontradiktorialitetit dhe të barazisë së armëve. Kërkesa e subjektit për rivendosje në afat shqyrtohet nga Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (ose Mbledhja e Gjyqtarëve), pa pasur dijeni dhe për rrjedhojë pa praninë e subjekteve të tjera të interesuara. Në këtë mënyrë duket sikur, palët e tjera pjesëmarrëse në gjykim nuk kanë mundësi për të kundërshtuar argumentat e kërkuetit për rivendosje në afat apo për të vënë në diskutim vendimmarrjen e Gjykatës për këtë pjesë. Për të sqaruar këtë situatë, duhet theksuar se vendimi i Kolegjit ose i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese për të kaluar çështjen për shqyrtim në seancë plenare nuk është vendim përfundimtar, por është një vendim i ndërmjetëm. Për rrjedhojë pjesëmarrësit e tjerë në gjykimin

<sup>734</sup> Vendimi nr.00-2008-585 (179), date 11.03.2008 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

kushtetues kanë mundësi që gjatë gjykimit në seancë plenare të paraqesin prapësimet e tyre në lidhje me kërkesën për rivendosje në afat, duke vënë pikërisht në diskutim legjitimitimin *ratione temporis* të kërkuarit. Nëse Gjykata Kushtetuese bindet nga këto prapësime atëherë ajo në përfundim të gjykimit vendos rrezimin e kërkesës për mungesë legjitimitimi të kërkuarit.

## 2. AKTET PROCEDURALE.

Procesi kushtetues nuk është një “reaksion kimik” që zhvillohet në mënyrë të natyrshme vetë, por përkundrazi vihet në lëvizje nga subjektet e procedimit kushtetues. Në vijë të përgjithshme procedurat të cilat zhvillohen gjatë gjykimit kushtetues, janë procedura formale të cilat kanë shumë ngjashmëri me procedurat që zhvillohen gjatë gjykimit të zakonshëm. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka theksuar ngjashmëritë dhe dallimet të cilat ekzistojnë midis gjykimit kushtetues dhe atij të zakonshëm. Kështu në një vendim të Gjykatës Kushtetuese gjejmë këto përfundime:

*Procedura e pranimit të ankesave dhe kërkesave, si dhe e gjykimit të tyre nga Gjykata Kushtetuese është shumë e ngjashme dhe, sipas rastit, edhe e njëjtë me procedurën e zbatuar në gjykimin e zakonshëm... Vullneti i Gjykatës Kushtetuese, sikundër edhe ai i çdo gjykate, të cilatdo juridiksion, shprehet vetëm përmes vendimeve, të cilët në aspektin e teknikës dhe formës së përdorur, janë identikë ndërmjet tyre. Këto vendime janë përfundimtare dhe kanë fuqi detyruese të përgjithshme...<sup>735</sup>*

Duke qenë një gjykatë e caktuar nga Kushtetuta për dhënien e drejtësisë kushtetuese, rezulton se edhe në këtë lloj gjykimi, ashtu si edhe në gjykimin e zakonshëm procesi fillon, zhvillohet dhe përfundon me kryerjen e akteve të ndryshme të subjekteve të tij, që janë aktet procedurale.<sup>736</sup> Skema e procedimit jepet nga dy akte kryesore ai i fillimit dhe i mbarimit: kërkesa e palës dhe vendimi i gjykatës. Të gjitha aktet e tjera të ndërmjetme, megjithëse ruajnë individualitetin e tyre nuk kanë qëllim tjetër përveç atij të përgatitjes së aktit përfundimtar, pra vendimit gjyqësor dhe procedimi tenton me të gjithë peshën e tij drejt këtij akti përfundimtar që e mbyll dhe e plotëson ciklin e hapur prej kërkesës së paraqitur nga pala.<sup>737</sup>

Aktet procedurale kushtetuese janë akte të procesit, janë akte të cilat e vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese dhe që e detyrojnë atë të shprehet me një vendim në përfundim të tij.

Përsa i përket kuptimit të aktit procedural, në doktrina dhe studime të ndryshme akti procedural është konsideruar “një deklaram, ose manifestim i mendimit i bërë në mënyrë të vullnetshme nga njëri prej subjekteve të procesit, i cili hyn në njërin prej kategorive të akteve të parashikuara nga ligji procedural dhe i takon procedimit, i cili ka efekte krijuese, ndryshuese ose shuese mbi marrëdhënien procedurale korresponduese”.<sup>738</sup> Ndërsa në një tjetër studim akti procedural përkufizohet si “dokument që përpilohet nga subjektet e procedimit, në të cilin pasqyrohen ose vërtetohen të dhënat, veprimtaria e tyre, në rastet dhe në format e parashikuara nga ligji”.<sup>739</sup>

<sup>735</sup> Vendimi nr.11, datë 06.04.2010 i Gjykatës Kushtetuese, paragraf.16.

<sup>736</sup> Brati, Alban, “Procedura Civile”, Botimi i Parë, Shtëpia Botuese “Dudaj”, Tiranë, 2008, fq.208.

<sup>737</sup> Po aty, fq.216

<sup>738</sup> Po aty, fq. 209

<sup>739</sup> Uka, Njazi, “Fjalori i Drejtësisë”, Botimi i Parë, Shtëpia Botuese “ILARI” P.F., Tiranë 2011, fq.34.

Për të vijuar më tej me karakteristikat e akteve procedurale si fillim duhet të ndalemi te **subjektet** e këtyre akteve. Kështu pavarësisht se vendimi i Gjykatës Kushtetuese konsiderohet se ka efekte *erga omnes* pra efekte juridike me natyrë të përgjithshme, gjykimi kushtetues zhvillohet brenda një rrethi të ngushtë subjektësh. Për rrjedhojë janë vetëm këto subjekte të cilët mund të “prodhojnë” akte procedurale. Të tillë subjekte janë: Gjykata Kushtetuese dhe pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues. Këtu në disa raste të rralla përfshihen edhe aktet e ekspertit, në ato raste kur është thirrur nga Gjykata. Në këtë drejtim edhe aktet procedurale ndahen në akte të gjykatës dhe akte të palëve.

Akte të gjykatës, janë disa të tilla ku mund të përmendim: relacioni i relatorit, relacioni i këshilltarit të gjyqtarit, opinioni i këshilltarit të gjyqtarit, vendimet e ndryshme që merr gjykata (vendimi i kalimit ose moskalimit në seancë plenare, vendimet e ndërmjetme, vendimi përfundimtar etj.) njoftimet, procesverbali gjyqësor etj.

Akte procedurale të pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues, janë kërkesat, mendimet me shkrim, memot e ndryshme, provat që paraqesin etj. Këto akte kryhen apo realizohen personalisht prej tyre ose nëpërmjet përfaqësuesve të caktuar prej tyre në varësi të llojit të mbrojtjes që kanë zgjedhur në gjykimin kushtetues.

Karakteristikë tjetër e akteve procedurale është **përmbajtja** e tyre. Përmbajtja e një akti procedural varet nga qëllimi që kërkon të arrijë subjekti i procedurës nëpërmjet tij. Legjislacioni që rregullon veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese dikton në një farë mënyre edhe përmbajtjen e aktit. Kështu për Gjykatën Kushtetuese janë përcaktuar llojet e vendimeve që mund të marr ajo. Për gjyqtarin relator është përcaktuar relacioni që duhet të përgatisë edhe përmbajtja e tij, po kështu edhe opinioni i këshilltarit. Për sekretarin është përcaktuar mbajtja e procesverbalit gjyqësor dhe kryerja e njoftimeve duke treguar edhe përmbajtjen e tyre.

Ndërsa për sa i përket akteve procedurale të palëve mund të themi se përmbajtja e tyre varet nga qëllimi që kërkohet të arrihet nëpërmjet vënies në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë drejtim një kërkesë për shfuqizimin e një ligji, ka përmbajtje më të gjerë se kërkesa për përjashtimin e një gjyqtari nga procesi.

**Forma e aktit** është një tjetër karakteristikë e akteve procedurale. Parimisht procesi kushtetues zhvillohet përpara Gjykatës Kushtetuese, në të dy format e tij, me gojë dhe me shkrim. Pavarësisht kësaj, duke analizuar në tërësi LGJK, rezulton se me qëllim për të shfaqur garanci dhe siguri për pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues, si edhe për procesin në tërësi, rëndësi i jepet më shumë procesit me shkrim. Kështu LGJK-ja, parashikon një sërë aktesh procedurale dhe formën, e cila duhet të jetë me shkrim, si: kërkesa, relacioni, procesverbali, vendimi etj. Nga ana tjetër, faza e parë e gjykimin kushtetues, ajo seleksionuese bëhet pa praninë e palëve dhe vetëm mbi bazë dokumentash, madje edhe gjykimi në seancë plenare (faza e dytë e procesit) mund të bëhet edhe vetëm mbi bazë dokumentash, pa praninë e palëve, referuar përmbajtjes së nenit 23, të ligjit organik të gjykatës.<sup>740</sup>

Format procedurale i përgjigjen një rendi domosdoshmërie, qartësie dhe efektiviteti dhe respektimi rigoroz i tyre përfaqëson një garanci për rregullshmërinë dhe ligjshmërinë e zhvillimit të procesit dhe të respektimit të të drejtave të palëve.<sup>741</sup> Për shkak të kësaj rëndësie në disa raste, megjithëse të pakta, LGJK-ja na ka dhënë formën që duhet domosdoshmërisht të ketë një akt procedural në mënyrë që të prodhojë pasojat e dëshiruara. Si shembull konkret mund të marrim “kërkesën”, akt procedural që parashikohet nga neni 28 i LGJK, dispozitë e cila na jep formën e

<sup>740</sup> LGJK, neni 23: *Shqyrtimi i çështjes në seancë plenare bëhet gojarisht ose mbi bazë dokumentash, sipas natyrës së çështjes.*

<sup>741</sup> Brati, Alban, “*Procedura Civile*”, Botimi i Parë, Shtëpia Botuese “Dudaj”, Tiranë, 2008, fq.212.



këtij akti (duhet te jetë me shkrim), si edhe tregues të tjerë që duhet të jenë patjetër pjesë e formës së tij. Në disa raste të tjera ligji në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte përcakton nëse akti duhet të jetë në formë të shkruar apo mund të jetë edhe në formë gojore.<sup>742</sup>

Megjithatë në shumicën e rasteve LGJK-ja kufizohet vetëm në emërimin e aktit procedural por nuk jep asnjë tregues për formën e tij. Në këto raste duke pasur në konsideratë parashikimin e nenin 1, pika 2 të LGJK, i referohemi për analogji K.Pr.C. dhe përkatësisht neneve 115-118 të tij. Kështu në këto dispozita gjejmë rregullime plotësuese në lidhje me formën e disa akteve procedurale si njoftimi, procesverbali i seancës gjyqësore etj. Po kështu referime të tjera mund të gjejmë në nenet 126, 127 dhe 310 të K.Pr.C., në lidhje me formën e vendimit gjyqësor.

Një tjetër aspekt që duhet të merret në konsideratë për formën e aktit është edhe gjuha që duhet përdorur. Ky moment është i kushtëzuar nga formulimi i nenit 14, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dispozitë e cila parashikon se gjuha zyrtare në Republikën e Shqipërisë është shqipja. Në zbatim të këtij detyrimi kushtetues LGJK në nenin 22, pika 1 të tij përcakton në mënyrë taksative se në shqyrtimin e çështjeve përdoret gjuha shqipe. Kjo dispozitë mund të plotësohet për qartësi me nenin 116 të K.Pr.C. ku disponohet se aktet procedurale hartohen në gjuhën shqipe.

Në këtë drejtim si në fazat e zhvillimit të procesit kushtetues, mbi bazë dokumentash apo edhe me gojë, gjuha që do të përdoret do të jetë gjuha shqipe. Megjithatë pavarësisht kësaj subjektet që mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese mund të jenë edhe individë të huaj, të cilët nuk kanë njohuri për gjuhën shqipe. Për të garantuar të drejtat e tyre edhe në procesin kushtetues (ku zbatohen parimet e procesit të rregullt ligjor) LGJK-ja parashikon në pikën 2 të nenit 22 se pjesëmarrësit në gjykim, që nuk dinë gjuhën shqipe, përdorin gjuhën e tyre. Ata marrin dijeni për të gjithë zhvillimin e procesit me anë të përkthyesit, që si rregull sigurohet nga Gjykata Kushtetuese.

Nga formulimi i kësaj dispozite, rezulton se individëve të huaj që nuk kanë njohuri për gjuhën shqipe u sigurohet një përkthyes. Një situatë që mund të diskutohet në këtë rast është fakti nëse Gjykata ka detyrimin për të caktuar një përkthyes që në momentin e paraqitjes së kërkesës apo duhet që të konkurrojnë edhe kushte të tjera në mënyrë që të pranohet kërkesa për caktimin e përkthyesit.

Nëse i referohemi Kushtetutës rezulton se ajo e citon përkthyesin vetëm në nenin 31, gërma "c" të saj, ku parashikohet se gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe. Nga ky formulim rezulton se ndihma e përkthyesit pa pagesë ofrohet vetëm në procesin gjyqësor penal. Përsa i përket procesit gjyqësor civil vërejmë se neni 27, pika 2 e K.Pr.C. përcakton se personat që nuk dinë shqip, përdorin gjuhën e tyre. Ata marrin dijeni për provat dhe për gjithë zhvillimin e gjykimit me anë të përkthyesit. Në lidhje me këtë parashikim të K.Pr.C. Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin se:

*Bazuar në konsideratat e mësipërme, si dhe në parimin e përgjithshëm të vetëpërgjegjësisë së palës në një gjykim civil, Gjykata vlerëson se, në kuadrin e këtij procesi, e drejta e individit "për të pasur ndihmën pa pagesë të një përkthyesi nëse nuk kupton ose nuk flet gjuhën shqipe", ndryshe nga kjo e drejtë në procesin penal, është subjekt i kushtit të dhënies së ndihmës juridike falas, të cilën individit, jo vetëm është i*

<sup>742</sup> Për shembull neni 40, pika 2 e LGJK-së parashikon se: *Eksperti e jep mendimin e tij me shkrim, por mund të dëgjohet edhe në seancë plenare.*



*detyruar ta kërkojë, por edhe të provojë pamundësinë e tij financiare për të përballuar shpenzimet e gjyqimit. Vetëm në këto kushte gjykatat e juridiksionit të zakonshëm janë të detyruara që në përmbushje të detyrimit kushtetues, për të zhvilluar një proces të rregullt ligjor, t'i caktojnë individit, palë të një gjykimi civil, një përkthyes që zyrtarisht të këtë njohuri mbi gjuhën e tij, duke qenë formalisht kompetent në njohjen e gjuhës së tij. Në të kundërtën, Gjykata bazuar në parimin e përgjithshëm të gjyqimit civil të vetëpërgjegjësive së palës, çmon se individit ka të drejtën dhe detyrimin që ta organizojë vetë mbrojtjen e tij, duke caktuar një përkthyes dhe/ose edhe një mbrojtës, duke përballuar paraprakisht/parapaguar shpenzimet e tij.<sup>743</sup>*

Pra, për procesin civil Gjykata Kushtetuese ka konkluduar faktin se është detyrim i palës ndërgjyqëse që nuk di shqip ta sigurojë vetë dhe me shpenzimet e tij një përkthyes, ose të sigurojë një mbrojtës, i cili njeh gjuhën e këtij individit. Duke qenë se Gjykata Kushtetuese zbaton si legjislacion plotësues dhe për analogji K.Pr.C. atëherë mund të thuhet se rregulli i përcaktuar prej saj për mënyrën e caktimit të përkthyesit në procesin civil vlen edhe për procesin kushtetues. Ky moment përforcohet nga fakti se formulimi i nenit 27, pika 2 të K.Pr.C. është shumë i ngjashëm me formulimin e nenit 22, pika 2 të LGJK-së. Megjithatë përsëri midis këtyre dy dispozitave ka ndryshim. Ndryshimi në këtë rast përbëhet nga togfjalëshi “*që si rregull sigurohet nga Gjykata Kushtetuese*” që përdoret në LGJK-në dhe që nuk e gjejmë në K.Pr.C. Nga ky formulim duket se është detyrim i Gjykatës Kushtetuese gjetja e përkthyesit kur një gjë e tillë kërkohet nga palët, detyrim ky që duket se buron nga termi “si rregull” që përdor dispozita ligjore.

Por ky detyrim i gjykatës nuk është kategorik nëse vërejmë edhe dispozita të tjera të LGJK-së siç është rasti i nenit 24, dispozitë e cila parashikon se pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues mbrohen vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit, në mënyrën e parashikuar në këtë ligj. Bazuar në këtë dispozitë dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese jam i mendimit se në rast se pjesëmarrësi në gjykimin kushtetues zgjedh një përfaqësues, atëherë mendoj se ai duhet që ta zgjedhë atë (përfaqësuesin) në mënyrë të tillë që ta ndihmojë pjesëmarrësin që të marrë dijeni si për aktet procedurale ashtu edhe ecurinë e procesit në gjuhën që ai kupton. Por pavarësisht kësaj kjo nuk e pengon pjesëmarrësin që përsëri të marrë një përkthyes vetë. Në rast se pjesëmarrësi nuk gjen përfaqësues apo përkthyes mund t'i kërkojë Gjykatës që t'ia caktojë ajo një përkthyes atij. Termi që përdor dispozita “*si rregull*” do të thotë që gjykata duhet t'ia pranojë kërkesën por jo domosdoshmërisht sigurimin e këtij përkthyesi nga Gjykata Kushtetuese do të ofrohet falas. Kështu neni 83 i LGJK-së përcaktohen se megjithëse procedurat në Gjykatën Kushtetuese janë të përjashtuara nga taksat për disa shërbime që kryhen si edhe për shpenzimet e bëra gjatë gjyqimit të çështjes, vendos Gjykata Kushtetuese. Duke pasur në konsideratë këtë dispozitë mund të konkludojmë se në rast se paraqitet një kërkesë nga një pjesëmarrës në procesin kushtetues për caktimin e një përkthyesi, Gjykata është e detyruar që t'ia plotësojë kërkesën, por duke i ngarkuar shpenzimet e përkthyesit palës që e kërkoi. Vetëm në rast se kjo palë pjesëmarrëse, kërkesën e saj për caktimin e një përkthyesi e justifikon edhe me argumentin se ndodhet në pamundësi financiare atëherë shpenzimet e përkthyesit mund t'ia marrë përsipër vetë Gjykata. Ky konkluzion buron nga parashikimi i pikës 2 të nenit 83 të LGJK-së duke ia lënë në diskrecion Gjykatës Kushtetuese që të vendosë sipas rastit në lidhje me caktimin e shpenzimeve gjyqësore.

Në vijim po japim karakteristikat kryesore të akteve të veçanta të një procesi kushtetues.

<sup>743</sup> Vendimi nr.35, datë 25.7.2011 i Gjykatës Kushtetuese.

## 2.1 Kërkesa.

Në lidhje me aktin procedural fillestar i cili vë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë na jep dy terma. Kështu në nenin 133, pika 1 ajo përdor termin *ankesë*,<sup>744</sup> ndërsa në nenin 134, pika 1 përdor termin *kërkesë*.<sup>745</sup> Ligjvënësi shqiptar në momentin e hartimit të LGJK-së midis këtyre dy termave përzgjedhi termin "*kërkesë*". Doktrina juridike e ka përkufizuar *kërkesën* si një mjet ligjor i veçantë që përdoret ndaj shkeljeve kushtetuese të shkaktuara nga ligjet, aktet normative të organeve qendrore dhe vendore, aktet administrative, si edhe vendimet gjyqësore.<sup>746</sup> Përdorimi i termit *kërkesë* është karakteristikë për procedurat para Gjykatës Kushtetuese me qëllim diferencimin nga termat padi, *kërkesëpadi*, *ankim*, *rekurs* që përdoret në gjykimet e zakonshme.<sup>747</sup> Në shumicën e rasteve *kërkesa* na shfaqet si akti kryesor që përdoret nga subjektet kushtetuese për të vënë në lëvizje një proces kushtetues, megjithatë nuk është i vetmi. Kështu duke pasur në konsideratë rregullimet e neneve 70,<sup>748</sup> 90,<sup>749</sup> 91,<sup>750</sup> 128<sup>751</sup> dhe 140<sup>752</sup> të Kushtetutës vërehet se në këto raste akti procedural që vënë lëvizje Gjykatën Kushtetuese është vendimi i Kuvendit, që inicion një prej procedurave të përcaktuara në këto dispozita kushtetuese. Një tjetër rast i veçantë është edhe situata e rregulluar nga neni 145<sup>753</sup> i Kushtetues që bën fjalë për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese nga gjykatat e zakonshme, në kuadër të kontrollit incidental me referim. Në këto raste akti procedural që vë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese është vendimi gjyqësor i gjykatës përkatëse.

Duke u rikthyer tek *kërkesa* si akti procedural më i përdorshëm për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, vërejmë së ky akt është i rregulluar përsa i përket formës dhe përmbajtjes në nenin 28 të LGJK-së.<sup>754</sup> Nga analiza e kësaj dispozite rezulton se forma e *kërkesës* duhet të jetë gjithmonë me shkrim, duke përjashtuar në këtë mënyrë paraqitjen e *kërkesës* me gojë, apo me dokument elektronik. Ligjvënësi pavarësisht parashikimit të bërë në nenin 22 të LGJK-së në lidhje me përdorimin e gjuhës shqipe, dispozitë të cilën e analizuam edhe më lart, e ka parë të domosdoshme që të parashikojë edhe në këtë rast që *kërkesa* të hartohet në gjuhën shqipe. Ky formulim, përbën në vetvete një kufizim për individët e huaj që nuk kanë njohur për gjuhën shqipe, të cilët janë të detyruar që të pajtojnë që në fillim një përkthyes në mënyrë që *kërkesën* e tyre ta paraqesin në gjuhën shqipe. Duke qenë se *kërkesa* nuk është paraqitur atëherë, individi i huaj nuk mundet që të kërkojë nga Gjykata, caktimin e një përkthyesi, pasi Gjykata Kushtetuese

<sup>744</sup> Kushtetuta, neni 133, pika 1: *Pranimi i ankesave për gjykim vendoset nga një numër gjyqtarësh, siç përcaktohet me ligj.*

<sup>745</sup> Kushtetuta, neni 134, pika 1: *Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të...*

<sup>746</sup> Sadushi, Sokol, "*Drejtesia Kushtetuese në zhvillim*", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq. 358

<sup>747</sup> Pirdeni, Adea, "*Justifikimi i interesit në gjykimin kushtetues: Vështrim mbi praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*", botuar në Revistën "*Studime Juridike*", nr.2, Botim i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, Shtëpia Botuese "Pegi", Tiranë 2011, fq.280.

<sup>748</sup> Verifikimi i papajtueshmërisë së ushtrimit të funksioneve të deputetëve.

<sup>749</sup> Verifikimi i shkaqeve të shkarkimit të Presidentit të Republikës

<sup>750</sup> Verifikimi i pamundësisë së ushtrimit të funksioneve nga Presidenti i Republikës

<sup>751</sup> Verifikimi i rasteve të shkarkimit të gjyqtarëve kushtetues

<sup>752</sup> Verifikimi i rasteve të shkarkimit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë

<sup>753</sup> Kushtet për të ushtruar kontrollin incidental me referim nga gjykatat e zakonshme.

<sup>754</sup> LGJK, neni 28: 1. *Kërkesa në Gjykatën Kushtetuese paraqitet në formë të shkruar në gjuhën shqipe, qartë e kuptueshëm, në aq kopje sa janë pjesëmarrësit dhe duhet të përmbajë: a) emrin e gjykatës përpara të cilës paraqitet; b) emrin, mbiemrin (emërtimin), vendbanimin ose vendqëndrimin e kërkuarit; c) emrin, mbiemrin (emërtimin), vendbanimin ose vendqëndrimin e subjekteve të interesuara; d) objektin e kërkesës; e) përmbajtjen e kërkesës dhe parashkrimin e shkaqeve; dh) treguesin e dokumenteve dhe mjeteve të tjera provuese që shoqërojnë kërkesën; e) nënshkrimin e kërkuarit ose të përfaqësuesit të tij. 2. Kërkesa u njoftohet palëve në gjykim.*

shprehet me vendim për çdo kërkim të palëve vetëm pasi të jetë vënë në lëvizje nga subjektet përkatëse.

Gërma "a" nenit 28 pika 1 kërkon që në kërkesë të përcaktohet edhe emri i gjykatës përpara së cilës paraqitet kërkesa. Ky kriter ka më shumë karakter formal dhe ka si qëllim dhënien e një solemniteti në paraqitjen e kërkesës, kjo për faktin se në Shqipëri kontrolli kushtetues ushtrohet në mënyrë të centralizuar nga Gjykata Kushtetuese dhe për rrjedhojë nuk ekziston mundësia e konfondimit të palëve se në cilën instancë gjyqësore duhet të paraqesin një kërkesë të tillë. Një situatë të tillë mund të kishim p.sh. në Gjermani ku kontrolli kushtetues është policentrik, pra ushtrohet nga një sërë gjykatash kushtetuese, ato të landeve dhe gjykata federale, por siç e sqaruam në Shqipëri një situatë e tillë është e pamundur që të ndodhë.

Gërma "b", kërkon përcaktimin e të dhënave të sakta për kërkuesin, në mënyrë që të arrihet identifikimi i plotë i tij. Ky kriter ka rëndësinë e tij pasi i jep mundësi Gjykatës që të vlerësojë karakteristikat e kërkuesit si subjekt për rrjedhojë të vlerësojë legjitimitimin e tij. Siç e kemi trajtuar edhe më sipër, jo çdo subjekt mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, por vetëm një rreth i përcaktuar qartë në nenin 134 të Kushtetutës. Për më tepër që edhe secili prej këtyre subjekteve nuk legjitimohet për cilido proces kushtetues, por vetëm për kategori të caktuara. Një tjetër arsye e fortë për të dhënë të dhëna të sakta për identifikimin e plotë të kërkuesit lidhet edhe me procedurat e njoftimit që duhet të ndjekë Gjykata Kushtetuese gjatë procesit që inicohet nëpërmjet paraqitjes së kërkesës.

Edhe gërma "c" kërkon përcaktimin e të dhënave të sakta për subjektet e interesuara. Ky kriter merr rëndësi sidomos kur kemi të bëjmë me palë private (në kuadër të një gjykimi për proces të rregullt ligjor), pasi mundëson identifikimin dhe njoftimin e palëve, për t'i dhënë atyre mundësinë për t'u mbrojtur në gjykimin kushtetues.

Kriteri i përcaktuar në gërmën "ç", objekti i kërkesës është nga më të rëndësishmit. Nëpërmjet përcaktimit të saktë të tij evidentohet që në fillim natyra e gjykimin kushtetues që kërkohet të inicohet (gjykim mbi ligjet, aktet normative apo proces të rregull ligjor etj). Po kështu nga mënyra sesi është formuluar objekti, Gjykata vlerëson nëse çështja që kërkohet të paraqitet për gjykim para saj është apo ajo brenda juridiksionit kushtetues.

Objekti i kërkesës duhet që të jetë i qartë dhe konkret. Në të duhet që domosdoshmërisht të tregohet akti (normativ, administrativ apo gjyqësor) që kundërshtohet përpara kësaj gjykate. Por duke u nisur nga natyra e kontrollit kushtetues rezulton se si rregull nuk mundet që në Gjykatën Kushtetuese të jetë objekt kontrolli akti individual<sup>755</sup>, me përjashtim të rasteve të përcaktuara nga vetë Kushtetuta.<sup>756</sup> Objekti i kërkesës duhet që të ketë lidhje me pretendimet e ngritura nga kërkuesi dhe të parashtruara në kërkesë. Në këtë drejtim nuk mundet që objekti i përcaktuar të jetë një akt (normativ, administrativ apo gjyqësor) dhe pretendimet e ngritura të referojnë apo kundërshtojnë akte të tjera, të cilat nuk përmenden në objekt.<sup>757</sup> Ky moment përbën nja largim nga procesi gjyqësor i zakonshëm, ku objekti i kërkimit përcaktohet nga shpjegimi tërësor i rrethanave që bëjnë palët në kërkesëpadi dhe jo vetëm nga ajo që ato shkruajnë në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë në rubrikën e titulluar "objekti".<sup>758</sup> Për më tepër referuar faktit që cituam më sipër se objekti i kërkesës duhet që si rregull të përmbajë akte (normative, administrative apo gjyqësore) të cilat kërkohet që të shfuqizohen, rezulton se objekti i kërkesës nuk mundet kurrësesi të përbëjë detyrime për kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve të

<sup>755</sup> Vendimet nr.185, datë 26.10.2001, nr.20, datë 4.5.2007 dhe nr.29, datë 21.20.2009 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>756</sup> Rastet e neneve 70, 90, 91, 115, 128 dhe 140 të Kushtetutës

<sup>757</sup> Vendimet nr.67, datë 11.10.2010 dhe nr.80, datë 20.07.2011 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>758</sup> Vendimi unifikues nr.3, datë 29.3.2012 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, parag.25.



institucioneve apo personave të tjerë.<sup>759</sup> Për më tepër nuk mundet që të jenë objekt i kërkesës, akte të cilat janë në favor të kërkuarit dhe që prodhojnë efekte pozitive për të.<sup>760</sup> Çdo paqartësi dhe/apo kontradiktorialitet e bën kërkesën të paplotë nga pikëpamja formale<sup>761</sup> dhe për rrjedhojë të papranueshme.

Kriter tjetër i kërkuar nga ligji *përmbajtjen e kërkesës dhe parashtrimin e shkaqeve* është i lidhur me kriterin e mësipërm, përcaktimin e objektit nga kërkuari. Ky kriter kërkon domosdoshmërisht që kërkuari, të paraqesë në mënyrë shteruese të gjitha argumentat që kanë të bëjnë me antikushtetutshmërinë e aktit të kundërshtuar prej tij. Në këtë kuptim, parashtrimi i shkaqeve duhet që të jetë i plotë i qartë dhe konkret duke treguar të drejtat apo parimet kushtetuese të cilat pretendohet se janë shkelur nga akti objekt i kërkesës. Por nuk është e mjaftueshme vetëm citimi i të drejtave dhe/apo parimeve që pretendohet se janë shkelur, por kërkuari duhet që domosdoshmërisht të japë edhe argumentat ku të tregohet edhe se në ç'mënyrë janë shkelur këto drejta/parime kushtetuese. Një mungesë e tillë do ta bënte kërkesën të paplotë dhe për rrjedhojë të papranueshme.

Për sa më sipër rezulton se pjesa përshkruese në çdo rast duhet të jetë logjike, e rregullt në formë dhe e qartë në përmbajtje. Në tërësinë e saj, ajo duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës përshkruese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat dhe ligjet e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda kërkesës, duke përjashtuar çdo kundërthënie apo kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur objektin e kërkesës, i cili është edhe kërkitimi kryesor, arsyeja se pse subjektet përkatëse po venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Paqartësia e objektit të kërkesës, ose kontradiktat dhe paqartësia në pjesën përshkruese të kërkesës janë vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese, si raste për të vendosur moskalimin e çështjes në seancë plenare.

Kriteri i përcaktuar në gërmën "dh", të dispozitës, kërkon që kërkuari të tregojë edhe *dokumente dhe mjete të tjera provuese që shoqërojnë kërkesën*. Ky kriter plotësohet më tej me parashikimin e nenit 29, pika 1 e LGJK-së i cili na tregon edhe aktet që duhet t'i bashkëlidhen

<sup>759</sup> Vendimi nr.94, datë 14.09.2012 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese: *Megjithatë, nga shqyrtimi i kërkesës Kolegji vëren se objekti i saj nuk është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese. Në zbatim të paragrafit të parë të nenit 132 të Kushtetutës "Gjykata Kushtetuese ka vetëm të drejtën e shfuqizimit të akteve që shqyrton". Kolegji vëren se kërkesa parashikon në objektin e saj detyrimin e një pale për të kryer një veprim si dhe marrjen e masës së sigurimit të padisë. Kolegji vlerëson se këto kërkitime, parashtruar në objektin e kërkesës, nuk lyjnë në kompetencën shfuqizuese të Gjykatës, njohur shprehimisht nga Kushtetuta.*

<sup>760</sup> Vendimi nr.141, datë 25.11.2011 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese: *Në lidhje me pretendimet e kërkuarit, Kolegji vlerëson se kërkesa është pa objekt në kuptim të gjykimit kushtetues. Kërkuari nuk ka arritur të ngrejë në nivel kushtetues pretendimet e tij në mënyrë që të legjitimohet racione materiae të kërkojë shfuqizimin e vendimit nr. 00-2009-300, datë 24.02.2009 të Gjykatës së Lartë. Nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se vendimi, objekt shqyrtimi, ka prodhuar efekte pozitive për kërkuarin, në lidhje me gëzimin e pronës nga ana e tij dhe për pasojë del qartë në pah mungesa e interesit që ai ka në një kërkitim të tillë kushtetues.*

<sup>761</sup> Vendimi nr.80, datë 28.10.2010 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese: *Në kërkesën e dërguar në Gjykatën Kushtetuese kërkuari pretendon për cënimin e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszbatimit të neneve 41, 42, 42 e 141/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 249 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe si rrjedhojë e moszbatimit të neneve 142/3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, dhe të neneve 510, dhe 511 të K.Pr.C. Sipas nenit 28 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", kërkesa në Gjykatën Kushtetuese, formalisht duhet të përmbajë objektin e kërkesës, si dhe parashtrimin e shkaqeve. Kolegji i Gjykatës Kushtetuese gjatë shqyrtimit paraprak çmoi se objekti dhe shkaqet e kësaj kërkesë janë të paqarta, kontradiktore dhe të barasvlefshme me mungesën e tyre, çka e bën këtë kërkesë të paplotë nga pikëpamja formale.*



kërkesës. Në këtë mënyrë dokumentat apo provat e tjera shkresore që ai i liston në kërkesën që i paraqit Gjykatës Kushtetuese, duhet që domosdoshmërisht të jenë edhe bashkëlidhur. Sipas nenit 29, pika 1 dokumentat që i bashkëlidhen kërkesës janë **a)** Akti i përfaqësimit, kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi; **b)** Kopje të aktit që është objekt i kërkesës dhe **c)** Dokumente origjinale ose të noterizuara, ose prova shkresore që kanë lidhje me çështjen në shqyrtim.

Në jurisprudencën e saj Gjykata Kushtetuese është shprehur se ngritja e një pretendimi mbi cilësinë e kërkujeses e pa shoqëruar me aktin përkatës që provon këtë vendim e bën kërkesën të paplotë.<sup>762</sup> Po kështu nga Gjykata, kërkesa është konsideruar e paplotë në ato raste kur nuk është shoqëruar me aktin e përfaqësimit duke vendosur sipas rastit se në cilën fazë ndodhej shqyrtimi i kërkesës, pushimin e gjykimit<sup>763</sup> ose moskalimin e çështjes në seancë.<sup>764</sup> Kjo vendimmarrje bazohet në argumentin se në rast se përfaqësuesi nuk e ka pasur tagrin për të përfaqësuar kërkujesin në një gjykim kushtetues, atëherë edhe kërkesa e bërë prej tij, pa autorizim të shprehur nga i përfaqësuesi, është inekzistente në kuptimin procedural.

Në rastet kur kërkesa bëhet nga organe kolegjiale, atëherë ajo duhet që të shoqërohet me vendimin e këtij organi. Në rast se një kërkesë paraqitet përpara Gjykatës Kushtetuese nga Këshilli i Qarkut/Bashkiak, Kuvendi, Këshilli i Ministrave, Këshilli i Lartë i Drejtësisë apo Konferenca Kombëtare Gjyqësore, ajo duhet që të shoqërohet me vendimin përkatës të organit kolegjial.<sup>765</sup> Në këto raste, vendimi i tyre nuk është i nevojshëm që të jetë i detajuar dhe shterues për sa i përket pretendimeve për cënimin e të drejtave apo parimeve kushtetuese. Detajimi i plotë në këtë rast bëhet në kërkesën që i dërgohet Gjykatës Kushtetuese, por me kusht që kjo kërkesë të mos shtojë pretendime apo kërkitime të tjera tej atyre të përcaktuara në vendimin e organit kolegjial. Mungesa e këtij vendimi sjell si pasojë mungesën e tagrit të titullarit të organit kolegjial për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese dhe për rrjedhojë, moslegjitimitimin e subjektit që i drejtohet.<sup>766</sup> Ndërsa në rastin kur kërkesa ka tejkalluar pretendimet e përcaktuar në

<sup>762</sup> Vendimi nr.30, datë 22.02.2013, i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese: *Konkretisht, Kolegji vëren se kërkujesja pretendon se vepron në cilësinë e trashëgimtares së S.H., i cili ka qenë palë në gjykimet objekt kërkesë. Megjithatë, kërkujesja nuk i ka bashkëngjitur kërkesës asnjë akt zyrtar që të provojë cilësinë e saj si trashëgimtare. ...Në kushtet kur kërkujesja nuk ka vënë në dispozicion të Gjykatës një vendim të tillë, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk është e plotë dhe si e tillë i duhet kthyer kërkujeses në mënyrë që ajo ta plotësojë, duke i bashkëngjitur një kopje autentike të vendimit gjyqësor për çeljen e trashëgimisë së S.H.*

<sup>763</sup> Vendimi nr.213, datë 16.11.2001 i Gjykatës Kushtetuese: *Avokati V.D., në emër të të gjykuarit G.M., ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.167, datë 27.2.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore rezultoi se avokati V.D., nuk është pajisur me prokurë nga ana e kërkujesit për ta përfaqësuar atë përpara Gjykatës Kushtetuese. Në këto kushte, avokati nuk mund ta përfaqësojë atë e, për pasojë, nuk mund të paraqesë kërkesë në emër të tij. Në këto rrethana duhet të vendoset pushimi i gjykimit të çështjes.*

<sup>764</sup> Vendimi nr.99, datë 25.09.2012 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese: *...sipas nenit 29/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i kërkujesit, kërkesës i bashkëlidhet, inter alia, edhe akti i përfaqësimit. Në rastin konkret Kolegji ka konstatuar se edhe pas kërkesës për vënien në dispozicion të aktit të përfaqësimit, ky dokument nuk rezultoi të jetë dërguar nga mbrojtësi ligjor që ka përpiluar dhe paraqitur kërkesën në emër të kërkujesit. Nisur nga sa më sipër, Kolegji vlerëson se nuk mund të vihet në lëvizje gjykimi kushtetues për shkelje të nenit 42 të Kushtetutës.*

<sup>765</sup> Në këtë rast për Kuvendin, Këshillin e Ministrave, Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Konferencën Kombëtare Gjyqësore, flitet vetëm si subjekte që mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese në rast se pretendojnë cënim të kompetencave të tyre, pra në rastin e gjykimit kushtetues të mosmarrëveshjes së kompetencave.

<sup>766</sup> Vendimi nr.52, datë 20.4.2012 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese: *Në vështrim të standardeve kushtetuese që zbatohen në rastet e mosmarrëveshjeve të kompetencave, pozitës kushtetuese dhe ligjore të KLD-së, si organ kolegjial dhe, rrethanave konkrete të çështjes, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se për sa i përket legjitimitimit formal dhe procedural, zëvendëskryetari i KLD-së nuk justifikon interesin për të vënë në lëvizje gjykimin*

vendimin e organit kolegjal, atëherë kjo pjesë e kërkesës nuk do të merret në konsideratë dhe nuk do të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, duke u legjitimuar subjekti vetëm pjesërisht.

I njëjti arsyetim vlen edhe në rastin e kërkesave të paraqitura nga subjektet e tjera kushtetuese si bashkësitë fetare, partitë politike dhe organizatat e tjera. Kushtetuta dhe LGJK-ja është totalisht indiferente në lidhje me faktin se cili organ i brendshëm i këtyre subjekteve duhet që të vendosë për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese. Kjo është një çështje e rregullimit të brendshëm dhe për rrjedhojë përcaktohet në statutet e tyre. Megjithatë në ato raste kur këto statute këtë të drejtë nuk ja kanë lënë si kompetencë organeve individuale të tyre por organeve kolegjiale, atëherë në këto raste duhet domosdoshmërisht ekzistenca e një vendimi të tillë që të autorizojë organin drejtues individual (nëse ka) ose persona të tjera për të hartuar dhe paraqitur kërkesën në Gjykatën Kushtetuese. Edhe në këto raste kërkesa duhet që të mos tejkalojë pretendimet e cituara në vendimin e organit kolegjal. Ajo (kërkesa), mund të jetë me e detajuar dhe më shteruese në lidhje me këto pretendime, por jo të shtojë të tjera. Edhe në këtë rast mungesa e këtij vendimi, e bën kërkesën të paraqitur nga titullari përkatës jashtë tagrave të tij dhe për rrjedhojë do të kemi moslegjitimin e kërkuarit.<sup>767</sup>

Kriteri i fundit që citohet në nenin 28 germa "e" të LGJK-së dhe që duhet të përmbajë kërkesa është nënshkrimi i kërkuarit ose i përfaqësuesit të tij. Nënshkrimi i cili në këtë rast duhet të jetë i plotë duke përfshirë emrin, mbiemrin dhe siglën e kërkuarit, shërben për të vërtetuar vullnetin e kërkuarit për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese nëpërmjet kërkesës së nënshkruar prej tij. Në rastin e autoriteteve publike, nënshkrimi bëhet nga titullarët e këtyre institucioneve, kurse në rastin e partive politike, bashkësive fetare dhe organizatave të tjera nga drejtuesit ekzekutivë të tyre, ose nga përfaqësuesit e autorizuar prej tyre. Mungesa e nënshkrimit sjell si pasojë mospranimin e kërkesës për shqyrtim.

Të dyja dispozitat, neni 28 dhe neni 29 kërkojnë që si kërkesa dhe dokumentet që e shoqërojnë të bëhen në aq kopje sa janë palët që do të marrin pjesë në gjykim. Ky detyrim rëndon mbi kërkuarin për të bërë kopje të akteve vetëm për gjykatën dhe palët që ai ka përcaktuar në kërkesën e tij. Nëse Gjykata Kushtetuese, do të çmojë të thërrasë edhe persona të tjerë atëherë, është në detyrimin e saj që sëbashku me njoftimin të përgatisë kopje të akteve edhe për këtë subjekt.

---

*kushtetues në kuptim të neneve 131, germa "ç" dhe 134 germa "f" të Kushtetutës. Zëvendëskryetari i KLD-së, të cilin ligji organik i njeh vetëm kompetenca organizative, drejtuese dhe kontrolluese, nuk mund të ushtrojë në mënyrë të pavarur kompetenca të cilat i takojnë organit kolegjal ku ai bën pjesë. Si përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se, në kushtet kur kërkesa është paraqitur nga zëvendëskryetari i KLD-së pa e pasur një kompetencë të tillë kushtetuese dhe pa qenë i pajisur me tagra përfaqësimi nga KLD-ja për të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues, kërkuari nuk plotëson kushtet për legjitimitimin racione personae.*

<sup>767</sup> Vendimi nr.40, datë 06.05.1999 i Gjykatës Kushtetuese: Sipas nenit 9 të Statutit, organet drejtuese të Shoqatës janë Mbledhja e Përgjithshme dhe Këshilli Drejtues, ndërsa sipas nenit 11/4 të tij veprimtaria e përgjithshme e Shoqatës dhe ajo që lind gjatë një-dy muajve drejtohet nga Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm. Pra, siç shihet, statuti udhëhiqet nga parimi i kolegjalitetit si në ndërtimin e organeve të tij ashtu edhe në veprimtarinë e këtyre organeve. Në periudhën midis dy Mbledhjeve të Përgjithshme, ai ka ngarkuar Këshillin Drejtues të drejtojë veprimtarinë e Shoqatës ndërsa për "veprimtarinë e përgjithshme" dhe për ato probleme që dalin gjatë periudhës midis dy mbledhjeve të Këshillit, statuti ka ngarkuar jo vetëm Kryetarin dhe as vetëm Sekretarin e Përgjithshëm, por të dy së bashku. Në çështjen në shqyrtim nuk ka ndonjë vendim të organeve drejtuese të Shoqatës, Mbledhjes së Përgjithshme ose Këshillit Drejtues për të ngritur paditë në Gjykatën Kushtetuese, me objekt papajtueshmërinë me Kushtetutën të nenit 48 të Ligjit nr.8436, datë 28.12.1998, siç kërkon neni 47 i Kodit Civil dhe as kërkesë të përbashkët të Kryetarit e Sekretarit të Përgjithshëm siç lejon neni 11/4 i Statutit të Shoqatës. Ka vetëm një kërkesë të nënshkruar nga Kryetari i Shoqatës dhe një prokurë me të cilën ka caktuar avokat të nënshkruar po prej tij. Duke qëndruar çështja si më sipër, vetëm kryetari i shoqatës duke mos qenë përfaqësuesi i saj, sipas Kodit Civil e Statutit të Shoqatës, nuk legjitimohet të vejë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese në kuptim të nenit 134 të Kushtetutës.

Gjithsesi në varësi të subjektit që vë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese dhe llojit të gjykimit kërkesat mund të ndryshojnë si në formë edhe në përmbajtje. Kështu kërkesat që paraqiten nga autoritetet publike, të cilat synojnë mbrojtjen e interesit publik, kryesisht nëpërmjet kontrollit abstrakt të normës juridike, nuk janë të njëjta në përmbajtje dhe në formë me kërkesat e paraqitura nga individët,<sup>768</sup> por në vija të përgjithshme këto kërkesa duhet që të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga LGJK-ja dhe të analizuar më sipër.

Këto janë kushte për ekzistencën formale të kërkesës dhe për këtë arsye janë kriteret e para që verifikohen nga Gjykata Kushtetuese. Vetëm në rast se kërkesa i përmban të gjitha elementët e përshkruara më sipër atëherë ajo është formalisht e aftë që të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese dhe ta detyrojë atë që të shprehet me një vendim.

## 2.2 Njoftimi.

Njoftimi është një tjetër akt procedural i rëndësishëm. LGJK e përmend njoftimin si veprim procedural në 10 dispozita dhe konkretisht në nenet 28 pika 2 (njoftimi i kërkesës), 29 pika 2 (njoftimi i akteve që i bashkëlidhen kërkesës), 38 (njoftimi dhe pjesëmarrja në seancë), 44 pika 2 (riçelja e seancës), 45 pika 2 (njoftimi i vendimit të pezullimit të aktit), 69 pika 2 (njoftimi i gjykatës dhe i subjekteve të interesuara në rastin e gjykimit incidental), 70 pika 3, (njoftimi i vendimit të Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave), 72 pika 4 (njoftimi për datën e shpalljes së vendimit), 78 (njoftimi i vendimit organeve përkatëse), 85 (detyrimi për publikimin e njoftimeve). Këto dispozita ligjore në zbatim të nenit 1 pika 2 të LGJK plotësohen më tej me rregullat mbi njoftimet të përcaktuara në Pjesën e Parë, Titullin VI, Kreu IV, nenet 128 – 144 të K.Pr.C.

Njoftimi si veprim procedural është një parakusht i domosdoshëm për realizimin e të drejtave të pjesëmarrësve në një gjykim kushtetues për një proces të rregullt ligjor. Për këtë arsye, njoftimi tashmë si akt procedural ka rëndësi të jashtëzakonshme. Nëpërmjet tij palët e ndryshme marrin dijeni për zhvillimin e procesit kushtetues dhe u krijon atyre mundësi për të përgatitur strategjinë e tyre juridike që do të ndjekin. Përsa i përket përmbajtjes së njoftimit, si akt procedural neni 38 pika 1 e LGJK-së kërkon vetëm që në të shënohet data dhe ora në të cilën do të zhvillohet seanca plenare e Gjykatës Kushtetuese për gjykimin e kërkesës përkatëse që e ka vënë në lëvizje atë. Por referuar përmbajtjes së nenit 129 të K.Pr.Civile, rezulton se njoftimi i Gjykatës Kushtetuese, duhet që të përmbajë edhe Gjykatën që e dërgon, identitetin e kërkuesit, të subjekteve të interesuara, mosmarrëveshjen për të cilën thirret, si dhe pasojat ligjore në rast se personi i thirrur nuk paraqitet në gjykatë. Në këtë rast duhet të njoftohet detyrimisht kërkuesi, subjektet e interesuara dhe/apo përfaqësuesit e tyre

Që njoftimi të jetë i rregullt duhet që domosdoshmërisht të respektohen kërkesat ligjore për kryerjen e njoftimit. Mosrespektimi i këtyre rregullave sjell si pasojë pavlefshmërinë e njoftimit dhe shtyrjen e seancës. Rregullat kryesore të njoftimit janë vendosur në nenin 38 pika 3 të LGJK, sipas të cilit njoftimi mund të bëhet në katër mënyra.

Dy mënyrat e parashikuara nga dispozita dhe të konsideruara normale si mënyra njoftimi, përfshijnë njoftimin me shkresë zyrtare ose me fletë-thirrje postare. Rasti i parë zbatohet për njoftimet të cilat bëhen brenda qytetit të Tiranës ku ka edhe selinë Gjykata Kushtetuese, ndërsa rasti i dytë bëhet për subjektet të cilët kanë vendbanimin apo selinë në qendrat e tjera banuese jashtë kryeqytetit. Në rastin e njoftimit me shkresë zyrtare dispozita përcakton se njoftimi u dorëzohet personalisht palëve, apo personave madhorë të familjes. Njoftimi si rregull bëhet në

<sup>768</sup> Sadushi, Sokol, "Drejtësia Kushtetuese në Zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq.359.



vendbanimin ose vendqëndrimin e marrësit ose në zyrën, apo vendin ku ushtron veprimtarinë tregtare, industriale ose të artizanatit.<sup>769</sup> Nëse kjo mënyrë njoftimi nuk është e mundur atëherë njoftimi mund të bëhet edhe nëpërmjet fqinjëve, që pranojnë t'ia dorëzojnë atë personit të thirrur, zyrës ose qendrës së punës së tij, përveçse kur i thirruri është i mitur, nën gjashtëmbëdhjetë vjeç, ose është i pazoti për të vepruar. Kur nuk është e mundur të bëhet njoftimi, sipas këtij parashikimi, kopja e njoftimit i dorëzohet portierit të ndërtesës së banimit, të zyrës apo të qendrës së punës.<sup>770</sup>

Pala, përfaqësuesi, apo personi që merr përsipër të njoftojë palën, duhet që të nënshkruajë origjinalin ose kopjen e saj.<sup>771</sup> Në rast se personi refuzon marrjen në dorëzim, nëpunësi gjyqësor bën shënimin përkatës në letërthirrje dhe kur është e mundur e vërteton me nënshkrimin e një dëshmitari të pranishëm.<sup>772</sup>

Për njoftimin që bëhet me fletë-thirrje postare duhet që nëpunësi gjyqësor duhet të shënojë mbi origjinalin dhe mbi kopjen e njoftimit edhe zyrën e postës nëpërmjet së cilës i është dërguar kopja marrësit, me dërgesë të porositur. Dëftesa e marrjes në dorëzim duhet t'i bashkohet origjinalit të aktit.<sup>773</sup> Njoftimi i akteve nëpërmjet postës njihet edhe nga juridiksionet e huaja kushtetuese.<sup>774</sup> Në këtë rast data e njoftimit apo marrjes dijeni konsiderohet vula e zyrës postare mbi zarf.

Për personat që nuk u dihet vendqëndrimi në Republikën e Shqipërisë ose që ndodhen jashtë vendit, nenit 38, pika 3 e LGJK-së përcakton që njoftimi në këtë rast bëhet me shpallje në selinë e Gjykatës Kushtetuese, ku qëndron e shpallur për të paktën një muaj. Ky parashikim vlen edhe për pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues që nuk i dihet vendqëndrimi ose ndodhet me qëndrim të përhershëm jashtë shtetit. Por, jam i mendimit se ky parashikim është problematik në raport me parashikimin e nenit 133 të K.Pr.C. i cili përcakton se në rastin e personave që nuk u dihet vendbanimi në Shqipëri njoftimi i aktit bëhet nëpërmjet afishimit të kopjes në gjykatën e vendit, ku do të gjykohet mosmarrëveshja, si dhe në vendin e afishimit, ku ka pasur vendbanimin e fundit. Në këtë rast, konflikti midis këtyre dy ligjeve zgjidhet në favor të LGJK-së, pasi pavarësisht se të dy këto ligje (LGJK-ja dhe K.Pr.C) miratohen me shumicë të cilësuar,<sup>775</sup> LGJK-ja është ligji i posaçëm (*lex specialis*) që rregullon veprimtarinë procedurale të Gjykatës Kushtetuese, ndërsa K.Pr.C. përbën në këtë rast një ligj të përgjithshëm (*lex generalis*) i cili në zbatim të nenit 1, pika 2 të LGJK-së thirret për zbatim nga Gjykata Kushtetuese vetëm në ato raste kur vetë ligji i saj organik nuk ka një rregullim specifik për rastin konkret, pra shërben si legjislacion plotësues.

Megjithatë, duket sikur kjo zgjidhje krijon disa pasoja për subjektet pjesëmarrëse në gjykimin kushtetues. Kështu duke u bërë afishimi vetëm në selinë e Gjykatës Kushtetuese bëhet i vështirë marrja dijeni për personat të cilët banojnë jashtë kryeqytetit. Pavarësisht se në rastin e kërkuarit, i cili ka bërë kërkesën ka detyrimin që të ndjekë fatin e çështjes së tij, në rastin e subjekteve të interesuara, për të cilët vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese mund të sjellë

<sup>769</sup> K.Pr.C., neni 131.

<sup>770</sup> Po aty

<sup>771</sup> Po aty

<sup>772</sup> K.Pr.C., neni 130.

<sup>773</sup> K.Pr.C., neni 143.

<sup>774</sup> Momcinovic, Hrvoje, "Contesting the arbitration decision in the proceedings before the constitutional court according to the croatian law", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15", botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998, fq. 79.

<sup>775</sup> Sipas nenit 81, pika 2, gërmat "a" dhe "d" të Kushtetutës



pasoja, ky moment bëhet problematik. Kështu ata mund të mos e dinë që ndaj tyre po zhvillohet një tjetër gjykim në Gjykatën Kushtetuese, mbi të gjitha mbasi kanë ezauruar të gjitha shkallët e tjera të gjykimit. Për këtë arsye është e nevojshme që dispozita të plotësohet duke vendosur edhe detyrimin për afishimin e njoftimit edhe në vendbanimin e fundit të subjekteve të interesuara në Republikën e Shqipërisë.

Për më tepër nisur nga mënyra se si është formuluar neni 38, pika 3 e LGJK, rezultojnë se njoftimi me shpallje bëhet në të gjitha rastet për palët që kanë qëndrim jashtë vendit pavarësisht faktit nëse u dihet apo jo adresa e banimit. Megjithatë një ligj procedural që duhet të marrë në konsideratë Gjykata Kushtetuese në këtë rast është edhe Konventa "Për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në fushën civile dhe tregtare", në të cilën Shqipëria ka aderuar me ligjin nr. 9554, datë 8.6.2006. Në këtë konventë ka rregulla të mirëpërcaktuara për njoftimin e akteve gjyqësore jashtë vendit. Referuar nenit 1, pika 2 të kësaj Konvente rezultojnë se ajo nuk zbatohet vetëm kur nuk dihet adresa e personit të cilit do t'i dërgohet dokumenti. Për rrjedhojë Gjykata Kushtetuese duhet që në çdo rast nëse ka të bëjë me palë të cilët ndodhen jashtë shtetit, por u dihet adresa në zbatim të nenit 122 të Kushtetutës duhet të shmangë parashikimin e nenit 38, pika 3 të LGJK-së dhe të zbatojë Konventën e sipërcituar.

Këto mënyra njoftimi shërbejnë për njoftimin e palëve private që përfshihen në gjykimin kushtetues. Në rastin e autoriteteve publike apo personave juridikë kuptohet që procedura është më e thjeshtë. Kështu njoftimet për institucionet, ndërmarrjet dhe personat e tjerë juridikë shtetërorë bëhet nëpërmjet dorëzimit të kopjes zyrës së titullarit dhe personave të ngarkuar për të pranuar akte. Kurse njoftimi për personat juridikë joshtetërorë bëhet në qendrën e tyre, nëpërmjet dorëzimit të kopjes së aktit përfaqësuesit ose personit të ngarkuar për të marrë njoftimin dhe në mungesë të tyre, një personi tjetër që punon në këtë qendër të personit juridik.<sup>776</sup>

Dy mënyrat e tjera që parashikon neni 38, pika 3 e LGJK-së është njoftimi në raste të ngutshme me telegram apo faks. Dispozita në këtë rast vetëm sa i citon si raste por nuk detajon më tej mënyrën e realizimit të këtyre dy llojeve njoftimesh. Kështu që edhe në këtë rast duhet që t'i referohemi K.Pr.C. dhe përkatësisht nenit 144 i cili parashikon se gjykata mund të urdhërojë me vendim edhe mënyra të tjera njoftimi nga ato të parashikuara nga ligji, si nëpërmjet telegramit me përgjigje, me faks, kur vërtetohet me shkrim marrja e tij, kur e kërkojnë rrethana të veçanta ose nevoja e një njoftimi të shpejtë. Duke interpretuar bashkarisht këto dy dispozita rezultojnë se këto dy mënyra njoftimi mund të bëhen vetëm në raste tepër të ngutshme,<sup>777</sup> por është e domosdoshme që në dosje të administrohen edhe konfirmimet përkatëse për marrjen dijeni nga këto mënyra njoftimi që në këtë rast janë përgjigjja për telegramin i cili realizohet nëpërmjet një telegrami tjetër që i kthehet gjykatës ose dërgimi i një vërtetimi me shkrim i marrjes dijeni për faksin e dërguar.

Në praktikën e Gjykatës Kushtetuese, rezultojnë që të jenë kryer njoftime edhe me mënyra të tjera. Kështu nga praktika e Gjykatës Kushtetuese rezultojnë të jetë zbatuar edhe njoftimi me telefon.<sup>778</sup> Kjo lloj mënyre njoftimi nuk gjendet e parashikuar në LGJK-në dhe po kështu nuk

<sup>776</sup> K.Pr.C., neni 141.

<sup>777</sup> Psh: në rastin e gjykimeve kushtetuese të vlerësimit të arrestit në flagrancë për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë.

<sup>778</sup> Vendimi nr.29, datë 1.3.2012 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese: *...pas kontaktimit në rrugë telefonike të kërkuesit nga Drejtoria Gjyqësore e kësaj Gjykate, ai konfirmoi se nuk është pajisur me ndonjë licensë të tillë dhe as ka nënshkruar ndonjë marrëveshje për ushtrimin e këtij aktiviteti.* Mesa duke në këtë rast komunikimi kishte si qëllim marrjen e informacionit për plotësimin e dokumentacionit, por jemi të mendimit se në këtë rast Kolegji i Gjykatës Kushtetuese duhet që të vendoste kthimin e kërkesës për plotësimin e të metave dhe jo të komunikonte në rrugë telefonike, mbi të gjitha kur një komunikim i tillë vështirë që të provohet se ka ndodhur.

gjendet e parashikuar edhe në K.Pr.C. Njoftimi me telefon parashikohet vetëm në K.Pr.P. dhe konkretisht në nenin 133 të tij, i cili me sa duket është përzgjedhur nga gjykata si ligji i zbatueshëm në këtë rast. Megjithatë referuar kësaj dispozite rezulton se ky njoftim bëhet vetëm në raste të ngutshme, duke u shënuar numri i telefonit të kërkuar, emri dhe detyra që kryen personi që merr njoftimin, marrëdhëniet e tij me atë që njoftohet, data dhe ora e telefonatës. Për më tepër në mënyrë që njoftimi me telefon të konsiderohet i rregullt duhet që të merret edhe konfirmimi i marrësit me anë të telegramit. Të gjitha këto kërkesa ligjore, nga arsyetimi që gjendet në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nuk rezulton të jenë ndjekur, duke e bërë të diskutueshëm vlefshmërinë e këtij njoftimi të bërë prej saj. E rëndësishme është që në çdo rast kur Gjykata Kushtetuese ndjek procedura njoftimi të ndryshme nga ato standarde të ndjekë me korrektësi marrjen e konfirmimeve përkatëse. Këto konfirmime kërkojnë në mënyrë që gjykata të ketë aftësinë të përcaktojë nëse pala pjesëmarrëse ka marrë dijeni efektivisht apo jo për seancën gjyqësore. Marrja dijeni për procesin gjyqësor është një kusht *sine qua non* pa të cilin procesi nuk mundet që të ecë më tej, për vetë rëndësinë që ka njoftimi si parakusht për të gjitha të drejtat e tjera procedurale që kanë palët në një gjykim.

Rregullat e mësipërme zbatohen edhe për njoftimin e akteve të tjera të Gjykatës Kushtetuese, kërkesës dhe akteve që i bashkëlidhen, vendimeve gjyqësore etj.

### 2.3 Procesverbali gjyqësor.

Procesverbali gjyqësor, si akt procedural, cilësohet dokumenti publik të cilin e përpilon gjykata për veprime procedurale të kryera gojarisht, në seancë apo jashtë seancës, nga palët ndërgjyqëse dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë.<sup>779</sup>

Nga ky formulim, rezulton se qëllimi i procesverbalit gjyqësor është të dokumentojë dhe të pasqyrojë veprimet verbale që kryhen midis palëve dhe gjykatës gjatë seancës gjyqësore. Duke qenë se edhe faza e shqyrtimit me gojë ka rëndësinë e saj të posaçme në një gjykim, përfshirë edhe gjykimin kushtetues, dokumentimi i kësaj faze nëpërmjet procesverbalit merr rëndësi të jashtëzakonshme. LGJK-ja këtë akt procedural e rregullon në nenin 46 të tij ku përcaktohet se në seancën plenare të Gjykatës Kushtetuese mbahet procesverbal, i cili, në përfundim të saj, nënshkruhet nga kryesuesi i seancës plenare dhe sekretari që e mban atë. Nga ky formulim rezulton se forma e procesverbalit është e shkruar (megjithëse del indirekt) dhe në përputhje me nenin 22 të LGJK-së mbahet në gjuhën shqipe. Tjetër element të formës që përcakton dispozita është nënshkrimi i tij i cili bëhet nga kryesuesi i seancës plenare dhe nga sekretari që e mban atë. Për element të tjerë të formës dhe të përmbajtjes jemi të detyruar që t'i referohemi K.Pr.C., i cili procesverbalin gjyqësor e rregullon veçanërisht në nenet 77, 118, 172 dhe 177.

Kështu për çdo veprim të kryer nga gjykata mbahet procesverbali përkatës, i cili duhet që në çdo rast t'i tregojë gjykatës identitetin e pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues përfaqësuesit e tyre, faktin nëse janë paraqitur apo jo. Sekretari që mban procesverbalin duhet të shënojë përmbledhjen e saktë të kërtimeve, të kundërshtimeve të palëve dhe të personave të tretë, të thënieve të dëshmitarëve dhe të ekspertëve, provat me shkresë që janë paraqitur, përmbajtja e shiritave të magnetofonit, e diapozitivave, e filmave, të gjitha vendimet që ka dhënë gjykata në vazhdim të gjykimit, si dhe pretendimet përfundimtare të palëve.

Është e kuptueshme që gjithë kjo veprimtari procedurale mbahet në mënyrë të përmbledhur nga ana e sekretarit gjyqësor, duke qenë e pamundur që të mbahet në mënyrë të plotë. Për këtë arsye referuar përmbajtjes së neneve 118, pika 3 dhe 177, pika 2 të K.Pr.Civile,

<sup>779</sup> Uka, Njazi, "Fjalori i Drejtësisë", Shtëpia Botuese "Iliri" P.F., Tiranë 2011, fq.593

palët pjesëmarrëse në gjykimin kushtetues kanë të drejtë që të kërkojnë që thenie të caktuar të palëve të tjera të shënohen *motu mo* (fjalë për fjalë) në procesverbalin gjyqësor dhe jo në mënyrë të përmbledhur. Kjo bëhet në ato raste kur synohet që të merret një pohim gjyqësor. Po kështu palët kanë të drejtë që të kërkojnë që të shënohet në procesverbal edhe veprime të caktuara të kryesuesit të seancës të cilat palët mendojnë se janë të kundraligjshme.

Për vetë rëndësinë që ka, procesverbali gjyqësor në përfundim të gjykimit bëhet pjesë e pandarë e dosjes gjyqësore.

## 2.4 Akte të tjera procedurale (relacioni/mendimi/opinion).

Për vetë karakteristikat që ka gjykimi kushtetues, në veprimtarinë e tij procedurale rezultojnë edhe një sërë aktesh të tjera të cilat janë të domosdoshme në këtë lloj gjykimi. Kështu LGJK-ja përcakton se përgatitja e çështjes paraprakisht bëhet nga një gjyqtar relator i caktuar nga kryetari i gjykatës<sup>780</sup> dhe se në seancë relatori lexon kërkesën.<sup>781</sup> Pavarësisht faktit se në këtë rast nuk përmendet shprehimisht relacioni si akt procedural, vetë fakti që njëri prej anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese caktohet si relator i çështjes, tregon se në këtë rast ai për kolegët e tij përgatit patjetër një relacion në lidhje me çështjen e paraqitur për shqyrtim dhe materialet që ndodhen në dosje. Po kështu këto dispozita të LGJK duhet të shihen të lidhura edhe me nenet 464<sup>782</sup> dhe 483<sup>783</sup> të K.Pr.C. të cilat përcaktojnë relacionin si akt procedural të rëndësishëm në gjykimin në apel dhe në Gjykatën e Lartë. Vërejmë pra, se në ato rast kur kemi gjykim kolegial si rregull relacioni është një pjesë e dosmodshme e dosjes gjyqësore. Ajo u mundëson anëtarëve të tjerë që të kenë njohuri në lidhje me çështjen dhe materialet që ndodhen në fashikullin e gjykimit.

Gjithsesi në Rregulloren e Brendshme të Gjykatës Kushtetuese “Mbi gjykimin kushtetues dhe veprimtarinë e administratës” gjejmë formulime në lidhje me përmbajtjen dhe formën e këtij akti procedural. Po kështu, në këtë akt vërejmë se në dosjen gjyqësore administrohen dhe bëhen pjesë përbërëse të tij disa relacione. Duke ndjekur etapat procedurale që ndjek një kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese, këto relacione janë:

**1. Relacioni i këshilltarit të gjyqtarëve.** Siç e kemi sqaruar më sipër, kur folëm për organizimin të brendshëm të Gjykatës Kushtetuese, pranë këtij institucioni funksionon edhe ajo strukturë që rregullorja e quan grupi i këshilltarëve. Ky grup përbehet nga nëntë këshilltarë, pra nga një këshilltar për çdo gjyqtar. Referuar neneve 6, pika 1,<sup>784</sup> 7, pika 2 gërma “b”<sup>785</sup> dhe 27, pika 3, fjalia e parë<sup>786</sup> e Rregullores së Gjykatës Kushtetuese, rezulton se gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës nga Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, të tre gjyqtarëve që do të shqyrtojnë kërkesën dhe materialet e çështjes nëse plotësohen ose jo kushtet për ta kaluar çështjen në seancë plenare, u vihet në dispozicion (përveç kërkesës dhe materialeve të tjera të sjellë nga kërkuesi) relacioni i këshilltarit të gjyqtarit relator. Duke interpretuar bashkarisht nenin 483 të K.Pr.C. dhe

<sup>780</sup> LGJK, neni 27, pika 2.

<sup>781</sup> LGJK, neni 43 gërma “d”.

<sup>782</sup> K.Pr.C., neni 464: *Seanca gjyqësore fillon me relacionin e njërit prej anëtarëve të trupit gjykues.*

<sup>783</sup> K.Pr.C., neni 483: *Në seancë gjyqësore relatori paraqet faktet që kanë rëndësi për marrjen e vendimit, përmbajtjen e vendimit të ankimuar dhe shkaqet e rekursit dhe të kundërrekursit.*

<sup>784</sup> Rregullorja, neni 6, pika 1: *Të paktën dy ditë para mbledhjes së kolegjit, gjyqtarët duhet të kenë në dispozicion materialin e përgatitur nga këshilltari i relatorit, i cili i bashkëlidhet materialeve të tjera të dosjes. Relatimi i kërkesës në kolegji bëhet nga gjyqtari relator.*

<sup>785</sup> Rregullorja, neni 7, pika 2, gërma “b”: *Relacioni me shkrim i këshilltarit të paraqitur në Kolegj.*

<sup>786</sup> Rregullorja, neni 27, pika 3: *Këshilltari jep mendimin e tij për kalimin ose jo të kërkesës për gjykim.*



nenin 27, pika 3 të Rregullores rezulton se ky relacion i këshilltarit duhet domosdoshmërisht që të përmbajë përmbajtjen e aktit normativ, administrativ apo gjyqësor të ankimuar, shkaqet e parashtruara në kërkesë, faktet që kanë rëndësi për marrjen e vendimit dhe mendimin e këshilltarit për kalimin ose jo të çështjes në seancë plenare.

**2. Relacioni i gjyqtarit relator.** Referuar rregullores se Gjykatës rezulton se gjyqtari relator paraqet relacione në dy raste të ndryshme. *Rasti i parë*, ka të bëjë me situatën kur Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, nuk ka marrë vendim unanim për kalimin ose moskalimin e çështjes në seancë plenare. Në këtë rast çështja kalon për gjykim në mbledhjen e gjyqtarëve. Sipas nenit 7, pika 2 gërma "a" të Rregullores, paraprakisht për Mbledhjen e Gjyqtarëve, relatori përgatit relacionin e tij ku përshkruhet në mënyrë të përmbledhur përmbajtja e kërkesës, të shkaqeve dhe argumenteve të parashtruara nga kërkuesi si dhe argumentet pro dhe kundër kalimit të kërkesës në seancë plenare.

Ndërsa në *rastin e dytë* kemi të bëjmë me situatën kur çështja ka kaluar për gjykim në seancë plenare. Në këtë rast relatori i çështjes përgatit dosjen për gjykim ku ndër të tjera përfshihet edhe relacioni i tij përmbledhës.<sup>787</sup> Në lidhje me përmbajtjen e relacionin jam i mendimit se në këtë rast duhet ndjekur modeli gjerman. Në këtë vend, relacioni i cili quhet "*Votum*" përshkruan çështjen dhe faktet e saj, jurisprudencën e Gjykatës në lidhje me parimet e përfshira, literaturën ligjore, pretendimet e palëve në lidhje me çështjen dhe përfundon me qëndrimin personal të gjyqtarit se si duhet që të vendoset në lidhje me çështjen.<sup>788</sup> Duhet theksuar se nuk është ky relacioni që lexohet në seancë nga gjyqtari relator. Kjo pasi ligji në këtë rast specifikon se ai lexon kërkesën. Pra, nuk mund të flasim për paragjykim të çështjes, ku për më tepër sipas praktikës procedurale të Gjykatës Kushtetuese, relacioni përgatitet mbas zhvillimit të seancës.

**3. Opinioni i këshilltarit të gjyqtarit relator.** Mbas përfundimit të hetimit gjyqësor, këshilltari i gjyqtarit duhet që të hartojë një opinion me shkrim ku ai parashtron edhe njëherë faktet e çështjes, qëndrimet e palëve pjesëmarrëse, historikun e ecurisë së çështjes në Gjykatën Kushtetuese, por mbi të gjitha, ajo që ka rëndësi në këtë pjesë është mendimi i tij personal në lidhje me themelin e çështjes, pra, nese kërkesa duhet pranuar ose jo. Rregullorja e Gjykatës përcakton qartësisht se ky opinion konsiderohet pjesë e dosjes dhe ruhet në arkivin e institucionit.<sup>789</sup> Ky opinion është një vlerësim personal i këshilltarit të relatorit i cili nuk është detyruar për gjyqtarët, por ruan vlerat e veta sugjestionuese.

**4. Mendimet me shkrim të pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues.** Në faza të ndryshme të gjykimit kushtetues, pjesëmarrësit mund të paraqesin me shkrim pretendime e tyre. Në thelb në këto mendime me shkrim palët paraqesin opinion e tyre në lidhje me problemet materiale dhe formale që kanë të bëjnë me çështjen në shqyrtim. Rregullorja njih dy mendime të tilla. Mendimi i parë mund të paraqitet me shkrim nga palët mbasi çështja ka kaluar për gjykim, por ende nuk është zhvilluar seanca gjyqësore, moment ky i cili parashikohet nga neni 8, pika 3 e Rregullores.<sup>790</sup> Ky lloj mendimi i paraqitur në këtë fazë të gjykimit është paraprak, por i shërben

<sup>787</sup> Rregullorja, neni 8, pika 2 gërma "c".

<sup>788</sup> Kommers, Donald P.; Miller, Russel A.: "*The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany*", Shtëpia Botuese "Duke University Press", Londër 2012, fq.27.

<sup>789</sup> Rregullorja, neni 10, pika 1 gërma "a".

<sup>790</sup> Rregullorja, neni 8, pika 3: *Kur çështja kalon për gjykim në seancë, Drejtoria Gjyqësore dhe e Dokumentacionit u komunikon subjekteve të interesuara kërkesën për të paraqitur parashtrimet e tyre, brenda një afati të caktuar, para zhvillimit të seancës. Kopje e tyre i dërgohet edhe kërkuesisit.*



Gjykatës për të pasur një ide më të qartë në lidhje me debatin që do të zhvillohet midis palëve. Këto akte, bëhen pjesë e dosjes gjyqësore.<sup>791</sup>

Një tjetër moment ku palët mund të paraqesin mendimin e tyre me shkrim është në seancë plenare. Edhe në këtë rast këto mendime bëhen pjesë e dosjes gjyqësore.<sup>792</sup>

Për këto akte, nuk është e rëndësishme ruajtja e një forme apo strukture të caktuar. Këtu janë palët që i japin rëndësi, si formës dhe përmbajtjes së tyre, pasi në këto akte pasqyrohen të gjitha kërkimet, pretendimet dhe argumentat e tyre në lidhje me çështjen që ndodhet në gjykim.

## 2.5 Vendimi gjyqësor.

Vendimet gjyqësore që merren nga gjykata kushtetuese mund të jenë disa llojesh. Ato mund të jenë vendime të ndërmjetme të cilat i japin zgjidhje kërkesave të palëve në gjykim (vendimi për kalimin e çështjes në seancë plenare, vendimet për pezullimin e zbatimit të akteve, vendimet për administrimin e provave etj), mund të jenë vendime jo përfundimtare të cilat mbyllim gjykim e një çështjeje por nuk zgjidhin themelin e çështjes (vendimet e moskalimit në seancë plenare, të pushimit, apo të refuzimit) si edhe vendime përfundimtare (vendime rrëzimi apo pranimi etj).

Analiza e secilit prej llojeve të vendimeve që merr Gjykata Kushtetuese, si edhe natyra e tyre do të trajtohen në pjesët e tjera të këtij punimi duke i vendosur përkatësisht në fazat e ndryshme të gjykimit kushtetues dhe në llojet e gjykimit kushtetues. Në këtë pjesë do të trajtohet vendimi gjyqësor vetëm përse i përket formës së tij duke e lidhur këtë me natyrën si akt procedural që ka vendimi gjyqësor dhe rëndësinë që paraqet si akt juridik që shpall përfundimin e një gjykimi kushtetues.<sup>793</sup>

Siç e sqaruar më sipër vendimet gjyqësore janë të formave të ndryshme në varësi të situatës që ato i përgjigjen. Nëse i referohemi kategorisë së parë të vendimeve, atyre të ndërmjetme vërejmë se në shumicën e rasteve këto vendime përmbajnë vetëm disponimin e gjykatës në lidhje me kërkimet e palëve dhe një arsyetimin minimal për pranueshmërinë ose jo të kërimit të bërë nga pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues. Si rregull këto vendime pasqyrohen në procesverbalin e seancës gjyqësore, por nuk përjashtohet mundësia që të arsyetohen edhe veçmas por në çdo rast duke i'u bashkëlidhur procesverbalit gjyqësor si pjesë përbërëse e tij. Përjashtim bën vetëm vendimi i Kolegjit ose i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë, vendim i cili hartohet në bazë të një formulari tip dhe që nënshkruhet nga të gjithë gjyqtarët.<sup>794</sup>

Në lidhje me dy kategoritë e tjera të vendimeve gjyqësore atyre përfundimtare dhe jo përfundimtare, vërejmë se LGJK, nuk na jep treguesit përse i përket formës dhe përmbajtjes së tyre. Në këtë rast atëherë do të duhej që t'i referoheshim K.Pr.C. dhe përkatësisht neneve 126<sup>795</sup> dhe 310<sup>796</sup> duke u zbatuar mutatis mutandis për vendimet gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>791</sup> Rregullorja, neni 8, pika 2, gërma "ç".

<sup>792</sup> Rregullorja, neni 8, pika 1, gërma "b".

<sup>793</sup> Sadushi, Sokol, "Drejtësia Kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq.375

<sup>794</sup> Rregullorja, neni 6, pika 2 dhe neni 7, pika 4.

<sup>795</sup> K.Pr.C., neni 126: *Vendimi përfundimtar jepet nga gjykata në përfundim të gjykimit i cili zgjidh çështjen në themel. Vendimi përfundimtar, si dhe vendimet që i japin fund procesit gjyqësor civil të parashikuara prej nenit 127 të këtij Kodi jepen në "Emër të Republikës" dhe përkatësisht duhet të përmbajnë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyra e zgjidhjes së saj.*

<sup>796</sup> K.Pr.C., neni 310: *Vendimi duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese. I Në hyrjen e vendimit duhet të përmenden: 1) gjykata që ka gjykuar çështjen, 2) trupi gjykues dhe sekretari, 3) koha dhe*

Kjo zgjidhje sugjerohet edhe nga neni 1, pika 2 e LGJK që lejon përdorimin e normave të tjera procedurale në ato raste kur vetë ligji organik i gjykatës nuk përmbante rregullime të veta. Pavarësisht këtyre parashikimeve Rregullorja e Gjykatës përcakton se vendimi përgatitet sipas një strukture të miratuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve. Për të bërë një interpretim pajtues në këtë rast është e nevojshme që Mbledhja e Gjyqtarëve t'i shtojë përmbajtjes dhe formës së vendimit elementë dytësorë që lidhen me karakteristikat që ka një gjykim kushtetues, por jo të ndryshojë në mënyrë thelbësore strukturën e përcaktuar nga normat juridike të sipërcituara.

Nga një analizë tërësore e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, si të atyre përfundimtare dhe atyre jopërfundimtare, rezulton se këto vendime, ashtu si edhe vendimet gjyqësore, lidhur me formën që paraqesin, kanë tri pjesë kryesore: *pjesën hyrëse*, ku përfshihen titulli, përbërja e gjykatës, paraqitja e të dhënave të subjekteve pjesëmarrëse në procesin kushtetues, data e zhvillimit të seancës plenare, si edhe të dhënat për sekretarinë gjyqësore; *pjesën arsyetuese*, në të cilën paraqiten argumentat e gjykatës, si edhe *dispozitivin*, ku shpallet konkluzioni përfundimtar për çështjen në shqyrtim.<sup>797</sup>

Pavarësisht kësaj ngjashmërie që kanë në formë vendimi i Gjykatës Kushtetuese me vendimin e një gjykate të zakonshme, në përmbajtje midis tyre ka disa dallime. Kështu, vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm kanë natyrë individuale, për arsye se analizojnë situata të veçanta për mënyrën e zbatimit konkret të normës ligjore. Ato e interpretojnë normën në një situatë të caktuar, nëpërmjet zbatimit të së cilës kërkohet të zgjidhet mosmarrëveshja juridike konkrete. Objekti i vendimeve gjyqësore është paligjshmëria e veprimit ose aktit juridik, ndërkohë që analiza e kushtetutshmërisë së aktit me natyrë normative që nxjerrin organet shtetërore, pa përjashtuar dhe aktet me natyrë individuale, përbëjnë objektin kryesor të vendimit në Gjykatën Kushtetuese. Interpretimi i normës ligjore nga Gjykata Kushtetuese është zakonisht abstrakt që synon të zbulojë pajtueshmërinë e saj me normën kushtetuese, që njihen në jurisprudencën ndërkombëtare, pasqyrojnë veçori jo vetëm në aspektin formal, por edhe në drejtim të përmbajtjes, të qëllimit të veçantë, të efekteve juridike që sjellin, si edhe të hyrjes së tyre në fuqi.<sup>798</sup>

Të gjitha këto vendime përfundimtare ose jo, në zbatim të nenit 146, pika 1 të Kushtetutës jepen “Në Emër të Republikës”. Nga praktika e Gjykatës Kushtetuese vërejmë se vetëm vendimet për moskalimin e çështjes në seancë plenare, megjithëse janë vendime jopërfundimtare, nuk jepen “Në Emër të Republikës”. Mendoj se një veprim i tillë është i gabuar, pasi referuar edhe përmbajtjes së neneve 126 dhe 127 të K.Pr.C, që në këtë rast zbatohen me analogji, rezulton se dhënia e vendimeve “Në Emër të Republikës” është një detyrim edhe për vendimet jopërfundimtare.

---

*vendi i dhënies së vendimit, 4) palët, duke u shënuar identiteti dhe cilësia e tyre si paditës, i paditur, ndërhyrës si dhe përfaqësuesit e tyre, 5) emri i prokurorit, nëse ka marrë pjesë, 6) objekti i padisë, 7) kërkimet përfundimtare të palëve, 8) mendimi i prokurorit nëse ka marrë pjesë. II. Në pjesën përshkruese-arsyetuese duhet të përmenden: 1) rrethanat e çështjes, ashtu siç janë konstatuar gjatë gjyqimit, dhe përfundimet e nxjerra nga gjykata, 2) provat dhe arsyet në të cilat mbështetet vendimi, 3) dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi. III. Në pjesën urdhëruese, ndër të tjera, duhet të përmenden: 1) çfarë vendosi gjykata, 1/1) Nëse gjykata vendos detyrime për palët, përmbajtjen konkrete të tyre. 2) kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore, 3) e drejta për të bërë ankim dhe afati për paraqitjen e tij.*

<sup>797</sup> Sadushi, Sokol, “Drejtësia Kushtetuese në zhvillim”, Shtëpia Botuese “Toena”, Tiranë 2012, fq.381.

<sup>798</sup> Po aty, fq.376.

### 3. PROVAT NË GJYKIMIN KUSHTETUES

Gjykimi kushtetues si rregull është një gjykim abstrakt i cili nënkupton një përjasje *in abstracto* të normës juridike të kundërshtuar me normat kushtetuese dhe për rrjedhojë në këto lloje gjykimesh si rregull nuk kemi gjykime mbi prova. Por në raste të caktuara edhe në këto lloje gjykimesh mund të shihet e domosdoshme marrja e provave. Nga ana tjetër, Gjykata Kushtetuese referuar një sërë dispozitave kushtetuese ka në kompetencën e vetë edhe gjykimin konkret. Është e kuptueshme që në këto raste, mund të paraqiten edhe prova gjatë gjyimit kushtetues.

Në LGJK-në nuk jepet kuptimi mbi provën, por një kuptim të tillë mund ta gjejmë duke iu referuar ligjeve të tjera. Kështu sipas K.Pr.C. "provat janë të dhëna që merren në formën e parashikuar nga ky Kod dhe që vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet ose prapësimet e pjesëmarrësve në proces",<sup>799</sup> ndërsa sipas K.Pr.P. "provat janë njoftimet mbi faktet e rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij".<sup>800</sup>

Të dyja këto përkufizime ligjore në thelb janë të njëjta, pavarësisht se përkufizimi i dhënë nga K.Pr.P. është më i detajuar. Duke qenë se gjykimi kushtetues afrohet më shumë me gjykimin civil, atëherë për bazë do të marrim formulimin e dhënë nga K.Pr.C. Që të jemi përpara një prove duhet që domosdoshmërisht të plotësohen këto karakteristika:

a) Prova është një e dhënë. Me të dhënë mund të kuptohet çdo akt, veprim apo fakt, i cili paraqitet i rëndësishëm për çështjen;

b) Duhet të merren sipas rregullave ligjore procedurale. Që një e dhënë të konsiderohet si provë është e nevojshme që marrja dhe administrimi i saj në proces të bëhet sipas rregullave procedurale, duke i dhënë mundësi edhe palëve për të debatur në lidhje me formën apo përmbajtjen e saj. Mosmarrja e tyre sipas rregullave procedurale përbën cënim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor;

c) Këto prova i shërbejnë çështjes dhe më konkretisht i shërbejnë vërtetimit apo rrëzimit të pretendimeve apo prapsimeve të palëve. Nga kjo karakteristikë nxirret edhe konkluzioni tjetër se provat që paraqiten nga palët duhet që të kenë lidhje me procesin përndryshe gjykata disponon me mosadministrimin e tyre.

Një tjetër element i rëndësishëm që lidhet edhe me procesin e të riprovuarit në gjykimin kushtetues është edhe barra e provës. Me barrë prove kuptojmë faktin se pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim që në përputhje me ligjin të provojë faktet mbi të cilët bazon pretendimin e saj.<sup>801</sup> Gjykata Kushtetuese këtë parim të së drejtës procedurale civile e ka konsideruar të zbatueshëm edhe në gjykimin kushtetues. Ajo ka vlerësuar se "parimi që lidhet me detyrimin e palës për të provuar pretendimet e ngritura gjatë një procesi gjyqësor civil (barra e provës), e ndjek palën edhe përpara Gjykatës Kushtetuese, kur ajo parashtron pretendimet e saj lidhur me

<sup>799</sup> K.Pr.C., neni 11.

<sup>800</sup> K.Pr.C., neni 149.

<sup>801</sup> K.Pr.C., neni 12.

standardet kushtetuese të gjykimit të zhvilluar nga gjykatat e zakonshme".<sup>802</sup> Këtë qëndrim e gjejmë të konsoliduar edhe në jurisprudencën e mëvonshme të kësaj gjykate.<sup>803</sup>

Megjithatë edhe në këtë pikë karakteristikat e gjykimit kushtetues e bëjnë më të ndryshëm këtë lloj gjykimi se gjykimi i zakonshëm. Kështu nga përmbajtja e neneve 40, 41 dhe 42 të LGJK-së që rregullojnë provën me ekspert, dëshmitarë dhe me dokumente, rezulton se Gjykata Kushtetuese, këto prova mund t'i kërkojë përveçse me kërkesën e palëve edhe kryesisht. Pra, në këtë rast kemi një rol aktiv të gjykatës kur dihet që parimi kryesor bazë që përshkruan procedurën civile është roli pasiv i gjykatës. Ky ndryshim i roleve në gjykimin kushtetues, justifikohet pikërisht me natyrën e këtij gjykimi, efektet e të cilëve si rregull janë *erga omnes*.

LGJK-ja vetë rregullon vetëm tre lloje provash, atë me ekspert, me dëshmitarë dhe me dokumenta, ku secila prej tyre ka nevojë për analizën e vetë.

### 3.1 Prova me ekspertë.

Prova e parë e përmendur nga ligji është ekspertimi, provë e cila rregullohet nga neni 40 i LGJK.<sup>804</sup> Nga kjo dispozitë rezulton se prova me ekspertë mund të kërkojë nga palët pjesëmarrëse në gjykimin kushtetues, por nëse çmohet e nevojshme dhe pavarësisht qëndrimit të palëve edhe nga vetë Gjykata Kushtetuese. Eksperti thirret vetëm nëse kërkohen njohuri për fusha të veçanta për të cilat si gjykata dhe palët nuk kanë informacionin dhe njohuritë e duhura për t'i shpjeguar shkencërisht. Akti që hartohet nga eksperti ose grupi i ekspertëve jepet si rregull me shkrim por duke ditur se gjithmonë rreth tij do të kërkohen shpjegime nga palët dhe gjykata atëherë dispozita krijon mundësinë që eksperti të degjohet edhe në seancë.

Kjo dispozitë, në zbatim të nenit 1 pika 2 të LGJK-së plotësohet nga dispozitat e tjera të K.Pr.C.,<sup>805</sup> Në këtë kontekst, duke qenë se për zgjidhjen e drejtë të çështjes sipas ligjit, gjykata duhet të vlerësojë dhe çmojë provat e debatuar në gjykim, nëse konstatimi e sqarimi i fakteve që ato përmbajnë kërkon njohuri të posaçme shkencore, i drejtohet mendimit të ekspertëve. Mendimi i tyre, që ka për objekt konstatimin dhe sqarimin nga pikëpamja tekniko-shkencore të fakteve, formalizohet në një akt, aktin e ekspertimit, i cili i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor sikurse të gjitha provat e tjera. Gjykata ka për detyrë të kujdeset që eksperti të jetë kompetent sipas fushës që kërkohet ekspertiza, të përmbushë detyrën me profesionalizëm e besnikëri ndaj së vërtetës dhe të mos ketë pengesa përjashtuese nga pjesëmarrja në gjykim. Por mendimi i ekspertit nuk është i detyrueshëm për gjykatën dhe gjykata mund të arsyetojë të kundërtën. Përpara marrjes së detyrës eksperti duhet që të bëjë betimin<sup>806</sup> me qëllim që të kryejë detyrat e tij. Eksperti ka të drejtë të njihet me materialet e çështjes, të marrë pjesë në seancën gjyqësore, të bëjë pyetje, të japë shpjegime dhe të kërkojë nga palët të marrë të dhëna nga të tretët brenda kufijve të nevojshëm për kryerjen e detyrës. Eksperti mund të asistohet edhe nga ndihmës të tij, por përgjegjësia për saktësinë e ekspertimit i mbetet atij.

<sup>802</sup> Vendimi nr.15, datë 25.5.2006 i Gjykatës Kushtetuese

<sup>803</sup> Vendimi nr.44, datë 7.10.2011 i Gjykatës Kushtetuese, parag.15: *Sa i takon pretendimit të subjektit të interesuar se deputeti F.T. ka votuar lidhur me kërkesën e grupit të deputetëve, por vota e tij nuk është llogaritur qëllimisht, Gjykata vlerëson se në seancë nuk u soll asnjë provë që të vërtetojë këtë pretendim.*

<sup>804</sup> LGJK, neni 40: 1. *Me kërkesën e pjesëmarrësve në gjykim ose kryesisht, Gjykata Kushtetuese mund të thërrasë me cilësinë e ekspertit persona që kanë njohuri të posaçme në fushën e shkencës, teknikës ose artit për konstatimin dhe sqarimin e fakteve që kanë lidhje me çështjen në shqyrtim. 2. Eksperti e jep mendimin e tij me shkrim, por mund të degjohet edhe në seancë plenare.*

<sup>805</sup> K.Pr.C., nenet 224/a – 230.

<sup>806</sup> K.Pr.C., neni 226.



Kur sipas vendimit të gjykatës për kryerjen e ekspertimit është e nevojshme që eksperti të njihet me sende, evidenca, llogari e dokumente të tjera, palët mund të jenë të pranishme dhe mund t'i paraqitin ekspertit me shkrim mendime, vërejtje të specialistëve të tyre, të cilët mund të pyeten me cilësinë e dëshmitarit ose kërkesa që lidhen me plotësimin e detyrës, por gjithnjë brenda kompetencave të caktuara në vendimin e gjykatës.<sup>807</sup>

Kur shihet se ekspertimi është i metë ose i paqartë, si dhe kur ka ndryshim mendimesh midis ekspertëve, gjykata, kryesisht ose me kërkesën e ndonjëres nga palët, mund të kërkojë sqarime plotësuese ose të urdhërojë kryerjen e një ekspertimi të ri, duke thirrur ekspertë të tjerë.<sup>808</sup>

Nga praktika e Gjykatës Kushtetuese, rezulton se në disa raste prova me ekspert është përdorur në gjykimin kushtetues. Këto raste janë të rralla dhe i përkasin gjykimin kushtetues për një proces të rregull ligjor dhe konkretisht për të vërtetuar çënimin e parimit të njoftimit të rregullt.<sup>809</sup> Megjithatë nga analiza e këtyre vendimeve rezulton se Gjykata Kushtetuese nuk ka pasur një kuptim të qartë në lidhje me provën me ekspert, duke arritur shpeshherë në konkluzione të kundërta. Kështu në rastin e parë të paraqitur për gjykim ku u kërkuar administrimi i provës me ekspertë, dhe ku pretendohet fallsiteti i nënshkrimit në dëftesën e njoftimit të rekursit Gjykata Kushtetuese është shprehur se:

*...dëftesa e komunikimit nr.65, datë 14.10.2000, që ndodhet në dosje në emër të këtij avokati, nuk pasqyron të vërtetën.*

*Si nga pyetja e avokatit G.N., me cilësinë e dëshmitarit, të bërë në seancë gjyqësore nga Gjykata Kushtetuese ashtu edhe nga akti i ekspertimit grafik datë 23.2.2002 të ekspertit kriminalist S.H., rezulton se avokati nuk ka marrë kopje të rekursit dhe se firma në dokument nuk është e tij, por e falsifikuar.*

Nga ky pasazh i vendimit rezulton se në rastin konkret nuk kemi pasur një akt ekspertimi gjyqësor të udhëruar nga Gjykata Kushtetuese konform kërkesave të nenit 40 të LGJK-së por kemi të bëjmë me një akt ekspertimi privat, konkluzionet e të cilit për fallsitetin e nënshkrimit merren si të mirëqena nga shumica e anëtarëve të gjykatës. Por sipas vendimit në pakicë konkluzioni i mësipërm kundërshtohet me këto argumenta:

*Përveç kësaj, nga ana e kërkuarit është pretenduar se njoftimi i rekursit është i falsifikuar. Këtë pretendim shumica e ka pranuar si të provuar, duke pranuar si provë një akt ekspertimi, i cili është paraqitur në mënyrë të njëanshme nga kërkuari. Për pasojë, mendoj se ky ekspertim nuk mund të merret për bazë për të provuar pretendimin e kërkuarit, pasi është kryer në kundërshtim me rregullat e përcaktuara nga nenet 11 e vijues, 80 e vijues si dhe 225 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.<sup>810</sup>*

Nga arsyetimi i mësipërm rezulton se gjyqtari në pakicë e ka kundërshtuar këtë akt ekspertimi për dy arsye: 1. është paraqitur në mënyrë të njëanshme nga njëra palë dhe 2. ekspertimi nuk është kryer dhe administruar në përputhje me rregullat e parashikuara në K.Pr.C.

<sup>807</sup> K.Pr.C., neni 227.

<sup>808</sup> K.Pr.C., neni 229.

<sup>809</sup> Vendimet nr.152, datë 5.7.2002, nr.18, datë 23.6.2006 dhe nr.38, datë 20.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>810</sup> Mendimi në pakicë i gjyqtarit kushtetues, Petrit Pllloçi, në vendimin nr.152, datë 5.7.2002 të Gjykatës Kushtetuese.

Interesant është fakti se edhe në këtë rast gjyqtari në pakicë i referohet legjislacionit procedural plotësues dhe jo legjislacionit kryesor pikërisht neni 40 të LGJK-së.

Megjithatë, në rastin e dytë të shfaqur më vonë kur është shtruar për diskutim prova me ekspertë, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur një qëndrim diametralisht të kundërt duke u shprehur se:

*Nisur nga rrethanat e çështjes, nga mënyra e parashtrimit të pretendimeve dhe materialet e administruara për këtë çështje, Gjykata Kushtetuese çmon se kërkuesit nuk arritën të provojnë pretendimet e tyre për mungesën e komunikimit të rekursit. Paraqitja prej tyre e aktit të ekspertimit grafik për të vërtetuar falsitetin e nënshkrimit për rastin konkret nuk përbën provë. Kjo për faktin se ekspertimi nuk është kërkuar në mënyrën e përcaktuar në ligj dhe se është kryer mbi bazën e një fotokopje dhe jo dokumentit origjinal. Lidhur me këtë, ka rëndësi fakti që në lajmërimin marrjen e aktit gjyqësor më datë 21.4.2004, përveç nëpunësit të gjykatës ka nënshkruar edhe postieri që ka komunikuar aktin, i cili duke e kthyer të firmosur nga marrësi mban përgjegjësi për mënyrën e njoftimit.<sup>811</sup>*

Nga pasazhi i mësipërm rezulton se argumenti i parë që ka përdorur gjykata për të mos e marrë në konsideratë akt ekspertimin e paraqitur nga kërkuesi është se *nuk është kërkuar në mënyrën e përcaktuar në ligj*. Më këtë konkluzion duket sikur Gjykata Kushtetuese ka dalë kundër qëndrimit që kishte mbajtur në vendimin e saj të mëparshëm. Këtë qëndrim të ri gjykata e justifikon në këtë mënyrë:

*Përsa i përket vendimit nr.152, që kërkuesit e konsiderojnë rast të njëjtë, ai në fakt është rast i ngjashëm, por duhet mbajtur parasysh se përveç pretendimit për mosnjoftim të kërkuesit, pala kishte paraqitur edhe një aktekspertimi të realizuar në rrugë private, nga i cili rezultonte se nënshkrimi në aktin e njoftimit ishte i falsifikuar. Në dallim nga çështja në shqyrtim ku njoftimi është bërë në emër të njërit nga kërkuesit, në rastin ku bëhet referimi, njoftimi ishte në emër të avokatit të palës, i cili u pyet si dëshmitar nga Gjykata Kushtetuese, gjë që nuk mund të bëhet për të pyetur me këtë cilësi njërin nga kërkuesit.*

Siç mund të vërehet dallimin kryesor midis të dy rasteve Gjykata Kushtetuese e bazon në faktin se në rastin e parë të trajtuar në vendimin nr.152/2002 Gjykata Kushtetuese e kishte vlerësuar akt ekspertimin të lidhur edhe me një provë tjetër dhe pikërisht me dëshminë e avokatit të palës kërkuese në gjykimin e zakonshëm. Ky veprim i tillë nuk mundej që të përsëritej në rastin e vendimit nr.18/2006, pasi në këtë rast firma që pretendohet se ishte fallsifikuar ishte e njërit prej kërkuesve dhe për rrjedhojë ai nuk mund të kishte cilësinë si dëshmitar.

Vetëm në rastin e tretë duket sikur Gjykata Kushtetuese ka dhënë një kuptim të plotë midis aktit ekspertues privat dhe atij gjyqësor. Kështu në vendimin nr.38, datë 20.09.2011 Gjykata Kushtetuese është shprehur se:

*Gjykata Kushtetuese konstaton se, kërkuesja pretendimin për falsitetin e "dëftesës së komunikimit" të rekursit e bazon në aktin e ekspertimit grafik të kryer në kuadrin e procedimit penal të "falsifikimit të dokumentave", procedim që është pushuar për shkak*

<sup>811</sup> Vendimi nr.18, datë 23.6.2006 i Gjykatës Kushtetuese.

*të parashkrimit të ndjekjes penale. Gjykata Kushtetuese, duke qenë se vendimi që ka përfunduar procedimin penal nuk është një vendim gjyqësor dhe si i tillë nuk zotëron fuqinë dhe efektet detyruese të parashikuara nga neni 70 i Kodit të Procedurës Penale, çmon se jashtë këtij procedimi, në cilësinë e provës, ky akt ekspertimi si çdo provë tjetër i nënshtrohet debatit gjyqësor dhe vlerësimit të lirë të Gjykatës. Gjykata Kushtetuese, duke ju përmbajtuar qëndrimin se falsiteti i "dëftesës së komunikimit" të rekursit çon në pavlefshmëri të këtij njoftimi, bazuar në nenin 1 pika 2 të ligjit nr. 8577 datë 10.02.2000 dhe në nenet 270-274 të Kodit të Procedurës Civile, të cilat lejojnë shqyrtimin e falsitetit të një akti në mënyrë incidentale gjatë zhvillimit të një procesi gjyqësor, vendosi që të riçelë më datën 24.03.2011 shqyrtimin gjyqësor në mënyrë që t'i jepej edhe një herë mundësi palëve që të shprehin qëndrimin e tyre në lidhje me aktin e ekspertimit grafik të kryer në kuadrin e procedimit penal. Gjatë debatit gjyqësor rezultoi se, si përfaqësuesi i kërkuarit, ashtu edhe përfaqësuesi i subjekteve të interesuara E.Rr. dhe F.H., nuk e kontestuan këtë akt duke pranuar si të mirëqenë konkluzionin e dhënë në të. Për këtë arsye, Gjykata vendosi që në lidhje me falsitetin e "dëftesës së komunikimit" të rekursit në emrin e saj dhe të bashkëshortit të saj, të mos thërriste në bazë të nenit 40 të ligjit nr. 8577 datë 10.02.2000 ekspertin e fushës, por të pranonte si të mirëqenë konkluzionin e aktit të ekspertimit olografik, sipas të cilët nënshkrimi në dëftesën e komunikimit të rekursit në emrin të kërkuarës dhe të bashkëshortit të saj nuk është nënshkrimi origjinal i tyre.*

Nga arsyetimi i mësipërm, për herë të parë Gjykata Kushtetuese pranon se akti ekspertimi i sjellë nga palët nuk ka efekte detyruese në lidhje me konkluzionet e shprehur në të, pasi vlera e tij provuese do të vlerësohet në përputhje me provat e tjera. Për këtë arsye rezultoi se Gjykata Kushtetuese ishte e gatshme që të emëronte ajo një ekspert në përputhje me kërkesën e nenit 40 të LGJK-së, por duke qenë se pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues nuk kishin asnjë kundërshti me përmbajtjen e tij atëherë gjykata i dha vlerë të plotë provuese.

Megjithatë pavarësisht se LGJK-ja parashikon mundësinë e caktimit të ekspertit nga Gjykata, kjo nuk do të thotë që ekspertimi privat ose ekspertimi i përgatitur nga institucione të tjera të mos ketë asnjë vlerë përballë ekspertimit gjyqësor. Edhe këto ekspertime private janë hartuar nga persona kompetentë me njohuri për fushën përkatëse dhe për rrjedhojë konkluzionet që ato kanë paraqitur duhet të vlerësohen dhe analizohen nga Gjykata në harmoni me provat e tjera. Në rast se nuk i merr në konsideratë, gjykata duhet që ta arsyetojë një fakt të tillë. Për ta mbështetur me tej këtë argument mendoj se duhet t'i referohemi me analogji edhe praktikës së Gjykatës së Lartë e cila në një rast të ngjashëm ka mbajtur qëndrimin e mëposhtëm:

*...në kuptim të neneve 224/a e vijues të Kodit të Procedurës Civile, ndonëse në aspektin thjesht formal të procedimit civil, mund të mos kualifikohet si akt ekspertimi për shkak se "eksperti" nuk është caktuar nga gjykata sipas normave procedurale, përsëri "akti i ekspertimit" "privat" i përpiluar nga një person i licencuar rregullisht dhe paraqitur në gjykim nga një palë ndërgjyqëse, përbën një provë shkresore që mund të lidhet me zgjidhjen e çështjes. Kjo sepse në fund të fundit në aspektin thjesht teknik, ai është një dokument i përgatitur nga një ekspert kompetent i fushës përkatëse të shkencës, i cili jep mendim tekniko-shkencor për konstatimin dhe sqarimin e fakteve që mund të kenë lidhje me mosmarrëveshjen në gjykim. Personi që ka përgatitur opinionin nuk është palë në gjykim, prandaj edhe mendimi shkencor i dhënë prej tij nuk mund të prezumohet*

*e cilësohet vetvetiu si akt dhe qëndrim "i njëanshem" i palës që ka porositur atë opinion. Aq më tepër kur personi që ka përgatitur aktin, pra opinionin tekniko-shkencor, është person i licencuar rregullisht si ekspert i fushës përkatëse të shkencës, sikurse ka ndodhur në çështjen objekt i këtij gjykimi. Në një rrethanë të tillë, nuk është në kapacitetin dhe misionin e gjykatës të mos marrë parasysh kompetencën profesionale e shkencore të ekspertëve të licencuar dhe as të bëjë dallim mbi besueshmërinë etike e profesionale mes tyre në varësi të faktit nëse janë caktuar ose jo nga gjykata, nëse janë apo jo të angazhuar pranë institucioneve shtetërore, etj...*<sup>812</sup>

Jam i mendimit se ky konkluzion i Gjykatës së Lartë, zbatohet *mutatis mutandis* edhe në rastet kur në gjykimin kushtetues kërkohet prova me ekspertë, pra edhe nëse ekspertimi nuk është realizuar nga gjykata, ai analizohet në harmoni me provat e tjera, për më tepër që edhe ekspertimi i hartuar me kërkesë të gjykatës sipas rregullave procedurale të LGJK-së dhe K.Pr.C. nuk është detyrues për Gjykatën.

### **3.2 Prova me dëshmitarë.**

Prova e dytë që rregullon LGJK-ja sipas rradhës është prova me dëshmitarë, provë e cila rregullohet nga neni 41 i këtij ligji.<sup>813</sup> Sipas kësaj dispozite marrja e provës me dëshmitarë kërkohet kur prania e tij është e domosdoshme për sqarimin e fakteve që lidhen me çështjen. Është e kuptueshme që kjo provë mund të merret vetëm brenda kuadrit të një gjykimi konkret që zhvillohet në Gjykatën Kushtetuese, pasi në gjykimet abstrakte një provë e tillë nuk ka aspak vlerë.

Dispozita e mësipërme e LGJK-së plotësohet nga dispozitat e tjera të K.Pr.C. Në këtë kontekst Gjykata Kushtetuese nuk mund të marr provën me dëshmitarë kundër ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar ose privat që përbën provë të plotë.<sup>814</sup> Gjykata gjithmonë duhet që të ketë në konsideratë faktin se cilët persona nuk mundet që të pyeten si dëshmitarë të cilët janë a) përfaqësuesit e palëve në çështje, për rrethana për të cilat kanë marrë dijeni nga të përfaqësuarit e tyre për shkak të detyrës së tyre si përfaqësues; b) personat që për shkak të metash fizike ose psikike nuk janë të aftë të kuptojnë drejt faktet që kanë rëndësi për çështjen dhe të bëjnë dëshmi të rregullt; c) bashkëshortët ende të pandarë, fëmijët, prindërit, gjyshërit, ose kushërinjtë, në vijë të drejtë ose të tërthortë deri në shkallë të dytë, përveç kur çështja ka lidhje me probleme personale e familjare, si dhe të miturit nën katërmëdhjetë vjeç, përveç kur thëniet e tyre janë të domosdoshme për zgjidhjen e çështjes. Këta persona vendosin vetë nëse do të dëshmojnë dhe nuk mund të dënohen për refuzimin për të bërë dëshmi.<sup>815</sup>

Dëshmitarët dëgjohen nga gjykata në debatin gjyqësor, por në raste të veçanta dhe për shkaqe madhore mund të pyeten jashtë gjykatës në prani të palëve dhe të gjithë gjykatës apo gjyqtarit të deleguar.<sup>816</sup>

Dëshmitarët janë të detyruar që të bëjnë betimin<sup>817</sup> dhe rradha e pyetjes së tyre caktohet nga kryetari i seancës.<sup>818</sup> Dëshmitari i thirrur pyetet fillimisht nga pala që e ka thirrur dhe më

<sup>812</sup> Vendimi Nr.00-2009-500 (34), datë 19.02.2009 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

<sup>813</sup> LGJK, neni 41: *Kur shihet e domosdoshme për sqarimin e fakteve që lidhen me çështjen në shqyrtim, me kërkesën e pjesëmarrësve në gjykim ose kryesisht, Gjykata Kushtetuese mund të thërrasë e të pyesë në seancë plenare persona me cilësinë e dëshmitarit.*

<sup>814</sup> K.Pr.C., neni 232.

<sup>815</sup> K.Pr.C., neni 235.

<sup>816</sup> K.Pr.C., neni 236.



pas nga pala tjetër ose nga vetë gjykata nëse ajo e ka thirrur kryesisht.<sup>819</sup> Po kështu dëshmitarët mund të ballafaqohen,<sup>820</sup> të ripyeten<sup>821</sup> dhe në rastet e caktuar nga ligji për dëshminë e tyre të përdorin edhe shënimet.<sup>822</sup>

Nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese rezulton se prova me dëshmitarë është përdorur nga kjo gjykatë, por edhe në këtë rast si provë është përdorur në kuadër të gjykimit kushtetues për një proces të rregullt ligjor. Kështu, në arsyetimin e një nga vendimeve të hershme të Gjykatës Kushtetuese gjejmë këtë pasazh:

*...i njëjti trup gjykues, për të njëjtën çështje, njëherë ka vendosur mospranimin e rekursit dhe herën e dytë prishjen e vendimeve dhe dërgimin e çështjes për rigjykim. Sa më sipër, rezulton e provuar jo vetëm nga ekzistenca e dy vendimeve, njëri prej të cilëve u paraqit nga kërkuesit, por edhe nga shpjegimet që dha në seancë, para Gjykatës Kushtetuese, kryesekretari i Gjykatës së Kasacionit, i cili konfirmoi se të dy vendimet e kolegjit gjinden në kodeksin e vendimeve...<sup>823</sup>*

Nga arsyetimi i mësipërm kuptojmë se gjykata ka marrë provën me dëshmitarë për të sqaruar faktin nëse nga Gjykata e Kasacionit<sup>824</sup> ishin dhënë apo jo dy vendime për të njëjtën çështje. Megjithatë mendoj se vendimi i Gjykatës Kushtetuese në këtë rast është i kritikueshëm. Marrja e provës me dëshmitarë në bazë të nenit 1, pika 2 të LGJK-së dhe nenit 232 të K.Pr.C. nuk lejohet kundër ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar. Vendimi gjyqësor në këtë rast përbën akt zyrtar. Duke qenë se në gjykatë në këtë rast ishin paraqitur si provë të dyja vendimet që dispononin për të njëjtën çështje atëherë rezulton se marrja e provës me dëshmitarë nuk kishte asnjë kuptim. Edhe në rast se Gjykata Kushtetuese kërkonte të dinte nëse këto dy vendime ishin rregjistruar në kodeksin e vendimeve të Gjykatës së Kasacionit përsëri ky fakt nuk mundet që të vërtetohet me dëshmitarë, por Gjykata duhej që të kishte administruar vetë kodeksin përkatës ose të kishte marrë ekstrakte të njësuara me origjinalin e këtij kodeksi.

Në një tjetër rast për marrjen e provës me dëshmitarë vërejmë se Gjykata Kushtetuese ka mbajtur këtë qëndrim:

*Gjykata Kushtetuese, veç konstatimit se në aktet e dosjes nuk është kopja e komunikimit të rekursit kërkuesit, në bazë të nenit 41 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin e funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", pyeti me cilësinë e dëshmitarëve Kryesekretaren e gjykatës së rrethit Tiranë F.K., sekretaren e po kësaj gjykate V.V., e cila merret me komunikimin e akteve të asaj gjykate si dhe D.Q., që punon në Kryesekretarinë e Gjykatës së Lartë.*

*Këto dëshmitarë, deklaruan se sipas rregullave ekzistuese, në sekretarinë përkatëse, dosja nuk dorëzohet në Gjykatën e Lartë pa u shoqëruar me dëftesën që vërteton komunikimin e rekursit. Por, për rastin konkret, nga shpjegimet e tyre nuk u*

<sup>817</sup> K.Pr.C., neni 237.

<sup>818</sup> K.Pr.C., neni 238.

<sup>819</sup> K.Pr.C., neni 239.

<sup>820</sup> K.Pr.C., neni 240.

<sup>821</sup> K.Pr.C., neni 241.

<sup>822</sup> K.Pr.C., neni 244.

<sup>823</sup> Vendimi nr.75, datë 29.12.1998 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>824</sup> Sot Gjykata e Lartë

*provua që të jetë bërë ky komunikim në format e parashikuara në nenet 132 e 140 të Kodit të Procedurës Penale.*<sup>825</sup>

Nga arsyetimi i mësipërm rezulton se shkak i marrjes së provës me dëshmitarë në këtë rast ka qenë sqarimi i faktit nëse dosja ishte dërguar në Gjykatën e Lartë me deftësen e komunikimit të rekursit apo pa një komunikim të tillë. Arsyeja e një veprimi të tillë të Gjykatës Kushtetuese, kur ajo vetë pranon se në dosje mungon një deftesë e tillë del nga qëndrimi i mbajtur nga gjyqtari në pakicë i cili u shpreh se:

*Është e vërtetë (përsa pretendohet nga kërkuesi), se në dosje nuk gjendet akti i komunikimit të rekursit, por është po aq e vërtetë se (qoftë edhe me sy të lirë) konstatohet që nga dosja është hequr një dokument, i cili nuk mund të mos ishte akti që vërteton komunikimin e rekursit. Edhe mënyra e heqjes (çngjijtja) nuk flet në favor të tezës së ngritur nga kërkuesi.*

Pra, në dosje mungonte deftesa e komunikimit por nga ana tjetër konstatohet se mbi dosje kishte pasur ndërhyrje. Për këtë arsye Gjykata vendosi që të marrë provën me dëshmitarë. Por përsëri mendoj se edhe në këtë rast marrja e kesaj prove nuk ishte e ligjshme. Kështu bazuar në legjislacionin procedural civil, “deftesa e komunikimit” të rekursit është një akt procedural, e cila bashkë me njoftimin me shpallje në Gjykatën e Lartë, siguron njoftimin e palëve për të marrë pjesë në gjykim.<sup>826</sup> Duke pasur këtë cilësi, “deftesa e komunikimit” përbën akt zyrtar dhe për rrjedhojë për të vërtetuar apo jo ekzistencën e tij si akt, nuk mundet që të merret prova me dëshmitarë në bazë të nenit 1, pika 2 të LGJK-së dhe nenit 232 të K.Pr.C.

Në një rast tjetër i cili është përmendur më sipër kur trajtuam ekspertimin si provë, Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar se:

*...deftesa e komunikimit nr.65, datë 14.10.2000, që ndodhet në dosje në emër të këtij avokati, nuk pasqyron të vërtetën.*

*Si nga pyetja e avokatit G.N., me cilësinë e dëshmitarit, të bërë në seancë gjyqësore nga Gjykata Kushtetuese ashtu edhe nga akti i ekspertimit grafik datë 23.2.2002 të ekspertit kriminalist S.H., rezulton se avokati nuk ka marrë kopje të rekursit dhe se firma në dokument nuk është e tij, por e falsifikuar.*<sup>827</sup>

Por për marrjen e kesaj prove me dëshmitarë pati edhe kundërshtime. Kështu gjyqtari në pakicë në këtë çështje mbajti këtë qëndrim:

*Gjithashtu, gjykata ka pranuar si provë edhe shpjegimet e avokatit të kërkuesit, i cili është shprehur se nuk e ka nënshkruar njoftimin e rekursit. Edhe këto shpjegime duhet të merren me rezervë, sepse dëshmitari duke qenë avokat i kërkuesit është i interesuar në zgjidhjen e çështjes.*

Personalisht bashkohem me mendimin e gjyqtarit në pakicë. Kështu dëshmitari i pyetur i cili kishte vepruar në bazë të tagrave të dhëna si përfaqësues i kërkesave në gjykimet e zhvilluara

<sup>825</sup> Vendimi nr.33, datë 24.5.2000 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>826</sup> Vendimi nr.38, datë 20.9.2011 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>827</sup> Vendimi nr.152, datë 5.7.2002 i Gjykatës Kushtetuese.

pranë gjyqësorit të zakonshëm, nuk mundet kurrësesi që të konsiderohej si një dëshmitar i besueshëm. Për më tepër që në këtë rast Gjykata Kushtetuese mund të kishte kërkuar thirrjen e avokatit jo me cilësinë e dëshmitarit por me qëllim për të ndjekur procedurën e krahasimit të nënshkrimit parashikuar nga neni 269, pika 3 e K.Pr.C.<sup>828</sup>

Nga sa më sipër konkludojmë se prova me dëshmitarë gjen zbatim edhe në gjykimin kushtetues, por në gjykimet me natyrë konkrete. Por nga analiza e mësipërme rezultoi se kjo dispozitë ligjore dhe mundësi që i është dhënë Gjykatës Kushtetuese, nuk është kuptuar drejtë prej saj duke thirrur dëshmitarë për të provuar ose jo ekzistencën e një akti zyrtar ose vërtetësinë apo jo të nënshkrimit, fakte këto të cilat nuk mundet që të vërtetohen me dëshmitarë.

### 3.3 Prova me dokumenta.

Prova e tretë e parashikuar nga LGJK-ja është prova me dokumenta e parashikuar në neni 42.<sup>829</sup> Kjo dispozitë plotësohet më tej nga neni 84 i LGJK.<sup>830</sup> Kjo lloj prove është nga më të përdorurat në gjykimin kushtetues dhe mund të përdoret në të gjitha gjykimet si ato abstrakte ashtu edhe ato konkrete. Kështu në gjykimin abstrakt mund të kërkohej procesverbalen e seancave të Kuvendit në ato raste kur vihet në dyshim votimi i realizuar për ligjin që mund të jetë objekt gjykimi. Po kështu çdo akt juridik që kundërshtohet në gjykatë (normativ, administrativ dhe gjyqësor) për çdo gjykim kushtetues dhe praktikën e tyre shoqëruese administrohen si provë në Gjykatë. Në gjykimin për procesin e rregullt ligjor Gjykata Kushtetuese administron edhe dosjen gjyqësore, e cila në kuptim të dispozitave të mësipërme përbën provë me dokumenta. Si rregull provat shkresore paraqiten nga vetë pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues për shkak të detyrimit të barrës së provës që rëndon mbi ta. Megjithatë në raste të caktuara kur ato ndodhen në pamundësi për marrjen e një prove shkresore ose Gjykata Kushtetuese çmon të zgjerohet më tej hetimin gjyqësor atëherë ajo mund të kërkojë në bazë të nenit 42 dokumentin përkatës pranë autoritetit shtetëror ose jo shtetëror ku ndodhet, të cilët në bazë të nenit 84 janë të detyruar që të përgjigjen pozitivisht dhe brenda afatit të caktuar nga Gjykata.

Edhe në këtë rast dispozitat e mësipërme të LGJK-së në bazë të nenit 1, pika 2 të saj plotësohen nga dispozitat e K.Pr.C. Kështu që shkresat të kenë vlerë provuese ato duhet të jenë hartuar në formën e caktuar, të kenë elementet e nevojshme për vlerën e tyre, nuk janë të copëtuara, të grisura ose të shuara, nuk kanë gërvishtje, ose shtesa midis rreshtave, ose çrregullime të tjera me shuarje dhe mund të lexohen.<sup>831</sup>

K.Pr.C. parashikon një sërë shkresash të cilat i ndan në shkresa zyrtare, shkresa të thjeshta dhe shkresa private. Personalisht jam i mendimit që për vetë natyrën që ka gjykimi kushtetues, mbi të gjitha kur nuk zgjidh edhe themelin e një çështjeje në rastin e gjykimin kushtetues për proces të rregullt ligjor, në këtë lloj gjykimi mund të administrohen vetëm prova shkresore që kanë natyrën e aktit zyrtar. Këto akte përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi

<sup>828</sup> K.Pr.C., neni 263, pika 3: *Ndërgjyqësi ose personi i tretë të cilit i mohohet origjinaliteti i shkrimit ose nënshkrimit, mund të detyrohet të shkruajë para gjykatës ose gjyqtarit të deleguar me letërporosi një tekst të caktuar me të cilin do të bëhet krahasimi. Teksti i bashkohet dosjes. Gjykata çmon lirish mohimin e ndërgjyqësit ose personit të tretë të shkruajë ose të bëjë përpjekje për të ndryshuar shkrimin e tij.*

<sup>829</sup> LGJK, neni 42: *1. Kur shihet e domosdoshme, me kërkesën e pjesëmarrësve në gjykim ose kryesisht, Gjykata Kushtetuese mund të kërkojë dokumente të cilat kanë lidhje me çështjen në shqyrtim. 2. Dokumentet e kërkuara administrohen në seancë plenare.*

<sup>830</sup> LGJK, neni 84: *Çdo organ shtetëror, person fizik ose juridik, detyrohet t'i japë Gjykatës Kushtetuese dokumente, të dhëna e njoftime kur këto kërkohej e çmohen të nevojshme për shqyrtimin e çështjes.*

<sup>831</sup> K.Pr.C., neni 246.

që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre.<sup>832</sup> Aktet zyrtare që dalin nga organet shtetërore dhe që përmbajnë një urdhër, një vendim ose çdo masë tjetër të marrë prej tyre ose që tregojnë kryerjen e një veprimi nga ana e këtyre organeve, përbëjnë provë të plotë për përmbajtjen e tyre.<sup>833</sup>

Këto dokumenta duhet që domosdoshmërisht të administrohen në seancë për t'u dhënë mundësi palëve të debatojnë mbi përmbajtjen e tyre duke respektuar në këtë mënyrë parimin e barazisë së armëve. Pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues kanë të drejtë që duke zbatuar rregullimet e neneve 270 – 275 të K.Pr.C., t'i godasin dokumentat e marra nga Gjykata Kushtetuese sipas nenit 42 të LGJK-së për fallsitet.

Një çështje që mund të shtrohet për diskutim për këtë lloj prove është rasti kur dokumenti përbën sekret shtetëror. LGJK-ja për këto lloje dokumentash nuk ka asnjë parashikim të shprehur si për ndalimin e marrjes së tyre ashtu edhe për administrimin e tyre. Ndërsa K.Pr.C. parashikon se kur të dhënat e kërkuara përbëjnë sekret shtetëror, gjykata kërkon lejen e organit qendror nga i cili varet administrata shtetërore ku ndodhen të dhënat e kërkuara. Kur kërkesa refuzohet, kërkesa e palës quhet si e paparashtruar.<sup>834</sup>

Jam i mendimit që zgjidhja që jep K.Pr.C. nuk duhet të merret në konsideratë në këtë rast. Parimi i barazisë së armëve kupton që ndër të tjera secila prej palëve të ketë mundësinë që të paraqesë çështjen e saj duke parashtruar edhe provat përkatëse. Përdorimi i justifikimit se në këtë rast mund të kemi të bëjmë me dokumenta të klasifikuar si sekret shtetëror edhe sikur të jetë i vërtetë nuk mundet që të merret në konsideratë nga gjykata. Duke bërë një interpretim të zgjeruar të neneve 42 dhe 84 të LGJK-së jam i mendimit se Gjykata Kushtetuese duhet që të urdhërojë administrimin e tyre në gjykimin kushtetues. Për më tepër ajo në këtë rast mund të marrë si referim edhe nenin 211 pika 2 të K.Pr.P. i cili parashikon se kur sekreti shtetëror konfirmohet nga organi kompetent dhe prova është thelbësore për zgjidhjen e çështjes, organi procedues vendos marrjen e provës. Aplikimi i kësaj dispozite të K.Pr.P është i mundur pasi neni 1, pika 2 i LGJK-së nuk e detyron Gjykatën Kushtetuese që si legjislacion plotësues të zbatojë vetëm K.Pr.C, por ligje të tjera në varësi të natyrës së çështjes. Për këtë arsye jam i mendimit në rastin e një gjykimi kushtetues, në të cilin prova shkresore është thelbësore për atë çështje, Gjykata Kushtetuese në zbatim të dispozitave të sipërcituara do të administrohet në gjykim.

Me qëllim ruajtjen e parimit të proporcionalitetit midis interesave të pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues dhe interesave të larta shtetërore, atëherë Gjykata Kushtetuese në zbatim të nenit 21 pika 2 të LGJK-së duhet ta përjashtojë publikun nga seanca plenare ose një pjesë të tij, me arsyetimin e mbrojtjes së sigurisë kombëtare.<sup>835</sup> Në këtë mënyrë ruhet edhe sekreti shtetëror dhe palët mundet që të ruajnë të drejtat e tyre procedurale.

<sup>832</sup> K.Pr.C., neni 253.

<sup>833</sup> K.Pr.C., neni 254.

<sup>834</sup> K.Pr.C., neni 224.

<sup>835</sup> LGJK, neni 21: 1. Shqyrtimi i çështjeve në seancë plenare nga Gjykata Kushtetuese bëhet i hapur. 2. Gjykata Kushtetuese mund ta përjashtojë publikun nga seanca plenare ose një pjesë të tij, me arsyetimin e mbrojtjes së moralit publik, të rendit publik, të sigurisë kombëtare, të së drejtës së jetës private ose të së drejtave vetjake.



## KONKLUZIONE.

Subjektet kërkuese dhe përfaqësuesit e tyre, duhet që në çdo rast të veprojnë brenda periudhave kohore të caktuara. Identifikimi i këtyre afateve, si edhe përcaktimi i momentit të ecjes së tyre ka rëndësi të madhe në planin praktik. Ekzistenca e afateve procedurale gjithmonë justifikohet me parimin e sigurisë juridike. Marrëdhëniet juridike, përfshirë edhe ato me karakter kushtetues duhet që të jenë të qëndrueshme. Kjo kërkon që edhe subjektet kushtetuese të jenë aktive në mbrojtjen e të drejtave të tyre. Megjithatë duhet theksuar se afatet procedurale sipas LGJK, janë afate të gjata. Kështu për procesin e rregullt ligjor afati i parashikuar nga LGJK është 2 vjeçar, ndërkohë që në shumicën e vendeve është disa muaj ose edhe më i shkurtër. Një shembull tipik në këtë drejtim është KEDNJ, sipas së cilës afati për t'u ankuar pranë GJEDNJ është 6 muaj dhe sipas protokollit nr.15 synohet që të kufizohet në 4 muaj. Po e njëjta gjë mund të thuhet edhe për për afatin e kundërshtimit të akteve normative i cili është 3 vjeçar. Për krahasim në disa vende është dy muaj, apo edhe disa ditore, siç është rasti i Kosovës. Pavarësisht këtij afati kaq të gjatë, përsëri ky afat edhe nëse ka kaluar, është i shmangshëm, nëse synohet që një ligj të kundërshtohet nëpërmjet një kontrolli incidental nga ana e gjykatave të zakonshme, ose duke pretenduar zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave, ku shkak i kësaj mosmarrëveshje mund të ketë qenë një akt normativ.

Afatet për gjykimet e tjera janë disi më të arsyeshme duke mbetur përgjithësisht në afatin 6 muaj, ose edhe 15 ditore siç është afati për të kundërshtuar vendimet e Këshillit të Ministrave për shpërndarjen apo shkarkimin e organeve të njëjësive vendore të zgjedhura drejtpërsëdrejti. Por LGJK parashikon edhe gjykime të cilat janë afate të pacaktuara siç është rasti i marrëveshjeve ndërkombëtare. Në këtë lloj gjykimi, afati fillon të ecë në momentin e nënshkrimit të testit final dhe përfundon në momentin kur ligji ratifikues hyn në fuqi sipas të drejtës së brendshme. Për këtë arsye subjektet që kanë interes për të kundërshtuar një marrëveshje të tillë, duhet që të jenë aktiv brenda kësaj periudhe.

Në disa raste afatet e gjykimeve kushtetuese lidhen me afatin e mandatit të organeve kushtetuese. Kështu, përse i përket gjykimeve në lidhje me Presidentin dhe deputetët duhet që të kryhet brenda mandatit të tyre në këto detyra. Mbas përfundimit të këtij mandati, një gjykim i tillë nuk mund të ngrihet më pasi ka humbur interesi dhe aktualiteti i çështjes.

Për disa gjykime LGJK nuk parashikon asnjë afat. Kjo lidhet me mbrojtjen e rendit kushtetues i cili nuk mund të kufizohet me asnjë afat apo kusht tjetër procedural. Një lloj gjykimi i tillë është ai për kontrollin kushtetues mbi partitë apo organizatat politike. Pavarësisht se këto grupime janë në themel të një qeverisje demokratike, ato mund të bëhen të rrezikshme për ta shkatërruar atë. Për këtë arsye nga Kushtetuta parashikohet si një gjykim i posaçëm kontrolli mbi këto organizma dhe LGJK nuk e lidh këtë gjykim me ndonjë afat të caktuar.

LGJK, kujdeset gjithashtu edhe për parashikimin e disa afateve për Gjykatën Kushtetuese, me qëllim që gjykimi i saj të zhvillohet brenda një afati të arsyeshëm. Afat i tillë është ai për gjykimin paraprak të kërkesave, i cili është 2 muaj. Në këtë fazë gjykata, brenda këtij afati duhet që t'i japë përgjigje nëse çështja i plotëson apo jo kërkesat procedurale për të kaluar për gjykim. Një tjetër afat është ai një muaj brenda së cilës Gjykata Kushtetuese duhet që të shqyrtojë kërkesën për kontrollin e një marrëveshje ndërkombëtare. Megjithatë Gjykata Kushtetuese nuk ka asnjë afat për të marrë vendim. Kjo lidhet me natyrën e gjykimit kushtetues dhe me faktin që forca e vendimeve të saj është pikërisht në fuqinë e arsytimit të vendimit. Por ky mosparashikim i ligjit nuk duhet që të kthehet nga Gjykata Kushtetuese në një mjet për të zgjatur pa fund marrjen e vendimeve nga ana e saj. I vetmi afat që parashikohet për Gjykatën

Kushtetuese për të marrë vendim, është gjykimi i çështjeve të shtruara për referendum. Në këtë rast afati është me natyrë kushtetuese dhe është 60 ditor. Ky lloj afati i veçantë dhe përjashtimor, ka të bëjë me natyrën e këtij lloj gjykimi, që lidhet me shqyrtimin sa më të shpejtë të kërkesave për mbajtjen e një referendumi.

Megjithëse nuk parashikohet nga LGJK, Gjykata Kushtetuese ka pranuar në jurisprudencën e saj, mundësinë e rivendosjes në afat të kërkesave. Kjo lloj mundësie deri më tani në planin praktik është njohur vetëm për kërkesat e individëve për një proces të rregull ligjor. Megjithatë mundësia e rivendosjes në afat, ndërkohë që vetë LGJK parashikon afate të gjata për paraqitjen e kërkesave, bën që ajo të ushtrohet rrallë. Siç e kemi trajtuar edhe me sipërjam i mendimit që kjo lloj mundësie mund të përdoret vetëm për gjykimet konkrete dhe jo për ato me natyrë abstrakte.

Subjektet kërkuese, përveçse duhet që t'i drejtohen në kohë Gjykatës Kushtetuese, duhet që edhe formalisht t'i drejtohen nëpërmjet akteve të caktuara procedurale. Si akti më i rëndësishëm që vë në lëvizje edhe Gjykatën Kushtetuese, është kërkesa. LGJK parashikon disa elementë formale të cilat duhet të plotësohen nga çdo kërkues, megjithëse nuk parashikohet një formë e caktuar dhe standarde për këtë akt procedural. Nga ana tjetër vetë Gjykata Kushtetuese e ushtron veprimtarinë e saj nëpërmjet akteve procedurale. Pjesa më e madhe e këtyre akteve parashikohen edhe nga kodet e procedurave për gjykimet e zakonshme, por në gjykimin kushtetues kanë karakteristikat e veta. Por rezulton se LGJK ka mbetur mbrapa në përcaktimin e disa formave të reja të dokumentimit të veprimtarisë së saj. Kështu LGJK, nuk parashikon regjistrimin audio të seancave plenare të Gjykatës Kushtetuese dhe vlerën juridike të këtyre regjistrimeve. Po kështu edhe përsa i përket njoftimit, LGJK njih vetëm format tradicionale të njoftimit, ndërkohë që njihen edhe format e njoftimit nëpërmjet postës elektronike. Për këto dy raste mund të argumentohet që në bazë të hapësirës që njih neni 1 pika 2 e LGJK të zbatohen edhe këto parashikime që gjenden në kodet e procedurave. Jam i mendimit që në këto raste është më mirë që parashikimi të jetë drejtpërdrejtë në LGJK.

Pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues kanë të drejtë që të paraqesin në mbështetje të pretendimeve të tyre edhe prova. LGJK rregullon vetëm tre prej tyre, provën me ekspert, me dëshmitarë dhe me dokumenta. Paraqitja e provave në gjykimin kushtetues në përgjithësi konsiderohet si fenomen i rrallë pasi gjykimet kryesore që aplikon Gjykata Kushtetuese janë me natyrë abstrakte. Në këto raste Gjykata, kontrollon vetëm pajtueshmërinë e normës me Kushtetutën. Për rrjedhojë në këto gjykime nuk ka nevojë që të paraqiten prova. Situata ndryshon krejtësisht në gjykimet konkrete. Në këto gjykime duhet që shpeshherë të paraqesin prova në gjykim për mbështetjen e argumentave të tyre. Gjykata Kushtetuese në pjesën më të madhe e ka aplikuar marrjen e provave në gjykimet për proces të rregullt ligjor.

Në lidhje me provën e parë, atë me ekspertë, fillimisht Gjykata Kushtetuese e ka aplikuar në mënyrë konfuzë, duke njohur si provë të tillë edhe ekspertimet private të sjella nga pjesëmarrësit. Pavarësisht se nuk mundet që të mohohet vlera e ekspertimeve private, ekspertimi si provë konsiderohet i marrë vetëm në rast se urdhërohet si i tillë nga vetë Gjykata. Kjo është arsyeja që në vendimmarrjet e saj të fundit shihet një lloj përmirësimi në mënyrën e përdorimit të kësaj prove.

Prova tjetër me dëshmitarë është përdorur nga Gjykata Kushtetuese përsëri kryesisht në gjykimin kushtetues për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste Gjykata Kushtetuese ka thirrur si dëshmitarë personel të administratës së gjykatave të zakonshme për të provuar dërgimin ose jo të njoftimeve, por edhe elementë të tjerë. Ajo që vihet re edhe për këtë provë është përsëri përdorimi i saj në mënyrë konfuzë. Kështu, Gjykata Kushtetuese ka marrë provën me dëshmitarë

për të kontrolluar përmbajtjen e dokumentave zyrtare (si regjistrat e gjykatave, etj), megjithëse sipas K.Pr.C. nuk lejohet prova me dëshmitarë kundër apo tej përmbajtjes së akteve zyrtare.

Prova e tretë e njohur nga LGJK është ajo me dokumenta. Kjo është prova dhe më e përdorshme nga Gjykata Kushtetuese, ku në të gjitha gjykimet administron si rregull akte zyrtare. Në lidhje me këtë provë njihet edhe një lloj roli aktiv i Gjykatës Kushtetuese. Kështu sipas nenit 42 të LGJK, Gjykata Kushtetuese ka të drejtë që të kërkojë vetë dokumenta nga institucione apo subjekte të tjera edhe nëse nuk ka një kërkesë nga pjesëmarrësit në gjykim. Ky element përveçse vë në dukje veçantinë e gjyimit kushtetues, njëkohësisht tregon edhe për rëndësinë e kësaj prove.

Rëndësia e të gjitha këtyre elementeve bën të mundur që gjykimi kushtetues të futet në kornizat e tij procedurale dhe mundëson zhvillimin e tij në mënyrë të rregullt. Këto elementë janë të domosdoshëm, pa të cilët vetë gjykimi kushtetues nuk do të mund të kuptohej.

## KREU V

### GJYKIMI KUSHTETUES

#### Hyrje

Gjykimi kushtetues, për vetë natyrën dhe specifikën ndryshon nga gjykimi i zakonshëm në shumë drejtime. Në rradhë të parë ndryshimi vërehet në ekzistencën e disa fazave të procesit kushtetues, të cilat mund t'i ndajmë në fazën paraprake, fazën gjykimore, vendimmarrëse dhe fazën ekzekutive. Të gjitha këto faza gjejnë rregullimin përkatës në LGJK të cilat vetë Gjykata i ka detajuar më tej në rregulloren e saj. Ndjekja e këtyre parimeve dhe e fazave përkatëse është ndjekja e një rregulli të mirëpërcaktuar të cilat do t'i analizojmë në vazhdim.

#### 1. FAZA E PARË – SHQYRTIMI PARAPRAK

Kjo fazë fillon me depozitimin e kërkesës dhe materialeve shoqëruese në kryesekretarinë e Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 27 të LGJK, strukturë kjo që sipas rregullores së Gjykatës quhet Drejtoria Gjyqësore dhe e Dokumentacionit.<sup>836</sup> Paraqitja e kërkesës nuk lidhet me detyrimin për pagimin e ndonjë tarife. Kjo ndihmon në rritjen e aksesit veçanërisht për individët.

Rregullorja në këtë fazë, parashikon një kontroll administrativ për pranimin e kërkesës. Pika 2 e nenit 4 të Rregullores parashikon se kushtet formale për pranimin administrativ të kërkesës për shqyrtim janë: (a) të jetë paraqitur nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 134 të Kushtetutës; (b) të përmbajë identitetin e plotë të kërkuarit dhe adresën e saktë të tij ose përfaqësuesit, si dhe identitetin dhe adresën e plotë të subjektit të interesuar; (c) të ketë kopje të vendimeve gjyqësore objekt shqyrtimi ose dispozitat e aktit normativ që kundërshtohet; (ç) të ketë prokurë/autorizim, nëse kërkesa paraqitet prej avokatit ose ndonjë personi tjetër përfaqësues; (d) të jetë brenda afatit 2-vjeçar, në rastin e kërkesave individuale me objekt kundërshtimin e vendimeve gjyqësore, dhe 3-vjeçar në rastin e kundërshtimit të akteve normative, përveç rasteve kur parashikohet afat i ndryshëm nga dispozitat e Kushtetutës apo ligjit organik të kësaj Gjykate.

Nëse nuk plotësohen këto kushte personeli i kësaj drejtorie i drejtohet sekretarit të përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese i cili komunikon në rrugë administrative me paraqitësin e kërkesës. Nëse këto të meta nuk plotësohen atëherë kërkesa nuk regjistrohet ndërsa nëse plotësohen kërkesa regjistrohet dhe i paraqitet Kryetarit të Gjykatës për veprimet e mëtejshme procedurale.<sup>837</sup>

Qëllimi i këtij parashikimi mesa duket është që nëpërmjet një procedure të tillë administrative, të lehtësojë gjykatën dhe trupën gjyqësore nga shqyrtimi i kërkesave të cilat nuk plotësojnë kriteret formale të parashikuara nga LGJK për paraqitjen e një kërkesë. Ky kontroll i kësaj drejtorie mund të justifikohet deri në njëfarë mase nëse kërkesa e paraqitur nuk përmban asnjë element formal nga ato që janë përcaktuar në nenin 28 të LGJK-së dhe që nga përmbajtja e saj vështirë se mund të klasifikohet si një kërkesë. Por kompetencat që i janë dhënë kësaj strukture të brendshme të Gjykatës Kushtetuese, duket se dalin jashtë qëllimit të vetë ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese. Personalisht jam i mendimit se një analizë e kujdesshme e këtyre dispozitave të rregullores tregon se këto dispozita janë në kundërshtim me parashikimet

<sup>836</sup> Rregullorja, neni 4, pika 1.

<sup>837</sup> Rregullorja, neni 5.



që vetë LGJK-ja ka për këtë fazë të procesit. Kështu ky ligj në nenin 27 të tij përcakton se kërkesa e paraqitur regjistrohet menjëherë<sup>838</sup> në regjistër. Përdorimi i këtij termi tregon se departamenti i Gjykatës Kushtetuese i ngarkuar me pranimin e kërkesave duhet që të bëjë menjëherë regjistrimin e kërkesës dhe jo të bëjë vlerësimin e kriterëve formale të saj.

Një tjetër problem që shfaqet është edhe fakti se kjo procedurë që zhvillohet përpara kësaj drejtorie, rregullorja e përcakton si një procedurë administrative, por parashikimi i një procedure administrative të tillë në gjykimin kushtetues përbën një *non sens* juridik. Siç është theksuar në doktrinë dhe në këtë punim, kërkesa është akti procedural që vë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Pra, paraqitja e kërkesës ve në lëvizje gjykimin kushtetues, gjykim i cili rregullohet nga rregullat e veta procedurale me natyrë gjyqësore. Në këtë kuptim, është alogjike zgjidhja e dhënë nga rregullorja për përcaktimin e procedurave administrative për verifikimin e kriterëve formale të një akti procedural gjyqësor. Në mbështetje të këtij argumenti vlen edhe parashikimi i nenit 31 pika 5 të LGJK-së në të cilin është përcaktuar se administrativisht veprohet për ankesat, lutjet dhe çdo korrespondencë tjetër që nuk përmban elementët e kërkesës.

Gjithashtu referuar nenit 31 pika 2, të LGJK-së vërejmë se konstatimi i të metave të kërkesës është kompetencë e Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese dhe jo e Drejtorisë Gjyqësore dhe të Dokumentacionit.<sup>839</sup> Është kjo strukturë që përcakton nëse kërkesa ka të meta apo jo dhe përcakton afatin për plotësimin e tyre, pra dukshëm një kompetencë e tillë nuk i takon Drejtorisë Gjyqësore të Dokumentacionit si edhe Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës. Për më tepër fjalia e fundit e kësaj dispozite të LGJK-së parashikon se kur të metat nuk plotësohen në afat, kërkesa nuk merret në shqyrtim, por jo se nuk regjistrohet.

Një tjetër argument është edhe fakti se kësaj drejtorie i është dhënë si kompetencë edhe verifikimi i afatit për paraqitjen e kërkesës, ndërkohë që afati i paraqitjes së kërkesës është konsideruar si çështje e legjitimitetit të kërkuarit në gjykimin kushtetues, si një nga elementët e *locus standi*, dhe konkretisht elementi *ratione temporis*. Duke qenë pjesë e verifikimit të legjitimitetit të subjektit atëherë verifikimi i këtij momenti është kompetencë e strukturave gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe jo Drejtorisë Gjyqësore dhe të Dokumentacionit.

Duke qenë se parashikimet ligjore janë të qarta dhe të plota, në këtë rast nuk gjen vend zbatimin i nenit 1 pika 2 të LGJK-së në lidhje me ligjet e tjera procedurale. Por, për të mbështetur argumentat e dhëna më sipër rezulton se edhe në gjykimin e zakonshëm, referuar parashikimeve ligjore të K.Pr.C., kthimi i kërkesëpadisë, ankimit apo rekursit për të meta nuk bëhet nga sekretaritet apo strukturat administrative të këtyre gjykatave, por përkundrazi nga trupat gjyqësore respektive të cilat japin edhe afatin për plotësimin e tyre.<sup>840</sup>

<sup>838</sup> LGJK, neni 27, pika 1: *Kërkesa që drejtohet në Gjykatën Kushtetuese regjistrohet menjëherë në regjistrin e posaçëm që mban kryesekretaria e Gjykatës Kushtetuese.*

<sup>839</sup> LGJK, neni 31, pika 2: *Kur kërkesa, megjithëse është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese dhe është paraqitur nga subjekti që legjitimohet, nuk është e plotë, kolegji i' a kthen kërkuarit për plotësim, duke treguar shkaqet e kihimit dhe afatin e plotësimit të saj. Pas kësaj, kur kërkesa paraqitet e plotësuar, kalon përsëri për shqyrtim paraprak në kolegji. Kërkesa e paplotësuar nuk merret në shqyrtim.*

<sup>840</sup> K.Pr.C., neni 154/a, pika 3: *Kur kërkesëpadia nuk plotëson kushtet e përmendura në këtë kre, gjyqtari i vetëm i' a kthen paditësit në kohën e paraqitjes së saj ose ai njoftohet me shkrim për plotësimin e të metave dhe, pasi të jetë shënuar në padi data e paraqitjes, caktohet një afat për plotësimin e të metave. Deri në këtë datë padia mbetet pa veprime.*

K.Pr.C., neni 455 pika 2: *Në rast se ankimi nuk plotëson kushtet e mësipërme, si dhe ato të neneve 453 dhe 454 të këtij Kodi, gjykata njofton palën që të ndreqë të metat brenda 5 ditëve, në të kundërt ankimi kthehet.*

K.Pr.C., neni 476, pika 3 dhe 4: *Sekretaria e gjykatës që ka dhënë vendimin e kundërshtuar, përcjell zyrtarisht në sekretarinë e Gjykatës së Lartë dosjen përkatëse së bashku me dokumentet e mësipërme.*

Këtë qëndrim mban edhe doktrina e huaj sipas së cilës në varësi të kualifikimit të stafit, sekretariati i gjykatës mund të kryejë një shqyrtim paraprak të kërkesës në mënyrë për të shmangur kërkesat haptazi të pabazuara sa më shumë të jetë e mundur. Megjithatë duke qenë se kompetencat gjyqësore nuk mundet që ti delegohen sekretariatit, mendimi i tij mund të jetë vetëm këshillimor. Në këtë mënyrë sekretariati mund të vejë në dukje mangësitë e kërkesës tek kërkuesi dhe ti kërkojë atij nëse ai do të vazhdojë me to, apo ti paraqesë një rekomandim gjykatësit për të mospranuar kërkesën.<sup>841</sup> Për sa më sipër mund të themi se detyra e Drejtorisë Gjyqësore dhe të Dokumentacionit, është regjistrimi i menjëhershëm i kërkesave që i paraqiten Gjykatës Kushtetuese dhe përcjelljen e tyre Kryetarit të Gjykatës, sipas kërkesave të nenit 27 pika 2 të LGJK-së.<sup>842</sup>

Mbasi kërkesa i dorëzohet Kryetarit të Gjykatës është ky i fundit i cili cakton gjyqtarin – relator të çështjes. Në ndryshim nga rregulli i caktimit të çështjes me short për gjyqtarët, i njohur për disa gjykata kushtetuese, rregullat procedurale të ligjit organik shqiptar njohin zgjedhjen e gjyqtarit relator, në bazë të ngarkesës, sipas vlerësimit të Kryetarit të Gjykatës. Të dyja format e përzgjedhjes së gjyqtarit relator, pavarësisht avantazheve dhe disavantazheve të tyre, janë të njohura dhe të pranueshme për natyrën e gjykimit kushtetues.<sup>843</sup>

Sipas LGJK-së, kërkesa më pas duhet që të shqyrtohet nga një strukturë e gjykatës e quajtur “Kolegji” dhe i përbërë nga tre gjyqtarë.<sup>844</sup> Shqyrtimi paraprak i kërkesës nga një kolegj i tillë me përbërje të ngushtë, pra jo nga trupa gjyqësore në tërësi, rezulton se është pasqyrim i nenit 133 pika 1 të Kushtetutës, që parashikon se “pranimi i ankesave për gjykim vendoset nga një numër gjyqtarësh, siç përcaktohet me ligj”. Mesa duket arsyet e zgjedhjes së një formule të tillë lidhen me efektivitetin e vendimmarrjes në Gjykatën Kushtetuese. Duke qenë një trupë më e vogël gjyqësore ajo ka mundësi seleksionimi dhe vendimmarrje më të shpejtë në krahasim me rastin tjetër nëse do të investohej e gjithë trupa gjyqësore për shqyrtimin e çdo kërkesë. Megjithatë përsëri shqyrtimi nga vetëm një e treta e trupës gjyqësore mund të krijojë probleme të shumta. Kështu nga analiza e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, rezulton se për të njëjtën kërkesë ka pasur edhe vendimmarrje të ndryshme nga kolegje të ndryshme të Gjykatës Kushtetuese.<sup>845</sup> Pra, në fillim nga një kolegj i Gjykatës është vendosur moskalimi i çështjes për gjykim, kurse nga ana tjetër kur kërkesa është riparaqitur një tjetër Kolegj i kësaj Gjykate ka çmuar se kërkesa përmban shkaqe kushtetuese dhe për rrjedhojë ka vendosur kalimin e saj në gjykim.

Nga këndvështrimi i subjektit kërkuar kjo situatë paraqitet në disfavor të tij. Kështu mund të ngrihet pretendimi se mbi çfarë baze një pakicë gjyqtarësh vendosin për fatin e çështjes së tij,

---

*Kur nuk plotësohen këto kushte, palës i caktohet një afat 10-ditor për të bërë plotësimet dhe, nëse pas këtij afati nuk bëhen plotësimet, rekursi kthehet. Në këtë dispozitë pavarësisht se nuk përcaktohet gjykata si struktura përkatëse për të vendosur për plotësimin e të metave të rekursit, nga mënyra se si është formuluar dispozita rezulton se sekretaria ka vetëm për detyrë të përcjellë dosjen gjyqësore sëbashku me aktet, pra, për rrjedhojë kompetenca për konstatimin e të metave dhe kthimin për plotësim i takon trupës gjyqësore.*

<sup>841</sup>Seibert, Helga, “Admissibility requirements for constitutional complaints and mechanisms for avoiding an excessive case load”, botuar në “The protection of fundamental rights by the constitutional court”, Koleksioni “Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15”, botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998, fq. 151.

<sup>842</sup>LGJK, neni 27, pika 2: *Kërkesa i dorëzohet Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, i cili cakton një relator që përgatit çështjen për shqyrtimin paraprak të saj.*

<sup>843</sup>Sadushi, Sokol, “Drejtësia Kushtetuese në zhvillim”, Shtëpia Botuese “Toena”, Tiranë 2012, fq.361.

<sup>844</sup>LGJK, neni 31, pika 1: *Kërkesa shqyrtohet paraprakisht nga kolegji i përbërë nga 3 gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, ku bën pjesë dhe relatori.*

<sup>845</sup>Vendimet nr.21, datë 21.04.2010 dhe nr.60, datë 28.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese.

ndërkohë që subjekti kërkues mund të jetë i aftë të bindë pjesën tjetër të gjyqtarëve që kërkimet e tij janë të bazuara. Për rrjedhojë në këtë rast për kërkuesin do të ishte një situatë me e preferueshme dhe më e qartë për pozicionin e tij nëse kërkesa do të shqyrtohej nga e gjithë trupa gjyqësore. Megjithatë midis këtyre dy pozicioneve të kundërta, ligjvënësi zgjodhi t'i japë më shumë rëndësi efektivitetit të shqyrtimit të kërkesave në fazën seleksionuese. Por, për të garantuar edhe një proces sa më të drejtë për kërkuesin, LGJK përcakton që vendimmarrja e Kolegjit si për kalimin për shqyrtim në seancë plenare, apo për moskalimin për shqyrtim, të jetë gjithmonë unanime. Kjo zgjedhje e legjislatorit është në përputhje edhe me standardet e vendeve të tjera ku gjithmonë sugjerohet që kërkesat të shqyrtohen nga një panel i vogël gjyqtarësh të cilët vendosin në mënyrë unanime mbi bazën e relacionit të paraqitur nga gjyqtari relator. Kjo shman një pjesë të ngarkesës me të cilën përballen Gjykatat Kushtetuese.<sup>846</sup>

LGJK-ja nuk përmban parashikime në lidhje me mënyrën e formimit të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese. Këtë rregullim e gjejmë në rregulloren e Gjykatës, ku është përcaktuar se në gjykatë formohen tre kolegje. Ndarja e gjyqtarëve në kolegje bëhet nga Kryetari i Gjykatës. Njëri kolegji drejtohet nga Kryetari, ndërsa dy të tjerët nga gjyqtari më i vjetër në moshë.<sup>847</sup> Pra, duke ruajtur frymën e LGJK-së, rregullorja ja lë si kompetencë po Kryetarit të Gjykatës që të caktojë përbërjen e Kolegjeve. Duke qenë se Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë anëtarë dhe një kolegji kërkon tre anëtarë që të jetë funksional sipas ligjit, atëherë natyrshëm që në Gjykatën Kushtetuese formohen tre kolegje. Nga ana tjetër, Kryetari duke caktuar relatorin e çështjes vetiu ka caktuar edhe Kolegjin që do të shqyrtojë paraprakisht kërkesën.

Organizimi i mbledhjeve të Kolegjit është detyrë e drejtuesit të kësaj strukture gjyqësore, ndërsa përgatitja e materialeve për çdo çështje që do të shqyrtohet është detyrë e relatorit. Në rast se ndonjëri prej gjyqtarëve nuk mund të marrë pjesë përkohësisht atëherë mbledhja e kolegjit shtyhet. Por në rast se pjesëmarrja e gjyqtarit vihet në diskutim për një kohë të gjatë atëherë rregullorja i jep të drejtë Kryetarit që të caktojë për këtë kolegji një gjyqtar tjetër.

Rëndësi në këtë fazë merr relacioni i këshilltarit të gjyqtarit – relator, ku këshilltari përveç përshkrimit të fakteve dhe të argumentave të çështjes jep edhe mendimin e tij për kalimin ose jo të çështjes në seancë. Në këtë fazë, relatori nuk paraqet asnjë mendim paraprak, por diskuton me kolegjet e tij mbi materialin e paraqitur nga këshilltari. Parashikimi i kësaj zgjidhje ndoshta ka pasur si qëllim që të shmangë paragjykimin e çështjes nga gjyqtari – relator, duke i vendosur të tre gjyqtarët në pozita të barabarta në lidhje me vendimmarrjen për këtë çështje.

Referuar parashikimeve të nenit 31 të LGJK-së rezulton se Kolegji ka të drejtë që në këtë fazë të gjykimit të kryejë këto veprime: a) të verifikojë nëse kërkesa plotëson kushtet formale të kërkuar nga ligji; b) nëse subjekti kërkues është nga ato subjekte që mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, pra legjitimiteti i tij; c) nëse çështja e paraqitur është kompetencë e Gjykatës Kushtetuese.

Në lidhje me elementin e parë, Kolegji Seleksionues ka për të detyrë që të verifikojë nëse kërkesa e paraqitur plotëson elementët e kërkuar nga nenet 28 dhe 29 të LGJK-së, ose në rastin e vënies në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese nga gjykatat e zakonshme, nëse plotësohen kriteret e nenit 68 të LGJK-së. Ky është veprimi i parë që duhet kryer prej tij. Në këtë fazë Kolegji nuk verifikon legjitimitetin e subjektit apo kompetencën e gjykatës për të shqyrtuar çështjen. Nëse

<sup>846</sup> Seibert, Helga, "Admissibility requirements for constitutional complaints and mechanisms for avoiding an excessive case load", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15", botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998, fq. 152.

<sup>847</sup> Rregullorja, neni 3, pika 1.



kërkesa nuk i plotëson kriteret e LGJK-së atëherë ajo i kthehet subjektit me qëllim plotësimin e të metave të saj.<sup>848</sup> Gjithsesi kontrolli që bën Kolegji në bazë të kësaj pike nuk duhet të jetë shumë i rreptë dhe i detajuar. Siç e ka pranuar doktrina kushtetuese kriteret e pranueshmërisë nuk duhet që të interpretohen në atë mënyrë që një person, të cilit i janë cënuar të drejtat, i mohohet aksesit në Gjykatën Kushtetuese.<sup>849</sup>

Nëse kriteret e LGJK në lidhje me kushtet formale janë të plota ose plotësohen më vonë dhe brenda afatit të vendosur nga Gjykata Kushtetuese, atëherë Gjykata kalon në analizën e dy elementëve të tjerë, legjitimitimin edhe kompetencën. Në lidhje me legjitimitimin, Gjykata Kushtetuese këtë element e ka ndarë në 3 kriterë. Kështu kriteri i parë është kriteri *ratione personae*, ku Gjykata Kushtetuese analizon së pari nëse subjekti është nga rrethi i subjekteve që parashikon Kushtetuta për vënien e saj në lëvizje dhe së dyti, nëse ky subjekt ka mundësi që të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për këtë lloj gjykimi kushtetues. Siç e kemi sqaruar edhe në pjesën kur kemi folur për pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues, subjektet kërkuese duhet që për lloje të veçanta gjykimi të plotësojnë kushte të përcaktuara. Kriteri i dytë është *ratione temporis* ku Gjykata Kushtetuese analizon nëse kërkesa është paraqitur brenda afateve të përcaktuara nga LGJK për lloje të veçanta të gjykimit kushtetues. Kriteri i tretë është *ratione materiae* ku Kolegji i Gjykatës Kushtetuese analizon nëse subjekti kërkues ka interes të drejtpërdrejtë të sigurtë dhe vetjak për çështjen që ai ngre përpara Gjykatës Kushtetuese. Është e kuptueshme që analiza e këtij kriteri bëhet vetëm në ato raste kur një gjë e tillë kërkohet nga natyra e gjykimin kushtetues. Mosplotësimi qoftë edhe i njërit prej këtyre kriterëve sjell si pasojë moslegjitimitimin e subjektit kërkues.

Përsa i përket kriterit të kompetencës, Gjykata analizon faktin nëse kërkimet e subjektit kërkues përfshihen brenda juridiksionit të saj. Si rregull juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese është përcaktuar në Kushtetutë dhe ligjin e saj organik dhe për rrjedhojë çdo kërkim tej këtyre rasteve nuk përbën juridiksion kushtetues dhe Kolegji duhet të vendosë moskalimin e çështjes në seancë plenare. Raste të tilla kanë qenë p.sh. kërkimi i antikushtetutshmërisë së një akti individual por në një gjykim abstrakt. Shembuj të tjerë kemi në rastin e gjykimin kushtetues për një proces të rregullt ligjor, kur kërkuesit kanë pasur si kërkim vlerësimin e provave, të mënyrës së zbatimit të ligjit etj.

Një tjetër element i shtuar nga praktika gjyqësore e kësaj Gjykate është nëse kërkesa është haptazi e pabazuar. Në këtë rast Gjykata vlerëson nëse kërkimet e subjektit kërkues gjejnë një mbështetje *prima facie* në aktet që i japin bashkëlidhur kërkesës. Në rast se kërkimet janë abuzive dhe nuk mbështeten në asnjë prej akteve shoqëruese atëherë Kolegji vendos moskalimin e saj në seancë.

Po kështu rezulton se Kolegji verifikon edhe faktin nëse kjo kërkesë është shqyrtuar më parë nga Gjykata Kushtetuese, në seancë, në mbledhjen e gjyqtarëve apo në Kolegji. Në rast se një fakt i tillë konstatohet atëherë Kolegji vendos moskalimin e çështjes pasi ndodhet përpara një tjetër vendimi të dhënë prej saj, pra përpara efekteve të gjësë së gjykuar (*res judicata*). Megjithatë nuk jemi përpara kësaj situatë në rast se kërkesa megjithëse është paraqitur edhe më parë nga i njëjti subjekt dhe me të njëjtin objekt përmban shkaqe të ndryshme nga kërkesa e

<sup>848</sup> Vendimet nr.52, datë 15.6.2009, nr.31, datë 5.3.2012 dhe nr.30, datë 22.2.2013 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese etj.

<sup>849</sup>Seibert, Helga, "Admissibility requirements for constitutional complaints and mechanisms for avoiding an excessive case load", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15", botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998, fq. 146.



paraqitur më parë. Kjo konsiderohet një kërkesë e re dhe për rrjedhojë i nënshtrohet shqyrtimit nga fillimi.

Mbas diskutimit kalohet në votim. LGJK-ja nuk na thotë për mënyrën e votimit të gjyqtarëve, por mendoj se në këtë rast, bazuar në parimet e përgjithshme voton i pari, relatori i çështjes, më pas gjyqtari tjetër dhe në fund drejtuesi i Kolegjit.

Për të zbutur disi efektin e një vendimmarrjeje nga pakica e gjyqtarëve në lidhje me një kërkesë të paraqitur, neni 31 i LGJK-së kërkon detyrimisht që vendimmarrja e Kolegjit të jetë unanime. Pra, si në rastin e kalimit të çështjes për gjykim në seancë plenare, ashtu edhe në rastin e moskalimit, të tre anëtarët duhet që të votojnë njëzëri. Përndryshe do të ekzistonte rreziku që kolegji të zhvillonte një jurisprudencë të tijën dhe të vendosë mbi çështje të cilat nuk janë vendosur nga vetë gjykata në seancë plenare.<sup>850</sup> Në rast se ky vendim është pozitiv për kërkesën, atëherë çështja kalon për gjykim dhe Kolegji ka të drejtë që të vendosë më pas në lidhje me subjektet e interesuara. Kështu Kolegji do të vendosë nëse të gjitha subjektet e thirrura nga kërkuuesi, e plotësojnë kriterin e interesit të drejtpërdrejtë ose jo. Në rast se po kolegji merr vendim për thirrjen e tyre, në të kundërtën vendos që ato të mos thirren nga Gjykata.<sup>851</sup> Por nga ana tjetër siç e kemi sqaruar edhe më sipër Kolegji mundet që të vendosë edhe për thirrjen e subjekteve të tjera të interesuara të cilët nuk janë thirrur nga kërkuuesi. Këto subjekte mund të thirren për shkak të interesit vetjak që mund të kenë në çështjen në shqyrtim, ose mund të thirren pasi Kolegji mendon se mund të kontribuojnë në të mirë të gjyqimit kushtetues.

## 1.2 Gjykimi i çështjes nga Mbledhja e Gjyqtarëve.

Më sipër u shprehëm se vendimmarrja e Kolegjit në lidhje me kalimin apo moskalimin e çështjes në seancë plenare duhet që të jetë unanime. Në mungesë të këtij unanimiteti, kërkesa kalon për gjykim në Mbledhjen e Gjyqtarëve,<sup>852</sup> e cila në këtë rast do të shqyrtojë nëse çështja do të kalojë apo jo për gjykim. Në mbledhjen e gjyqtarëve marrin pjesë të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, por referuar me analogji nenit 32 pika 2 të LGJK duhet që të jenë të paktën dy të tretat e anëtarëve, pra minimalisht gjashtë gjyqtarë.

Mbledhjes së Gjyqtarëve, para shqyrtimit të çështjes, i vihet në dispozicion, relacioni i gjyqtarit relator, ku përshkruhet në mënyrë të përmbledhur përmbajtja e kërkesës e shkaqeve dhe argumentave të parashtruara nga kërkuuesi si dhe argumentet “pro” dhe “kundër” kalimit të kërkesës në seancë plenare, relacioni me shkrim i këshilltarit të paraqitur në Kolegji, si edhe dokumente të tjera p.sh vendimet gjyqësore që kanë lidhje me çështjen, prova shkresore të paraqitura nga kërkuuesi, apelimet dhe rekursat, si dhe çdo dokument tjetër që kolegji e mendon të nevojshëm.<sup>853</sup>

Mbledhja e Gjyqtarëve, drejtohet nga Kryetari i Gjykatës ose nga një gjyqtar i autorizuar prej tij. Në Mbledhjen e Gjyqtarëve diskutohen po të njëjta kriteret dhe elemente që shqyrtohen

<sup>850</sup> Seibert, Helga, “Admissibility requirements for constitutional complaints and mechanisms for avoiding an excessive case load”, botuar në “The protection of fundamental rights by the constitutional court”, Koleksioni “Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15”, botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998, fq. 155.

<sup>851</sup> Në vendimin nr.16, datë 19.04.2013 rezultoi se pavarësisht se kërkuuesi kishte thirrur si subjekt të interesuar edhe Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, që kishte qënë me pozitën procedurale të personit të tretë në gjykimin pranë gjykatave të zakonshme, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese vendosi që të mos e thërrasë në gjykimin kushtetues, përderisa në gjykimin e zakonshëm kishte mbajtur një qëndrim indiferent në lidhje me çështjen.

<sup>852</sup> LGJK, neni 31, pika 3.

<sup>853</sup> Rregullorja, neni 7, pika 2.

nga Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, si legjitimimi i subjektit (në tre format e tij *ratione personae, temporis* dhe *materiae*), kompetenca e Gjykatës Kushtetuese, si edhe fakti nëse kërkesa nuk është haptazi e pabazuar.

Pavarësisht numrit pjesëmarrës të gjyqtarëve vendimet duhet që domosdoshmërisht të merren me të paktën pesë vota,<sup>854</sup> duke vendosur sipas rastit kalimin e çështjes për gjykim në seancë plenarë ose moskalimin e saj. Në rast se vendoset kalimi i çështjes në gjykim Mbledhja e Gjyqtarëve vendos edhe për subjektet e interesuara që do të thirren. Një kompetencë e veçantë që i takon Mbledhjes së Gjyqtarëve dhe jo Kolegjit është edhe fakti se referuar nenit 45 të LGJK-së Mbledhja e Gjyqtarëve mund të vendosë edhe pezullimin e aktit objekt kërkesë kryesisht ose me kërkesë të palëve.

Një çështje e diskutueshme që mund të paraqitet në këtë fazë është kur votat e gjyqtarëve për kalimin ose moskalimin e çështjes ndahen në mënyrë të barabartë, ose në atë mënyrë që nuk arrihet shumica e kërkuar nga Kushtetuta. LGJK-ja nuk na jep zgjidhje për këtë situatë, por duke zbatuar me analogji nenin 74 të LGJK-së rezulton se Mbledhja e Gjyqtarëve duhet që të vendosë refuzimin e çështjes edhe në këtë fazë të gjykimit. Ky refuzim i kërkesës nuk e pengon kërkuesin që të riparaqesë kërkesën në rast se krijohen kushte për formimin e shumicës së kërkuar.

### **1.3 Natyra e vendimit të kalimit të çështjes për gjykim në seancën plenare dhe e vendimit për moskalim në seancë plenare.**

Si Kolegji ashtu edhe Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në përfundim të shqyrtimit të kërkesës dhe materialeve bashkëlidhur vendosin nëse çështja do të kalojë apo jo në gjykim. Në rastin se vendimmarrja është pozitive atëherë vendoset kalimi i çështjes në gjykim. Megjithatë problemi i vlerësimit të legjitimitetit të subjektit kërkues dhe i kompetencës së Gjykatës për zgjidhjen e çështjes në këtë rast nuk konsiderohet i përfunduar. Kështu në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese është vërejtur se megjithëse çështja kishte kaluar për gjykim, Gjykata Kushtetuese është shprehur në seancë plenarë për legjitimitetin apo moslegjitimitetin e subjektit kërkues.

Për këtë arsye është e nevojshme që të përcaktohet natyra e vendimeve që merr Kolegji/Mbledhja e Gjyqtarëve gjatë fazës së seleksionimit. Duke analizuar parashikimet e LGJK, por më tepër jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese vërejmë se në rastin kur është vendosur moskalimi i çështjes në seancë plenare vendimi konsiderohet si i formës së prerë dhe ka efektin e gjësë së gjykuar. Ndërsa kur vendos kalimin e çështjes në seancë plenare atëherë ky vendim konsiderohet si i ndërmjetëm.

Duke i analizuar sipas rradhës mund të themi se vendimi i Kolegjit/Mbledhjes së Gjyqtarëve që ka vendosur moskalimin e çështjes në seancë plenare është vendimi përfundimtar për çështjen e cila në këtë rast është i formës së prerë. Në jurisprudencë, Kolegji,<sup>855</sup> Mbledhja e Gjyqtarëve<sup>856</sup> apo Gjykata Kushtetuese në seancë plenare<sup>857</sup> si rregull, sa herë ka konsultuar që

<sup>854</sup> Kushtetuta, neni 133 pika 2.

<sup>855</sup> Vendimet nr.90, datë 16.10.2009, nr.45, datë 28.4.2011, nr.57, datë 3.6.2011, nr.96, datë 16.9.2011, nr.101, datë 22.9.2011, nr.77, datë 15.6.2012, nr.127, datë 4.12.2012, nr.1, datë 15.6.2013 dhe nr.32, datë 26.2.2013 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>856</sup> Vendimet nr.14, datë 19.2.2009 dhe nr.15, datë 19.2.2009 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>857</sup> Vendimi nr.60, datë 28.12.2012 i Gjykatës Kushtetuese, par.15: *Gjykata vëren se në kërkesën e re, objekt i këtij gjykimi, kërkuesi nuk ka parashtruar asnjë shkak të ri apo argument shtesë për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve të tij për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se vendimi nr.61, datë 09.06.2011, në të cilin është vlerësuar se pretendimet e ngritura nga kërkuesi janë haptazi të*

çështja ka qenë gjykuar me parë nga Kolegji ka vendosur sipas rastit moskalimin e çështjes apo rrëzimin e saj, për shkak të efektit të gjësë së gjykuar. Për më tepër në një rast Kolegji është shprehur në lidhje me pretendimet e një kërkuesi se ishin të ngjashme me kërkimet e një kërkuesi tjetër të cilat ishin konsideruar si haptazi të pabazuara më parë.<sup>858</sup> Megjithatë duhet theksuar se në këtë rast Kolegji u shpreh fillimisht me terma të përgjithshëm mbi pabazueshmërinë e pretendimeve të kërkuesit dhe i referohet vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve për shkaqet se përse i konsideron si të pabazuar. Pra, në këtë rast Kolegji i Gjykatës Kushtetuese e ka shmangur pjesën e arsytimit të vendimit duke iu referuar një tjetër vendimi të marrë prej saj. Përjashtimisht kërkesat e paraqitura nga i njëjti subjekt dhe për të njëjtin objekt janë marrë në shqyrtim në ato raste kur janë paraqitur shkaqe të tjera të cilat nuk janë shqyrtuar më parë, mjafton që këto kërkime të reja të jenë paraqitur brenda afateve procedurale.

Në këtë drejtim vlen për t'u theksuar se Gjykata Kushtetuese në këtë lloj procedure nuk është se zbaton institutin e rishikimeve të vendimeve të saj, por e konsideron nga pikëpamja procedurale si një kërkesë të re e cila nëse është paraqitur brenda afatit dhe konsiderohet e bazuar atëherë ndjek hapat e tjerë proceduralë për shqyrtimin e saj.<sup>859</sup>

Baza juridike e cila shërben në këtë rast për këtë lloj vendimmarrje është neni 132, pika 1 e Kushtetutës që i konsideron vendimet e Gjykatës Kushtetuese si përfundimtare. Jurisprudenca e kësaj Gjykate e ka shtrirë zbatimin e kësaj dispozite edhe për vendimet e moskalimit të çështjeve në seancën plenare, model ky që ndiqet edhe nga vende të tjera.<sup>860</sup>

Megjithatë ky qëndrim jo gjithmonë është ndjekur nga vetë Gjykata Kushtetuese. Kështu, me interes do të ishte analizimi i një rasti konkret, ku Kolegji i Gjykatës Kushtetuese mori në shqyrtim kërkesën e një individ i cili ankohej për proces të parregullt ligjor. Pretendimet që kishte ngritur individi kishin të bënin me (i) shkeljen e parimit të barazisë së armëve; (ii) zhvillimin e gjykimit në mungesë; (iii) mangësitë në arsytimin e vendimit; (iv) mohimin e mundësive efektive ligjore për mbrojtje; (v) moszbatimin e parimit të paanësisë, sepse në gjykimin e kërkesës për rishikim ka marrë pjesë i njëjti gjyqtar, i cili me vendimin nr.566, datë 23.10.2002 ishte shprehur për fajësinë e kërkuesit. Në përfundim të shqyrtimit Kolegji i Gjykatës Kushtetuese mbajti qëndrimin se pretendimet e kërkuesit janë haptazi të pabazuara dhe për rrjedhojë vendosi moskalimin e çështjes në seancë plenare.<sup>861</sup>

Kërkuesi e riparqiti dhe njëherë kërkesën dhe një tjetër Kolegji i Gjykatës Kushtetuese vendosi kalimin në seancë plenare. Gjykata Kushtetuese e ndodhur përballë kërkesës së prokurorisë për ta konsideruar çështjen si gjë të gjykuar, u shpreh se:

---

*pabazuara dhe është vendosur moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare, përbën pengesë në aspektin kushtetues, për sa kohë që ajo ka mbajtur një qëndrim përfundimtar lidhur me të njëjtat shkaqe të cilat kërkuesi, në thelb, i ka ngritur përsëri në këtë kërkesë.*

<sup>858</sup> Vendimi nr.26, datë 17.3.2011 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese: *Përveç kësaj Kolegji vë në dukje, gjithashtu, se pretendimet që kërkuesi parashtron para Gjykatës Kushtetuese nëpërmjet kërkesës në shqyrtim janë të njëjta me pretendimet e parashtruara më parë para kësaj Gjykate nga i vëllai i tij N.P., pretendime të cilat Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese i ka dhënë përgjigje me vendimin e saj nr. 27 datë, 08.04.2010, duke vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, për shkak të pabazueshmërisë dhe pathemelsisë së këtyre pretendimeve.*

<sup>859</sup> Vendimi nr.88, datë 22.7.2011 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>860</sup> Mavcic, Arne, "The protection of fundamental rights by the constitutional court and practice of the Constitutional Court of the Republic of Slovenia", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15", botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998, fq. 217.

<sup>861</sup> Vendimi nr.74, datë 18.9.2009 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.



8. Kërkesa në shqyrtim është gjykuar nga Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (këtu e në vijim: Kolegji), i cili me vendimin nr.74, datë 18.09.2009 ka vendosur "Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare". Nga analiza integrale e këtij vendimi, Gjykata vëren se, ndonëse kërkuesi ka ngritur një sërë pretendimesh, Kolegji, në vendimin e tij i ka dhënë përgjigje vetëm pretendimeve në lidhje me "zhvillimin e gjykimin në mungesë të kërkuetit apo mbrojtësit të tij" dhe "të parimit të paanësisë së gjykatës", ndërkohë që nuk rezulton të jetë evidentuar në vendim dhe të ketë marrë përgjigje pretendimi i kërkuetit mbi "garancinë e dhënë nga Shteti Shqiptar për rigjykimin e tij dhe garantimin e një procesi ku do të siguroheshin standardet e gjithëpranuara të mbrojtjes".

9. Mos shqyrtimi nga Kolegji i shkakut ligjor që lidhet me garancinë e dhënë nga Shteti Shqiptar për rigjykimin e kërkuetit, nuk krijon pengesë për Gjykatën që të përfshijë këtë çështje në juridiksionin e saj kushtetues. Gjykata, në praktikën e saj, ka pranuar rishqyrtimin e kërkesës së të njëjtit individ, me të njëjtin objekt, kur përmes një kërkesë tjetër, brenda afatit 2 vjeçar të parashikuar nga ligji i saj organik, ka argumentuar një shkak të ri për antikushtetutshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.<sup>862</sup>

Në thelb qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese mbështetet në faktin se Kolegji nuk i ka dhënë përgjigje njërit prej pretendimeve të ngritura në kërkesën fillestare dhe konkretisht, zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Konventa për Ekstradimin. Pavarësisht kësaj rezulton se Gjykata Kushtetuese e ka shfuqizuar vendimin e Gjykatës së Lartë objekt kërkesë me shkakun se:

*Bazuar në këtë arsytim, të ndikuar edhe nga doktrina dhe jurisprudenca kushtetuese, Gjykata vlerëson se, në rastin në shqyrtim, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese nuk rezulton të ketë pasur arsye të përligjura për të ndryshuar qëndrimin konsekuent të jurisprudencës kushtetuese, në lidhje me cenimin e parimit të paanësisë. Për rrjedhojë, Gjykata konkludon se në kuptim edhe të standardit për një qëndrueshmëri në vendimmarrjen kushtetuese, pretendimi i kërkuetit për pjesëmarrjen e të njëjtit gjyqtar në të njëjtën çështje, ka cenuar një prej elementëve të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor që lidhet me besueshmërinë e gjykatës për të qenë objektivisht e paanshme. Për rrjedhojë, kërkesa sa i përket këtij pretendimi të kërkuetit është e bazuar dhe duhet pranuar.<sup>863</sup>*

Në fakt në lidhje me këtë pretendim të kërkuetit dhe konkretisht paanshmëria e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë kishte mbajtur qëndrim edhe Kolegji në vendimin e tij të mëparshëm duke u shprehur:

*Përsa i përket pretendimit për cenim të parimit të paanësisë nga pjesëmarrja në të dy gjykimet e çështjeve të një anëtari të Gjykatës së Lartë, konstatohet se gjykimet nuk janë të njëjta. Me vendimin nr.566, datë 23.10.2002 Kolegji ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, ndërsa me vendimin nr.14, datë 03.10.2008, Kolegji ka vendosur për mospranimin e kërkesës për rishikim. Për të vërtetuar shkeljen e parimit të paanshmërisë në një proces gjyqësor duhet dalluar qëndrimi subjektiv, në të cilin bëhen përpjekje për t'u siguruar lidhur me bindjen personale të një gjyqtari në çështjen*

<sup>862</sup> Vendimi nr.21, datë 29.4.2010 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>863</sup> Po aty, parag.18.



*konkrete si dhe qëndrimi objektiv, i cili përqendrohet në vlerësimin e garancive të njaftueshme që mënjanojnë çfarëdolloj dyshimesh që janë të justifikueshme në këtë sferë (vendimi nr.37, datë 22.12.2003 i Gjykatës Kushtetuese). Paanësia e gjykatës në një proces pranohet se është një garanci kushtetuese për çdo individ, por nga ana tjetër, pranohet gjithashtu, se gjykimi, konsiderohet i paanshëm derisa njëra nga palët, në rrjedhën e procesit, të paraqesë prova për të vërtetuar të kundërtën (vendimi nr.7, datë 11.03.2008 i Gjykatës Kushtetuese). Kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë lloj argumenti apo treguesi se përse gjyqtari mund të ketë qenë i anshëm në procesin gjyqësor.<sup>864</sup>*

Duke i analizuar këto dy vendimmarrje, atë të Kolegjit dhe të Gjykatës Kushtetuese në seancë plenare rezulton se Gjykata Kushtetuese në shkelje të parimit të gjësë së gjykuar ka marrë në shqyrtim një pretendim të kërkuesit për të cilin Kolegji i Gjykatës kishte mbajtur një qëndrim të shprehur. Ky veprim i Gjykatës bie në kundërshtim edhe me konkluzionet e saj në po të njëjtin vendim, ku ajo shprehej se kërkesa po merrej në gjykim pasi Kolegji nuk kishte mbajtur qëndrim në lidhje me pretendimin për cënimin e detyrimeve ndërkombëtare të shtetit shqiptar. Duke rishqyrtuar pretendimin në lidhje me shkeljen e pretendimit të paanshmërisë Gjykata ka cënuar vetë parimin e gjësë së gjykuar. Ndërsa në lidhje me pretendimin për moszbatimin e detyrimeve ndërkombëtare Gjykata Kushtetuese mbajti qëndrimin që:

*Në këtë drejtim, Gjykata thekson se, në kuptim të rregullimeve të parashikuara në nenin 122 të Kushtetutës, interpretimi i konceptit kushtetues të vetëzbatueshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat kanë epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të, është në vlerësimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili ka në juridiksionin e vet zgjidhjen përfundimisht të çështjes konkrete.<sup>865</sup>*

Ky qëndrim i Gjykatës Kushtetuese për këtë pretendim tregon se ajo nuk e ka shfuqizuar vendimin e Gjykatës së Lartë për këtë shkak, për të cilin kufizohet vetëm t'ia verë në dukje që ta ketë në konsideratë. Përkundrazi edhe në këtë rast rezulton se shkak kryesor për të cilin Gjykata Kushtetuese pranoi kërkesën e individit për pretendimin e cënimit të parimit të paanshmërisë, pretendim që ishte shqyrtuar më parë dhe që ishte konsideruar i pabazuar. Megjithatë ky rast ka mbetur i izoluar dhe nuk është shfaqur më në jurisprudencën kushtetuese, e cila ka mbajtur një qëndrim konstant në këtë drejtim.

Duke filluar nga viti 2009 Gjykata Kushtetuese ka krijuar praktikën e arsytimit të vendimeve gjyqësore për moskalimin e çështjes në seancë, duke hequr dorë nga qëndrimi i mëparshëm i arsytimit në mënyrë të kufizuar "de plano". Të dyja këto qëndrime kanë avantazhet dhe disavantazhet e tyre. Shqyrtimi paraprak mund të lehtësohet shumë nëse nuk është e nevojshme që të jepen arsye për refuzimin e kërkesës. Është me e lehtë të biesh dakort për argumentat e paraqitura në një relacion të brendshëm se sa në një tekst i cili i dërgohet kërkuesit apo edhe mund të publikohet dhe humbet shumë kohë në arsytimin e vendimit, duke mos ia dedikuar këtë kohë çështjeve të tjera më të rëndësishme. Nga ana tjetër respekti për Gjykatën Kushtetuese zvogëlohet shumë nëse një numër i madh kërkesash kushtetuese, nuk pranohen pa dhënë asnjë arsye. Prandaj është një vendim i vështirë për të përcaktuar nëse është më e rëndësishme të shpjegosh arsyet për mos pranimin e kërkesës kushtetuese apo për të

<sup>864</sup> Vendimi nr.74, datë 18.9.2009 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>865</sup> Vendimi nr.21, datë 29.4.2010 i Gjykatës Kushtetuese, parag.22.

ruajtuar kapacitetin punues të Gjykatës dhe aftësisë së saj për t'i dedikuar më shumë kohë çështjeve të rëndësishme.<sup>866</sup>

Duke iu referuar përgjithësisht praktikave që ndjekin gjykatat kushtetuese të huaja rezulton se zgjedhja ka qenë në favor të arsytimit të këtyre vendimeve, zgjedhje që ka bërë dhe Gjykata jonë Kushtetuese.

Në lidhje me vendimmarrjen tjetër të Kolegjit/Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, atë të kalimit të çështjes në seancë plenare, rezulton se ky vendim nuk është përfundimtar nga ana procedurale. Kështu, ky vendim nuk i jep një zgjidhje përfundimtare gjykimit kushtetues por përkundrazi e çon atë në një fazë tjetër dhe pikërisht atë të shqyrtimit në themel. Pavarësisht kësaj nuk rezulton që edhe vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me legjitimitimin e subjektit kërkues dhe kompetencën e Gjykatës Kushtetuese, e cila merret në këtë fazë paraprake të jetë i formës së prerë. Nga jurisprudenca kushtetuese rezulton se Gjykata Kushtetuese ka marrë në shqyrtim pretendimet e subjekteve të interesuara për mungesën e legjitimitetit të kërkuesit apo për mungesën e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese. Kjo mundësi për subjektet e interesuara dhe mundësia procedurale e Gjykatës Kushtetuese për t'u rishprehur në lidhje me legjitimitetin e kërkuesit dhe juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, pavarësisht vendimmarrjes e Kolegjit/Mbledhjes së Gjyqtarëve, garanton edhe procesin e rregullt ligjor. Kështu subjektet e interesuara nuk kanë mundësi procedurale që të shprehen në lidhje me këto dy elemente procedurale gjatë kohës kur kërkesa është në fazën e shqyrtimit paraprak të saj. Kjo pjesë e procedurës shqyrtohet në dhomë këshillimi dhe pa praninë e palëve. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese nuk pranon ndërhyrje nga subjektet e tjera, qoftë edhe në formën e akteve të shkruara. Sipas Gjykatës këto pretendime mund të paraqiten vetëm nëse çështja kalon për gjykim në seancë plenare.<sup>867</sup> Për rrjedhojë pjesëmarrësit e tjerë në gjykimin kushtetues kanë mundësi që gjatë gjykimit në seancë plenare të paraqesin prapësimet e tyre në lidhje me kërkesën për rivendosje në afat, duke venë pikërisht në diskutim legjitimitimin e kërkuesit dhe të juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese. Nëse Gjykata Kushtetuese bindet nga këto prapësime atëherë ajo në përfundim të gjykimit vendos rrezimin e kërkesës për mungesë legjitimi të kërkuesit, apo për mungesë juridiksioni të Gjykatës.

#### 1.4 Procedurat e veçanta në fazën paraprake.

Në përgjithësi procedura e shpjeguar më sipër është e ngjashme për të gjitha gjykimet kushtetuese, por në disa raste për shkak të natyrës së gjykimit kushtetues, ka disa përjashtime nga këto rregulla. Në disa gjykime të veçanta, faza paraprake e gjykimit kushtetues kthehet në një formalitet. Kështu përsa i përket gjykimit kushtetues *aposteriori* të marrëveshjeve

<sup>866</sup> Seibert, Helga, "Admissibility requirements for constitutional complaints and mechanisms for avoiding an excessive case load", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15", botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998, fq. 152.

<sup>867</sup> Vendimi nr.42, datë 19.5.2009 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese: *Kolegji i Gjykatës Kushtetuese çmon, se kërkuesi nuk legjitimohet në kërkimet e tij lidhur me shqyrtimin ose jo të një kërkesë nga kjo Gjykatë. I takon vetëm Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë kushtet formale dhe materiale për pranimin e një kërkesë për gjykim, mbështetur në dispozitat kushtetuese dhe ligjore të parashikuara për këtë qëllim. Kolegji vlerëson, se megjithë interesin që kërkuesi mund të ketë në çështjen në fjalë, paraqitja e interesave dhe pretendimeve është pjesë e hetimit dhe debatit gjyqësor, ku përcaktohet edhe bazueshmëria e tyre nga Gjykata. Kërkuesi mund t'i paraqesë pretendimet e tij në shqyrtimin gjyqësor, nëse kërkesa e paraqitur nga administratori i Shoqërisë "VEFA" Sh.p.k. në administrim do të kalojë për gjykim, por nuk mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me pretendimin për mosmarrje në shqyrtim të kërkesave të caktuara, megjithë interesin e tij në proces.*

ndërkombëtare rezulton se ka një dallim. Ky lloj gjykimi është një gjykim fakultativ. Kjo do të thotë që Gjykata në këtë rast vihet në lëvizje vetëm mbi bazën e kërkesës së Këshillit të Ministrave. Është ky organ i cili vlerëson paraprakisht kushtetutshmërinë e një marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar dhe ia dërgon për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese. Kjo më pas procedon në Kolegj dhe eventualisht në Mbledhjen e Gjyqtarëve, procedurat e shqyrtimit paraprak të kërkesës. Por duke qenë se kërkesa është paraqitur nga Këshilli i Ministrave dhe ka për objekt një marrëveshje ndërkombëtare atëherë kjo fazë kthehet në një formalitet. I vetmi kontroll që mund të ushtrohet në këtë fazë është nëse kërkesa e paraqitur nga Këshilli i Ministrave plotëson kushtet formale dhe shoqërohet nga dokumentacioni përkatës.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për proceset që iniciohen mbi bazën e vendimit të Kuvendit. Në këtë mënyrë faza seleksionuese për procedurat e shkarkimit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të funksioneve nga Presidenti apo për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksioneve të deputetit, mund të verifikohen nga Kolegji/Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese vetëm për plotësimin e kriterëve formale, por në asnjë rast nuk mund të thuhet që Gjykata Kushtetuese mund të vejë në diskutim legjitimitetin e këtij organi.

Në lidhje me procedurat e shkarkimit të Presidentit të Republikës fillimi i procedurave gjyqësore duket sikur paraqet një kontradiktë në LGJK. Kështu neni 61, pika 1 e LGJK, përcakton se Gjykata Kushtetuese për deklarimin e shkarkimit të Presidentit të Republikës vihet në lëvizje me vendimin e Kuvendit që ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra. Kjo mënyrë e të shkruarit të dispozitës duket sikur tregon që në këtë rast fillimi i procedurës gjyqësore është automatik dhe nuk i nënshtrohet procedurave vlerësuese paraprake si për gjykimet e tjera. Kjo mënyrë zgjedhje duket sikur është në përputhje me parashikimet kushtetuese të cilat përcaktojnë se vendimi i Kuvendit i dërgohet Gjykatës Kushtetuese, e cila, kur vërteton fajësinë e Presidentit të Republikës, deklaron shkarkimin e tij nga detyra.<sup>868</sup>

Megjithatë, ndoshta duke i qëndruar besnik parashikimit tjetër kushtetues për vlerësimin paraprak të kërkesave që i paraqiten për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese,<sup>869</sup> LGJK parashikon shprehimisht një procedurë të vlerësimit paraprak nga Mbledhja e Gjyqtarëve e cila vlerëson me shumicë votash nëse do ta kalojë çështjen në seancë plenare apo jo. Duke qenë se në këtë rast Mbledhja e Gjyqtarëve nuk vlerëson legjitimitetin e subjektit, pasi në këtë rast është i mirëpërcaktuar, dhe nuk vlerëson as kompetencën e Gjykatës e cila sipas nenit 90 dhe 133 të Kushtetutës është taksative, atëherë e vetmja gjë që mbetet për tu vlerësuar është nëse vendimi i Kuvendit është haptazi i pabazuar apo jo. Pra, nëse jemi përpara një vendimi të Kuvendit për shkarkim i cila ka një bazueshmëri në aktet me të cilat shoqërohen atëherë Gjykata duhet të vendosë shqyrtimin e saj në seance plenare. Në rast të kundërt duhet që të vendosë moskalimin e saj në seancë. Ideja e këtij parashikimi është shpëtimi i kreut të shtetit nga procedime të cilat *prima facie* nuk qëndrojnë aspak.

Por pavarësisht kësaj ideje, jam i mendimit që në këtë rast krijohet një kontradiktë e fortë në vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese. Kështu nëse hipotetikisht mendojnë që Mbledhja e Gjyqtarëve, njëzëri apo me shumicë votash vlerëson që vendimi i Kuvendit është haptazi i pabazuar atëherë, çështja nuk kalon për gjykim. Normalisht që si çështje duhet të mbyllet aty, por pikërisht një lloj vendimmarrje e tillë, moskalimi i çështjes në seancë plenare, do të krijonte një situatë të pakuptimtë, pasi le të papekur formalisht vendimin e Kuvendit për shkarkimin e

<sup>868</sup> Kushtetuta, neni 90, pika 3.

<sup>869</sup> Kushtetuta, neni 133, pika 1.



Presidentit të Republikës. Pra, në fund do të kishim një vendim të Kuvendit në fuqi, por me një çështje të përfunduar, pra një paradoks juridik.

Për këtë arsye jam i mendimit që parashikimi i nenit 62, pika 1 e LGJK është i pakuptimtë dhe i pazbatueshëm. Për më tepër parashikimi i nenit 133, pika 1 e Kushtetutës që kërkon një vlerësim paraprak të kërkesave është me natyrë të përgjithshme, kurse parashikimi i nenit 90, pika 3 e Kushtetutës është specifik për gjykimin konkret dhe prevalon në këtë rast. Prandaj në këtë rast duhet domosdoshmërisht që vendimi i Kuvendit të shqyrtohet në seancë plenare, ndërsa vlerësimi paraprak që bën Mbledhja e Gjyqtarëve, shërben vetëm për të verifikuar rregullshmërinë dhe plotësinë e dosjes së sjellë nga Kuvendi. Vetëm në rast se ajo është e mangët, Mbledhja e Gjyqtarëve mund të kërkojë plotësimin e saj, por në asnjë rast të vendosë në lidhje për kalimin apo jo të çështjes për gjykim në seancë plenare.

Ndërkohë jam i mendimit se duhet të kalojë menjëherë për gjykim kërkesat e prokurorisë për arrestimin apo ndalimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Për vetë urgjencën e këtyre kërkesave si edhe legjitimitetin që gëzon organi i akuzës në bazë të Kushtetutës, faza paraprake në këtë lloj gjykimi humbet çdo lloj kuptimi.

Në lidhje me gjykimin kushtetues të çështjeve të shtruara për referendum, me depozitim të akteve nga KQZ-ja apo Kuvendi, në Gjykatë dhe caktimin e relatorit, çështja kalon për shqyrtim më pas në Kolegjin e Gjykatës Kushtetuese. Duke pasur në konsideratë natyrën e këtij gjykimi, kompetencat e Kolegjit në këtë rast kufizohen vetëm në analizimin e kriterëve formale që shoqërojnë këtë praktikë. Fakti që shqyrtimi i kushtetutshmërisë së kërkesave është detyrues për t'u bërë nga Gjykata Kushtetuese, sjell si pasojë që me t'u paraqitur kërkesa, Gjykata Kushtetuese fillon shqyrtimin e saj pa bërë verifikimin e legjitimitetit të subjektit, siç do të bënte në kushtet e nenit 131, gërma "f" dhe 134, pika 2 të Kushtetutës. Çështjen e verifikimit të legjitimitetit e ka kryer në këtë rast një organ tjetër i ngarkuar me këtë detyrë, që është KQZ-ja. Pra, shqyrtimi i çështjes nga Gjykata Kushtetuese fillon si detyrim i drejtpërdrejtë nga Kushtetuta, pa pasur nevojë të vihet në lëvizje nga subjekte dhe procedura të parashikuara normalisht nga dispozitat përkatëse për këtë qëllim.<sup>870</sup>

Edhe në rastin e gjyimit kundër vendimeve të Këshillit të Ministrave për shpërndarjen apo shkarkimin e organeve të njësisë vendore të zgjedhura drejtpërdrejtë Gjykata Kushtetuese, nuk kontrollon legjitimitetin e subjektit. Duke qenë se në këtë rast Gjykata Kushtetuese vepron si një gjykatë e zakonshme, kontrolli i Kolegjit duhet të fokusohet vetëm në faktin nëse kërkesa është e paraqitur e plotë nga pikëpamja formale dhe nëse është paraqitur brenda afatit kushtetues. Në rast se këto dy momente rezultojnë pozitive atëherë, kolegji kalon çështjen për gjykim në seancë plenare.

## 2. PEZULLIMI NË GJYKIMIN KUSHTETUES.

Mënyra që ka zgjedhur Republika e Shqipërisë për të ushtruar kontroll kushtetues është si rregull ai *aposteriori*. Sipas kësaj mënyre rezulton që Gjykata Kushtetuese, shqyrton akte të cilat janë miratura, kanë hyrë në fuqi dhe që prodhojnë efekte. Për këtë arsye, duke pasur në konsideratë kohën që u duhet procedurave dhe shqyrtimit gjyqësor që Gjykata të dalë me një vendim dhe për të tepër që të mbetet një mjete ankimor efektiv, LGJK ka parashikuar edhe të drejtën e Gjykatës që të pezullojë shqyrtimin e akteve që janë bërë objekt gjykimi përpara saj. Themi që të konsiderohet një mjet efektiv pasi gjatë kohës që Gjykatës Kushtetuese do t'i duhet

<sup>870</sup> Vorpsi, Arta, "Referendumi shfuqizues dhe shqyrtimi i kërkesës nga Gjykata Kushtetuese", botuar në Revistën "E drejta parlamentare dhe politikë ligjore", botim i Qendrës së Studimeve Parlamentare, nr.31, viti 2006, fq.8



që të marrë vendimin, akti juridik mund të prodhojë pasoja të tilla, që pavarësisht vendimmarrjes së Gjykatës në një kohë të mëvonshme, të drejtat dhe liritë themelore apo edhe marrëdhëniet institucionale mund të jenë cënuar në mënyrë të tillë që riparimi i tyre do të ishte i vështirë ose edhe i pamundur.

E drejta për pezullim e Gjykatës, i është njohur që në momentin e krijimit të saj nga ligji kushtetues përkatës, e cila parashikonte, që gjatë shqyrtimit gjyqësor, të drejtën e Gjykatës për të pezulluar ligjet nëse binin në kundërshtim me LDKK, ose të akteve të tjera nënligjore nëse binin në kundërshtim me ligjet. Gjykata kishte gjithashtu të drejtën që të vendoste edhe në lidhje me marrjen e masave të tjera të cilat ajo i çmonte si të nevojshme.<sup>871</sup>

Në Kushtetutën aktuale, një e drejtë e tillë e Gjykatës, nuk u njoh shprehimisht. Përrjashtim bën vetëm parashikimi i nenit 115, pika 2 e Kushtetutës që bën fjalë për pezullimin e zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave, që ka vendosur shkarkimin apo shpërndarjen e organeve të zgjedhura drejtpërsëdrejti të njësisve të qeverisjes vendore, në rast se ushtrohet ankimi. Por kjo nuk do të thotë që një mundësi e tillë nuk mund të ushtrohet nga Gjykata Kushtetuese. Në hartimin e LGJK, ligjvënësi pati kujdesin e veçantë që të parashikonte një mundësi të tillë, në nenin 45 të LGJK.<sup>872</sup>

Nëse analizojmë me kujdes paragrafët e kësaj dispozite rezulton se nisma për të marrë masën e pezullimit është ose e vetë Gjykatës, kryesisht, ose nëpërmjet kërkesës së palëve. Në të dyja rastet kjo mundësi, është e kuptueshme që mund të ushtrohet vetëm në kuadër të një procesi të nisur. Në analizën e jurisprudencës kushtetuese deri më sot nuk rezulton që Gjykata Kushtetuese, kryesisht të ketë vendosur vetë marrjen e kësaj mase. Ajo gjithmonë ka reguar vetëm mbi bazën e kërkesave të kërkuarit. Një zgjidhje e tillë e Gjykatës Kushtetuese, lidhet me ruajtjen e rolit të saj të paanshëm.

Normat që mund të jenë objekt pezullimi janë ligjet ose aktet. Siç vërehet dispozita përdor këto dy terma. Në lidhje me ligjet, mund të pezullohen të gjitha ligjet që janë objekt gjykimi, pavarësisht llojit të ligjit, nëse ai është i miratuara me shumicë të thjeshtë, absolute apo të cilësuar. Përsa i përket akteve të tjera ato janë akte të cilat në varësi të llojit të gjykimit kushtetues mund të bëhen objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese. Të tilla mund të jenë, aktet normative të organeve qendrore dhe atyre vendore, aktet të cilat mund të kenë shërbyer për lindjen e mosmarrëveshjes së kompetencave, si edhe vendimet gjyqësore apo administrative të cilat janë ankimuar në gjykimin kushtetues si rezultat i pretendimeve për një proces të parregullt gjyqësor. Pra, kjo masë mund të aplikohet në një sërë procedurash të kontrollit kushtetues që nga kontrolli abstrakt i normës, ankimit individual apo gjatë një procedure me karakter individual.<sup>873</sup>

<sup>871</sup> Ligji nr. 7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", neni 24, pika 10: Gjykata Kushtetuese ka këto kompetenca:...10. Vendos pezullimin e zbatimit të ligjit kur vëren se nuk pajtohet me ligjin "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe pezullimin ose shfuqizimin e akteve e të dispozitave të tjera, kur vëren se nuk pajtohen me ligjin "Për dispozitat kryesore kushtetuese" ose me ligjin, si dhe merr masat që çmon të përshtatshme për çështjen që gjykon.

<sup>872</sup> LGJK, neni 45: 1. Gjykata Kushtetuese, kryesisht ose me kërkesë të palës, kur vlerëson se zbatimi i ligjit ose i aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërorë, shoqërorë ose të individëve sipas rastit, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancën plenare, urdhëron pezullimin e ligjit ose të aktit. Pezullimi vazhdon derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi. 2. Vendimi për masën e pezullimit i njoftohet organit përkatës që ka nxjerrë ligjin ose aktin, si dhe bëhet publikimi i tij. 3. Gjykata Kushtetuese në çdo fazë të shqyrtimit të çështjes, me vendim në seancën plenare, mund të heqë masën e pezullimit. 4. Gjykata Kushtetuese duhet të shprehet në vendimin përfundimtar për vazhdimësinë ose jo të masës së pezullimit.

<sup>873</sup> Biba, Denar, "Pezullimi në gjykimin kushtetues", botuar në Revistën "Jeta Juridike", nr.4 dhjetor 2006, botim i Shkollës së Lartë të Magjistraturës, Shtëpia Botuese "Erik", fq.38.

Gjykata Kushtetuese, këtë mundësi që i jep neni 45 i LGJK e ka shtrirë edhe në procedurat që ndiqen nga organet kushtetuese, kur Gjykata ka qenë në gjykimin për interpretimin përfundimtar të normave kushtetuese.<sup>874</sup> Parimisht duke qenë se në rastin konkret nuk jemi përpara kontrollit kushtetues për ndonjë akt, atëherë rezulton se në këtë rast nuk mund të merret një masë e tillë, për me tepër pezullimi nuk mundet kurrësesi që të vendoset ndaj normave themelore të rendit juridik. Megjithatë siç e kemi përmendur më sipër në këtë lloj gjykimi Gjykata Kushtetuese, ka vendosur marrjen e një mase të tillë kundrejt procedurave që ndjek një organ kushtetues. Le ta analizojmë këtë situatë. Kështu në vendimin nr.28, datë 21.2.2002 Gjykata Kushtetuese është shprehur:

*Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese e datës 20.02.2002 konstatoi se Kuvendi në seancë plenare, sipas neneve 96 e 97 të Kushtetutës, e kishte filluar procedurën për miratimin e Kryeministrit së bashku me programin politik dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave. Pas diskutimit të kërkesës për pezullim, Mbledhja e Gjyqtarëve arriti në konkluzionin se përfundimi nga Kuvendi i procedurës për miratimin e Kryeministrit, të programit politik dhe të përbërjes së Këshillit të Ministrave përpara shpalljes së vendimit përfundimtar nga kjo Gjykatë për interpretimin e normave të mësipërme të Kushtetutës, mund të sillte pasoja që preknin interesat shtetërorë. Prandaj, në kuptim të neneve 1 e 45 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" dhe të dispozitave procedurale që parashikojnë marrjen e masave për pezullimin e zbatimit të akteve apo të veprimeve procedurale, Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi pezullimin e shqyrtimit të procedurës për miratimin e Kryeministrit, të programit politik të Këshillit të Ministrave e të përbërjes së tij deri në marrjen e vendimit nga kjo Gjykatë.*

Nga ky pasazh i vendimit kuptojmë që Gjykata Kushtetuese ka qenë ndodhur përpara rrezikut kur Kuvendi mund të vazhdonte procedurat e tij parlamentare dhe të votëbesonte Këshillin e ri të Ministrave, ndërkohë që në Gjykatën Kushtetuese ishte në shqyrtim, çështja me objekt interpretimin e dispozitave kushtetuese që kishin të bënin me këtë procedurë parlamentare. Në mungesë të një parashikimi të qartë në lidhje me kompetencën e Gjykatës, për të pezulluar edhe procedurat sipas nenit 45 të LGJK, Gjykata i referohet edhe nenit 1 të të njëjtit ligj. Nëse i referohemi kësaj dispozite dukshëm Gjykata, ka tentuar që të zbatojë me analogji edhe dispozita e K.Pr.C. ku në nenin 206 të saj parashikohet edhe mundësia e Gjykatës për të marrë masa të tjera të përshtatshme.

Kjo lloj vendimmarrje e Gjykatës, na duket e gabuar për dy arsye. Së pari gjykimi kushtetues për interpretimin përfundimtar të një norme kushtetuese është me karakter deklarativ. Për rrjedhojë në dispozitivin e këtij vendimi jepet vetëm kuptimi i normës kushtetuese dhe nuk disponohet në lidhje me ndonjë akt. Është e vërtetë që Gjykata bazuar në këtë vendim mund të marrë një tjetër vendim gjyqësor duke pasur për objekt, aktet apo procedurat e një tjetër organi kushtetues, por nuk mundet që këtë shqyrtim ta bëjë gjatë këtij gjykimi. Së dyti, vetë neni 1, pika 2 e LGJK të jep mundësinë që Gjykata të përdorë ligje të tjera në mungesë të një parashikimi të qartë në vetë LGJK. Në këtë rast jam i mendimit që neni 45 i LGJK duhet kuptuar si shterues. Pra, Gjykata nuk mundet që të vendosë forma të tjera pezullimi tej atyre që parashikon kjo dispozitë. Për me tepër në ato raste kur ligjëvënesi ka dashur t'i japë të drejtë Gjykatës që të vendosë edhe mënyra të tjera pezullimi, këtë e ka bërë shprehimisht, si për pezullimin e

<sup>874</sup> Vendimi nr.28, datë 21.2.2002 i Gjykatës Kushtetuese.

procedurave të ratifikimit të një marrëveshje ndërkombëtare,<sup>875</sup> ose në rastin e pezullimit të veprimtarisë së partive apo organizatave politike.<sup>876</sup>

Sidoqoftë një vendimmarrje e tillë e Gjykatës, ka ndodhur vetëm njeherë dhe nuk është përsëritur më në raste të tjera. Bazuar në arsyet e përmendura më sipër jam i mendimit që një masë e tillë nuk mundet të merret gjatë këtij lloj gjykimi.

Sipas LGJK pezullimi mund të vendoset në rast se zbatimi i ligjit ose i aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërorë, shoqërorë ose të individëve. Këto kriterë janë tepër të gjera dhe për rrjedhojë është e vështirë që të identifikohen më konkretisht si raste në praktikë.

Termi i parë që duhet sqaruar është kuptimi i “pasojës” që parashikon dispozita. Gjykata me termin “pasoja” ka kuptuar gjithmonë “pasoja të rënda dhe të pariparueshme”. Zbërthimi i këtij termi në këtë mënyrë është gjithashtu një interpretim teleologjik i rregullimit ligjor që ka bërë legjislatori në nenin 45, pika 1. Çdo mendim tjetër i kundërt me këtë do të krijonte një situatë kaotike, pasi nuk mund të imagjinohet ndonjë akt që nuk sjell pasoja për askënd. Pra, nëse do t’i konfirmoheshim kuptimit të shprehjes “pasoja” pa e shoqëruar atë me epitetet “të rënda dhe të pariparueshme”, atëherë praktikisht Gjykata do të duhej të pranonte absolutisht të gjitha kërkesat për vendosjen e masave të pezullimit që do t’i paraqiteshin nga subjektet e interesuara.<sup>877</sup> Pra, përgjithësisht, vlerësimi i Gjykatës për të vendosur pezullimin ka të bëjë ekskluzivisht me rëndësinë (seriozitetin) dhe pariparueshmërinë e pasojave që vendimi i kundërshtuar mund të prodhojë *medio tempore*, para se Gjykata të shprehet në mënyrë përfundimtare mbi themelin e kërkesës.<sup>878</sup>

Përveç sa më sipër, LGJK kërkon që këto pasoja të rënda të prekin interesa shtetërore, shoqërore apo individuale. Në lidhje me rastin e parë, prekja e interesave shtetërore, duhet të kuptojmë cënimin e marrëdhënieve institucionale ose të pavarësisë së këtyre institucioneve në mënyrë të tillë nga zbatimi i aktit saqë vendimi i mëpasshëm i Gjykatës, nuk do të mund ta rregullonte këtë pasojë.<sup>879</sup>

Në lidhje me rastin e dytë, prekjen e interesave shoqërore, situata shfaqet shumë e paqartë. Mesa duket ideja në këtë rast është për të mbrojtur të drejta kolektive të grupimeve të caktuara, duke pasur në konsideratë që Gjykata mund të vihet në lëvizje edhe mbi bazën e kërkesave të organizatave të ndryshme. Por duke qenë se janë individët ata që mbajtës të së drejtave të njeriut ku përfshihen si të drejtat vetjake ashtu edhe ato kolektive, prekja e interesave shoqërore nuk duket sikur ka të bëjë me një situatë konkrete. Më shumë duket sikur është

<sup>875</sup> LGJK, neni 52, pika 3.

<sup>876</sup> LGJK, neni 59.

<sup>877</sup> Biba, Denar, “Pezullimi në gjykimin kushtetues”, botuar në Revistën “Jeta Juridike”, nr.4 dhjetor 2006, botim i Shkollës së Lartë të Magjistraturës, Shtëpia Botuese “Erik”, fq.45.

<sup>878</sup> Vendimi nr.19, datë 25.4.2013 i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 10.

<sup>879</sup> Vendimi nr.9, datë 23.3.2010 i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 15-16: 15. Sipas kërkesve, nga zbatimi i menjëhershëm i ligjit interesave të rëndësishme shtetërore u shkaktohet një dëm shumë serioz dhe vështirësisht i riparueshëm; krijohen dukshëm mosmarrëveshje kompetencash ndërmjet organeve kushtetuese dhe një autoriteti të krijuar me ligj të zakonshëm; cenohet apo kufizohet ushtrimi i veprimtarisë kushtetuese të Presidentit të Republikës, Kuvendit, Këshillit të Ministrave, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Prokurorit të Përgjithshëm si dhe i të gjithë institucioneve të tjera të administratës publike, nga veprimtaria e Autoritetit të Kontrollit të Figurave; krijohet vakum institucional deri në bllokim të veprimtarisë kushtetuese të organit shtetëror; përfundojnë marrëdhëniet e punës për funksionarët e lartë të shtetit, të cilët kanë status kushtetues. 16. Gjykata Kushtetuese, shkaqet e parashtruara nga kërkesit lidhur me kërkesën për pezullimin e ligjit, në kuptim të nenit 45 të ligjit organik të saj, i ka vlerësuar si shkaqe të përligjura për të argumentuar parandalimin e pasojave që mund t’i vijnë funksionimit normal të shtetit të së drejtës si dhe të drejtave dhe lirive themelore të individëve dhe mbi këtë arsytim vendosi pezullimin e ligjit deri në dhënien e vendimit të saj përfundimtar.



përdorur nga legjislatori si plotësues i kërkesave të tjera, prekjen e interesave shtetërore ose të individëve. Kjo pasi fusha e veprimtarisë së një akti juridik shtrihet ose mbi veprimtarinë shtetërore ose mbi të drejtat dhe liritë themelore të individit.

Në lidhje me rastin e tretë, atë të prekjes së interesave të individëve, pezullimi nga ana e Gjykatës mund të bëhet në disa forma. Kështu për shkak të prekjes së interesave të individëve mund të pezullohen edhe akte juridike me natyrë normative<sup>880</sup> ashtu edhe akte me natyrë individuale siç janë vendimet gjyqësore.<sup>881</sup>

Vështirësia për të qartësuar këto kritere qëndron në faktin se Gjykata Kushtetuese pavarësisht se pjesë të caktuara të vendimit të saj ia kushton vendimmarrjes në lidhje me masën e pezullimit, nuk arsyeton në mënyrë të plotë në lidhje me pranimin apo rrëzimin e kërkesës. Në përgjithësi në këto raste Gjykata vetëm liston argumentat e palës kërkuese dhe në fund shprehet për bazueshmërinë e saj apo jo në vetëm një fjali. Në rast se pranohet kjo do të thotë që argumentat ishin bindëse dhe për këtë arsye u vendos pezullimi i aktit. Pra, në këtë rast argumentat e palës kërkuese bëhen pjesë e arsytimit gjyqësor. Në rast se nuk i gjen të bazuara Gjykata shprehet vetëm për pabazueshmërinë e tyre. Vetëm në pak raste është arsyetuar nga Gjykata për rrezimin e kërkesës duke e lidhur me mjetet të tjera procedurale që kishte në dispozicion kërkuesi për të rivendosur të drejtat e tij,<sup>882</sup> ose ngaqë akti ishte pezulluar për shkaqe të tjera.<sup>883</sup>

Kjo mënyrë e të arsyetuarit të Gjykatës Kushtetuese mund të justifikohet vetëm për të ruajtur paanshmërinë e Gjykatës, me qëllim që duke marrë një masë të tillë, Gjykata të mos tregojë se ka paragjykuar çështjen. Por nga ana tjetër mungesa e një arsytimi sa më të plotë pengon palët që të marrin dijeni për shkaqet se përse Gjykata vendosi ta pranojë apo rrëzojë kërkesën për pezullimin e aktit, shqetësim ky i cili është ngritur më herët edhe nga doktrina.<sup>884</sup> Duke u bazuar në praktikën e deritanishme kushtetuese rezulton se praktikisht, Gjykata duket se e bazon vendimin e saj në dhënien ose jo të një mase të përkohshme të gjasat e suksesit (ose jo)

<sup>880</sup> Vendimi nr.20, datë 11.7.2006 i Gjykatës Kushtetuese: *Gjatë shqyrtimit të çështjes, Gjykata Kushtetuese vlerësoi të bazuar kërkesën për pezullim të zbatimit të vendimeve të Këshillit të Ministrave deri në një vendim përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese dhe me vendimin e datës 21.03.2006, vendosi pezullimin e tyre. Gjithashtu, ajo çmon se analiza e çështjeve që dalin në funksion të kontrollit kushtetues të këtyre akteve normative lidhet me faktin nëse vendimet e kundërshtuara kufizojnë të drejtat e njeriut dhe nëse ato janë në pajtim me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*

<sup>881</sup> Vendimi nr.20, datë 1.6.2011 i Gjykatës Kushtetuese: *Për këtë kërkesë, Gjykata Kushtetuese, më datë 23.02.2011, ka vendosur pezullimin e vendimit nr. 417, datë 20.06.2001 ë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si dhe të vendimeve nr.191, datë 23.10.1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Durrësit dhe nr.1106, datë 27.11.1996 të Gjykatës së Apelit të Durrësit.*

<sup>882</sup> Vendimi nr.19, datë 25.4.2013 i Gjykatës Kushtetuese, par.10: *Në mbështetje të sa më sipër, Gjykata vlerësoi se nuk ekziston rreziku që vendimet objekt kundërshtimi, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të mundshëm të pranimit të kësaj kërkesë nga Gjykata Kushtetuese, të prodhojnë pasoja të pariparueshme që prekin interesat e kërkuesit, pasi ky i fundit ka në dispozicion edhe mjete të tjera të parashikuara nga KPC-ja (shih Mjetet e mbrojtjes kundër ekzekutimit të vendimeve, nenet 609 e vijues të KPC-së) për mbrojtjen e të drejtave të tij. Prandaj, Gjykata çmoi si të pabazuara argumentet e parashtruara nga kërkuesi për cenimin e të drejtës së pronësisë së tij nga ekzekutimi i vendimeve të lartpërmendura dhe, për rrjedhojë, vendosi rrëzimin e kërkesës.*

<sup>883</sup> Vendimi nr.27, datë 24.6.2013 i Gjykatës Kushtetuese, par.11: *Në përfundim të seancës plenare Gjykata, e tërhequr në dhomën e këshillimit, edhe për shkakun se u konstatua se ekzekutimi i vendimit të kundërshtuar është pezulluar tashmë, vendosi përsëri rrëzimin e kërkesës për mungesë të shkaqeve të parashikuara nga neni 45 i ligjit organik të kësaj Gjykate.*

<sup>884</sup> Biba, Denar, "Pezullimi në gjykimin kushtetues", botuar në Revistën "Jeta Juridike", nr.4 dhjetor 2006, botim i Shkollës së Lartë të Magjistraturës, Shtëpia Botuese "Erik", fq.40.



të çështjes themelore.<sup>885</sup> Në fakt nga analiza e jurisprudencës rezulton se në të gjitha rastet kur është marrë vendimi i pezullimit, kërkesa është pranuar. Po kështu, bazuar në qëndrimin e jurisprudencës dhe të doktrinës rezulton se shanset për pranimin e kërkesës për vendosjen e masës së pezullimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese shtohen me shtimin e personave, interesat e të cilëve mund të kenë pasoja të rënda dhe të riparueshme.<sup>886</sup>

Vendimi për marrjen e masës së pezullimit mund të merret nga Mbledhja e Gjyqtarëve ose nga Gjykata në seancë plenare. Si rregull, masa merret nga Mbledhja e Gjyqtarëve e cila vlerëson nëse duhet apo jo të pezullohet akti. Në këtë mënyrë nëse Kolegji është shprehur për kalimin e kërkesës për gjykim në seancë plenare ai më tej për kompetencë i kalon Mbledhjes së Gjyqtarëve shqyrtimin e kërkesës për pezullim, nëse është paraqitur edhe një kërkesë e tillë. Në rast se Kolegji nuk ka arritur në asnjë vendim në lidhje me kalimin apo jo për gjykim të kërkesës dhe çështja kalon në Mbledhjen e Gjyqtarëve atëherë kjo e fundit vendos për të dyja këto kërkitime. Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese në këtë fazë nuk çënon të drejtat e subjekteve të interesuara për të kundërshtuar një masë të tillë, në seancë gjyqësore. Siç parashikon edhe neni 45, pika 3 e LGJK masa e pezullimit mund të hiqet në çdo kohë. Po kështu në rast se kërkesa për marrjen e kësaj mase është rrëzuar nga Gjykata në Mbledhjen e Gjyqtarëve, kërkuesi nuk ka asnjë pengesë që ta riparaqesë kërkesën për pezullim por bazuar në shkaqe të reja të cilat e bëjnë të nevojshme marrjen e kësaj mase.<sup>887</sup>

Shqyrtimi i kësaj kërkesë në seancë bëhet vetëm nëse Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se nuk i ka të gjitha elementët e nevojshëm dhe për këtë arsye është e nevojshme që të dëgjohen edhe palët në seancë.<sup>888</sup>

Kur Gjykata, merr një vendim të tillë, masa e pezullimit i sjell si rregull pasojat derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi. Për këtë arsye Gjykata duhet që ta bëjë publik një vendimmarrje të tillë dhe të njoftojë organin që ka nxjerrë aktin. Një njoftim i tillë ka rëndësi të madhe. Kështu vërtet ligjet miratohen nga Kuvendi dhe ky organ njoftohet për një masë të tillë, por njëkohësisht ligjet që miratohen prej tij i drejtohen një sërë subjektsh dhe

<sup>885</sup> Po aty, fq.40.

<sup>886</sup> Biba, Denar, "Pezullimi në gjykimin kushtetues", botuar në Revistën "Jeta Juridike", nr.4 dhjetor 2006, botim i Shkollës së Lartë të Magjistraturës, Shtëpia Botuese "Erik", fq.47.

<sup>887</sup> Vendimi nr.14, datë 21.3.2014 i Gjykatës Kushtetuese, parag.11: *Për këtë arsye, në datën 27.06.2013, Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullimin e zbatimit të vendimit nr.200, datë 13.03.2013, të Këshillit të Ministrave. Kërkuësja përsëriti kërkesën për pezullim edhe në seancë gjyqësore, prandaj dhe Gjykata, me vendimin e ndërmjetëm të datës 03.10.2013, u shpreh për rrëzimin e kërkesës për pezullim të vendimit nr.200, datë 13.03.2013, të Këshillit të Ministrave, me të njëjtin argument.*

<sup>888</sup> Vendimi nr.18, datë 29.7.2008 i Gjykatës Kushtetuese: *Në bazë të nenit 45 të Ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", në fillim të seancës plenare, Gjykata Kushtetuese (Gjykata), pasi dëgjoi pretendimet e palëve për kërkitimin që lidhet me pezullimin e ligjit, objekt shqyrtimi, vendosi rrëzimin e kësaj kërkesë si të pabazuar, me arsyetimin se zbatimi i ligjit nuk lidhet me cenimin e interesave shtetërore, shoqërore ose të individëve.*

Vendimi nr.27, datë 24.6.2013 i Gjykatës Kushtetuese, parag.10-11: *10. Gjykata Kushtetuese (Gjykata), mori në shqyrtim, përpara seancës plenare, kërkesën për pezullimin e zbatimit të vendimit nr.00-2012-1593 (269), datë 24.05.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Në kuptim të nenit 45 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me vendimin e datës 21.11.2012, Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullim, për arsye se nuk ndodhej para kushteve të parashikuara në këtë dispozitë. 11. Në seancë plenare, Gjykata u dha përsëri palëve mundësinë të paraqisnin argumente rreth kësaj kërkesë. Në përfundim të seancës plenare Gjykata, e tërhequr në dhomën e këshillimit, edhe për shkakun se u konstatua se ekzekutimi i vendimit të kundërshtuar është pezulluar tashmë, vendosi përsëri rrëzimin e kërkesës për mungesë të shkaqeve të parashikuara nga neni 45 i ligjit organik të kësaj Gjykate.*

institucionesh të tjera. Për këtë qëllim është i nevojshëm edhe njoftimi publik i marrjes së masës së pezullimit, në mënyrë që edhe këto institucione dhe subjekte të mos e zbatojnë një ligj të tillë. Nga praktika e deritanishme rezulton se një njoftim i tillë publikohet në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës Kushtetuese. Është e diskutueshme nëse një formë e tillë mund të konsiderohet efektive por duke pasur parasysh mbulimin mediatik që i bëhet Gjykatës nga ana e mediave të shkruara, audiovizuale dhe elektronike, një mënyrë e tillë veprimi duket se ia ka arritur qëllimit.

Më sipër përmendëm që në çdo kohë Gjykata mund të vendosë heqjen e masës së pezullimit. Kjo mund të bëhet për arsye se nuk ekzistojnë më shkaqet për të cilat është vendosur masa e pezullimit, ose nëse masa e pezullimit nuk ka më asnjë kuptim pasi pasojat kanë ardhur tashmë.<sup>889</sup>

Sipas nenit 45, pika 4 e LGJK-së Gjykata Kushtetuese duhet të shprehet në vendimin përfundimtar për vazhdimësinë ose jo të masës së pezullimit. Duke u nisur edhe nga praktika e deritanishme e gjykatave të zakonshme, normalisht një qëndrim të tillë duhet që ta gjejmë në dispozitivin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Kjo praktikë është ndjekur në fillim edhe nga vetë Gjykata Kushtetuese,<sup>890</sup> por kohët e fundit në dispozitivin e vendimeve nuk gjendet asnjë parashikim në lidhje me fatin e masës së pezullimit.<sup>891</sup> Vetëm në ndonjë rast Gjykata ka mbajtur qëndrim në lidhje me vazhdimin e masës dhe këtë e ka bërë në pjesën arsyetuese të vendimit gjyqësor<sup>892</sup> por jo në dispozitivin e vendimit. Në rast se Gjykata nuk shprehet aspak në lidhje me vazhdimin apo jo të masës së pezullimit, sipas doktrinës, automatikisht, në zbatim të pikës 1 të nenit 45, masa e pezullimit do të pushojë së ekzistuari në momentin që vendimi për çështjen themelore hyn në fuqi.<sup>893</sup>

Në LGJK ekzistojnë edhe dy masa të tjera pezullimi. E para ka të bëjë me pezullimin e procedurave për ratifikimin e një marrëveshje ndërkombëtare. Pezullimi në këtë rast, si një element i rëndësishëm procedural në duart e Gjykatës Kushtetuese, ndryshon nga masa e zakonshme e pezullimit që merr si rregull Gjykata Kushtetuese. Kështu sipas nenit 45 të LGJK, Gjykata, mund të vendosë pezullimin e aktit, por në këtë rast duke qenë se jemi përpara një marrëveshje ndërkombëtare ende të paratifikuar atëherë është e kuptueshme që në këtë rast nuk ka ende, në kuptimin juridiko-formal, një akt për të pezulluar.

Për këtë arsye, LGJK, procedurën e pezullimit për marrëveshjet ndërkombëtare e rregullon veçmas dhe konkretisht në nenin 52, pika 3 e tij, parashikon se në rast se çështja ka kaluar në seancë plenare, pezullohen procedurat për ratifikimin e marrëveshjes. Kjo dispozitë tregon dy elementë proceduralë të pezullimit për këtë lloj gjykimi. Së pari në këtë rast rezulton se pezullohen procedurat e ratifikimit të marrëveshjes ndërkombëtare. Pra, në çdo fazë që ndodhen këto procedura, menjëherë mbas nënshkrimit, në Kuvend, apo në procedurën e shpalljes/hyrjes në fuqi të ligjit ratifikues, ato pezullohen dhe nuk mund të vazhdojnë më tej. Së

---

<sup>889</sup> Vendimi nr.8, datë 23.1.2002 i Gjykatës Kushtetuese: *Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, me vendimin e datës 30.10.2001, ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për lirinë e dorëzimitin e banesës. Gjatë gjykimit në Gjykatën Kushtetuese u konstatua se ato vendime janë ekzekutuar një ditë para se të merrej vendimi i pezullimit. Si rrjedhojë, vendimi i pezullimit duhet revokuar.*

<sup>890</sup> Vendimi nr.8, datë 23.1.2002 i Gjykatës Kushtetuese, pika 2 e dispozitivit: *Revokimin e vendimit të pezullimit të ekzekutimit datë 30.10.2001 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.*

<sup>891</sup> Vendimi nr.9, datë 23.3.2010 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>892</sup> Vendimi nr.20, datë 1.6.2011 i Gjykatës Kushtetuese: *Gjykata, në përputhje me nenin 45/4 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash, vendosi gjithashtu të heqë masën e pezullimit.*

<sup>893</sup> Biba, Denar, "Pezullimi në gjykimin kushtetues", botuar në Revistën "Jeta Juridike", nr.4 dhjetor 2006, botim i Shkollës së Lartë të Magjistraturës, Shtëpia Botuese "Erik", fq.39

dyti, ky pezullim nuk është pasojë e ndonjë vlerësimi nga Gjykata Kushtetuese, por është *ipso lege*. Pra, në momentin kur Gjykata vendos kalimin e kërkesës në seancë plenare atëherë pezullimi i procedurave të ratifikimit të marrëveshjes ndërkombëtare bëhet për shkak të ligjit. Në këtë drejtim duke qenë se vendimin për kalimin në seancë plenare mund ta marrë edhe Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, atëherë pezullimi i procedurave, fillon që nga ky moment dhe nuk është nevojshme që të shprehet Mbledhja e Gjyqtarëve siç ndodh në rastin e parashikuar nga neni 45 i LGJK. Kjo i jep Gjykatës kohën e nevojshme për të përcaktuar drejt kushtetutshmërinë e marrëveshjes ndërkombëtare të paraqitur për ratifikim përpara saj.

Rasti i dytë është kontrolli kushtetues i partive apo organizatave politike. Neni 59 i LGJK, i ka dhënë të drejtën Gjykatës Kushtetuese që të vendosë dhe për pasojë të urdhërojë pezullimin e veprimtarisë së partisë/organizatës politike. Ky vendim i Gjykatës mund të merret vetëm në rast se ajo çmon se ka të dhëna që veprimtaria e mëtejshme e një partie ose organizate politike çënon rendin kushtetues ose interesat shtetërorë apo publikë.

Në varësi të të dhënave që janë paraqitur vendimi mund të merret gjatë shqyrtimit paraprak nga Mbledhja e Gjyqtarëve apo nga Gjykata në seancë plenare. Kështu, nëse veprimtaria e partisë politike shfaqet e dhunshme dhe me efekte të rënda, për shpejtësi veprimi dhe për mbrojtjen e interesave të rëndësishme publike vendimi duhet të merret nga Mbledhja e Gjyqtarëve, në të kundërt nëse nuk ka një rrezik potencial, çdo lloj vendimmarrje për pezullimin e veprimtarisë së partisë politike duhet të merret në seancë plenare duke respektuar në këtë rast parimin e kontradiktorialitetit.

Kjo masë pezullimi është e ndryshme nga ajo e parashikuar nga neni 45 i LGJK pasi në këtë rast nuk pezullohet zbatimi i ndonjë akti ligjor, nënligjor, administrativ apo gjyqësor, por përkundrazi vendoset pezullimi i një veprimtarie të një subjekti të së drejtës, të një personi juridik.

Një tjetër rast pezullimi është parashikimi nga vetë Kushtetuta i vendimit të Këshillit të Ministrave për shkarkimin apo shpërndarjen e organeve të zgjedhura drejtpërsëdrejti të njësisive të qeverisjes vendore. Kushtetuta në pikën 2 të nenit 115 të saj përcakton se me depozitimin e ankimit në Gjykatën Kushtetuese nga organi i shpërndarë apo i shkarkuar, kundër vendimit të Këshillit të Ministrave, zbatimi i këtij të fundit pezullohet automatikisht. Pra, në këtë rast kemi të bëjmë me një pezullim të menjëhershëm i cili në ndryshim nga rastet e tjera të pezullimit të parashikuara nga LGJK, nuk i nënshtrohet vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese.

Ky lloj pezullimi në dukje bie në kundërshtim edhe me parimin që përshkron procedurën administrative sipas të cilit vetëm në rast të ankimit administrativ pezullohet zbatimi i një akti administrativ<sup>894</sup> ndërsa ankimi gjyqësor nuk sjell pezullimin e zbatimit të një akti administrativ me përjashtim të rastit kur gjykata vendos ndryshe.<sup>895</sup>

Në rastin e procedurës disiplinore ndaj organeve të qeverisjes vendore, duke pasur në konsideratë faktin se kemi të bëjmë me organe të zgjedhura drejtpërsëdrejti nga populli, Kushtetuta vetë ka parashikuar pezullimin e menjëhershëm të zbatimit vendimit të Këshillit të Ministrave, duke shmangur në këtë mënyrë pasojat që mund të vijnë nga një vendim pozitiv i Gjykatës Kushtetuese në lidhje me kërkesën ankimore. Në rast se nuk do të veprimej në këtë

<sup>894</sup> K.Pr.A., neni 138, pika 1.

<sup>895</sup> K.Pr.A., neni 131, pika 2.

Vendimi nr.32, datë 24.11.2003 i Gjykatës Kushtetuese: ... *vetëm paraqitja e ankimit në gjykatë për këto vendime nuk shkakton automatikisht pezullimin e tyre. Por, kur pala e interesuar kërkon njëkohësisht edhe pezullimin e këtyre akteve, atëherë gjykata nuk ka asnjë pengesë që kur janë kushtet e nenit 329 të Kodit të Procedurës Civile të vendosë pezullimin e aktit të rëxjerrë nga këto organe...*



mënyrë atëherë mund të gjendeshim përballë situatës kur do të kishim zgjedhje vendore të tjera nga ku do të dilnin organe ekzekutive dhe përfaqësuese të tjera, ndërkohë që Gjykata Kushtetuese mund të vendoste edhe anulimin e shpërndarjes apo shkarkimit të organit të mëparshëm. Është mëse e qartë se në një situatë të tillë ushtrimi i sovranitetit nga ana e popullit vihet seriozisht në diskutim.

Pavarësisht parashkimit të LGJK, ka disa gjykime ku masa e pezullimit nuk mundet që të zbatohet. Një rast i tillë është mungesa e mundësisë për pezullimin e amendamenteve kushtetuese. Kjo e drejtë e Gjykatës buron nga ligji organik dhe jo nga ndonjë normë kushtetuese siç parashikohej nga paketa e mëparshme kushtetuese,<sup>896</sup> ndërkohë që amendamenti kushtetues për nga fuqia juridike barazohet me Kushtetutën.<sup>897</sup> Për këtë arsye jam i mendimit që parashikimi i nenit 45 të ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese nuk mundet që të gjejë zbatim kundrejt amendamenteve kushtetuese, duke qenë se është një normë me fuqi juridike më të ulët në raport me amendamentin kushtetues që në këtë rast shfaqet si normë e epërme.

Në lidhje me kontrollin e papajtueshmërisë së ushtrimit të funksioneve nga Presidenti i Republikës, rezulton se në këtë rast parashikimet e LGJK-së nuk gjejnë zbatim. Në këtë lloj gjykimi shqyrtohet sjellja e Presidentit të Republikës dhe jo ndonjë akt juridik, për rrjedhojë parashikimet nenit 45 të LGJK në këtë rast nuk gjejnë asnjë zbatim.

Pezullimi i Presidentit të Republikës nga detyra në rastin e procedurave “*impeachment*” zbatohet në disa vende. Kështu në Hungari në rast të ngritjes së akuzës nga Asambleja Kombëtare, Presidenti konsiderohet i pezulluar deri në përfundimin e gjykimit.<sup>898</sup> E njëjta gjë ndodh edhe në Korenë e jugut.<sup>899</sup> Në Slloveni Presidenti mund të pezullohet vetëm nëse një gjë e tillë vendoset nga Gjykata Kushtetuese.<sup>900</sup> Pavarësisht shkeljeve të pretenduara që i atribuohen Presidentit të Republikës, si Kushtetuta dhe LGJK në asnjë moment nuk parashikojnë pezullimin e Presidentit të Republikës nga detyra. Kujtojmë se neni 45 i LGJK bën fjalë për pezullimin e akteve dhe jo të ushtrimit të funksioneve.

I njëjti arsyetim mund të thuhet edhe për gjykimet për vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të funksioneve nga Presidenti i Republikës apo shkarkimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë.

LGJK në lidhje me pezullimin e veprimtarisë së deputetëve nuk ka asnjë parashikim në këtë rast. Kjo vlen edhe kur gjykohet zgjedhshmëria e deputetit. Një alternativë është referimi në parashikimin e nenit 45 të LGJK ku në bazë të të cilit mund të pezullohet akti i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që ka shpallur fitues deputetin, mandati i të cili po kundërshtohet në Gjykatën Kushtetuese. Në rast se do të zbatohet kjo mundësi atëherë ky deputet nuk do të mund të ushtrojë detyrat e tij si deputet i Kuvendit. Në këtë situatë duhet që të justifikohen interesat e rënda që i vijnë veprimtarisë shtetërore, ku argumenti bazë është fakti që vendimmarrja e Kuvendit mund të bazohet edhe në një vendimmarrje antikushtetuese pasi një prej anëtarëve të saj nuk i takon ky mandat. Në këtë rast është e kuptueshme që pretendimet për zgjedhshmërinë e deputetit në mënyrë antikushtetuese duhet të jenë të bazuara, *prima facie*. Sipas alternativës

<sup>896</sup> Neni 24, pika 10 e ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese””.

<sup>897</sup> Omari, Luan; Anastasi, Aurela; “*E drejta kushtetuese*”, shtëpia botuese “PEGI”, Tiranë 2010, fq.47.

<sup>898</sup> Pistan, Carna, “*Le esperienze di Croazia, Slovenia, Polonia e Ungheria*”, botuar në “*Sistemi e modelli di giustizia costituzionale*”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “Cedam”, Padova 2009, fq.437.

<sup>899</sup> Fanotto, Luca, “*La giustizia costituzionale negli ordinamenti asiatici*”, botuar në “*Sistemi e modelli di giustizia costituzionale*”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “Cedam”, Padova 2009, fq.748.

<sup>900</sup> Pistan, Carna, “*Le esperienze di Croazia, Slovenia, Polonia e Ungheria*”, botuar në “*Sistemi e modelli di giustizia costituzionale*”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “Cedam”, Padova 2009, fq.439.



tjetër, një mundësi e tillë nuk është e mundur. Kështu, Kuvendi e përfundon mandatin e tij në të njëjtën ditë të të njëjtit muaj të vitit të katërt. Për rrjedhojë atë ditë duhet që të mblidhet Kuvendi i ri. Në rast se nuk mblidhet do të kishim vakum të një institucioni të rëndësishëm kushtetues, vakum i cili nuk njihet nga Kushtetuta. Për me tepër momenti i mbarimit dhe i fillimit të mandatit të Kuvendit parashikohet nga Kushtetuta dhe për rrjedhojë duhet që të prevalojë ndaj parashikimeve ligjore të LGJK. Personalisht bashkohem me alternativën e dytë, duke pasur në konsideratë edhe faktin se kundërshtimi i mandatit të deputetit, nuk mundet që të çënojë veprimtarinë e Kuvendit.

Masa e pezullimit është e pamundur të merret edhe kur gjykohet papajtueshmëria e ushtrimit të funksionit nga ana e deputetëve. Kështu asnjë dispozitë kushtetuese apo ligjore nuk ja jep këtë të drejtë Gjykatës Kushtetuese për të pezulluar ushtrimin e mandatit të deputetit. Për më tepër që në këtë rast nuk është duke u shqyrtuar ndonjë akt i caktuar por është duke u gjykuar sjella dhe veprimtaria e një deputeti.

E diskutueshme është marrja e masës së pezullimit edhe në lidhje me gjykimin e verifikimit të zgjedhjes së deputetëve. Në në këtë rast vlejné të njëjtat argumenta që analizuam më sipër për pezullimin në rastin e procedurave për kontrollin e zgjedhshmërisë së deputetëve.

Personalisht jam me mendimin e dytë për asyet që i prekëm më sipër. Është e kuptueshme që Gjykata Kushtetuese duhet ta shqyrtojë çështjen me përparësi dhe të vendosë mundësisht përpara mbledhjes së parë të legjislaturës së re.

### 3. BASHKIMI DHE NDARJA E ÇËSHTJES.

Një tjetër vendimmarrje që mund të marrë Kolegji është bashkimi apo ndarja e kërkesave. Qëllimi i këtyre veprimeve procedurale ka si qëllim rritjen e efektivitetit dhe ekonominë gjyqësore në gjykimin kushtetues. Pavarësisht se në LGJK nuk ka asnjë parashikim në lidhje bashkimin apo ndarjen e çështjeve gjykata duke zbatuar parashikimin e nenit 1, pika 2 të ligjit të saj i është referuar K.Pr.C.

Në rastin e bashkimit të çështjeve, gjykata ka zbatuar *mutatis mutandis* parashikimet e neneve 57,<sup>901</sup> 448<sup>902</sup> të K.Pr.C. dhe të nenit 92<sup>903</sup> të K.Pr.P. Bazuar në këto dispozita si edhe duke analizuar jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, vërejmë se kjo gjykatë e ka zbatuar bashkimin e çështjeve në disa raste. Bashkimi i çështjeve varet nga natyra e gjykimit, e subjektit, objektit të kërkesës dhe shkaqeve të ngritura.

Në gjykimet me natyrë abstrakte, në rradhë të parë, Gjykata ka vendosur bashkimin e çështjeve kur ka qenë përpara disa kërkesave të paraqitura nga subjekte të ndryshme por që kanë pasur objekt të njëjtë,<sup>904</sup> pavarësisht se argumentat e tyre mund të kenë qenë të ndryshme. Bashkimi i çështjeve ka qenë më i përshtatshëm për Gjykatën në ato raste kur megjithëse ka pasur subjekte kërkuese të ndryshme, objekti dhe shkaqet e paraqitura prej tyre kanë qenë të

<sup>901</sup> K.Pr.C., neni 57: *Paditë kundër disa të paditurve që shqyrtohen nga gjykata me trupa gjyqësive të ndryshme, kur kanë lidhje midis tyre për nga objekti, mund të bashkohen me një çështje të vetme dhe të shqyrtohen nga gjykata e vendit të banimit ose të qëndrimit të njërit prej të paditurve.*

<sup>902</sup> K.Pr.C., neni 448: *Të gjitha ankimet e bëra veçmas kundër të njëjtit vendim bashkohen në një proces të vetëm.*

<sup>903</sup> K.Pr.P., neni 200: *Bashkimi i çështjeve që qëndrojnë në të njëjtën gjendje dhe shkallë para të njëjtës gjykate mund të vendoset, kur nuk dënohet shpejtësia e zgjidhjes së tyre: a) në rastet e parashikuara nga neni 79; b) në rastet e veprave penale të kryera nga disa persona në dëm të njëri-tjetrit; c) në rastet, kur prova e një veprave penale ose e një rrethane të saj ndikon mbi provën e një veprave penale tjetër ose të një rrethane të saj.*

<sup>904</sup> Vendimet nr.27, datë 26.5.2010, nr.1, datë 12.1.2011 dhe nr.43, datë 6.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

njëjta.<sup>905</sup> Rast tjetër të bashkimit të çështjeve në një gjykim abstrakt ka pasur kur i njëjti subjekt kërkues ka paraqitur kërkesa të ndryshme, të cilat kundërshtojnë dispozita të ndryshme por që i përkasin të njëjtit ligj.<sup>906</sup> Në të njëjtën mënyrë ka proceduar Gjykata Kushtetuese edhe në ato raste kur i njëjti subjekt ka kundërshtuar të njëjtën dispozitë ligjore, pavarësisht se shkaqet e paraqitura kanë qenë të ndryshme në të dyja kërkesat.<sup>907</sup>

Gjithsesi, Gjykata Kushtetuese ka bashkuar edhe çështje që kanë pasur natyra të ndryshme, ku njëra ka qenë gjykim abstrakt, ndërsa tjetra ka qenë gjykim konkret. Në këtë rast ajo ka konstatuar se kërkesa me objekt kontrollin e kushtetutshmërisë së normës juridike ka natyrë të njëjtë, në substancë dhe në argumentet e paraqitura me njërin nga pretendimet e parashtruara në kërkesën me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, paraqitur nga kërkuesi tjetër. Për këtë arsye dhe me qëllimin e arritjes së efektivitetit të gjykimit, ajo i ka bashkuar kërkesat e sipërpërmendura në një çështje të vetme dhe ia ka nënshtruar ato shqyrtimit kushtetues.<sup>908</sup>

Gjykata Kushtetuese në gjykimet konkrete dhe konkretisht në gjykimin për një proces të rregull ligjor ka vendosur bashkimin e çështjeve në ato raste kur vendimet gjyqësore janë kundërshtuar njëkohësisht nga disa subjekte të cilët kanë qenë pjesëmarrëse në këto gjykime por kanë paraqitur kërkesa të veçanta. Atëherë duke qenë se objekti i kërkesave ka të bëjë me të njëjtin gjykim ku kërkuesit kanë qenë palë dhe objektet e kërkesave të tyre janë të njëjta apo të lidhura ngushtë midis tyre, Gjykata ka vendosur që të bashkojë kërkesat në një proces të vetëm gjykimi kushtetues.<sup>909</sup>

Përveç bashkimit të çështjeve Gjykata Kushtetuese ka si mundësi edhe veçimin e tyre. Kështu në jurisprudencën e saj Gjykata Kushtetuese e ka pranuar këtë mundësi në ato raste kur arrin në përfundim se një pjesë e kërkimeve të paraqitura në kërkesë kanë karakter të veçantë dhe për shkak të rëndësisë së tyre kërkojnë një shqyrtim më vete, krejt të ndryshëm nga kërkimet e tjera. Prandaj, për këtë pjesë bëhet veçimi i çështjes duke u marrë në shqyrtim si çështje e veçantë.<sup>910</sup>

Por mund të ndodhë që përpara Gjykatës Kushtetuese të shfaqen kërkesa nga subjekte të ndryshme të cilat kanë kërkime të ndryshme ndaj akteve të ndryshme, por që ndërthuren me njëra – tjetrën. Në këto raste Gjykata ka mundësinë që të ndajë kërkesat në pjesë të ndryshme duke bashkuar me njëra-tjetrën vetëm kërkimet që janë të njëjta dhe duke u shprehur në vendime të ndryshme.<sup>911</sup> Një mundësi e tillë është shfrytëzuar nga Gjykata Kushtetuese në fillimet e saj. Kështu në jurisprudencën e hershme të kësaj gjykate, në lidhje me këtë situatë gjejmë këtë arsyetim:

*Gjykata Kushtetuese, duke u nisur nga fakti se kërkesa e Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate është e njëjtë në thelb me kërkesën e Shoqatës së "Privatëve të Lirë Shqiptarë" dhe se kërkesa e Shoqatës "Pronësi me Drejtësi" pjesërisht ka lidhje me*

<sup>905</sup> Vendimet nr.16, datë 7.6.1997, nr.40, datë 11.3.2002 dhe nr.52, datë 1.12.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>906</sup> Vendimi nr.135, datë 17.6.2002 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>907</sup> Vendimi nr.5, datë 6.3.2009 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>908</sup> Vendimi nr.20, datë 4.5.2007 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>909</sup> Vendimet nr.27, datë 27.7.2009, nr.30, datë 16.5.2012, nr.38, datë 5.7.2012 dhe nr.6, datë 26.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>910</sup> Vendimi nr.13, datë 29.5.1997 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>911</sup> Agosta, Stefano, "“Soggetti” ed “oggetti” del giudizio in via principale al banco di prova: i chiaroscuolo della giurisprudenza costituzionale", botuar në "Le zone d'ombra della giustizia costituzionale – I giudizi sulle leggi", botim i "Quaderni del "Gruppo di Pisa"", Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2007, fq.331.

*kërkesat e mësipërme vetëm përsa u përket neneve 12 dhe 17 të ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", me vendimin e ndërmjetshëm të datës 25.2.1994 vendosi të bashkojë në gjykimin e filluar, të inicuar nga "Shoqata e Privatëve të Lirë Shqiptarë", edhe kërkesën e Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate si dhe pjesën e kërkesës së Shoqatës "Pronësi me Drejtësi" që ka të bëjë me atakimin për pakushtetutshmëri, nga këndvështrimi i ish-pronarëve, të neneve 12 dhe 17 të ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve". Në të njëjtën kohë u vendos që pjesët e tjera të kërkesës së Shoqatës "Pronësi me Drejtësi" të shqyrtohen si çështje më vete.<sup>912</sup>*

Bashkimi dhe ndarja e çështjeve është një mundësi që i jepet gjykatës për t'i dhënë sa më shumë efektivitet dhe shpejtësi gjykimit kushtetues. Kështu ajo mund të vendosë bashkimin e çështjeve nëse ato kanë lidhje të mjaftueshme midis tyre dhe për rrjedhojë mund të shqyrtohen disa kërkesa njëkohësisht duke përshpjeguar procesin kushtetues. Por nga ana tjetër kur kemi kërkesa të cilat për shkak të larmisë së kërtimeve dhe shkaqeve të paraqitura, gjykimi i tyre mund të bëhet pengesë për efektivitetin e gjykimit. Atëherë për lehtësi gjykimi, Gjykata mund të vendosë veçimin e kërtimeve në çështje të veçanta, ose të zbatojë metodën e alternuar duke ndarë disa çështje dhe duke i bashkuar këto pjesë me kërtime të çështjeve të tjera që kanë natyrë të njëjtë. Aplikimi i secilës prej këtyre metodave është në diskrecionin e vetë Gjykatës Kushtetuese. Kjo lloj vendimmarrje mund të merret përveçse nga Kolegji edhe nga Mbledhja e Gjyqtarëve ose nga vetë Gjykata Kushtetuese në seancë plenare nëse një situatë e tillë çmohet edhe në këtë fazë. E rëndësishme është që Gjykata Kushtetuese të mos e ketë mbyllur hetimin gjyqësor dhe të jetë tërhequr për vendim. Në rast se një situatë e tillë shfaqet pikërisht në këtë fazë të vonshme të gjykimit kushtetues, atëherë Gjykata Kushtetuese duhet që të rihapë hetimin gjyqësor.

#### **4. GJYKIMI NË SEANCË PLENARE.**

Nëse vendimi i Kolegjit/Mbledhjes së Gjyqtarëve është pozitiv, atëherë çështja kalon për gjykim në seancë plenare. Në këtë rast, Drejtoria Gjyqësore dhe e Dokumentacionit u komunikon subjekteve të interesuara kërkesën për të paraqitur parashtrimet e tyre, brenda një afati të caktuar, para zhvillimit të seancës. Kopje e tyre i dërgohet edhe kërkuesit. Pjesëmarrësit në gjykim kanë të drejtë të njihen në çdo kohë me materialet e dosjes.<sup>913</sup> Kjo bëhet me qëllim që palët të kenë mundësi të parashtrojnë në kohë pretendimet e tyre në lidhje me çështjen dhe të nihen me materialet e saj duke garantuar respektimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Njëkohësisht paraqitja e pretendimeve nga palët në kohë, ndihmon edhe Gjykatën që të ketë të gjithë materialet e nevojshme për të arritur në një vendimmarrje sa më të saktë në lidhje me çështjen. Shqyrtimi i çështjes në seancë plenare bëhet gojarisht ose mbi bazë dokumentash, sipas natyrës së çështjes.<sup>914</sup> LGJK më tej nuk përcakton shkaqe apo kritere mbi bazën e së cilës mundet që të përcaktohet se në çfarë mënyrë do të zhvillohet gjykimi. Kjo i është lënë në dorë vetë Gjykatës Kushtetuese, e cila shpeshherë për të shmangur ngarkesën e çështjeve dhe për të rritur efektivitetin e saj mund të zhvillojë shqyrtimin gjyqësor edhe mbi bazë dokumentash. Në fakt në shumicën e vendeve kjo mënyrë gjykimi preferohet më shumë nga gjykatat kushtetuese.

<sup>912</sup> Vendimi nr.4, datë 08.04.1994 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>913</sup> Rregullorja, neni 8.

<sup>914</sup> LGJK, neni 23.

Kështu në Gjermani për vitin 2011 vetëm shtatë çështje u shqyrtuan gojarisht ndërkohë që pjesa tjetër vetëm mbi bazë dokumentash. Shqyrtimi në seancë plenare gojarisht zhvillohet si rregull për çështje me rëndësi të veçantë politike.<sup>915</sup> Në vijim po bëjmë një analizë të mëtejshme të tyre.

#### 4.1 Gjykimi në seancë gojarisht.

Si formë të parë të zhvillimit të seancës gjyqësore është pikërisht zhvillimi i seancës gjyqësore në prani të palëve pjesëmarrëse. Në zhvillimin e kësaj seance marrin pjesë të gjithë gjyqtarët por jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tyre.<sup>916</sup> Përpara zhvillimit të seancës relatori i çështjes, nëpërmjet Drejtorisë Gjyqësore dhe të Dokumentacionit, duhet të sigurohet që secilit gjyqtar t'i vihet në dispozicion një fashikull që të përmbajë, datën dhe orën e gjykimit të çështjes, kopjen e kërkesës, relacionin përmbledhës të relatorit të çështjes, pretendimet paraprake të paraqitura nga palët rreth kërkesës që do të shqyrtohet, kopjen e vendimeve gjyqësore që i janë bashkëlidhur kërkesës, kopjen e aktit normativ ose shënimit për vendndodhjen e tij në Fletoren Zyrtare.<sup>917</sup>

Seancën plenare të Gjykatës Kushtetuese e thërret dhe e drejton Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, por me miratimin e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, seancën plenare mund ta thërrasë dhe ta drejtojë një gjyqtar i saj.<sup>918</sup> Kjo situatë mund të ndodhë në ato raste kur Kryetari i Gjykatës Kushtetuese ndodhet në pamundësi ligjore për të marrë pjesë në gjykimin kushtetues. Si rregull më tej gjykimi kushtetues ndjek këto hapa ku në fillim deklarohet çelja e seancës plenare nga kryesuesi i saj dhe më pas verifikohet paraqitja e pjesëmarrësve. Në rast se pjesëmarrësit nuk janë paraqitur atëherë verifikohen shkaqet e mosparaqitjes së tyre. Në rast se ka shkaqe të arsyeshme për mosparaqitjen e tyre gjykata shtyn zhvillimin e seancës gjyqësore. Në rastin kur nuk ka shkaqe të arsyeshme Gjykata Kushtetuese në praktikë ka mbajtur qëndrime të ndryshme, herë duke vazhduar gjykimin në mungesë por më shpesh duke vendosur pushimin e gjykimit. Rasti i dytë që është shfaqur në praktikë ka të bëjë me situatën kur pala kërkuese nuk paraqitet në gjykim megjithëse ka marrë njoftim rregullisht dhe nuk ka paraqitur shkaqe të arsyeshme. Në përgjithësi Gjykata Kushtetuese është shprehur se:

*Ligji nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", në nenin 1, paragrafi i dytë, parashikon se "Për çështje që lidhen me procedurën që nuk rregullohen nga ky ligj, Gjykata Kushtetuese merr parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes." Bazuar në këtë dispozitë, Gjykata Kushtetuese ju referua Kodit të Procedurës Civile, neni 179, i cili parashikon se "Nëse paditësi ose asnjë nga palët, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqiten, si në veprimet përgatitore ashtu dhe seancën gjyqësore dhe rezultoni se kanë dijeni rregullisht, gjykata vendos pushimin e gjykimit të çështjes."*

*Në kushtet e mësipërme, Gjykata Kushtetuese vlerëson se plotësohen kriteret për pushimin e gjykimit të çështjes në bazë të dispozitës së sipërcituar të K.Pr.Civile. Konkretisht, pala kërkuese është njoftuar për ditën e gjykimit në këtë Gjykatë, sipas*

<sup>915</sup> Kommers, Donald P.; Miller, Russell A.; "The constitutional jurisprudence of the Federal Republic of Germany", Botimi i tretë, Shtëpia Botuese "Duke University Press", Londër 2012, fq.26.

<sup>916</sup> LGJK, neni 32.

<sup>917</sup> Rregullorja, neni 8.

<sup>918</sup> LGJK, neni 33.



*procedurës që parashikon neni 38, pika 3, i Ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Kështu, meqë kërkuësja është më vendqëndrim jashtë shtetit, Gjykata Kushtetuese ka proceduar me njoftimin e saj me shpallje në selinë e Gjykatës Kushtetuese. Përveç kësaj, në seancë rezultoi se kërkuësja nuk ka njoftuar për ndonjë shkak të arsyeshëm për mosparaqitje.*

*Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese konkludon, se përderisa njoftimi me shpallje prezumon dijeninë e kërkuëses dhe përderisa kjo e fundit nuk është paraqitur në gjyq, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, në bazë të nenit 179 të K.Pr.Civile, gjykimi i çështjes duhet të pushohet.<sup>919</sup>*

Arsyet e kësaj vendimmarrje duket se bazohen në parimin e disponibilitetit. Gjykata në këtë rast duke shfrytëzura hapësirën që i jep neni 1, pika 2 e ligjit të saj si edhe referimi në dispozitat e K.Pr.C. ka vendosur gjithmonë pushimin e Gjykimit. Por, mendoj se kësaj vendimmarrje në këtë rast mund ti bëhen disa kritika. Kjo për shkak se 38, pika 6 i ligjit organik të Gjykatës parashikon se kur kërkuësi, subjekti i interesuar ose përfaqësuesit e tyre, megjithëse janë njoftuar, nuk paraqiten në seancë plenare dhe për këtë nuk kanë paraqitur shkaqe të përligjura, seanca plenare zhvillohet në mungesë. Pra, sipas kësaj dispozite rezulton se gjykimi zhvillohet në mungesë pavarësisht se cili subjekt mungon. Nëse i qëndrojmë besnik teknikave të interpretimit sipas të cilave mënyra dëftore e ndërtimit të fjalisë është e barabartë me mënyrën urdhëroren, atëherë bazuar në togfjalëshin e fundit të dispozitës sipas së cilës *seanca plenare zhvillohet në mungesë*, rezulton se Gjykata Kushtetuese duhet të vazhdojë gjykimin në mungesë dhe kur mungon kërkuësi pa shkaqe të përligjura. Në fakt kjo Gjykatë, ka vepruar në këtë mënyrë në disa raste. Kështu në një rast ajo është shprehur se:

*Në bazë të nenit 38, pika 6 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", Gjykata vlerëson se arsyeja për mospraninë e avokatit të kërkuësit në këtë gjykim, për shkak të angazhimit të tij për përfaqësimin e një shtetasi në një tjetër gjykim që zhvillohej në Gjykatën e Lartë, ndërkohë që ka pasur kohën e mjaftueshme për t'iu përgjigjur kërkesave procedurale të gjykimit kushtetues, nuk përbën shkak të përligjur për shtyrjen e gjykimit. Për rrjedhojë, Gjykata vendosi të zhvillojë gjykimin në mungesë të kërkuësit, duke u bazuar në pretendimet me shkrim të paraqitura prej tij më datën 13.11.2008...<sup>920</sup>*

Në të njëjtën mënyrë u veprua nga Gjykata Kushtetuese edhe në kuadër të kërkesës që ishte paraqitur përpara saj për pretendimet e procesit të parregullt ligjor në lidhje me cënimin e afatit të arsyeshëm.<sup>921</sup> Një tjetër argument që mund të ngrihet në këtë drejtim është edhe raporti midis ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese dhe K.Pr.C. Ky raport rezulton qartësisht nga formulimi i nenit 1, pika 2 të LGJK, dispozitë e cila parashikon se për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj, Gjykata Kushtetuese merr parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes. Sipas fjalisë së parë të kësaj dispozite rezulton qartësisht se ligjet e tjera (përfshirë edhe K.Pr.C.), Gjykata Kushtetuese mund t'iu referohet vetëm në rast se nuk gjen rregullim në ligjin e saj

<sup>919</sup> Vendimi nr.27, datë 15.12.2008 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>920</sup> Vendimi nr.19, datë 9.7.2009 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>921</sup> Vendimi nr.12, datë 5.3.2012 i Gjykatës Kushtetuese.

organik. Në rastin konkret siç rezulton nga përmbajtja e nenit 38, pika 6 të cituar më sipër kjo situatë rregullohet nga vetë LGJK dhe për rrjedhojë Gjykata Kushtetuese nuk ka shkak që t'i referohej K.Pr.C. Përderisa kërkuesi e ka depozituar kërkesën pranë kësaj Gjykate dhe vetë nuk ka kërkuar më vonë që të tërhiqet prej saj, atëherë Gjykata Kushtetuese është e detyruar që të vazhdojë gjykimin. Edhe në vende të tjera po e njëjtja llogjikë juridike ndiqet, ku për shembull në Kroaci një nga rastet e pushimit të gjykimit është kur ankesa kushtetuese tërhiqet.<sup>922</sup>

Më tej Gjykata kalon në verifikimin e legjitimiteti të pjesëmarrësve ose të përfaqësuesve të tyre dhe kur është rasti i fton ata të plotësojnë aktet dhe dokumentet që rezultojnë me të meta, duke përfshirë këtu edhe aktet lidhur me përfaqësimin, gjetjen e personit dhe, kur e shih të nevojshme, u cakton palëve një afat.<sup>923</sup> Nëse çdo gjë është në rregull deri në këtë fazë atëherë pyeten pjesëmarrësit nëse kanë kërkesa paraprake dhe vendoset për to. Më pas lexohet kërkesa nga gjyqtari relator dhe ftohen pjesëmarrësit të parashirojnë kërkesat dhe kundërshtimet, duke filluar nga subjekti që ka paraqitur kërkesën. Pjesëmarrësit në proces japin shpjegime ose bëjnë sqarime për pyetjet e gjyqtarëve. Më pas nga Gjykata administrohen provat dhe ftohen pjesëmarrësit të japin mendime për përmbajtjen e tyre. Në përfundim ftohen pjesëmarrësit të bëjnë kërkesat përfundimtare dhe deklarohet nga kryesuesi mbyllja e seancës plenare dhe tërheqja për vendim.

Nëse pas mbylljes të seancës plenare çmohet e domosdoshme sqarimi i rrethanave plotësuese, të cilat kanë rëndësi të veçantë për çështjen në shqyrtim, vendoset riçelja e saj. Vendimi për riçeljen e seancës plenare merret me shumicë votash nga gjyqtarët që kanë qenë të pranishëm në seancën plenare. Vendimi për riçeljen e seancës plenare u njoftohet pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues, të cilët kanë të drejtë të marrin pjesë në të dhe t'u jepet fjala nëse e kërkojnë, për të bërë shpjegime që i çmojnë në interes të tyre.<sup>924</sup>

#### 4.2 Gjykimi mbi bazë dokumentash.

Gjykimi mbi bazë dokumentash është karakteristikë për natyrën e gjykimit kushtetues.<sup>925</sup> Shqyrtimi mbi bazë dokumentash është përdorur nga Gjykata Kushtetuese për herë të parë në vendimin nr.28, datë 21.2.2002, që kishte për objekt interpretimin e neneve 96, 97 të Kushtetutës. Sipas doktrinës kryerja e këtij procesi mbi bazë dokumentash justifikohet me faktin që në këtë rast kërkohej të dihej mënyra se si duhej të vepronte Kuvendi për miratimin e Këshillit të Ministrave njëherazi apo në faza të ndryshme dhe urgjenca e vendimmarrjes nga Gjykata Kushtetuese e shkaktuar nga pezullimi i procedurave parlamentare, e paraqisnin të domosdoshme shmangien e seancës dëgjimore dhe shqyrtimin e çështjes mbi bazë dokumentash.<sup>926</sup>

Me kohën Gjykata Kushtetuese ka filluar ta zbatojë gjithmonë e më shumë këtë lloj procesi në krahasim me procesin gojor. Në përgjithësi ky lloj procesi është zbatuar në kuadër të shqyrtimit të kërkesave për proces të rregullt ligjor. Zbatimi në këtë rast i këtij gjykimi ka ndodhur në ato raste kur Gjykata Kushtetuese ka pasur një praktikë të konsoliduar në lidhje me shqyrtimin e këtyrë çështjeve. Kështu si të tilla mund të përmendim kërkesat për proces të

<sup>922</sup> Momcinovic, Hrvoje, "Contesting the arbitration decision in the proceedings before the Constitutional Court according to the Croatian law", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të Demokracisë", botim i Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) Nr.15, ribotim 1998, fq.81.

<sup>923</sup> K.Pr.C., neni 176.

<sup>924</sup> LGJK, neni 44.

<sup>925</sup> Sadushi, Sokol, "Drejtësia Kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq.349.

<sup>926</sup> Po aty, fq.348.

parregullt ligjor kur Gjykata e Lartë nuk ka pranuar rekursin sepse nuk ishin nënshkruar nga mbrojtësit e të pandehurve.<sup>927</sup> Një tjetër rast ka qenë në lidhje me pretendimet për mënyrën e arsyetimit të vendimeve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi, veçanërisht në ato raste kur në vendimin e mospranimit të rekursit nuk ishin treguar shkaqet e rekursit.<sup>928</sup> Tjetër rast ka qenë kur për një pjesë të pretendimeve kërkuesi nuk kishte shteruar mjetet juridike.<sup>929</sup> Shqyrtimi i kërkesave për mosekzekutim të vendimeve të formës së prerë për të cilat Gjykata Kushtetuese ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar është një tjetër rast kur gjykimi zhvillohet mbi bazë dokumentash.<sup>930</sup> Si rregull shembujt më të mëdhenj janë në procesin e rregullt ligjor dhe lidhen me qartësinë e çështjes bazuar në dokumentat shkresore të paraqitura nga palët dhe nga jurisprudenca e konsoliduar e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me këto pretendime.

Gjykimi mbi bazë dokumentash është zbatuar edhe në gjykimin e mosmarrëveshje të kompetencave midis pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore, në ato raste kur Gjykata Kushtetuese e kishte shprehur qëndrimin e saj në një tjetër çështje, e cila ishte e njëjtë në objekt dhe në shkaqet e paraqitura me çështjen në shqyrtim përpara saj.<sup>931</sup>

Tjetër shembull i zhvillimit të gjykimit me dyer të mbyllura lidhet me shqyrtimin e kërkesave për plotësim apo korigjim të gabimeve në arsyetimin e vendimeve. Edhe në këtë rast nëse ka gabime në vendimin gjyqësor, apo jo, kjo verifikohet lehtësisht nga aktet dhe nuk është e nevojshme zhvillimi i një seance dëgjimore.<sup>932</sup>

Megjithatë gjykimi mbi bazë dokumentash është zhvilluar në disa raste edhe për sa i përket shqyrtimit të kërkesave për kushtetutshmërinë e ligjeve. Edhe në këtë rast ndodhemi si rregull përballë rasteve të qarta dhe një jurisprudencë të konsoliduar, por nuk kanë munguar dhe përjashtimet.

Në këto lloje gjykimesh, seanca zhvillohet vetëm në prani të trupës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, ku fjalën i pari e merr relatori i çështjes që bën prezantimin e pretendimeve të palëve që i kanë paraqitur më parë me shkrim dhe mund të ketë pyetje nga gjyqtarët kundrejt relatorit. Mbas kësaj seance Gjykata tërhiqet në dhomë këshillimi ku zhvillon më tej debatin midis vetë gjyqtarëve për vendimin që duhet të merret.

Megjithatë asgjë nuk e pengon Gjykatën që nëpërmjet një vendimi të ndërmjetëm të kalojë nga gjykimi mbi bazë dokumentash në gjykimin në seancë plenare me praninë e palëve nëse çmohet e nevojshme.

### 4.3 Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese.

Në marrjen e vendimi të Gjykatës Kushtetuese, marrin pjesë të gjithë gjyqtarët që kanë qenë në shqyrtimin e çështjes. Nëse gjatë kësaj kohe ndodh ndërrimi i gjyqtarëve për shkak të përfundimit të mandatit, gjyqtarët e rinj nuk marrin pjesë në procesin vendimmarrës të Gjykatës. LGJK nuk jep detaje mbi procesin e diskutimit dhe të votimit midis gjyqtarëve në dhomë këshillimi. Në këtë rast LGJK kufizohet vetëm me deklarimin se bisedimet si dhe votimi i vendimit bëhen pa praninë e personave të tjerë.<sup>933</sup> LGJK parashikon edhe mundësinë e shtyrjes së vendimmarrjes në raste kur ndonjëri prej gjyqtarëve që ka marrë pjesë në shqyrtimin e

<sup>927</sup> Vendimi nr.53, datë 1.12.2014 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>928</sup> Vendimi nr.55, datë 5.12.2014 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>929</sup> Vendimi nr.56, datë 5.12.2014 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>930</sup> Vendimi nr.46, datë 30.7.2014 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>931</sup> Vendimi nr.54, datë 5.12.2014 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>932</sup> Vendimi nr.33, datë 9.6.2014 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>933</sup> LGJK, neni 72, pika 1.



çështjes mungon në bisedime ose në votim. Në këtë rast, Mbledhja e Gjyqtarëve nuk zhvillohet dhe shtyhet për një datë tjetër. Në qoftë se edhe pas kësaj, pjesëmarrja e gjyqtarit nuk mund të sigurohet brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata vendos përfundimisht për çështjen, kur formohet shumica absolute e anëtarëve të saj. Në rast se kjo shumicë nuk formohet dhe ekziston mundësia për përfshirjen në këtë gjykim të gjyqtarëve të tjerë, që më parë nuk kanë marrë pjesë në të, seanca rihapet dhe shqyrtimi i çështjes fillon nga e para.<sup>934</sup> Kjo bëhet me qëllim që të shmanget situata ku Gjykata të ndodhet në pamundësi të marrjes së një vendimi. Në lidhje me këtë fazë, si rregull, Gjykata nuk ka asnjë afat.

Ana procedurale në lidhje me këtë fazë disiplinohet nga Rregullorja e Gjykatës sipas të cilës pas përfundimit të seancës plenare, para fillimit të diskutimit për marrjen e vendimit, gjyqtarëve u vihet në dispozicion opinioni me shkrim i këshilltarit të gjyqtarit relator, i cili konsiderohet pjesë e dosjes dhe ruhet në arkivin e institucionit, mendimet me shkrim të pjesëmarrësve në gjykim të paraqitura gjatë seancës plenare, dokumente e prova shkresore të dorëzuara nga palët në përfundim të seancës plenare, të cilat çmohen së kanë rëndësi për zgjidhjen e çështjes.<sup>935</sup> Rregullorja përcakton se gjyqtarët mbliidhen menjëherë për marrjen e vendimit, por jo gjithmonë kjo është mundur, bazuar edhe në kompleksitetin e natyrës që ka gjykimi kushtetues. Për këtë arsye koha në dispozicion të gjyqtarëve për përgatitjen e çështjes dhe diskutimin përfundimtar të saj, caktohet nga Kryetari në varësi të natyrës së çështjes, rëndësisë dhe vështirësisë që ajo paraqet.<sup>936</sup> Në lidhje me këtë moment bazuar në K.Pr.C.<sup>937</sup> dhe në Rregullore,<sup>938</sup> bisedimet bëhen për të gjitha elementet e çështjes. Është detyrë e Kryetarit që të drejtojë diskutimet, të formulojë çështjet për të cilat do të bëhet votimi dhe të formojë një shumicë gjyqtarësh pas çdo vendimi të gjykatës, pavarësisht qëndrimit të tij personal mbi çështjen.<sup>939</sup> Diskutimi bëhet mbi secilën prej kërtimeve e më pas vendoset për dispozitivin. Diskutimet mund të rihapen nëse nuk arrihet në sqarimin përfundimtar të çështjes ose gjyqtarët kanë nevojë për më shumë kohë në dispozicion. Në përfundim të tyre votohet duke filluar nga gjyqtari më i ri në detyrë, në fund voton Kryetari. Para se të bëhet votimi përfundimtar, gjyqtari ka të drejtë të ndryshojë qëndrim dhe/ose të kërkojë shtyrjen e diskutimit mbi çështjen.

Në përfundim të votimit përcaktohet koha për përgatitjen e vendimit nga gjyqtari relator, që caktohet në Mbledhjen e Gjyqtarëve në momentin e votimit të vendimit. Vendimi përgatitet sipas një strukture të miratuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve. Projekt vendimi diskutohet dhe miratohet nga të gjithë gjyqtarët. Para se të shpallet, vendimi i nënshtrohet redaktimit përfundimtar në mbikëqyrjen e relatorit ose këshilltarit.<sup>940</sup> Në përgjithësi është gjyqtari relator që arsyeton vendimin pavarësisht nëse ai ka votuar "pro" apo "kundër" tij. Vetëm në raste të rralla kur relatori është kundër vendimmarrjes së shumicës, mund të kërkojë që vendimin ta arsyetojë një tjetër gjyqtar.<sup>941</sup> Menjëherë pas miratimit të variantit përfundimtar të vendimit, gjyqtari relator ia përcjell atë Drejtorisë Gjyqësore dhe të Dokumentacionit, e cila pasi e zbardh dhe e regjistron në Regjistrin e Vendimeve, u njofton palëve ditën dhe orën e shpalljes së vendimit nga

<sup>934</sup> LGJK, neni 73.

<sup>935</sup> Rregullorja, neni 10.

<sup>936</sup> Rregullorja, neni 10

<sup>937</sup> K.Pr.C, neni 307

<sup>938</sup> Rregullorja, neni 11.

<sup>939</sup> Kommers, Donald P.; Miller, Russell A.; *"The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany"*, Shtëpia Botuese "Duke University Press", Londër 2012, fq.28.

<sup>940</sup> Rregullorja, neni 12.

<sup>941</sup> Kommers, Donald P.; Miller, Russell A.; *"The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany"*, Shtëpia Botuese "Duke University Press", Londër 2012, fq.28.



Gjykata. Gjykata e shpall vendimin në prani të pjesëmarrësve në gjykim ose ua bën të ditur atyre nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm. Pas çdo shpallje vendimi, një kopje u dërgohet pjesëmarrësve në gjykim dhe një kopje dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare. Vendimi pasqyrohet edhe në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës në formën e tij të plotë. Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun dhe me Jashtë për çdo rast përgatit njoftimin për shtyp, i cili përmban edhe një përmbledhje të vendimit. Vendimet e Gjykatës që merren “Në Emër të Republikës së Shqipërisë” botohen në fillim të çdo viti pasardhës në një përmbledhje të veçantë që përgatitet nga Drejtoria e Kërkimeve, Studimeve dhe Botimeve. Botimi shoqërohet edhe me indeksin përkatës dhe pasqyrë statistikore të vendimmarrjes së Gjykatës për periudhën në fjalë.<sup>942</sup>

#### 4.4 Interpretimi, plotësimi dhe korrigjimi i vendimit.

Megjithë kohën e nevojshme që merr Gjykata Kushtetuese për arsyetimin e vendimit përsëri mund të ndodhë që pjesë të vendimit të saj të mbetën të errëta, të mangëta ose të ketë edhe gabime në të. Për këtë arsye LGJK parashikon edhe mundësinë për të ndërhyrë në vendim edhe mbas shpalljes së tij. Sipas nenit 80, pa anuluar apo ndryshuar vendimin e saj Gjykata Kushtetuese ka të drejtë që të interpretojë vendimin në rast dyshimi ose mosmarrëveshje për kuptimin e tij, pa ndryshuar në asnjë rast përmbajtjen ose të plotësojë vendimin, të ndreqë gabimet në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në të, brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit.

Kërkues në këtë rast është secili prej pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues që është zhvilluar.<sup>943</sup> Pra, karakteristikë në këtë pikë është fakti që kërkuesi nuk lidhet me parashikimet kushtetuese të legjitimitetit të subjektit. Mjafton që ai të ketë qenë pjesëmarrës në gjykimin kushtetues dhe të argumentojë se vendimi ka pjesë të errëta ose ka pasaktësi dhe gabime.

Interpretimi i vendimit është bërë nga Gjykata Kushtetuese në ato raste kur nuk përputhet plotësisht mënyra se si ajo ishte shprehur në dispozitiv në raport me pjesën arsyetuese të vendimit,<sup>944</sup> ndërsa ndreqja e gabimeve nga Gjykata Kushtetuese është pranuar nëse në vendimin e saj janë shkruar gabim të dhëna apo ekstremitetet e akteve që kanë qenë pjesë e shqyrtimit gjyqësor. Kështu shembuj të tillë ka pasur kur është shkruar gabimisht numri i një vendimi gjyqësor.<sup>945</sup>

<sup>942</sup> Rregullojta, neni 13.

<sup>943</sup> Vendimi nr.23, datë 23.4.2012 i Gjykatës Kushtetuese, parag.7: *Gjykata, në jurisprudencën e saj, në lidhje me legjitimitetin e kërkuesit, në kushtet kur ajo investohet për interpretimin e një vendimi të saj, ka theksuar se në kuptim të nenit 80 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, edhe pse Gjykata Kushtetuese ka në kompetencë të interpretojë vendimin e saj në rast dyshimi ose mosmarrëveshjeje për kuptimin e tij, por pa ndryshuar përmbajtjen e tij, ajo mund të vihet në lëvizje vetëm nga palët pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes.*

<sup>944</sup> Vendimi nr.6, datë 5.3.2008 i Gjykatës Kushtetuese: *Në ushtrim të kësaj kompetence, Gjykata Kushtetuese çmon, se në rastin konkret, dispozitivi i vendimit të saj nr.9, datë 11.05.2006 duhet interpretuar në pajtim dhe harmoni me pjesën arsyetuese të këtij vendimi në të cilin janë pranuar shkelje të standardeve të gjykimin për një proces të rregullt ligjor vetëm për kërkuesin A.P. Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin, se dispozitivi i vendimit nr.9, datë 11.05.2006 që shfuqizon si të papajtueshëm me Kushtetutën vendimin nr.129, datë 02.03.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ka efekt vetëm për kërkuesin Arben Prifti. Shih edhe vendimin nr.23, datë 23.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese.*

<sup>945</sup> Vendimi nr.7, datë 1.4.2004 i Gjykatës Kushtetuese: *Një gabim i aspektit material ekziston në vendimin e sipërcituar të Gjykatës Kushtetuese. Me këtë vendim, Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar tre vendime, nga të cilët vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë rezulton me numrin 1952, datë 19.12.2001. Në fakt, nga këqyrja e*

Nga ana tjetër, Gjykata Kushtetuese ka qenë gjithmonë e qëndrueshme në refuzimin e interpretimit të vendimit të saj në mënyrë të tillë që do ta ndryshonte atë ose do të nxirrte këtë Gjykatë jashtë juridiksionit të saj.<sup>946</sup>

## 5. VENDIMET E GJYKATËS KUSHTETUESE.

Gjykata Kushtetuese, si çdo Gjykatë është e detyruar që të arsyetojë vendimet e saj.<sup>947</sup> LGJK vetë nuk na jep elementët dhe formën që duhet të ketë vendimi gjyqësor. Ndërsa Rregullorja, siç e përmendëm edhe më sipër, parashikon se vendimi përgatitet sipas një strukture të miratuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve. Në fakt, struktura dhe elementët e vendimit janë ato që përcaktohen nga K.Pr.C. si ligj plotësues në këtë rast. Mbledhja e Gjyqtarëve në këtë rast i shton strukturës së vendimit disa veçori, të cilat identifikohen nga qëllimi dhe objektivat që kërkon të realizojë drejtësia kushtetuese.<sup>948</sup>

Duke iu rikthyer K.Pr.C. rezulton se sipas nenit 310 vendimi gjyqësor duhet që të përmbajë disa elementë<sup>949</sup> dhe në përgjithësi e njëjta strukturë ndiqet edhe nga vendimet e

---

*vendimit origjinal të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, rezulton se si numri i vendimit edhe viti janë shkruar gabim. Pra, numri 1252 i vendimit është shkruar 1952 dhe viti 2002 është shkruar 2001. Ky gabim material qëndron vetëm në këto shifra, ndërsa pjesa i përket elementeve të tjera që lidhen me palët në gjykim, objektin e gjykimit si dhe arsyetimin e vendimit rezultojnë se janë identike. Në këto kushte Gjykata Kushtetuese, duke u bazuar në nenin 80 pika 1 shkronja "b" të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" dhe nisur nga fakti se pretendimi për ndreqjen e këtij gabimi material është paraqitur në afatin e caktuar, çmon se kërkesa është e drejtë e duhet pranuar. Shih edhe vendimet nr.24, datë 29.5.2013 dhe nr.33 datë 9.6.2014 të Gjykatës Kushtetuese.*

<sup>946</sup> Vendimi nr.37, datë 7.3.2002 të Gjykatës Kushtetuese: *Në bazë të nenit 80 pika 1 germa "a" të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", Gjykata Kushtetuese ka të drejtë "të interpretojë vendimin në rast dyshimi ose mosmarrëveshjeje për kuptimin e tij, pa ndryshuar në asnjë rast përmbajtjen". Sipas kësaj dispozite, që të bëhet interpretimi i vendimit duhet të ekzistojnë dy elementë që kanë të bëjnë me kuptimin e tij dhe që janë dyshimi ose marrëveshja. Këto duhet të jenë të tilla që ta bëjnë vendimin të pakuptueshëm e, për rrjedhojë, të pazbatueshëm. Por, në rastin konkret, njohja e së drejtës së parablerjes, duke cituar në vendim nenin përkatës të ligjit që mbron dhe garanton këtë të drejtë, nuk e bën vendimin të dyshimtë dhe as krijon ndonjë mosmarrëveshje për kuptimin e tij. Përkundrazi, përmendja e dispozitës ligjore, e cila përbën thelbin e vendimit, e bën këtë të fundit më të qartë e më të zbatueshëm. Kërkesa që të bëhet interpretimi për të sqaruar që e drejta e parablerjes dhe privatizimi i objektit të realizohen duke zbatuar ligjin që ka qenë në fuqi në kohën e dhënies së vendimeve, i kalon caqet ligjore të interpretimit dhe do të ndryshonte përmbajtjen e vendimit. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese i ka njohur në fakt të drejtën e parablerjes sipas ligjit, por jo të shprehet për mënyrën e realizimit të kësaj të drejte, çka do të bënte që çështja të dilte jashtë juridiksionit kushtetues. Problemet që mund të lindin më vonë në praktikë për kërkuesin dhe vështirësitë e privatizimit të objektit nuk kanë të bëjnë me kuptimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, por me realizimin e së drejtës së tij të njohur me ligj. Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese çmon se kërkesa për interpretim të vendimeve të lartpërmendura është e pabazuar dhe duhet të rrëzohet. Shih edhe vendimin nr.138 datë 14.12.2012 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.*

<sup>947</sup> Kushtetuta, neni 142, pika 1: *Vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara.*

<sup>948</sup> Sadushi, Sokol. "Drejtësia Kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq.376.

<sup>949</sup> K.Pr.C., neni 310: *Vendimi duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese. I. Në hyrjen e vendimit duhet të përmenden: 1) gjykata që ka gjycur çështjen, 2) trupi gjyqësor dhe sekretari, 3) koha dhe vendi i dhënies së vendimit, 4) palët, duke u shënuar identiteti dhe cilësia e tyre si paditës, i paditur, ndërhyrës si dhe përfaqësuesit e tyre, 5) emri i prokurorit, nëse ka marrë pjesë, 6) objekti i padisë, 7) kërkimet përfundimtare të palëve, 8) mendimi i prokurorit nëse ka marrë pjesë. II. Në pjesën përshkruese-arsyetuese duhet të përmenden: 1) rrethanat e çështjes, ashtu siç janë konstatuar gjatë gjykimit, dhe përfundimet e nxjerra nga gjykata, 2) provat dhe arsyet në të cilat mbështetet vendimi, 3) dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi. III. Në pjesën urdhëruese, ndër të tjera, duhet të përmenden: 1) çfarë vendosi gjykata, 1/1) Nëse gjykata vendos detyrime për palët, përmbajtjen konkrete të tyre. 2) kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore, 3) e drejta për të bërë ankim dhe afati për paraqitjen e tij.*

Gjykatës Kushtetuese me pak përjashtime, si për shembull në të nuk gjen pasqyrim e drejta për të bërë ankim dhe afati për paraqitjen e tij, pasi vendimet e Gjykatës janë përfundimtare, por gjen pasqyrim momenti i hyrjes në fuqi të vendimit.

Vendimi gjyqësor si akt procedural është shumë i rëndësishëm. Ai është akti që përmbyll procesin gjyqësor dhe deklaron pranimin ose jo të kërkesës. Duke e lidhur me efektet juridike që ka një vendim i Gjykatës Kushtetuese, rezulton se vendimi i Gjykatës ka vlerë dhe rëndësi, në parim, për një rreth të gjërë subjektsh. Për rrjedhojë një vlerë të rëndësishme merr edhe arsyetimi i vendimit. Në pjesën arsyetuese gjejnë pasqyrim argumentat e Gjykatës në lidhje me çështjen. Aty tregohet nëse institucionet kushtetuese kanë vepruar në përputhje apo jo me Kushtetutën. Është detyrë e tyre që gjithmonë ta rregullojnë sjelljen e ardhshme në përputhje me këtë qëndrim të Gjykatës. Për me tëpër këto argumenta, si rregull shërbejnë edhe për vendimmarrjen e ardhshme të Gjykatës, në çështje të ngjashme. Vetë Gjykata Kushtetuese në lidhje me vlerën e pjesës arsyetuese të vendimit të saj është shprehur :

*Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Në respekt të doktrinës dhe të jurisprudencës kushtetuese Gjykata thekson se efekti detyrues që pasqyrohet mbi argumentet thelbësore të vendimit të saj përbëjnë edhe një ratio decidendi, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë.<sup>950</sup>*

Mënyra e të shkruarit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese ka evoluar me kohën. Në fillimet e saj vendimet ishin standarde, pothuajse të njëjta me vendimet gjyqësore të gjykatave të zakonshme. Me kalimin e kohë pjesa arsyetuese ka ardhur duke u zgjeruar dhe strukturuar. Modeli që ndiqet aktualisht është i ngjashëm me modelin që përdor GJEDNJ dhe shumë gjykata të tjera kushtetuese. Ky lloj modeli kërkon që pjesa arsyetuese e vendimit të ndahet sipas rastit në rrethanat e çështjes, legjitimitimi i palëve, disponimi në lidhje me kërkesat për pezullim dhe në varësi të natyrës së gjykimit, kemi ndarje të vendimit për secilin nga pretendimet që ka ngritur kërkuesi dhe mbi bazueshmërinë e së cilave argumenton edhe Gjykata. Një tjetër aspekt i formës është edhe numërtimi i paragrafëve. Kjo mënyrë e të strukturuarit të vendimit paraqet një sërë avantazhesh, pasi është më i lehtë studimi i tyre si edhe referimi përkatës në raste të tjera.

Në varësi të mënyrës së votimit vendimet ndahen në vendime unanime, me shumicë votash dhe plurale. Vendimet unanime janë ato vendime në të cilat votimi i gjyqtarëve ka qenë i njëjtë për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Këto si rregull janë edhe vendimmarrjet më të preferuara pasi tregon për kompaktësinë e Gjykatës dhe për zgjidhjen e drejtë të çështjes.

Vendimet me shumicë votash, janë ato vendime në të cilat vendimmarrja e Gjykatës nuk ka qenë njëzëri. Por që vendimi të quhet i marrë atëherë duhet që të paktën pesë gjyqtarë të përbëjnë shumicën e kërkuar. Arsyetimi i shumicës së gjyqtarëve përbën edhe arsyetimin e Gjykatës dhe duhet që të përmbajnë të gjitha elementët që analizuam më sipër. Gjyqtarët në pakicë, kanë të drejtë nëse e shohin të nevojshme që të arsyetojnë qëndrimin e tyre. Ky arsyetim që njihet si “mendimi në pakicë”, tregon për një hapje të madhe të Gjykatës, pasi është një e drejtë që e njeh vetë Kushtetuta.<sup>951</sup> E themi këtë pasi ende sot ka gjykata të cilat nuk e pranojnë një mundësi të tillë. Për shembull në Itali, gjyqtarët që kanë votuar kundër shumicës nuk kanë të

<sup>950</sup> Vendimi nr.21, datë 29.4.2010 i Gjykatës Kushtetuese, parag.16.

<sup>951</sup> Kushtetuta, neni 131, pika 2: *Mendimi i pakicës botohet bashkë me vendimin.*



drejtë që të argumentojnë qëndrimin e tyre. Kjo justifikohet me argumentin për të ruajtur legjitimitetin e gjykatës si një trupë të vetme dhe ruajtjen e parimit të kolegjalitetit.<sup>952</sup> Në Sllovaki, gjyqtarët kishin të drejtë që mendimin e tyre në pakicë ta shprehin në procesverbalin gjyqësor, por nuk lejohej që mendimi në pakicë të publikohej me vendimin përfundimtar.<sup>953</sup> Raste të tjera të ndalimit janë edhe juridiksionet kushtetuese të Austrisë, Belgjikës, Francës dhe Luksemburgut.<sup>954</sup> Edhe në Gjermani fillimisht nuk lejohej arsyetimi i qëndrimit të gjyqtarëve që kishin mbetur në pakicë. Për herë të parë kjo u lejua në vitin 1971, por për të ruajtur kompaktësinë e gjykatës edhe në këtë vend arsyetimet e pakicës kanë qenë të pakta. Që nga viti 1971 deri në vitin 2012 mendime në pakicë të publikuara bashkë me vendimin përfundimtar ka pasur vetëm në 146 raste.<sup>955</sup> Në Lituani, në fillim mendimet në pakicë u ndaluan me qëllimin që Gjykata Kushtetuese e cila ishte e sapo krijuar të mund të vendoste autoritetin e saj. Në vitin 2008, parlamenti lituanëz mendoi se përvoja deritanishme e gjykatës, ishte mëse e mjaftueshme dhe amendoi ligjin përkatës duke lejuar mendimet në pakicë.<sup>956</sup>

Arsyeja e ndalimit të publikimit të mendimeve në pakicë reflekton nocionet arkaike të familjes së vendeve në "*civil law*", sipas së cilës ligji është i përcaktuar i qartë dhe i kuptueshëm dhe të gjithë gjyqtarët e zbatojnë atë. Kjo, është e kuptueshme që është një *non sens* juridik, që është pranuar gjithmonë dhe veçanërisht kur përfshihet edhe e drejta kushtetuese asnjëri nuk e beson më këtë.<sup>957</sup>

Mendimi në pakicë në justifikimin, stilin dhe qëllimin e tij është një largim nga qëndrimi i shumicës. Nëpërmjet këtij arsyetimi, gjyqtari në pakicë synon të nënvizojë dallimet e tij etike jurisprudenciale dhe doktrinale me shumicën.<sup>958</sup> Mendimi në pakicë në disa raste në një vendimarrje të ardhshme të Gjykatës Kushtetuese është kthyer në qëndrim të shumicës. Kështu si shembuj mund të përmendim, kuorumin e nevojshëm për votimin e thjeshtë sipas nenit 78 të pika 1 të Kushtetutës<sup>959</sup> si edhe cënimin e apo jo të panashmërisë së gjyqtarit të zakonshëm kur ai ka shqyrtuar edhe rekursin edhe kërkesën për rishikim vendim të formës së prerë të paraqitur nga e njëjta palë.<sup>960</sup>

Referuar Kushtetutës sonë rezulton se mendimet në pakicë botohen bashkë me vendimin përfundimtar të Gjykatës. Por ka edhe vende që ndjekin një tjetër procedurë. Kështu në Letoni ato botohen veçmas vendimit dhe në një përmbledhje të gjykatës në fund të çdo viti. Në Slloveni mendimet në pakicë nuk botohen bashkë me vendimin përfundimtar në Fletoren Zyrtare, por

<sup>952</sup> Ruggeri, Antonio; Spadaro, Antonino, "*Lineamenti di giustizia costituzionale*", Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2009, fq.65..

<sup>953</sup> Schwartz, Herman, "*The struggle for constitutional justice in post-communist Europe*", Shtëpia Botuese "The University of Chicago Press", Chicago 2000, fq.200.

<sup>954</sup> Kelemen, Katalin, "*Dissenting opinions in constitutional courts*", botuar në "German Law Journal" Vol.14, Nr.8, viti 2013 fq.1345, versioni online, marrë nga faqja e internetit: <https://www.germanlawjournal.com/pdfs/Vol14-No8/14.8.19.pdf> (parë për herë të fundit me datë 5.1.2014).

<sup>955</sup> Kommers, Donald P.; Miller, Russell A.; "*The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany*", Shtëpia Botuese "Duke University Press", Londër 2012, fq.29.

<sup>956</sup> Kelemen, Katalin, "*Dissenting opinions in constitutional courts*", botuar në "German Law Journal" Vol.14, Nr.8, viti 2013 fq.1350, versioni online, marrë nga faqja e internetit: <https://www.germanlawjournal.com/pdfs/Vol14-No8/14.8.19.pdf> (parë për herë të fundit me datë 5.1.2014).

<sup>957</sup> Schwartz, Herman, "*The struggle for constitutional justice in post-communist Europe*", Shtëpia Botuese "The University of Chicago Press", Chicago 2000, fq.246.

<sup>958</sup> Kommers, Donald P.; Miller, Russell A.; "*The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany*", Shtëpia Botuese "Duke University Press", Londër 2012, fq.29.

<sup>959</sup> Vendimet nr.29, datë 21.10.2009 dhe nr.44, datë 7.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>960</sup> Vendimi nr.7, datë 7.3.2011 dhe nr.25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese.



botohen në faqen e internetit, në përmbledhëse dhe në revista juridike. Arsyeja e këtij veprimi lidhet me shpenzimet që duhet të përballojë Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë e cila duhet që të pagujë edhe për botimin e vendimeve të saj në Fletoren Zyrtare. Edhe në Çeki mendimi në pakicë nuk botohet në Fletoren Zyrtare. Në këtë të fundit ka vetëm një shënim sipas së cilës ka edhe mendime në pakicë në lidhje me vendimin. Vendimi sëbashku me mendimet në pakicë botohet në përmbledhësen vjetore të vendimeve të gjykatës.<sup>961</sup>

Vendimet plurale, janë vendime në të cilat nuk ka një shumicë absolute të gjyqtarëve për sa i përket qëndrimit në lidhje me pranimin apo rrëzimin e kërkesës. Në këtë rast kemi një shumicë gjyqtarësh të cilat shprehen "pro" apo "kundër" kërkesës së paraqitur për shqyrtim por që arsyet për një vendimmarrje të tillë janë të ndryshme për gjyqtarët. Si shembuj po marrim dy raste nga praktika e Gjykatës Kushtetuese. Në rastin e parë Gjykata Kushtetuese kishte marrë në shqyrtim ankesën e një subjekti zgjedhor për zgjedhjet e zhvilluara dhe në të cilën pretendoheshin parregullsi. Në vendimin nr.3, datë 13.2.2003 katër gjyqtarë kushtetues mbajtën qëndrimin se gjatë zhvillimit të zgjedhjeve nuk kishte ndodhur asnjë parregullsi<sup>962</sup> dhe për rrjedhojë kërkesa duhej rrezuar. Një tjetër gjyqtar kushtetues megjithëse ishte për rrëzimin e kërkesës, argumentonte mungesën e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e kësaj çështjeje.<sup>963</sup> Ndërsa 4 gjyqtarë të tjerë ishin me mendime pakice.

Një tjetër rast lidhet me legjitimitimin e një grupi deputetësh të cilët në kuptim të nenit 134, pika 1, gërma "c" i ishin drejtuar Gjykatës Kushtetuese si subjekt kushtetues, jo më pak se një e pesta e deputetëve, duke kërkuar shfuqizimin e një ligji si të papajtueshëm me Kushtetutën. Në vendimin nr.25, datë 8.5.2012 katër gjyqtarë mbajtën qëndrimin se në këtë rast ndodhemi përballë një mosmarrëveshje kompetencash midis Kuvendit dhe Bashkisë Tiranë dhe për rrjedhojë, ky subjekt nuk legjitimohet në këtë lloj mosmarrëveshjeje. Një tjetër gjyqtar, i cili ishte për të mos e legjitimuar këtë grupim deputetësh, u bazua në të tjera argumenta. Sipas tij në

<sup>961</sup> Kelemen, Katalin, "Dissenting opinions in constitutional courts", botuar në "German Law Journal" Vol.14, Nr.8, viti 2013 fq.1351, versioni online, marrë nga faqja e internetit: <https://www.germanlawjournal.com/pdfs/Vol14-No8/14.8.19.pdf> (parë për herë të fundit me datë 5.1.2014).

<sup>962</sup> Vendimi nr.3, datë 13.2.2003 i Gjykatës Kushtetuese: *Në rrethanat kur prokuroria nuk gjeti elementet e fajësisë së kandidates për deputete apo të stafit të saj dhe, kur nga dokumentacioni i paraqitur nuk rezultojnë vërejtje nga anëtarët e komisioneve të qendrave të votimit, ishte detyrë e kërkuarit të provonte se dhënia e ndihmave ushqimore 160 familjeve të zonës ka ndikuar në cenimin e parimit të votës së lirë dhe se ky cenim ka qenë i një shkalle të tillë që ka ndikuar në dhenien e mandatit. ...Edhe pretendimet e tjera të kërkuarit që lidhen me mohimin e të drejtës të votës së zgjedhësve, për shkak të refuzimit të bërë nga gjykata për shtesat në listat e zgjedhësve ose për shkak të mosmarrjes së masave për pajisjen e zgjedhësve me certifikata të gjendjes civile nuk qëndrojnë. Ankimet për listat e zgjedhësve janë paraqitur jashtë afatit dhe me listë nga subjekti zgjedhor, në kushtet kur, sipas nenit 56 të Kodit Zgjedhor, këto ankime ka të drejtë t'i paraqesë në gjykatën e faktit çdo zgjedhës që nuk është regjistruar në listat e zgjedhësve, sipas procedurës të caktuar dhe afatit ligjor. Veç sa sipër, këto pretendime nuk u shoqëruan me asnjë provë për të krijuar bindjen e gjykatës për vërtetësinë e parregullsisë të tilla.*

<sup>963</sup> Mendimi paralel i gjyqtarit kushtetues, Sokol Sadushi, në vendimin nr.3, datë 13.2.2003 të Gjykatës Kushtetuese: *Bashkohem me shumicën vetëm për zgjidhjen e dhënë në dispozitivin e vendimit, por mendimi im ndryshon nga arsyetimi i vendimit të saj. Thelbi i mendimit ndryshe qëndron në konceptet jo të njëjta që ne kemi për përfshirjen e kësaj çështjeje në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese...Verifikimi i zgjedhjes së deputetit që parashikohet në nenin 131, shkronja "e" e Kushtetutës është një kompetencë e kësaj gjykate, por ajo duhet parë e lidhur ngushtë me konceptin e pavlefshmërisë dhe të heqjes së mandatit të deputetit. Ajo që parashikohet në Kushtetutë lidhet me pamundësinë e Gjykatës Kushtetuese, që tej rasteve të nenit 71 të shpallë pavlefshmërinë e mandatit të një deputeti të zgjedhur. Mandati i deputetit të zgjedhur nuk mund të preket në tejkalim të neneve apo dhe të koncepteve të Kushtetutës. Prandaj për këto arsye, çështja objekt shqyrtimi mbetet jashtë juridiksionit kushtetues dhe për rrjedhojë kërkesa, me këtë arsyetim, konsiderohet e rrëzuar.*

këtë rast deputetët duke mos qenë të pranishëm në votimin e projekligjit në Kuvend, pra duke e bojkotuar atë kishin humbur të drejtën për të kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese këtë ligj.

Nga të dyja këto raste rezultojnë se për të vendosur rrëzimin e kërkesës është krijuar një shumicë prej pesë gjyqtarësh, por të cilët kishin qëndrime të ndryshme për rrëzimin e saj. Në këtë lloj vendimesh, arsytimi bazë konsiderohet ai arsytim që ka shumicën relative të votave. Vetë Gjykata Kushtetuese është shprehur se arsyetimet e një gjyqtari në mendimin e tij paralel, nuk përfaqësojnë qëndrimin e shumicës duke përbërë kështu vetëm një qëndrim doktrinar të gjyqtarit përkatës.<sup>964</sup> Pra, në dy rastet tona arsyetimet që kanë marrë votat e katër gjyqtarëve. Megjithatë, duke pasur një shumicë relative vendimmarrëse, këtyre vendimeve u mungon forca ligjore e vendimeve të tjera, shërbejnë vetëm për zgjidhjen e çështjes konkrete dhe nuk mundet që të përdoret në të ardhmen, si precedentë.

Duke qëndruar në të njëjtën tematikë, rezultojnë se gjyqtari që ka pasur mendime të ndryshme nga shumica e gjyqtarëve pavarësisht konkluzionit të njëjtë del me një tjetër arsytim që është quajtur “mendim paralel”. Edhe në këtë lloj mendimi, si në mendimin në pakicë, gjyqtari kushtetues shpreh dallimet e tij në lidhje me qëndrimin që kanë mbajtur gjyqtarët e tjerë të Gjykatës Kushtetuese. Ndryshimi që ekziston në këtë rast midis “mendimit paralel” dhe “mendimit në pakicë” është që “mendimi paralel” shërben për të krijuar një shumicë në vendimmarrjen e Gjykatës, pasi në këtë rast konkluzioni midis gjyqtarëve është i njëjtë, kurse “mendimi në pakicë” nuk shërben për një qëllim të tillë.

### 5.1 Teknikat e interpretimit të Gjykatës Kushtetuese.

Për të arsyetuar në lidhje me bazueshmërinë ose jo në Kushtetutë të një kërkimi nga subjektet përkatëse, Gjykata Kushtetuese përdor disa teknika interpretimi të cilat dallojnë nga njera – tjetra.

Mënyra e parë e interpretimit është ai “literal”. Për këtë arsye Gjykata Kushtetuese bazohet në Kushtetutë. Kuptimi i gjuhës dhe i fjalëve të Kushtetutës merret shumë seriozisht nga Gjykata. Ajo rrallë interpreton gjuhën kushtetuese në një mënyrë radikale të ndryshme nga kuptimi i zakonshëm që u jepet atyre në përgjithësi.<sup>965</sup> Për të zbatuar këtë teknikë Gjykata Kushtetuese shpeshherë përdor si burim Fjalorin e Gjuhës Shqipe. Duke përdorur disa shembuj rezultojnë se Gjykata Kushtetuese e ka përdorur fjalorin për të nxjerrë kuptimin e termave “kombësi”<sup>966</sup> si edhe të “nevojës” dhe të “urgjencës”.<sup>967</sup> Por pavarësisht këtij qëndrimi, për t’i qëndruar besnik formulimeve të dispozitave kushtetuese vetë Gjykata Kushtetuese ka pranuar që

<sup>964</sup> Vendimi nr.138, datë 14.12.2012 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>965</sup> Kommers, Donald P.; Miller, Russell A.; “*The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany*”, Shtëpia Botuese “Duke University Press”, Londër 2012, fq.70 – 71.

<sup>966</sup> Vendimi nr.52, datë 1.12.2011 i Gjykatës Kushtetuese, parag.18: Në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe termi “komb” përkufizohet si “një bashkësi e qëndrueshme njerëzish e formuar historikisht në bazë të bashkësisë së gjuhës, të territorit, të jetës ekonomike dhe formimit psikik, që shfaqet në bashkësinë e kulturës”. Ndërsa termi “kombësi” përkufizohet si “bashkësi e qëndrueshme njerëzish që i paraprin kombit e që është formuar historikisht gjatë shkurtes së marrëdhënieve fisnore në bazë të bashkësisë së gjuhës, të territorit e të kulturës, e cila ka ardhur duke u zhvilluar e duke u forcuar”. “Përkatësia etnike” ose e thënë naryshe “etnia”, sipas Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe përkufizohet si “bashkësi e qëndrueshme njerëzish, e formuar historikisht në një truall të caktuar e cila ka një gjuhë dhe kulturë materiale e shpirtërore të njëjtë”.

<sup>967</sup> Vendimi nr.5, datë 5.2.2014 i Gjykatës Kushtetuese, shënimi 9: Sipas Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe, Botimet Toena, 2002, termi “nevojë” nënkupton “kusht pamundësie për të vepruar në mënyrë të ndryshme”, kurse termi “urgjencë” ka kuptimin e “nevojës shumë të ngutshme dhe të domosdoshme”.

edhe mund t'u shmanget këtyre parashikimve bazuar në funksionin që i jep neni 124 i Kushtetutës. Më konkretisht Gjykata është shprehur se:

*Nisur nga tagrat që i jep neni 124 i Kushtetutës, roli dhe funksioni i Gjykatës Kushtetuese është që nëpërmjet vendimeve të transformojë dispozitat kushtetuese nga abstrakte-metafizike, në substanciale dhe konkrete, duke i garantuar mbrojtje kushtetuese situatave juridike në të cilat ndodhen individët. Për shkak të vetë formës ekstremisht konçize që kanë dispozitat kushtetuese, nëpërmjet vendimeve, pra interpretimit që bën Gjykata, bëhet e mundur që Kushtetuta të jetë "e gjallë", që do të thotë se Gjykata i përshtatet evolucionit që bëjnë vlerat në vendin tonë, duke garantuar që vlera të reja, të cilat ndoshta nuk ishin në vëmendje të hartuesve të Kushtetutës, të marrin dinjitet, njohje dhe, mbi të gjitha, mbrojtje kushtetuese. Për vetë faktin se norma kushtetuese bëhet realitet gjatë interpretimit, pra gjatë procesit vendimmarrës të Gjykatës, e bën këtë të fundit pa diskutim burim të së drejtës, për më tepër e bën atë një burim parësor të saj, duke pasur parasysh se neni 4 i Kushtetutës parashikon se Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë.<sup>965</sup>*

Nga ky pasazh qartësisht kuptohet që Gjykata Kushtetuese mund të bazohet edhe në vlera apo parime të tjera të cilat megjithëse nuk janë përmendur shprehimisht nga Kushtetuta, kanë mundësi që të njihen dhe të njohin mbrojtje kushtetuese nëpërmjet jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese. Në këtë rast pra, Gjykata do të bazohet në parime të pashkruara të Kushtetutës, të cilat dalin në pah me evoluimin e shoqërisë.

Një tjetër teknikë interpretimi është ai "gjuhësor". Sipas kësaj teknike Gjykata Kushtetuese për të nxjerrë kuptimin e gjuhës së përdorur në Kushtetutë apo akte të tjera ligjore përdor rregullat e gramatikës së gjuhës shqipe. Përdorimi i rregullave gramatikore megjithëse shfaqet rrallë në jurisprudencën kushtetuese, rezulton të jetë përdorur nga ana e Gjykatës për të nxjerrë kuptimin e disa normave ligjore, në mënyrë që më pas të arsyetohej përsa i përket kushtetushmërisë së dispozitave të kundërshtuara. Në këtë drejtim, shembulli më konkret ka qenë, duke përdorur rregullat gramatikore, nxjerra e kuptimit të termit "leje vjetore e pagueshme"<sup>969</sup> me qëllim për të konkluduar nëse Kuvendi, nëpërmjet një ligji që kishte miratuar, kishte cënuar apo jo përfitimet e gjyqtarëve të zakonshëm në lidhje me lejet e tyre të zakonshme.

Interpretimi "historik" është një tjetër teknikë që përdoret nga Gjykata Kushtetuese. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese, shfrytëzon materiale historike si Kushtetuta të mëparshme, praktika kushtetuese etj. Për ta konkretizuar me shembuj rezultojnë se Gjykata Kushtetuese e ka përdorur këtë interpretim për të përcaktuar natyrën e ligjit për administratën gjyqësore, nëse ishte ligj që mund të votohej me shumicë të thjeshtë apo të cilësuar,<sup>970</sup> për të përcaktuar nëse Gjykata

<sup>968</sup> Vendimi nr.20, datë 1.6.2011 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>969</sup> Vendimi nr.31, datë 2.12.2009 i Gjykatës Kushtetuese: *Në vijim, Gjykata vlerëson të analizojë kuptimin gramatikor të togfjalëshit "leje vjetore e pagueshme" në funksion të qartësisimit të përmbajtjes së normës së kundërshtuar. Togfjalëshi "leje vjetore e pagueshme" është një grup emëror i formuar nga një emër (leje), nga një mbiemër i pamyjshëm (vjetore) dhe nga një mbiemër i nyjshëm (e pagueshme), i përdorur në fjali në funksionin e kundërshtuar të drejtë. Të dy mbiemrat ruajnë funksionin e tyre përcaktues të cilësive të emrit "leje" dhe janë të pavarur nga njëri-tjetri.*

<sup>970</sup> Vendimi nr.10, datë 6.3.2014 i Gjykatës Kushtetuese, parag.28: *Gjykata çmon të marrë në konsideratë dhe të vlerësojë me analogji edhe procedurën e miratimit me shumicë të cilësuar të ligjeve të ngjashme me ligjin e kundërshtuar, për nga lënda që trajtojnë.Ligji objekt shqyrtimi, ndjek konceptin dhe strukturën e ligjit për shërbimin civil, pavarësisht specifikave dhe natyrës atipike që paraqet administrata gjyqësore në raport me "nëpunësin civil",*



Kushtetuese kishte juridiksion për të kontrolluar ligjshmërinë e zgjedhjeve,<sup>971</sup> për të përcaktuar kushtetutshmërinë e dy dënimeve kryesore në K.P.,<sup>972</sup> marrëdhëniet midis Presidentit të Republikës dhe Kuvendit<sup>973</sup> si edhe midis Kuvendit dhe Prokurorisë,<sup>974</sup> etj.

Interpretimi "doktrinor" përdoret nga Gjykata Kushtetuese duke iu referuar teksteve të ndryshme juridike të shkruar nga akademikë, studiues të së drejtës apo profesionistë. Burimet doktrinare që mund të përdoren në këto raste mund të jenë të vendit apo të huaja. Në këtë drejtim rezultojnë që të jenë përdorur tekste të së drejtës penale,<sup>975</sup> komantarë të huaj,<sup>976</sup> enciklopedi të huaja,<sup>977</sup> tekste të së drejtës ndërkombëtare,<sup>978</sup> fjalorë juridikë të huaj,<sup>979</sup> etj.

Interpretimi mbi "qëllimin" ose "teleologjik" siç e përdor Gjykata Kushtetuese, ka si qëllim që të nxjerrë kuptimin e normës juridike duke u nisur nga qëllimi që ka dispozita së cilës i referohet. Për të nxjerrë këtë kuptim, shpeshherë Gjykata Kushtetuese i referohet punëve përgatitore të Komisionit Parlamentar për Hartimin e Projektkushtetutës, punime të cilat janë botuar nga OSBE në dy vëllime.<sup>980</sup>

---

*që ushtron një funksion publik klasik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore. Funksionet që kryen administrata gjyqësore, veçanërisht në shërbimin ndaj publikut, përfshihen në kuptimin e funksionit publik, sipas përcaktimit që Kushtetuta jep në nenin 107 të saj. Në këtë kuptim, Gjykata konsideron orientues edhe historikun legjislativ për shërbimin civil, i cili dëshmon qartë se ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" si dhe ligji nr. 152/2013, në preambul referojnë si bazë kushtetuese të miratimit të tyre, nenin 81, paragrafi 2, shkronja "a", të Kushtetutës, i cili parashikon vendimmarrjen parlamentare me shumicë të cilësuar.*

<sup>971</sup> Vendimi nr.53, datë 7.5.2013 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, parag.26: *Dhe në aspektin historik, ndonëse në Kodin Zgjedhor të vitit 2000 parashikohej e drejta e Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar kërkesat e subjekteve zgjedhore lidhur me kundërshtimin e rezultatit të zgjedhjeve, me ndryshimet e Kodit Zgjedhor të vitit 2003<sup>971</sup>, u vlerësua i arsyeshëm përjashtimi i këtij institucioni nga shqyrtimi i çështjeve zgjedhore (ratione materiae), si një kompetencë që shkonte tej parashikimeve kushtetuese. Përjashtim, i cili u reflektua dhe në Kodin Zgjedhor të vitit 2008, si dhe në ndryshimet e mëpasshme të tij.*

<sup>972</sup> Vendimi nr.47, datë 26.7.2012 i Gjykatës Kushtetuese, parag.14: *Gjykata, para se t'i japë përgjigje pretendimeve të gjykatës referuese, nëse dispozitat penale, objekt kontrolli kushtetues, bien ndesh me nenet 17, 18 dhe 30 të Kushtetutës, vlerëson të arsyeshme të analizojë, fillimisht, nën dritën e një këndvështrimi historik dhe krahasues, legjislativin penal shqiptar lidhur me klasifikimin e dënimeve kryesore dhe plotësuese, kriteret e zbatimit të tyre dhe qëllimet që ndjekin në frymën e parimeve të përgjithshme të Kodit Penal.*

<sup>973</sup> Vendimi nr.2, datë 18.1.2005 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>974</sup> Vendimi nr.26, datë 4.12.2006 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>975</sup> Vendimi nr.3, datë 3.11.2004 i Gjykatës Kushtetuese. Teksti që referohet: *Ismet Elezi, E drejta Penale, Pjesa e posaçme fage 71, botim i Shblu, Tiranë 2002.*

<sup>976</sup> Vendimi nr.3, datë 3.11.2004 i Gjykatës Kushtetuese. Teksti që referohet: *Komenti i Përgjithshëm 20, para.,2 të Komitetit për të Drejtat e Njeriut të P.D.C.P.; Komenti i përgjithshëm 24 të Komitetit për të Drejtat e Njeriut të P.D.C.P.*

<sup>977</sup> Vendimi nr.15, datë 15.4.2010 i Gjykatës Kushtetuese. Teksti që i referohet: *Shabtai Rossene, Treaties, Conclusion and Entry into force, në: Encyclopedia of Public International Law, Vol.7 (1995), fq.465; Günther Jaenicke, Law of the Sea, në: Encyclopedia of the Public International Law, Vol.11, Northholland-Oxford (1989), fq.174.; Christos L. Rozakis : "Continental Shelf", Encyclopedia of Public International Law, Vol.1. (1992), fq.783-792.; Shigeru Oda "Exclusive Economic Zone", në: Encyclopedia of Public International Law, Vol.2, (1995) fq.305-312.; Equity in International Law në: Encyclopedia of Public International Law Vol.2 (1995), fq.109.;*

<sup>978</sup> Vendimi nr.15, datë 15.4.2010 i Gjykatës Kushtetuese. Teksti që i referohet: *Ian Brownlie, Principles of Public International Law, Bot.7 Northholland-Oxford (2008) fq. 107.*

<sup>979</sup> Vendimi nr.25, datë 5.12.2008 i gjykatës Kushtetuese. Teksti që i referohet: *Gerard Cornu: Vocabulaire juridique, Editions PUF, Paris 2004*

Vendimi nr.15, datë 15.4.2010 i Gjykatës Kushtetuese. Teksti që i referohet: *Webster's Third International Law Dictionary Vol.1 (1993) fq.769.*

<sup>980</sup> Vendimi nr.1, datë 12.1.2011 i Gjykatës Kushtetuese: *Nga shqyrtimi i debateve të Komisionit Parlamentar për hartimin e Kushtetutës rezultojnë se ekzistonte ideja që një kategori ligjesh, për shkak të rëndësisë së tyre, të*



Interpretimi “krahasimor”, është një teknikë shumë e përdorur nga Gjykata Kushtetuese. Në bazë të këtij interpretimi Gjykata Kushtetuese përdor materiale ligjore apo praktika gjyqësore të huaja të cilat e ndihmojnë atë në krijimin e një ideje më të qartë në lidhje me çështjen dhe për rrjedhojë në lidhje me vendimmarrjen e saj. Materialet ligjore për referim mund të jenë kombëtare<sup>981</sup> ose të huaja.<sup>982</sup> Praktika gjyqësore, ose jurisprudenca e huaj që përdoret mund të jetë e gjykatave ndërkombëtare, nga ku dallohet përdorimi i jurisprudencës së GJEDNJ-së e cila ka rolin parësor në referime. Po kështu nga Gjykata jonë Kushtetuese janë përdorur edhe vendimet e GJED, të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, si edhe të arbitrazheve ndërkombëtare. Një tjetër formë e përdorimit të jurisprudencës së huaj është edhe përdorimi i vendimeve të gjykatave kushtetuese të huaja. Gjykata Kushtetuese ka përdorur si material krahasimor vendime të gjykatave kushtetuese të Çekisë, Polonisë, Sllovenisë, Lituanisë, por ato që referohen më shumë janë Gjykata Kushtetuese Italiane dhe veçanërisht Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane. Ndaj këtyre dy gjykatave, Gjykata Kushtetuese influencohet më shumë. Madje ndikimi i saj sidomos nga e drejta kushtetuese gjermane, vihet në pah nga referimi më i fundit në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të Landit të Brandenburgut.<sup>983</sup>

Përdorimin e këtyre burimeve Gjykata Kushtetuese e ka konsideruar si një funksion shtytës – evolutiv i cili shpesh është rrjedhojë e vlerës që kanë vendimet e GJEDNJ-së, dhe faktit se Gjykata mund të përdorë në mbështetje të arsytetimeve të veta qëndrimet që kanë mbajtur gjykatat homologe evropiane.

Përdorimi i interpretimit krahasimor duhet që të përdoret me kujdes. Kjo pasi sistemet juridike kushtetuese pavarësisht afërsive dhe ngjashmërive në parime që kanë, kanë edhe dallime midis tyre. Për këtë arsye përdorimi i tyre mund të jetë i dëshirueshëm vetëm në ato raste kur ka ngjashmëri të mjaftueshme midis parimeve kushtetuese dhe situatave në vendin tonë dhe asaj të shqyrtuar nga gjykata kushtetuese e huaj. Përdorimi i kësaj metode interpretimi mund të bëhet vetëm në raste kur njihet mirë si baza kushtetuese e huaj ashtu edhe jurisprudenca kushtetuese e atij vendit. Një përdorim jo i plotë mund të sjellë që Gjykata Kushtetuese të marrë një vendim të “gabuar”. Për ta ilustruar më saktë këtë situatë po i referohemi një vendimmarrje të vetë Gjykatës Kushtetuese e cila në vendimin e saj nr.5, datë 5.2.2014, ndër të tjera i është referuar gjerësisht rasteve spanjolle dhe italiane për të konkluduar që në ligjet që parashikohen nga neni 81 pika 2 e Kushtetutës, nuk mundet që të ndërhyhet më akt normativ me fuqinë e ligjit. Ndër argumentave që ka përdorur janë edhe referimet në kushtetuta spanjolle dhe italiane. Më konkretisht në shënimin nr.4 Gjykata Kushtetuese shprehet se:

---

*miratoheshin nga Kuvendi me shumicë të cilësuar, së pari për t'i bërë ato sa më të qëndrueshme dhe, së dyti, për të shmangur mundësinë që forca politike, që do të kishte shumicën, të cenonte parime themelore për funksionimin e një shoqërie demokratike (Shih “Debati Kushtetues I” fq. 298 e në vijim).*

<sup>981</sup> Vendimi nr.10, datë 6.3.2014 i Gjykatës Kushtetuese, par.28: *Gjykata çmon të marrë në konsideratë dhe të vlerësojë me analogji edhe procedurën e miratimit me shumicë të cilësuar të ligjeve të ngjashme me ligjin e kundërshtuar, për nga lënda që trajtojnë. Ligji objekt shqyrtimi, ndjek konceptin dhe strukturën e ligjit për shërbimin civil, pavarësisht specifikave dhe natyrës atipike që paraqet administrata gjyqësore në raport me “nëpunësin civil”, që ushtron një funksion publik klasik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore. Funksionet që kryen administrata gjyqësore, veçanërisht në shërbimin ndaj publikut, përfshihen në kuptimin e funksionit publik, sipas përcaktimit që Kushtetuta jep në nenin 107 të saj.*

<sup>982</sup> Vendimi nr.19, datë 1.6.2011 i Gjykatës Kushtetuese: *Duke qenë se subjektet e interesuara kanë pretenduar se konvertimi i dënimit me gjobë, në dënim me burgim, është një praktikë e parashikuar nga legjislacionet e shumë vendeve evropiane, përfshirë dhe atë të Gjermanisë, Gjykata e sheh të arsyeshme të analizojë në mënyrë të përmbledhur përmbajtjen e dispozitave të disa prej këtyre vendeve, duke i krahasuar me dispozitat objekt shqyrtimi.*

<sup>983</sup> Vendimi nr. 19, datë 15.4.2015 i Gjykatës Kushtetuese. Në paragrafin 61, ndër të tjera i referohet vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Landit të Brandenburgut VfGBbg 95/03, 18 dhjetor 2003.

*Neni 77 i Kushtetutës Italiane parashikon se: "Qeveria nuk mund, pa delegimin e Dhomave, të nxjerrë dekrete që kanë vlerën e ligjit të zakonshëm. Kur në raste të jashtëzakonshme nevojë dhe urgjence, Qeveria, nën përgjegjësinë e vet, nxjerr akte të përkohshme që kanë fuqinë e ligjit, duhet po atë ditë t'ua paraqesë për t'i kthyer në ligj Dhomave, të cilat, edhe po të jenë të shpërndara, thirren enkas dhe mblidhen brenda pesë ditëve. Dekretet humbasin fuqinë që nga fillimi, në rast se nuk kthehen në ligj brenda 60 ditëve që nga botimi i tyre. Megjithatë, Dhomat mund të rregullojnë me ligj marrëdhëniet juridike të lindura mbi bazën e dekreteve të pakthyera në ligj." Neni 72, paragrafi 4 përcakton se: "Procedura normale e shqyrtimit dhe e miratimit të drejtpërdrejtë nga ana e Parlamentit vendoset gjithmonë për projektligjet në fushën kushtetuese dhe zgjedhore dhe për ato të delegimit ligjvënës, të autorizimit për ratifikim traktatesh ndërkombëtare, të miratimit të buxheteve dhe të raporteve përfundimtare." Ligji nr. 400, datë 23.08.1988 "Disciplina dell'attività di Governo e ordinamento della Presidenza del Consiglio dei Ministri" në nenin 15/2/b parashikon se: "Qeveria nuk mundet, përmes dekretligjit, të ndërhyjë në çështjet e treguara në nenin 72, paragrafi 4 i Kushtetutës."*

Ky referim në Kushtetutën dhe materiale të tjera ligjore të Italisë, u bë pa pasur në konsideratë jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese Italiane e cila është shprehur se:

*Për sa i përket dyshimit për legjitimitetin kushtetues të dekret-ligjit nr.79 të vitit 1995 i ngritur në lidhje me fushën penale që përbën edhe objektin, nuk mundet që të afirmohet, parimisht, që dekret-ligjet nuk mundet që të prekin çështje dhe sanksione penale. Nëse do të ishte kështu, do të përfshihej një kufi në përmbajtjen e dekret-ligjeve që nuk parashikohet nga neni 77 i Kushtetutës dhe që nuk mundet që të deduktohet nga parimi i rezervës ligjore në fushën penale (neni 25 i Kushtetutës) duke qenë se një rezervë e tillë duhet që të respektohet edhe nga aktet që kanë fuqinë e ligjit (vendimi nr.184 i vitit 1974) por duke ruajtur rigorozisht parakushtet kushtetuese të dhëna prej saj. Rreziku i marrjes Parlamentit të kompetencave dhe përgjegjësiive të zgjedhjes në fushën penale, që gjyqtarët referues mendojnë se mundet që të vijë si pasojë e përdorimit të dekret-ligjeve, si akte të rregullimit në fushën penale mjaft të pasigurta dhe jo të lidhura me vullnetin e legjislatorit nuk ekziston megjithatë për dekret-ligjin nr.79 të vitit 1995 që është konvertuar në ligj.<sup>984</sup>*

Pra, rezulton qartësisht që sipas Gjykatës Kushtetuese Italiane nuk ka asnjë kufizim për të ndërhyrë me akte normative me fuqinë e ligjit (dekret-ligje siç emërtohen në Itali). Madje në rastin konkret ndërhyrja ishte bërë në Kodin Penal Italian, ligj i cili është edhe më i ndjeshëm për sa i përket të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Ndërsa për sa i përket rastit spanjoll Gjykata Kushtetuese në shënim 5 të saj shprehet:

*Neni 86 i Kushtetutës spanjolle përcakton se "1. Në raste të jashtëzakonshme dhe urgjente nevojë, Qeveria mund të nxjerrë dispozita legjislative provizore, që marrin formën e dekretligjeve (decreto – ley) dhe që nuk mund të ndërhyjnë/ influencojnë mbi*

<sup>984</sup> Vendimi Nr. 330, datë 18-29 korrik 1996 i Gjykatës Kushtetuese Italiane, marrë nga faqja e saj zyrtare [www.cortecostituzionale.it](http://www.cortecostituzionale.it).

*rendin juridik ose mbi institucionet themelore të shtetit, mbi të drejtat, detyrimet dhe liritë e individit sipas Titullit I, mbi regjimin i Bashkësive autonome dhe mbi të drejtën e zgjedhjeve në përgjithësi. 2. Dekretligjet duhet të paraqiten menjëherë për diskutim dhe votim në Kongresin e deputetëve, i cili me atë rast thirret enkas nëse nuk është i mbledhur, brenda 30 ditëve nga botimi i tyre. Kongresi duhet të shprehet në mënyrë eksplicite, brenda këtij afati, për miratimin ose shfuqizimin e tyre, sipas një procedure të veçantë dhe të përshtetshme, të përcaktuar nga rregullorja."*

Edhe në rastin spanjoll, referuar doktrinës<sup>985</sup>, rezulton se pavarësisht parashikimit të mësipërm të dispozitës kushtetuese, Gjykata Kushtetuese spanjolle ka lejuar që me akte të tilla të ndërhyhet edhe në fushat të cilat në dukje ka ndalim. Madje edhe vetë Komisioni Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias),<sup>986</sup> duke analizuar mënyrën e përdorimit të akteve normative më fuqinë e ligjit në Rumani, ka mbajtur qëndrimin që këto akte mund të përdoren kundrejt çdo ligji mjafton që kur të miratohet nga organi ligjvënës të bëhet me të njëjtën shumicë që kërkohet për miratimin e ligjit nga Kushtetuta.

Është e vërtetë që materialet e huaja krahasimore nuk janë detyruese për Gjykatën Kushtetuese. Kjo është edhe arsye përse termin e "gabuar" e vendos në thonjëza. Por në rast se Gjykata Kushtetuese nuk donte që të mbante qëndrimin e këtyre vendeve dhe të dilte me konkluzione të tjera (siç edhe bëri) atëherë ajo nuk duhej që t'i përdorte materialet e huaja krahasimore, si mbështetje për vendimmarrjen e saj.

## **5.2 Format dhe emërtimet e vendimeve që merr Gjykata Kushtetuese.**

Në varësi të objektit të kërkesës dhe të llojit të gjykimit, Gjykata Kushtetuese merr disa vendime të cilat dallojnë midis tyre për nga forma dhe efektet që ato japin. Kështu kemi:

**a) vendime pranimi.** Këto vendime zbatohen ndaj pjesës më të madhe të gjykimeve që zhvillon Gjykata Kushtetuese. Pranimi mund të jetë i plotë ose i pjesshëm. Në rast kur pranimi është i plotë atëherë kërkesa është pranuar për të gjitha kërkimet e saj, ndërsa kur është i pjesshëm vetëm për një pjesë të tyre. Nëpërmjet këtij lloji vendimi pranohen kërkesa për shfuqizimin e një amendamenti kushtetues, ligji, akti normativ, shfuqizimin e një vendimi gjyqësor etj. Vendim pranimi konsiderohet edhe kur Gjykata Kushtetuese pranon kërkesat për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese shfuqizon aktin i cili ka sjellë lindjen e kësaj mosmarrëveshjeje, pavarësisht nëse është me natyrë normative apo individuale. Por ky vendim ka edhe një tjetër pjesë e cila është me natyrë deklarative dhe që ka të bëjë me deklarimin se kujt organi i përket kompetenca në mosmarrëveshje.

Një vendim pranimi disi i veçantë për nga natyra është ai që ka të bëjë me shqyrtimin

<sup>985</sup> Lopez, Enrique Guillen, "Judicial Review in Spain: The Constitutional Court", botuar në "Loyola of Los Angeles Law Review", Vol.41, 2008, fq.556, versioni online, marrë nga adresa e internetit: <http://digitalcommons.lmu.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=2616&context=llr>. (parë për herë të fundit me datë 10.3.2014)

<sup>986</sup> Opinioni i Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) CDL-AD (2012)026 "Opinion on the compatibility with constitutional principles and the rule of law of actions taken by the government and the parliament of Romania in respect of other state institutions and on the government emergency ordinance on amendment to the law no.47/1992 regarding the organization and functioning of the Constitutional Court and on the government emergency ordinance on amending and completing the law no.2/2000 regarding the organization of a referendum of Romania", parag.14.



*aposteriori* i kërkesave të Këshillit të Ministrave për kontrollin e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara përpara hyrjes në fuqi të Kushtetutës. Pavarësisht se Gjykata Kushtetuese kontrollon kushtetutshmërinë e marrëveshjes ndërkombëtare ajo nuk mundet që të shfuqizojë atë. Marrëveshja ndërkombëtare është një akt i jashtëm dhe nuk i përket të drejtës sonë të brendshme. Për rrjedhojë Gjykata Kushtetuese në rast se pranon kërkesën nuk mundet që ta shfuqizojë atë. Kjo është arsyeja që LGJK parashikon se në këtë rast Gjykata Kushtetuese shfuqizon vetëm aktin e ratifikimit të kësaj marrëveshjeje.<sup>987</sup> Pasoja e këtij veprimi është që marrëveshja ndërkombëtare bëhet e paefektshme në sistemin e brendshëm juridik me hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.<sup>988</sup> Në këtë rast, marrëveshja nuk mundet që të ratifikohet më. Ajo mund të ndryshohet mbi bazën e rinegociimit të saj ose të ratifikohet përsëri por duke u ushtruar nga vendi ynë, rezerva përkatëse, nëse është e mundur. Një tjetër mundësi është edhe amendimi i vetë Kushtetutës.

Në rastin kur objekt gjykimi është kontrolli i kushtetutshmërisë së partive apo organizatave politike nëse kërkesa gjendet e bazuar, Gjykata Kushtetuese, vendos sipas rastit, shfuqizimin e aktit të krijimit, ndalimin e veprimitarisë dhe çregjistrimin e partisë/organizatës politike.<sup>989</sup> Gjykata mund të vendosë shfuqizimin e aktit të krijimit nëse partia/organizata politike sapo është krijuar dhe ende nuk ka filluar një aktivitet të mirëfilltë. Ajo vendos për shfuqizimin e aktit të krijimit vetëm nëse antikushtetueshmëria e saj rezulton qartë në aktet e krijimit të saj depozituar pranë gjykatës së zakonshme (statuti, programi politik etj), e cila megjithëse nuk duhet ta kishte pranuar regjistrimin e saj, në mënyrë antikushtetuese dhe të gabuar e ka regjistruar atë. Në rastin tjetër Gjykata, mund të vendosë ndalimin e veprimitarisë së partisë/organizatës politike, kur ky grupim ka zhvilluar një aktivitet antikushtetues. Është e kuptueshme që njëkohësisht nëse kemi një vendimmarrje të tillë, Gjykata duhet të urdhërojë edhe ç'rregjistrimin e partisë/organizatës politike. Pavarësisht se dispozita në këtë rast përdor termin "ose", mendoj se në këtë rast Gjykata mund dhe duhet të disponojë për të dyja këto urdhërime.

Rasti kur mund të vendoset vetëm ç'rregjistrimi i partisë politike, mund të jetë rasti kur partia/organizata ka ushtruar veprimtari antikushtetuese, por më vonë e ka ndërprerë atë dhe praktikisht nuk funksionon më si grupim. Në këtë rast Gjykata mund të kufizohet edhe në duke disponuar vetëm me ç'rregjistrimin e saj.

Në këto dy rastet e fundit, parashikuar nga neni 60, pika 2 e LGJK-së, antikushtetueshmëria e partisë politike, nuk rezulton nga aktet e krijimit, por nga veprimtaria e saj në praktikë. Në rast se antikushtetueshmëria e partisë/organizatës rezulton si nga aktet e krijimit, ashtu edhe nga veprimtaria e saj, atëherë Gjykata mund të urdhërojë njëkohësisht edhe shfuqizimin e aktit të krijimit edhe ndalimin e veprimitarisë së saj.

**b) Vendime rrëzimi.** Janë vendime nëpërmjet të cilave vendoset rrëzimi i kërkesës pasi pretendimet e ngritura në të nuk janë të bazuara. Në këtë rast akti juridik apo veprimi që kundërshtohet mbetet në fuqi.

Vendimi i rrëzimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave kanë si veçanti faktin se në të përcaktohet se subjektit kërkues nuk i është cënuar kompetenca, pra do të thotë që organi tjetër ka vepruar brenda kompetencave të tij kushtetuese dhe ky fakt duhet pasqyruar në dispozitivin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Vendimi i Gjykatës në këtë rast përcakton

<sup>987</sup> LGJK, neni 53, pika 2.

<sup>988</sup> Wagner, Britta, "Remedies and effects of decisions in constitutional complaint procedure", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15", botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998, fq. 183.

<sup>989</sup> Neni 60 i LGJK.



kompetencën që ka qenë pjesë e mosmarrëveshjes dhe ia cakton njërës nga palët në proces, pa zënë vendin e legjislativit.<sup>990</sup> Në thelb në këtë rast ky vendim rrëzimi ka edhe natyrë deklarative.

**c) Vendim refuzimi.** Ky vendim parashikohet nga neni 74 i LGJK.<sup>991</sup> Nga analiza e dispozitës rezultojnë se ajo parashikon dy situata kur mund të vendoset refuzimi i kërkesës. Situata e parë është kur votat ndahen në mënyrë të barabartë. Në këtë situatë, Gjykata nuk gjykon me trupë gjyqësore të plotë por gjykon me trupë gjyqësore të cilët në total përbëjnë një numër çift, pra me 8 ose me 6 gjyqtarë. Në këtë rast votat mund të ndahen katër me katër ose tre me tre. Në këtë rast Gjykata nuk arrin dot shumicën prej pesë anëtarësh që kërkon neni 133, pika 2 e Kushtetutës. Në rastin e dytë, pavarësisht përbërjes së trupës së Gjykatës Kushtetuese, rezultojnë se gjyqtarët në votimin e tyre ndahen në qëndrime të ndryshme (më shumë se dy) dhe për rrjedhojë asnjëri prej këtyre qëndrimeve nuk merr dot pesë votat e nevojshme të kërkuara nga Kushtetuta. Edhe në këtë rast përsëri vendoset refuzimi i kërkesës.

Pasojë juridike e refuzimit është që kërkesa nuk konsiderohet e panuar apo e rrëzuar dhe subjekti kërkuar ka të drejtë që ta riparqesë kërkesën në raste kur mendon se krijohet një shumicë e re. Ky lloj rasti është kur kemi përtëritjen pjesore të Gjykatës Kushtetuese. Me ardhjen e gjyqtarëve të rinj Gjykata Kushtetuese mund të rimarrë çështjen nëse ripërsëritet kërkesa në shqyrtim. Nga analiza e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese rezultojnë që kjo ka ndodhur vetëm njëherë.<sup>992</sup>

Arsyeja e një parashikimi të tillë ligjor është e diskutueshme dhe mund të hipotetizojmë shumë argumenta. Në rradhë të parë neni 133, pika 2 e Kushtetutës parashikon në mënyrë taksative se Gjykata Kushtetuese vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve të saj. Në këtë kuptim nuk mundet që të aplikoheshin zgjidhje të huazuara nga legjislacione të huaja që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e gjykatave të tjera kushtetuese. Rregulli më i përdorshëm në këtë rast është që nëse kemi barazi votash, atëherë vendos votat e kryetarit, por tek ne, duke qenë se kërkohet shumica absolute një shembull i tillë nuk mundet që të gjejë zbatim. Nga ana tjetër ligjvënësi duke pasur në konsideratë që përsëri shumica e Gjykatës nuk ka votuar kundër kërkesës, e ka konsideruar të vështirë që ta konsiderojë kërkesën e rrëzuar. Një tjetër argument në këtë rast është edhe fakti për të vendosur barazi midis gjyqtarëve kushtetues dhe jo dhënies përparësi një grupi të caktuar. Një tjetër arsye që mund të ketë ndikuar në miratimin e këtij parashikimi ligjor besoj se ka qenë edhe vetë jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese e cila u krijua në vitin 1992, deri në vitin 1998 nuk ka pasur një ligj të saj in organik. Për këtë arsye për situata të veçanta që mund të shfaqeshin përpara saj Gjykata Kushtetuese aplikonte zgjidhje të ndryshme. Në disa raste Gjykata Kushtetuese u gjend përpara një situatë të tillë dhe ka arsyetuar si më poshtë:

<sup>990</sup> Vendimi nr.94-1-CC, datë 16.12.1994 i Gjykatës Kushtetuese të Andorës, marrë nga CODICES e Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), me numër referimi AND-2001-2-001.

<sup>991</sup> LGJK, neni 74: *Kur gjatë votimit votat ndahen në mënyrë të barabartë ose në atë mënyrë që asnjë përfundim i çështjes nuk votohet nga shumica e kërkuar, Gjykata Kushtetuese vendos refuzimin e kërkesës. Refuzimi nuk përbën pengesë që kërkuar të riparqesë kërkesën në rast se krijohet kushte për formimin e shumicës së kërkuar.*

<sup>992</sup> Vendimi nr.8, datë 25.3.2003 i Gjykatës Kushtetuese: *Me vendimin nr.221, datë 4.11.2002 Gjykata Kushtetuese ka refuzuar kërkesën e paraqitur nga Xh.B. dhe M.P., për shkak se përbërja e saj nuk ka qenë e plotë dhe mendimet e gjyqtarëve janë ndarë në mënyrë të tillë që nuk arrihet të votohet për zgjidhjen përfundimisht të çështjes. Me krijimin e kushteve të favorshme për formimin e shumicës së kërkuar, Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", rifilloi shqyrtimin e kësaj çështjeje.*

*Përsa i përket kërimit për përmbajtjen e nenit 4 që rregullon përbërjen e komisionit, Gjykata nuk shprehet në themel, për shkak se nuk u formua shumica e kërkuar sipas nenit 26, paragrafi i parë, të ligjit kushtetues "Për organizimin e drejtësisë dhe Gjykatën Kushtetuese".<sup>993</sup>*

Gjykata ruajti në thelb të njëjtin qëndrim edhe në një rast tjetër duke u shprehur se:

*Gjatë diskutimit të çështjes u ravijëzuan në Gjykatë dy qëndrime: Sipas njëres pikëpamje janë të mbështetura ligjërisht pretendimet e palës kërkuese për shpalljen të papajtueshëm me ligjin kushtetues të vendimeve nr.6019, datë 24.11.1994 të gjykatës së rrethit Tiranë; nr.167, datë 18.01.1995 të Gjykatës së Apelit; nr.310, datë 22.03.1995 dhe nr.928, datë 04.07.1996 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit, ndërsa sipas pikëpamjes tjetër këto vendime janë të bazuara në akte ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe për pasojë, nuk vijnë në kundërshtim me ligjin kushtetues.*

*Në votim, teza e parë për shpalljen të papajtueshëm me kushtetutën vendimet e përmendura më lart nuk arriti shumicën e kërkuar nga neni 26 paragrafi i parë i Ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", mbasi në favor të saj kanë votuar vetëm katër anëtarë të kësaj Gjykate.<sup>994</sup>*

Në të dyja këto raste Gjykata Kushtetuese, vendosi rrëzimin e kërkesës, megjithëse nga arsyetimi del që këtë vendim nuk e ka marrë sepse në themel e ka konsideruar si të pabazuar. Ndoshta është kjo arsyeja që Kuvendi në hartimin e LGJK (por edhe të ligjit pararendës) ka ndryshuar terminologjinë duke e konsideruar si "refuzim" dhe i ka dhënë të drejtë palëve që ta riparaqesin edhe një herë kërkesën kur në Gjykatë krijohen shumica të tjera.

Një tjetër hipoteze e kësaj zgjedhjeje ndoshta lidhet edhe me përvojat e vendeve të tjera. Kështu rezultoi se Gjykata Kushtetuese Bullgare në fillimet e saj ka përzgjedhur një formulë deri diku të ngjashme kur nuk arrihej shumica e cilësuar për marrjen e vendimeve.<sup>995</sup>

Gjykata ka tentuar që të shpëtojë nga kjo lloj vendimmarrjeje në disa raste. Kështu në një mendim pakice disa gjyqtarë, u shprehen:

*Pakica vlerëson të mos shprehet në lidhje me shfuqizimin e shprehjes "më të ulët", në nenin 42/1 të ligjit 9877/2008, duke pasur parasysh se ky pretendim është refuzuar nga Gjykata në përputhje me nenin 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" (ligji 8577/2000). Pavarësisht nga ky qëndrim i mbajtur nga Gjykata, pakica është e mendimit se, në bazë të nenit 73/3 të ligjit 8577/2000, Gjykata mund të riçelto seancën në mënyrë që të mundësohej një vendimmarrje e saj në këtë drejtim.<sup>996</sup>*

Pakica në këtë rast i referohet situatës kur për arsye të ndryshme shumica nuk mund të formohet dhe ekziston mundësia për përfshirjen në këtë gjykim të gjyqtarëve të tjerë, që më parë

<sup>993</sup> Vendimi nr.1, datë 31.1.1996 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>994</sup> Vendimi nr.46, datë 26.11.1996 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>995</sup> Schwartz, Herman, "The struggle for constitutional justice in post-communist Europe", Shtëpia Botuese "The University of Chicago Press", Chicago 2000, fq.192.

<sup>996</sup> Vendimi nr.5, datë 16.2.2012 i Gjykatës Kushtetuese, mendimi në pakicë, parag.13.

nuk kanë marrë pjesë në të, seanca riçelet dhe shqyrtimi i çështjes fillon nga e para. Personalisht jam i mendimit se asgjë nuk e pengon Gjykatën që të zbatojë këtë parashikim në rastin kur për shkak të rotacionit, Gjykata plotësohet me gjyqtarë të rinj. Megjithatë zbatimi i kësaj mundësie deri më sot nuk është pranuar nga Gjykata Kushtetuese. Në disa raste Gjykata Kushtetuese ka përdorur një tjetër teknikë. Kështu ndërkohë që ka pasur një ndarje votash midis gjyqtarëve për një pretendim të kërkuarit, ajo ka vendosur pranimin e saj për pretendimet e tjera.<sup>997</sup> Në këtë mënyrë çështja kthehet për rigjykim dhe për pasojë individit nuk mundet që të ankojë në GJEDNJ. Por kjo zgjidhje është e rallë dhe shpeshherë nuk ka qenë i mundur zbatimi i saj.

Kjo lloj vendimmarrje në çështjen “Marini kundër Shqipërisë”<sup>998</sup> është konsideruar si jo në përputhje me KEDNJ për shkak të cënimit të parimit të sigurisë juridike. GJEDNJ arsyeton në këtë rast se një palë i drejtohet një gjykate me qëllim që të marrë një vendim, një zgjidhje, në lidhje me konfliktin e tij, por kurrësi të mbesë pa përgjigje. Kjo vendimmarrje e GJEDNJ e ka vënë në pozicion të vështirë Gjykatën Kushtetuese për raste të tjera të ngjashme, për shkak se dispozita ligjore është ende në fuqi, dhe se ligji parashikon barazinë e votave midis gjykatësve kushtetues dhe nuk i njeh ndonjë vlerë të veçantë votës së Kryetarit të Gjykatës apo të ndonjë gjyqtari tjetër.

Vetë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese herë pas herë ngrejnë shqetësime të tilla, por nga ana e ligjvënësit deri më sot nuk ka pasur asnjë reagim. Për këtë arsye, në mungesë të reagimit të Kuvendit për të amenduar këtë dispozitë të LGJK, vetë Gjykata Kushtetuese duke zbatuar teknikën e kontrollit incidental,<sup>999</sup> duhet që të vendosë shfuqizimin e kësaj dispozite dhe në përfundim nëse nuk arrihet shumica e kërkuar rrëzimin e kërkesës. Duhet vendosur rrëzimi i kërkesës, pasi neni 133, pika 2 e Kushtetues parashikon faktin se kërkesa quhet e pranuar kur kanë votuar për të shumica e të gjithë gjyqtarëve, pra minimalisht pesë gjyqtarë. Me një interpretim *a contrario*, në rast se kjo shumicë nuk arrihet, atëherë Gjykata duhet të vendosë rrëzimin e kërkesës.

**ç) Vendimet e interpretimit pajtues.** Në këto vendime Gjykata Kushtetuese bën një interpretim të normave të kundërshtuara në mënyrë të tillë që të jenë në pajtim me normat kushtetuese. Ky interpretim është i mundur kur një ligj apo dispozitë ligjore mund të interpretohet në më shumë se një mënyrë, njëra nga të cilat është në pajtim me Kushtetutën. Kjo metodë kërkon efektet kushtetuese të rezultateve të ndryshme dhe përzgjedh rezultatit që është në pajtim me vlerat kushtetuese, duke marrë parasysh këtu të drejtat themelore të individëve.<sup>1000</sup>

Nga ana formale vendimet e këtij lloji mund të përfundojnë me pranimin e kërkesës ose rrëzimin e kërkesës. Pranimi i kërkesës kur jemi përpara një vendimi ku është zbatuar teknika e interpretimit pajtues është një situatë e rallë dhe konsiston në shfuqizimin teorik të dispozitave të kundërshtuara por në thelb duke mos e prekur përmbajtjen e normës. Rezulton se Gjykata jonë Kushtetuese e ka zbatuar një teknikë të tillë në të paktën një rast. Kështu në dispozitivin e vendimit nr.19, datë 3.5.2007 Gjykata Kushtetuese është shprehur:

*Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të nenit 1/1, nenit 4, nenit 7/2, nenit 9, nenit 10/1, 2 dhe nenit 20 të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të*

<sup>997</sup> Vendimi nr.27, datë 9.5.2012 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>998</sup> GJEDNJ, Dhoma e Katërt, ankimi nr. 3738/02, çështja “Marini kundër Shqipërisë”, datë 18.12.2007, parag.122.

<sup>999</sup> Për këtë mundësi, shih në Kreun II, pjesën 3.4 të këtij punimi.

<sup>1000</sup> Vendimet nr.29, datë 31.5.2010, nr.30, datë 17.6.2010 dhe nr.33, datë 24.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese.



*institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, vetëm për sa i përket institucioneve të pavarura kushtetuese.*

Duke e analizuar këtë vendim në tërësi, dhe ligjin që ishte objekt gjykimi rezulton se dispozitat përkatëse të cilat u “shfuqizuan” nga Gjykata Kushtetuese, nuk patën asnjë ndryshim në mënyrën e formulimit dhe të përmbajtjes së tyre. Vetëm se bazuar në këtë vendim institucionet shtetërore nuk mundet që të shtrijnë efektet e zbatimit të këtij ligji edhe mbi institucionet kushtetuese.

Vendimi i rrëzimit, kur Gjykata ka përdorur teknikën e interpretimit pajtues, është më i zakonshëm në praktikë. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese mbasi jep mënyrën se si duhet interpretuar dhe kuptuar normat juridike që të jenë në përputhje me Kushtetutën vendos rrëzimin e kërkesës. Në këtë rast ky vendim rrëzimi është i ndryshëm nga vendimi i rrëzimit tradicional që merr Gjykata, pasi në këtë rast vendimi ka efekte *erga omnes*. Pra, i shtrin efektet e tij mbi të gjitha subjektet e prekura nga normat juridike, të cilat duhet ta zbatojnë atë sikundër e ka interpretuar Gjykata Kushtetuese në pjesën arsyetuese të vendimit të saj.<sup>1001</sup> Zbatimi i kësaj teknike bëhet me qëllim shpëtimin e ligjit nga shfuqizimi i tij dhe tregon edhe vetëpërmbajtje gjyqësore. Normalisht që një mundësi e tillë zbut edhe pozicionin e Gjykatës ndaj institucioneve të tjera, aktet e të cilave janë bërë objekt gjykimi.

**d) Vendime konstatauese.** Vendimet konstatauese merren nga Gjykata në një sërë çështjes. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese nuk vendos për shfuqizimin e një akti por thjesht konstaton një situatë faktike e cila është në kundërshtim me parashikimet kushtetuese. Një tjetër situatë lidhet me dy lloje të veçanta gjykimesh për sa i përket kërkesave për proces të parregullt ligjor. Në thelb Gjykata Kushtetuese kur një vendim gjyqësor nuk është ekzekutuar brenda nja afati të arsyeshëm ose një gjykim nuk ka përfunduar brenda një afati të arsyeshëm vendos konstatimin e shkeljes së të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Në çdo rast i takon institucioneve administrative apo gjyqësore që të veprojnë në përputhje me pjesën arsyetuese të vendimit të Gjykatës. Raste të tjera janë kur konstatohet papajtueshmëria në ushtrimin e funksioneve të Presidentit dhe të deputetëve.

**dh) Vendimet deklarative.** Vendimet deklarative merren në disa raste. Rasti i parë është vendimi që Gjykata Kushtetuese merr kur bën interpretimin përfundimtar të normave Kushtetuese. Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese për këtë lloj gjykimi ka natyrë deklarative. Si rregull dispozitivi i vendimit në këtë rast përmban një formulë përkufizuese e cila jep kuptimin e normës kushtetuese për të cilin ishte kërkuar interpretimi.

Në këtë rast ky vendim nuk shfuqizon asnjë akt tjetër, por mund të shërbejë si bazë për një vendimmarrje tjetër të Gjykatës kur ajo shqyrton një akt tjetër të organeve kushtetuese me natyrë normative apo individuale. Kështu ndërsa me vendimin nr.75, datë 19.4.2002 Gjykata Kushtetuese dha kuptimin e normave kushtetuese për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm dhe procedurave që duhet të ndiqen për këtë qëllim, me vendimin nr.76, datë 25.4.2002, bazuar

<sup>1001</sup> Vendimi nr.33, datë 24.6.2010 i Gjykatës Kushtetuese: *Gjykata, bazuar në këtë interpretim pajtues, arrin në përfundimin se neni 29 i ligjit 10142, datë 15.05.2009 është i pajtueshëm me Kushtetutën, me kusht që dispozitat e tij të interpretohen si më sipër. Asnjë interpretim tjetër i këtyre dispozitave nuk është i lejueshëm nga pikëpamja kushtetuese dhe se mbrojtja e të drejtave të situara nuk mund të arrihet në rast se dispozitave të kundërshtuara u jepet një kuptim tjetër. Duke u nisur nga interpretimi i mësipërm, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kjo dispozitë nuk cenon parimin e sigurisë juridike.*



në vendimin e saj të mëparshëm shfuqizoi vendimin e Kuvendit dhe dekretin e Presidentit të Republikës për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm.<sup>1002</sup>

Por që vendimi interpretues i Gjykatës Kushtetuese të përdoret në gjykime të tjera kushtetuese është e nevojshme që të plotësohen edhe kushtet e tjera procedurale që kanë të bëjnë me këto gjykime, si legjitimiteti, afati, etj. Kështu edhe nëse do të kishim një vendim interpretues në favor të një subjekti, por ka kaluar afati 3 vjeçar për të kundërshtuar ligjin në Gjykatën Kushtetuese, atëherë është e kuptueshme që një gjykim i tillë nuk mundet që të zhvillohet.

Duke marrë parasysh situatat që mund të krijohen, na duket si më i drejtë një rast i shfaqur në praktikë ku subjekti kërkues, përveç interpretimit përfundimtar të normave kushtetuese kërkoi edhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave midis pushtetit qendror dhe atij vendor.<sup>1003</sup> Në këtë rast, bashkimi i këtyre dy gjykimeve përbën ekonomi gjyqësore dhe tregon se Gjykata Kushtetuese nuk ka asnjë pengesë që të bëjë interpretimin përfundimtar të Kushtetutës edhe në rastin e një nga gjykimet që parashikohen nga neni 131 i Kushtetutës.

Një tjetër problem që shfaqet në këtë rast lidhet me kuptimin e termit “përfundimtar”. Parimisht, interpretimi që bën Gjykata Kushtetuese në këtë rast do të thotë që qëndrimi që mban Gjykata Kushtetuese në lidhje me kuptimin e normës kushtetuese është përfundimtar dhe nuk mundet që të ndryshohet në të ardhmen, përjashtoj situatën e një amendimi të vetë Kushtetutës. Ky parim jo gjithmonë është ruajtur nga jurisprudenca kushtetuese. Kështu me vendimin nr. 49, datë 31.7.2000 Gjykata Kushtetuese ka mbajtur këtë qëndrim:

*Avokati i Popullit, në kuptim të nenit 134, paragrafi 2 të Kushtetutës mund t'i drejtohet me kërkesë Gjykatës Kushtetuese për rastet e parashikuara në nenet 49, 52 dhe 71 të ligjit 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese së Republikës së Shqipërisë”, për çështje që lidhen me funksionin e tij në mbrojtje të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, kur këto janë shkelur nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike e të konstatuara nga Avokati i Popullit, si dhe kur janë cënuar rregullat kushtetuese për organizimin dhe funksionimin e institucionit të tij.*

<sup>1002</sup> Vendimi nr.76, datë 25.4.2002 i Gjykatës Kushtetuese: Lidhur me pretendimin e kërkuesit se është zhvilluar një proces i parregullt ligjor gjatë procedurës për shkarkimin e tij nga detyra, Gjykata Kushtetuese çmon të theksojë se çdo organ i pushtetit publik gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues e ligjor është i detyruar të respektojë standardet e gjithëpramara demokratike, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë. Në vendimin interpretues nr.75, datë 19.4.2002, Gjykata Kushtetuese e ka konsoliduar qëndrimin e saj lidhur me kuptimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke arsyetuar se njohja paraprake e personit, ndaj të cilit kërkohet të merret masa e shkarkimit, me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i të drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, si me anën e dhënies së sqarimeve paraprake ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilltdo për një proces të rregullt, si një e drejtë themelore, cenimin e së cilës, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese e ka identifikuar në çdo rast, si shkelje të Kushtetutës.

<sup>1003</sup> Vendimi nr.29, datë 21.12.2006 i Gjykatës Kushtetuese. Objekti i këtij gjykimi ishte: 1. Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet qeverisjes vendore (Bashkia Tiranë) dhe pushtetit qendror (Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Policia e Ndërtimit) 2. Me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes kompetencave, shqyrtimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën dhe me Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore, si dhe shfuqizimin e: a) neneve 9, paragrafi i parafundit, 10, 19, 21, 54 (fjalja “apo Policia e Ndërtimit”), 75/2 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, b) neneve 2, (fjalja “Policia e Ndërtimit varet nga Ministria që mbulon veprimtarinë në fushën e urbanistikës e të ndërtimit”), 3/3 (fjalja “të marrë vendim për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm”) dhe nenin 6 të ligjit nr.8408, datë 25.9.1998 “Për Policinë e Ndërtimit”. 3. Interpretimin përfundimtar të nenit 13 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Bazuar në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.178, datë 8.11.2001 u shpreh se:

*Një zgjidhje e tillë gjen mbështetje në nenin 134 pika 2 të Kushtetutës. Në vështrim të kësaj dispozite Avokati i Popullit nuk legjitimohet të verë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Çështja që ai ka ngritur dhe që ka për objekt shfuqizimin si antikushtetues të këtij akti normativ të organit ligjvënës nuk lidhet me interesat e tij. Asnjë normë e këtij ligji nuk del të ketë prekur strukturën organizative të institucionit që ai drejton, të ketë cënuar sadopak statusin e tij si person ose të punonjësve të tjerë të këtij institucioni, apo ta ketë penguar atë në ushtrimin e kompetencave që kanë lidhje me funksionin e tij, rrethana këto që përmenden në mënyrë indikative edhe në vendimin interpretues nr.49, datë 31.7.2000 të Gjykatës Kushtetuese. Pra, pa qenë të pranishme këto rrethana Avokati i Popullit nuk mund t'i drejtohet gjykatës Kushtetuese dhe ta investojë atë në shqyrtimin e çështjes.*

Pra, rezulton se sipas vendimit interpretues, nuk është në interesin e Avokatit të Popullit, që të kundërshtonte aktet legjislative të Kuvendit. Kjo situatë megjithëse u përsërit në jurisprudencë,<sup>1004</sup> ndryshoi me vendimin nr.40, datë 16.11.2007, ku Gjykata Kushtetuese mbajti qëndrimin se:

*Gjykata Kushtetuese e sheh me vend të ndalet edhe një herë në përcaktimin e konceptit "interes" në çështjen me kërkues Avokatin e Popullit, sipas nenit 134/2 të Kushtetutës, ku parashikohet se ky organ mund të bëjë kërkesë para kësaj Gjykate vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tij.*

...

*Kur Avokati i Popullit krijon bindjen se shkelja ka ardhur si pasojë e përmbajtjes së një ligji ose akti tjetër normativ, pra nga vetëformulimi i vullnetit të organit që e ka nxjerrë atë, atëherë ai mund ta investojë Gjykatën Kushtetuese duke kërkuar shfuqizimin e aktit si antikushtetues. Në një rast të tillë mund të thuhet se çështja konkrete lidhet me interesin e këtij organi kushtetues për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e individit. Në këtë këndvështrim, interesi i Avokatit të Popullit për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me qëllim shfuqizimin si antikushtetues të aktit të ligjvënësit duhet të shqyrtohet rast pas rasti, pasi ky është edhe kuptimi i nenit 134/2 të Kushtetutës, i cili e ka renditur këtë organ në grupin e subjekteve që i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, vetëm nëse justifikojnë interesin e tyre në çështjen konkrete.*

<sup>1004</sup> Vendimi nr.2, datë 3.2.2004 i Gjykatës Kushtetuese: *Dispozitat e ligjit që kërkohet të shfuqizohen trajtojnë çështje të fushës së doganave. Ato nuk kanë lidhje me organizimin dhe funksionimin e institucionit të Avokatit të Popullit dhe nuk e prekin atë. Në këto kushte, Avokati i Popullit, në kuptim të nenit 134 pika 2 të Kushtetutës, nuk legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, sepse ajo nuk ka lidhje me interesat e tij. Një qëndrim i tillë është mbajtur nga Gjykata Kushtetuese edhe me vendimin nr.178, datë 8.11.2001, për çështjen me objekt shfuqizimin si antikushtetues të ligjit nr.8377, datë 22.7.1998 "Për shpalljen e moratoriumit të detyrimeve të pashlyera të ish-ndërmarrjeve të tregtisë së jashtme". Me këtë vendim është rrëzuar kërkesa që ka paraqitur Avokati i Popullit me arsyetimin se asnjë normë e këtij ligji nuk kishte prekur "strukturën organizative të institucionit të Avokatit të Popullit dhe nuk kishte penguar statusin e tij si person juridik, rrethana këto që përmenden në mënyrë indikative në vendimin interpretues nr.49, datë 31.7.2000 të Gjykatës Kushtetuese".*

Vendimi i mësipërm që u pasua edhe me vendime të tjera të Gjykatës Kushtetuese, tregon qartësisht se Gjykata ndryshoi qëndrimin e saj për interpretimin përfundimtar të termit “interes”, përse i përket institucionit të Avokatit të Popullit.

Një situatë e ngjashme shfaqet edhe në një rast tjetër. Kështu Gjykata Kushtetuese duke interpretuar nenin 78 pika 1 të Kushtetutës në vendimin e saj nr. 29, datë 21.10.2009 ka mbajtur këtë qëndrim:

*Interpretimin e pikës 1 të nenit 78 të Kushtetutës si vijon:*

*1. Numri i deputetëve të pranishëm për çeljen e seancës së votimit parlamentar është minimalisht 71 deputetë.*

*2. Vendimi i Kuvendit miratohet kur për të kanë votuar pro jo më pak se gjysma plus një e anëtarëve që janë të pranishëm.*

Ndërsa dy vjet më pas në vendimin nr.44, datë 7.10.2011 Gjykata Kushtetuese, në një gjykim konkret u shpreh:

*Gjykata çmon se një deputet që nuk shpreh vullnet me votën e tij dhe si rrjedhojë nuk ndikon në procesin e votimit në Kuvend nuk duhet të llogaritet në konceptin “shumicë e të pranishmëve” për efekt të kuorumit të votimit. Nëse do të pranohet të kundërtën, atëherë do të prodhohej një rritje artificiale dhe e pajustificuar e kuorumit, gjë e cila nuk është në përputhje me qëllimin e ligjvënësit.*

Edhe në këtë rast rezulton se konkluzionet e një vendimi për interpretim përfundimtar të një norme kushtetuese janë ndryshuar me një vendim tjetër të Gjykatës Kushtetuese të marra në kuadër të një gjykimi konkret. Në këtë kuptim rezulton se termi “përfundimtar” që përdor Kushtetuta në nenin 124, pika 1 të saj duhet kuptuar në sensin relativ të tij, përderisa kuptimi i tyre mund të ndryshohet në kuadër të gjykimeve të tjera kushtetuese.

Rast tjetër është vendimi që merr Gjykata Kushtetuese kur konstaton pajtueshmërinë apo papajtueshmërinë e një marrëveshje ndërkombëtare me Kushtetutën. Ky lloj vendimi nuk është një vendim klasik i rrëzimit apo i pranimit të kërkesës, me pasojë në rastin e fundit, shfuqizimin e aktit. Në rastin konkret duke qenë se ndodhemi përpara një kontrolli *apriori* të një marrëveshje ndërkombëtare, atëherë vendimi i saj është në parim deklarativ, teknikë kjo e cila njihet edhe në vende të tjera.<sup>1005</sup> Kjo ndodh pasi kontrolli paraprak është i karakterizuar nga një veçanti. Në ndryshim nga gjykimet e tjera kushtetuese, që marrin formën e një kërkesë apo kundërshtimi, në këtë rast Gjykata Kushtetuese vepron më shumë si një organ këshillimor, duke përpunuar një mendim, i ndryshëm nga një vendim, në të cilin shqyrton përputhshmërinë e një traktati me Kushtetutën dhe për pasojë e vlerëson nëse Shteti është i legjitimuar për të dhënë pëlqimin e tij.<sup>1006</sup>

Nëse Gjykata shprehet për pajtueshmërinë e marrëveshjes ndërkombëtare me Kushtetutën, Kuvendi është i lirë ta ratifikojë atë ose jo, mbështetur në gjykimin e tij politik, marrëveshjen ndërkombëtare. Ndërsa kur Gjykata shprehet për papajtueshmërinë e marrëveshjes ndërkombëtare me Kushtetutën, marrëveshja ndërkombëtare nuk mundet që të ratifikohet më në Kuvend, sipas parashikimit të LGJK. Në këtë rast, vendimi i Gjykatës Kushtetuese, megjithëse

<sup>1005</sup> Ruiz, Gerardo Ruiz-Rico, “Il Tribunale Costituzionale Spagnolo”, botuar në “Sistemi e modelli di giustizia costituzionale”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “Cedam”, Padova, 2009, fq.252.

<sup>1006</sup> Po aty, fq.265.

deklarativ ka efekt detyrues. Ratifikimi i marrëveshjes mund të bëhet vetëm në rast se rinegocihet marrëveshja ndërkombëtare duke e përputhur atë me standardet kushtetuese, ose nëse amendohen dispozitat përkatëse kushtetuese. Ky lloj efekti njihet edhe nga kushtetuta të vendeve të tjera si Spanja,<sup>1007</sup> Sllovenia,<sup>1008</sup> apo Franca<sup>1009</sup> ku organi legjislativ mund të ratifikojë një marrëveshje të deklaruar si antikushtetuese vetëm në rast se amendon Kushtetutën e saj.

Siç e trajtuam edhe në vendimet e pranimit, vendimi i Gjykatës Kushtetuese që vendos pranimin e kërkesës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave duhet të ketë edhe një pjesë deklarative sipas së cilës deklarohet se cilit institucion i takon kompetenca që është në mosmarrëveshje. Neni 56 i LGJK përcakton se ky institucion në vendimin e saj përfundimtar duhet të shprehet qartësisht në lidhje me faktin se cilit organ i përket një kompetencë e caktuar. Gjithashtu, po kjo dispozitë i jep të drejtën Gjykatës që të eliminojë shkaktuesin e mosmarrëveshjes duke shqyrtuar kushtetutshmërinë dhe/apo ligjshmërinë e aktit, që është bërë shkak për lindjen e mosmarrëveshjes.

Në praktikën e saj, Gjykata ka vendosur në mënyra të ndryshme. Kështu në dy raste,<sup>1010</sup> Gjykata është shprehur vetëm se cilit organ i përket kompetenca e caktuar, objekt i mosmarrëveshjes. Në dy raste të tjera,<sup>1011</sup> Gjykata është shprehur në mënyrë kumulative se cilit organ i përket e drejta që të ushtrojë kompetencën, objekt gjykimi, si edhe për shfuqizimin e akteve që kanë shkaktuar mosmarrëveshjen e kompetencave dhe vetëm në një rast,<sup>1012</sup> është shprehur vetëm për shfuqizimin e aktit që ka shkaktuar mosmarrëveshjen midis organeve të ndryshme.

Pavarësisht veçorive që ka secila çështje mendoj se në dispozitivin e vendimit Gjykata në të gjitha rastet duhet të vendosë së pari se cilit organ i përket e drejta për të ushtuar një kompetencë të caktuar, dhe së dyti duhet të shfuqizojë aktin, apo të deklarojë si antikushtetuese veprimtarinë e një institucioni.

Pjesa arsyetuese e një vendimi gjyqësor përbëhet nga faktet e konstatuara nga gjykata, provat e administruara në gjykim si edhe nga argumentat e gjykatës që pranojnë apo rrëzojnë pretendimet e palëve ndërgjyqëse. Po në pjesën arsyetuese, gjykata sqaron, si rregull, edhe nocione të ndryshme ligjore dhe kushtetuese, dhe tregon se si duhet të kuptohen dhe zbatohen normat në fuqi.

Është e vertetë se konkluzionet e Gjykatës Kushtetuese të shprehura në pjesën arsyetuese të saj kanë fuqinë e ligjit dhe janë detyruese për organet e tjera shtetërore,<sup>1013</sup> por është përsëri pjesa urdhëruese (dispozitivi i vendimit) që tregon vullnetin shtetëror, të shprehur në vendimin e një gjykate, për fatin e një çështjeje dhe mënyrës se si duhet të veprojnë apo të mosveprojnë organe të caktuara pas dhënies së vendimit.

<sup>1007</sup> Po aty, fq.252.

<sup>1008</sup> Sovdat, Jaradanka, "Human Rights between the Constitution, Treaties, and EU Law. The Case of Slovenia", botuar në "International Constitutional Law", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "G.Giappichelli Editore", Torino 2014, fq.332.

<sup>1009</sup> Albrerton, Ghislaine, "Francia", botuar në "Giustizia Costituzionale e Unione Europea – Una comparazione tra Austria, Francia, Germania, Italia, Spagna e Portogallo", nën kujdesin e Alfonso Celotto, Javier Tajadura, Josu De Miguel Barcena, përkthimi në italisht, Shtëpia Botuese "Editoriale Scientifica srl", Napoli 2011, fq.208.

<sup>1010</sup> Shih dispozitivin e vendimit nr.26, datë 4.12.2006 dhe të vendimit nr.12, datë 20.5.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>1011</sup> Shih dispozitivin e vendimit nr.29, datë 21.12.2006 dhe të vendimit nr. 20, datë 04.05.2007 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>1012</sup> Shih dispozitivin e vendimit nr. 22, datë 5.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>1013</sup> Vendimi nr.5, datë 7.2.2001 të Gjykatës Kushtetuese



Për rrjedhojë faktit se kujt pushteti i përket kompetenca objekt gjykimi duhet të pasqyrohet në dispozitiv, krahas pjesës për shfuqizimin e aktit apo deklarimit antikushtetues të veprimt qe ka shkaktuar këtë mosmarrëveshjeje.

Pavarësisht nga sa më sipër, totalisht deklarativ është vendimi i Gjykatës Kushtetuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave në rastin e një konflikti negativ. Në rastin e konfliktit negativ të kompetencave, Gjykata mund të shprehet me vendim deklarativ për antikushtetutshmërinë e mosushtimit të kompetencës nga një organ i caktuar, pasi dhe praktikisht duke qenë se ky organ nuk vepron, nuk ka nxjerrë asnjë akt dhe për rrjedhojë Gjykata nuk ka se çfarë të shfuqizojë.

Në lidhje me këtë gjykim, së fundmi Gjykata Kushtetuese e ka zbatuar edhe një lloj vendimmarrje deklarative të veçantë.<sup>1014</sup> Kështu ndërkohë që Kuvendi e kishte shfuqizuar vendimin e tij që ishte bërë objekt gjykimi dhe e ka zëvendësuar atë me një tjetër vendim i cili përputhej me kërkesat e jo më pak se një të katërtës së deputetëve për ngritjen e një komisioni hetimor. Por Gjykata Kushtetuese në këtë rast nuk vendosi pushimin e çështjes por deklaroi se ka pasur një mosmarrëveshje kompetencash.

Kjo lloj mënyre vendimmarrje e Gjykatës Kushtetuese në këtë rast duket se ka si qëllim që t'i detyrojë institucionet të veprojnë në përputhje me parashikimet Kushtetuese dhe jo ti shmangen gjykimit Kushtetues duke shfuqizuar apo ndryshuar aktet që janë bërë objekt gjykimi. Por personalisht nuk pajtohem me këtë vendimmarrje të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë rast gjykimi nuk ka asnjë objekt dhe për rrjedhojë ajo duhet që të vendosë pushimin e gjykimit. Gjykim pa objekt nuk ka. Për më tepër që në këtë rast Gjykata, mënjanon mundësinë e institucioneve për t'u vetëkorrigjuar, si edhe cënon parimin e vetëpërmbytjes gjyqësore. Për ta përforcuar si argument duhet theksuar se Gjykata Kushtetuese në këtë rast ka ndryshuar edhe precedentët e saj të mëparshëm pa dhënë asnjë argument apo arsye mbi këtë ndryshim.

Një tjetër vendimmarrje deklarative e Gjykatës Kushtetuese është ajo sipas nenit 64, pika 3 të LGJK. Në këtë rast nëse vërtetohet se Presidenti ka ushtruar një aktivitet që sipas Kushtetutës është i ndaluar, ajo vendos deklarimin e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës. Në këtë rast Kushtetuta nuk parashikon ndonjë pasojë të mëtejshme, pra largimin nga detyra të Presidentit në mënyrë të shprehur. Jam i mendimit se në këtë rast Presidenti do të duhej të jepte dorëheqjen. Nëse ai nuk e bën një gjë të tillë atëherë Kuvendi ka të drejtë që të nisë procedurën e shkarkimit të tij për shkelje të rëndë të Kushtetutës sipas parashikimeve të nenit 90 të Kushtetutës.

Vendim tjetër me natyrë deklarative është vendimi që merr Gjykata në lidhje me kushtetutshmërinë e çështjeve të shtruaara për referendum. Në këto raste Gjykata Kushtetuese nuk shprehet në lidhje me ndonjë akt, por deklaron nëse një referendum mund të mbahet ose jo nga pikëpamja kushtetuese.

**e) Vendimet e pushimit.** Ky lloj vendimi si rregull merret në tre raste Në rastin e parë merret nëse akti i cili është objekt gjykimi, shfuqizohet<sup>1015</sup> ose ndryshohet<sup>1016</sup> gjatë shqyrtimit

<sup>1014</sup> Vendimi nr.38, datë 12.6.2015 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>1015</sup> Vendimi nr.34, datë 8.12.2003 i Gjykatës Kushtetuese: *Përfaqësuesi i subjektit të interesuar deklaroi se Kryeministri, me urdhrin nr.157, datë 12.11.2003, ka revokuar urdhrin nr.226, datë 20.8.2002 "Për komunikimin me organet e medias së shkruar dhe elektronike", i cili kërkohet të deklarohet si antikushtetues nga kërkuessit. Një kopje e urdhrin revokues u administrua gjatë gjykimit. Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkesa e paraqitur nuk ka më objektin e saj, sepse urdhri që kontestohet nuk ekziston, pasi ai është revokuar nga vetë organi që e ka nxjerrë.* Vendimi nr.57, datë 5.12.2014 i Gjykatës Kushtetuese, parag.12-14: 12. *Pas pezullimit të çështjes, gjatë shqyrtimit në themel të saj, Gjykata konstatoi se Këshilli i Ministrave, në datën 01.10.2014, ka miratuar vendimin nr. 642 (më poshtë "VKM nr. 642/2014") me anë të të cilit ka shfuqizuar VKM nr.354/2014 "Për ngritjen*

gjyqësor. Kusht në këtë rast është që norma e re ka përmbajtje thelbësisht të ndryshme nga norma e vjetër. Në këtë rast duke qenë se pretendimet e kërkuetit lidheshin me një normë e cila nuk është më në fuqi, këto norma nuk kanë prodhuar pasoja dhe gjykimi nuk ka më objekt Gjykata vendos pushimin e gjykimit.

Megjithatë ka një luhatje së fundmi në jurisprudencën kushtetuese në lidhje me pushimin e çështjes. Por së fundmi disa gjyqtarë kushtetues në një mendim në pakicë janë shprehur se:

*Nisur nga fuqia detyruese e vendimeve të kësaj Gjykate, si dhe nga rëndësia e veçantë që merr kontrolli i pajtueshmërisë me Kushtetutën i ligjeve apo i akteve të tjera normative, me qëllim garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit, jemi të mendimit se marrja në shqyrtim e kushtetutshmërisë së VKM-së nr.354/2014, edhe pse nuk do të kishte efekte të drejtpërdrejta në rastin konkret, në këndvështrim të standardeve kushtetuese, paraqet interes si në rregullimin e disiplinës ligjore objekt shqyrtimi për të ardhmen, ashtu edhe në konsolidimin e mëtejshëm të jurisprudencës së kësaj Gjykate në këtë aspekt. Për më tepër, në çështjen objekt shqyrtimi, ajo paraqet rëndësi në funksion të mbrojtjes së interesit publik, duke konsideruar parime të tilla si ai i shtetit të së drejtës, por edhe ndjeshmërinë dhe sidomos pritsshmëritë e qytetarëve për garantimin e jetës private, të cilat kërkueti pretendon se janë cenuar.<sup>1017</sup>*

Në këtë rast jam i mendimit që kjo linjë arsyetimi nuk mundet që të qëndrojë. Në rradhë të parë siç e pranon edhe pakica një vendim i tillë do të ishte vetëm deklarativ dhe nuk do të sillte asnjë pasojë. Një mënyrë veprimi e tillë do ta bënte gjykatën në rolin e një organi këshillues, funksion ky i cili nuk është në rolin e saj. Për më tepër Gjykata duhet që të karakterizohet nga vetëpërmbajtja gjyqësore dhe të mos influencojë vendimmarrjet e ardhshme të vetë Gjykatës Kushtetuese, që mund ta marrë ajo përballë një çështjeje konkrete. Megjithatë përsëri Gjykata Kushtetuese e aplikoi në një rast tjetër një situatë të tillë, siç edhe e trajtuam më sipër, në një gjykim për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave. Në këtë rast vendimi është me karakter deklarativ.

Në rastin e dytë kemi të bëjmë me situatën kur pala kërkuese ka hequr dorë vetë nga gjykimi i kërkesës. Në lidhje me këtë rast Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr.8, datë 12.3.2009 ka mbajtur këtë qëndrim:

*Në seancën plenare, më datë 24.02.2009 kërkueti hoqi dorë nga kërkesa e tij duke u shprehur se gjykimi i mëtejshëm i çështjes nuk paraqet interes për të. Heqjen dorë nga kërkesa, kërkueti e ka depozituar edhe me shkrim pranë Gjykatës më datë 26.01.2009.*

---

*e bazës së të dhënave IMEI për regjistrimin e numrave IMEI të aparateve celulare, që përdoren në rrjetet e shërbimeve të komunikimeve të lëvizshme", objekt shqyrtimi. 13. VKM-ja nr. 642/2014 e lartpërmendur, që parashikon se hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 154, datë 08.10.2014. Pra, ka hyrë në fuqi në datën 08.10.2014. Kjo rrethanë u parashtrua edhe nga subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave. 14. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në rastin konkret ndodhet në kushtet kur VKM-ja nr. 354/2014, objekt shqyrtimi, i ka përfunduar efektet e saj. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se çështja mbetet pa objekt dhe se gjykimi i saj duhet të pushohet.*

<sup>1016</sup> Vendimi nr.4, datë 12.2.2010 i Gjykatës Kushtetuese: *Nga analiza e mësipërme, Gjykata vlerëson, se për të gjitha pretendimet në lidhje me nenin 1, 8 dhe 12, për të cilat ligji i ri ka sjellë shtesa dhe ndryshime, çështja mbetet pa objekt, e për rrjedhojë, duhet të pushohet.*

<sup>1017</sup> Mendimi i pakicës në vendimin nr.57, datë 5.12.2014 të Gjykatës Kushtetuese, parag.8.

*Ligji nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", në nenin 1, paragrafi i dytë, parashikon se "Për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj, Gjykata Kushtetuese merr parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes." Bazuar në këtë dispozitë, Gjykata Kushtetuese iu referua Kodit të Proçedurës Civile (KPC), neni 299/b, i cili parashikon se "gjykata vendos pushimin e gjykimit nëse paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë".*

*Në kushtet e mësipërme, Gjykata Kushtetuese vlerëson se plotësohen kriteret për pushimin e gjykimit të çështjes në bazë të dispozitës së sipërcituar të KPC.<sup>1018</sup>*

Duke qenë se e drejta e disponimit është një e drejtë ekskluzive e kërkuesit, atëherë Gjykata nuk duhet të shprehet me vendim nëse një gjë e tillë nuk kërkohet nga vetë palët në proces. Për rrjedhojë pushimi i gjykimit të çështjes në këtë drejtim është mëse i drejtë.

Rasti i tretë që është shfaqur në praktikë ka të bëjë me situatën kur pala kërkuese nuk paraqitet në gjykim megjithëse ka marrë njoftim rregullisht dhe nuk ka paraqitur shkaqe të arsyeshme. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese është shprehur se:

*Ligji nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", në nenin 1, paragrafi i dytë, parashikon se "Për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj, Gjykata Kushtetuese merr parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes." Bazuar në këtë dispozitë, Gjykata Kushtetuese ju referua Kodit të Proçedurës Civile, neni 179, i cili parashikon se "Nëse paditësi ose asnjë nga palët, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqiten, si në veprimet përgatitore ashtu dhe seancën gjyqësore dhe rezulton se kanë dijeni rregullisht, gjykata vendos pushimin e gjykimit të çështjes."*

*Në kushtet e mësipërme, Gjykata Kushtetuese vlerëson se plotësohen kriteret për pushimin e gjykimit të çështjes në bazë të dispozitës së sipërcituar të K.Pr.Civile. Konkretisht, pala kërkuese është njoftuar për ditën e gjykimit në këtë Gjykatë, sipas proçedurës që parashikon neni 38, pika 3, i Ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Kështu, meqë kërkuesja është më vendqëndrim jashtë shtetit, Gjykata Kushtetuese ka proçeduar me njoftimin e saj me shpallje në selinë e Gjykatës Kushtetuese. Përveç kësaj, ne seancë rezultoi se kërkuesja nuk ka njoftuar për ndonjë shkak të arsyeshëm për mosparaqitje.*

*Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese konkludon, se përderisa njoftimi me shpallje prezumon dijeninë e kërkueses dhe përderisa kjo e fundit nuk është paraqitur në gjyq, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, në bazë të nenit 179 të K.Pr.Civile, gjykimi i çështjes duhet të pushohet.<sup>1019</sup>*

Arsyeja e kësaj vendimmarrje duket se bazohet në parimin e disponibilitetit. Gjykata në këtë rast duke shfrytëzuar hapësirën që i jep neni 1, pika 2 e LGJK si edhe referimi në dispozitat e K.Pr.C. ka vendosur pushimin e gjykimit. Kjo lloj mënyre e të vepruarit e Gjykatës bie në kundërshtim me parashikimin e nenit 38, pika 6 të LGJK parashikon se kur kërkuesi, subjekti i

<sup>1018</sup> Të njëjtin qendrim ka mbajtur Gjykata Kushtetuese edhe në vendimin nr.34, datë 8.10.2010.

<sup>1019</sup> Vendimi nr.27, datë 15.12.2008 të Gjykatës Kushtetuese



interesuar ose përfaqësuesit e tyre, megjithëse janë njoftuar, nuk paraqiten në seancë plenare dhe për këtë nuk kanë paraqitur shkaqe të përligjura, seanca plenare zhvillohet në mungesë. Në këtë kuptim Gjykata Kushtetuese nuk mundet që të vendosë pushimin e gjykimit për shkak të mosparaqitjes së kërkuarit por duhet të vazhdojë gjykimin.

Një tjetër vendimmarrje që parashikohet nga LGJK është ajo e pushimit të gjykimit në rast se Presidenti jep dorëheqjen gjatë gjykimit kushtetues për shkarkimin e tij, ose përfundon mandati i tij.<sup>1020</sup> Në këtë rast duke mos pasur më objekt, pra nëse personi që pretendohet se është zgjedhur në kundërshtim me Kushtetutën nuk është më në detyrën e Presidentit, atëherë dhe gjykimi kushtetues nuk ka më vlerë.

Pavarësisht kësaj LGJK parashikon se me kërkesë të Kuvendit ose të ish-presidentit gjykimi rifillon.<sup>1021</sup> Në fakt ish-Presidenti dhe Kuvendi nuk janë subjekte të cilat parashikohen nga Kushtetuta për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Legjitimiteti i tyre në këtë rast bazohet në legjitimitetin që ato kanë fituar me çeljen fillestare të procesit kushtetutës në Gjykatë. Ky parashikim vlen të analizohet edhe me tej pasi e drejta për të kërkuar rifillimin e procedurave gjyqësore nuk është e subjektit kërkuar por përkundrazi e subjekteve të interesuara. Mos dhënia e kësaj të drejte subjekteve kërkuese në këtë rast lidhet me faktin që me dhënien e dorëheqjes së Presidentit ose me mbarimin e mandatit të tij, kërkesa e tyre nuk ka më shkak. Personi që ata donin të largonin nëpërmjet kërkesës është larguar, pra qëllimi i tyre është arritur.

Ndërsa për sa i përket subjekteve të tjera, mund të themi se ato janë më të interesuara për vazhdimin e gjykimit. Kështu pushimi i gjykimit për këto arsye e le të hapur dyshimin që personi që kishte detyrën e Presidentit nuk është zgjedhur në përputhje me kërkesat e Kushtetutës. Për këtë arsye për çështje të dinjitetit dhe për të ruajtur kapitalin politik, atëherë ish-presidenti ka të drejtë të kërkojë vazhdimin e gjykimit. Megjithatë mund të vihet në diskutim interesi i ish Presidentit për të kërkuar rifillimin e gjykimit në rast se ai ka dhënë dorëheqjen. Duke qenë se ai ishte i vetëdijshëm për pasojën që dha dorëheqja e tij atëherë mund të pretendohet se në këtë rast ai nuk ka asnjë interes për vazhdimin e gjykimit. Një interes të tillë mund ta ketë Kuvendi, i cili kërkon të mbrojë deri në fund vendimmarrjen e tij, si në përputhje më normat Kushtetuese. Ndërsa për sa i përket rastit kur gjykimi pushohet për shkak të mbarimit të mandatit atëherë të dy këto subjekte kanë të drejtë që të kërkojnë rifillimin e gjykimit.

E njëjta situatë parashikohet nga LGJK edhe në rastin e gjykimit për papajtueshmërinë në ushtrimin e funksioneve nga Presidenti i Republikës.

Një rast i rrallë do të ishte kur Gjykata Kushtetuese, ka në shqyrtim paralelisht një kërkesë për shfuqizimin e një ligji apo dispozitash ligjore të caktuara si të papajtueshme me kushtetutën dhe një kërkesë tjetër për mbajtjen e një referendumit të përgjithshëm shfuqizues për të njëjtin akt. Nëse Gjykata Kushtetuese, shprehet fillimisht për shfuqizimin e ligjit si antikushtetues, çfarë do të ndodhë me gjykimin tjetër për referendumin? Sipas jurisprudencës kushtetuese italiane ky lloj gjykimi do të vazhdojë madje edhe mund të konsiderohet si referendum që edhe mund të mbahet pasi këto dy gjykime janë të pavaruara nga njëri – tjetri dhe nuk ndikojnë.<sup>1022</sup> Në këtë rast i takon KQZ-së që të vendosë pushimin e procedurave të referendumit. Personalisht jam kundër kësaj zgjidhjeje, pasi mendoj se Gjykata Kushtetuese

<sup>1020</sup> Neni 64 i LGJK-së

<sup>1021</sup> Po aty.

<sup>1022</sup> Shih vendimet nr.24 dhe 25 të vitit 2004 të Gjykatës Kushtetuese Italiane si edhe Tonga, Massimo, "Dinamica processuale ed effetti della promozie" botuar në "Le zone d'ombra della giustizia costituzionale – I giudizi sui conflitti di attribuzione e sull'ammissibilità del referendum abrogativo". Aktet e seminarit të Modena mbajtur më 13 tetor 2006, botuar nga "Quaderni del "Gruppo di Pisa", nën kujdesin e Roberto Pindari, Shtëpia Botuese "G.Giappichelli", Torino 2007, fq. 336-337.



duhet që të vendosë pushimin e çështjes në këtë situatë duke qenë se gjykimi nuk ka më objekt dhe për rrjedhojë nuk mundet që të vazhdojë më.

### 5.3 Hyrja në fuqi e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Në lidhje me hyrjen në fuqi të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese neni 132, pika 2 e Kushtetutës ka përcaktuar dy raste sipas së cilës vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi, ditën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe se Gjykata Kushtetuese mund të vendosë që ligji ose akti tjetër normativ të shfuqizohet në një datë tjetër.

Në rastin e parë vendimi mbasi është arsyetuar, redaktuar dhe nënshkruar nga të gjithë gjyqtarët i dërgohet për botim Qendrës së Botimeve Zyrtare e cila detyrohet të bëjë botimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, jo më vonë se 15 ditë nga ardhja e tyre për botim.<sup>1023</sup> Respektimi i këtij afati ka rëndësi të madhe pasi me publikimin e vendimit fillojnë që edhe efektet e vendimit të Gjykatës të prodhojnë pasoja. Në këtë drejtim çdo vonesë do të sillte pasoja të rënda dhe përgjegjësi disiplinore. Ditën që vendimi botohet në Fletoren Zyrtare, atë ditë konsiderohet se edhe vendimi ka hyrë në fuqi. Kjo lloj mënyre e hyrjes në fuqi zbatohet për të gjitha llojet e vendimeve që merr Gjykata Kushtetuese, përderisa dispozita nuk bën asnjë përjashtim.

Në rastin e dytë, për të shmangur boshllëkun legjislativ Gjykata Kushtetuese mund të vendosë që ligji apo akti tjetër normativ të shfuqizohet në një datë tjetër. Kuptohet që kjo datë është e ndryshme nga data që vendimi i Gjykatës botohet në Fletoren Zyrtare. Ajo mund të jetë një datë fikse,<sup>1024</sup> ose një afat i përcaktuar si për shembull gjashtë muaj mbas botimit në Fletoren Zyrtare. Në këtë rast afati fillon të ecë mbas botimit të vendimit të Fletoren Zyrtare. Kjo lloj mënyre vendimmarrje zbatohet vetëm në rast se objekt gjykimi janë ligje apo akte të tjera normative dhe jo ndaj akteve të tjera që janë objekt shqyrtimi në gjykime të tjera kushtetuese. Por në praktikën e Gjykatës Kushtetuese gjejmë raste kur është devijuar nga ky parashikim kushtetues. Kështu në vendimin nr.20, datë 18.4.2000 Gjykata Kushtetuese megjithëse ka pasur për objekt shqyrtimin e kushtetushmërisë së një vendimi të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është shprehur në dispozitiv se ky vendim hyn në fuqi 15 ditë mbas botimit në Fletoren Zyrtare. Është mëse e qartë që kjo mënyrë e të disponuarit nuk është në përputhje me Kushtetutën përderisa vendimi i Gjykatës së Lartë nuk është as ligj dhe as akt normativ.

Gjykata Kushtetuese e ka zbatuar këtë mundësi në disa raste, por nga ana formale në mënyrë të gabuar. Kështu në dispozitivin e vendimeve të saj ajo është shprehur për hyrjen në fuqi të vendimit të saj 15 ditë<sup>1025</sup> apo 6 muaj<sup>1026</sup> mbas botimit të vendimit në Fletoren Zyrtare. Kjo mënyrë e të disponuarit duket sikur është në kundërshtim me parashikimet kushtetuese të cilat në çdo rast përcaktojnë se vendimi hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare. Ajo që mund të shtyhet është data e shfuqizimit të ligjit apo aktit normativ por jo hyrja në fuqi e vendimit. E thënë ndryshe, vendimi hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare por efektet e tij i sjell në një moment të dytë.

LGJK përcakton edhe një tjetër kohë të hyrjes në fuqi të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Kështu në nenin 26 të LGJK përcaktohet se kur vendimi ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të individit, Gjykata mund të vendosë që ai të hyjë në fuqi me shpalljen e

<sup>1023</sup> LGJK, neni 26, pika 2.

<sup>1024</sup> Vendimi nr.1, datë 12.1.2011 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>1025</sup> Vendimi nr.20, datë 18.4.2000 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>1026</sup> Vendimi nr.12, datë 14.4.2010 i Gjykatës Kushtetuese.

tij. Ky parashikim i LGJK nuk gjen asnjë mbështetje në normat kushtetuese. Pra, duket sikur ligjvënësi ka tejkalluar parashikimet kushtetuese duke i dhënë një kompetencë të tillë Gjykatës. Zbatimi i kësaj mundësie justifikohet vetëm në raste kur kemi të bëjmë me të drejtat dhe liritë themelore të individëve dhe jo në raste të tjera si për shembull marrëdhëniet dhe kompetencat kushtetuese të institucioneve. Gjykata Kushtetuese e ka zbatuar këtë mundësi në pak raste. Në një rast Gjykata, duke konstatuar cënimin e së drejtës së votës së individëve ka vendosur hyrjen menjëherë të vendimit të saj.<sup>1027</sup> Në një rast tjetër, pavarësisht se gjykimi kishte për objekt të drejtën për një proces të rregullt ligjor, Gjykata vendosi hyrjen në fuqi menjëherë të vendimit të saj për shkak të mungesës së juridiksionit të saj dhe për t'i dhënë mundësi Gjykatës së Lartë që të vazhdonte me shqyrtimin e çështjes.<sup>1028</sup> Por kjo lloj vendimmarrje duket sikur nuk ka asnjë bazë kushtetuese. Përderisa Kushtetuta përcakton se vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare, LGJK vetë, si një akt me fuqi më të ulët nuk mundet që të dalë kundër këtij parashikimi. Në atë rast kur Kushtetuta ka dashur të bëjë përjashtim e ka bërë vetë, siç është rasti i efektit të vonuar të vendimit të saj të sqaruar më sipër. Në rastin e kësaj dispozite të LGJK nuk gjejmë asnjë parashikim përjashtues në vetë Kushtetutën e vendit, për rrjedhojë pavarësisht qëllimit që ka kjo dispozitë, përmbajtja e saj del jashtë kuadrit kushtetues.

#### 5.4 Efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Kushtetuta në lidhje me efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese ka parashikime të pakta. Kështu neni 132, pika 1 përcakton se vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ky është efekti *erga omnes* i vendimeve. Por duke përgjithësuar praktikën gjyqësore dhe doktrinën mund të themi se në tërësi vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë efekte të gjësë së gjykuar, *erga omnes*, të forcës së ligjit dhe efektin përfundimtar të vendimit. Le ti trajtojmë me rradhë.

##### 5.4.1 Efekti i gjësë së gjykuar.

Gjënë e gjykuar si një nga efektet që merr vendimi gjyqësor nuk parashikohet në Kushtetutë apo në LGJK shprehimisht. Megjithatë si parim procedural gjyqësor ai është i zbatueshëm edhe për Gjykatën Kushtetuese. Më konkretisht ky parim është i rregulluar në nenin

<sup>1027</sup> Vendimi nr.49, datë 2.6.2001 i Gjykatës Kushtetuese: *Përsa i përket hyrjes në fuqi të këtij vendimi, Gjykata Kushtetuese, duke iu referuar nenit 132 pika 2 të Kushtetutës dhe nenit 26 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", si dhe duke vlerësuar nevojën për zgjidhjen e shpejtë të problemeve të dala në praktikë, arriti në përfundimin se ky vendim duhet të hyjë në fuqi menjëherë.*

<sup>1028</sup> Vendimi nr.163, datë 31.10.2001 i Gjykatës Kushtetuese: *Në seancë gjyqësore përfaqësuesi i kërkuarit ka deklaruar se në datën 4.10.2001, e njëjta kërkesë, me të njëjtët palë dhe me të njëjtin objekt është paraqitur për shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranës, e cila me vendimin nr.4764 Akti, datë 4.10.2001 ka vendosur moskompetencën e saj për gjykimin e çështjes. Kundër këtij vendimi, kërkuari Stefan Naumov ka paraqitur ankim të veçantë në Gjykatën e Lartë, nëpërmjet të cilit ka kërkuar prishjen e vendimit nr.4764, datë 4.10.2001 të gjykatës së shkallës së parë...Nisur nga sa më lart, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se momentalisht çështja nuk mund të gjykohet nga ana e saj dhe, për rrjedhojë, kërkesa duhet rrëzuar me arsyetimin e mungesës së juridiksionit. Gjithashtu, lidhur me fuqinë e vendimit të saj, Gjykata Kushtetuese konkludon se duhet të zbatohet neni 26 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".*

451/a të K.Pr.C.<sup>1029</sup> dhe gjen zbatim në procedurën kushtetuese nëpërmjet parashikimit të nenit 1, pika 2 të LGJK.

Duke qenë një normë ligjore, për sqarimin e saj të mëtjshëm e shohim të nevojshme që ti referohemi edhe jurisprudencës së Gjykatës së Lartë e cila duke bërë zbërthimin e kësaj dispozite është shprehur se:

*Gjëja e gjykuar shfaqet ne procesin civil ne dy trajta, ne ate formale dhe substanciale (materiale).*

*Gjëja e gjykuar ne kuptimin formal (res iudicata) kuptohet si nje gjendje juridike e ezaurimit te mjeteve procedurale te ankimit si dhe e ekzistences se prekluzivitetit lidhur me mundesine per t'u ankuar ndaj vendimit gjyqesor te formes se prere, pavaresisht nese vendimi i dhene ka disponuar ne lidhje me themelin apo ceshtje procedurale te shqyrtimit gjyqesor te mosmarreveshjes. Fuqia detyruese, pandryshueshmeria e vendimit gjyqesor lind ne castin kur ai ka marre forme te prere, pra qe nuk eshte me subjekt i procedurave te shqyrtimit gjyqesor dhe mjeteve te ankimit nga palet ndergjyqese.*

*Sipas nenit 451/a te K.Pr.Civile, autoriteti, fuqia e gjëse se gjykuar, ne kuptimin substancial, te vendimit gjyqesor te formes se prere percakton detyrueshmerine dhe pakundershtueshmerine e permbajtjes se vendimit te themelit te dhene nga gjykata, ne ate proces por edhe ne gjykime te tjera ne te ardhmen. Gjëja e gjykuar ne kuptimin substancial kuptohet si nje gjendje juridike jo thjesht pamundesie nga palet ndergjyqese te treguara ne vendimin gjyqesor te formes se prere per te rihapur shqyrtimin e ceshtjes, por edhe si nje e drejte e seciles prej tyre per te kundershtuar mundesine e rishikimit te zgjidhjes se dhene per konfliktin ne nje gjykim te ri (exceptio rei iudicatae).*

*Po keshtu, ne kuptimin substancial, autoriteti i gjësë së gjykuar ben qe vendimi gjyqesor i formes se prere, me te cilin vertetohen rrethanat dhe jepet zgjidhja perfundimtare e mosmarreveshjes, te jete i detyrueshem per palet ndergjyqese, trashegimtarët e tyre dhe ata qe terheqin te drejta prej tyre, sikurse edhe si nje mbeshtetje ligjore per te ndjekur proceduren e ekzekutimit te detyrueshem te ketij vendimi. Madje, ky detyrim per te patur parasysht perfundimet dhe urdherimet e vendimit te formes se prere eshte jo vetem per palet ndergjyqese por edhe per gjykatat ne gjykime te tjera te mevonshme, me objek padie dhe shkak ligjor tjetër.<sup>1030</sup>*

Parimet e mësipërme gjejnë trajtim edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, por duke u zbatuar me disa ndryshime të cilat kuptohet janë për shkak të veçantisë që ka gjykimi kushtetues në raport me gjykimin e zakonshëm. Kështu Gjykata në lidhje me këtë aspekt ka mbajtur qëndrimin se:

*Në të drejtën kushtetuese, res iudicata njihet si një nga tre format e efekteve që merr vendimi gjyqësor në procedurën abstrakte të kontrollit të kushtetutshmërisë së normave juridike. Në aspektin formal e procedural, gjë e gjykuar nënkupton përfundimin,*

<sup>1029</sup> K.Pr.C., neni 451/a: *Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshem për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Vendimi që ka marrë formë të prerë ka fuqi vetëm për çka është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohej përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe.*

<sup>1030</sup> Vendimi nr.484, datë 25.4.2006 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

*në drejtim të mosankueshmërisë së vendimit, ndërsa, në atë substancial, nënkupton fuqinë e detyrueshme të vendimit. Ky parim është i zbatueshëm jo vetëm ndaj palëve në gjykim, por edhe ndaj të gjitha autoriteteve publike brenda juridiksionit që janë të interesuara ose të përfshira në përmbajtjen e vendimit të gjykatës.*

*Tipar karakteristik i gjësë së gjykuar është se kur në vendimin e parë çështja e ngritur është konsideruar e pabazuar në themel, ajo nuk mund të shqyrtohet më tej. Në rastet kur nuk është shprehur pajtueshmëria kushtetuese e normës juridike, kërkuesi nuk ndalohet të bëjë përsëri të njëjtën kërkesë me motiv rishikimin e normës për pakushtetutshmëri. Kjo gjë varet nga pjesa arsyetuese e vendimit, sepse rrëzimi i kërkesës mund të jetë vendosur për shkaqe të tjera.<sup>1031</sup>*

Karakteristikë për parimin e *res judicata* është efekti prekluziv, në kuptimin se palët, sipas rastit dhe mundësisë, përmbahen nga efektet e gjësë së gjykuar të vendimit dhe ndalohen për të kërkuar nxjerrjen e një vendimi tjetër gjyqësor, i cili do të kundërshtojë përmbajtjen përfundimtare të vendimit të parë. Ky efekt e ndalon gjykatën të jap vendime mbi përmbajtjen identike që devijojnë nga vendimi që trajton gjënë e gjykuar.<sup>1032</sup>

Në aspektin procedural, Gjykata Kushtetuese ka konsideruar si gjë të gjykuar vendimet që ajo merr në Kolegji,<sup>1033</sup> Mbledhjen e Gjyqtarëve,<sup>1034</sup> apo në seancë plenare.<sup>1035</sup> Në këtë rast nëse kërkesa e re që paraqitet me të njëjtin objekt nuk ka shkaqe të reja atëherë ajo nuk merret në shqyrtim nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

Në planin substancial Gjykata Kushtetuese ka pranuar që të marrë në shqyrtim çështje apo akte të cilat kanë qënë shqyrtuar më parë prej saj por nga ana tjetër subjekti paraqet objekt të ndryshëm,<sup>1036</sup> shkaqe të reja,<sup>1037</sup> ose kur ka ndryshuar baza juridike e mosmarrëveshjes së zgjidhur më parë.<sup>1038</sup>

<sup>1031</sup> Vendimi nr.29, datë 21.12.2006 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>1032</sup> Sadushi, Sokol, "Drejtësia kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq.386.

<sup>1033</sup> Vendimi nr.72 datë 15.6.2012 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>1034</sup> Vendimi nr.37 datë 7.3.2013 i Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Vendimi nr.60 datë 28.12.2012 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>1035</sup> Vendimi nr.5, datë 6.3.2009 i Gjykatës Kushtetuese: *Gjykata Kushtetuese e çmon të bazuar argumentin e paraqitur nga subjektet e interesuara duke theksuar se pajtueshmëria e neneve 327/2 dhe 328 të KPP me Kushtetutën është marrë në shqyrtim nga kjo Gjykatë mbi bazën e një kontrolli incidental të inicuar nga Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda. Me vendimin nr.14, datë 16.07.2008, është vendosur se këto dispozita janë në përputhje me dispozitat përkatëse të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese i çmon kërkimet lidhur me këto dispozita si gjë të gjykuar duke lënë si objekt shqyrtimi veitëm nenin 329/1, pjesa e fjalisë "përveçse kur me vendim është deklaruar se fakti nuk ekziston" të KPP.*

<sup>1036</sup> Vendimi nr.28, datë 9.5.2012 i Gjykatës Kushtetuese, parag.15: *Gjykata vëren se me vendimin nr.32, datë 21.06.2010, i është dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit lidhur me pajtueshmërinë me Kushtetutën të neneve 68 dhe 71 të Kodit Zgjedhor, ndërkohë që me kërkesën objekt shqyrtimi asaj i është kërkuar të shprehet lidhur me dispozita të ndryshme nga ato të marra në shqyrtim në vendimin e mësipërm, konkretisht nenet 69, 70 dhe 87 të Kodit Zgjedhor. Edhe pse këto dispozita përfshihen në të njëjtin kapitull të Kodit Zgjedhor, në kushtet kur vendimi i mëparshëm nuk rezultoi të ketë pasur një efekt çfarëdo mbi dispozitat e kundërshtuara, ai nuk përbën asnjë pengesë të aspektit kushtetues. Për sa kohë që kërkuesit kanë paraqitur një kërkesë me objekt të ndryshëm, edhe pse për të njëjtat shkaqe dhe me të njëjtën bazë ligjore, Gjykata nuk ka asnjë pengesë ligjore për të marrë në shqyrtim këtë kërkesë.*

<sup>1037</sup> Vendimi nr.12, datë 21.3.2000 i Gjykatës Kushtetuese: *Është e vërtetë se Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 9, datë 30.11.1994 të saj është shprehur për kushtetutshmërinë e nenit 10 të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", mbi kërkesën e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste dhe për shkaqet e paraqitura, e ka rrëzuar këtë kërkesë. Por, ky fakt nuk do të thotë se jemi para gjësë së gjykuar. Megjithatë rregullat e gjësë së gjykuar vlejnë edhe për Gjykatën Kushtetuese, kjo e fundit është e detyruar të marrë*



Pavarësisht se në fillim jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese e ka konsideruar si shkak për të mos qenë përpara gjësë së gjykuar ndryshimi i subjektit kërkues, me kohën ajo ka hequr dorë nga kjo mundësi. Në jurisprudencën e saj Gjykata Kushtetuese, pavarësisht se subjekti ka qenë i ndryshëm, por objekti i kërkesës dhe shkaqet e paraqitura janë të njëjta me ato që janë shqyrtuar më parë nga Gjykata Kushtetuese atëherë ajo nuk pranon ta marrë në shqyrtim kërkesën pasi ndodhet përballë efektit të gjësë së gjykuar.<sup>1039</sup>

---

*në shqyrtim çdo çështje me të njëjtin objekt, pavarësisht se është shqyrtuar më parë, kur ndryshojnë subjektet dhe shkaqet e parashtruara dhe në rrethanat kur kërkesa është rrëzuar. Në rastin konkret, jo vetëm ka ndryshuar subjekti që është Shoqata "Barazi para Ligjit", por edhe shkaqet që kjo ka paraqitur për shfuqizimin e nenit 10 janë të tjera dhe shumë më të gjëra. Pra, duke ndryshuar subjekti dhe shkaku, Gjykata Kushtetuese nuk ka pengesë për të marrë në shqyrtim kërkesën e Shoqatës "Barazi para Ligjit".*

Vendimi nr.5, datë 2.3.2010 i Gjykatës Kushtetuese: Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr.102, datë 28.07.2008, ka vendosur moskalimin e çështjes në seancë plenare, për mungesë të shkaqeve që e bëjnë procesin të parregullt në kuptimin kushtetues. Më datë 06.04.2009, kërkuesi iu drejtua përsëri Gjykatës Kushtetuese, duke parashtruar një shkak të ri për shfuqizimin e vendimit të mësipërm të Gjykatës së Lartë.

<sup>1038</sup> Vendimi nr.29, datë 21.12.2006 i Gjykatës Kushtetuese: Nga shqyrtimi i pretendimeve të paraqitura, si në kërkesën e parë, ashtu edhe në të dytën, Gjykata Kushtetuese konstaton se midis tyre ka diferencë të theksuara në referimin të baza juridike, dispozitat e kundërshtuara dhe në shkaqet kushtetuese që parashtrohen. Vendimi i mëparshëm i kësaj gjykate nuk përbën asnjë pengesë të aspektit kushtetues, për sa kohë që kërkuesit kanë situar ndryshim si numrin e dispozitave ligjore që kundërshtohen, ashtu edhe argumentet për papajtueshmërinë e tyre me Kushtetutën dhe veçanërisht me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara. Në kërkesën e re objekt shqyrtimi, janë parashtruar shkaqe të reja që nuk janë shfaqur në vendimin e parë dhe që, për pasojë, nuk vepron parimi res judicata. Argumenti kryesor i kërkuesit mbështetet në faktin se të vendimi i mëparshëm i Gjykatës Kushtetuese nuk bëhet referencë në aktet juridike bazë që rregullojnë decentralizimin e pushtetit dhe autonominë vendore në fushën e planifikimit urban dhe të kontrollit të territorit, për arsye të miratimit të tyre nga ligjvënësi pas këtij vendimi. Për rastin në shqyrtim, Kuvendi i Shqipërisë, pas vendimit nr.2, datë 25.1.1999 të Gjykatës Kushtetuese, ka miratuar ligjin nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore", ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", si dhe ligjin nr.8927, datë 25.7.2002 "Për prefektin". Sidoqoftë, Gjykata Kushtetuese duke qenë e orientuar në kuptimin doktrinar që i jepet parimit res judicata mbam në vëmendje të veçantë edhe arsyet dhe shkaqet e përligjura dhe objektive të cilat diktojnë domosdoshmërinë e evoluimit të jurisprudencës kushtetuese dhe përshtatjen e saj me standardet demokratike bashkëkohore. Në këtë drejtim, është për t'u theksuar se Gjykata Kushtetuese, sipas nenit 131 shkronja "a" të Kushtetutës, ka jo vetëm të drejtën, por edhe detyrimin që, për arsye të ratifikimit të një marrëveshjeje ndërkombëtare, të jetë e lirë dhe të mos pengohet në ushtrimin e kompetencës së saj për të vendosur për pajtueshmërinë e ligjit me këtë marrëveshje ndërkombëtare. Në rastin në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese, pasi analizoi paralelisht të dyja kërkesat dhe veçanërisht qëndrimin që ajo ka shprehur në arsyetimin e vendimit nr.2, datë 25.1.1999 konkludon se qoftë në aspektin formal, ashtu dhe në atë substancial nuk ndodhemi përpara gjësë së gjykuar. Ndonëse të dy çështjet kanë ngjashmëri, këndvështrimi aktual i Gjykatës Kushtetuese është drejtuar nga shkaku i ndryshëm ligjor dhe kërkimet përfundimtare të kërkuesit që kanë të bëjnë me zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore dhe papajtueshmërinë e dispozitave ligjore me Kartën Europiane të Autonomisë Vendore.

<sup>1039</sup> Vendimi nr.27, datë 20.2.2013 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese, parag.8-9: 8. Kolegji vëren se kërkesa në shqyrtim, e paraqitur nga gjykata referuese, është e njëjtë në objekt dhe pretendime me kërkesën e paraqitur përpara Gjykatës nga Shoqata e Xhenierëve të Shqipërisë, në datën 16.01.2012. Gjykata i ka shqyrtuar këto pretendime nga pikëpamja kushtetuese dhe iu ka dhënë përgjigje në vendimin nr. 2, datë 18.02.2013. Në këtë vendim Gjykata, mbas analizës së pretendimeve, ndër të tjera, ka arritur në përfundimin se, megjithëse parimi i sigurisë juridike është prekur nga rregullimi i ri, kjo ndërhyrje është bërë duke respektuar kriteret kushtetuese për këtë qëllim të parashikuar nga neni 17/1 i Kushtetutës, konkretisht mbrojtjen e interesit publik, vendosjen e një raporti të drejtë midis së drejtës së cenuar dhe qëllimit që synohet të arrihet nëpërmjet ndërhyrjes legislative si dhe ruajtjen e thelbit të së drejtës për sigurim shoqëror (shih për më shumë vendimin nr. 2/2013 më sipër). 9. Në këto kushte, përderisa Gjykata ka vlerësuar kushtetueshmërinë e ligjit, objekt kërkese, dhe i ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura, Kolegji çmon se kërkesa nuk duhet të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

Duke qenë se gjëja e gjykuar bëhet e diskutueshme në rastet e cituara më sipër Gjykata kur rrezon kërkesën nuk duhet të pohojë pajtueshmërinë kushtetuese të normës, sepse nuk do të linte hapësirë për një rishqyrtim të kushtetutshmërisë së normës juridike në të ardhmen.<sup>1040</sup>

#### 5.4.2 Efekti *erga omnes*.

Efekti *erga omnes* në vendimet e Gjykatës Kushtetuese nënkupton shtrirjen e pasojave të tyre mbi të gjitha autoritetet publike, personat a subjektet e tjera të sistemeve ligjore të juridiksionit të brendshëm.<sup>1041</sup>

Doktrina bën dallimin midis efektit “*erga omnes*” dhe “*res judicata*” të vendimeve gjyqësore, pasi Gjykata Kushtetuese nuk është e lidhur me efektin e përgjithshëm, pasi ajo mund ta ndryshojë praktikën në një çështje analoge në të ardhmen dhe t’i jap praktikës një drejtim të ndryshëm. Përkundrazi, ajo nuk mund të rigjykojë një çështje që e ka gjykuar një herë në mënyrë definitive.<sup>1042</sup>

Duke iu referuar natyrës së gjykimeve kushtetuese, rezulton se vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë efekte “*erga omnes*” në ato raste kur gjykojnë kushtetutshmërinë e një ligji apo akti normativ. Në rastet e tjera si rregull efektet e vendimit të Gjykatës Kushtetuese kanë efekte *inter partes*. Në këtë mënyrë kur vendoset për antikushtetutshmërinë e një organizate apo partie politike, kur vendoset për procedurat *impeachment* ndaj disa funksionarëve të lartë, kur vendoset për kushtetutshmërinë e referendumeve apo për zgjidhjen e kërkesave të individëve për një proces të rregullt ligjor, efektet e vendimit janë *inter partes*.<sup>1043</sup>

Me një natyrë të veçantë paraqitet situata kur Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet e kompetencave midis organeve kushtetuese. Normalisht efektet e këtij vendimi, duke qenë një gjykim konkret dhe midis palëve në proces, duhet që të jenë vetëm *inter partes*.<sup>1044</sup> Është e kuptueshme që në ato raste kur mosmarrëveshja e kompetencave është

---

Vendimi nr.86, datë 12.7.2013 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese, parag.8-11: 8. Kolegji vëren se kërkesa në shqyrtim e paraqitur nga gjykata referuese, është e njëjtë në objekt dhe në pretendime me kërkesën e paraqitur përpara Gjykatës Kushtetuese nga Shoqata e Xhenierëve të Shqipërisë, në datën 16.01.2012. Gjykata Kushtetuese i ka shqyrtuar këto pretendime me vendimin nr.2, datë 18.02.2013. 9. Mbas analizës së pretendimeve, ndër të tjera, Gjykata ka arritur në përfundimin se, megjithëse parimi i sigurisë juridike është prekur nga rregullimi i ri, kjo ndërhyrje është bërë duke respektuar kriteret kushtetuese për këtë qëllim të parashikuar nga neni 17, pika 1, i Kushtetutës, konkretisht mbrojtjen e interesit publik, vendosjen e një raporti të drejtë midis së drejtës së cenuar dhe qëllimit që synohet të arrihet nëpërmjet ndërhyrjes legislative si dhe ruajtjen e thelbit të së drejtës për sigurim shoqëror. 10. Kolegji çmon se lidhur me çështjen konkrete, Gjykata Kushtetuese e ka vlerësuar kushtetutshmërinë e aktit të paraqitur nga gjykata referuese dhe u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura. 11. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkesa e paraqitur nuk duhet të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

<sup>1040</sup> Sadushi, Sokol, “Drejtesia kushtetuese në zhvillim”, Shtëpia Botuese “Toena”, Tiranë 2012, fq.385.

<sup>1041</sup> Po aty, fq.388.

<sup>1042</sup> Traja, Kristaq, “Drejtesia Kushtetuese”, Shtëpia Botuese “Luarasi”, Tiranë 2000.

<sup>1043</sup> Vendimi nr.205, datë 24.12.2001 i Gjykatës Kushtetuese: Këto veprime nuk janë të njëjtoja dhe nuk mund të konfundohen me rastet kur jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka konstatuar se Kolegjet e Gjykatës së Lartë në Dhomën e Këshillimit kanë mohuar ekzistencën e shkaqeve ligjore, ndërkohë që këto shkaqe kanë qenë prezente në dosje, duke cenuar në këtë mënyrë parimin e dëgjimit dhe të mbrojtjes, të cilat lidhen pajtueshmërisht me të drejtën e individëve për një proces të rregullt ligjor. Duke iu referuar jurisprudencës kushtetuese për çështje të ndryshme, si dhe qëndrimeve të mbajtura, të cilat vlerësohen për çdo rast konkret, pasi këto vendime kanë efekte *inter partes*, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të theksojë se nuk është qëllimi i saj të orientojë dhe të vërë detyra në një praktikë të saj më të konsoliduar për t’i dhënë kuptimin kushtetues të drejtës së individëve për një proces të rregullt ligjor.

<sup>1044</sup> Ruggeri, Antonio; Spadaro, Antonino, “Lineamenti di giustizia costituzionale”, Shtëpia Botuese “G. Giappichelli Editore”, Torino 2009, fq.266.

rezultat i një akti administrative individual apo një veprimi tjetër administrativ, ky lloj parashikimi përputhet plotësisht. Në këtë rast objekt i konfliktit është kompetenca konkrete, domethënë përkatësia ose jo e kompetencës së ushtruar me këtë akt specifik, në atë mënyrë specifike. Për rrjedhojë edhe një akt tjetër që ndërhyt në të njëjtën kompetencë nuk çënon parimin e gjësë së gjykuar. Një gjykim i ri i inicuar nga i njëjti organ kundër po të njëjtit organ do të ishte një gjykim i ndryshëm pasi i ndryshëm do të ishte edhe shkaku. Por është mëse e qartë që vendimi i mëparshëm i Gjykatës do të ishte një precedent autoritar, i cili do të shërbente për zgjidhjen përsëri të mosmarrëveshjes së krijuar.<sup>1045</sup>

Një situatë totalisht e ndryshme paraqitet kur kemi të bëjmë me mosmarrëveshje që buron nga akte normative (ligj apo akte nënligjore normative). Në praktikën tonë ka pasur raste kur Gjykata Kushtetuese ka zgjidhur konflikte të tilla dhe ka shfuqizuar norma ligjore.<sup>1046</sup> Por duke qenë se Kuvendi nuk ka qenë i thirrur në këtë proces duket sikur ai nuk e ka konsideruar veten të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me dispozitivin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Kuvendi përkundrazi miratoi një ligj tjetër nëpërmjet të cilit vendosi të shfuqizojë të njëjtat dispozita të cilat ishin shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj.<sup>1047</sup> Është e kuptueshme që një situatë e tillë nuk është aspak normale. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e normave ligjore është detyrues dhe i prodhon në mënyrë të menjëhershme efektet e saj. Por siç e kemi trajtuar edhe më sipër, një pjesë të përgjegjësive për këtë situatë mban edhe vetë Gjykata Kushtetuese e cila nuk kishte thirrur edhe Kuvendin si pjesëmarrëse në procesin kushtetues.

Pavarësisht kësaj problematike, jam i mendimit që vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese, kur zgjidh një mosmarrëveshje kompetencash e cila, ka për shkak të konfliktit norma juridike me karakter normativ, vendimi i saj ka efekte *erga omnes*. Në këtë rast shfuqizimi i aktit me karakter normativ vetiu do të sjellë pasoja edhe për subjektet e tjera (institucione shtetërore apo individë) të cilët nuk kanë qenë pjesë e këtij gjykimi.<sup>1048</sup> Është e kuptueshme që organi çënues nuk mund të nxjerri përsëri të njëjtin akt dhe për rrjedhojë të provokojë një gjykim të ri kushtetues, pasi në këtë rast me shfuqizimin e aktit normativ nga Gjykata Kushtetuese atij i mungon autorizimi për të vepruar në një mënyrë të caktuar.

Efekti "*erga omnes*" shtrihet vetëm për vendime në të cilat është pranuar kërkesa për shfuqizimin e ligji apo aktit normativ. Në rast se është vendosur rrëzimi i kërkesës atëherë nuk kemi efekt *erga omnes* pasi nuk përjashtohet mundësia për të kundërshtuar të njëjtin akt por për shkaqe të tjera. Përjashtim në këtë rast bëjnë vendimet e rrëzimit të kërkesës kur Gjykata Kushtetuese ka zbatuar teknikën e interpretimit pajtues. Në këtë rast vendimi ka fuqi "*erga omnes*".

---

<sup>1045</sup> Padula, Carlo, "Conflitti di attribuzione tra Stato e Regioni", botuar në "Le zone d'ombra della giustizia costituzionale - I giudizi sui conflitti di attribuzione e sull'ammisibilità del referendum abrogativo", botuar nga "Quaderni del "Gruppo di Pisa", nën kujdesin e Roberto Pinardi, Shtëpia Botuese "G.Giappichelli Editore", Torino 2007, fq.104-105.

<sup>1046</sup> Vendimi nr.29, datë 21.12.2006 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>1047</sup> Ligji nr. 9743, datë 28.05.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", të ndryshuar".

<sup>1048</sup> Ruggeri, Antonio; Spadaro, Antonino, "Lineamenti di giustizia costituzionale", Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2009, fq.266.



### 5.4.3 Efekti i forcës së ligjit.

Gjykata Kushtetuese shpeshherë ka mbajtur qëndrimin që vendimet e saj kanë forcën e ligjit.<sup>1049</sup> Kjo do të thotë që ato duhet të zbatohen dhe të respektohen në mënyrë të njëllojtë. Pra, vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, ashtu si edhe ligjet, janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha autoritetet shtetërore, subjektet e ndryshme ose dhe nga gjykatat brenda fushës së veprimtarisë së tyre, sa herë që u kërkohet që t'u përmbahen këtyre urdhërimeve.<sup>1050</sup>

Pavarësisht këtij efekti Gjykata Kushtetuese nëpërmjet vendimeve të saj ka vetëm të drejtën e shfuqizimit të akteve që shqyrton. Ky parashikim i drejtpërdrejtë kushtetues synonte të frenonte një praktikë të hershme të Gjykatës Kushtetuese e cila nëpërmjet vendimeve të saj ndryshonte normat ligjore, duke u kthyer praktikisht në një ligjvënës pozitiv.<sup>1051</sup> Duke parashikuar vetëm të drejtën e shfuqizimit të akteve nga Gjykata Kushtetuese ligjvënësi kushtetues ka parashikuar rolin e natyrshëm të kësaj Gjykate si një ligjvënës negativ.

Në lidhje me këtë efekt ka edhe një jurisprudencë të Gjykatës Kushtetuese përsa i përket ndryshimit të precedentëve të saj. Më konkretisht, Gjykata Kushtetuese në kuadër të një procesi të rregullt ligjor u njohu të drejtën edhe avokatëve të caktuar kryesisht në gjykimet penale të ushtrorë të drejtën e ankimit.<sup>1052</sup> Me pas Gjykata Kushtetuese, e ndryshoi qëndrimin e saj duke u shprehur se këta avokatë mund ta ushtronin të drejtën e ankimit vetëm nëse kishin tagra të plota nga i pandehuri.<sup>1053</sup> Në këtë rast lind për diskutim pyetja se çfarë bëhet me vendimet që kanë dhënë gjykatat e zakonshme bazuar në precedentin e parë të Gjykatës Kushtetuese? A janë ato antikushtetuese dhe për rrjedhojë mbi bazën e ankimit për proces të parregullt ligjor, Gjykata Kushtetuese duhet që t'i shfuqizojë ato? Gjykata Kushtetuese, ndryshimit të praktikës së saj nuk i ka njohur fuqi prapavepruese. Në këtë rast ajo ka vepruar sikur ndodhet përpara ligjeve duke i konsideruar të bazuara vendimet e gjykatave të zakonshme të cilat janë bazuar në precedentët e saj të vjetër, pavarësisht se ato ishin ndryshuar më pas. Me konkretisht i referohemi vetë arsytimit të kësaj Gjykate:

*Kërkesa konkrete drejtuar Gjykatës me pretendimin, midis të tjerash, për cenimin e të drejtës së mbrojtjes, si një nga komponentët e të drejtës për një proces të rregullt*

<sup>1049</sup> Vendimi nr.5, datë 7.2.2001 i Gjykatës Kushtetuese: Zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i garantuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila në nenin 132 dhe 145 të saj sanksionon shprehimisht këtë koncept kushtetues. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit.

<sup>1050</sup> Sadushi, Sokol, "Drejtësia kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq.390.

<sup>1051</sup> Vendimi nr.6, datë 26.8.1992 i Gjykatës Kushtetuese, pika 1 e dispozitivit: Paragrafi 2 i nenit 1 të ligjit nr.7575, datë 29.6.1992 të ndryshohet si vijon: "Kur qiramarrësi nuk pranon vendimin përkatës të organit ekzekutiv kompetent në rreth për dorëzimin e sipërfaqes të tepërt të banimit, ky organ nxjerr urdhër administrativ. Qiramarrësi ka të drejtë të anikohet kundër këtij urdhëri në gjykatën e rrethit përkatës brenda pesë ditëve nga data kur ai i është njoftuar. Vendimi i gjykatës se rrethit është i formës së prerë. Ankimi, që është bërë brenda afatit pesë ditor, pezullon zbatimin e urdhërit administrativ".

Vendimi nr.8, datë 18.9.1992 i Gjykatës Kushtetuese, pika 1 e dispozitivit: Fjalja e parë e paragrafit të katërt të nenit 14 të ligjit nr.7566, datë 25.5.1992 "Për armët" të ndryshohet si vijon: "Organet e policisë së rendit lejohen që pa miratimin paraprak të prokurorit të rrethit përkatës, të kryejnë kontrolle të personit ose të banesës vetëm në raste flagrante ose kur kanë të dhëna mjaftësisht të bazuara se ai mban pa leje armë, municione apo eksploziv. Menjëherë pas kryerjes së çdo kontrolli të tillë, e gjithësesi jo më vonë se 12 orë nga përfundimi i tij, organet e policisë detyrohen të njoftojnë prokurorin e rrethit përkatës për miratim".

<sup>1052</sup> Vendimi nr.5, datë 7.2.2001 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>1053</sup> Vendimi nr.30, datë 17.06.2010 i Gjykatës Kushtetuese.



*ligjor, është paraqitur pas datës 30.06.2010, e cila është data e hyrjes në fuqi të vendimit të ri interpretues, mbi bazën e të cilit janë përcaktuar standardet e reja dhe i është dhënë një kuptim i ndryshëm nenit 410/2 të KPP-së. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, me të drejtë, kanë pramuar mbrojtjen e interesave të kërkuarit, të deklaruar në mungesë, nga mbrojtësi i caktuar nga familjarët. Vendimet e këtyre gjykatave kanë qenë në përputhje me interpretimin që Gjykata i ka bërë përmbajtjes së nenit 410/2 të KPP-së, në lidhje me mbrojtësin e zgjedhur nga familjarët, përmes vendimeve të saj interpretuese përpara vitit 2010, ndaj mbi bazën e këtij arsyetimi, Kolegji e vlerëson këtë pretendim të kërkuarit haptazi të pambështetur.*<sup>1054</sup>

Gjykata në këtë rast, pranon që ka pasur një ndryshim të jurisprudencës së saj, por nga ana tjetër pranon se vendimet e gjykatave të zakonshme që janë dhënë përpara ndryshimit të jurisprudencës e cila duke mos pasur efekte prapavepruese nuk i bën të cënueshme ato.

#### **5.4.4 Efekti përfundimtar i vendimit.**

Kushtetuta përcakton se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare.<sup>1055</sup> Kjo mënyrë formulimi e shmang ndërhyrjen e organeve të tjera, qoftë edhe të Kuvendit, mbi natyrën përfundimtare të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.<sup>1056</sup> Në përgjithësi vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë zbatuar rregullisht por në ndonjë rast, Kuvendi ka refuzuar që të zbatojë vendimet e saj. Rasti më domethënës është reagimi i Kuvendit përpara vendimeve nr.75, datë 19.4.2002 dhe nr.76 datë 25.4.2002 të Gjykatës Kushtetuese. I pari është vendim për interpretim përfundimtar, kurse i dyti shqyrton respektimin procesit të rregullt ligjor. Në rastin e parë Gjykata interpretoi kushtet për shkarkimin e një sërë funksionarësh të lartë, ndërsa në rastin e dytë (bazuar tek i pari), Gjykata shfuqizoi vendimet e Kuvendit dhe të Presidenit për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm, pasi ishin marrë në shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Kuvendi, mbasi analizoi këto dy vendime gjyqësore doli me një vendim të tijin ku disponoi sa më poshtë:

*I. Të ngarkojë Komisionin e përhershëm të Imunitetit, Mandateve dhe Rregullores dhe Komisionin e përhershëm të Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjore për të përgatitur ndryshimet përkatëse në Rregulloren e Kuvendit, në lidhje me përmirësimet e procedurave të emërimit dhe të shkarkimit të funksionarëve të lartë të parashikuar në Kushtetutë, për t'u ndjekur e zbatuar në të ardhmen nga Kuvendi.*

*II. Në bazë të nenit 178 pika 2 të Kushtetutës, t'i kërkojë Këshillit të Ministrave të përgatisë dhe të sjellë sa më parë në Kuvend ndryshimet e nevojshme në ligjin nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".*

*III. Në bazë të nenit 28 të Rregullores së Kuvendit, njoftohet Këshilli i Ministrave për këtë vendim të Kuvendit.*

*IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*<sup>1057</sup>

<sup>1054</sup> Vendimi nr.84, datë 12.7.2012 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>1055</sup> Kushtetuta, neni 132, pikal.

<sup>1056</sup> Sadushi, Sokol, "Drejtesia kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq.392.

<sup>1057</sup> Vendimi nr.42, datë 6.6.2002 i Kuvendit "Për përfundimet e shqyrtimit të vendimeve nr.75, datë 19.4.2002 dhe nr.76, date 25.4.2002 të Gjykatës Kushtetuese".

Nga analiza e këtij vendimi rezulton se në pikën e parë të dispozitivit Kuvendi pranon nevojën për ndryshime në rregulloren e tij me qëllim që t'ia përshtasë konkluzioneve të Gjykatës Kushtetuese. Kjo tregon për një pranim të pjesshëm të vendimeve të Gjykatës. Pika e dytë e vendimit i kërkon Këshillit të Ministrave që të paraqesë një projektligj për ndryshime në LGJK. Në këtë rast Kuvendi bazohet në nenin 178, pika 2 e Kushtetutës, dispozitë e cila parashikon Këshilli i Ministrave i paraqet Kuvendit projektligjet e nevojshme për vënien në zbatim të kësaj Kushtetute.

Për sa më sipër, nuk rezulton qartë se çfarë synohet të arrihet nëpërmjet kësaj pike dhe se çfarë ndryshimesh duhej që të sillte Këshilli i Ministrave në lidhje me ndryshimet në LGJK. Situata mbetet më e errët për shkak se Këshilli i Ministrave nuk paraqit asnjëherë një projektligj në këtë drejtim.

Është fakt i njohur se Kuvendi nuk e respektoi kurrë detyrimin që buronte nga vendimi nr.76, datë 25.4.2002 i Gjykatës Kushtetuese për të rishqyrtuar edhe njëherë shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Doktrina e lidh këtë qëndrim me faktin se gjatë shqyrtimit në Gjykatën Kushtetuese, Kuvendi dhe Presidenti kishte emëruar një tjetër Prokuror të Përgjithshëm.<sup>1058</sup>

Një tjetër organ i cili ka refuzuar që të zbatojë vendimet e Gjykatës Kushtetuese ka qenë edhe Gjykata e Lartë. Kur Gjykata Kushtetuese shfuqizoi një vendim unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe e ktheu për rishqyrtim, Gjykata e Lartë mbajti një qëndrim refuzues duke konkluduar edhe njëherë në vendimin saj të mëparshëm.<sup>1059</sup> Por ky vendim u rrëzua përsëri nga Gjykata Kushtetuese, duke iu imponuar në këtë drejtim Gjykatës së Lartë.<sup>1060</sup> Kohët e fundit Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin që edhe vendimet që ajo merr në Mbledhjen e Gjyqtarëve janë detyruese dhe kanë karakter përfundimtar.<sup>1061</sup>

Megjithatë pavarësisht këtyre rasteve të izoluara, karakteri detyrues i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në përgjithësi nuk vihet në diskutim nga institucionet kushtetuese, gjyqësore apo administrative.

## 5.5 Fuqia e vendimeve gjyqësore.

Në doktrinë dhe jurisprudencë ka gjithmonë një debat në lidhje me momentin e prodhimit të pasojave të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese. Pra, efekti që ato kanë. Në Kushtetutë nuk ka asnjë parashikim të drejtpërdrejtë, por mund të nxirret me deduksion nga pika 2 e nenit 132 që përcakton se vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare. Duke qenë se vendimet hyjnë në fuqi në këtë moment, atëherë rezulton se nga ky moment si rregull, vendimet prodhojnë efekte, për rrjedhojë vendimet e Gjykatës Kushtetuese sjellin efekte vetëm për të ardhmen. Por LGJK në nenet 76, 77 dhe 79 të LGJK përcakton disa situata të tjera për efektet në kohë të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>1058</sup> Sadushi, Sokol, "Drejtesia kushtetuese në zhvillim", Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012, fq.393.

<sup>1059</sup> Vendimi nr.371, datë 27.10.2000 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

<sup>1060</sup> Vendimi nr.5, datë 7.2.2001 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>1061</sup> Vendimi nr.20, datë 1.6.2011 i Gjykatës Kushtetuese: *Nëse Gjykata ka çmuar se një shtetasi të caktuar i janë cenuar të drejtat e veta kushtetuese, siç ka bërë në vendimin e saj nr. 22, datë 09.03.2010, ky fakt nuk mund t'i nënshtrohet një procesi vlerësimi nga askush, aq më pak nga Gjykata e Lartë, e cila ka për detyrë të garantojë zbatimin korrekt të ligjit penal, procedural dhe material nga të gjitha gjykatat, në përputhje me Kushtetutën dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese.*

Në doktrinë flitet për dy lloje efektesh, *ex tunc* dhe *ex nunc*. Sipas efektit *ex tunc* vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi prapavepruese, për rrjedhojë ato e shfuqizojnë ligjin apo aktin normativ që nga fillimi, pra nga momenti që ai ka hyrë në fuqi. Ky lloj efekti nuk është i preferuar në legjisllacionin kushtetues. Kjo për shkak se shfuqizimi i një akti mund të bëhet edhe shumë kohë mbasi ai është miratuar. Kujtojmë që gjykatat, nuk janë të kufizuara nga asnjë afat për të inciuar një gjykim incidental kundër një ligji. Një aplikim i fortë i këtij efekti mundet që potencialisht të ketë pasoja serioze për shoqërinë dhe mund të rezultojë në një barrë të rëndë për buxhetin e shtetit, nëse shumë çështje duhet të rihapen, të cilat mund të datojnë shumë kohë më parë.<sup>1062</sup> Në këtë mënyrë shfuqizimi me efekt *ex tunc*, kombinuar me efektin *erga omnes* do të sillte si pasojë tronditjen e shumë marrëdhënieve juridike tashmë të konsoliduara. Pra në këtë rast do të kishim cënim të parimit të sigurisë juridike. Për këtë arsye si rregull preferohet efekti *ex nunc* i vendimeve gjyqësore. Sipas këtij efekti, shfuqizimi sjell pasoja vetëm për të ardhmen dhe nuk prek marrëdhëniet që tashmë janë krijuar dhe kanë sjelle efekte të plota. Kufizimi i efekteve të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese vetëm në çështjet e ardhshme dhe në çështjet ende për të cilat nuk ka përfunduar procesi me vendim të formës së prerë ka një avantazh nga pikëpamja e sigurisë juridike.<sup>1063</sup>

Dhënien e kësaj forme të efektit duket sikur ka zgjedhur edhe Kushtetuta jonë duke përcaktuar rregullin se vendimet e saj hyjnë në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe që është pasqyruar si rregull nga neni 76 pika 1 e LGJK.<sup>1064</sup> Ky rregull, i mos prekjes së marrëdhënieve juridike të konsoliduara dhe kur pasojat janë sjellë plotësisht, është respektuar edhe nga praktika gjyqësore. Kështu si Gjykata Kushtetuese, ashtu edhe gjykatat kanë refuzuar pranimin e kërkesave/padive të cilat janë ngritur në gjykatë mbasi Gjykata Kushtetuese kishte shfuqizuar një ligj.<sup>1065</sup>

Rast tjetër kur vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka efekte *ex nunc*, lidhet me shfuqizimin e Kuvendit për zgjedhjen e Presidentit të Republikës. Shfuqizimi i vendimit të Kuvendit bazuar në rregullimet e nenit 76 të LGJK, nuk ka fuqi prapavepruese. Pra, të gjitha aktet që ka marrë Presidenti gjatë ushtrimit të detyrës së tij që nga momenti që ka bërë betimin deri në momentin që u shfuqizua vendimi i Kuvendit do të quhen të vlefshme. Ky konkluzion bazohet edhe në jurisprudencën kushtetuese kosovare e cila në një rast të ngjashëm u shpreh si më poshtë:

<sup>1062</sup> Opinioni i Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) CDL-AD (2008)029 "Opinion on the draft laws amending and supplementing (1) The Law on Constitutional Proceedings and (2) the Law on the Constitutional Court of Kyrgyzstan", paragrafi 26.

<sup>1063</sup> Po aty.

<sup>1064</sup> LGJK, neni 76, pika 1: *Vendimi i Gjykatës Kushtetuese që ka shfuqizuar një ligj apo akt normativ si të papajtueshëm me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, si rregull sjell efekte juridike nga data e hyrjes së tij në fuqi.*

<sup>1065</sup> Vendimi nr.75, datë 22.10.2010 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese: *Kolegji gjithashtu thekson se lidhur me antikushtetutshmërinë e pjesës së dispozitës 329/1, pjesa e fjalisë "përveçse kur me vendim është deklaruar se fakti nuk ekziston" të KP, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.5, dt.06.03.2009, ka vendosur shfuqizimin e saj si antikushtetuese. Megjithatë rezultoni se gjykimet e themelit në të gjitha shkallët janë zhvilluar para hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, prandaj nuk mund të gjente zbatim për rastin konkret.*

Vendimi nr.1275, datë 3.7.2003 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë: *Duhet pasur parasysh se në rastin në shqyrtim rezultoni se vendimi i Komisionit të Pronave nr.5/1 mban datën 13.10.1993. Në baze të disponimit të këtij vendimi prona është rregjistruar që në atë kohë në pronësi të trashëgimtareve të ish-pronarit (të paditurve). Paditesja e ka pranuar këtë realitet dhe me datën 05.07.1996 ka lidhur për këtë pronë një kontratë që e ve në pozitën e qiramarreses. Ndërsa padinë e ngre fillimisht me datën 06.11.1998 dhe e ringre me datën 29.05.2000. Sa me lart, tregoni se për rastin në shqyrtim, pasojat e ligjit kanë qene të ezauruara para shfuqizimit të ligjit me vendim të Gjykatës Kushtetuese.*



*Sa i përket pyetjes së parë nëse Aktgjykimi i kësaj Gjykate ka efekt retroaktiv, përgjigja është se Aktgjykimi i kësaj Gjykate hyn në fuqi me efekt të menjëhershëm me 30 mars 2011 dhe se Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, i 22 shkurtit 2011, me nuk është në fuqi që nga 31 marsi 2011, që është data e publikimit të këtij Aktgjykimi në Gazetën Zyrtare.<sup>1066</sup>*

Pra, rezulton qartazi që vendimi hyn në fuqi me publikimin në Fletoren Zyrtare siç e kërkon edhe neni 132, pika 2 e Kushtetutës sonë dhe se nuk ka fuqi prapavepruese. E njëjta gjë vlen edhe në rast se shpallet pavleshmëria e zgjedhjes së një deputeti.

Pavarësisht këtij efekti, vetë LGJK parashikon një sërë rastesh kur vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka efekt *ex tunc* pra prapavepruese. Këto parashikohen në nente 76, pika 2, 77 dhe 79 të LGJK. Me konkretisht këto raste janë a) ndaj një dënimi penal edhe gjatë kohës që është në ekzekutim, nëse ai lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit ose të aktit normativ të shfuqizuar; b) ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk kanë marrë formë të prerë; ç) ndaj pasojave ende të paezauruara të ligjit apo aktit normativ të shfuqizuar; d) vendimet gjyqësore të shfuqizuara nga Gjykata Kushtetuese; dh) interpretimi përfundimtar i normave kushtetuese.

Duke i analizuar sipas rradhës rastet e mësipërme mund të themi se për rastin e parë, rezulton se vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka fuqi prapavepruese ndaj një dënimi penal edhe gjatë kohës që është në ekzekutim, nëse ai lidhet drejtpërsëdrejti me zbatimin e ligjit ose të aktit normativ të shfuqizuar. Në këtë rast nëse një person është dënuar dhe apo është duke vuajtur dënimin, vendimi i Gjykatës Kushtetuese që shfuqizon normën penale mbi bazën e së cilës është dënuar personi ka efekt vetëm për pjesën e mbetur të dënimit. Pra, në këtë rast personi nuk vuan pjesën që i ka mbetur nga dënimi i tij. Por duhet theksuar se vendimi i Gjykatës nuk ka efekt prapaveprues për pjesën e dënimit që personi ka vuajtur. Vendimi ka efekt prapaveprues sepse shuan efektet e një vendimi gjyqësor penal që gjykatat e zakonshme e kanë dhënë përpara se Gjykata Kushtetuese të japë vendimin e saj. Në këtë rast personi nuk mund të kërkojë shpërbllim dëmi për burgim të padrejtë për pjesën e vuajtur të dënimit. I njëjti konkluzion vlen edhe në rastin kur personi e ka vuajtur tërësisht dënimin dhe më pas Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar normën penale. Edhe në këtë rast personi nuk mundet të pretendojë se burgimi i tij ka qenë i padrejtë.

Në lidhje me rastin e dytë, rezulton se vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi prapavepruese ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk kanë marrë formë të prerë. Ky rast mund të shfaqet në dy situata të ndryshme. Situata e parë ka të bëjë me rastin kur gjykatat kanë ushtruar kontroll incidental ndaj një ligji. Në këtë rast si për gjykatën që ka ushtruar këtë kontroll ashtu edhe për gjykatat e tjera, që kanë në proces çështje që bazohen tek ai ligj, vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka fuqi prapavepruese dhe të gjitha gjykatat duhet që të marrin në konsideratë. Do të ishte *non sens* juridik që gjykatat e zakonshme të inicionin një gjykim të tillë nëse më pas vendimi i Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e ligjit nuk do të kishte asnjë pasojë për procesin gjyqësor. Pra, mund të themi që efekti *ex tunc* në disa raste i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese buron nga vetë normat kushtetuese. Në këtë këndvështrim duhet të shihen edhe rastet e tjera të fuqisë prapavepruese të vendimeve të Gjykatës. Situata e dytë është kur ligji apo akti tjetër normativ shfuqizohet për shkak të vënies në lëvizje nga

<sup>1066</sup> Sqarim i Aktgjykimin në rastin KO 29/11, datë 1.4.2011 i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, parag.10

subjekte të tjera të së drejtës. Edhe në këtë rast për çështjet gjyqësore që janë ende në proces vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka fuqi prapavepruese.

Efekt i prapaveprues në këtë rast justifikohet me faktin se gjykatat e zakonshme nuk duhet që të japin një zgjidhje antikushtetuese. Përderisa çështja është e papërfunduar dhe ende në proces atëherë gjykatat e zakonshme nuk mund të bazohen në një ligj i cili është shfuqizuar dhe deklaruar si antikushtetues. Në këtë drejtim duhet theksuar se vendimmarrja e gjykatave të zakonshme ka qenë e qëndrueshme.<sup>1067</sup>

Në praktikën tonë gjithsesi është shfaqur një situatë e cila e bën të diskutueshëm efektin prapaveprues të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese në këtë rast. Për të kuptuar më mirë situatën është e nevojshme që të analizojmë rastin në mënyrë sa më të plotë. Kuvendi, me datë 30.5.2013, Kuvendi miratoi ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", ku neni 72 i tij përcaktonte se ky ligj hyn në fuqi më 1 tetor 2013. Me datë 30.9.2013, Këshilli i Ministrave miratoi aktin normativ me fuqinë e ligjit nr.5/2013. Sipas këtij akti, fillimi i efekteve të ligjit fillonte gjashtë muaj mbas hyrjes së tij në fuqi dhe deri atëherë do të zbatohet legjislacioni i vjetër për shërbimin civil. Sipas kësaj rezultoi se ligji nr.152/2013 do të fillonte të zbatohet mbas datës 1.6.2014. Duke zbatuar ligjin e vjetër nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", në këtë kohë u bënë disa ndryshime në administratë e cila provokoi edhe një sërë padish përpara gjykatave administrative. Njëkohësisht vetë akti normativ me fuqinë e ligjit, i cili më pas ishte miratuar nga Kuvendi me ligjin nr.161/2013, u kundërshtua në Gjykatën Kushtetuese, e cila me vendimin nr.5, datë 5.2.2014, vendosi shfuqizimin e tij. Ky vendim u publikua në Fletoren Zyrtare nr.18, datë 26.2.2014, duke hyrë në fuqi në atë datë.

Çështja që në këtë rast shtrohet për diskutim ishte nëse vendimi i Gjykatës Kushtetuese do të kishte fuqi prapavepruese. Gjykatat administrative në këtë pikë qenë të ndara, ku disa gjyqtarë në zbatim të nenit 76, pika 2, gërma "b" e zbatonin vendimin e Gjykatës Kushtetuese me efekte prapaveprues dhe disa gjyqtarë jo. Por në përgjithësi tendenca ishte që ky vendim të

<sup>1067</sup> Vendimi nr.00-2010-193 (52), datë 2.2.2010 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë: *Duke qenë se vendimi i Gjykatës Kushtetuese që shfuqizon një ligj apo akt normativ si të papajtueshëm me Kushtetutën ka fuqi prapavepruese në këtë rast konkret, atëherë Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë çmon se vendimi i KRRTRSH është i pabazuar në ligj. Në këto rrethana, rezultoi se pala e paditur, Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, nuk ka diskrecion për të shfuqizuar vendimet e KRRT -ve të Bashkive, e në rastin konkret, nuk ka kompetencë ligjore për të shfuqizuar vendimet e KRRT-së të Rrethit Fier me nr.3, datë 09.06.2000 "Për miratimin e sheshit të ndërtimit për një objekt dy kate për qytetarin Spartak Lajthia, në territorin e lulishtes së qytetit Patos" dhe vendimit nr.4, datë 07.07.2000 "Për miratimin e lejes së ndërtimit të këtij objekti në favor të këtij shtetasi". Kolegji Civil çmon se vendimi nr.336, datë 20.03.2007 i Gjykatës së Apelit Tiranë duhet prishur dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjyqësor.*

Vendimi nr.00-2010-1414 (445), datë 7.12.2010 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë: *Nga ana tjetër, sipas nenit 76 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", vendimi i kësaj gjykate që shfuqizon një ligj si të papajtueshëm me Kushtetutën, si rregull sjell efekte juridike nga data e hyrjes në fuqi. Por këto vendime kanë fuqi retroaktive ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat derisa vendimet e tyre nuk kanë marrë formë të prerë. Në rrethana të tilla të posaçme, duke qenë përpara një çështje gjyqësore ende në gjykim, ndonëse mbahet parasysh se jemi në shqyrtimin e çështjes në aspektin juridiksional dhe jo të themelit, gjithësesi, gjykata e shkallës së parë, sikurse edhe vetë ky Kolegji Civil, nuk mund të mos marrin parasysh se dispozitat e ligjit, mbi të cilat është nxjerrë vendimi nr.1116, datë 17.10.2008 i të paditurit A.K.K.K.P. Tiranë, pikërisht me vetë nismën e tij (kruesisht), u shfuqizuan si dispozita të papajtueshme me Kushtetutën nga Gjykata Kushtetuese. Pikërisht, shfuqizimi në thelb i vetë kompetencës së një organi shtetëror, sikurse në çështjen objekt gjykimi, për të marrë nismë kruesisht dhe për të nxjerrë vendimin përkatës mbi një çështje, kërkesë a ankesë, bën të mos ekzistojë, si e pakuptimtë ligjërisht, edhe ndjekja e aq më tepër detyrueshmëria e ndjekjes së rrugës administrative të shqyrtimit të çështjes në hallka të tjera administrative si pasojë e atij vendimi të dhënë, duke u bazuar në një normë të shfuqizuar si e papajtueshme me Kushtetutën.*

zbatohet me efekt prapaveprues. Personalisht nuk jam i këtij mendimi. Në LGJK parashikohet se vendimet e saj sjellin efekte juridike nga data e hyrjes së tyre në fuqi. Përkrahimisht ligji i ka lejuar të drejtën vetë Gjykatës që në raste të veçanta të specifikuara në nenin 76, pika 2 të nxjerrë vendime me efekt prapaveprues. Në rastin konkret, siç do të arsyetohet dhe në vijim, nuk jemi përpara asnjërit nga rastet e parashikuara nga kjo dispozitë ku për më tepër vetë Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj, nuk është shprehur për fuqi prapavepruese të vendimit. Për rrjedhim vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk ka se si të çenojë fuqinë juridike të aktit që ka dalë përpara dhënies së vendimit.

Në doktrinë është pranuar ideja se vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqinë e ligjit. Në funksion të këtij prezumimi kemi të drejtë të arrijmë në konkluzionin se ashtu sikurse ligjet edhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk kanë fuqi prapavepruese. Ky argumentim mbeshtetet edhe në qëndrimin që ka mbajtur vetë Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj.<sup>1068</sup>

Të njëjtën përbajtje për fuqinë prapavepruese të ligjit e gjejmë edhe në pikën 2 të nenit 76 të ligjit aktual të Gjykatës Kushtetuese, për rrjedhim do të konkludojmë se fuqia prapavepruese e një ligji ashtu si dhe e një vendimi të Gjykatës Kushtetuese nuk mund të vijë, veçse për raste të përcaktuara shprehimisht në ligj dhe kur vetë Gjykata e thotë shprehimisht këtë.

Edhe nëse i referohemi doktrines rezulton se synimi i Gjykatës Kushtetuese nuk është për të shpallur antikushtetueshmërinë e normës, nga koha e nxjerrjes së saj, por nga një datë e caktuar, për të ardhmen. Edhe nëse i referohemi jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese vërejmë se në ato raste që vetë kjo Gjykatë ka dëshiruar që t'i japë fuqi prapavepruese vendimeve të saj, e ka bërë këtë duke përcaktuar shprehimisht në dispozitivin e vendimeve të veta. Kështu me vendimin nr.8, datë 21.5.1993 kjo Gjykatë në dispozitivin e vetë është shprehur si me poshtë:

*Shfuqizimin e neneve 1, 3, 4 e 5 të ligjit nr.7666 datë 26 janar 1993 "Për krijimin e komisionit për rivlerësimin e lejeve për ushtrimin e avokatisë", sepse vijne në kundërshtim me dispozitat e sipërcituara të ligjeve kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, si edhe rrjedhimisht anulimin e vendimeve me të cilat ky komision u ka hequr avokateve perkates lejen për ushtrimin e këtij profesioni.*

Në rastin e mësipërm, Gjykata Kushtetuese përveç shfuqizimit të ligjit është shprehur edhe për rregullimin e pasojave që kanë ardhur nga zbatimi i tij. Këtë rregullim nuk e gjejmë si në dispozitivin e vendimit nr.5, datë 5.2.2014, dhe as në pjesën arsyetuese të vendimit.

Referimi që bëhet nga gjykatat në gërmën "b" të pikës 2 të nenit 76, në këtë rast, mendoj se është i gabuar dhe nuk tregon një kuptim të qartë të dispozitës. Theksoj se kuptimi i drejtë i kësaj pike shihet i lidhur ngushtë me pikën 1 të nenit 76 që parashikon se vendimi i Gjykatës Kushtetuese "që ka shfuqizuar një ligj apo akt normativ si të papajtueshëm me Kushtetutën" ose me marrëveshjet ndërkombëtare, si rregull sjell efekte juridike nga data e hyrjes së tij në fuqi. Nga ana tjetër sipas së njëjtës dispozitë, pika 2 gërma "b", vendimi ka fuqi prapavepruese vetëm ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk kanë marrë formë të prerë.

<sup>1068</sup> Vendimin nr.9 datë 26.02.2007 i Gjykatës Kushtetuese: *Teoria e së drejtës pranon se fuqia prapavepruese zbatohet si përjashtim si për shembull në ligjet penale favorizuese, në ligjet që ndërhyjnë për të rregulluar me ligj situata të paligjshme të krijuara më parë, në ligjet që interpretojnë anët e errëta ose të paqarta të një ligji të mëparshëm e në ndonjë rast tjetër ku paraqitet domosdoshmëria për të shmangur pasoja të rënda, negative ose të pandreqshme. Në rastin në shqyrtim, nuk ka pasur situata të paligjshme ose të errëta apo me pasoja të tilla kaq të rënda.*



Nga formulimi dhe interpretimi i përbashkët i këtyre dispozitave rezulton qartësisht se që të jemi përpara rastit të parashikuar në gërmën "b" të nenit 76 duhet që vendimi i Gjykatës Kushtetuese të këtë shfuqizuar ligjin i cili ka qenë i zbatueshëm për çështjen konkrete. Duke e lidhur konkluzionin e mësipërm me rastin konkret, rezulton se, procedurat që kanë ndjekur institucionet e administratës shtetërore bazoheshin në ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe në aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij, ndërkohë që Gjykata Kushtetuese në dispozitivin e vendimit nr.5, datë 05.02.2014 është shprehur për "Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të aktit normativ të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 30.09.2013 "Për disa ndryshime në ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" dhe të ligjit të Kuvendit nr.161/2013 "Për miratimin e aktit normativ nr.5, datë 30.09.2013". Pra, rezulton qartësisht se Gjykata Kushtetuese nuk ka shfuqizuar ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij. Për rrjedhojë ky vendim nuk i shtrin efektet në çështjet në gjykim pasi për procedurat e kundërshtuara nuk është zbatuar akti normativ nr. 5, datë 30.09.2013 i Këshillit të Ministrave dhe ligji nr.161/2013, por siç e sqaruar më sipër një ligj tjetër.

Për rrjedhojë lidhja indirekte që bëhet është haptazi e pabazuar, pasi që të ndodheshim përballë gërmës "b" të pikës 2 të nenit 76 të LGJK ishte e domosdoshme që ligji i shfuqizuar si antikushtetues të ishte ligji nr.8549/1999 dhe jo akti normativ nr.5/2013 i Këshillit të Ministrave.

Për më tepër veprimet që janë kryer nga administrata në bazë të Ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe në aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij, kanë sjellë pasojat e tyre dhe nuk mund të preken nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese.

Në përfundim duhet specifikuar se kjo situatë zbatohet vetëm nëse ligji që është shfuqizuar ka qenë ai që zbatohet në çështjen konkrete. E theksojmë këtë fakt pasi siç e shpjegojmë më sipër, qëllimi i këtij parashikimi është që gjykatat e zakonshme për zgjidhjen e një çështjeje të mos bazohen në një ligj antikushtetues, por jo kur vetë ligji për zbatimin e çështjes nuk është deklaruar si i tillë nga Gjykata Kushtetuese.

Në lidhje me rastin e tretë, vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka fuqi prapavepruese ndaj pasojave ende të pazezuruara të ligjit apo aktit normativ të shfuqizuar. Rezulton se sipas këtij rasti nuk preken pasojat që tashmë kanë ardhur por vetëm pasojat që priten të vijnë në të ardhmen. Në këtë rast quhet se vendimi ka fuqi prapavepruese pasi prek një ligj i cili ka hyrë në fuqi përpara vendimit të Gjykatës Kushtetuese, por që ende nuk i ka sjellë pasojat e plota të tij.

Në lidhje me rastin e katërt, është mëse e kuptueshme që vendimet e Gjykatës që shfuqizojnë vendimet e gjykatave të zakonshme të kenë fuqi prapavepruese. Kjo për shkakun se ai vendim gjyqësor i shfuqizuar konsiderohet se nuk ka ekzistuar kurrë, përderisa Gjykata Kushtetuese e kthen çështjen për rigjykim. Në këtë situatë gjykata e zakonshme duhet që të dalë me një tjetër vendim përpara i përket çështjes.

Një problematikë paraqet çështja kur pranohet kërkesa dhe prishet vendimi i gjykatës së arbitrazhit. Në këtë situatë lind diskutimi se në cilin gjykatë, Gjykata Kushtetuese duhet që të riktheje çështjen për shqyrtim. Në doktrinën e huaj janë shfaqur këto pikëpamje. Pikëpamja e parë lidhet me faktin që me dhënien e vendimit gjykata e arbitrazhit e ka ezauruar mandatin e saj. Marrja e vendimit nga arbitrazhi, pavarësisht përmbajtjes së tij dhe fatit të mëtejshëm ligjor të tij, ka konsumuar marrëveshjen e arbitrazhit dhe për rrjedhojë nuk ka më asnjë bazë juridike sipas të cilit arbitrazhi do të mund të gjykojë mosmarrëveshjen përsëri mbasi vendimi i saj është shfuqizuar. Në këtë rast procedura e re e mosmarrëveshjes duhet t'i besohet gjykatës



shtetërore.<sup>1069</sup>

Sipas pikëpamjes së dytë, vendimi i gjykatës kushtetuese sipas të cilit vendimi i gjykatës së arbitrazhit është shfuqizuar, nuk prek vlefshmërinë e marrëveshjes për arbitrazh mbi bazën e të cilit krijohet arbitrazhi. Shfuqizimi i vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit nga Gjykata Kushtetuese nuk sjell përfundimin e marrëveshjes së arbitrazhit në përputhje me qëllimet e palëve kontraktuese. Në këtë mënyrë marrëveshja e arbitrazhit nuk është konsumuar për arritjen e një vendimi arbitrazhi, kështu që edhe procedura e re duhet të kryhet përpara gjykatës kompetente të arbitrazhit në përputhje me marrëveshjen e cila është ende në fuqi.<sup>1070</sup>

Sipas pikëpamjes së tretë fati i marrëveshjes së arbitrazhit mbas shfuqizimit të vendimit të arbitrazhit mund të lidhet me arsyet për të cilën vendimi i arbitrazhit u shfuqizua si edhe për përmbajtjen e vetë marrëveshjes së arbitrazhit. Gjykata Kushtetuese do të shfuqizojë marrëveshjen e arbitrazhit nëse çënon të drejtat dhe liritë kushtetuese të garantuara nga kërkuesit. Është e mundur që çënimi i të drejtave dhe liritë kushtetuese janë kryer nga gjykata e arbitrazhit në kryerjen e procedurave dhe marrjen e vendimit në kushtet e mosekzistencës apo mosefektivitetit të marrëveshjes së arbitrazhit, apo në marrjen e një vendimi i cili nuk ishte pjesë e objektit të marrëveshjes së arbitrazhit. Në këto raste nuk ka më bazë për krijimin e një gjykatë të re arbitrazhi për të gjykuar këtë mosmarrëveshje. Përkundrazi gjykata shtetërore do të jetë kompetente për shqyrtimin e kësaj mosmarrëveshjeje. Nëse gjykata e arbitrazhit ka vendosur bazuar në një marrëveshje arbitrazhi të vlefshme i cili aplikohet në të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga disa marrëdhënie juridike të veçanta kjo marrëveshje do të mbesë në fuqi. Nëse vendimi i arbitrazhit është shfuqizuar për arsye të cilat nuk lidhen me vlefshmërinë e vetë marrëveshjes së arbitrazhit atëherë marrëveshja e arbitrazhit do të jetë një bazë e vlefshme juridike për të formuar një gjykatë të re arbitrazhi për të njëjtën mosmarrëveshje.<sup>1071</sup>

Personalisht, bazuar edhe në qëndrimin që kam mbajtur, sipas së cilës Gjykata Kushtetuese mund të kontrollojë vlefshmërinë e marrëveshjes për arbitrazh, bashkohem me pikëpamjen e tretë të cituar më sipër.

Në lidhje me rastin e pestë, është e kuptueshme që vendimi që interpreton në mënyrë përfundimtare një normë kushtetuese të këtë fuqi prapaverpuese. Kjo për shkak se norma ka kohë që është në fuqi dhe vendimi interpretues tregon se si duhej të ishte kuptuar norma që në fillimin e saj, pra që nga momenti që ajo ka hyrë në fuqi.

Një diskutim që është shfaqur herët në doktrinë lidhet me faktin nëse, shfuqizimi i një ligji nga Gjykata Kushtetuese, sjell apo jo hyrjen në fuqi të normave të vjetra të shfuqizuara, nga ligji i cili tashmë u deklarua si antikushtetues. Në fillimet e saj doktrina kushtetuese në vendin tonë, është shprehur se në mënyrë të domosdoshme "ringjallet" ligji që ka ekzistuar para ligjit që është bërë objekt gjykimi e që është shfuqizuar. Kjo gjë bëhet vetvetiu, sepse duke u shfuqizuar ligji që u shqyrtua në mënyrë të vetëkuptueshme mbetet në fuqi ligji i mëparshëm.<sup>1072</sup> Po kështu një qëndrim të ngjashëm gjejmë edhe në fillimet e Gjykatës Kushtetuese Bullgare, ku sipas së

<sup>1069</sup> Momcinovic, Hrvoje, "Contesting the arbitration decision in the proceedings before the Constitutional Court according to the Croatian law", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të Demokracisë", botim i Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) Nr.15, ribotim 1998, fq.91.

<sup>1070</sup> Po aty, fq.91-92.

<sup>1071</sup> Po aty, fq.92.

<sup>1072</sup> Abdiu, Fehmi, "Kushtetuta dhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë", Shtëpia Botuese Redona 2001, Tiranë, Dhjetor 2000, fq.217.

cilës mbas shfuqizimit nga gjykata të një norme si antikushtetuese, norma origjinale behet efektive automatikisht.<sup>1073</sup>

Sipas një tjetër qëndrimi në doktrinë, ripërtëritja e fuqisë së ligjit të mëparshëm, me përjashtim të rasteve kur vetë ligji e parashikon shprehimisht, nuk është një metodë e përhapur në teknikat legjislative dhe as në jurisprudencën kushtetuese shqiptare. Ringjallja *ex lege*, mbetet një çështje e diskutueshme në fushën e drejtësisë kushtetuese, për aq kohë sa Gjykata Kushtetuese, nëse shprehet për rikthimin e vlefshmërisë juridike të ligjit të mëparshëm, i jep vetës kompetenca *quasi-legjislative*.<sup>1074</sup>

Personalisht bashkohem me mendimin e dytë, pasi në këndvështrimin personal shfuqizimi i një ligji nuk sjell hyrjen në fuqi të normave të “vjetra”. Në rradhë të parë vetë Hans Kelzen si ideatori i krijimit të Gjykatës Kushtetuese si institucion dhe i drejtësisë kushtetuese si proces ka qenë i mendimit që anulimi i një ligji nuk prodhonte rilindje të ligjit të vjetër të shfuqizuar nga ligji përkatës.<sup>1075</sup> Sipas nenit 132 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese ka vetëm të drejtën e shfuqizimit të akteve që shqyrton. Ky parashikim do të thotë që Gjykata Kushtetuese, në rolin e ligjvënës negativ, ka vetëm të drejtë që të shfuqizojë norma juridike dhe jo të miratojë apo të sjellë norma të tjera në fuqi. Kuvendi me miratimin e një ligji, shpreh njëkohësisht qëndrimin e tij për shfuqizimin e normave të tjera, të “vjetra”. Duke qenë se ligji mund të bëhet objekt gjykimi vetëm mbas miratimit të tij nga Kuvendi, mund të themi se ligji, objekt gjykimi, pasojën e tij tashmë e solli përse i përket shfuqizimit të normave të “vjetra”. Për pasojë Gjykata Kushtetuese, si ligjvënës negativ nuk mundet që t’i sjellë ato në fuqi. Në favor të këtij argumenti është edhe parashikimi i nenit 78 të LGJK-së sipas të cilit kur Gjykata Kushtetuese konstaton se nga shfuqizimi i ligjeve ka nevojë për rregullim juridik të ri, njofton organet përkatëse dhe konkretisht Kuvendin. Në rast se do të ktheheshin normat e “vjetra” në fuqi, atëherë kuptohet që nuk do të kishte boshllëk legjislativ dhe për rrjedhojë nuk do të kishte nevojë edhe për një rregullim të ri juridik. Në këtë rast nenit 78 i LGJK do të mbetej pa kuptim.

Në mbështetje të këtij argumenti vjen edhe vetë jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese. Kështu Kuvendi miratoi ligjin nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”. Me nenin 1 të ligjin nr.9260, datë 15.7.2004, ndryshoi nenin 9 të ligjit ekzistues. Rregullimi i ri ligjor u bë objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese e cila mbasi konstatoi antikushtetutshmërinë e kësaj dispozite u shpreh:

*Përse më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzionin se neni 1 i ligjit nr.9260, datë 15.07.2004 duhet të shfuqizohet si antikushtetues, pasi në përmbajtjen e tij ka një sërë pasaktësisht e paqartësisht, sqarimi i të cilave është mëse i domosdoshëm për kuptimin dhe zbatimin e drejtë të tij në praktikë.*

*Me shfuqizimin e kësaj dispozite krijohet boshllëk ligjor, prandaj i rekomandohet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë që në bazë edhe të këtij vendimi, të ndër marrë hapat e nevojshëm në këtë drejtim.*<sup>1076</sup>

<sup>1073</sup> Schwartz, Herman, “The struggle for constitutional justice in post-communist Europe”, Shtëpia Botuese “The University of Chicago Press”, Chicago 2000, fq.178.

<sup>1074</sup> Sadushi, Sokol, “Drejtësia kushtetuese në zhvillim”, Shtëpia Botuese “Toena”, Tiranë 2012, fq.241-242.

<sup>1075</sup> Berberi, Sokol, “Ligjvënësi dhe kontrolli kushtetues”, botuar në Revistën “Avokatia”, nr.14, botim i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Shtëpia Botuese “Kumi”, Tiranë, Prill 2015, fq.17

<sup>1076</sup> Vendimi nr.34, datë 20.12.2005 i Gjykatës Kushtetuese.

Në këtë rast rezulton se sipas Gjykatës Kushtetuese, shfuqizimi i dispozitës së re, nuk solli automatikisht në fuqi rregullimin e vjetër. Përkundrazi Gjykata Kushtetuese e konsideroi se tashmë jemi përpara një boshllëku legjislativ dhe për rrjedhojë duhej njoftuar Kuvendi për të marrë masat e nevojshme.

Një tjetër argument që mund të përdoret me analogji na vjen nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese Italiane në rastin e gjykimit të kushtetutshmërisë së kërkesave për referendum shfuqizues. Në çdo rast Gjykata Kushtetuese Italiane ka mbajtur qëndrimin se shfuqizimi i një ligji nëpërmjet një referendumi nuk sjell si pasojë hyrjen në fuqi të normave të “vjetra” që ekzistonin përpara miratimit të ligjit që i nështruhej referendumit. Jam i mendimit që i njëjti arsyetim vlen edhe për ligjet që shfuqizohen nga Gjykata Kushtetuese.<sup>1077</sup>

## 6. Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Përsa i përket ekzekutimeve të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, Kushtetuta kufizohet vetëm në deklarimin se ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme,<sup>1078</sup> ndërsa LGJK i kushton vetëm një dispozitë ekzekutimit të këtyre vendimeve.<sup>1079</sup>

Pika 1 e kësaj dispozite është me karakter deklarativ. Ajo vetëm thekson detyrueshmërinë e zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Pika e dytë e dispozitës është më konkrete. Ajo ngarkon Këshillin e Ministrave si organin i cili duke pasur edhe mbështetjen e aparatit administrativ, ka detyrimin që të realizojë ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Kjo do të thotë që në çdo rast që Gjykata Kushtetuese nuk shprehet në lidhje me organin që bën ekzekutimin e vendimit të saj i takon Këshillit të Ministrave që të veprojë kryesisht. Megjithatë shpeshherë për shkak të natyrës së vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese, Këshilli i Ministrave nuk ka se çfarë të ekzekutojë. Kështu nëse i referohemi vendimeve që merren për shfuqizimin e një ligji apo akti tjetër normativ, vendimi i Gjykatës Kushtetuese hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe akti konsiderohet se ka humbur fuqinë e tij juridike. Edhe në gjykimin kushtetues për kontrollin e marrëveshjeve ndërkombëtare, Kuvendi ka detyrimin për të mos ratifikuar një marrëveshje të deklaruar si antikushtetuese. Siç mund të konstatohet detyrimi i Kuvendit është pasiv, pra të mos veprojë.

Situata mund të ndryshojë në rastin e mosmarrëveshjes së kompetencave midis pushteteve të ndryshme. Në këtë rast i takon organit që është gjendur në shkelje që të veprojë ose mos veprojë në një mënyrë të caktuar. Megjithëse ky organ mund të jetë edhe Këshilli i Ministrave, përsëri, organi që duhet ta ekzekutojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese përcaktohet nga arsyetimi i vendimit dhe jo në çdo rast është Këshilli i Ministrave.

Një situatë e vështirë në ekzekutim paraqitet kur Gjykata Kushtetuese është shprehur me vendim deklarativ për antikushtetutshmërinë e mosushtimit të kompetencës nga një organ i caktuar. Duke zbatuar parashikimet nenit 81, pika 3 të LGJK, Gjykata Kushtetuese, mund të përcaktojë edhe mënyrën se si organi duhet që ta ekzekutojë vendimin e saj. Këtu përfshihen si

<sup>1077</sup> Zagrebelesky, Gustavo; Marceno, Valeria; “*Giustizia costituzionale*”, Shtëpia Botuese “il Mulino”, Bologna 2012.

<sup>1078</sup> Kushtetuta, neni 132, pika 1.

<sup>1079</sup> LGJK, neni 81: 1. *Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për zbatim.* 2. *Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese sigurohet nga Këshilli i Ministrave me anën e organeve përkatëse të administratës shtetërore.* 3. *Gjykata Kushtetuese mund të caktojë vetë një organ tjetër që ngarkohet me zbatimin e vendimit të saj dhe, kur është e nevojshme, edhe mënyrën e ekzekutimit të tij.* 4. *Personat që nuk zbatojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese ose pengojnë zbatimin e tyre, kur veprimi nuk përbën vepër penale, dënohen me gjobë deri në 100 mijë lekë nga kryetari i Gjykatës Kushtetuese, vendimi i të cilit është i formës së prerë dhe përbën titull ekzekutiv.*



veprimet administrative që duhet të kryejë, ashtu edhe afatet për kryerjen e tyre. Pas vendimit është detyrë e këtij organi që të veprojë në përputhje me vendimin dhe konkluzionet e shprehura nga Gjykata në dispozitivin dhe pjesën arsyetuese të vendimit.

Por përsëri mund të lind një tjetër problematikë. Çfarë ndodh në rast se pavarësisht vendimit të Gjykatës Kushtetuese, organi i cili nëpërmjet mosveprimit të tij, ka shkaktuar cënimin e kompetencave të organit tjetër, përsëri nuk vepron? Është e kuptueshme që zhvillimi i një gjykimi tjetër kushtetues në këtë rast nuk do të kishte asnjë kuptim, pasi mosmarrëveshja në këtë rast përbën *res judicata*. Një zgjidhje do të ishte që Kryetari i Gjykatës Kushtetuese duke zbatuar nenin 81, pika 4 e LGJK të caktojë një gjobë ndaj titullarit të institucionit. Pavarësisht kësaj, jam i mendimit që caktimi i gjobës nuk është një mjet efektiv për arritjen e qëllimit. Mundësitë e diskutuar nga doktrina në këtë rast janë dy.<sup>1080</sup> Mundësia e parë është që me kalimin e afatit organit të cilit i është cënuar kompetenca nga mosveprimi i organit tjetër, mund të sillët sikur ky veprim tashmë është realizuar mbas kalimit të afatit të vendosur nga Gjykata Kushtetuese. Kjo mundësi zgjidhjeje megjithatë është përsëri problematike. Kështu në Kushtetutë, mundësia e një organi për të vepruar, rezulton që të vijë nga e drejta që një tjetër organ për të propozuar kandidatura për një pozicion të caktuar. Si shembull janë e drejta e Presidentit për të emëruar anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë dhe e drejta e Kuvendit për të dhënë ose jo pëlqimin në lidhje me to. Në këtë rast nëse nuk kemi propozime të tilla organi tjetër kurrësesi nuk mundet që këto kandidatura ti gjej vetë. Mundësia e dytë është që vetë Gjykata Kushtetuese me kalimin e afateve të përcaktuar prej saj të nxjerrë ajo vetë një vendim, i cili zëvendëson aktin administrativ që duhet të nxirte organi mosveprues. Kjo zgjidhje e propozuar duket sikur gjen edhe një mbështetje ligjore. Kështu Gjykata Kushtetuese, duke zbatuar nenin 1, pika 2 të LGJK dhe nenin 67, pika 1 të LGJA, mbi bazën e kërkesës së palëve, mundet që në një dhomë këshillimi, pa praninë e palëve, nëse gjatë shqyrtimit gjyqësor ka konstatuar se janë vërtetuar të gjitha faktet e nevojshme për nxjerrjen e aktit, të mund të marrë një vendim, që zëvendëson aktin administrativ, i cili prodhon të gjitha pasojat e nevojshme juridike.

Kjo zgjidhje mëse e pelqyeshme, megjithëse kërkon një kurajo të fortë nga ana e Gjykatës Kushtetuese, përsëri në disa aspekte mund të jetë problematike. Kështu në doktrinë është pranuar që i vetmi rast i shfaqur i një mosmarrëveshje negative midis organeve kushtetuese, ka qenë kur Kuvendi, në kundërshtim me parashikimet e Kushtetutës<sup>1081</sup> nuk u shpreh në lidhje me dekretet e Presidentit për emërimin e disa ministrave. Në atë kohë Presidenti, zgjodhi një rrugë tjetër të zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke kërkuar interpretimin e nenit 98 të ligjit themelor në kuadër të një gjykimi abstrakt për interpretimin përfundimtar të Kushtetutës. Pavarësisht kësaj rruge dhe zgjidhjes që dha Gjykata Kushtetuese në atë rast, pra që edhe me kalimin e afatit 10 ditor, Kuvendi nuk shkarkohet nga përgjegjësia për t'u shprehur në lidhje me dekretet e Presidentit, përsëri këto dekrete mbetën pa përgjigje nga ana e Kuvendit. Duke iu referuar zgjidhjes së propozuar me sipër do të duhej që Gjykata Kushtetuese në këtë rast të nxirte një vendim i cili do të zëvendësonte aktin e Kuvendit për miratimin ose jo të dekretëve të Presidentit. Është e kuptueshme që në këto raste kjo zgjidhje nuk funksionon. Miratimi ose jo nga Kuvendi i dekretëve të Presidentit është një akt me natyrë politike dhe për rrjedhojë nuk mundet që të zëvendësohet me një vendim nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Për më tepër që neni

<sup>1080</sup> Ruggeri, Antonio; Spadaro, Antonino, "Lineamenti di giustizia costituzionale", Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2009, fq.267.

<sup>1081</sup> Neni 98 i Kushtetutës: 1. Ministri emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të Kryeministrit, brenda 7 ditëve. 2. Dekreti shqyrtohet brenda 10 ditëve nga Kuvendi.

66, pika 1 e LGJA bën fjalë për nxjerrjen e një vendimi gjyqësor që zëvendëson një akt administrativ dhe jo një akt politik. Pra edhe kjo bazë ligjore nuk mundet të veprojë në këto raste. E njëjta situatë vlen edhe për aktet normative. Nuk mundet kurrësesi që Gjykata Kushtetuese si një ligjvënës negativ të nxjerrë një vendim që të zëvendësojë një ligj apo një akt normativ nënligjor.

Nga sa më sipër jam i mendimit që në rastin e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese e cila ka zgjidhur një mosmarrëveshje kompetencash negative, Gjykata Kushtetuese mund të marrë vendim që zëvendëson aktin administrativ vetëm në ato raste kur ka zgjidhur një mosmarrëveshje midis organeve kushtetuese por me natyrë administrative. Siç e kemi trajtuar më sipër shumica e mosmarrëveshjeve sot para Gjykatave Kushtetuese kanë natyrë administrative por me kusht që kompetenca kryesore të jetë parashikuar në Kushtetutë megjithëse në mënyrë të përgjithshme. Në rastin e akteve të tilla me natyrë politike apo normative, Gjykata Kushtetuese me përjashtim të konstatimit të mosveprimit të një organi kushtetues, sipas mendimit tim, nuk mundet që të veprojë më tej.

Këshilli i Ministrave mund të quhet organ zbatues edhe në rastet kur deklarohet antikushtetues një parti/organizatë politike. Në këtë rast ai duhet të veprojë për të ndaluar veprimtarinë e këtyre grupimeve. Është e nënkuptuar që një parti/organizatë e deklaruar si antikushtetuese, nuk mundet që të ushtrojë aktivitetin e saj si edhe të rikrijohet me emër apo në ndonjë formë tjetër, pavarësisht se në këtë rast nuk ka një qëndrim të shprehur ligjor. Në rast se partia/organizata politike rikrijohet dhe vazhdon veprimtarinë e saj në formën e një subjekti tjetër, atëherë në këtë rast duhet që për ndalimin e saj të zhvillohet një tjetër gjykim kushtetues mbi bazën e kërkesës së subjekteve të interesuara. Në këtë rast kërkuesi duhet të provojë ekzistencën e skemës për të shmangur dhe anashkaluar zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.<sup>1082</sup>

Kushtetuta dhe legjislacione të ndryshme përgjegjësinë e pjesëmarrjes në partitë/organizatat politike të konstatuara si antikushtetuese e zgjidhin në forma të ndryshme. Kështu në Gjermani nëse kërkesa pranohet, Gjykata Kushtetuese urdhëron sekuestrimin e të gjitha pasurive të partisë politike dhe heqjen e mandatit të deputetit ose të zgjedhurve vendorë që i përkasin kësaj force politike.<sup>1083</sup> Në Kili, personave përgjegjës për deklarimin antikushtetues të partisë politike u hiqet mandati nëse janë të zgjedhur si përfaqësues në parlament apo në organet vendore, ose shkarkohen nga funksionet e tyre në rast se ndodhen në pozicione ekzekutive. Ky ndalim vlen për pesë vjet (dhjetë vjet në rast përsëritje) dhe për këta persona ndalohet rehabilitimi.<sup>1084</sup> Në Turqi, me ndryshimet e fundit legjislative është vendosur që në rast se shkelja nuk është e një shkalle të lartë, të vendosen edhe masa të tjera si përgjysmimi i përfitimeve financiare nga ana e shtetit. Por në rast të deklarimit antikushtetues, pasuritë e partisë politike sekuestrohen në favor të shtetit dhe njëkohësisht u hiqet mandati i deputetit personave që me veprimet dhe deklaratat e tyre kanë sjellë si pasojë antikushtetutshmërinë e partisë politike.<sup>1085</sup>

<sup>1082</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Spanjolle nr.62, datë 5.5.2011, marrë nga CODICES e Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Vencias) regjistruar me numër 2011-2-010.

<sup>1083</sup> Palermo, Francesco, "La giustizia costituzionale in Germania", botuar në "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale", botim nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova 2009, fq.166.

<sup>1084</sup> Po aty, fq.554

<sup>1085</sup> Carducci, Michele, "Il sistema di giustizia costituzionale della Turchia", botuar në "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale", Vëllimi II, botim nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova 2011, fq.300.

Në Shqipëri si Kushtetuta, ashtu edhe LGJK nuk parashikojnë asnjë pasojë për personat përgjegjës për deklarimin antikushtetues të partisë/organizatës politike dhe për pasurinë e saj. Megjithatë pasoja të tilla lindin nga ligje të tjera. Kështu personat përgjegjës për krijimin apo veprimtarinë antikushtetuese të partisë/organizatës politike mund të deklarohen fajtor nga gjykatat e zakonshme në bazë të nenit 224 të Kodit Penal që parashikon si vepër penale krijimin e partive dhe të shoqatave antikushtetuese. Sipas kësaj dispozite personat përgjegjës mund të dënohen me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet dhe në rast përsëritjeje me burgim nga një gjer në pesë vjet. Nga kjo përgjegjësi penale nuk bëjnë përjashtim asnjë subjekt, përfshirë deputetë, funksionarë të lartë, apo edhe anëtarë të thjeshtë. Në rast se deputetë, të zgjedhur vendor apo funksionarë të tjerë të lartë deklarohen fajtor në bazë të kësaj norme penale atëherë në bazë neneve 71, pika 2, shkronja "dh", nenit 115 të Kushtetutës, mandati i tyre do të konsiderohet si i përfunduar. Për më tepër në bazë të neneve 30 dhe 35 të Kodit Penal këta persona mund të dënohen edhe me dënimin plotësues të heqjes të së drejtës për të ushtruar funksione publike.

Përsa i përket problemit të pasurisë së partisë apo organizatës politike mendoj se në këtë rast gjen zbatim nenit 36/a i K.P. i cili parashikon konfiskimin e detyrueshëm nga gjykata dhe ka të bëjë me marrjen dhe kalimin në favor të shtetit të sendeve që kanë shërbyer ose janë caktuar si mjete për kryerjen e veprës penale. Duke qenë se partitë/organizatat politike kishin si qëllim realizimin e një prej ndalimeve kushtetuese, atëherë edhe pasuria e luajtshme apo e paluajtshme e këtij subjekti që ka shërbyer ose do të shërbente për arritjen e këtij qëllimi, duhet të sekuestrohet. Por këto masa merren nga prokuroria vetëm mbas vendimit të gjykatës së zakonshme që merr formë të prerë.

Edhe në gjykimet e tjera roli i Këshillit të Ministrave është përgjithësisht i kufizuar. Kështu mund të themi edhe për procesin e rregullt ligjor, si rregull janë gjykatat e zakonshme ato që detyrohen për zbatimin e vendimeve të Gjykatës. Por situata ndryshon kur kemi të bëjmë me konstatimin e mos ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Në këtë rast Këshilli i Ministrave ka mundësinë dhe detyrën për të vepruar, nëpërmjet zyrave të përmbarimit që janë institucion i administratës shtetërore.

Pika e tretë e dispozitës, synon që ta bëjë më konkrete ekzekutimin e vendimit. Në këtë rast Gjykata mund të caktojë një tjetër organ për zbatimin e vendimit të saj në varësi të natyrës së çështjes dhe madje kur është e mundur dhe mënyrën e zbatimit të vendimit. Kjo mundësi rezulton që të jetë zbatuar vetëm një herë nga Gjykata Kushtetuese. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese, duke shfuqizuar vendimet gjyqësore me karakter penal, kërkoi edhe lirimin e të kërkuesit që mbahej i burgosur për shkak të këtyre vendimeve.<sup>1086</sup> Nga ana tjetër, Gjykata Kushtetuese ka refuzuar kryerjen e veprimeve të ndryshme procedurale, për rikthimin e palëve në gjendjen e mëparshme në rast se shfuqizonte vendimet gjyqësore që ishin ekzekutuar, me arsyetimin se ajo ka vetëm të drejtën e shfuqizimit të akteve që shqyrton.<sup>1087</sup>

Problematike paraqitet edhe situatë për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese kur konstatojnë cënimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Kështu teorikisht duke qenë së

<sup>1086</sup> Vendimi nr.33, datë 24.5.2000 i Gjykatës Kushtetuese: *Sipas nenit 77 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", vendimet e gjykatave të çdo shkalje, të cilat shfuqizohen nga Gjykata Kushtetuese, nuk kanë fuqi juridike që nga çasti i marrjes së tyre. Në këto rrethana, duhet të urdhërohet lirimi i të gjykuarit nga burgju. Për realizimin e këtij detyrimi ligjor, në bazë të pikës 3 të nenit 81 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000, ngarkohet Prokurori i Përgjithshëm, i cili do të veprojë në bazë të neneve 67, 68 dhe 69 të ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim", ku parashikohet se lirimi i të dënuarve bëhet në bazë të ligjit, në rastin konkret me urdhër të prokurorit.*

<sup>1087</sup> Vendimi nr.16, datë 19.4.2013 i Gjykatës Kushtetuese.



Gjykata Kushtetuese nuk shprehet për organin e ngarkuar për zbatimin e vendimeve të saj duhet që Këshilli i Ministrave të marrë masa për zbatimin e tij, por që në praktikë një gjë e tillë ka ndodhur në pak raste. Në lidhje me këtë problematikë në vende të tjera Gjykatat Kushtetuese, të cilat kanë përfshirë në konceptin e procesit të rregullt ligjor edhe të drejtën për të zbatuar vendimet gjyqësore përfundimtare, kërkojnë edhe marrjen e masave shtrënguese të caktuara.<sup>1088</sup> Pra, realizimi i të drejtës së kërkuarit do të varet gjithsesi në rradhë të fundit nga funksionimi i hallkave që pasojnë gjykimin kushtetues.<sup>1089</sup> Është e kuptueshme që çdo vonesë në ekzekutimin e vendimit sjell si pasojë rëndimin e mëtejshëm të pozicionit të gjyqfituesit. Në këtë drejtim, mundësia për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, për të konstatuar shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duhet që njëkohësisht të krijojë mundësinë tjetër që ti kompensojë palës edhe dëmin e shkaktuar si rezultat i vonesave në ekzekutimin e vendimit. Por në jurisprudencën e saj Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin se:

*Kërkuarisi ka pretenduar përpara Gjykatës Kushtetuese edhe dëmshpërblimin financiar dhe jofinanciar, të ardhur për shkak të vonesës në ekzekutimin e vendimeve.*

*Gjykata Kushtetuese thekson, se në sistemin tonë ligjor, kushdo që konsideron se ka patur një shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, mund ti drejtohet Gjykatës Kushtetuese, pasi ka shteruar të gjitha mjetet e brendshme juridike, në kuptim të nenit 131, germa "f", të Kushtetutës. Një kërkesë e tillë është edhe ajo që ka paraqitur kërkuarisi lidhur me shkeljen e të drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i ekzekutimit të një afati të arsyeshëm të vendimeve gjyqësore në favor të tij.*

*Sa i përket kërimit për kompensimin e dëmit si rezultat i ekzekutimit me vonesë të vendimeve gjyqësore, Gjykata Kushtetuese vlerëson se ky është një kërkim i ri, i cili mund të paraqitet në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në bazë të dispozitave të Kodit Civil që kanë të bëjnë me kompensimin e dëmit të shkaktuar si rrjedhim i vonesës në pagimin e një shume parash (neni 450 i Kodit Civil). Vetëm pas ezaurimit të mbrojtjes juridiksionale, kërkuarisi mund të vërë në lëvizje procedurat kushtetuese, në bazë të nenit 131, germa "f", të Kushtetutës.*

*Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkesa për dëmshpërblim nuk mund të merret në shqyrtim prej saj.<sup>1090</sup>*

Kjo vendimmarrje nga ana e Gjykatës ndoshta kushtëzohet nga fakti se si Kushtetuta ashtu edhe ligji organik i saj, nuk parashikojnë në asnjë dispozitë të drejtën për të vendosur në lidhje me dëmshpërblime të kësaj natyre. Çdo vendimmarrje e ndryshme në këtë drejtim do të çonte në mënyrë të paevitueshme në krijimin e një norme të re juridike, funksion ky i cili është jashtë kufijve të juridiksionit kushtetues të përcaktuar në nenin 132 të Kushtetutës.<sup>1091</sup>

Por ka edhe autorë që mendojnë se nisur nga konstatimi që ka bërë GJEDNJ, rezulton se Gjykata Kushtetuese nuk ka asnjë pengesë për të vendosur mbi kërkesat për kompensim si rezultat i vonesave të paarsyeshme dhe të pajustificuara në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore

<sup>1088</sup> Freixes, Teresa, "The right to a fair trial in Spain", botuar në "The right to a fair trial", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të demokracisë", nr.28, botim i Komisionit Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias), Gjermani 2000, fq. 61.

<sup>1089</sup> Pirdeni, Adea, "Vështrim i shkurtër mbi aksesin e individit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", botuar në "Sistemi kushtetues dhe sfidat e tij", Revista "Studime Juridike", botim i Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Shtëpia Botuese "Adelprint", Tiranë 2009, fq.124.

<sup>1090</sup> Vendimi nr.8, datë 23.03.2010 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>1091</sup> Kushtetuta, neni 132, pika 1: Gjykata Kushtetuese ka vetëm të drejtën e shfuqizimit të akteve që shqyrton.

duke iu referuar dispozitave të përgjithshme materiale dhe procedurale për këtë qëllim.<sup>1092</sup> Një konstatim i Gjykatës pa një mundësi konkrete për individin të paktën për të kompensuar lidhur me pasojat negative të kësaj shkeljeje, do të ishte pakuptim. GJEDNJ në një rast ka konstatuar se megjithë konstatimin e shkeljes Gjykata Kushtetuese duhej të kishte marrë edhe masa të tjera.<sup>1093</sup> Nëse i referohemi LGJK rezulton se në këtë rast është detyrimi i Këshillit të Ministrave që të marrë masa të menjëhershme për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Pavarësisht kësaj edhe vetë Gjykata Kushtetuese mund dhe duhet të tregohet më aktive duke përcaktuar vetë ajo organin që duhet të kryejë veprimet e caktuara për zbatimin e këtij vendimi si edhe veprimet që duhet të kryhen prej tij.<sup>1094</sup>

Po të njëjtën vendimmarrje ka Gjykata Kushtetuese, pra konstatimin e cënimit për një proces të rregullt ligjor në ato raste kur gjykatat janë duke gjykuar çështjet në tejkalim të çdo afati të arsyeshëm. Edhe në këtë rast mungojnë hallkat për ndjekjen e kësaj çështjeje mbas vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese. Jam i mendimit se duke u bazuar në LGJK, në këtë rast Gjykata Kushtetuese duhet të ngarkojë Këshillin e Lartë të Drejtësisë për ndjekjen e kësaj çështjeje me përparësi.

Pika 4 e dispozitës synon të vendosë një mekanizëm garantues. Në raste pengesash për zbatimin e vendimit Kryetari i Gjykatës ka të drejtë që të vendosë një gjobë deri në vlerën 100.000 Lekë. Siç e ka përcaktuar jurisprudenca kushtetuese, kjo mundësi është në diskrecionin e Kryetarit dhe jo pjesë e juridiksionit kushtetues dhe nuk mund të jetë pjesë e kërkimit të palëve.<sup>1095</sup> Kjo situatë lidhet me faktin që ekzekutimi i vendimeve nga pikëpamja procedurale është e ndarë nga faza e ekzekutimit. Për rrjedhojë edhe masa e gjobës që mund të marrë Kryetari i Gjykatës, nuk është pjesë e aktivitetit procedural të Gjykatës Kushtetuese. Kjo nuk i pengon pjesëmarrësit që t'i drejtohen atij nëpërmjet kërkesave administrative. Megjithatë, mënyra se si është formuluar dispozita dhe interpretimi që i ka dhënë Gjykata Kushtetuese këtij rasti, tregon se kjo është një kompetencë diskrecionale e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese. Pjesëmarrësit jo vetëm që nuk e detyrojnë dot që të veprojnë, por nuk kanë edhe se ku të ankohen për mosveprimin e tij. Kjo lloj zgjidhjeje e legjislacionit, duket sikur justifikohet me pozitën e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese dhe me rolin që ai duhet të mbajë duke mos u përfshirë, kundër gjykimit të tij, në procedura që mund të kenë edhe kontekst politik apo që përfshijnë imazhin e Gjykatës Kushtetuese.

## KONKLUZIONE.

Gjykimi kushtetues në tërësinë e tij, dallon në shumë aspekte nga gjykimi i zakonshëm. Karakteristikë fillestare e këtij dallimi është pikërisht dhe ekzistenca e një fazë paraprake të shqyrtimit të kërkesave. Kjo fazë shërben për të shmangur Gjykatën Kushtetuese nga një

<sup>1092</sup> Vorpsi, Arta, "Ankimi individual në Gjykatën Kushtetuese Shqiptare – Mjet juridik efektiv?", botuar në "Mekanizmat mbrojtës të të drejtave të individëve në kuadër të procesit të rregullt ligjor", Shtëpia Botuese "Pegi", Tiranë 2012, fq. 109.

<sup>1093</sup> Po aty, fq. 111.

<sup>1094</sup> LGJK, neni 81, pika 2 dhe 3.

<sup>1095</sup> Vendimi nr.12, datë 15.4.2011 i Gjykatës Kushtetuese: *Gjykata vlerëson se pretendimi i parashtruar më sipër nuk përfshihet në rrethin e çështjeve që i përkasin juridiksionit kushtetues. Në referim të nenit 81, pika 4 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese" caktimi i gjobave në rast moszbatimi të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese ose pengimi i zbatimit të tyre është kompetencë e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese. Nga sa më sipër, pretendimi i kërkuesit është haptazi i pabazuar dhe, për rrjedhojë, kërkuesi nuk legjitimohet të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues për këtë pretendim.*

bllokimi i saj për shkak të mbingarkesës që do të kishte nëse të gjitha kërkesat do t'i shqyrtonte në seancë plenare. Për ta bërë sa më efektive këtë fazë nga Kushtetuta dhe nga LGJK parashikohet se kërkesat shqyrtohen nga një trupë e vogël gjyqtarësh dhe jo nga e gjithë Gjykata Kushtetuese. Këto trupa formojnë ato që LGJK i quan kolegje. Një Kolegj i Gjykatës Kushtetuese përbëhet nga tre anëtarë. Karakteristikë e këtyre trupave gjyqësore është se kanë kompetencë të plotë vendimmarrëse për kalimin apo jo të një çështje për gjykim në seancë plenare. Problematika që qëndron në këtë rast lidhet me numrin e vogël të gjyqtarëve. Kështu për çështje të tilla si legjitimitimi, juridiksioni dhe fakti nëse kërkesa është apo jo haptazi e pabazuar, vendos një trupë shumë e vogël gjyqtarësh e cila nuk përfaqëson shumicën e trupës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese. Për të kompensuar këtë problematikë LGJK ka parashikuar që vendimmarrja e kësaj trupe duhet që gjithmonë të jetë unanime. Për pasojë në çdo rast, si kur vendosin moskalimin e çështjes, si kur vendosin kalimin e saj, gjyqtarët duhet që të vendosin njëzëri. Nga ana tjetër Kolegji i Gjykatës Kushtetuese është kompetent edhe për të vendosur bashkimin apo ndarjen e çështjeve. Është e kuptueshme që Kolegji i Gjykatës Kushtetuese duhet që të vendosë në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.

Në rast të mungesës së unanimitetit në Kolegj çështja kalon për kompetencë në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo trupë gjyqësore në këtë rast vendos me shumicë votash dhe shqyrton të njëjtat çështje që shqyrton edhe Kolegji i Gjykatës Kushtetuese por që nuk arriti të vendosë me unanimitet. Nga ana tjetër Mbledhja e Gjyqtarëve ka si kompetencë të saj ekskluzive që të vendosë edhe marrjen e masës së pezullimit të zbatimit të aktit. Mbledhja e Gjyqtarëve është një strukturë e cila duhet të mbledhet dhe të funksionojë rrallë. Kjo sepse në rast se ajo përshihet sa më shpesh në fazën paraprake të seleksionimit të kërkesave, atëherë veprimtaria e Gjykatës Kushtetuese do të ngadalësohej shumë për shkak të mbingarkesës me çështje.

Natyra e vendimet që marrin këto dy struktura të Gjykatës Kushtetuese, ndryshon në varësi të vendimit që ato marrin. Kështu në rast se vendimi është moskalimi i çështjes në seancë plenare atëherë vendimi është përfundimtar dhe i formës së prerë si edhe përbën *res judicata*. Në këtë mënyrë çështja konsiderohet e mbyllur dhe nuk mundet që të rihapet më. Bazuar në këtë lloj efekti, rezulton se Gjykata Kushtetuese refuzon të marrë në shqyrtim kërkesat e tjera që paraqiten nga të njëjtat subjekte me të njëjtat shkaqe. Në përgjithësi Gjykata Kushtetuese ka qenë e qëndrueshme kur ka qenë përpara këtyre rasteve. Përrjashtim është vetëm një rast, ku Gjykata Kushtetuese pranoi të marrë në shqyrtim të njëjtën kërkesë megjithëse më parë Kolegji kishte vendosur moskalimin e saj me arsyetimin se kjo trupë nuk i kishte dhënë përgjigje njërit prej pretendimeve të ngritura në kërkesë. Nga ky qëndrim, rezulton se e vetmja mundësi për të shmangur vendimmarrjen e mëparshme të kolegjit, është që kërkesa e re të argumentojë që në shqyrtimin e parë Kolegji apo Mbledhja e Gjyqtarëve nuk ka marrë në shqyrtim një apo disa prej pretendimeve, ose të përmbajë shkaqe të tjera nga kërkesa fillestare, në mënyrë që të rishqyrtohet përsëri nga strukturat përkatëse të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë rast kusht thelbësor është që kjo kërkesë e re të bëhet brenda afateve të përcaktuar nga LGJK.

Pavarësisht këtyre rregullave të fazës paraprake, në disa gjykime të veçanta ajo kthehet në një formalitet për disa gjykime kushtetuese. Kështu për disa gjykime ekskluzive, siç janë për shkarkimin e Presidentit dhe të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, kontrollin e pajtueshmërisë së ushtrimit të funksioneve nga Presidenti dhe deputetët, kontrollin e çështjeve të shtruara për referendum, kontrollin kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë përpara hyrjes në fuqi të Kushtetutës etj, Kolegji apo Mbledhja e Gjyqtarëve, nuk kontrollojnë legjitimitetin apo kompetencën lëndore të Gjykatës, pasi në këtë rast si subjekti dhe juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese janë përcaktuar mjaft mirë nga vetë akti



themelor. Do të ishte një situatë e rrallë që një subjekt tjetër, tej atyre të përcaktuar shprehimisht, të kërkonin që të inicionin një gjykim të tillë dhe nga praktika e deritanishme një gjë e tillë nuk rezulton të ketë ndodhur. Për këtë arsye këto dy struktura mund të kontrollojnë vetëm plotësimin e kriterëve formale të kërkesës (apo vendimit) të këtyre subjekteve dhe vetëm në rast se ajo nuk është e plotë, të shprehen për kthimin e saj për plotësim. Në çdo rast tjetër Gjykata Kushtetuese duhet që të shprehet në seancë plenare.

Pezullimi në gjykimin kushtetues është një mjet i rëndësishëm procedural, i cili synon pezullimin e zbatimit të akteve, procedurave apo veprimtarive që mund të çenojnë rendin dhe parashikimet kushtetuese. Pezullimi i zbatimit të akteve është masa tradicionale që parashikohet nga LGJK dhe që merret nga Gjykata Kushtetuese. Me termin "akt" në këtë rast është kuptuar si ato me natyrë normative, ligje apo akte nënligjore, ashtu edhe akte administrative me natyrë individuale. Këtu nuk bëjnë përjashtim edhe aktet e pushtetit gjyqësor. Pra, fusha e veprimit të këtij parashikimi është shumë e gjerë. Nga ana tjetër vetë LGJK parashikon edhe dy masa pezullimi të veçanta. E para është masa e pezullimit të procedurave të Kuvendit për ratifikimin e një marrëveshje ndërkombëtare, nëse është vendosur kalimi për gjykim i kërkesës për kontrollin kushtetues të një marrëveshje të tillë. Kjo masë merret *ipso lege* në momentin që vendoset kalimi për gjykim i kërkesës. Ajo ka si qëllim që t'i japë kohën e nevojshme për shqyrtim dhe vendimmarrje Gjykatës Kushtetuese përse i përket kushtetutshmërisë së marrëveshjes, e cila nuk duhet të vihet nën presion apo të anashkalohet nga Kuvendi dhe institucione të tjera kushtetuese të cilat mund ta ratifikojnë atë përpara përfundimit të procesit në Gjykatën Kushtetuese. Kjo zgjidhje e ligjvënës, megjithëse llogjike, ka edhe një pikë të dobët. LGJK nuk parashikon asnjë masë pezullimi të procedurave të ratifikimit të marrëveshjes nga ana e Kuvendit, gjatë fazës procedurale kur kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese por ende nuk është marrë një vendim në lidhje me të. Arsyeja duket sikur është, që të mos luhet me procedurat parlamentare të ratifikimit, të cilat mund të bllokohen me paraqitjen e kërkesave fiktive në Gjykatën Kushtetuese nga subjekte të ndryshme. Por nga ana tjetër asnjë gjë nuk e pengon Kuvendin që me marrjen dijani të paraqitjes së një kërkesë të tillë në Gjykatën Kushtetuese të procedojë me shpejtësi për ratifikimin e marrëveshjes së kundërshtuar. Madje duke qenë se këto marrëveshje nuk ratifikohen me shumicë të cilësuar, atëherë nuk ka asnjë pengesë që ato të kalojnë me procedurë të përshpjeguar. Mundësia e vetme në këtë rast është që vendimi i Gjykatës Kushtetuese ta gjejë këtë procedurë ratifikimi në fazat e tjera të shpalljes, publikimit apo hyrjes në fuqi të ligjit ratifikues. Këto faza janë shpallja që bën Presidenti i Republikës, publikimi në Fletoren Zyrtare dhe kalimi i afatit pesëmbëdhjetë ditor për hyrjen në fuqi të ligjit. Është e kuptueshme që në këto raste po flasim më shumë për "lojra shpejtësie" se sa për procedura të mirëfillta në një shtet të së drejtës.

Rasti i dytë është masa e pezullimit të veprimtarisë së një partie apo organizate me karakter politik nëse është vënë në diskutim, nëpërmjet një kërkesë, kushtetutueshmëria e saj dhe ka baza të mjaftueshme për të dyshuar që veprimtaria e saj mund t'i sjellë dëm rendit kushtetues. Në këto raste Gjykata Kushtetuese vendos për pezullimin e veprimtarisë politike të këtij subjekti derisa ajo të marrë një vendim përfundimtar.

Masa e pezullimit synon të mbrojë rendin kushtetues dhe të drejtat e njeriut nga pasoja të rënda dhe të pariparueshme që mund të sjellë zbatimi i aktit, vijimi i procedurave parlamentare apo veprimtaria e një subjekti politik. Barra e provës në këtë rast i mbetet si rregull kërkuesit, por nuk përjashtohet mundësia që Gjykata Kushtetuese mund ta çmojë vetë marrjen e një mase të tillë. Kjo justifikohet nga fakti që vetë LGJK ja njeh të drejtën Gjykatës Kushtetuese që këtë masë ta marrë edhe vetë kryesisht. Deri më sot në jurisprudencën kushtetuese nuk rezulton që të

jetë marrë një masë e tillë nga vetë Gjykata, pa kërkesën e palëve. Qëllimi në këtë rast është që të mbrojë paanshmërinë e Gjykatës Kushtetuese. Për rrjedhojë nëse Gjykata Kushtetuese do të detyrohet të veprojë qoftë edhe kryesisht atëherë jemi përpara një situatë antikushtetutshmërie të një shkalle shumë të lartë e cila rrezikon rëndë rendin kushtetues.

Masa e pezullimit si rregull merret nga Gjykata Kushtetuese mbasi vlerësohet se një masë e tillë mbron parashikimet kushtetuese dhe nuk çënon interesin publik. Kjo do të thotë që marrja e saj nuk është e menjëhershme. Përrjashtimisht, vetëm përsa i përket procedurave parlamentare të ratifikimit të një marrëveshje ndërkombëtare, marrja e kësaj mase është *ipso lege* nëse është vendosur kalimi i çështjes në gjykim dhe nuk i nënshtrohet asnjë vlerësimi nga ana e trupës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

Në një rast, të gabuar në këndvështrimin tim, Gjykata Kushtetuese ka vendosur edhe pezullimin e procedurave parlamentare për votëbesimin e Këshillit të Ministrave. E konsideroj të gabuar pasi Gjykata Kushtetuese nuk po shqyrtonte ndonjë akt por vetëm duhet të bënte interpretimin e një norme kushtetuese. Në këtë rast, tejkalimi i parashikimeve ligjore të LGJK, nga ana e Gjykatës Kushtetuese nuk është i justifikuar. Një tjetër agument është edhe se Gjykata Kushtetuese, bazuar në një ligj vendosi të pezullojë procedurat që parashikohen nga vetë Kushtetuta. Është e kuptueshme që një procedurë kushtetuese nuk mund të pezullohet nga parashikimet e një akti me fuqi më të ulët siç është ligji.

Gjykata Kushtetuese, megjithëse në mungesë të parashikimeve në vetë LGJK, duke u bazuar megjithatë në K.Pr.C., ka vendosur në disa raste bashkimin apo ndarjen e çështjeve. Si rregull bashkimi i çështjeve bëhet në rastet se objekti është i njëjtë dhe shkaqet e paraqitura janë të njëjta. Kjo ndihmon që Gjykata Kushtetuese të realizojë një ekonomi gjyqësore në shqyrtimin e kërkesave duke grupuar ato që kanë natyrë të njëjtë, pavarësisht se subjektet janë të ndryshme.

Ndarja e çështjeve është aplikuar më rrallë nga Gjykata Kushtetuese. Qëllimi i kësaj procedure është që Gjykata të ndajë kërkimet nga njëra – tjetra që janë të ndryshme për nga natyra e tyre dhe që mund të zgjidhen më mirë në një gjykim të veçantë. Kusht në këtë rast është që të mos dëmtohet çështja, pra nga ndarja e kërkimeve, ato të mbesin pas asnjë kuptim. Kjo e ndihmon Gjykatën Kushtetuese që të shqyrtojë më me objektivitet pretendimet e kërkuesit.

Në një rast të rrallë Gjykata Kushtetuese ka bërë ndarjen e një çështjeje dhe e ka bashkuar njërin prej kërkimeve me një tjetër çështje e cila ishte ngjashme përsa i përket objektit dhe shkaqeve me këtë kërkim. Kjo mënyrë veprimi megjithëse ka ndodhur vetëm një herë dhe shumë kohë përpara, në fakt është një teknikë e përkryer e përdorimit të njëkohshëm të kërkesave për ekonomi gjyqësore dhe shqyrtimit me objektivitet të tyre. Kjo si teknikë përdoret shumë edhe nga gjykata të tjera kushtetuese por tek ne siç u përmend ka mbetur një rast i izoluar.

Mbas përfundimit të shqyrtimit të çështjes në fazën paraprake dhe plotësimit të gjithave kërkesave ligjore, atëherë çështja kalon për gjykim në seancë plenare. Shqyrtimi në seancë ndjek disa rregulla procedurale të mirëpërcaktuara që i japin drejtim kësaj faze të procesit. Gjykata Kushtetuese ka diskrecion të plotë për të vendosur nëse ky gjykim do të zhvillohet gojarisht, në prani të palëve, apo mbi bazë dokumentash. Si rregull seanca bëhet me praninë e palëve në rast se anëtarët e Gjykatës Kushtetuese çmojnë se çështja ka nevojë për sqarime të mëtejshme të cilat duhet që të jepen personalisht nga vetë palët. Po kështu seanca bëhet me praninë e palëve nëse do të administrohen prova të tjera, tej atyre të paraqitura prej tyre si edhe është pranuar që të merret prova me dëshmitarë apo ekspertë. Një tjetër rast i kryerjes së seancës me praninë e palëve është edhe nëse çështja e paraqitur ka ndjeshmëri të lartë në publik. Nga ana tjetër seanca si rregull bëhet mbi bazë dokumentash nëse çështja është e qartë nga materialet me shkrim që kanë paraqitur pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues dhe nuk ka nevojë për sqarime të mëtejshme. Po

kështu seanca bëhet mbi bazë dokumentash kur për çështjen e paraqitur ka një jurisprudencë të konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese si rregull, nën shembullin edhe të gjykatave të tjera kushtetuese, kohët e fundit po anon në drejtim të zhvillimit të seancave plenare mbi bazë dokumentash. Kjo mënyrë veprimi ka disa avantazhe si për shembull zhvillimi i sa më shumë seancave gjyqësore duke zbatuar parimin e ekonomisë gjyqësore. Duke vepruar në këtë mënyrë në këto seanca, diskutimi zhvillohet midis vetë anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe shpesh pjesën e shpjegimeve dhe pyetjeve – përgjigjeve midis Gjykatës dhe pjesëmarrësve në gjykim. Kjo padiskutim që shkurton më shumë kohë dhe mundëson që Gjykata Kushtetuese të marrë në shqyrtim më shumë çështje. Kjo sjellje e Gjykatës, justifikohet tashmë edhe me vjetërsinë saj. Në mbi dy dekada përvojë Gjykata Kushtetuese ka krijuar një jurisprudencë të pasur dhe për rrjedhojë shumë prej çështjeve që paraqiten para saj, bien në fushëveprimin e precedentëve të shumtë që Gjykata ka krijuar. Për këtë arsye nuk është e nevojshme zhvillimi i një seance me praninë e palëve.

Në përfundim të seancës, Gjykata Kushtetuese tërhiqet për të marrë vendim. Në këtë fazë diskutimi është i ngushtë vetëm midis anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe ka si qëllim diskutimin e të gjitha pretendimeve të palëve, si ato me shkaqe procedurale ashtu edhe për ato që kanë të bëjnë me themelin e çështjes. Për shkak se çështja mund të jetë e komplikuar ose për shkak të mungesave të anëtarëve të saj, vendimmarrja mund të shtyhet edhe në ditë të tjera. Mbas përmbylljes së fazës së diskutimit kalohet në votim, ku fillohet nga anëtari më i ri dhe deri tek Kryetari i Gjykatës. Me pas kalohet në arsyetimin dhe redaktimin e vendimit i cili pasi miratohet nënshkruhet nga të gjithë anëtarët. Gjyqtarët që kanë pasur mendim kundër, kanë të drejtë që të arsyetojnë qëndrimin e tyre, arsyetim i cili i bashkëlidhet vendimit përfundimtar.

Nëse ky vendim përmban pjesë të errëta ose gabime atëherë pjesëmarrësit mund të kërkojnë interpretimin ose korigjimin e vendimit.

Teknika që përdor Gjykata Kushtetuese në arsyetimin e vendimeve të saj janë të ndryshme. Si rregull në të gjejmë gjurmë të përdorimit të interpretimi literal, teleologjik, gjuhësor, doktrinor etj. Të gjitha këto teknika shërbëjnë për të nxjerrë kuptimin e normës kushtetuese. Por duke analizuar me kujdes jurisprudencën kushtetuese rezulton se ajo mbështet gjerësisht edhe në interpretimin krahasimor. Këtë metodë Gjykata Kushtetuese e ndjek kur i referohet doktrinës së huaj, akteve juridike të huaja, por veçanërisht vendimeve të gjykatave të huaja, kushtetuese dhe ndërkombëtare. Për këtë të fundit Gjykata jonë Kushtetuese i është referuar, sipas rastit dhe natyrës së çështjeve GJEDNJ, kryesisht kur ka të bëjë me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, GJED, kryesisht kur ka pasur çështje që diskutojnë lirinë ekonomike. Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, si rregull, Gjykata Kushtetuese i është referuar, kur ka shqyrtuar marrëveshjet ndërkombëtare. Në lidhje me gjykatat kushtetuese të vendeve të tjera, veçanërisht të Gjermanisë dhe Italisë, Gjykata Kushtetuese i është referuar, për marrëdhëniet midis institucioneve me karakter kushtetues, por në disa raste edhe për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Në disa raste Gjykata jonë Kushtetuese u është referuar, megjithëse shumë më pak, edhe gjykatave kushtetuese të vendeve të tjera. Përdorimi i së drejtës së krahasuar paraqet avantazhet e veta, pasi mundëson përdorimin e një jurisprudencë të përparuar dhe të konsoliduar kushtetuese të vendeve të tjera të zhvilluara. Kjo mundëson përthithjen e parimeve kushtetuese të këtyre vendeve duke i përshtatur ato me realitetin shqiptar. Kjo sjell që jurisprudenca jonë të ndjekë shembujt më të mirë me qëllim evolimin e saj më të shpejt dhe drejt standardeve bashkëkohore. Por përdorimi i kësaj jurisprudencë duhet që të përdoret edhe me kujdes, pasi siç e ilustruam me shembullin të trajtuar në këtë punim, Gjykata Kushtetuese në



mënyrë të gabuar u është referuar kushtetutave të Spanjës dhe Italisë, për të arritur në një konkluzion të caktuar kur në fakt jurisprudenca kushtetuese e këtyre vendeve sugjeronte një zgjidhje tjetër. Po kështu duhet të merret në konsideratë fakti që e drejta e krahasuar jo gjithmonë ofron zgjidhje për çështjet e vendit tonë, pasi vendet e ndryshme kanë veti dhe tradita dhe praktika të ndryshme.

Forma që merr vendimi i Gjykatës Kushtetuese mund të jetë unanime, me shumicë votash ose plural. Në vendimin unanime të gjitha gjyqtarët kanë votuar njëzëri për zgjidhjen e çështjes, ndërsa në vendimin me shumicë votash kanë votuar "pro" një zgjidhjeje të caktuar, të paktën pesë prej gjyqtarëve kushtetues. Në këtë rast gjyqtarët që janë "kundër" kanë të drejtë që të arsyetojnë qëndrimin e tyre në pakicë. Ky qëndrim i tyre në disa raste, përveç vlerave doktrimore, është kthyer edhe në vendim shumicë në të ardhmen. Vendimet plurale janë disi më të ralla, Në këto vendime ka një shumicë absolute përsa i përket zgjidhjes së çështjes por jo përsa i përket arsyeve. Në këtë rast kemi një shumicë relative gjyqtarësh të cilët teorikisht formojnë shumicën dhe arsyetimi i tyre quhet arsyetim i vendimit, por që janë më pak se pesë. Ndërkohë kemi gjyqtarë të tjerë që megjithëse janë dakort për mënyrën e zgjidhjes së çështjes, nuk janë dakort për arsyet e kësaj zgjidhjeje. Në thelb ato kanë arsye dhe qëndrime të tjera. Këto vendime është e kuptueshme që nuk përbëjnë jurisprudencë por zgjidhin vetëm çështjen konkrete.

Gjykata Kushtetuese në vendimmarrjen e saj përdor shumë vendime të cilat janë me karakter deklarativ, konstatues, pranues, rrëzues, refuzues etj. Këto vendime pasqyrojnë edhe llojet e ndryshme të gjykimit që Gjykata Kushtetuese duhet që të zhvillojë mbi bazën e kërkesave të palëve. Si rregull vendimet kryesore me të cilat punon Gjykata Kushtetuese janë ato që kanë të bëjnë me pranimin apo rrëzimin e kërkesës. Në të dyja rastet ky mund të jetë i plotë ose i pjesshëm. Në rast se kërkesa pranohet atëherë akti objekt gjykimi shfuqizohet. Në rast të kundërt kërkesa rrëzohet dhe akti mbetet në fuqi. Vendimi refuzues, është një zgjidhje ligjore e legjislatorit shqiptar e cila ka treguar se nuk qëndron. Megjithatë deri më sot, pavarësisht edhe dënimit të GJEDNJ, ky parashikim është ende në fuqi. Qëllimi i këtij parashikimi, ishte që të vinte një barazi midis votave të gjyqtarëve kushtetues, por nga ana tjetër ka bllokuar veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese dhe ka lënë pa përgjigje kërkesit që i janë drejtuar kësaj Gjykate. Edhe zgjidhja që ofron kjo dispozitë, pra, riparqitja e kërkesës, referuar jurisprudencës kushtetuese, rezulton se ka funksionuar vetëm njëherë. Duke vijuar më tej me argumentat, rezulton se sipas rregullit që vetë LGJK parashikon, një gjyqtar nuk mund të abstenojë në zgjidhjen e një çështjeje, por nga ana tjetër duke përcaktuar një lloj vendimmarrje të tillë rezulton se "abstenon" vetë Gjykata Kushtetuese në marrjen e një vendimi. Dukshëm kjo lloj vendimmarrje është allogjike.

Vendimet interpretuese janë një tjetër vendimmarrje e Gjykatës Kushtetuese. Ato mund të jenë pranuese ose rrëzuese. Lloji i parë është zbatuar rrallë nga Gjykata dhe sjell një shfuqizim teorik të dispozitave ligjore objekt gjykimi. Në këtë rast përmbajtja e dispozitave nuk ndryshon por këto dispozita nuk zbatohen në raste të përcaktuara nga Gjykata Kushtetuese në arsyetimin e vendimit të saj. Lloji tjetër i vendimit është më i përdorshëm. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese rrëzon kërkesën nga ana formale por duke i dhënë një interpretim pajtues të dispozitave me Kushtetutën. Në këtë rast normat juridike mund të kuptohen dhe zbatohen vetëm në mënyrën e parashtruar nga Gjykata Kushtetuese. Kjo lloj vendimmarrje shpëton shumë ligje nga shfuqizimi i tyre dhe një marrëdhënie më të zbutur në raport me pushtetin ligjvënës.

Vendimi deklarativ zbatohet nga Gjykata Kushtetuese në disa raste. Kështu ai zbatohet në rastet kur bën interpretimin përfundimtar të një norme kushtetuese si edhe kur zgjidh një mosmarrëveshje kompetencash. Në këto raste vendimi ka vetëm karakter deklarativ dhe nuk sjell

shfuqizimin e ndonjë norme tjetër juridike. Ky vendim gjithsesi mund të përdoret në një tjetër gjykim kushtetues për zgjidhjen e asaj çështjeje në përputhje me këtë vendim deklarativ.

Gjykata Kushtetuese ka filluar ta përdorë këtë vendim edhe në ato raste kur akti juridik që ishte objekt i gjykimit është shfuqizuar nga ana e institucionit që e kishte nxjerrë. Kjo metodë e fundit, duket sikur nuk ka bazë ligjore dhe qëllim në vetvete, pasi procesi ka mbetur pa objekt. Për më tepër, duke pasur në konsideratë vlerën e një vendimi kushtetues, rezulton se kufizohet pa arsye vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese në të ardhmen.

Vendimet konstatuese, janë ato vendime të Gjykatës Kushtetuese të cilat konstatojnë cënimin e një të drejte, por asgjë më shumë. Ky vendim është përdorur në ato raste kur Gjykata Kushtetuese është shprehur për shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, nëse vendimi gjyqësor i formës së prerë nuk është ekzekutuar, ose gjykimi i zakonshëm nuk është zhvilluar brenda një afati të arsyeshëm. Këto vendime janë konsideruar prej GJEDNJ si mjete joefektive për realizimin e të drejtave të individëve.

Vendimet e pushimit janë ato vendime që Gjykata Kushtetuese i merr në ato raste, kur çështja nuk ka më objekt, pra akti juridik objekt i gjykimit është shfuqizuar, ose nëse kërkuesi ka hequr dorë vullnetarisht nga kërkesa e tij. Pushimi i gjykimit është aplikuar nga Gjykata Kushtetuese edhe në rastin kur kërkuesi nuk është paraqitur në seancë gjyqësore, megjithëse ishte njoftuar rregullisht dhe nuk kishte paraqitur arsye për mungesën e tij. Sipas Gjykatës Kushtetuese, kjo barazohet me humbjen e interesit për çështjen. Për të justifikuar këtë qëndrim Gjykata Kushtetuese është bazuar në dispozitat e K.Pr.C. Jam i mendimit se kjo zgjidhje e Gjykatës Kushtetuese është e gabuar, pasi në rradhë të parë dispozitat e K.Pr.C. zbatohen nëse nuk ka parashikime ligjore në vetë LGJK. Në rastin konkret parashikime të tilla ka dhe sipas tyre gjykimi duhet që të vazhdojë në mungesë. Nga ana tjetër situata shfaqet ndryshe nëse Gjykata vendos që çështjen ta marrë në shqyrtim mbi bazë dokumentash. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese nuk ka mundësi që të verifikojë nëse kërkuesi ka më interes për zhvillimin e gjykimit apo jo, pasi ky gjykim bëhet pa praninë e palëve. Pra, Gjykata e merr si të mirëqenë që pala ka interes, kur e zhvillon gjykimin mbi bazë dokumentash, kurse kur e zhvillon me praninë e palëve, nëse nuk paraqitet kërkuesi e merr të mirëqenë që ai nuk ka më interes. Kjo mënyrë e të vepruarit me dy standarde, në këndvështrimin tim personal nuk qëndron.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi sipas Kushtetutës, me botimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare. Ky moment është i njëjtë për të gjitha llojet e vendimeve përfundimtare ose jopërfundimtare që merr Gjykata Kushtetuese. Duhet theksuar se LGJK parashikon edhe një tjetër moment të hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, atë me shpalljen e vendimit. Siç e sqaruam edhe në pjesën përkatëse ky parashikim i LGJK nuk ka asnjë bazë kushtetuese përderisa vetë Kushtetuta nuk e lejon një përjashtim të tillë.

I vetmi përjashtim që lejon Kushtetuta është efekti i vonuar i vendimit të saj. Ky parashikim megjithëse është zbatuar disa herë nga Gjykata Kushtetuese, është zbatuar në mënyrë të gabuar. Kështu sipas Kushtetutës, vendimi hyn në fuqi me botimin e tij në Fletoren Zyrtare kurse akti juridik shfuqizohet në një tjetër datë të mëvonshme. Pra, momenti i hyrjes në fuqi të vendimit nuk ndryshon, por ky vendim nuk prodhon menjëherë efektin e tij, efekt i cili do të vijë në një moment të dytë. Qëllimi i këtij parashikimi është shmangia e një vakumi ligjor dhe dhënia e mundësisë që legjislatori të ndërhyjë në kohë për të bërë ndryshimet ligjore të nevojshme me qëllim që edhe marrëdhëniet juridike të mos mbesin të pa rregulluara dhe të tronditura.

Vendimi që merr Gjykata Kushtetuese merr efekte të ndryshme. Efekti i parë është *res judicata* ose gjë e gjykuar. Sipas këtij efekti e njëjta çështje me të njëjtin objekt dhe të njëjtat shkaqe nuk mund të ngrihet më. Ky lloj efekti vlen edhe nëse subjekti kërkues ndryshon. Ky

është një dallim nga parimi i gjësë së gjykuar në procesin e zakonshëm gjyqësor pasi me ndryshimin e palëve gjykata e zakonshme është e detyruar që të shqyrtojë çështjen në themel. Por nuk ka rëndësi nëse subjekti është i njëjtë apo i ndryshëm nëse paraqitet një çështje me të njëjtin objekt, por me shkaqe të tjera. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese merr në shqyrtim çështjen, madje mund të vendosë edhe në mënyrë të ndryshme nga hera e parë. Kushti i vetëm është që kërkesa e re të bëhet brenda afateve procedurale përkatëse.

Efekti *erga omnes* vlen në ato raste kur kërkesa pranohet dhe akti juridik shfuqizohet ose deklarohet si antikushtetues. Në këtë rast ky vendim nuk ka efekte për pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues por ka efekt të përgjithshëm. Ky lloj efekti nuk parashikohet në rast se kërkesa rrëzohet, pasi siç e trajtuam më sipër mund të paraqitet një kërkesë e re me të njëjtin objekt por me shkaqe të ndryshme. Efekti *erga omnes* është i diskutueshëm në rastin e gjykimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave. Në rast se konflikti ka lindur për shkak të akteve individuale atëherë ai është me natyrë *inter partes* kurse në rast se shkak i konfliktit është akt me natyrë normative atëherë vendimi është me efekt *erga omnes*.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë gjithashtu edhe efektin e forcës së ligjit. Kjo do të thotë që ato duhet të zbatohen dhe të respektohen në mënyrë të njëllotë si ligjet. Por kjo nuk duhet kuptuar që Gjykata Kushtetuese nëpërmjet vendimeve të saj mund të miratojë akte me karakter normativ pasi, sipas Kushtetutës, ajo ka vetëm të drejtën e shfuqizimit të akteve që shqyrton. Ky lloj efekti ka rëndësinë e saj pasi i jep vlerën e precedentit vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, ndryshimi i të cilës mund të bëhet vetëm në kushte të caktuara. Po kështu, ndryshimi i precedentit nuk ka fuqi prapavepruese, siç veprohet edhe me ligjet.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë gjithashtu edhe përfundimtare. Kjo është edhe arsyeja që në Kushtetutë, LGJK nuk parashikohet asnjë procedurë për rishikimin e vendimeve të kësaj Gjykate. Për më tepër në këtë rast nuk gjejmë zbatim parashikimet e kodeve të procedurave civile dhe penale për rishikimin e vendimeve gjyqësore. Në rast se vendimi i Gjykatës Kushtetuese, konsiderohet i gabuar nga GJEDNJ, e shumta që mund të bëj Gjykata Kushtetuese është që të ndryshojë jurisprudencën e saj për çështjet e ardhshme por jo të rishikojë vendimet e saj të mëparshme. Po kështu efekti përfundimtar i vendimit shtrihet edhe mbi të gjitha institucionet e administratës publike që janë të detyruara që t'i zbatojnë ato. Në përgjithësi zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese ka qenë korrekt nga ana e institucioneve me përjashtim të disa rasteve të izoluar.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë si rregull fuqi për të ardhmen. Kjo bëhet me qëllim që të sigurohet zbatimi i parimit të sigurisë juridike dhe që marrëdhëniet juridike të stabilizuar me kohë të mos tronditen për shkak se akti juridik që i rregullonte ato u shfuqizua si antikushtetues. Gjykata Kushtetuese mund të marrë në shqyrtim edhe ligje të cilat kanë shumë kohë që janë miratuar. Kjo bëhet e mundur falë kontrollit incidental që ushtrojnë gjykatat e zakonshme sipas së cilave ky lloj gjykimi nuk kufizohet nga asnjë afat. Për këtë arsye disa ligje mund të shfuqizohen edhe pas kalimit të shumë viteve. Është e kuptueshme që rishikimi i të gjitha marrëdhënieve juridike që janë zgjidhur nga ky ligj do të krijonte pasoja të rënda për shoqërinë.

Por rregulli i mësipërm nuk vlen në disa raste. Kështu nëse akti nuk i ka prodhuar ende pasojat, nëse jemi përpara denimeve penale, çështja është në gjykim, shfuqizohen vendimet e gjykatave të zakonshme apo kemi interpretim përfundimtar të normave kushtetuese, ligji parashikon në mënyrë të shprehur që në këto raste vendimi i Gjykatës Kushtetuese, ka fuqi prapavepruese. Kjo fuqi prapavepruese justifikohet me faktin se marrëdhëniet nuk janë zgjidhur dhe stabilizuar ende, për rrjedhojë ekziston mundësia që në këto rast marrëdhëniet të rregullohet



mbi baza kushtetuese. Por në këtë situatë kemi një handicap juridik. Vetë Gjykata Kushtetuese nuk shprehet në lidhje me efektin e vendimeve të saj, duke ja lënë në dorë institucioneve administrative apo gjyqësore që duke zbatuar rregullat e parashikuara nga LGJK të vendosin vetë nëse efekti i vendimit është me fuqi për të ardhmen apo ka fuqi prapavepruese. Kjo mënyrë e të vepruarit të Gjykatës Kushtetuese krijon paqartësi në praktikë dhe shpeshherë edhe zbatim të gabuar të efekteve të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Pra, në këtë rast në vend që të kemi qëndrueshmëri, kemi paqëndrueshmëri dhe pasoja të rënda për marrëdhëniet juridike. Për këtë arsye Gjykata Kushtetuese duhet që të marrë përgjegjësinë e vendimmarrjes së vetë dhe të mbajë qëndrim të shprehur në lidhje me efektin e vendimeve të saja.

Ekzekutimi i vendimeve është një tjetër pikë e diskutueshme në skemën e procesit kushtetues. Shpeshherë ekzekutimi i tyre paraqitet i thjeshtë. Kështu, në ato raste kur Gjykata Kushtetuese shfuqizon norma juridike, atëherë ato konsiderohen si jashtë rendit juridik dhe nuk ka nevojë për asnjë organ që të shprehet. Po kështu edhe kur deklaron papajtueshmërinë e një marrëveshjeje ndërkombëtare me Kushtetutën, detyrimi i vetëm i Kuvendit është që të mos e ratifikojë marrëveshjen në mënyrë që të ekzekutojë vendimin e Gjykatës. Problematike mund të shfaqet ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese përsa i përket gjykimeve konkrete. Kështu në rastin e mosmarrëveshjeve të kompetencave të lindura si rezultat i mosveprimit të një organi kushtetues, Gjykata Kushtetuese nuk ka asnjë mjet për ta detyruar këtë organ që të vihet në lëvizje. E vetmja mundësi, është që duke zbatuar me analogji dispozitat e LGJA, Gjykata Kushtetuese të nxjerrë një vendim që zëvendëson aktin administrativ. Por siç e trajtuam edhe më sipër kjo mundësi zbatohet vetëm për akte administrative individuale dhe jo për akte normative apo politike.

I diskutueshëm është edhe ekzekutimi i vendimeve përsa i përket vendimeve që Gjykata merr për konstatimin e cënimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor kur nuk ekzekutohet një e drejtë e fituar gjyqësisht ose gjykimi nuk përfundon brënda një afati të arsyeshëm. Në këtë rast parashikimi i LGJK sipas së cilit, si rregull ngarkohet Këshilli i Ministrave për zbatimin e tyre, rezultojnë i pamjaftueshëm. Po kështu edhe parashikimi tjetër sipas së cilit Gjykata Kushtetuese parashikon organin dhe/apo mënyrën e ekzekutimit të vendimit të saj, është zbatuar rrallë dhe për më tepër nuk rezultojnë funksional. Gjithashtu edhe parashikimi i një gjobe që mund të vendosë Kryetari i Gjykatës rezultojnë të mos jetë zbatuar asnjëherë. Për më tepër LGJK ka mangësi në parashikimin e një kompetence për Gjykatën Kushtetuese që të caktojë masë dëmshpërblimi në favor të kërkuarit. Të gjitha këto mangësi dhe parashikime ligjore të pamjaftueshme bëjnë që në këto raste vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese të jetë jo efektive.

## KREU VI

### RAPORTI I GJYKATËS KUSHTETUESE ME GJYKATAT E TJERA NË NIVEL KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR

#### Hyrje

Gjykata Kushtetuese, megjithëse nga pikëpamja doktrinale përbën një pushtet të veçantë, ka shumë pika kontakti dhe ndërthurje edhe me organe të tjera juridiksionale. Ky raport shihet në dy plane, në atë të brendshëm dhe atë të jashtëm. Në planin e brendshëm kompetencat e Gjykatës Kushtetuese ndërthuren me juridiksionin e gjykatave të zakonshme. Kështu nga doktrina janë përcaktuar si pika kontakti rastet kur gjykatat e zakonshme ushtrojnë kontroll incidental si edhe rastin kur individët ankohen në Gjykatën Kushtetuese për shkeljen e së drejtës së tyre për një proces të rregullt ligjor.<sup>1096</sup> Nga ana tjetër juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese krijon përsëri ndërthurje, veçanërisht me gjykatat administrative përsa i përket kontrollit të akteve normative nënligjore apo zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave. Një tjetër pikë kontakti midis të dy juridiksioneve është edhe kontrolli i kushtetutshmërisë së partive apo organizatave politike. Kështu, ky kontroll në bazë të neneve 9 dhe 131, gërma “d” të Kushtetutës është pjesë e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, ndërsa nga ana tjetër K.P. në nenin 224 të tij parashikon si vepër penale krijimin e partive dhe të shoqatave antikushtetuese. Kjo do të thotë që fakti nëse kemi apo jo një parti apo organizatë antikushtetuese, mbas hetimit të prokurorisë është edhe pjesë e juridiksionit penal të gjykatave të zakonshme.

Nga ana tjetër Gjykata jonë Kushtetuese për shkak të kompetencës që ka për të mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut ka pika kontakti edhe me GJEDNJ. Madje shpeshherë ka qenë e detyruar që të ndryshojë qëndrim për shkak të vendimmarrjes së GJEDNJ. Në të ardhmen, me zhvillimin e procesit të integritetit të vendit tonë në strukturat e BE, Gjykatës sonë Kushtetuese do t'i duhet që të krijojë edhe një marrëdhënie bashkëpunimi edhe me GJED. Kjo marrëdhënie shtrihet në dy plane. Në planin e parë duhet analizuar nëse Gjykata Kushtetuese mund të verë në lëvizje GJED, ndërsa në planin e dytë duhet analizuar nëse Gjykata Kushtetuese mund të kontrollojë kushtetutshmërinë e legjislacionit dytësor të BE-së.

Gjetja e këtij raporti midis Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave të tjera është edhe fokusi kryesor në analizën e këtij kreu.

#### **1. Raporti midis gjykimit kushtetues dhe gjykimit të zakonshëm në rastet e kërkesave për kontroll incidental.**

Kur gjykatat vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese shtrohet për diskutim edhe raporti midis këtyre dy gjykimeve. Në përgjithësi pranohet që procesi kushtetues është i pavaruar nga procesi fillestar. Në këtë mënyrë ky proces i filluar rregullisht duhet që të vazhdojë pavarësisht rrethanave të reja që mund të dalin në procesin fillestar.<sup>1097</sup> Në këtë mënyrë nuk ka rëndësi për procesin kushtetues, nëse palët tërhiqen nga gjykimi fillestar dhe kërkojnë pushimin e tij. Në këtë

<sup>1096</sup> Omari, Luan; Anastasi, Aurela; “E drejta kushtetuese”, Shtëpia Botuese “PEGI”, Tiranë 2010, fq.396-397.

<sup>1097</sup> Carlassare, Lorenza, “Interlocutory Review – Abstract Review”, botuar në “The protection of fundamental rights by the constitutional court”, Koleksioni “Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15”, botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998, fq. 128.

rast gjykata e zakonshme mund ta pushojë gjykimin e saj, por kjo nuk e pengon Gjykatën Kushtetuese që të vazhdojë gjykimin e saj dhe të dalë me një vendim përfundimtar.

## **2. Akti nënligjor normativ midis juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit gjyqësor të zakonshëm.**

Sipas legjislacionit shqiptar akti nënligjor normativ mund të jetë objekt gjykimi si në Gjykatën Kushtetuese<sup>1098</sup> ashtu edhe pranë gjykatave administrative.<sup>1099</sup> Përpara hyrjes në fuqi të LGJA, situata rregullohej nga K.Pr.C e cila në nenin 326 të saj kishte një formulim disi konfuz.<sup>1100</sup>

Në rastin e gërmës "a" dispozita paraqiste një kontradiktë me vetveten pasi në dukje përjashtonte nga kontrolli gjyqësor aktet normative kurse nga ana tjetër vendoste si përjashtim faktin nëse këto akte cënonin të drejtat dhe liritë themelore. Siç me të drejtë ka theksuar doktrina në këtë rast përjashtimi kthehej në rregull pasi nuk mund të mendoj që do të kishte një akt normativ nënligjor i cili nuk do të prekte një të drejtë apo liri themelore.<sup>1101</sup> Këtë kontradiktë praktika gjyqësore u mundua që ta zgjidhte në këtë mënyrë:

*14.1. Nga përmbajtja e nenit 326 të Kodit të Proçedurës Civile del se mund të kundërshtohen në gjykatat e zakonshme vetëm aktet administrative individuale (duke përjashtuar ato të parashikuara në pikat "b" dhe "c"). Pjesa e parë e pikës "a", pikat "b" dhe "c" të nenit 326 të Kodit të Proçedurës Civile kanë karakter ndalues, ndërsa pjesa e dytë e pikës "a" të këtij neni ka karakter lejues.*

*14.1.a) Duke e parë në tërësinë e saj dispozitën, rezulton se gjykatat e zakonshme nuk mund të gjykojnë padi të cilat kanë për objekt kundërshtimin e akteve normative. Ato nuk mund të gjykojnë në mënyrë abstrakte normën juridike. Veprimtaria e gjykatës në proçesin e shqyrtimit të konflikteve administrative është drejtpërdrejt e lidhur me mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të subjekteve (personave fizikë e juridikë). Megjithatë, gjykata e zakonshme kur gjatë shqyrtimit të një padie me objekt mbrojtjen e një të drejte konkrete, konstaton se një akt nënligjor me karakter normativ vjen në kundërshtim me ligjin, ka për detyrë të zbatojë ligjin drejtpërdrejt edhe sikur kjo të lerë pa fuqi aktin nënligjor. Bëhet fjalë në këtë rast për shqyrtim incidental të aktit normativ nga gjykata e zakonshme.*

*Kjo është mënyra se si duhet kuptuar gërma "a" e nenit 326 të Kodit të Proçedurës Civile.<sup>1102</sup>*

Nga arsyetimi i mësipërm rezulton se gjykatat e zakonshme nuk kishin të drejtë që të shqyrtonin në mënyrë abstrakte ligjshmërinë e një akti normativ nënligjor, po kishin të drejtë që

<sup>1098</sup> Kushtetuta, neni 131, gërma "c".

<sup>1099</sup> LGJA, nenet 7, 10, 18, 37 dhe 38.

<sup>1100</sup> K.Pr.C., neni 326 (i shfuqizuar): *Nuk mund të ngrihen padi në gjykatë për: a) aktet administrative të Këshillit të Ministrave dhe të institucioneve të tjera të administratës publike të nivelit qendror ose vendor që kanë karakter normativ, përveç kur ato cenojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe interesa të tjerë të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë; b) aktet administrative që kanë rregullim ligjor të posaçëm dhe lidhen me emërimin dhe shkarkimin e funksionarëve publikë; c) aktet administrative të cilat sipas Kushtetutës janë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese.*

<sup>1101</sup> Sadushi, Sokol, "E Drejta Administrative 2, Teoria e aktit administrativ", Shtëpia Botuese "ORA", Tiranë 2005.

<sup>1102</sup> Vendimi nr.00-2010-1158 (360), datë 30.9.2010 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.



në rast se e konstatojnë atë si të kundërligjshëm, ta shmangnin zbatimin e tij duke iu referuar drejtpërsëdrejti ligjit.

Me hyrjen në fuqi të LGJA-së, situata ndryshoi. Ky ligj aktualisht njih dy forma kontrolli mbi aktet normative nënligjore. Sipas formës së parë ruhet kontrolli incidental i gjykatave administrative mbi aktet normative nënligjore.<sup>1103</sup> Sipas këtij parashikimi rezulton se gjykatat administrative kanë të drejtë që të shmangin zbatimin e një akti normativ të paligjshëm duke zbatuar drejtpërdrejtë ligjin. Në rastin e dytë LGJA u jep mundësinë subjekteve të ndryshme që të kundërshtojnë drejtpërsëdrejti në gjykatën administrative të apelit një akt normativ nënligjor. Gjykata e Apelit shqyrton si gjykatë e shkallës së parë çështjen në trup gjykues me pesë gjyqtarë.

Në këtë rast bëhet e nevojshme një analizë e kufirit se ku ndahet juridiksioni kushtetues dhe ai gjyqësor për të shqyrtuar akte të këtij lloji. Parimisht ndarja ka të bëjë me natyrën e pretendimeve që ngrihen. Kështu në rast se ngrihen pretendime të natyrës kushtetuese çështja i përket normalisht juridiksionit kushtetues dhe në rast se pretendimet janë për paligjshmëri atëherë çështja i përket juridiksionit gjyqësor.

Ky moment është deri diku i qartë përsa i përket pretendimeve që ngrihen për të metat materiale të aktit. Në këtë rast, nëse ngrihen pretendime për cënimin e parimeve apo të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese atëherë çështja është në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese, ndërsa nëse pretendimet ngrihen për të drejta ligjore atëherë çështja është në kompetencën e gjykatave administrative. Në këtë rast vetë LGJA parashikon kufijtë e shqyrtimit material të aktit normativ nënligjor duke përcaktuar se në këtë rast vlerësohen së pari nëse zgjedhja nga organi publik është bërë në përputhje me objektivin dhe qëllimin e ligjit, së dyti nëse zgjedhja nga organi publik është bërë vetëm për të arritur qëllimin e ligjit dhe së treti zgjedhja nga organi publik është në raport të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.<sup>1104</sup>

Nga sa më sipër mund të arrihet në konkluzionin që një dallim midis juridiksioneve përsa i përket të metave materiale të aktit edhe mund të arrihet.

Përsa i përket të metave procedurale situata bëhet më e komplikuar. Pretendimet kryesore që ngrihen për të metat e akteve normative nënligjore janë të meta që lidhen me mosrespektimin e kërkesave të nenit 118 të Kushtetutës. Por mos respektimi i kësaj dispozite, së me të drejtë është pranuar edhe nga doktrina pasjell njëkohësisht edhe paligjshmëri të aktit.<sup>1105</sup> Në këtë rast jam i mendimit që të dyja këto dy juridiksione mund të ushtrojnë kontroll. Kështu nëse sipas nenit 118 pika 2 e Kushtetutës pasjell antikushtetutshmëri nxjerrja e një akti të paautorizuar nga ligji, ndërsa sipas nenit 116, gërma "b" të K.Pr.A. po i njëjti veprim është nxjerrja e aktit në tejkalim të kompetencave. Po e njëjta gjë mund të thuhet për formën dhe procedurën në krahasim me kërkesat e tjera të nenit 118 të Kushtetutës.

<sup>1103</sup> LGJA, neni 38: *Gjykata administrative, gjatë shqyrtimit gjyqësor të një veprimi administrativ, kryesisht ose me kërkesë të palëve, vendos të mos zbatohet një akt nënligjor normativ, në bazë të të cilit është kryer veprimi administrativ që shqyrtohet, kur çmon se akti nënligjor është i paligjshëm. Gjykata vendos në këtë mënyrë edhe nëse gjykimi parësor i aktit normativ nuk është në kompetencën e saj. Ky vendim përmban në mënyrë të hollësishme shkaqet e paligjshmërisë, të konstatuara nga gjykata.*

<sup>1104</sup> LGJA, neni 37: 3. *Në rastin kur ligji i jep organit publik të drejtën për zgjedhje alternative, në nxjerrjen e një akti administrativ apo në kryerjen e veprimit tjetër administrativ, gjykata shqyrton edhe nëse: zgjedhja nga organi publik është bërë në përputhje me objektivin dhe qëllimin e ligjit; zgjedhja nga organi publik është bërë vetëm për të arritur qëllimin e ligjit; zgjedhja nga organi publik është në raport të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë. 4. Në rastin e aktit nënligjor normativ, gjykata shqyrton ligjshmërinë e aktit që kundërshtohet, duke vlerësuar të tre kriteret e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.*

<sup>1105</sup> Sadushi, Sokol, "E Drejta Administrative 2, Teoria e aktit administrativ", Shtëpia Botuese "ORA", Tiranë 2005.

Në këtë rast dukshëm kemi një juridiksion konkurrues midis Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave administrative. Këto dy gjykata kanë të drejtë që të shqyrtojnë të metat procedurale të një akti normativ nënligjor bazuar në thelb në të njëjtat kritere kushtetuese dhe ligjore. Në këtë rast dallimi duhet të bëhet në bazë të aksesit që kanë subjektet për të kundërshtuar një akt të tillë në Gjykatën Kushtetuese apo në gjykatën administrative të apelit. Siç e trajtuam dhe më sipër subjektet përgjithësisht kanë një akses të kufizuar (subjektet e kushtëzuara), ose nuk kanë akses (individët). Për këtë pjesë, ligjvënësi u ka siguruar këtyre subjekteve aksesin në gjykatën administrative të apelit.

Një çështje e fundit që meriton të trajtohen në këtë rast është vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese dhe asaj administrative në rast se konstatojnë se akti është goditur gabimisht pranë tyre, kur në fakt duhej që të shqyrtohej në juridiksionin tjetër. Duke qenë se në këtë rast, pavarësisht se ndodhemi përpara gjykatave, nga pikpëmja juridiko-formale jemi përpara dy pushteteve të ndara që rregullohen respektivisht nga Pjesa VIII dhe Pjesa e IX e Kushtetutës. Për këtë arsye këto dy gjykata nuk mund të shpallin mungesën e kompetencës lëndore dhe t'ia dërgojnë aktet gjykatës tjetër. Duke u bazuar me analogji, në disa raste të ngjashme të jurisprudencës aktuale të Gjykatës së Lartë dhe asaj kushtetuese rezulton se vendoset rrëzimi i kërkesës. Më konkretisht Gjykata e Lartë ka mbajtur këtë qëndrim:

*Në kuptim të kësaj dispozite gjykata, pasi konstaton moskompetencën e saj lëndore apo tokësore, është e detyruar të shprehet edhe për gjykatën së cilës i dërgon aktet për zhvillimin e gjykimit. Kjo dispozitë përmban një rregullim procedural të zbatueshëm nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm. Rasti në shqyrtim nuk është i tillë dhe nuk ka të bëjë me kompetencën lëndore të ndonjë gjykate tjetër brenda sistemit të gjykatave të zakonshme. Po kështu, në zbatim korrekt të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile dhe të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", gjykata e shkallës së parë nuk mund t'i dërgojë çështjen për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese, me arsyetimin se i mungon kompetenca lëndore për shqyrtimin e saj.*

12.3. Në vijim të argumentit ligjor të mësipërm, ky Kolegj, ndryshe nga përfundimi i gjykatës së shkallës së parë, në analizë dhe interpretim të dispozitave ligjore të zbatueshme për rastin konkret, vlerëson se gjykata ka gabuar kur ajo shprehet për moskompetencë lëndore të mosmarrëveshjes objekt gjykimi.

16. Gjykata mund të shpallë moskompetencën lëndore, atëherë kur Kodi i Procedurës Civile apo ligji në mënyrë eksplicite ka përcaktuar gjykatën konkrete që ka kompetencën të marrë në shqyrtim çështjen, gjykatë kjo që përfshihet brenda sistemit të gjykatave të zakonshme.

16.1. Për rastin në shqyrtim dhe në kushtet kur ligji për nga pikëpamja lëndore nuk ka përcaktuar ndonjë gjykatë tjetër si gjykatë kompetente, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, referuar neneve 6§1 dhe 13 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, neni 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, vlerëson se paditësit të këtij gjykimi nga pikëpamja procedurale jo vetëm që nuk mund t'i mohohet e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, por nga ana tjetër as gjykata e shkallës së parë nuk mund të shpallë moskompetencën lëndore.

17. Në një rast të tillë gjykata e shkallës së parë, për të arritur në një përfundim të drejtë duhet të analizojë juridikisht pretendimet e palës paditëse dhe, nëse konkludon se

*me padinë në shqyrtim kundërshtohet një akt administrativ ndaj të cilit, sipas nenit 326 Kodit të Procedurës Civile, nuk mund të ngrihet padi, duhet të rrëzohet padinë dhe jo të shpallë moskompetencën e saj.*<sup>1106</sup>

Për analogji, edhe Gjykata Kushtetuese në rast se ndodhet përballë një situatë të tillë vendos moskalimin e çështjes në seancë plenarë nëse kërkesa po shqyrtohet në Kolegjin/Mbledhjen e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe në rast se ka kaluar për shqyrtim në seancë plenare atëherë vendoset rrëzimi i kërkesës.<sup>1107</sup>

### **3. Raporti midis gjykimit kushtetues dhe gjykimit të zakonshëm administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencave.**

Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencave midis organeve shtetërore është parashikuar edhe si kompetencë e Gjykatës Kushtetuese<sup>1108</sup> si edhe kompetencë e gjykatave administrative.<sup>1109</sup> Duke qenë se organet kushtetuese janë njëkohësisht edhe organe administrative, si edhe fakti se mosmarrëveshja e kompetencave po merr gjithmonë e më shumë natyrë ligjore dhe jo kushtetuese, konflikti midis juridiksionit kushtetues dhe atij gjyqësor administrativ është mëse i mundshëm.

Zgjidhja që do të afrohej në këto raste do të kishte të bënte me natyrën e mosmarrëveshjes. Kështu organi që ankohet nëse pretendon cënimin e një të kompetence kushtetuese e cila megjithëse detajohet më tej me ligje duhet të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese. Në rast të kundërt nëse organi kërkues nuk pretendon cënimin e një kompetence kushtetuese por vetëm ligjore atëherë kompetente do të ishte gjykata administrative.

Në rast se çështja do të ishte paraqitur gabim në njërin prej gjykatave, duke qenë se Gjykata Kushtetuese dhe gjykata administrative i përkasin juridiksioneve të ndryshme atëherë ato do të dispononim, Gjykata Kushtetuese me rrëzim kërkesë<sup>1110</sup> dhe gjykata administrative me rrëzim padie.

Por situata mund të shfaqej problematike nëse të dyja si Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata Administrative do ta konsideronin vetën kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin, respektivisht të kërkesës apo të kërkesëpadisë të paraqitur pranë tyre.

Përballë kësaj situatë duhet që gjyqtari administrativ të pezullojë çështjen e tij në pritje të vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese. Kjo është zgjidhja më e pëlqyeshme për të koordinuar këto dy juridiksione dhe për të shmangur një tjetër mosmarrëveshje midis këtyre dy gjykimeve.<sup>1111</sup> Nëse Gjykata Kushtetuese e shfuqizon aktin objekt i mosmarrëveshjes atëherë gjykata administrative do të duhet të pushojë gjykimin e çështjes. Pushimi i çështjes do të duhet të vendoset nga Gjykata Administrative edhe në rast se Gjykata Kushtetuese ka vendosur rrëzimin e kërkesës pasi kërkesa ka qenë e pabazuar, por jo për mungesë juridiksioni. Në këtë rast rezulton qartazi se Gjykata Kushtetuese ka qenë kompetente për shqyrtimin e çështjes dhe për rrjedhojë zgjidhja që ka dhënë ajo përbën tashmë *res judicata*. Bazuar në nenin 132, pika 1

<sup>1106</sup> Vendimi nr. 00-2010-1351 (436), datë 2.12.2010 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

<sup>1107</sup> Vendimi nr.78, datë 18.7.2011 i Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>1108</sup> Neni 131, shkronja "ç" e Kushtetutës

<sup>1109</sup> Neni 7, shkronja "c" e LGJA-së

<sup>1110</sup> Evetualisht edhe me moskalim në seancë nëse Gjykata Kushtetuese shprehet për kompetencën e saj që në këtë fazë.

<sup>1111</sup> Zagrebesky, Gustavo; Marceno, Valeria, "*Giustizia costituzionale*", Shtëpia Botuese "Il Mulino", Bologna 2012, fq.480.



të Kushtetutës rezulton se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim. Për rrjedhojë një vendim i kësaj Gjykate që zgjidh një mosmarrëveshje kompetencash nuk mundet që të shqyrtohet nga gjykatat e tjera.<sup>1112</sup> Karakteri detyrues i vendimeve të rrëzimit, për një gjykim të mosmarrëveshjes së kompetencave, kundërt një gjykimi administrativ me të njëjtat palë dhe të njëjtin objekt, përveç arsyes së mësipërme bazohet edhe në argumentat e tjera si ekonomizimi i gjykimeve, mënjanimi i vendimeve të kundërta si edhe dhënia përparësi vendimmarrjes së atij organi, që përveçse ka një pozicion të veçantë në rendin kushtetues, ka në lidhje me pretendimet për cënimin e kompetencave kushtetuese një juridiksion të posaçëm dhe të parashikuar nga Kushtetuta.<sup>1113</sup> Vetëm në rast se Gjykata Kushtetuese vendos rrëzimin për mungesë të juridiksionit kushtetues atëherë gjykata administrative mund të vazhdojë gjykimin e çështjes.

Nga ana tjetër nëse gjykata administrative ka vendosur shfuqizimin e aktit, përpara se procedurat seleksionuese në Gjykatën Kushtetuese të kenë përfunduar dhe vendimi ka marrë formë të prerë, atëherë Gjykata Kushtetuese duhet të vendosë pushimin e çështjes për mungesë të shkakut të mosmarrëveshjes.<sup>1114</sup>

Megjithatë edhe në rast se Gjykata Administrative duke e shqyrtuar kërkesëpadinë në themel, vendos rrëzimin e saj dhe vendimi merr formë të prerë përpara se Gjykata Kushtetuese të ketë filluar gjykimin kushtetues në mënyrë të mirëfilltë, jam i mendimit se në këtë rast Gjykata Kushtetuese nuk e pushon çështjen pasi, natyra e gjykimit në këtë rast është e karakterit kushtetues dhe për rrjedhojë Gjykata Kushtetuese nuk mundet që të ndikohet nga rezultati që ka sjellë gjykimin administrativ i zakonshëm, i cili shikon vetëm aspektet ligjore të çështjes.

#### **4. Raporti midis gjykimit kushtetues dhe gjykimit të zakonshëm për kontrollin e kushtetutshmërisë së krijimit dhe veprimtarisë së partive dhe organizatave politike.**

Siç e kemi trajtuar deri në këtë pikë gjykimi i kushtetutshmërisë së partive politike është çështje e juridiksionit kushtetues. Megjithatë legjislatori ka parashikuar si në nenin 224 të K.P. si vepër penale krijimin e partive dhe të shoqatave antikushtetuese.<sup>1115</sup>

Duke qenë e parashikuar si vepër penale, rezulton se prokuroria si organ i ngarkuar nga Kushtetuta për ndjekjen penale në emër të shtetit<sup>1116</sup> ka të drejtë që të zhvillojë hetimet përkatëse dhe nëse gjykon se ka element të veprës penale atëherë mund ta dërgojë çështjen për gjykim duke akuzuar personat përgjegjës.<sup>1117</sup> Më pas gjykata e zakonshme mbi bazën e kërkesës për gjykim paraqitur nga ana e organit të akuzës dhe provave që e shoqërojnë atë, vendos përfundimisht për deklarimin fajtor, të pafajshëm apo për pushimin e gjykimit, në varësi të situatës.

<sup>1112</sup> Padula, Carlo, "Conflitti di attribuzione tra Stato e Regioni", botuar në "Le zone d'ombra della giustizia costituzionale - I giudizi sui conflitti di attribuzione e sull'ammisibilità del referendum abrogativo", botuar nga "Quaderni del "Gruppo di Pisa", nën kujdesin e Roberto Pinardi, Shtëpia Botuese "G.Giappichelli Editore", Torino 2007, fq.96.

<sup>1113</sup> Po aty, fq.112.

<sup>1114</sup> Ruggeri, Antonio; Spadaro, Antonino, "Lineamenti di giustizia costituzionale", Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2009, fq.269.

<sup>1115</sup> K.P., neni 224: *Krijimi apo pjesëmarrja në parti, organizata apo shoqata që synojnë përmbysjen me dhunë të rendit kushtetues, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet. Rikrijimi i një partie, organizate ose shoqate të shpërndarë si antikushtetuese apo vazhdimi i veprimtarisë në mënyrë të fshehtë ose të hapur, dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet.*

<sup>1116</sup> Kushtetuta, neni 148, pika 1.

<sup>1117</sup> Neni 331 i K.Pr.P.

Nga sa më sipër rezulton qartësisht se mund të ketë një konkurrim midis juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit gjyqësor për deklarimin ose jo të një partie/organizate si antikushtetuese. Në këtë situatë, shtrihet për diskutim çështja nëse këto dy juridiksione janë autonome në raport me njëri-tjetrin, pra mund të zhvillohen edhe paralelisht pa u ndikuar nga rezultati i njërit prej procesve, apo janë procese të lidhura dhe nuk mundet që të zhvillohet njëri proces pa përfunduar tjetri? Në rastin e dytë, cili gjykim do të konsiderohet kryesor, gjykimi kushtetues apo ai i zakonshëm?

Në lidhje me çështjen e parë nëse këto dy procese janë autonome, jam i mendimit që përgjigjja është negative. Kështu nuk mundet që këto dy procese të kenë rrugë të ndryshme dhe të ndodhemi përballë një situatë allogjike ku për shembull Gjykata Kushtetuese deklaron se partia/organizata politike nuk është krijuar apo nuk ka kryer veprime antikushtetuese dhe gjykata e zakonshme deklaron fajtor partinë/organizatën politike<sup>1118</sup> dhe anëtarët e saj, pikërisht sepse kanë krijuar subjekte antikushtetuese apo me këto subjekte kanë kryer veprimtari antikushtetuese.

Pra, rezulton qartësisht se këto dy procese janë të lidhura më njëri – tjetrin dhe ndikohen prej tyre. E rëndësishme është që në këtë rast të dallohet se cili prej këtyre gjykimeve është gjykim kryesor dhe cili është gjykim dytësor, pra që duhet të presë përfundimin e gjykimit të parë për të vazhduar më tej.

Personalisht jam i mendimit se gjykimi kushtetues është gjykim kryesor në këtë rast. Kështu konstatimi i antikushtetutshmërisë së një akti apo veprimi është çështje e juridiksionit kushtetues. Është Gjykata Kushtetuese ajo që duhet të deklarojë nëse një veprim i caktuar është apo jo në përputhje me Kushtetutën, kompetencë kjo që i është dhënë ekskluzivisht nga ligji themelor i vendit. Në këtë kuptim kjo Gjykatë nuk mundet që të dublohet nga gjykata e zakonshme dhe aq më tepër të presë konkluzionet e gjykatave të zakonshme nëse një veprim apo mosveprim i caktuar në këtë rast përbën antikushtetutshmëri. Nëse do të pranohet të kundërtën atëherë do të rezultonte se gjykimi kushtetues do të ishte formal dhe për pasojë fati i këtij gjykimi do të varej nga rezultati i gjykimit të zakonshëm. Ky fakt bie në kundërshtim me argumentimin që kemi trajtuar, sipas të cilit, duke qenë se në partitë/organizatat politike organizohet politikisht populli dhe ka të bëjë me ushtrimin e sovranitetit prej tij, atëherë i vetmi organ që mund të vendosë kufizime për të është Gjykata Kushtetuese. Për më tepër, në rast se gjykimi kushtetues nuk do të ishte primar atëherë do të vepronim në kundërshtim me standardet ndërkombëtare. Kjo sepse do të rezultonte që me plotësimin e disa kushteve ndjekja penale do të fillonte automatikisht, ndërkohë që nga institucionet ndërkombëtare është kërkuar që procedimi ndaj një partie/organizate politike të jetë e një natyre diskrecionale.<sup>1119</sup>

Nga analiza e mësipërme, mendoj se në këtë rast gjykimi kushtetues do të ishte ai që do të cilësohej si gjykim kryesor. Vetëm mbasi partia/organizata politike të ishte deklaruar si antikushtetuese, atëherë organ i prokurorisë mund të fillonte procedimin penal dhe dërgimin më tej në gjykatë për gjykimin e plotë të personave të akuzuar. Referuar parashikimeve në K.Pr.P., vlera e gjykimit kushtetues në këtë rast do të përcaktonte se fakti ka ndodhur, por jo fajësinë e personave.<sup>1120</sup>

<sup>1118</sup> Sipas nenit 45 të Kodit Penal dhe Ligjit nr. 9754, datë 14.06.2007 "Për përgjegjësinë penale të personave juridikë"

<sup>1119</sup> Opinioni CDL-AD (2009) 006 i Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), nr.489/2008, datë 13 mars 2009, fq.7, parag.33

<sup>1120</sup> Neni 70 i K.Pr.P.

## **5. Raporti i Gjykatës Kushtetuese me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore dhe me Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.**

Me ligjin nr.7959, datë 11.07.1995 Kuvendi Popullor ka vendosur aderimin e Republikës së Shqipërisë në Statutin e Këshillit të Evropës. Anëtarësimin e saj me të drejta të plota përfaqësimi në këtë Këshill, Republika e Shqipërisë e realizoi krahas zhvillimeve të karakterit politik, ekonomik, social dhe juridik që kishte arritur dhe kalimit gradual drejt një shoqërie të lirë e demokratike, por edhe kundrejt disa angazhimeve dhe detyrimeve të karakterit juridik ndërkombëtar, të cilat ajo i mori përsipër për t'i përmbushur brenda disa afteve të caktuara, në bazë të Rezolutës nr. 189 të vitit 1995 të miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, e shoqëruar nga vendimi i Komitetit të Ministrave nr. (95) i datës 10 korrik 1995.

Shqipëria në vitin 1996 aderoi në KEDNJ,<sup>1121</sup> dhe në të gjitha protokollat e saj shtesë që deri në atë moment ishin miratuar dhe kishin sjellë ndryshime në Konventë. Madje e njëjta praktikë u ndoq edhe me protokollat e tjera të miratuara mbas aderimit tonë në Konventë.

Pozita e KEDNJ dhe ndikimi i saj ndryshon shumë nga njëri shtet në tjetrin brenda Këshillit të Evropës. Në shumicën e rasteve ndikimi i Konventës dhe statusi i saj në legjislacionin e brendshëm varet nga pozicioni që kanë normat e së drejtës ndërkombëtare. Vetëm në Austri, KEDNJ ka një status kushtetues. Në Zvicër, statusi i saj është i përafërt me statusin kushtetues. Në vende të tjera Konventës i njihet një status midis ligjit dhe kushtetutës apo me fuqinë e ligjit. Shtete të tjera madje nuk e konsiderojnë Konventën si pjesë të së drejtës së tyre të brendshme dhe për rrjedhojë individët nuk mundet që të bëjnë referencë të drejtpërdrejtë në kërkesat e tyre.<sup>1122</sup>

Me Kushtetutën aktuale, KEDNJ iu dha një vlerë e veçantë. Kështu duke e konsideruar si një standard minimum për mbrojtjen e të drejtave themelore dhe duke e thirrur shprehimisht në nenin 17, pika 2 të Kushtetutës rezulton se në këtë situatë KEDNJ-ja barazohet me aktin themelor të vendit.

KEDNJ-ja, vendos një sistem vlerash të veçanta për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të cilat vendet që kanë aderuar në të pranojnë t'i garantojnë dhe mbrojnë ato. Ajo erdhi si rezultat i krimeve të shumta kundër njerëzimit që u bënë gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe është nënshkruar në vitin 1950. Me kohën, KEDNJ-ja është pasuruar në përmbajtjen e saj si edhe janë shtuar vendet anëtare që kanë aderuar në të.

Kjo Konventë parashikon edhe një lloj mekanizmi kontrollues për zbatimin e detyrimeve nga ana e shteteve anëtare. Mekanizmi kontrollues në këtë rast është GJEDNJ-ja. Ekzistenca e këtij mekanizmi shtrun për diskutim çështjen e përcaktimit të raportit midis Gjykatës sonë Kushtetuese dhe GJEDNJ-së. Shpeshherë ka pasur përplasje dhe divergjenca midis gjykatave kushtetuese të vendeve anëtare, përfshirë edhe Shqipërinë, me GJEDNJ-në. Kështu edhe midis Gjykatës Kushtetuese Spanjolle dhe asaj të GJEDNJ-së ka shumë mospërputhje. Në rradhë të parë sa herë që GJEDNJ-ja dënon shtetin spanjoll, kjo shpeshherë është kundër vetë Gjykatës Kushtetuese të këtij vendi, e cila normalisht përfshihet në çështje përderisa duhet të shterohen gjitha mjetet në mënyrë që t'i drejtohesh GJEDNJ-së. Por, nga ana tjetër edhe Gjykata

<sup>1121</sup> Ligji nr.8137, datë 31.7.1996 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore".

<sup>1122</sup> Crnic, Jadanko, "What rights can be duly protected by a constitutional complaint", botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15", botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998, fq. 70-71.



Kushtetuese Spanjolle nuk e konsideron vetën si një zbatuese e thjeshtë e kërkesave të GJEDNJ-së.<sup>1123</sup>

Gjykata jonë Kushtetuese, gradualisht me kalimin e viteve, por gjithmonë e më shumë i referohet KEDNJ ashtu siç është interpretuar nga GJEDNJ-së në një numër të madh vendimesh, veçanërisht kur kemi të bëjmë me të drejtat dhe liritë themelore të individëve. Ky referim bëhet drejtpërdrejtë në tekstin e Konventës, ashtu edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së. Referimi në rastet e GJEDNJ bëhet pasi është e pamundur që një gjykatë kombëtare përfshirë edhe Gjykatën Kushtetuese t'i japë normave të KEDNJ një tjetër kuptim nga ato që i kanë dhënë jurisprudenca e GJEDNJ-së.<sup>1124</sup>

Përdorimi i KEDNJ-së dhe rasteve të GJEDNJ-së bëhet për disa arsye. Në radhë të parë përdoret për të mbështetur vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese. Në këtë kuptim, jurisprudenca e GJEDNJ-së përdoret si një instrument ndihmës për të mbështetur vendimin e Gjykatës Kushtetuese, apo si një mjet interpretues për të përcaktuar përmbajtjen dhe qëllimin e të drejtave themelore dhe parimeve kushtetuese të Kushtetutës sonë.<sup>1125</sup> Jurisprudenca jonë kushtetuese ofron plot shembuj në këtë drejtim.

Së dyti, Gjykata Kushtetuese, duke pasur në konsideratë edhe formulimin e nenit 17, pika 2 të Kushtetutës sonë, ka mundësi që të konstatojë vetë edhe cënimin e KEDNJ mbi bazën e kërkesave që mund të vijnë nga subjekte të ndryshme.<sup>1126</sup> Në vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese, shpeshherë është konstatuar që një ligj apo akt i caktuar përveçse bie në kundërshtim me Kushtetutën, cënon edhe vetë KEDNJ. Si shembull por marrim rastin e çështjes së dënimit me vdekje ku Gjykata Kushtetuese mbajti këtë qëndrim:

*Konventa Europiane për të Drejtat e njeriut është një nga këto marrëveshje ndërkombëtare, të cilën Shqipëria e ka nënshkruar dhe ratifikuar. Sipas nenit 1 të Protokollit nr.6, "dënimi me vdekje, hiqet. Askush nuk mund të ndëshkohet me një dënim të tillë, as të ekzekutohet". Shqipëria nuk ka arritur që të ratifikojë aktualisht Protokollin nr.6 të Kësaj Konventë, por nisur nga fakti që Kushtetuta në nenin 17, pika 2 nuk lejon për asnjë rast kufizime të lirive dhe të të drejtave të njeriut që mund të tejkalojnë ato kufizime të parashikuara në Konventë, kuptohet se dënimi me vdekje i parashikuar nga Kodi Penal është një tejkallim i konceptit dhe frymës që krijon Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si dhe i vetë Konventës, e cila nuk e parashikon një kufizim të tillë."<sup>1127</sup>*

Së treti, Gjykata Kushtetuese ndryshon edhe jurisprudencën e saj me qëllim që të përshtatet me jurisprudencën e GJEDNJ. Shembuj të tillë janë të shumtë edhe në vende të tjera si

<sup>1123</sup> Sanchez, Pedro Julio Tenorio, "International treaties in Spanish Law", botuar në "International Constitutional Law", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2014, fq.360.

<sup>1124</sup> Mezzetti, Luca; Polacchini, Francesca; "Primacy of supranational Law and supremacy of the Constitution in the Italian legal system", botuar në "International Constitutional Law", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2014, fq.171.

<sup>1125</sup> Pistan, Carna, "The implementation of International/European Law in the Republic of Croatia: Theory and practice", botuar në "International Constitutional Law", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2014, fq.46.

<sup>1126</sup> Di Martino, Alessandra, "The open constitutional state: Germany response to international and european legal pluralism", botuar në "International Constitutional Law", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2014, fq.118.

<sup>1127</sup> Vendimi nr.65, datë 10.12.1999 i Gjykatës Kushtetuese.

në Kroaci,<sup>1128</sup> Hungari, etj.<sup>1129</sup> Raste të ndryshimit të jurisprudencës sonë kushtetuese mund të përmendim pranimin e kërkesave të individëve kur pretendonin shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i moszekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë,<sup>1130</sup> që erdhi si pasojë e vendimmarrjes së GJEDNJ-së në çështjen “Qufaj kundër Shqipërisë”.<sup>1131</sup> Në këtë rast GJEDNJ i referohej të drejtës së Gjykatës Kushtetuese për të trajtuar ankesa të tilla nga ana e individëve dhe për të marrë vendime detyruese për të gjitha palët.<sup>1132</sup> Një tjetër rast është pranimi i kërkesave për pretendimin e cënimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i zhvillimit të gjyqimit tej një afati të arsyeshem,<sup>1133</sup> pasojë kjo e çështjes “Gjonboçari dhe të tjerë kundër Shqipërisë”<sup>1134</sup> ku vendi ynë u gjet fajtor për shkeljen e të drejtave të parashikuara në Konventë në lidhje me zhvillimin e proceseve gjyqësore brenda një afati të arsyeshem kohor dhe mungesën e mjeteve efektive ankimore në lidhje me këtë situatë, pra, neni 6 dhe neni 13 i Konventës.<sup>1135</sup> Përveç rasteve kur kemi pasur një vendimarrje të drejtpërdrejtë të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, Gjykata jonë Kushtetuese ka pranuar që të ndryshojë jurisprudencën e saj edhe bazuar në vendimarrje të tjera të GJEDNJ, pavarësisht se kundër vendit tonë nuk kishte asnjë vendim. Në këtë rast Gjykata jonë Kushtetuese i'u referua praktikës së GJEDNJ-së kundër vendeve të tjera.<sup>1136</sup>

Por, ka pasur raste kur Gjykata jonë Kushtetuese ka refuzuar që të ndjekë jurisprudencën e GJEDNJ. Këtë ajo e ka bërë bazuar në argumentin se KEDNJ përbën një standard minimum të cilin shtetet anëtare mundet që ta tejkalojnë nëpërmjet legjislacionit të tyre të brendshëm. Në këtë drejtim kur Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se ndodhemi përballë një jurisprudence të GJEDNJ e cila ofron mbrojtje më të ulët së parashikimet kushtetuese, ajo ka zbatuar pa ngurim këto të fundit.<sup>1137</sup>

Një rast problematik mbetet kur GJEDNJ-ja ka vendosur në çështjen “Marini kundër Shqipërisë”, përse i përket vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese në rast të barazisë së votave. Në këtë rast Gjykata vendos refuzimin e kërkesës, por që sipas GJEDNJ-së kjo lloj vendimarrje është në kundërshtim me KEDNJ-në. Në këtë rast duke ndjekur shembullin e

<sup>1128</sup> Pistan, Carna, “The implementation of International/European Law in the Republic of Croatia: Theory and practice”, botuar në “International Constitutional Law”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “G. Giappichelli Editore”, Torino 2014, fq.46.

<sup>1129</sup> Kovacs, Peter, “International Law in recent jurisprudence of the Hungarian Constitutional Court – Opening a new tendency?”, botuar në “International Constitutional Law”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “G. Giappichelli Editore”, Torino 2014, fq.466.

<sup>1130</sup> Vendimi nr.6, datë 31.3.2006 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>1131</sup> GJEDNJ, Vendimi i Seksionit të tretë, datë 18 nëntor 2004, çështja “Qufaj Co. sh.p.k. kundër Shqipërisë”, aplikimi nr.54268/00.

, aplikimi nr. 133/1996/752/951, paragraf. 42-43.

<sup>1132</sup> Alimehmeti, Evis, “Neni 13 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave e Lirive Themelore të Njeriut dhe kuadri ligjor shqiptar”, Shtëpia Botuese “GEER”, Tiranë 2012, fq.110.

<sup>1133</sup> Vendimi nr.12, datë 5.3.2012 i Gjykatës Kushtetuese.

<sup>1134</sup> GJEDNJ, Vendimi i Seksionit të katërt, datë 23 tetor 2007, çështja “Gjonboçari dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, aplikimi nr.10508/02.

<sup>1135</sup> Alimehmeti, Evis, “Neni 13 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave e Lirive Themelore të Njeriut dhe kuadri ligjor shqiptar”, Shtëpia Botuese “GEER”, Tiranë 2012, fq.117.

<sup>1136</sup> Vendimi nr.30, datë 17.6.2010 i Gjykatës Kushtetuese, paragraf.35 dhe 37.

<sup>1137</sup> Vendimi nr.76, datë 25.4.2002 i Gjykatës Kushtetuese.

vendeve të tjera<sup>1138</sup> duhet që të ndryshojmë edhe vetë LGJK-në, përse i përket këtij aspekti procedural, por që deri më sot nuk ka pasur asnjë ndërhyrje nga ana e ligjvënësit.

Ndryshe nga sa u trajtua më sipër, Gjykata jonë Kushtetuese e ka pasur më të lehtë që të veprojë në kushtet e vakumit ligjor. Kështu megjithëse K.Pr.P. nuk parashikonte si shkak për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, vendimin e GJEDNJ, Gjykata Kushtetuese është shprehur se mungesa e një parashikimi ligjor nuk mundet që të jetë shkak për të moszbatuar vendimin e GJEDNJ-së. Ky qëndrim i Gjykatës sonë është shumë më përparimtar se i disa gjykatave të tjera kushtetuese. Në një rast të ngjashëm në Gjermani, Gjykata Kushtetuese Federale mbasi specifikoi kufijtë kohorë, subjektive dhe objektive të efekteve të vendimeve të GJEDNJ-së, mohoi rihapjen e një procedure për shkak se vendimi kombëtar ishte final. Kjo u rregullua vetëm më pas me ndryshimet në K.Pr.P. gjermane në vitin 1998.<sup>1139</sup>

Përdorimi i jurisprudencës së GJEDNJ nga Gjykata jonë Kushtetuese është i plotë. Pra, Gjykata në zgjidhjen e çështjeve nuk i referohet vetëm rasteve që GJEDNJ ka vendosur kundër Shqipërisë por edhe rasteve të tjera të vendosur kundër vendeve të tjera. Madje siç e cituam më sipër rastet e huaja kanë shërbyer edhe për ndryshimin e vetë jurisprudencës kushtetuese shqiptare. Kjo qasje tregon solidaritetin e Gjykatës me një praktikë tipike në shumë vende të Evropës, sipas së cilës efekti direkt i një vendimi të GJEDNJ-së nuk ka vlerë vetëm për shtetin palë në proces, por i shtrin efektet e tij plotësisht edhe kundrejt vendeve të tjera anëtare të KEDNJ-së.<sup>1140</sup> Megjithatë jo të gjitha vendet e kanë pranuar një mundësi të tillë. Kështu fillimisht Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane nuk ka pranuar të marrë në konsideratë vendimet që GJEDNJ kishte dhënë kundër shteteve të tjera me arsyetimin se në këtë rast ndodhemi përballë situatave të ndryshme të cilat ndryshojnë nga një vend në tjetrin për më tepër kur edhe palët janë të ndryshme. Pra jemi përpara specifikave shumë të veçanta.<sup>1141</sup> Megjithatë në vitin 2011 Gjykata Kushtetuese Federale pranoi se vendimet e GJEDNJ-së në “raste paralele” (ato që i përkasin të njëjtit shtet por jo të njëjtave palëve private) duhet të kenë të paktën efikasitetin fakultativ të një precedenti dhe për këtë arsye referimi tek KEDNJ duhet të jetë i mirë orientuar. Qëllimi i këtij ndryshimi ishte që të shmangte sa më shumë të ishte e mundur përgjegjësinë ndërkombëtare të Gjermanisë.<sup>1142</sup> Por, ky rast është i izoluar dhe në përgjithësi shtetet ndjekin jurisprudencën e GJEDNJ-së.

Raporti midis Gjykatës sonë Kushtetuese dhe GJEDNJ merr një zhvillim të ri, në momentin që do të hyjë në fuqi Protokollin i 16 i cili është ratifikuar nga vendi ynë.<sup>1143</sup> Qëllimi i

<sup>1138</sup> Pistan, Carna, *“The implementation of International/European Law in the Republic of Croatia: Theory and practice”*, botuar në *“International Constitutional Law”*, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “G. Giappichelli Editore”, Torino 2014, fq.47.

<sup>1139</sup> Di Martino, Alessandra, *“The open constitutional state: Germany response to international and european legal pluralism”*, botuar në *“International Constitutional Law”*, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “G. Giappichelli Editore”, Torino 2014, fq.117.

<sup>1140</sup> Kampo, Vlodymyr M.; Savchyn, Mykhaylo V.; *“Ukraine: International treaties and European acts in national courts practice”*, botuar në *“International Constitutional Law”*, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “G. Giappichelli Editore”, Torino 2014, fq.447.

<sup>1141</sup> Di Martino, Alessandra, *“The open constitutional state: Germany response to international and european legal pluralism”*, botuar në *“International Constitutional Law”*, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “G. Giappichelli Editore”, Torino 2014, fq.118.

<sup>1142</sup> Po aty, fq.120.

<sup>1143</sup> Ligji nr.48/2015 “Për ratifikimin e Protokollit të 16-të të Konventës “Për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Në Protokollin 16, neni 1 ka këtë përmbajtje: 1. Gjykata dhe tribunale më të larta të një Pale të Lartë Kontraktuese, të përcaktuara në përputhje me nenin 10, mund t'i kërkojnë Gjykatës të japë opinione rekomanduese mbi çështje parimore të lidhura me interpretimin ose zbatimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara



këtij protokollit është që të forcojë dialogun institucional midis gjykatave të brendshme dhe GJEDNJ-së duke u dhënë të drejtën gjykatave më të larta të shteteve kontraktuese mundësinë që të kërkojnë një opinion këshillimor mbi bazën e pyetjeve që kanë të bëjnë në parim me interpretimin apo zbatimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë dhe protokollet e saj. Besohet se ndërhyrja e gjyqtarëve evropianë do të shërbejë për të siguruar një interpretim të qëndrueshëm midis dy niveleve (ndërkombëtar dhe të brendshëm) të mbrojtjes.<sup>1144</sup>

Nëse bëjmë një analizë të këtij protokollit, rezulton se Gjykata dhe Tribunalet më të larta të palëve kontraktuese kanë të drejtë t'i kërkojnë GJEDNJ, një opinion këshillimor. Dispozita në fakt përmend termin "mund". Përdorimi i këtij termi tregon që ky mekanizëm është fakultativ, nuk është detyrues dhe për më tepër edhe në rast se "gjykatat e larta" i janë drejtuar GJEDNJ, ato mund të tërhiqen në çdo rast, kuptohet derisa nuk është dhënë vendimi.<sup>1145</sup>

Protokollit bën fjalë gjithashtu për të drejtën e gjykatave më të larta të shtetit për ta ushtruar këtë të drejtë. Përcaktimi i këtyre gjykatave bëhet sipas nenit 10 të Protokollit dhe konkretisht nëpërmjet një letre që autoritetet e secilit vend i drejtojnë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Sipas informacionit që jep Këshilli i Evropës, deri më tani Protokollit 16 është ratifikuar nga pesë shtete të cilat janë: Shqipëria, Gjeorgjia, Rumania, San Marino dhe Sllovenia. Shqipëria, Gjeorgjia dhe Sllovenia kanë përzgjedhur si gjykata të larta në kuptim të neneve 1 dhe 10 të Protokollit 16 të KEDNJ, Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë. San Marino ka përzgjedhur të vetmen gjykatë që ky shtet ka (Gjykata e San Marino). Ndërsa Rumania ka përzgjedhur përveç Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe Drejtësisë dhe Gjykatës Kushtetuese edhe gjykatat e apelit.<sup>1146</sup> Pra, siç mund të shihet vende të ndryshme zgjedhin vetë se deri në çfarë niveli do të duan të shkojnë në përcaktimin e gjykatave që e gëzojnë këtë të drejtë. Për mendimin tim personal, duke qenë se gjykatat e apelit marrin vendime që janë të formës së prerë dhe Gjykata e Lartë si edhe ajo Kushtetuese kanë të drejtë të mos i marrin në shqyrtim rekursat/kërkesat që vijnë kundër këtyre vendimeve, duhet që të kishin mundësi t'i drejtoheshin GJEDNJ, nëpërmjet këtij mekanizmi.

Në çdo rast shteti mund të ndryshojë listën e gjykatave të larta që ka përcaktuar. Qëllimi i këtij parashikimi është që të kemi një diskrecion të vendeve anëtarë për të përcaktuar vetë gjykatat e tyre të larta në përputhje me strukturën e tyre kushtetuese të pushtetit gjyqësor por edhe të gjykatave të veçanta. Për më tepër përcaktimi i gjykatës më të lartë duket sikur është në përputhje me parimin e Konventës për shterimin e të gjitha mjeteve përpara se t'i drejtohesh GJEDNJ. Në këtë drejtim fakti që kërkesën e bën autoriteti më i lartë gjyqësor, tregon se çështja ka kaluar nëpër të gjitha shkallët e gjyqimit.<sup>1147</sup>

---

*në Konventë ose protokollet e saj.2. Gjykata ose tribunali kërkues mund të kërkojnë një opinion rekomandues vetëm në kontekstin e një çështjeje të mbetur pezull para saj.3. Gjykata ose tribunali kërkues jep arsyet për kërkesën e saj/të tij dhe informacionin përkatës paraparak ligjor dhe faktik në lidhje me çështjen e mbetur pezull.*

<sup>1144</sup> Mezzetti, Luca; Polacchini, Francesca: "Primacy of supranational Law and supremacy of the Constitution in the Italian legal system", botuar në "International Constitutional Law", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Boniese "G. Giappichelli Editore", Torino 2014, fq.173.

<sup>1145</sup> Këshilli i Evropës, "Protocol No. 16 to the Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms – Explanatory Report", fq.2, marrë nga adresa e internetit: [http://www.echr.coe.int/Documents/Protocol\\_16\\_explanatory\\_report\\_ENG.pdf](http://www.echr.coe.int/Documents/Protocol_16_explanatory_report_ENG.pdf) (parë për herë të fundit me datë 5.7.2015)

<sup>1146</sup> Informacion i marrë nga faqja zyrtare e internetit të GJEDNJ, në adresën <http://conventions.coe.int/Treaty/Commun/ListeDeclarations.asp?NT=214&CM=8&DF=01/08/2014&CL=ENG&V=L=1>. (Parë për herë të fundit me datë 18.8.2015).

<sup>1147</sup> Këshilli i Evropës, "Protocol No. 16 to the Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms – Explanatory Report", fq.2, marrë nga adresa e internetit:

Nga formulimi i protokollit rezulton gjithashtu se opinioni këshillimor jepet mbi çështje parimore të lidhura me interpretimin ose zbatimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë ose protokollet e saj.

Sipas paragrafit të dytë, opinioni mund të kërkohet vetëm për çështje të cilat janë duke u shqyrtuar përpara gjykatës kombëtare. Në këtë drejtim ky mekanizëm është i ngjashëm me kontrollin incidental. Pra, gjykatat kombëtare do të duhet që të kenë një çështje konkrete për gjykim pranë tyre, çështje e cila prek parashikimet e KEDNJ-së. Në këtë rast nuk mundet kurrësesi që gjykatat e larta të kërkojnë opinion këshillimor në mënyrë abstrakte.

Paragrafi i tretë, është më natyrë procedurale. Sipas këtij paragrafi gjykata kombëtare do të duhej që të japë arsyet e një kërkesë të tillë, si edhe duke sqaruar situatën faktike dhe ligjore të çështjes. Për këtë arsye gjykata kërkuese duhet që t'i paraqesë GJEDNJ-së:

- objektin e kërkesës së çështjes konkrete dhe faktet kryesore të ngjara gjatë procedurës gjyqësore ose të paktën një përmbledhje të tyre;
- dispozitat ligjore kombëtare të rëndësishme për çështjen;
- çështjet e rëndësishme që prekin Konventën, në veçanti të drejtat dhe liritë që preken;
- nëse është e nevojshme një përmbledhje e pretendimeve dhe argumentave të palëve në procedurën gjyqësore kombëtare në këtë çështje;
- nëse është e mundur dhe e përshtatshme, një qëndrim të gjykatës ku pasqyrohen qëndrimet e saj në lidhje me çështjen, duke përfshirë çdo analizë që ajo mund të ketë mbi çështjen.<sup>1148</sup>

Paraprakisht procedura shqyrtohet nga një panel prej 5 gjyqtarësh të cilët zgjidhen nga gjyqtarët e dhomës së madhe të GJEDNJ-së. Qëllimi i kësaj procedure seleksionuese është që të shmangë shqyrtimin e kërkesave të cilat nuk janë bërë në përputhje me kërkesat procedurale, ose kërkohet të abuzohet me dhënien e opinionit këshillimor. Megjithatë duke qenë se kjo kërkesë do t'i drejtohet nga një gjykatë e lartë siç është edhe Gjykata Kushtetuese, vështirë se mund të themi që kërkesa të tilla do të mund të refuzohen. Gjithsesi në çdo rast edhe kur vendos refuzimin, paneli duhet që ta arsyetojë vendimin e saj, në ndryshim nga procedurat e tjera refuzuese që ajo ndjek. Kjo bëhet me qëllim për të rritur dialogun midis gjykatave kombëtare dhe GJEDNJ. Në ndryshim nga gjykimi kushtetues nëse paneli e ka pranuar kërkesën, Dhoma e Madhe do të japë opinionin këshillimor. Pra, Dhoma e Madhe e GJEDNJ nuk ka të drejtë që të refuzojë dhënien e opinionit. Edhe në këtë rast gjyqtari që i përket vendit nga vjen kërkesa duhet që të jetë pjesë e trupës gjyqësore dhe në rast pamundësie ligjore zëvendësohet nga një gjyqtar tjetër i caktuar nga Kryetari.

Në rast se çështja kalon për gjykim, Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut dhe Pala e Lartë Kontraktuese të cilës i përket gjykata ose tribunali kërkues, kanë të drejtën e paraqitjes së komenteve me shkrim dhe të jenë pjesëmarrës në seancë. Në interesin e miradministrimit të drejtësisë, Kryetari i Gjykatës gjithashtu mund të ftojë ndonjë palë tjetër të lartë kontraktuese ose person që të paraqesë komente me shkrim ose të marrë pjesë në seancë.<sup>1149</sup> Në kuptim të kësaj dispozite lejohet që të marrin pjesë përfaqësuesit e qeverisë së vendit, gjykata e të cilit ka bërë kërkesën, por edhe përfaqësues të vendeve të tjera të cilët mund të kenë raste të

---

[http://www.echr.coe.int/Documents/Protocol\\_16\\_explanatory\\_report\\_ENG.pdf](http://www.echr.coe.int/Documents/Protocol_16_explanatory_report_ENG.pdf) (parë për herë të fundit me datë 18.8.2015).

<sup>1148</sup> Këshilli i Evropës, "Protocol No. 16 to the Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms – Explanatory Report", fq.3, marrë nga adresa e internetit: [http://www.echr.coe.int/Documents/Protocol\\_16\\_explanatory\\_report\\_ENG.pdf](http://www.echr.coe.int/Documents/Protocol_16_explanatory_report_ENG.pdf) (parë për herë të fundit me datë 18.8.2015).

<sup>1149</sup> Protokollit 16 i KEDNJ, neni 3.

ngjashme si edhe janë të interesuar në vendimin që mund të marrë GJEDNJ. Po kështu GJEDNJ dhe në këtë lloj procedure ka të drejtë që të marrë opinione *amicus curiae* nga subjekte të ndryshme.

Opinionet në çdo rast duhet të jetë i arsyetuar dhe atij i bashkëlidhen edhe mendimet e gjyqtarëve në pakicë nëse ka. Ky vendim u njoftohet të gjitha palëve dhe publikohet. E veçanta është se ky vendim sipas protokollit nuk është detyrues, ai është vetëm këshillimor. Megjithatë duke pasur në konsideratë faktin se një çështje e tillë mund të shkojë përsëri në GJEDNJ mbi bazën e aplikimeve individuale, GJEDNJ-ja normalisht do të mbajë qëndrimin e saj të mëparshëm. Për rrjedhojë, megjithëse jo formalisht detyrues, praktikisht vlera e tij juridike është e një rëndësie të madhe. Në rastin tonë nëse kërkesa është bërë nga Gjykata Kushtetuese dhe GJEDNJ shprehet se në opinionin e saj nëse një akt ligjor, nënligjor apo gjyqësor është në kundërshtim me KEDNJ, atëherë ajo do t'i duhet që të shfuqizojë aktin. Ndërsa nëse situata paraqitet e njëjtë por kërkesa është bërë nga Gjykata e Lartë atëherë, nëse akti është ligj ajo do të duhet të ushtrojë kontrollin incidental para Gjykatës Kushtetuese, ndërsa në rast se jemi përpara një akti normativ nënligjor atëherë do të duhet të mos e zbatojë atë, kurse kur është një vendim gjyqësor ta prishë dhe ta kthejë çështjen për rigjykim.

## **6. Raporti i Gjykatës Kushtetuese me Gjykatën Evropiane të Drejtësisë dhe me legjislacionin e BE**

Vendi ynë si çdo vend tjetër që doli nga regjimi komunist, ka filluar që në fillim të viteve '90 të shekullit XX, përpjektet për reformimin tërësor të sistemit politik, juridik dhe ekonomik me qëllim përshtatjen e tij për t'u bërë pjesë e familjes së madhe evropiane të njohur sot si Bashkimi Evropian. Integrimi i vendit tonë në këtë organizatë *sui generis* sjell edhe problematika të përcaktimit të një raporti sa më të drejtë midis Kushtetutës sonë dhe legjislacionit, parësor dhe dytësor, të BE-së.

Për këtë arsye kjo pjesë e fundit e punimit synon që të trajtojë raportin që do të ketë Gjykata jonë Kushtetuese me GJED-në dhe me legjislacionin e BE-së, në të ardhmen.

### **6.1 Raporti i Gjykatës Kushtetuese me GJED.**

GJED-ja është organi gjyqësor kryesor i BE-së i ngarkuar nga traktatet themeluese për të garantuar interpretimin e njëzuar të legjislacionit të BE-së nga të gjitha vendet anëtare. Për këtë arsye TFBE-ja përcakton si një nga gjykimet që mund të zhvillohen prej saj edhe i çështjeve paragjykimore të cilat ngrihen mbi bazën e pyetjeve që vijnë nga gjykatat kombëtare të vendeve anëtare të BE-së. Gjykatat kombëtare, veçanërisht kur janë shkallë e fundit, janë të detyruara që të ngrejne pyetjen paragjykimore në lidhje me një akt të BE-së, nëse është e nevojshme për të zgjidhur çështjen e paraqitur përpara tyre, nuk është interpretuar më parë nga GJED-ja në një rast të ngjashëm ose nëse zbatimi korrekt i së drejtës së BE-së nuk është i mundur duke shmangur çdo dyshim të arsyeshëm në lidhje me të.<sup>1150</sup> TFBE-ja përmend termin "gjyqtar kombëtar". Në këtë kuptim shihet e nevojshme sqarimi i këtij termi dhe nëse në këtë term përfshihet apo jo edhe Gjykata jonë Kushtetuese.

<sup>1150</sup> Gamper, Anna, "Austria", botuar në "Giustizia Costituzionale e Unione Europea – Una comparazione tra Austria, Francia, Germania, Italia, Spanga e Portogallo", në kujdesin e Alfonso Celotto, Javier Tajadura, Josu De Miguel Barcena, Shtëpia Botuese "Editoriale Scientifica srl", Napoli 2011, fq.142.



Duke qenë se termi “gjykatë kombëtare”, përmendet në traktatin e BE-së, atëherë rezulton se i takon GJED-së që të na japë kriteret për të përcaktuar se cili organizëm kombëtar mund të konsiderohet si “gjykatë” në kuptim të traktatit. Sipas GJED-së, një “gjykatë” është një organ i krijuar me ligj. Ajo është e përhershme dhe ka për mision të zgjidhë mosmarrëveshjet mbi bazën e së drejtës në kuadrin e një procedure kontradiktore. Kompetenca e saj nuk varet nga vullneti i palëve.<sup>1151</sup> Si një çështje e cila u trajtua më vonë nga jurisprudenca e GJED-së ishte edhe kriteri i gjashtë por shumë i rëndësishëm, ai i pavarësisë së gjykatës.<sup>1152</sup>

Fillimisht duhet sqaruar që gjykatat kushtetuese, të cilat kanë edhe një lloj prestigji si ajo gjermane, italiane dhe franceze, kanë refuzuar që ta konsiderojnë veten si “gjykatë kombëtare” në kuptim të traktatit. Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane, në ato raste kur çështja nuk mund të zgjidhej pa pasur një vendim interpretativ të legjislacionit të BE-së dhe gjykatat e zakonshme gjatë procedurës përkatëse nuk i ishin drejtuar me një pyetje paragjykimore GJED-së, prishte vendimet duke e kthyer çështjen për rigjykim dhe duke i lënë si detyrë gjykatës së zakonshme që t’i drejtohej GJED-së.<sup>1153</sup> Megjithatë edhe së fundi Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane ka pranuar që ta konsiderojë vetën si “gjykatë kombëtare” në kuptim të traktateve të BE-së dhe për rrjedhojë të ngrejë pyetje për çështje paragjykimore pranë GJED-së.<sup>1154</sup>

Në Itali, Gjykata Kushtetuese, me vendimin e saj nr.13 të vitit 1960 ishte deklaruar si jo e përshtatshme për t’u përfshirë në organet gjyqësore, të zakonshme apo të posaçme për dallimet e theksuara për shkak të detyrës që i ishte ngarkuar asaj.<sup>1155</sup> Frika qëndronte në argumentin që përdorimi i një mekanizmi të tillë do të cënonte vetë legjitimitetin e Gjykatës Kushtetuese duke e ndikuar atë nga interpretimet e GJED-së dhe duke e vendosur në një pozicion varësie të nënkuptuar.<sup>1156</sup> Ky qëndrim jurisprudencial i kësaj gjykate u ndryshua vetëm nëpërmjet urdhëresës nr.103 të vitit 2008, në të cilin Gjykata Kushtetuese e përcakton funksionin e saj si një “gjykatë kombëtare” në kuptim të Traktatit të BE-së dhe si gjykatë e instancës së fundit në lidhje me një rreth të caktuar çështjesh.<sup>1157</sup>

Edhe në Francë, ka pasur fillimisht një qëndrim të ngjashëm por për arsye të tjera. Kështu, deri në vitin 2013, Këshilli Kushtetues Francez, në mënyrë sistematike ka refuzuar që të zbatojë nenin 267 të TFBE-së. Shumë autorë kanë vënë në dukje pamundësinë teknike për

<sup>1151</sup> Jacque, Jean Paul, *“E drejta institucionale e Bashkimit Evropian”*, botim në shqip, Shtëpia Botuese “Papyrus”, Tiranë 2010, fq.527.

<sup>1152</sup> Po aty, fq.528.

<sup>1153</sup> Vidal, Carlos, *“Germania”*, botuar në “Giustizia Costituzionale e Unione Europea – Una comparazione tra Austria, Francia, Germania, Italia, Spanga e Portogallo”, në kujdesin e Alfonso Celotto, Javier Tajadura, Josu De Miguel Barcena, Shtëpia Botuese “Editoriale Scientifica srl”, Napoli 2011, fq.80.

<sup>1154</sup> Vendimi 2 BvR 2728/13, 2 BvR 2728/13, 2 BvR 2729/13, 2 BvR 2730/13, 2 BvR, 2731/13, datë 14 janar 2014, i Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë.

<sup>1155</sup> Cannone, Andrea, *“La giurisprudenza costituzionale in materia internazionale ed europea, 2001 – 2009, III”*, Shtëpia Botuese “Editoriale Scientifica” Napoli 2010, fq.XXIX.

Mezzetti, Luca; Polacchini, Francesca; *“Primacy of supranational law and supremacy of the Constitution in the Italian legal system”*, botuar në “International Constitutional Law”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “G. Giappichelli Editore”, Torino 2014, fq.178.

<sup>1156</sup> Celotto, Alfonso, *“Italia”*, botuar në “Giustizia Costituzionale e Unione Europea – Una comparazione tra Austria, Francia, Germania, Italia, Spanga e Portogallo”, në kujdesin e Alfonso Celotto, Javier Tajadura, Josu De Miguel Barcena, Shtëpia Botuese “Editoriale Scientifica srl”, Napoli 2011, fq.273.

<sup>1157</sup> Cannone, Andrea, *“La giurisprudenza costituzionale in materia internazionale ed europea, 2001 – 2009, III”*, Shtëpia Botuese “Editoriale Scientifica” Napoli 2010, fq.XXVII – XXVIII.

Mezzetti, Luca; Polacchini, Francesca; *“Primacy of supranational law and supremacy of the Constitution in the Italian legal system”*, botuar në “International Constitutional Law”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “G. Giappichelli Editore”, Torino 2014, fq.179.

Këshillin Kushtetues që të aktivizojë mekanizmin paragjykimor brenda juridiksionit të saj për kontrollin *apriori* të ligjeve. Mekanizmi paragjykimor nuk zbatohet në këtë rast duke qenë se nuk kemi paraqitje të një kërkesë, asnjë “palë” nuk paraqitet në gjykim, nuk ka domosdoshmërisht një argumentim dhe nuk ka asnjë interes për ta vënë në lëvizje. Për më tepër vetë Këshilli Kushtetues ka shtuar një tjetër argument të cilin e lidh me afatin e shkurtër brenda së cilit zhvillohet gjykimi *apriori* dhe për rrjedhojë pamundësia e saj për të aplikuar një mekanizëm të tillë.<sup>1158</sup> Megjithatë edhe Këshilli Kushtetues Francez, bazuar në ndryshimet kushtetuese që ishin bërë, konkretisht shtimi i nenit 88-2 që të referon në të drejtën e BE, u detyrua që në vitin 2013 t’i drejtohej GJED-së për interpretimin e një direktive të BE-së. Interesant është fakti që në këtë rast Dhoma e Madhe e GJED-së pranoi kërkesën e Këshillit Kushtetues për ta shqyrtuar me urgjencë maksimale.<sup>1159</sup>

Por ka pasur edhe gjykata kushtetuese, të cilat nuk e kanë konsideruar asnjëherë problem mundësinë për të ngritur çështje paragjykimore pranë GJED-së. Kështu, pavarësisht se Austria ka qenë një nga vendet që ka hyrë vonë në BE, në vitin 1995, Gjykata e saj Kushtetuese ka qenë ndër të parat që ka ushtruar një mundësi të tillë. Një veprim i tillë nuk do të thotë se Gjykata Kushtetuese Austriake e sheh GJED-në si një gjykatë eprore ndaj saj. Kjo lloj procedure tregon një lloj raporti bashkëpunimi midis këtyre gjykatave si të barabarta dhe plotësuese ndaj njëra – tjetrës.<sup>1160</sup>

Duke pasur parasysh këto qëndrime është e nevojshme që të analizojmë nëse Gjykata jonë Kushtetuese, përmbush kriteret që kërkohen nga traktati i BE-së dhe jurisprudenca e GJED-së për tu konsideruar si “gjykatë kombëtare”.

Kriteri i parë që kërkohet në këtë rast është krijimi i saj me ligj. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë rezulton se është krijuar fillimisht me ligj kushtetues<sup>1161</sup> dhe aktualisht funksionon bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe të LGJK-së, por kuptohet që personalitetin e saj e fiton për shkak të parashikimeve kushtetuese.

Kriteri i dytë, që gjykata të jetë e përhershme, plotësohet edhe në këtë rast. Dispozitat përkatëse kushtetuese e kanë formuar atë si një organ të përhershëm, dhe nuk parashikojnë asnjë afat për veprimtarinë e saj. Një tjetër argument në favor të kësaj teze është edhe fakti që ndryshimi i ligjit kushtetues në vitin 1998 nuk solli asnjë pasojë në lidhje me kohëzgjatjen e Gjykatës Kushtetuese. Nuk duhet të ngatërrohet në këtë rast, mandati që kanë gjyqtarët kushtetues me përhershmërinë e Gjykatës Kushtetuese si institucion. Përfundimi i mandateve të gjyqtarëve të veçantë, ka si qëllim përtëritjen e Gjykatës Kushtetuese me gjyqtarë të rinj duke sjellë përvoja të reja në drejtësinë kushtetuese. Por ky ndryshim i gjyqtarëve nuk ka asnjë pasojë në ekzistencën e Gjykatës Kushtetuese si institucion.

Kriteri i tretë, zgjidhja e mosmarrëveshjes mbi bazën e së drejtës, plotësohet edhe në këtë rast. Kështu Gjykata Kushtetuese zgjidh një sërë mosmarrëveshjes që kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë e ligjeve, marrëveshjeve ndërkombëtare, akteve normative nënligjore, mosmarrëveshjet e kompetencës, kushtetutshmërinë e partive politike, kushtetutshmërinë e

<sup>1158</sup> Burgorgue-Larsen, Laurnce; Bruck, Veronique; “*The relationship between EU Law, the ECHR and French Constitutional Law*”, botuar në “*International Constitutional Law*”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “G. Giappichelli Editore”, Torino 2014, fq.90.

<sup>1159</sup> Po aty, fq.92.

<sup>1160</sup> Gamper, Anna, “*Austria*”, botuar në “*Giustizia Costituzionale e Unione Europea – Una comparazione tra Austria, Francia, Germania, Italia, Spanga e Portogallo*”, në kujdesin e Alfonso Celotto, Javier Tajadura, Josu De Miguel Barcena, Shtëpia Botuese “Editoriale Scientifica srl”, Napoli 2011, fq.143.

<sup>1161</sup> Ligji nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.

çështjeve të shtruara për referendum, zgjedhjen, pajtueshmërinë e deputetëve dhe të Presidentit të Republikës, procedurat *impeachment*, ndaj Presidenit, anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, kryetarëve dhe këshillave të bashkive etj. Për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve Gjykata Kushtetuese zbaton Kushtetutën, si aktin parësor që përbën të drejtën në vendin tonë.

Kriteri i katërt, zgjidhja e mosmarrëveshjes bazuar në një procedurë kontradiktore, plotësohet nga vetë natyra e gjykimit që ushtron Gjykata Kushtetuese. Kështu në këtë punim, kemi trajtuar pozitën e ndryshme procedurale të subjekteve kërkuese, të subjekteve të interesuara si edhe të drejtave dhe detyrimeve të tyre në procesin kushtetues.

Përsa i përket kriterit të pestë, që kompetenca e saj për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me natyrë kushtetuese, nuk varet nga vullneti i palëve, plotësohet nga Gjykata jonë Kushtetuese. Kompetencat e saj janë të përcaktuara në Kushtetutë dhe të detajuara në ligj dhe për rrjedhojë pjesëmarrësit në një gjykim kushtetues, nuk mundet kurrësesi që t'i imponohen Gjykatës Kushtetuese.

Në lidhje me kriterin e gjashtë dhe të fundit, atë të pavarësisë së Gjykatës Kushtetuese, rezultojnë se Kushtetuta jonë ofron një sërë garancish të cilat kanë të bëjnë me mandatin, palëvizshmërinë, statusin, garancitë financiare etj, të gjyqtarëve kushtetues. Po kështu edhe vetë Gjykata Kushtetuese gëzon pavarësi institucionale dhe financiare nga pushtetet e tjera.

Pra, nga sa më sipër rezultojnë se Gjykata Kushtetuese, mundet që të konsiderohet si "gjykatë kombëtare" në kuptim të traktatit të BE-së dhe për rrjedhojë e aftë për të ngritur pyetje paragjykimore përpara GJED-së.

Sipas nenit 267 të TFBE-së, GJED-ja ka kompetencë të marrë vendim në rastin kur i drejtohet një kërkesë nga një gjyqtar kombëtar a) për interpretimin e traktateve dhe b) për vlefshmërinë dhe interpretimin e akteve të institucioneve, organeve apo organizmave të BE-së.<sup>1162</sup>

Nga ky formulim rezultojnë se Gjykata jonë Kushtetuese, në momentin e aderimit të vendit tonë në BE, mund të kërkojë interpretimin e normave të TFBE-së. Duhet theksuar se në këtë rast GJED-ja ka kompetencë vetëm për interpretimin e traktatit dhe jo për të kontrolluar vlefshmërinë e tij. Kjo pasi e drejta primare buron nga shtetet anëtare të BE-së dhe jo nga vetë Komuniteti. Për këtë arsye institucionet e Komunitetit nuk mund të vlerësojnë vlefshmërinë e saj. Por nga ana tjetër nëpërmjet pyetjeve paragjykimore, GJED-ja mund të bëjë interpretimin dhe/apo të kontrollojë vlefshmërinë e akteve që nxjerrin organet e BE-së.<sup>1163</sup>

Për këtë arsye GJED-ja ka përpunuar një sërë rregullash mbi bazën e së cilës mund të ngrihet pyetja paragjykimore nga gjykatat kombëtare, në rastin tonë nga Gjykata Kushtetuese. Kështu qëllimi i kësaj procedure është para së gjithash që t'i japë gjyqtarit kombëtar elementët e nevojshëm për të zgjidhur mosmarrëveshjen që i është paraqitur. Procedura e kërkesës paraprake për interpretim është në shërbim të gjyqtarit kombëtar dhe GJED-ja nuk mundet që të futet në çështje që duhet t'i vlerësojë gjykata kombëtare, siç janë faktet dhe saktësia e tyre. GJED-ja ka detyrimin që të përgjigjet, por nevojitet, që nga ana e tij, gjyqtari kombëtar t'i japë GJED-së elementët e nevojshëm me qëllim që përgjigja të jetë e drejtë.<sup>1164</sup> Interpretimi që gjyqtari kombëtar kërkon nga GJED-ja, duhet që domosdoshmërisht të ketë lidhje me mosmarrëveshjen që gjykohet pranë saj. Në rast të kundërt GJED-ja mund të refuzojë të përgjigjet nëse duket qartë

<sup>1162</sup> Jacque, Jean Paul, "E drejta institucionale e Bashkimit Evropian", botim në shqip, Shtëpia Botuese "Papyrus", Tiranë 2010, fq.526.

<sup>1163</sup> Po aty, fq.529.

<sup>1164</sup> Po aty, fq.531.



se interpretimi i së drejtës komunitare ose shqyrtimi i vlefshmërisë së një rregulli komunitar nuk ka asnjë lidhje me realitetin ose objektin e mosmarrëveshjes kryesore.<sup>1165</sup>

Po kështu, GJED mund të refuzojë t'u përgjigjet kërkesave të bëra në kuadrin e një mosmarrëveshje fiktive që është sajuar vetëm për të patur një interpretim të së drejtës komunitare.<sup>1166</sup>

Një tjetër kërkesë procedurale është që kërkesat për interpretim apo vlefshmërinë e një akti të BE-së të jenë detyruese kur bëhet fjalë për juridiksione vendimet e së cilës nuk mund të apelohej.<sup>1167</sup> Në rastin tonë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare.<sup>1168</sup> Pra, kundër tyre nuk lejohet asnjë formë ankimi apo rishikimi. Për këtë arsye Gjykata Kushtetuese, kur gjendet përballë normave të BE-së që kanë nevojë për interpretim apo kontroll të vlefshmërisë, është e detyruar t'i drejtohet GJED-së. Kjo nuk i heq të drejtën Gjykatës Kushtetuese për të vlerësuar nëse një vendim i tillë nevojitet për të dhënë vendim përfundimtar.<sup>1169</sup> Megjithatë nuk do të jemi përpara një detyrimi të tillë nëse materialisht çështja është e njëjtë me një çështje që ka qenë tashme objekt i një kërkesë për interpretim. Kjo është teoria e aktit të qartë, sipas së cilës, gjykatat nuk kanë nevojë t'i drejtohen GJED-së në rast kur dihet përgjigja që ajo do të marrë në këtë rast. Kuptohet që kjo vlen edhe për Gjykatën Kushtetuese.<sup>1170</sup> Nëse kemi një çështje që ndodhet përpara Gjykatës Kushtetuese dhe për kuptimin e një akti të së drejtës së BE-së është e nevojshme që të ngrihet çështja paragjykimore në GJED, por ndërkohë për të njëjtin akt ka bërë kërkesë një tjetër gjykatë e një tjetër vendi anëtar të BE-së, atëherë në këtë rast, Gjykata Kushtetuese duhet të pezullojë çështjen e saj, t'ia njoftojë pezullimin GJED-së dhe të presë vendimmarrjen e saj.<sup>1171</sup>

Nga së më sipër rezulton qartësisht se Gjykata jonë Kushtetuese plotëson kriteret për t'u konsideruar si "gjykatë kombëtare" në kuptim të TFBE-së dhe për rrjedhojë ka mundësi që në momentin e integritimit tonë në BE të bëjë kërkesa pranë GJED-së. Por këtë ajo mund ta bëjë duke pasur në konsideratë kriteret e tjera të cituara më sipër. Përdorimi i kësaj mundësie në mënyrën e duhur do të thotë që Gjykata Kushtetuese, mund të marrë pjesë dhe të ndihmojë në procesin e formimit të së drejtës komunitare.

## 6.2 Kontrolli i legjislacionit të BE-së nga Gjykata Kushtetuese.

Procesi i integritimit të vendeve evropiane në BE sjell shpeshherë një problematikë të fortë në lidhje me përplasjen midis së drejtës komunitare dhe të drejtës kushtetuese të vendeve anëtare. GJED-ja që në fillim është munduar që të përcaktojë supremacinë e së drejtës komunitare mbi të drejtën e brendshme, në dy çështje Costa/Enel<sup>1172</sup> dhe Simmenthal.<sup>1173</sup> Por pavarësisht këtij qëndrimi të GJED-së, siç pranohet gjerësisht në doktrinë janë mjaft të rralla

<sup>1165</sup> Po aty, fq.533.

<sup>1166</sup> Po aty, fq.533.

<sup>1167</sup> Po aty, fq.534.

<sup>1168</sup> Kushtetuta, neni 132, pika 1.

<sup>1169</sup> Jacques, Jean Paul, "E drejta institucionale e Bashkimit Evropian", botim në shqip, Shtëpia Botuese "Papyrus", Tiranë 2010, fq.535.

<sup>1170</sup> Po aty, fq.535.

<sup>1171</sup> Sovdat, Jadranka, "Human rights between the constitution, treaties, and european union law. The case of Slovenia", botuar në "International Constitutional Law", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2014, fq.340.

<sup>1172</sup> Vendimi i GJED, C 6/64, datë 15.7.1964.

<sup>1173</sup> Vendimi i GJED, C 106/77, datë 9.3.1978.

rastet kur shtetet kanë vendosur që norma ndërkombëtare të ketë përparësi edhe mbi vetë Kushtetutën.<sup>1174</sup> Për rrjedhojë rezultoi se shumica e vendeve të BE-së pranojnë formalisht ekzistencën e epërsisë së Kushtetutës mbi normat ndërkombëtare përfshirë edhe normat e BE-së. Për këtë arsye delegimi i kompetencave shtetërore tek BE-ja duhet që të respektojë strukturat themelore të një rendi kushtetues të brendshëm, pasi janë këto të fundit që ruajnë identitetin e një shteti.<sup>1175</sup> Shembuj tipik në këtë rast është Franca, ku gjyqtarët e lartë të ligjshmërisë dhe administrativë pranuan supremacinë e së drejtës ndërkombëtare dhe komunitare, por vetëm ndaj ligjeve dhe në asnjë rast ndaj Kushtetutës.<sup>1176</sup> Po e njëjta situatë u shfaq mbasi Këshilli Kushtetues Francez deklaroi si antikushtetues Traktatin e Mastrihtit, që solli si pasojë ndryshimin e Kushtetutës me qëllim ratifikimin e tij.

Edhe në Gjermani, Gjykata Kushtetuese Federale u shpreh në lidhje me kushtetutshmërinë e Traktatit të Mastrihtit, duke provokuar në këtë vend ndryshime kushtetuese me qëllim ratifikimin e tij. Qëndrimi gjerman ka frymëzuar edhe Gjykatën Kushtetuese Spanjolle e cila ka mbajtur qëndrimin se ajo ka të drejtë që të kontrollojë legjislacionin e BE-së në rast se vjen në kundërshtim me normat kushtetuese,<sup>1177</sup> pasi i konsideron ato si norma inferiore në raport me të.<sup>1178</sup> Por ka edhe vende që nuk e pranojnë një kontroll të tillë, si Austria,<sup>1179</sup> Hungaria<sup>1180</sup> dhe Portugalia<sup>1181</sup> pasi akte të tilla nuk konsiderohen si pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe për rrjedhojë janë jashtë juridiksionit kushtetues.

Përsa i përket vendit tonë duhet theksuar se, Kushtetuta e vitit 1998, ishte ndër kushtetutat e para në Evropë që sanksionoi dispozita të vlefshme për procesin e integritetit. Deri në atë kohë, vetëm Kushtetuta e Polonisë, kishte parashikuar dispozita që vendosnin klauzolat e integritetit dhe të delegimit të pushteteve.<sup>1182</sup> Nëse analizojmë sistemin normativ në Kushtetutë, vërejmë një tendencë të dukshme të trupëzimit të normave ndërkombëtare në të drejtën e brendshme të vendit, duke krijuar dy sisteme të ndryshme të raportit të normave. Sistemi i parë, rregullon raportin e akteve të brendshme me normat klasike të së drejtës Ndërkombëtare Publike,

<sup>1174</sup> Omari, Luan; Anastasi, Aurela; *"E drejta kushtetuese"*, Shtëpia Botuese "ABC", Tiranë 2010, fq. 53.

<sup>1175</sup> Vidal, Carlos, *"Germania"*, botuar në *"Giustizia Costituzionale e Unione Europea – Una comparazione tra Austria, Francia, Germania, Italia, Spanga e Portogallo"*, në kujdesin e Alfonso Celotto, Javier Tajadura, Josu De Miguel Barcena, Shtëpia Botuese "Editoriale Scientifica srl", Napoli 2011, fq.48.

<sup>1176</sup> Burgorgue-Larsen, Laurance; Bruck, Veronique; *"The relationship between EU Law, the ECHR and French Constitutional Law"*, botuar në *"International Constitutional Law"*, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2014, fq.73.

<sup>1177</sup> Sanchez, Pedro Julio Tenorio, *"International treaties in Spanish Law"*, botuar në *"International Constitutional Law"*, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2014, fq.373.

<sup>1178</sup> De Miguel Barcena, Josu, *"Spanga"*, botuar në *"Giustizia Costituzionale e Unione Europea – Una comparazione tra Austria, Francia, Germania, Italia, Spanga e Portogallo"*, në kujdesin e Alfonso Celotto, Javier Tajadura, Josu De Miguel Barcena, Shtëpia Botuese "Editoriale Scientifica srl", Napoli 2011, fq.165.

<sup>1179</sup> Gamper, Anna, *"Austria"*, botuar në *"Giustizia Costituzionale e Unione Europea – Una comparazione tra Austria, Francia, Germania, Italia, Spanga e Portogallo"*, në kujdesin e Alfonso Celotto, Javier Tajadura, Josu De Miguel Barcena, Shtëpia Botuese "Editoriale Scientifica srl", Napoli 2011, fq.140.

<sup>1180</sup> Kovacs, Peter, *"International Law in the recent jurisprudence of the Hungarian Constitutional Court"*, botuar në *"International Constitutional Law"*, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2014, fq.462.

<sup>1181</sup> Duarte, Maria Luisa; Gomes, Carlo Amado; *"Portogallo"*, botuar në *"Giustizia Costituzionale e Unione Europea – Una comparazione tra Austria, Francia, Germania, Italia, Spanga e Portogallo"*, në kujdesin e Alfonso Celotto, Javier Tajadura, Josu De Miguel Barcena, Shtëpia Botuese "Editoriale Scientifica srl", Napoli 2011, fq.324.

<sup>1182</sup> Zaganjori, Xhezair; Anastasi, Aurela; Çani, Eralda; *"Shteti i së drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë"*, Botim i Fondacionit "Konrad Adenaur", Shtëpia Botuese "Adelprint", Tiranë 2011, fq.59-60.

kurse i dyti, rregullon marrëdhëniet që krijohen midis normave të brendshme, me normat e organizatave ndërkombëtare, në të cilat Shqipëria aderon me marrëveshje të posaçme.<sup>1183</sup>

Sipas përcaktimeve në doktrinë “sistemi i dytë i normave, paraqet disa veçori të cilat e ndryshojnë nga sistemi i sipërpërmendur. Këto parime, Kushtetuta i ka vendosur posaçërisht, për ratifikimin e marrëveshjeve për aderimin e Shqipërisë në organizata ndërkombëtare. Edhe këtu afirmohen parimet e sipërpërmendura siç është ai i zbatimit të drejtpërdrejtë të normave të nxjerra prej kësaj organizate, kur kjo parashikohet shprehimisht në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë. Por, përpos këtij, parimi i epërsisë së normave të organizatës ndërkombëtare, shtrihet jo thjesht mbi ligjet e brendshme në kuptimin formal të fjalës, por mbi të gjithë “të drejtën e vendit”. Nga ana tjetër, parashikohet parimi i delegimit të kompetencave shtetërore për çështje të caktuara, në bazë të marrëveshjes. Kështu, parimi i epërsisë së normave të organizatës ndërkombëtare mbi “të drejtën” e vendit, është i dallueshëm nga epërsia e marrëveshjeve të ratifikuara në kuadrin e së drejtës klasike Ndërkombëtare Publike, të cilat *expressis verbis* kanë një epërsi vetëm mbi “ligjet” e vendit. Në gjuhën shqipe, e drejta e vendit përfshin të gjitha normat e brendshme, përfshirë edhe Kushtetutën e Shqipërisë, prandaj është e kuptueshme një epërsi e tyre edhe mbi vetë Kushtetutën dhe jo vetëm mbi ligjet e brendshme. Natyrisht, kjo “*klauzolë e epërsisë*” zbatohet për normat e organizatave ndërkombëtare, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në to, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej saj. Edhe pse Kushtetuta nuk i është adresuar në mënyrë të shprehur drejtpërdrejt Bashkimit Evropian dhe të drejtës Komunitare, dallohet qartë marrëdhënia e veçantë që ajo krijon me këtë të fundit (neni 122, pika 3 e Kushtetutës). Pra, në rastin e aderimit të Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare, me vullnetin e popullit të shprehur përmes përfaqësuesve të tij, kryhet bartja e sovranitetit të shtetit, në mënyrë të pjesshme, për çështje të caktuara, përmes delegimit të kompetencave shtetërore. Nuk ka dyshim, se në këtë rast kemi të bëjmë jo vetëm me kufizimin e sovranitetit të shtetit (aspekti i jashtëm), por edhe me kufizimin e sovranitetit të popullit (aspekti i brendshëm).<sup>1184</sup> Kuvendi është sovran vetë në këtë transferim specifik kompetencash dhe madje, është i lirë të vendosë nëse do ta bëjë ai vetë ratifikimin e kësaj marrëveshjeje apo do të vendosë që ratifikimi të bëhet me referendum.<sup>1185</sup>

Arsyetimi i mësipërm doktrinor kuptohet që vlen në ato raste kur legjislacioni i BE bie në kundërshtim si me ligjet, ashtu edhe me Kushtetutën e vendit tonë. Por, në këtë rast dhe pavarësisht mënyrës së si është formuluar neni 122, pika 3 e Kushtetutës, legjislacioni i BE nuk mundet kurrësesi që të çënojë dhe prekë, bërthamën e Kushtetutës, pra atë pjesë të ligjit themelor të quajtur superkushtetutë, veçanërisht kur bëhet fjalë për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.<sup>1186</sup> Kjo pjesë siç e kemi theksuar edhe më sipër nuk mundet që të preket nga vetë populli, (nëpërmjet përfaqësuesve apo drejtpërsëdrejti), që është edhe mbajtësi i sovranitetit në rastet kur ndryshon Kushtetutën dhe aq më pak të çënohet nga normat e BE-së. Për këtë arsye një formë kontrolli mbi legjislacionin e BE-së mund dhe duhet të ushtrohet nga Gjykata jonë Kushtetuese. Edhe në Poloni, prej nga janë marrë si shembuj dispozitat tona kushtetuese, rezulton se Tribunali Kushtetues, në mënyrë të konsoliduar ka mbajtur qëndrimin që kundërshtitë midis një norme

<sup>1183</sup> Po aty, fq.60.

<sup>1184</sup> Po aty, fq.61.

<sup>1185</sup> Omari, Luan; Anastasi, Aurelia, “E drejta kushtetuese”, Shtëpia Botuese “ABC”, Tiranë 2010, fq.62-63.

<sup>1186</sup> Si në Gjermani. Ndërsa për Poloninë shih Banaszak, Boguslaw; Jorsz-ZukowskaSylwia; Zukowski, Lukas; “International and european law in the polish legal system”, botuar në “International Constitutional Law”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “G. Giappichelli Editore”, Torino 2014, fq.240.



kushtetuese dhe një norme të BE-së, nuk mundet që të zgjidhen duke njohur përparësinë e legjislacionit të BE-së mbi normën kushtetuese apo me humbjen e forcës detyruese të normave kushtetuese dhe zëvendësimin e tij me një normë të BE-së.<sup>1187</sup>

Kontrolli i Gjykatës sonë Kushtetuese në varësi të llojit të aktit që do të kontrollojë, legjislacionin parësor apo dytësor të BE, është i ndryshueshëm. Kështu në lidhje me legjislacionin parësor të BE-së traktatet, Gjykata Kushtetuese, mund të ushtrojë kontroll në rastet dhe mënyrat e parashikuara nga neni 131 gërma "b" e Kushtetutës dhe nga dispozitat përkatëse të LGJK-së. Pra, në këtë rast TFBE-ja, mundet që mbi bazën e kërkesave të subjekteve të ndryshme të kontrollohet për përputhshmërinë e saj me Kushtetutën. Një kontroll i ngjashëm është ushtruar edhe nga Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane, për traktatin e Mastroiitit, bazuar në mungesën e legjitimitetit demokratik të institucioneve të BE-së.<sup>1188</sup>

Përsa i përket legjislacionit dytësor të BE-së, ai si rregull përbëhet nga "Rregulloret", "Direktivat" dhe "Vendimet". Rregulloret të cilat janë shumë pak të përdorshme në krahasim me direktivat janë të detyrueshme si për rrugën ashtu edhe për rezultatin që duhet të arrijnë vendet anëtarë të BE-së. Direktivat nga ana tjetër janë detyruese vetëm për rezultatin. Vendet anëtarë nëpërmjet transpozimit të tyre në legjislacionin e brendshëm, duke miratuar një ligj për këtë qëllim, janë të lira të zgjedhin rrugën që mendojnë si më të përshtatshme për arritjen e rezulttit të kërkuar. Vendimet si rregull janë akte individuale dhe për rrjedhojë nuk prodhojnë pasoja me karakter të përgjithshëm për vendet anëtare të BE-së. Këto akte sipas jurisprudencës së disa vendeve mund të jenë objekt kontrolli nga gjykatat kushtetuese respektive. Në lidhje me një tjetër akt, atë të marrëveshjeve që BE-ja lidh me vende të tjera, ka një tendencë për të refuzuar kontrollin ndaj tyre.<sup>1189</sup>

Duke reflektuar mbi strukturën juridike të BE-së, rezulton se kjo organizatë nëpërmjet legjislacionit të saj mund ta çenojë Kushtetutën në dy drejtime. Në rastin e parë ekziston një abuzim i qartë i kompetencave nga ana e organeve komunitare që kanë sipas traktateve. Në këtë situatë, organet e BE-së tejkalojnë pushtetin që u është deleguar dhe për rrjedhojë hyjnë në kompetencat kushtetuese të vendeve anëtare. Në rastin e dytë, megjithëse pushteti ushtrohet në përputhje me kompetencat e dhëna, nuk respektohet niveli i mbrojtjes së të drejtave të njeriut i përcaktuar nga Kushtetuta.<sup>1190</sup>

Disa gjykata kushtetuese, në të vërtetë e kanë deklaruar mundësinë dhe kompetencën për të shqyrtuar kushtetutshmërinë e legjislacionit dytësor të BE-së. Forma e kontrollit mund të jetë e ndryshme. Forma më e zbutur është në ato raste kur gjykata kushtetuese kontrollon kushtetutshmërinë e legjislacionit të miratuar nga pushteti legjislativ dhe që synon zbatimin e detyrimeve që rrjedh nga legjislacioni i BE-së. Shembull në këtë drejtim është Gjykata Kushtetuese Italiane, e cila në rast se një akt i legjislacionit dytësor të BE-së bie në kundërshtim me Kushtetutën e këtij vendi atëherë ajo shfuqizon ligjin që ka dalë në bazë të zbatimit të këtij

<sup>1187</sup> Po aty, fq.240.

<sup>1188</sup> Di Martino, Alessandra, "The open constitutional state: Germany response to international and european legal pluralism", botuar në "International Constitutional Law", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2014, fq.123.

<sup>1189</sup> Gamper, Anna, "Austria", botuar në "Giustizia Costituzionale e Unione Europea – Una comparazione tra Austria, Francia, Germania, Italia, Spanga e Portogallo", në kujdesin e Alfonso Celotto, Javier Tajadura, Josu De Miguel Barcena, Shtëpia Botuese "Editoriale Scientifica srl", Napoli 2011, fq.142.

<sup>1190</sup> Vidal, Carlos, "Germania", botuar në "Giustizia Costituzionale e Unione Europea – Una comparazione tra Austria, Francia, Germania, Italia, Spanga e Portogallo", në kujdesin e Alfonso Celotto, Javier Tajadura, Josu De Miguel Barcena, Shtëpia Botuese "Editoriale Scientifica srl", Napoli 2011, fq.81.

akti.<sup>1191</sup> Pra nuk godet drejtpërsëdrejti aktin por legjislacionin kombëtar për zbatimin e tij. Në këtë rast me shfuqizimin e ligjit si antikushtetues, indirekt është deklaruar dhe akti i BE-së duke e lënë atë pa fuqi juridike në vend. Kjo teknikë është përdorur edhe nga disa gjykata të tjera kushtetuese veçanërisht për vendimin kuadër të BE-së për urdhërin e arrestit evropian. Kjo mënyrë veprimi mund të zbatohet efektivisht ndaj direktivave, por jo ndaj akteve të tjera të BE-së. Mënyra tjetër dhe më e drejtpërdrejtë është që gjykatat kushtetuese të kontrollojnë vetë aktet e BE-së. Një vend i cili pranon këtë mundësi është edhe Gjermania.<sup>1192</sup> Në këtë mënyrë Gjykata Kushtetuese Federale ndryshoi qëndrimin e saj të hershëm që i konsideronte këto akte si jashtë juridiksionit të saj, pasi nuk ishin miratuar nga organe të së drejtës publike gjermane.<sup>1193</sup> Ky kontroll ndaj legjislacionit dytësor ushtrohet në bashkëpunim me GJED-në. Për këtë arsye kontrolli i këtyre akteve është i GJED-së, por Gjykata Kushtetuese Federale do të veprojë në rast se GJED-ja do të braktisë standardet e të drejtave themelore.<sup>1194</sup> Gjykata Kushtetuese Federale e ka shtrirë juridiksionin e saj për të kontrolluar aktet e BE-së kur ato tejkalojnë kompetencat që u janë dhënë atyre, duke i konsideruar si *ultra vires*. Sipas Gjykatës, tre janë kriterët për të gjendur përpara një shtete të tillë. **Së pari**, përpara deklarimit të një akti *ultra vires*, GJED-së i duhet dhënë mundësia për të thënë fjalën e saj nëpërmjet mekanizmit paragjykimor. **Së dyti**, kontrolli i akteve *ultra vires* mund të merret në konsideratë nëse miratimi i këtij akti të BE-së përbën një cënim të hapur të kompetencave. **Së treti**, ky kontroll mund të ushtrohet nëse nga jurisprudenca e GJED-së rezulton se akti ndërhyr në fushën e një vendimmarrje të rëndësishme politike ose që shkakton ndryshime strukturore në sistemin e ndarjes së kompetencave kushtetuese.<sup>1195</sup>

Jurisprudenca që ka përpunuar Gjykata Kushtetuese Federale në këtë drejtim, mundëson kontrollin e legjislacionit dytësor të BE-së vetëm pasi më parë gjykatat e vendit i janë drejtuar me parë GJED-së për të kontrolluar përputhshmërinë e aktit të BE-së me TFBE-në. Normalisht në TFBE janë përfshirë të gjitha kompetencat që shtetet ia kanë deleguar BE-së. Çdo tejkallim i tyre do të sillte, cënim të sovranitetit të këtyre shteteve si edhe të kushtetutave respektive. Megjithatë pavarësisht kësaj, Gjykata Kushtetuese nuk e sheh veten të lidhur nga vendimmarrja e GJED-së. Duke iu referuar kriterit të tretë, Gjykata Kushtetuese Federale, ka marrë në konsideratë situatën kur vetë GJED-ja nëpërmjet jurisprudencës së saj dhe në tejkallim të kompetencave shtetërore të deleguara synon të mbrojë këtë zgjerim të pajustificuar të kompetencave të BE-së. Pra, në çdo rast fjalën e fundit për të përcaktuar përputhshmërinë e legjislacionit dytësor të BE-së me Kushtetutën e ka Gjykata Kushtetuese.

Polonia, e ndikuar edhe nga jurisprudenca gjermane, ka shkuar edhe më tej. Tribunali Kushtetues, ka mbajtur qëndrimin se shtetet anëtare ruajnë të drejtën të vlerësojnë nëse organet legjislative të BE-së veprojnë brenda kompetencave të deleguara kur miratojnë një akt të caktuar (parashikime ligjore) dhe nëse ushtrojnë kurdoherë të drejtat e tyre në përputhje me parimet e

<sup>1191</sup> Mezzetti, Luca; Polacchini, Francesca: "Primacy of supranational Law and supremacy of the Constitution in the Italian legal system", botuar në "International Constitutional Law", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2014, fq.147.

<sup>1192</sup> Di Martino, Alessandra, "The open constitutional state: Germany response to international and european legal pluralism", botuar në "International Constitutional Law", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2014, fq.121.

<sup>1193</sup> Vidal, Carlos, "Germania", botuar në "Giustizia Costituzionale e Unione Europea – Una comparazione tra Austria, Francia, Germania, Italia, Spanga e Portogallo", në kujdesin e Alfonso Celotto, Javier Tajadura, Josu De Miguel Barcena, Shtëpia Botuese "Editoriale Scientifica srl", Napoli 2011, fq.49-50.

<sup>1194</sup> Di Martino, Alessandra, "The open constitutional state: Germany response to international and european legal pluralism", botuar në "International Constitutional Law", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2014, fq.122.

<sup>1195</sup> Po aty, fq.124.

subsidiaritetit dhe të proporcionalitetit. Duke tejkaluar këto kufij mund të rezultojë që aktet janë miratuar tej qëllimit të tyre dhe nuk mbulohen nga parimi i përparësisë së legjislacionit të BE-së.<sup>1196</sup> Në një tjetër vendim të mëvonshëm Tribunali Kushtetues, pa ekuivok përcaktoi se një akt normativ, siç përcaktohet në nenin 79/1 të Kushtetutës, mund të mos jetë vetëm një akt normativ i miratuar nga një organ polak, por gjithashtu, mbasi përmbush edhe kritere të tjera, edhe një akt i miratuar nga një organ i një organizate ndërkombëtare në të cilën Republika e Polonisë është anëtare. Kjo në rradhë të parë ka të bëjë me aktet që i përkasin legjislacionit të BE-së të miratuara nga institucionet e kësaj organizate, pasi një akt i tillë përbën një element të rendit ligjor detyrues në Poloni.<sup>1197</sup>

Nga analizat e mësipërme rezultojnë dy qëndrime të kundërta në jurisprudencën kushtetuese. Ka gjykata që e pranojnë një kontroll të tillë, siç ka edhe gjykata që refuzojnë të kenë një juridiksion të tillë. Në Shqipëri situata paraqitet më e ndërlikuar, për shkak të formulimit që ka nëni 122, pika 3 e Kushtetutës. Jam i mendimit që edhe Gjykata jonë Kushtetuese e gëzon mundësinë që të kontrollojë kushtetutshmërinë e legjislacionit të BE-së. Teknika më e preferuar në këtë rast do të ishte që Gjykata Kushtetuese të kontrollonte kushtetutshmërinë e legjislacionit që miratohet nga Kuvendi për zbatimin e akteve të BE-së. Por në rast se një veprim i tillë nuk është i mundur atëherë, bazuar në jurisprudencën kushtetuese gjermane dhe polake, Gjykata duhet që të analizojë edhe vetë legjislacionin e BE-së drejtpërsëdrejti. Një kompetencë e tillë, mund të nxirret nga interpretimi i nenit 131, gërma "c" e Kushtetutës. Dispozita në fjalë, siç e kemi cituar i jep të drejtë Gjykatës që të kontrollojë kushtetutshmërinë e akteve normative të organeve qendrore. Atëherë në këtë rast me të drejtë lind pyetja a janë organet e BE-së organe qendrore në kuptim të Kushtetutës sonë? Në këndvështrimin personal jam i mendimit që kësaj pyetje i duhet dhënë një përgjigje pozitive. Ky konkluzion buron nga një interpretim teleologjik i nenit 122 pika 3 e Kushtetutës, e cila bën fjalë për përparësinë e normave të nxjerra nga një organizatë ndërkombëtare. Në këtë rast organizata ndërkombëtare parashikohet drejtpërsëdrejti nga Kushtetuta, pra merr cilësi kushtetuese. Për rrjedhojë edhe normat që ato nxjerrin mund të konsiderohen si akte normative në kuptim të nenit 131, gërma "c" të Kushtetutës.

Një tjetër argument në favor të kësaj teze do të ishte edhe parashikimi që ka vetë TFBE-ja në nenin 4 të tij, pikat 1 dhe 2, në të cilat parashikohen ruajtja e identitetit kombëtar dhe kushtetues.<sup>1198</sup> Nga formulimi i këtyre dispozitave duket qartësisht se BE-ja nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera tej atyre të dhëna nga traktatet. Ato kompetenca i takojnë shteteve. Në këtë mënyrë ajo duhet që të respektojë identitetin kombëtar dhe strukturën themelore kushtetuese të vendeve anëtare. Këto dy momente, janë shumë të rëndësishme që të lihen vetëm në diskrecionin gjyqësor të GJED-së. Ato mundet dhe duhet të garantohen edhe nga gjykatat kushtetuese të vendeve anëtare të BE-së.

<sup>1196</sup> Vendimi nr. K 18/04, datë 11.5.2005 i Tribunalit Kushtetues Polak, referuar në: Banaszak, Boguslaw; Jorsz-ZukowskaSylwia; Zukowski, Lukas; "International and european Law in the polish legal system", botuar në "International Constitutional Law", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2014, fq.245.

<sup>1197</sup> Po aty, vendimi nr. SK 45/09, nëntor 2011 i Tribunalit Kushtetues Polak, fq.246.

<sup>1198</sup> Versioni i konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Europian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Europian, botim i Ministrisë së Integritimit Evropian, pa vit, fq.20, neni 4: 1. Në përputhje me nenin 5, kompetencat që Traktatet nuk ja japin Bashkimit, u mbeten shteteve anëtare. 2. Bashkimi respekton barazinë e Shteteve Anëtare përpara Traktateve si edhe identitetet e tyre kombëtare, që janë të pandara nga strukturat e tyre themelore, politike dhe kushtetuese, duke përfshirë edhe vetqeverisjen rajonale dhe vendore.



Por, përgjithësisht gjykatat kushtetuese të vendeve anëtare të BE-së, megjithë deklaratimet e tyre për të shqyrtuar dhe shfuqizuar akte të BE-së nuk e kanë ushtruar këtë mundësi në praktikë. I vetmi rast për të cilin gjejmë një referencë në këtë drejtim është Gjykata Kushtetuese e Çekisë e cila ka anuluar një vendim të GJED duke e konsideruar atë si *ultra vires*.<sup>1199</sup> Ndërhyrja e Gjykatës Kushtetuese varet në një shkallë të madhe gjithmonë nga sjellja e legjislatorit. Në këtë rast ligjvënësi ka detyrimin që të bëjë zbatimin e legjislacionit të BE-së duke miratuar aktet përkatëse. Por në këtë rast ajo mund ta bëjë vetëm duke respektuar kufijtë dhe parimet kushtetuese.<sup>1200</sup>

Por çfarë pasojash do të sillte një vendimmarrje e tillë? Sipas Tribunalit Kushtetues Polak, në rast se do të deklarohet antikushtetues një akt, pjesë e legjislacionit dytësor të BE-së, atëherë këtij akti i hiqet mundësia për t'u zbatuar nga organet polake dhe për të sjellë efekte në Poloni. Vendimi i Tribunalit do të rezultonte në pezullimin e zbatimit të normave të legjislacionit të BE-së të papajtueshme me Kushtetutën në territorin e Republikës së Polonisë.<sup>1201</sup> I njëjti arsytim mendoj se vlen edhe për vendin tonë.

Për shtetin pasojat në këtë rast ndodhur përballë një vendimmarrje të tillë të Gjykatës Kushtetuese do të ishin ndryshimi i kushtetutës, ndryshimi i legjislacionit të BE-së, ose edhe tërheqja nga BE.<sup>1202</sup>

## KONKLUZIONE.

Gjykata Kushtetuese megjithëse është një institucion që sipas Kushtetutës sonë formon një pushtet më vetë, nuk është plotësisht i ndarë dhe pa pika kontakti me gjykatat e juridiksioneve të tjera. Këto gjykata janë kombëtare dhe ndërkombëtare. Për këtë arsye Gjykata Kushtetuese në vendimmarrjen e saj duhet që gjithmonë të ketë kujdes për të mos krijuar mosmarrëveshje me juridiksionet e tjera, por nga ana tjetër të krijojë edhe marrëdhënie me to.

Përsa i përket gjykatave të juridiksionit kombëtar, Gjykata Kushtetuese ka shumë pika kontakti me to. Në rradhë të parë, pika e kontaktit që krijohet dhe që njëkohësisht përbën edhe marrëdhënie institucionale midis këtyre dy juridiksioneve është e drejta që kanë gjykatat e zakonshme për të ushtruar kontroll incidental me referim në Gjykatën Kushtetuese për të kontrolluar kushtetutshmërinë e ligjit të zbatueshëm në atë çështje. Pavarësisht se në këtë rast Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje nëpërmjet gjykatave të zakonshme, procesi kushtetues i mëpasshëm ruan autonominë e vetë në krahasim me gjykimin e zakonshëm. Kështu në rast se gjykata e zakonshme e pushon çështjen, kjo nuk ka asnjë efekt në lidhje me gjykimin kushtetues i cili vazhdon procedurën e tij normale.

Një tjetër pikë kontakti midis këtyre dy juridiksioneve është kompetenca që kanë Gjykata Kushtetuese dhe gjykatat administrative për të shqyrtuar aktet normative nënligjore. Parimisht asnjëra prej këtyre dy juridiksioneve nuk mund të marrë në shqyrtim çështje që i përkasin juridiksionit tjetër. Për këtë arsye është e nevojshme që të bëhet një analizë në lidhje me këtë

<sup>1199</sup> Sanchez, Pedro Julio Tenorio, "International treaties in Spanish Law", botuar në "International Constitutional Law", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2014, fq.376.

<sup>1200</sup> Vidal, Carlos, "Germania", botuar në "Giustizia Costituzionale e Unione Europea – Una comparazione tra Austria, Francia, Germania, Italia, Spanga e Portogallo", në kujdesin e Alfonso Celotto, Javier Tajadura, Josu De Miguel Barcena, Shtëpia Botuese "Editoriale Scientifica srl", Napoli 2011, fq.93.

<sup>1201</sup> Banaszak, Boguslaw; Jorsz-ZukowskaSylwia; Zukowski, Lukas; "International and european law in the polish legal system", botuar në "International Constitutional Law", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2014, fq.247.

<sup>1202</sup> Po aty, fq.240.

kufi. Përsa i përket anës materiale të problemit, kufiri është plotësisht i dallueshëm. Ky dallim lidhet me natyrën e pretendimeve që ngre ankuesi. Nëse ato janë me natyrë kushtetuese atëherë çështja është pjesë e juridiksionit kushtetues dhe në rast se ngrihen pretendime me natyrë ligjore, atëherë çështja i përket gjykatave administrative. Shqetësuese shfaqet situata kur kemi të bëjmë me anën formale të problemit. Siç me të drejtë është pranuar në doktrinë, kriteret që parashikohen në nenin 118 të Kushtetutës, janë njëkohësisht si kritere ligjore ashtu edhe kritere kushtetuese. Pra, çënimi i ligjit sjell edhe çënim të Kushtetutës. Në këtë rast jam i mendimit që jemi përpara një konkurimi midis këtyre dy juridiksioneve. Për rrjedhojë një çështje e tillë mund të paraqitet si përpara gjykatave administrative ashtu edhe përpara Gjykatës Kushtetuese. Ky lloj juridiksioni konkuroes njihet edhe në disa vende si në Austri por në një farë shkalle edhe në Itali.

Duke qenë se organet kushtetuese janë njëkohësisht edhe organe administrative, problematike shfaqet situata edhe në rastin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes së kompetencave që parashikohet edhe si kompetencë lëndore e Gjykatës Kushtetuese por edhe e gjykatave administrative. Edhe në këtë rast për të përcaktuar se ku ndodhet kufiri midis këtyre dy juridiksioneve duhet që të analizojmë natyrën e mosmarrëveshjes si edhe shkakun e saj. Kështu nëse kompetenca e pretenduar si e çënuar, është me natyrë kushtetuese pavarësisht se detajohet më tej në aktet ligjore dhe nënligjore, kompetente për shqyrtimin e saj është Gjykata Kushtetuese. Në rast se kompetenca e pretenduar buron vetëm nga ligji dhe nuk ka asnjë mbështetje kushtetuese atëherë kompetente mbetet gjykata administrative.

Në rast të një shtate hipotetike sipas së cilave të dyja juridiksionet do të shpreheshin se janë kompetente për shqyrtimin e çështjes për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave atëherë duhet që gjyqtari administrativ të pezullojë çështjen e tij në pritje të vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese. Kjo është zgjidhja më e pëlqyeshme për të koordinuar këto dy juridiksione dhe për të shmangur një tjetër mosmarrëveshje midis këtyre dy gjykimeve.

Nëse Gjykata Kushtetuese e shfuqizon aktin objekt të mosmarrëveshjes atëherë gjykata administrative do të duhet të pushojë gjykimin e çështjes. Pushimi i çështjes do të duhet të vendoset nga gjykata administrative edhe në rast se Gjykata Kushtetuese ka vendosur rrëzimin e kërkesës por jo për mungesë juridiksioni, por pasi kërkesa ka qenë e pabazuar. Vetëm në rast se Gjykata Kushtetuese vendos rrëzimin për mungesë të juridiksionit kushtetues atëherë gjykata administrative mund të vazhdojë gjykimin e çështjes. Nga ana tjetër nëse gjykata administrative ka vendosur shfuqizimin e aktit, përpara se procedurat seleksionuese në Gjykatën Kushtetuese të kenë përfunduar dhe vendimi ka marrë formë të prerë, atëherë Gjykata Kushtetuese duhet të vendosë pushimin e çështjes për mungesë të shkakut të mosmarrëveshjes. Vetëm në këtë mënyrë mundet që të koordinohen këto dy juridiksione.

Një tjetër pikëtakim lidhet me mbrojtjen e rendit kushtetues. Kështu, pavarësisht se thelbi i demokracisë është pluralizmi politik, vetë sistemi kushtetues duhet që të ketë mekanizma mbrojtje nga grupime të tilla si partitë apo organizatat politike që ka si qëllim përmbysjen e rendit kushtetues. Për këtë arsye Kushtetuta përcakton Gjykatën Kushtetuese si kompetente për të vlerësuar regjistrimin dhe veprimtarinë e këtyre grupimeve. Nga ana tjetër vetë ligjvënësi e ka konsideruar si vepër penale krijimin dhe ushtrimin e veprimtarisë për parti politike apo shoqata me karakter antikushtetues. Për këtë arsye është e nevojshme që të kemi përsëri një koordinim të këtyre dy juridiksioneve. Duke u bazuar në hierarkinë e normave juridike në vend, si edhe faktin që e drejta e organizimit është një e drejtë që gëzon mbrojtje kushtetuese, mund të konkludohet që në këtë rast duhet që fillimisht të shprehet Gjykata Kushtetuese nëse një parti apo organizatë politike ushtron aktivitet antikushtetues. Më pas, mbas këtij vendimi organi i akuzës mund të vihet në lëvizje që të hetojë përgjegjësinë e personave të përfshirë në këtë veprimtari dhe

eventualisht nëse e çmon të nevojshme ta dërgojë atë në gjykatë. E kundërta është e pamundur pasi gjykatat e zakonshme nuk e kanë kompetencën për të vlerësuar kushtetutshmërinë e partive apo organizatave politike.

Në lidhje me vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese edhe të gjykatave të zakonshme, bazuar në rastet e mësipërme, rregulli është që në rast se Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për shqyrtimin e çështjes ajo vendos moskalimin e saj në seancë plenare dhe në rast se ka kaluar vendos rrëzimin e kërkesës. Kurse në rastin e gjykatave të zakonshme vendoset përkatësisht nga gjykatat administrative rrëzimi i kërkesëpadsisë, ose në rastin e gjykatës së zakonshme penale, pushimi i gjykimit.

Në lidhje me raportin që ka Gjykata jonë Kushtetuese me GJEDNJ-në, raporti është disi më i veçantë. Kështu GJEDNJ-ja, është autoriteti përfundimtar për të interpretuar normat e KEDNJ-së. Duke qenë se në këtë rast të drejtat dhe liritë themelore që janë parashikuar në Kushtetutë, janë modeluar mbi bazën e të drejtave dhe lirive themelore që parashikohen nga KEDNJ-ja, atëherë Gjykata jonë Kushtetuese është e lidhur nga interpretimi që i bën këtyre normave konventore GJEDNJ-ja. Ky moment shtrihet edhe në aspekte procedurale duke qenë se interpretimi që bën GJEDNJ-ja prek edhe procesin e rregullt ligjor si edhe shterimin e mjeteve të brendshme. Këto dy momente janë të lidhura edhe me procesin kushtetues përderisa, procesi i rregullt ligjor zbatohet edhe në procedurat përpara Gjykatës Kushtetuese dhe përderisa Gjykata Kushtetuese konsiderohet si mjet që si rregull duhet shteruar me qëllim krijimin e aksesit pranë GJEDNJ-së.

Gjatë jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, vihet re që në disa raste Gjykata jonë ka ndryshuar precedentët e saj për shkak të jurisprudencës së GJEDNJ-së. Ky ndryshim ka pasur të bëjë për shembull edhe me juridiksionin e vetë Gjykatës, e cila u zgjerua edhe për pranimin e kërkesave për moszekutimin e vendimeve të formës së prerë dhe të ankesave për zhvillimin e proceseve gjyqësore tej një afati të arsyeshëm. Ndryshimi i precedentëve është parë edhe në anën materiale, ku Gjykata Kushtetuese ka ndryshuar edhe praktikën e saj për çështje të caktuara. Ajo që duhet theksuar është fakti që Gjykata jonë Kushtetuese është shumë e hapur ndaj GJEDNJ-së. Kështu në vendimmarrjen e saj Gjykata Kushtetuese i referohet gjerësisht, aty ku është e mundur, GJEDNJ-së. Për më tepër Gjykata Kushtetuese, nuk merr vetëm në konsideratë çështjet në të cilat Shteti Shqiptar ka qenë palë, por edhe çështjet e tjera me palë shtete të tjera. Kjo bëhet me qëllim për të qenë në të njëjtën linjë arsyetimi me këtë gjykatë, duke garantuar në këtë mënyrë ofrimin e të njëjtit standard në trajtimin e çështjeve dhe për rrjedhojë garantimin e të drejtave dhe lirive themelore.

Megjithatë duhet vënë në dukje se Gjykata jonë Kushtetuese jo gjithmonë ka qenë një ndjekëse besnike e jurisprudencës së GJEDNJ-së. Në ato pak raste kur ajo ka konstatuar që KEDNJ-ja dhe jurisprudenca e GJEDNJ-së ofronin mbrojtje më të ulët në raport me parashikimet kushtetuese, Gjykata Kushtetuese nuk ka ngurruar që të mbajë një tjetër qëndrim, të ndryshëm nga GJEDNJ-ja, me synim favorizimin e të drejtave dhe lirive themelore.

Bashkëpunimi dhe marrëdhënia midis këtyre dy gjykatave pritet që të shtrihet edhe më tej me ratifikimin e protokollit nr.16 të KEDNJ-së. Sipas këtij protokollit dhe njoftimit që ka bërë Shtetit Shqiptar, Gjykata Kushtetuese ka të drejtë që t'i drejtohet GJEDNJ-së me pyetje të caktuara në formën e çështjeve paragjykimore. Parimisht opinioni që jep GJEDNJ-ja në këtë rast është këshillimor, por duke pasur parasysh mundësinë e ankimit në GJEDNJ si edhe kompetencat që ka Gjykata Kushtetuese, atëherë është e kuptueshme që qëndrimi i GJEDNJ-së do të jetë përcaktues edhe për vendimmarrjen e Gjykatës sonë Kushtetuese, e cila në rast se janë konstatuar shkelje të KEDNJ-së do të duhet të shfuqizojë aktin objekt gjykimi pranë saj.



Në të ardhmen, me zhvillimin e proceseve integruese, Gjykata Kushtetuese do të përfshihet në krijimin e një marrëdhënie dhe raporti me GJED-në. Parimisht Gjykata jonë Kushtetuese ka në kompetencë që përpara aderimit të vendit tonë në BE të kontrollojë kushtetutshmërinë e legjislacionit parësor, pra të traktateve themeluese në raport me ligjin themelor të vendit. Por për këtë veprim, Gjykata Kushtetuese duhet që të vihet në lëvizje me kërkesën e subjekteve kushtetuese. Më pas, mbas aderimit, Gjykatës sonë Kushtetuese i lind e drejta që të vejë në lëvizje GJED-në. Jam i mendimit që Gjykata Kushtetuese duhet t'i bashkohet mendimit progresiv, që pavarësisht luhatjeve fillestare, po ndiqet tashmë nga çdo gjykatë kushtetuese, dhe ta konsiderojë veten e saj si një gjykatë kombëtare e aftë që të vejë në lëvizje, nëpërmjet çështjeve paragjykimore GJED-në. Ky veprim mund të realizohet pasi, Gjykata Kushtetuese plotëson kërkesat për t'u konsideruar si një gjykatë kombëtare në kuptim të traktateve themeluese të BE-së. Gjykata jonë Kushtetuese është një institucion i cili është krijuar me ligj, duke qenë se personalitetin juridik e ka për shkak të parashikimit nga vetë Kushtetuta. Si e tillë, Gjykata Kushtetuese konsiderohet edhe një institucion i përhershëm që funksionon në vazhdimësi dhe jo *ad hoc*, i përkohshëm. Gjykata Kushtetuese është gjithashtu një organ juridiksional që ka si qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me karakter kushtetues. Kjo zgjidhje e mosmarrëveshjeve bazohet në një procedurë kontradiktore e cila mundëson që të gjithë pjesëmarrësit e përfshirë në proces, të kenë mundësinë që të paraqesin çështjen e tyre si edhe të debatojnë mbi pretendimet apo argumentat e palës tjetër. Mbasi ka dëgjuar pjesëmarrësit, Gjykata Kushtetuese vendos mbi bazën e bindjes së krijuar nga vetë gjyqtarët dhe ka të drejtë që të bëjë edhe vlerësime juridike të ndryshme nga ato të paraqitura prej palëve. Për më tepër duhet theksuar që për shkak të garancive kushtetuese dhe ligjore për Gjykatën si institucion dhe për vetë gjyqtarët kushtetues, Gjykata Kushtetuese konsiderohet absolutisht një institucion i pavarur. Si një kriter i fundit, rezulton se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare, pra të paapelueshme.

Duke përmbledhur të gjitha këto kushte mund të themi se Gjykata jonë Kushtetuese, plotëson kushtet për t'u quajtur "gjykatë kombëtare" dhe për rrjedhojë ka legjitimitetin juridik, për të vënë në lëvizje GJED-në. Këtë mundësi, Gjykata Kushtetuese mund ta shfrytëzojë për të kërkuar interpretimin e traktateve ose për vlefshmërinë dhe interpretimin e akteve të institucioneve, organeve apo organizmave të BE-së.

Por Gjykata Kushtetuese ka edhe një rol tjetër. Sipas nenit 124 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese bën interpretimin përfundimtar të ligjit themelor dhe gjithashtu është edhe garantja e saj. Në këtë aspekt roli dhe qëllimi i saj nuk është që ta mbrojë Kushtetutën nga akte të brendshme të cilat e çënojnë atë por edhe nga akte ndërkombëtare. Kështu, Kushtetuta parashikon edhe kontrollin e këtyre akteve me karakter ndërkombëtar megjithëse para hyrjes së tyre në fuqi. Këto mekanizma tregojnë që superioriteti i Kushtetutës duhet të ruhet në çdo rast. Në këtë aspekt duhet të shihet edhe raporti i Kushtetutës sonë me aktet e institucioneve të BE, pra, me legjislacionin dytësor të kësaj organizate. Duke qenë se më sipër argumentuam që ekziston një bërthamë e Kushtetutës e cila nuk mundet që të çënohet edhe nëpërmjet ndryshimeve kushtetuese, atëherë është e pakuptimtë që kjo bërthamë të mund të mos mbrohet edhe ndaj akteve të BE-së. Duke pasur në konsideratë analizën krahasimore të zhvilluar në këtë punim, mbi qëndrimet e gjykatave kushtetuese të huaja në raport me legjislacionin dytësor të BE-së, i qëndroj mendimit se Gjykata jonë Kushtetuese ka juridiksion për të kontrolluar përputhshmërinë e akteve të BE-së në raport me ligjin themelor të vendit. Ky kontroll shërben për të ruajtur identitetin kombëtar dhe kushtetues të vendit tonë, i cili është edhe një nga vlerat e shprehura në traktatet themeluese të BE-së.

Forma e kontrollit, mundet që të jetë e zbutur, si për shembull e drejta që ka Gjykata Kushtetuese për të shqyrtuar përputhshmërinë e legjislacionit të brendshëm me Kushtetutën. Nga kjo rezulton se ndërhyrja e Gjykatës Kushtetuese varet në një shkallë të madhe gjithmonë nga sjellja e legjislatorit. Në këtë rast ligjvënësi ka detyrimin që të bëjë zbatimin e legjislacionit të BE-së duke miratuar aktet përkatëse. Përballë kësaj situatë, mundet që të kontrollohen dhe shfuqizohen aktet e brendshme, duke lënë indirekt pa fuqi aktet e BE-së në territorin e vendit tonë. Por nuk duhet përjashtuar edhe mundësia që të kontrollohen vetë aktet e BE-së. Duke përshtatur zgjidhjet e dhëna nga jurisprudenca kushtetuese gjermane dhe polake në lidhje me këtë çështje, mund të themi që Gjykata jonë Kushtetuese ka juridiksion për të shqyrtuar këto akte bazuar në kompetencën që i jep Kushtetuta për të shqyrtuar aktet normative të organeve qendrore. Por në këtë rast duhet që të plotësohen disa kushte si fillimisht dërgimin e çështjes pranë GJED-së nëpërmjet mekanizimit paragjykimor, në mënyrë që fillimisht të jetë kjo instancë që të shprehet në lidhje me vlefshmërinë e këtij akti. Ky lloj kontrolli mund të ushtrohet vetëm nëse miratimi i këtij akti të BE-së përbën një cënim të hapur të kompetencave, pra cënon bërthamën e Kushtetutës së vendit tonë. Së fundmi ky kontroll mund të ushtrohet vetëm nëse rezulton se akti ndërhyr në fushën e një vendimmarrjeje të rëndësishme politike ose shkakton ndryshime strukturore në sistemin e ndarjes së kompetencave kushtetuese. Pra, në këtë rast një akt i BE-së i marr në tejkalim të kompetencave që shtetet anëtare i kanë deleguar BE-së, përveçse e bën atë *ultra vires*, cënon edhe kompetencat kushtetuese të vendeve anëtare të cilat nuk e kanë deleguar një kompetencë të tillë, kësaj organizate.

Në këtë situatë nëse do të deklarohej antikushtetues një akt, pjesë e legjislacionit dytësor të BE-së, atëherë këtij akti i hiqet mundësia për t'u zbatuar nga organet e brendshme dhe për të sjellë efekte në vendin tonë. E thënë ndryshe vendimi i Gjykatës Kushtetuese do të rezultonte në pezullimin e zbatimit të normave të legjislacionit të BE-së të papajtueshme me Kushtetutën në territorin e vendit tonë.

## REKOMANDIME

Procesi kushtetues është një mekanizëm kompleks, i përbërë nga shumë rregulla të cilat kanë si qëllim disiplinimin e veprimtarisë së Gjykatës Kushtetuese. Këto rregulla procedurale synojnë që t'u japin mundësinë pjesëmarrësve në proces, që të ushtrojnë të drejtat e tyre kushtetuese për të vënë në lëvizje Gjykatën, të dëgjohej, të kenë mundësinë të paraqesin çështjen e tyre, provat që ato kanë dhe në fund të presin vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese.

Gjatë këtij punimi u analizuan pikërisht këto elementë në tërësinë e tyre dhe nga kjo analizë dolën edhe problematikat përkatëse, të cilat kanë nevojë që të adresohen për të pasur një zgjidhje sa më të mirë të tyre.

1. Problematika e parë e evidentuar në këtë punim lidhet me shpërndarjen e madhe që kanë burimet e së drejtës procedurale kushtetuese. Kjo problematikë qëndron në faktin se një shpërndarje e tillë, sjell inflacion të këtyre normave, pasaktësi në formulim, duke krijuar njëkohësisht vështirësi serioze në njohjen, kuptimin dhe zbatimin e tyre. Për të zgjidhur këto problematika dhe me qëllim qartësimin e situatës juridike për procedurat që ndjek Gjykata Kushtetuese do të ishte e rekomandueshme kodifikimi i rregullave procedurale të gjykimit kushtetues në një akt të vetëm juridik, i cili do të rregullonte të gjitha llojet e proceseve gjyqësore etj. Ky veprim mund të realizohet tashmë pasi, Gjykata jonë Kushtetuese ka një jurisprudencë të pasur, të formuar ndër vite e cila ka sqaruar mjaft mirë kuptimin e normave procedurale dhe mënyrën e zbatimit të tyre. Po kështu në këtë kodifikim duhet që domosdoshmërisht të merret në konsideratë edhe jurisprudenca e GJEDNJ-së e cila ka vërejtur shpeshherë shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga vetë Gjykata jonë Kushtetuese.

2. Një tjetër problematikë që është shfaqur në veprimtarinë e Gjykatës sonë Kushtetuese është edhe ndryshimi i shpeshtë i jurisprudencës. Kjo problematikë shfaqet edhe në planin procedural, duke ndryshuar parametrat dhe kërkesat që Gjykata Kushtetuese ka përpunuar ndër vite. Kjo mënyrë e të vepruarit, dukshëm çënon parimin e pritshmërisë së ligjshme dhe tregon një lloj konfuzioni në aktivitetin vendimmarrës të Gjykatës Kushtetuese. Për të adresuar këtë problematikë rekomandojmë që të ndiqet rregullimi që ka bërë Shteti i Andorës. Sipas ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese të këtij vendi, rezulton se precedentët e vendosura nga vetë Gjykata Kushtetuese janë detyruese dhe për atë. Po sipas këtij akti ligjor konsiderohet se jemi përpara një precedenti në rast se të paktën dy çështje të ngjashme janë zgjidhur në mënyrë të njëjtë.<sup>1203</sup> Në këtë mënyrë edhe vetë palët do të ishin më të sigurta në mënyrën e veprimit të tyre përpara Gjykatës Kushtetuese dhe jo të gjendeshin përballë rasteve "suprizë" që prodhon herë pas here Gjykata Kushtetuese. Është e kuptueshme që këto precedentë mund të ndryshojnë, duke zbatuar edhe kërkesat që ka vendosur vetë Gjykata Kushtetuese për ndryshimin e jurisprudencës së saj. Bazuar në këto kritere, Gjykata Kushtetuese në çdo rast që bën një ndryshim në precedentët e saj duhet që të japë argumentat përkatës.

3. Një tjetër rekomandim lidhet edhe me heqjen apo eliminimin e gjykimit për interpretimin përfundimtar të normave Kushtetuese, si një gjykim autonom, pasi kërkon një gjykim abstrakt në formën e tij më ekstreme të mundshme.<sup>1204</sup> Për më tepër ky lloj gjykimi përdoret shpeshherë nga politika për zgjidhjen e problemeve që kanë karakter politik dhe jo juridik. Në këtë mënyrë edhe vetë Gjykata Kushtetuese, pa pasur qëllim, përfshihet në "lojën

<sup>1203</sup> Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Andorës, miratuar me datë 3 shtator 1993, neni 3, marrë nga përmbledhja elektronike e Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) "CODICES".

<sup>1204</sup> Schwartz, Herman, "The struggle for constitutional justice in post-communist Europe", Shtëpia Botuese "The University of Chicago Press", Chicago 2000, fq.245.



politike”, të momentit. Ky lloj gjykimi mund të përdoret vetëm në rast se përpara Gjykatës Kushtetuese, njëkohësisht kërkohet edhe shfuqizimi i një akti tjetër juridik (ligj, akt nënligjor, vendim gjyqësor apo administrativ). Në këtë mënyrë edhe interpretimi përfundimtar i normës mund të bëhet më i saktë duke pasur edhe një situatë juridike për të zgjidhur, por gjithashtu shmang edhe Gjykatën Kushtetuese nga detyrimi për të ndryshuar jurisprudencën e saj nëse gjendet përballë një situatë të tillë.

4. Një tjetër problematikë e trajtuar në këtë punim është edhe kontrolli mbi amendamentet kushtetuese. Siç u argumentua, jemi të mendimit që Gjykata Kushtetuese ka juridiksion për të ushtruar një kontroll të tillë, pasi amendamentet konsiderohen “ligje” dhe për rrjedhojë mund të kontrollohen në këtë formë. Por ky lloj kontrolli ka vetëm një të metë, që në këndvështrimin tim, është edhe e metë thelbësore. Në rast se Gjykata Kushtetuese shfuqizon një amendament kushtetues si në kundërshtim me parimet bazë të Kushtetutës, atëherë fusha përkatëse që rregullohej prej saj do të mbesë e parregulluar. Pra, do të kemi një boshllëk kushtetues, një ometim. Në këtë pikë do të sugjeroja që në kuadër të ndryshimeve kushtetuese që mund të bëhen në të ardhmen, juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese për të kontrolluar kushtetutshmërinë e amendamenteve kushtetuese të përcaktohej si një juridiksion *apriori*, paraprak. Ky model megjithëse është përzgjedhur nga pak shtete, në fakt rezulton që të jetë më i suksesshmi, ku si shembull mund të marrim së fundmi edhe Kosovën që ka zgjedhur këtë lloj modeli.

Në këtë lloj gjykimi, subjekti kërkues duhet që të jetë Kryetari i Kuvendit. Nisma e tij nuk duhet që të jetë diskrecionale por duhet të jetë e detyrueshme. Pra në këtë rast, sa herë bëhet fjalë për amendamente kushtetuese, Kryetari i Kuvendit përpara se t’ia kalojë seancës plenare të Kuvendit për miratim përfundimtar duhet që t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Drafti i cili do të kalojë për shqyrtim në Gjykatë duhet të jetë drafti final, i shqyrtuar nga komisionet parlamentare. Me qëllim që më pas të mos bëhen ndryshime të mëtejshme, sugjerojmë që këto ndryshime të kalojnë për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese mbas realizimit të dy votimeve të para në Kuvend, atij në parim dhe atij nen për nen. Në këtë mënyrë në draftin final përfshihen edhe ndryshimet e mundshme që mund të jenë propozuar gjatë votimit dhe që janë miratuar. Duke qenë se drafti, nuk është votuar në tërësi ai nuk është ende i miratuar nga Kuvendi dhe për rrjedhojë në këtë fazë duhet t’i nënshtrohet kontrollit kushtetues. Kjo mënyrë veprimi krijon mundësinë që drafti që do të kontrollohet është ai përfundimtar dhe nuk është më objekt i ndryshimeve të mëtejshme gjatë procedurave parlamentare. Pra, në çdo rast që kemi kërkesa për ndryshimin e Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese duhet që domosdoshmërisht të shprehet me vendim për përputhshmërinë e këtyre amendamenteve me ndryshimet kushtetuese. Një praktikë e tillë njihet nga Kushtetuta jonë për disa procese kushtetuese, ku mund të përmendim, gjykimin e kërkesave për referendum.

Avantazhi i këtij kontrolli është se në rast se Gjykata Kushtetuese çmon se amendamentet e propozuara çënojnë bërthamën e Kushtetutës, atëherë ajo del me vendim për antikushtetutshmërinë e tyre. Në këtë rast këto amendamente nuk mundet që të miratohen dhe dispozitat kushtetuese të cilat kërkohet që të ndryshoheshin mbeten në fuqi. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese në këtë lloj kontrolli do të ketë karakteristikat e një vendimi deklarativ, por që pavarësisht kësaj është detyrues ndaj Kuvendit në ndjekjen e procedurave prej tij për amendimin e Kushtetutës.

5. Një tjetër çështje e diskutueshme është edhe shqyrtimi i ometimit ligjor. Jam i mendimit që në këtë rast, pavarësisht hapjes që po tregon Gjykata Kushtetuese edhe për shqyrtimin e këtyre rasteve, është e domosdoshme që nëpërmjet ndryshimeve kushtetuese të parashikohet edhe një kompetencë e shprehur e Gjykatës për të pasur juridiksion edhe në këto

raste. Është e vërtetë që Gjykata Kushtetuese nuk do të ketë mekanizma efektivë për të detyruar Kuvendin që të miratojë një ligj, por presioni moral që ushtrohet prej vendimit të saj, në mënyrë të padiskutueshme është më mirë se sa një heshtje në këtë pikë. Si shembull për këtë lloj juridiksioni mund të shërbejë Portugalia, Kushtetuta e së cilit e njeh këtë mekanizëm dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të këtij vendi ka një praktikë të zhvilluar në këtë drejtim.

6. Përsa i përket juridiksionit që Gjykata Kushtetuese ka për të kontrolluar pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën, rekomandoj që ky juridiksion të zgjerohet më tej duke përfshirë edhe kontrollin mbi marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen nga Këshilli i Ministrave. Nuk mendoj se është normale që akte të tilla të një rëndësie jo të vogël në arenën ndërkombëtare dhe me pasoja në rendin e brendshëm juridik, të jenë jashtë çdo lloj forme kontrolli. Duke qenë se dijenia për këto marrëveshje vjen vetëm mbas miratimit të tyre nga Këshilli i Ministrave, atëherë kontrolli për to mund të jetë vetëm *aposteriori*. Përsa i përket rregullave të tjera, duhet që të ndiqen parashikimet që kanë të bëjnë me kontrollin mbi aktet ligjore dhe nënligjore.

7. Një tjetër rekomandim është edhe parashikimi i rregullave procedurale për disa lloje gjykimesh, të cilat gjejnë pak ose aspak trajtim në LGJK. Të tilla gjykime janë ato që kanë të bëjnë me kontrollin e çështjeve të shtruara për referendum, verifikimin e rezultateve të referendumit dhe verifikimin e zgjedhjes së deputetëve. Në këtë drejtim shihet e nevojshme plotësimi i LGJK me dispozita të tjera më të rregullta dhe më të plota të cilat të plotësojnë këto gjykime kushtetuese, duke përcaktuar hapa procedurale dhe afate të qarta. Kjo mënyrë veprimi do të rriste qartësinë e ligjit, do të forconte sigurinë juridike dhe do ta bënte më të aksesueshëm drejtësinë kushtetuese për këto lloje problemesh, të cilat kanë të bëjnë drejtpërdrejt me sovranitetin popullor dhe për të cilën Gjykata Kushtetuese duhet të jetë garantja.

8. Pozita procedurale e pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues është e një rëndësie të veçantë. Në këtë mënyrë duhet që të rregullohet kategoria e subjekteve kërkuese. Kështu, duke pasur në konsideratë rolin dhe misionin që Kushtetuta ka përcaktuar për KLSH, jemi të mendimit që në këtë rast, Kryetari i këtij institucioni nuk mundet që të jetë një subjekt i pakushtëzuar. Për këtë arsye jemi të mendimit që ai duhet që të parashikohet si një subjekt i kushtëzuar. I njëjti arsyetim vlen edhe për organet e bashkësive fetare. Parashikimi i tyre si subjekt më vetë është i tepërt duke qenë se përsëri ato klasifikohen si "organizata të tjera". Po kështu si subjekte kërkuese mund të përfshihen edhe institucione të pavarura që janë krijuar nga Kuvendi dhe që shërbejnë për garantimin e të disa të drejtave dhe lirive themelore, siç janë Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale apo Komisioneri kundër Diskriminimit. Është e kuptueshme që ligjvënësi kushtetues duhet të përzgjedhë një formulë të përgjithshme edhe për të përfshirë institucione të tjera të ngjashme që mund të krijohen në të ardhmen. Një tjetër subjekt mund dhe duhet të jetë edhe Prokurori i Përgjithshëm. Ky subjekt duhet të jetë i kushtëzuar, ku interesi i tij mund të përfshinte, legjisllacionin penal, procedural penal, ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale, trajtimin e të burgosurve, si edhe organizimin dhe funksionimin e strukturave të policisë gjyqësore. Po kështu jam i mendimit që Gjykata Kushtetuese duhet që t'i rikthehet jurisprudencës së saj të vjetër në lidhje me legjitimitimin e organizatave të tjera, duke lejuar edhe ato organizata pa anëtarësi. Këto organizata kanë treguar që janë shumë aktive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Për rrjedhojë nuk duhet që t'u mohohet legjitimiteti, aq më tepër kur Gjykata Kushtetuese nuk dha asnjë arsye për ndryshimin e jurisprudencës së saj.

9. Përsa i përket legjitimitetit të gjykatave rekomandojmë një zgjerim të kuptimit të këtij nocioni duke përfshirë edhe organet *quasi* gjyqësore. Në këtë mënyrë edhe në ato raste kur këto

organe ushtrojnë veprimtari “juridiksionale” dhe zgjidhin mosmarrëveshje, kanë mekanizmin që t’i zgjidhin ato në përputhje me parimet kushtetuese. Mohimi i kësaj mundësie do të sillte si pasojë një zvarritje të procedurave pasi do ta detyronin subjektin e së drejtës që më pas të ankohej në gjykatën e zakonshme dhe të kërkonte zhvillimin e një kontrolli incidental. Duhet theksuar se legjitimiteti i këtyre organeve njihet nga shumë juridiksione kushtetuese të huaja duke mos paraqitur asnjë problematikë në praktikë.

10. Një tjetër rekomandim është edhe krijimi i mundësisë për vetë Gjykatën Kushtetuese që të ushtrojë kontroll incidental pranë vetes së saj. Në këtë mënyrë, Gjykata Kushtetuese në çdo rast mund të shfuqizojë legjislacionin i cili shfaq probleme kushtetutshmërie dhe që duhet të zbatohet prej saj. Kështu, në kuadër të një gjykimi konkret, Gjykata Kushtetuese, mundet që të shfuqizojë edhe akte normative që kanë cënuar të drejtat apo parimet kushtetuese. Kjo mundëson kthimin e këtij institucioni në një mjet efektiv ankimor sipas parashikimeve të KEDNJ-së.

11. Një tjetër aspekt që ka nevojë për ndryshime në jurisprudencë është edhe legjitimiteti i gjykatave të zakonshme për të ushtruar edhe kontrollin konvencional ndaj ligjeve. Duke zbatuar këtë rekomandim, fryma dhe gërma e Kushtetutës mund të zbatohen siç duhet dhe për më tepër nuk do të kishim akte ligjore në fuqi, të cilat janë në kundërshtim me detyrimet ndërkombëtare të marra përsipër nga vendi ynë.

12. Individu si një tjetër subjekt i rëndësishëm kërkues duhet që të ketë një legjitimitet më të madh, për të kërkuar mbrojtjen e të gjitha të drejtave dhe lirive që Kushtetuta apo marrëveshje të tjera ndërkombëtare ia njohin atij. Për këtë arsye ky zgjerim i legjitimitetit të tij duhet që të shoqërohet edhe me zgjerimin e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese duke pranuar edhe kërkesat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të tjera përveç të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Ky zgjerim do të shërbejë si një garanci më e madhe për individin por njëkohësisht do të bëjë edhe më përgjegjëse institucionet e vendit tonë, karshi këtyre të drejtave. Është e kuptueshme që një individ mund të ankohet në Gjykatën Kushtetuese vetëm nëse ka shteruar të gjitha mjetet ankimore në dispozicion të tij. Edhe në këtë rast, ky shterim i mjeteve ankimore duhet që të jetë si formal, nëpërmjet të gjitha shkallëve ankimore, ashtu edhe material, duke ngritur pretendimet në çdo shkallë. Për më tepër nëse pretendohet se cënimi vjen nga një akt ligjor atëherë individ duhet që domosdoshmërisht të kërkojë nga organet administrative apo ato gjyqësore pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese. Në rast se individ nuk e kërkon kryerjen e këtij veprimi procedural në çdo shkallë atëherë ai nuk legjitimohet që të kundërshtojë ligjin më pas në Gjykatën Kushtetuese. Kjo mënyrë veprimi ndihmon edhe në parandalimin e ngarkesës në Gjykatën Kushtetuese.

13. Si një tjetër rekomandim, duhet që domosdoshmërisht të hiqen parashikimet e LGJK për legjitimitetin e subjekteve të ndryshme që nuk kanë status kushtetues. Pra, në ato raste kur përmendet Kuvendi apo kandidatë të pavarur të cilët për disa gjykime të veçanta kanë të drejtë të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese duhet që të hiqen si parashikime ligjore përderisa vetë Kushtetuta nuk i parashikon si subjekte për ato lloje procesesh. Në këtë linjë duhet që të hiqen edhe parashikimet e LGJK-së që bëjnë fjalë për kufizimin e disa subjekteve kushtetuese për disa procese kushtetuese. Kjo pasi në ato raste kur nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta, nuk mundet që ta bëjë ligji.

14. Në gjykimin kushtetues duhet që të lejohet dhe mundësohet edhe përdorimi i opinionëve *amicus curiae*. Gjykata Kushtetuese këtë mundësi e ka, duke qënë se LGJK-ja parashikon mundësinë e përfshirjes edhe të subjekteve të tjerë si pjesëmarrës, mjafton që të ketë interes për çështjen. Duke qënë se Gjykata Kushtetuese e ka interpretuar në mënyrë të gjerë këtë mundësi, atëherë është e rekomandueshme që vetë Gjykata Kushtetuese të lejojë pjesëmarrjen e



subjekteve që argumentojnë se mund të paraqesin trajtime që ndihmojnë në zgjidhjen e drejtë të çështjes, por edhe vetë kryesisht, të jetë aktive për të kërkuar pjesëmarrjen e tyre. Përfshirja e këtyre grupimeve ndihmon Gjykatën Kushtetuese në krijimin e një pasqyre më të plotë rreth çështjes dhe për rrjedhojë në marrjen e një vendimi më të drejtë.

15. Afatet procedurale janë një tjetër aspekt i rëndësishëm i procesit kushtetues. Megjithatë duhet theksuar se këto afate janë përgjithësisht të gjata pothuaj për të gjitha llojet e gjykimit. Për këtë arsye rekomandojmë që këto afate të shkurtohen. Kështu afati për të kundërshtuar në mënyrë abstrakte aktet normative duhet që të jetë 1 vjeçar, nga 3 vjeçar që është aktualisht. Afatet 6 mujore që parashikohen për disa lloje gjykimesh, si ai për mosmarrëveshjen e kompetencave, kontrollin e zgjedhshmërisë së deputetëve etj, të jetë një afat 2 mujor, ndërsa afati për të drejtën e individëve për t'u ankuar në Gjykatën Kushtetuese nga momenti që kanë shteruar të gjitha mjetet e tjera ankimore të jetë 4 mujor. Këto afate përgjithësisht zbatohen edhe në vende të tjera. Ndërsa përsa i përket afatit 4 mujor për individët, ky propozim mbështetet në parashikimin e ri që ka Protokollin 15 i KEDNJ-së sipas së cilit ankimi në GJEDNJ duhet që të ushtrohet brenda 4 muajve nga momenti i shterimit të mjeteve ankimore të brendshme. Në këtë mënyrë mund të themi që ruhet i njëjti standard. Shkurtimi i afateve sjell si pasojë rritjen e garancisë për ruajtjen e parimit të sigurisë juridike. Kjo nga ana tjetër kërkon që subjektet e legjitimuara nga Kushtetuta të jenë më aktive për mbrojtjen e të drejtave, parimeve kushtetuese dhe interesave të tyre. Duke qenë se Kushtetuta jonë parashikon një rreth shumë të gjerë subjektësh në raport me disa vende të tjera, si edhe duke pasur në konsideratë rekomandimin për zgjerimin e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, atëherë për të ulur edhe nivelin e ngarkesës së Gjykatës, duhet që afatet të jenë më të shkurtra se ato që parashikohen aktualisht nga LGJK-ja.

16. Gjykata Kushtetuese duhet që veprimtarinë e saj procedurale ta rregullojë edhe në përputhje me gjetjet e reja inovative dhe teknologjike. Kështu mund të parashikohet që për kryerjen e veprimeve të caktuara procedurale, si për shembull njoftimi, të bëhet nëpërmjet formave të ndryshme elektronike të komunikimit. Për këtë arsye mjafton që kërkuesi dhe subjektet e tjera të japin pëlqimin nëpërmjet një deklarate që janë dakort për përdorimin e këtyre formave në mënyrë që njoftimi të quhet i ligjshëm. Po kështu Gjykata, nëpërmjet këtyre formave mund të bëjë edhe shkëmbimin e materialeve që pjesëmarrësit paraqesin në gjykim, duke fituar në këtë mënyrë kohë dhe duke garantuar zbatimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor edhe në gjykimin kushtetues. Një tjetër shembull mund të jetë edhe regjistrimi i seancave gjyqësore. Duke iu përshtatur zgjidhjeve të reja inovative, Gjykata Kushtetuese mund të bëhet edhe më e aksesueshme për individët, të cilët mund të paraqesin kërkesat e tyre në formë elektronike, duke shmangur, deri në njëfarë shkalle, veprimet burokratike. Për këtë arsye është e nevojshme që në LGJK të bëhen edhe parashikimet normative përkatëse.

17. Një tjetër aspekt që ka të bëjë me gjykimin kushtetues dhe ka nevojë për përmirësim janë edhe provat. Kështu përveç provave klasike që lejohen në gjykimin kushtetues, duhet që Gjykata Kushtetuese të kërkojë marrjen e disa lloje provash të cilat i shërbejnë veçanërisht gjykimit kushtetues. Këto mund të jenë studime të ndryshme, mendime nga ekspertë të fushave të ndryshme, si psikologë, sociologë, ekonomistë etj. Marrja e këtyre provave megjithëse duket sikur parashikohet aktualisht nga LGJK-ja, ka nevojë për një rregullim të posaçëm, pasi kemi të bëjmë më shumë me studime dhe mendime akademike sesa ekspertime të mirëfillta. Këto lloje provash që përdoren shumë nga gjykatat kushtetuese homologe shërbejnë shumë edhe në gjykimet abstrakte për të nxjerrë një kuptim më të plotë të situatës ku vepron akti juridik, objekt gjykimi dhe për rrjedhojë për të konkluduar më mirë në raport me kushtetutshmërinë e normës.

18. Duke pasur në konsideratë, zgjerimin e subjekteve kërkuese dhe veçanërisht të juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, rekomandojmë që edhe gjykimi kushtetues në tërësinë e tij të ndryshohet. Kështu ndarja e Gjykatës nëpër kolegje nuk duhet që të bëhet vetëm me qëllim verifikimin e plotësimin të kushteve formale të kërkesës, legjitimitimin e subjektit dhe kompetencën e Gjykatës Kushtetuese, por këto kolegje duhet që të jenë trupa gjyqësore të mirëfilltë. Pra, një kolegji i Gjykatës Kushtetuese, duhet të ketë mundësinë që të vendosë edhe për themelin e çështjes. Gjikimi në trupa më të vogla është një praktikë që njihet edhe nga disa gjykata të tjera kushtetuese, si ajo spanjolle, gjermane, çeke etj. Është e kuptueshme që këto kolegje do të gjykojnë çështje për të cilat ka precedentë të konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese. Në rast se nuk ka precedentë për çështjen e paraqitur, ose kolegji kërkon që ta ndryshojë këtë precedent atëherë Gjykata Kushtetuese duhet që ta shqyrtojë kërkesën me pjesëmarrjen e të gjithë gjyqtarëve. Me pjesëmarrjen e të gjithë gjyqtarëve duhet që të shqyrtohen edhe çështjet që kanë të bëjnë me procedurat *impeachment*, apo me statusin dhe mandatin e të zgjedhurve dhe funksionarëve të lartë që ushtrojnë funksione kushtetuese, si edhe me kontrollin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Për të mos lejuar daljen e kolegjeve nga precedentët e Gjykatës Kushtetuese duhet që vendimet në to të merren gjithmonë me unanimitet. Në mungesë të këtij unanimiteti atëherë çështja duhet që të gjykohej nga Gjykata Kushtetuese me pjesëmarrjen e të gjithë gjyqtarëve. Nëpërmjet kësaj zgjidhjeje, e lidhur edhe me fortësimin e rolit të precedentit të sugjeruar më sipër dhe me shkurtimin e afateve procedurale, jam i mendimit që Gjykata Kushtetuese do të mundet që të menaxhojë ngarkesën e çështjeve që mund të vijnë përpara saj dhe të marrë vendime brenda një afati të arsyeshëm.

19. Gjykata Kushtetuese në arsyetimin e vendimeve të saj duhet që të përdorë me kujdes teknikat e shumta që ka në dispozicion. Kështu nga ana e saj duhet të përdoret me kujdes veçanërisht e drejta e krahasuar, pasi një njohje jo e plotë dhe e mangët e saj mund të çojë në rezultate diametralisht të kundërta në raport me modelin që përdoret si krahasim.

20. Një tjetër mjet për të ulur ngarkesën është edhe dhënia e kompetencës Gjykatës Kushtetuese për të penalizuar kërkuesit që abuzojnë me të drejtën e ankimit kushtetues. Legjislacioni në këtë rast duhet që të parashikojë vetëm minimumin dhe maksimumin e penalizimit, duke e lënë në diskrecionin e Gjykatës Kushtetuese përcaktimin e masës konkrete. Në këtë mënyrë do të kemi një frenim të kërkesave abuzive apo të përsëritura.

21. Një tjetër sugjerim lidhet me mënyrën e arsyetimit të vendimeve për pranimin ose rrëzimin e kërkesave për pezullimin e akteve objekt gjykimi. Sugjerojmë që në këtë rast Gjykata Kushtetuese duhet që të japë argumenta më të plotë se përse ka vendosur ta pranojë apo rrëzojë një kërkesë të tillë. Kjo mundëson një njohje më të mirë të kritereve mbi bazën e së cilave Gjykata Kushtetuese e përdor këtë instrument procedural dhe nga ana tjetër shmang paraqitjen e kërkesave abuzive dhe të vazhdueshme për pezullimin e akteve objekt gjykimi.

22. Një tjetër rekomandim që lidhet edhe me marrjen e masës së pezullimit është edhe pezullimi i procedurave të ratifikimit të një marrëveshje ndërkombëtare. Kështu, në këndvështrimin personal, këto procedura parlamentare duhet që të pezullohen në momentin e paraqitjes së kërkesës. Në këtë rast, me paraqitjen e këtij akti, Gjykata Kushtetuese njofton menjëherë Kuvendin i cili pezullon procedurat. Në këtë mënyrë shmanget zhvillimi i procedurave parlamentare me shpejtësi, me synimin për të kaluar në kohë procedurat seleksionuese të Gjykatës Kushtetuese dhe për të vënë atë përpara faktit të kryer. Nga ana tjetër duke pasur në konsideratë praktikën e deritanishme sipas së cilës marrëveshjet ndërkombëtare janë kundërshtuar vetëm dy herë përpara Gjykatës Kushtetuese, nuk duhet të kemi frikë se mund të abuzohet me paraqitjen e kërkesës me qëllim pengimin e Kuvendit. Për më tepër ky

rekomandim i shoqëruar edhe me rekomandimin për vendosjen e penalizimeve për kërkesat abuzive shpesh frikën për krijimin e një situatë të tillë.

23. Përsa i përket vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese ajo ka nevojë që të ndryshojë në lidhje me heqjen e mundësisë për të vendosur refuzimin e çështjes. Rregullimi aktual kushtetues, sipas nenit 133, pika 2 të ligjit themelor, kërkon që "pro" kërkesës të votojnë të paktën pesë gjyqtarë. Për të mos rënë në kundërshtim me këtë parashikim kushtetues, mundësia më e mirë, për rregullimin e kësaj situatë, është që Gjykata Kushtetuese, në rast të mos arritjes së pesë votave "pro" kërkesës së paraqitur, të vendosë rrëzimin e saj. Në këtë mënyrë kërkuesi ka marrë një vendim në lidhje me pretendimet e tij. Por gjithashtu mund të sugjerohet, por vetëm duke ndryshuar Kushtetutën dhe përkatësisht nenin 133, pika 2, që përcaktuese në këtë rast të bëhet vota e Kryetarit. Pavarësisht njëres apo tjetres zgjidhje, kjo lloj vendimmarrje e Gjykatës Kushtetuese duhet që të rregullohet në mënyrë që gjykimi i saj dhe vetë vendi ynë të mos penalizohet më në të ardhmen nga GJEDNJ-ja.

24. Në lidhje me efektin e vendimeve të saj Gjykata Kushtetuese duhet që në mënyrë të shprehur të mbajë një qëndrim. Këtu mund të shërbejnë si shembull plot vende të tjera kur mund të përmendim Italinë, Austrinë etj, ku Gjykata Kushtetuese në çdo rast që shfuqizon një akt shprehet në pjesën arsyetuese ose në dispozitiv për efektet e vendimit të saj në përputhje me rastet e ndryshme që parashikon dhe legjislacioni përkatës. Duke vepruar në këtë mënyrë krijohet një qartësi më e madhe në marrëdhëniet juridike që preken nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese. Në këtë aspekt edhe institucionet e tjera, si edhe gjykatat e zakonshme në zgjidhjen e çështjeve janë më të qëndrueshme në vendimmarrjen e tyre.

25. Një tjetër aspekt që ka nevojë për një reformim dhe ndërhyrje të thellë, është ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, pasi rregullimi aktual ka treguar se është i pamjaftueshëm. Duke qenë se juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese mund edhe të zgjerohet me pranimin e ankesave të individëve për shkeljen e çdo të drejte të njohur nga Kushtetuta apo marrëveshje ndërkombëtare, atëherë këtij institucioni i duhen dhënë edhe mjetet për të garantuar zbatimin e vendimeve të saj. Shembuj në këtë drejtim janë të shumtë, por personalisht rekomandoj që Gjykata Kushtetuese të përcaktojë në vendimin e saj organin e ngarkuar për ekzekutimin e vendimit gjyqësor si edhe mënyrën e veprimit. Ky moment duhet përforcuar edhe me parashikimin e detyrimit për raportim të organit që ka barrën për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Nëse Gjykata Kushtetuese nuk bindet nga këto raportime atëherë ajo duhet të ketë të drejtën që të kërkojë procedimin disiplinor të përgjegjësve për moszbatimin e vendimit të saj si edhe t'i penalizojë ato nëpërmjet masave financiare. Gjithashtu si pikë e fundit Gjykata Kushtetuese duhet që të ketë mundësinë që të caktojë edhe dëmshpërblimin për individët që sipas Gjykatës, kanë pësuar çnime në të drejtat dhe liritë e tyre. Masa e dëmshpërblimit nuk duhet që të vendoset nga LGJK-ja por i duhet lënë në diskrecion Gjykatës Kushtetuese që ta vendosë sipas shembullit të GJEDNJ-së. Kombinimi i këtyre mënyrave do të mundësojë rritjen e efektivitetit për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

26. Përsa i përket raportit midis juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave të zakonshme, jemi të mendimit që në këtë rast ka nevojë të madhe për një përpunim jurisprudencial nga vetë Gjykata Kushtetuese. Kështu, Gjykata, duhet që në çdo rast të japë në pjesën arsyetuese të vendimit, pikat e kontaktit dhe të dallimit midis këtyre dy juridiksioneve. Kjo do të shërbejë për një dallim dhe orientim më të mirë të zbatuesve të së drejtës por edhe të institucioneve shtetërore. E themi këtë pasi në disa raste Gjykata Kushtetuese ka pasur mundësinë që të japë një qëndrim në rastin e gjykimit të mosmarrëveshjeve të kompetencave apo të shkarkimit të disa funksionarëve nga Kuvendi, çështje që ishin paraqitur njëkohësisht edhe në



Gjykatën Kushtetuese edhe në gjykatat e zakonshme, por që janë lënë në heshtje prej saj. Duke qenë më aktive dhe prodhuese në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese u krijon mundësinë subjekteve që të kenë të qartë mjetet e tyre ankimore.

27. Gjykata Kushtetuese duhet që gjithashtu të veprojë në mënyrë më aktive për të qenë në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së. Kështu përveç ndjekjes së rregullt të qëndrimeve të kësaj gjykate, Gjykata Kushtetuese duhet domosdoshmërisht që të marrë në konsideratë rastet kur Shqipëria është dënuar nga GJEDNJ-ja. Rasti më tipik është dënimi që pësuam për shkak të zbatimit nga Gjykata Kushtetuese të vendimit të refuzimit. Megjithëse vendimi i GJEDNJ-së është i vitit 2008, deri më sot Gjykata jonë Kushtetuese përsëri ka vepruar duke vendosur refuzimin e kërkesës në shumë raste të tjera. Është e vërtetë që ajo nuk ka kompetencën për të miratuar ligje por duke qenë se sipas mendimit të shprehur në këtë punim, ka mundësinë që të ushtrojë kontroll incidental pranë vetes së saj, atëherë ajo duhet që ta kishte shfuqizuar me kohë këtë dispozitë. Më pas duke zbatuar parashikimin e nenit 133, pika 2 të Kushtetutës që kërkon shumicën e të gjithë anëtarëve të disponojë me rrëzimin e kërkesave që nuk marrin minimalisht 5 vota "pro".

Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese duhet që të përgatitet edhe për krijimin e një dialogu të ri me GJEDNJ-në, bazuar në Protokollin 16 të KEDNJ-së. Kjo procedurë e re, që mundëson ngritjen e çështjeve paragykimore pranë GJEDNJ-së, kërkon një njohje të mirë të jurisprudencës së kësaj gjykate. Gjykata jonë Kushtetuese duhet që të ketë kurajon ta përdorë sa më shumë të jetë e mundur, kuptohet aty ku është nevoja, këtë mjet të ri procedural.

28. Ndoshta është shpejt dhe e tepërt që të flitet për rekomandime për Gjykatën Kushtetuese dhe raportin e saj me legjislacionin e BE-së dhe GJED-së. Por, Gjykata Kushtetuese duhet që të ketë në konsideratë faktin që është një "gjykatë kombëtare", e aftë për të vënë në lëvizje GJED-në dhe për më tepër, ka autoritetin, juridiksionin dhe kompetencën për të vendosur për kushtetutshmërinë e legjislacionit dytësor të BE-së.

## BIBLOGRAFIA

### Literaturë

- Abdiu, Fehmi, *"Kushtetuta dhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë"*, Shtëpia Botuese Redona 2001, Tiranë, Dhjetor 2000.
- Alimehmeti, Evis, *"Neni 13 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave e Lirive Themelore të Njeriut dhe kuadri ligjor shqiptar"*, Shtëpia Botuese "Geer", Tiranë 2012.
- Anastasi, Aurela, *"Historia e së drejtës kushtetuese në Shqipëri 1912-1939"*, Shtëpia Botuese "Pegi", Tiranë 2007.
- Brati, Alban, *"Procedura Civile"*, Botim i Parë, Shtëpia Botuese "Dudaj", Tiranë 2008.
- *"Black's Law Dictionary"*, botimi i nëntë, Shtëpia Botuese "West Publishing Co", Dallas 2009.
- Cannone, Andrea, *"La giurisprudenza costituzionale in materia internazionale ed europea, 2001 – 2009, III"*, Shtëpia Botuese "Editoriale Scientifica" Napoli 2010.
- Cavalieri, Paolo, *"Diritto Regionale"*, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova 2006.
- *"Debati Kushtetues"*, Vëllimi 1, botim i OSBE, Shtëpia Botuese "P.S.H. 2015", Tiranë 2006.
- *"Debati Kushtetues"*, Vëllimi 2, botim i OSBE, Shtëpia Botuese "P.S.H. 2015", Tiranë 2006.
- Dobjani, Ermir; Toska, Elsa; Puto, Erlir; Dobjani, Erajd; *"E drejta administrative – Kontrolli mbi Administratën Publike"*, Shtëpia Botuese "EMAL", Tiranë 2013.
- Dhima, Dhimo, *"E Drejta Kushtetuese e Republikës Popullore të Shqipërisë"*, Shtypshkronja Mihal Duri, Tiranë 1963.
- *"Fjalori i Gjuhës Shqipe"*, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 2006.
- *"Fjalori Enciklopedik Shqiptar"*, botim i Akademisë e Shkencave të Shqipërisë, Shtypshkronja "Kristalina – KH", Vëllimi II, Tiranë 2008
- Gozler, Kemal, *"Judicial Review of constitutional amendments"*, Shtëpia Botuese "Ekin Press", Bursa – Turqi 2008.
- Harberle, Peter, *"La verfassungsbeschöerde nel sistema della giustizia costituzionale tedesca"*, botimi në italisht, Shtëpia Botuese "Giuffrè Editore", Milano 2000.
- INTERIGHTS MANUAL - *RIGHT TO A FAIR TRIAL UNDER THE EUROPEAN CONVENTION ON HUMAN RIGHTS (ARTICLE 6)*, Viti 2009, version online.
- Jacque, Jean Paul, *"E drejta institucionale e Bashkimit Evropian"*, botim në shqip, Shtëpia Botuese "Papyrus", Tiranë 2010.
- Kommers, Donald P.; Miller, Russell A.; *"The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany"*, Shtëpia Botuese "Duke University Press", Londër 2012.
- Kuijer, Martin, *"Applicability of Article 6 ECHR"*, viti 2009, format elektronik.
- Luarasi, Aleks, *"Akte Juridike për Historinë e Shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri – Pjesa II"*, Shtëpia Botuese Luarasi, Tiranë 1999.
- Martines, Temistocle, *"E drejta kushtetuese"*, botim në gjuhën shqipe, Shtëpia Botuese "UET Press", Tiranë 2011.
- Nova, Koço, *"Zhvillimi i organizimit gjyqësor në Shqipëri"*, Kombinati Poligrafik, Tiranë 1982.

- Omari, Luan; Anastasi, Aurela; *"E drejta kushtetuese"*, Shtëpia Botuese "ABC", Tiranë 2010.
- Palnikaj, Dritan, *"Kushtetutat"*, Shypshkronja "Grand Prind", Tiranë 2006.
- *"Protocol No. 16 to the Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms – Explanatory Report"*, botim i Këshillit të Evropës, viti 2014, format elektronik.
- Puto, Arben, *"Çështja Shqiptare në Aktet Ndërkombëtare të Periudhës së Imperializmit"*, Vëllimi II, Shtëpia Botuese "8 Nëntori", Tiranë 1987.
- *"Qeveria e Përkohëshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj"*, Botim i Drejtorisë së Përgjithëshme të Arkivave Shtetërore të R.P.Sh., Shtëpia Botuese "Mihal Duri", Tiranë 1963.
- Ruggeri, Antonio; Spadaro, Antonino, *"Lineamenti di giustizia costituzionale"*, Shtëpia Botuese "G. Giappichelli Editore", Torino 2009.
- Sadushi, Sokol, *"Kontrolli kushtetues"*, Shtëpia Botuese "Botimpex", Tiranë 2004.
- Sadushi, Sokol, *"E Drejta Administrative 2, Teoria e aktit administrativ"*, Shtëpia Botuese "ORA", Tiranë 2005.
- Sadushi, Sokol, *"Drejtësia kushtetuese në zhvillim"*, Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2012.
- Schwartz, Herman, *"The struggle for constitutional justice in post-communist Europe"*, Shtëpia Botuese "The University of Chicago Press", Chicago 2000.
- Teresi, Francesco, *"I giudizi della Corte Costituzionale"*, Shtëpia Botuese "Cacucci", Bari – Itali 2010.
- Traja, Kristaq, *"Drejtësia Kushtetuese"*, Shtëpia Botuese "Luarasi", Tiranë 2000.
- *"Udhëzime dhe Vendime të Gjykatës së Lartë të RPSSH (Përmbledhje të viteve 1974, 1975, 1976, 1977)"*, Shtëpia Botuese "8 Nëntori", Tiranë 1982.
- Uka, Njazi, *"Fjalori i Drejtësisë"*, Shtëpia Botuese "Iliar" P.F., Tiranë 2011.
- *"Vendime të Përzgjedhura të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane"*, botim i Fondacionit "Konrad Adenauer", Shtëpia Botuese "Vinsent-Grafika", Shkup 2010.
- Vorpsi, Arta, *"Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë"*, botim i Fondacionit Konrad Adenauer, Shtëpia Botuese "Maluka", Tiranë 2011.
- Versioni i konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Europian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Europian, botim i Ministrisë së Integritimit Evropian në bashkëpunim me GIZ, pa vit.
- Zaganjori, Xhezair; Anastasi, Aurela; Çani (Met'hasani), Eralda; *"Shteti i së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë"*, Botim i Fondacionit Konrad Adenauer, Shtëpia Botuese "Adelprint", Tiranë 2011.
- Zaganjori, Xhezair; Vorpsi, Arta; Biba, Denar; *"Parime kushtetuese dhe të drejta themelore në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese"*, botim i Fondacionit "Konrad Adenauer", Shtëpia Botuese "Adelprint", Tiranë 2012.
- Zagrebelesky, Gustavo; Marceno, Valeria; *"Giustizia costituzionale"*, Shtëpia Botuese "il Mulino", Bologna 2012.



## Referime shkencore

- Agosta, Stefano, ““Soggetti” ed “oggetti” del giudizio in via principale al banco di prova: i chiaroscuo della giurisprudenza costituzionale”, botuar në “Le zone d’ombra della giustizia costituzionale – I giudizi sulle leggi”, botim i “Quaderni del “Gruppo di Pisa””, Shtëpia Botuese “G. Giappichelli Editore”, Torino 2007.
- Alberton, Ghislaine, “Francia”, botuar në “Giustizia Costituzionale e Unione Europea – Una comparazione tra Austria, Francia, Germania, Italia, Spagna e Portogallo”, nën kujdesin e Alfonso Celotto, Javier Tajadura, Josu De Miguel Barcena, përkthimi në italisht, Shtëpia Botuese “Editoriale Scientifica srl”, Napoli 2011.
- Banaszak, Boguslaw; Jorsz-Zukowska Sylwia; Zukowski, Lukas; “International and European Law in the polish legal system”, botuar në “International Constitutional Law”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “G. Giappichelli Editore”, Torino 2014.
- Belletti, Michele, “Il sistema costituzionale portoghese”, botuar në “Sistemi e modelli di giustizia costituzionale”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “Cedam”, Padova, 2009.
- Burgorgue-Larsen, Laurnce; Bruck, Veronique; “The relationship between EU Law, the ECHR and French Constitutional Law”, botuar në “International Constitutional Law”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “G. Giappichelli Editore”, Torino 2014.
- Carducci, Michele, “Il sistema di giustizia costituzionale della Turchia”, botuar në “Sistemi e modelli di giustizia costituzionale”, Vëllimi II, botim nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “Cedam”, Padova 2011.
- Carlassare, Lorenza, “Interlocutory Review – Abstract Review”, botuar në “The protection of fundamental rights by the constitutional court”, Koleksioni “Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15”, botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998.
- Castro, J.L. Cascajo, “Rights suitable for protection by constitutional appeal procedures”, botuar në “The protection of fundamental rights by the constitutional court”, Koleksioni “Shkenca dhe teknika të Demokracisë”, Nr.15, ribotim 1998.
- Celotto, Alfonso, “Italia”, botuar në “Giustizia Costituzionale e Unione Europea – Una comparazione tra Austria, Francia, Germania, Italia, Spanga e Portogallo”, në kujdesin e Alfonso Celotto, Javier Tajadura, Josu De Miguel Barcena, Shtëpia Botuese “Editoriale Scientifica srl”, Napoli 2011.
- Cecamore, Francesca, “L’autorita indipendente come parte nel conflitto di attribuzione fra poteri dello Stato”, botuar në “Le zone d’ombra della giustizia costituzionale – I giudizi sui conflitti di attribuzione e sull’ammisibilità del referendum abrogativo”, botuar nga “Quaderni del “Gruppo di Pisa”, nën kujdesin e Roberto Pinardi, Shtëpia Botuese “G.Giappichelli Editore”, Torino 2007.
- Crnic, Jadanko, “What rights can be duly protected by a constitutional complaint”, botuar në “The protection of fundamental rights by the constitutional court”, Koleksioni “Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15”, botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998.
- De Miguel Barcena, Josu, “Spanga”, botuar në “Giustizia Costituzionale e Unione Europea – Una comparazione tra Austria, Francia, Germania, Italia, Spanga e Portogallo”, nën kujdesin e Alfonso Celotto, Javier Tajadura, Josu De Miguel Barcena, Shtëpia Botuese “Editoriale Scientifica srl”, Napoli 2011.

- Di Giacomo Russo, Bruno, *“La difesa costituzionale delle autonomie locali”*, botuar në “Le zone d’ombra della giustizia costituzionale – I giudizi sui conflitti di attribuzione e sull’ammisibilità del referendum abrogativo”, botuar nga “Quaderni del “Gruppo di Pisa”, nën kujdesin e Roberto Pinardi, Shtëpia Botuese “G.Giappichelli Editore”, Torino 2007.
- Di Gregorio, Angela, *“La corte costituzionale della Russia”*, botuar në “Sistemi e modelli di giustizia costituzionale”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “Cedam”, Padova, 2009.
- Di Martino, Alessandra, *“The open constitutional state: Germany response to international and european legal pluralism”*, botuar në “International Constitutional Law”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “G. Giappichelli Editore”, Torino 2014.
- Dobjani, Erajd; Toska, Elsa; *“Neni 131/e i Kushtetutës dhe kodet zgjedhore”. A është kolegji zgjedhor instancë e fundit ankimi për verifikimin e zgjedhshmërisë së kandidatëve për deputetë?*, botuar në “Aspekte të ndryshme të sistemeve zgjedhore dhe roli i tyre në zhvillimin e demokracisë”, Tiranë 2015.
- D’Orlando, Elena, *“La giustizia costituzionale in Austria”*, botuar në “Sistemi e modelli di giustizia costituzionale”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “Cedam”, Padova, 2009.
- Duarte, Maria Luisa; Gomes, Carla Amado; *“Portogallo”*, botuar në “Giustizia Costituzionale e Unione Europea – Una comparazione tra Austria, Francia, Germania, Italia, Spagna e Portogallo”, nën kujdesin e Alfonso Celotto, Javier Tajadura, Josu De Miguel Barcena, përkthimi në italisht, Shtëpia Botuese “Editoriale Scientifica srl”, Napoli 2011.
- Fanotto, Luca *“La giustizia costituzionale negli ordinamenti asiatici”*, botuar në “Sistemi e modelli di giustizia costituzionale”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “Cedam”, Padova 2009.
- Freixes, Teresa, *“The right to a fair trial in Spain”*, botuar në “The right to a fair trial”, Koleksioni “Shkenca dhe teknika të demokracisë”, nr.28, botim i Komisionit Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias), Gjermani 2000.
- Gamper, Anna, *“Austria”*, botuar në “Giustizia Costituzionale e Unione Europea – Una comparazione tra Austria, Francia, Germania, Italia, Spanga e Portogallo”, nën kujdesin e Alfonso Celotto, Javier Tajadura, Josu De Miguel Barcena, Shtëpia Botuese “Editoriale Scientifica srl”, Napoli 2011.
- Giovannetti, Tommaso, *“I “soggetti esclusi” nei conflitti di atribuzione”*, botuar në “Le zone d’ombra della giustizia costituzionale – I giudizi sui conflitti di attribuzione e sull’ammisibilità del referendum abrogativo”, botuar nga “Quaderni del “Gruppo di Pisa”, nën kujdesin e Roberto Pinardi, Shtëpia Botuese “G.Giappichelli Editore”, Torino 2007.
- Hollander, Pavel, *“The right to a fair trial in the Czech Republic”*, botuar në “The right to a fair trial”, Koleksioni “Shkenca dhe teknika të demokracisë”, nr.28, botim i Komisionit Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias), Gjermani 2000.
- Kovacs, Peter, *“International Law in recent jurisprudence of the Hungarian Constitutional Court – Opening a new tendency?”*, botuar në “International Constitutional Law”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “G. Giappichelli Editore”, Torino 2014.

- Matscher, Franz, *"The right to a fair trial in the case law of the organs of the European Convention on Human Rights"*, botuar në "The right to a fair trial", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të demokracisë", nr.28, botim i Komisionit Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias), Gjermani 2000.
- Mavcic, Arne, *"The protection of fundamental rights by the Constitutional Court and the practice of the Constitutional Court of the Republic of Slovenia"*, botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të Demokracisë", botim i Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) Nr.15, ribotim 1998.
- Mezzetti, Luca dhe Polacchini Francesca, *"Primacy of Supranational Law and Supremacy of the Constitution in the Italian Legal System"*, botuar në "International Constitutional Law", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "G.Giappichelli Editore", Torino 2014.
- Momcinovic, Hrvoje, *"Contesting the arbitration decision in the proceedings before the Constitutional Court according to the Croatian law"*, botuar në "The protection of fundamental rights by the constitutional court", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të Demokracisë", botim i Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) Nr.15, ribotim 1998.
- M. Kampo, Volodymyr; V. Savchyn, Mykhaylo; *"Ukraine: International Treaties and European Acts in National Courts Practice"*, botuar në "International Constitutional Law", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "G.Giappichelli Editore", Torino 2014.
- Nicotra, Ida, *"Le zone d'ombra nel giudizio di ammissibilita del referendum abrogativo"*, botuar në "Le zone d'ombra della giustizia costituzionale – I giudizi sui conflitti di attribuzione e sull'ammissibilita derl referendum abrogativo", Aktet e seminarit të Modena, mbajtur më 13 tetor 2006, botuar nga "Quaderni del "Gruppo di Pisa", nën kujdesin e Roberto Pindari, Shtëpia Botuese "G.Giappichelli", Torino 2007.
- Oniszczyk, Jerzy, *"The right to a fair trial in the decisions of the Polish Constitutional Tribunal"*, botuar në "The right to a fair trial", Koleksioni "Shkenca dhe teknika të demokracisë", nr.28, botim i Komisionit Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias), Gjermani 2000.
- Padula, Carlo, *"Conflitti di attribuzione tra Stato e Regioni"*, botuar në "Le zone d'ombra della giustizia costituzionale – I giudizi sui conflitti di attribuzione e sull'ammissibilita del referendum abrogativo", botuar nga "Quaderni del "Gruppo di Pisa", nën kujdesin e Roberto Pinardi, Shtëpia Botuese "G.Giappichelli Editore", Torino 2007.
- Palermo, Francesco, *"La giustizia costituzionale in Germania"*, botuar në "Sistemi e modelli di giustizia costituzionale", nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese "Cedam", Padova 2009.
- Parisi, Stefania, *"Parametro e oggetto nei conflitti di attribuzione"*, botuar në "Le zone d'ombra della giustizia costituzionale – I giudizi sui conflitti di attribuzione e sull'ammissibilita del referendum abrogativo", botuar nga "Quaderni del "Gruppo di Pisa", nën kujdesin e Roberto Pinardi, Shtëpia Botuese "G.Giappichelli Editore", Torino 2007.



- Pistan, Carna, *“La giustizia costituzionale nell’Europa Centro-Orientale: Le esperienze di Croazia, Slovenia, Polonia e Ungheria”*, botuar në “Sistemi e modelli di giustizia costituzionale”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “Cedam”, Padova, 2009.
- Pistan, Carna, *“I sistemi di giustizia costituzionale nei paesi dell’Europa centro-orientale e dell’area post-sovietica”*, botuar në “Sistemi e modelli di giustizia costituzionale – Tomo II”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “Cedam”, Padova 2011.
- Pistan, Carna, *“The implementation of International/European Law in the Republic of Croatia”*, botuar në “International Constitutional Law”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “G.Giappichelli Editore”, Torino 2014.
- Ruço, Noela; Pajo (Bala), Valbona; *“Standardet zgjedhore në fokusin e jurisprudencës kushtetuese shqiptare”*, botuar në “Aspekte të ndryshme të sistemeve zgjedhore dhe roli i tyre në zhvillimin e demokracisë”, Tiranë 2015.
- Ruiz, Gerardo Ruiz-Rico, *“Il Tribunale Costituzionale Spagnolo”*, botuar në “Sistemi e modelli di giustizia costituzionale”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “Cedam”, Padova, 2009.
- Sanchez, Pedro Julio Tenorio, *“International treaties in Spanish Law”*, botuar në “International Constitutional Law”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “G. Giappichelli Editore”, Torino 2014.
- Seibert, Helga, *“Admissibility requirements for constitutional complaints and mechanisms for avoiding an excessive case load”*, botuar në “The protection of fundamental rights by the constitutional court”, Koleksioni “Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15”, botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998.
- Specchia, Marina Calamo, *“La giustizia costituzionale in Francia”*, botuar në “Sistemi e modelli di giustizia costituzionale”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “Cedam”, Padova, 2009.
- Sovdat, Jaradanka, *“Human Rights between the Constitution, Treaties, and EU Law. The Case of Slovenia”*, botuar në “International Constitutional Law”, nën kujdesin e Luca Mezzetti, Shtëpia Botuese “G.Giappichelli Editore”, Torino 2014.
- Tonga, Massimo, *“Dinamica processuale ed effetti della pronuzie”* botuar në “Le zone d’ombra della giustizia costituzionale – I giudizi sui conflitti di atribuzione e sull’ammissibilità del referendum abrogativo”, Aktet e seminarit të Modena mbajtur më 13 tetor 2006, botuar nga “Quaderni del “Gruppo di Pisa”, nën kujdesin e Roberto Pindari, Shtëpia Botuese “G.Giappichelli”, Torino 2007.
- Vidal, Carlos, *“Germania”*, botuar në “Giustizia Costituzionale e Unione Europea – Una comparazione tra Austria, Francia, Germania, Italia, Spanga e Portogallo”, në kujdesin e Alfonso Celotto, Javier Tajadura, Josu De Miguel Barcena, Shtëpia Botuese “Editoriale Scientifica srl”, Napoli 2011.
- Vorpsi, Arta, *“Ankimi individual në Gjykatën Kushtetuese Shqiptare – Mjet juridik efektiv?”*, botuar në “Mekanizmat mbrojtës të të drejtave të individëve në kuadër të procesit të rregullt ligjor”, Shtëpia Botuese “Pegi”, Tiranë 2012.

- Anastasi, Aurela, "Gjykatë e paanshme", si parim kushtetues për një gjyqësor të fortë dhe të besueshëm", botuar në Revistën "Avokatia", nr.8, botim i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Tetor 2013.
- Berberi, Sokol, "Ligjvënësi dhe kontrolli kushtetues", botuar në Revistën "Avokatia", nr.14, botim i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Shtëpia Botuese "Kumi", Tiranë, Prill 2015.
- Biba, Denar, "Pezullimi në gjykimin kushtetues", botuar në Revistën "Jeta Juridike", nr.4 dhjetor 2006, botim i Shkollës së Lartë të Magjistraturës, Shtëpia Botuese "Erik".
- Hasani, Enver, "Kontrolli abstrakt dhe preventiv (paraprak) i amendamenteve kushtetuese dhe mbrojtja nga shkarkimi i shefit të shtetit: rasti i Kosovës", botuar në revistën "E Drejta – Pravo – Law", nr.1/2013, botim i USAID dhe Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.
- Kelemen, Katalin, "Dissenting opinions in constitutional courts", botuar në "German Law Journal" Vol.14, Nr.8, viti 2013 fq.1345, versioni online,
- Leskoviku, Migena; Leskoviku, Dorian, "Partitë politike në Shqipëri. Roli i tyre si organizime kushtetuese dhe formacione individuale të lira", botuar në Revistën "Jus & Justicia", nr.6, botim i Fakultetit Juridike të Universitetit European të Tiranës, Shtëpia Botuese "UET Press" Tiranë 2011.
- Lopez, Enrique Guillen, "Judicial Review in Spain: The Constitutional Court", botuar në "Loyola of Los Angeles LawReview", Vol.41, 2008
- Pirdeni, Adea, "Vështrim i shkurtër mbi aksesin e individit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", botuar në "Sistemi kushtetues dhe sfidat e tij", Revista "Studime Juridike", botim i Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Shtëpia Botuese "Adelprint", Tiranë 2009.
- Pirdeni, Adea, "Justifikimi i interesit në gjykimin kushtetues: Vështrim mbi praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", botuar në Revistën "Studime Juridike", Nr.2, i vitit 2011, Botim i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, Shtëpia Botuese "Pegi", Tiranë 2011.
- Rado, Klodian, "Kontrolli incidental në Shqipëri", botuar në Revistën "Studime Juridike", nr.2, i vitit 2006, botim i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, Shtëpia Botuese "Pegi".
- Sadushi, Sokol, "Pushteti legjislativ i administratës", botuar në Revistën "Avokatia", nr.6, Botim i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Shtypshkronja "Dea Print", Tiranë, Prill 2013.
- Sulko, Ervin, "Ankimi individual në këndvështrimin kushtetues krahasimor", botuar në Revistën "Studime Juridike", nr.2, botim i Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Shtëpia Botuese "Europrint", Tiranë 2014.
- Traja, Kristaq, "Procesi i rregullt ligjor", Revista "Studime Juridike", nr.1 i vitit 2005, botim i Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Shtëpia Botuese "Adelprint", Tiranë 2005.
- Vorpsi, Arta, "Referendumi shfuqizues dhe shqyrtimi i kërkesës nga Gjykata Kushtetuese", botuar në Revistën "E drejta parlamentare dhe politikat ligjore", botim i Qendrës së Studimeve Parlamentare, nr.31, viti 2006.

- Wagner, Britta, *“Remedies and effects of decisions in constitutional complaint procedure”*, botuar në *“The protection of fundamental rights by the constitutional court”*, Koleksioni *“Shkenca dhe teknika të demokracisë, nr.15”*, botim i Komisionit Evropian Demokraci përmes Ligjit, ribotim 1998.
- Zaganjori, Xhezair, *“Roli i partive politike në shtetin demokratik”*, botuar në Revistën *“Studime Juridike”*, nr.1 botimi Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranë, Shtëpia Botuese *“Luarasi”*, Tiranë 2001.

#### *Opinione të Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias).*

- Opinioni i datës 17 prill 1998, CDL-INF (98) 9, i Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias).
- Opinioni i Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) CDL-AD (2008) 029 *“Opinion on the draft laws amending and supplementing (1) The Law on Constitutional Proceedings and (2) the Law on the Constitutional Court of Kyrgyzstan”*.
- Opinioni CDL-AD (2009) 006 i Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), nr.489/2008, datë 13 mars 2009.
- Opinioni i Komisionit Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) CDL-AD (2012)026 *“Opinion on the compatibility of constitutional principles and the rule of law of actions taken by the government and the parliament of Romania in respect of other state institutions and on the government emergency ordinance on amendment to the law no.47/1992 regarding the organization and functioning of the Constitutional Court and on the government emergency ordinance on amending and completing the law no.2/2000 regarding the organization of a referendum of Romania”*.

## **Legjislacion**

### *Akte Kushtetuese*

- Ligj nr.7491, datë 29.4.1991 *“Për dispozitat kryesore kushtetuese”*, i ndryshuar dhe plotësuar disa herë më ligje të tjera kushtetuese.
- Ligj kushtetues nr.7561, datë 29.4.1992 *“Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”*
- Ligj kushtetues nr.8257, datë 19.11.1997 *“Për një plotësim në ligjin nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese””*
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (miratuar me ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 dhe amenduar me ligjet nr.9675, datë 13.1.2007, nr.9904, datë 21.4.2008, dhe nr.88/2012).

### *Marrëveshje ndërkombëtare*

- Ligj nr.7959, datë 11.7.1995 *“Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Statutin e Këshillit të Evropës”*.
- Ligj nr.8137, datë 31.7.1996 *“Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”*.



- Ligj nr.8322, datë 02.04.1998 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për Ekstradimin dhe të Dy Protokolleve Shtesë””.
- Ligj nr.8688 datë 09.11.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit” Nju Jork, 10 qershor 1958
- Ligj nr.9554, datë 8.6.2006, për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në fushën civile dhe tregtare”.
- Ligj nr.48/2015 “Për ratifikimin e Protokollit të 16-të të Konventës “Për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”.

#### *Akte ligjore*

- Ligj nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, i ndryshuar me ligjin nr.9260, datë 15.7.2004.
- Ligj nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligj nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligj nr.7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale”, i ndryshuar.
- Ligj nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligj nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile”, i ndryshuar.
- Ligj nr.8373, datë 15.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.
- Ligj nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.
- Ligj nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligj nr.8550, datë 18.11.1999 “Statusi i deputetit”, i ndryshuar.
- Ligj nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese së Republikës së Shqipërisë”.
- Ligj nr.8580, dt.17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar.
- Ligj nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligj nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligj nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.
- Ligj nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”.
- Ligj nr.8789, datë 7.5.2001 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”.
- Ligj nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligj nr.9110, datë 24.7.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”.
- Ligj nr.9640, datë 9.11.2006 “Për dhomat e tregtisë dhe të industrisë”, i ndryshuar.
- Ligj nr. 9743, datë 28.05.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar”.
- Ligj nr.9754, datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”.
- Ligj nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Ligj nr.10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar.
- Ligj nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligj nr. 10034, datë 22.12.2008 “Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve”.
- Ligj nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.
- Ligj nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Akti normativ me fuqinë e ligjit nr.5/2013.
- Ligj nr.161/2013 “Për miratimin e aktit normative me fuqinë e ligjit nr.5/2013, të Këshillit të Ministrave”.
- Ligj nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

#### *Akte nënligjore*

- Vendimi nr.339, datë 3.9.1997 i Kuvendit Popullor.
- Dekret nr.2260, datë 28.11.1998 i Presidentit të Republikës.
- Vendimi nr.42, datë 6.6.2002 i Kuvendit “Për përfundimet e shqyrtimit të vendimeve nr.75, datë 19.4.2002 dhe nr.76, date 25.4.2002 të Gjykatës Kushtetuese”.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.229, datë 23.4.2004 “Për miratimin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Udhëzimi nr. 2, datë 18.08.2011 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit”, i Këshilli të Ministrave.
- Dekreti i Presidentit të Republikës nr.8349, datë 14.10.2013.
- “Rregullorja e brendshme mbi gjykimin kushtetues dhe funksionimin e administratës e Gjykatës Kushtetuese”, e miratuar me vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve. Hyrë në fuqi më datën 15.6.2009.

#### *Akte të huaja*

- Ligj nr.87 i vitit 1953 “Për normat e integruara të procesit kushtetuese”. (Italia)
- Rezoluta nr. 189 e vitit 1995 e miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës.
- Vendimi i Komitetit të Ministrave nr. (95) i datës 10 korrik 1995.
- Ligj për Gjykatën Kushtetuese të Andorrës, miratuar me datë 3 shtator 1993.

### **Jurisprudencë**

#### **Vendime të Gjykatës Kushtetuese**

##### *Vendime të seancës plenare*

- Vendimi nr.1, datë 13.7.1992.
- Vendimi nr.6, datë 26.8.1992.
- Vendimi nr.8, datë 18.9.1992.
- Vendimi nr.8, datë 21.5.1993.

- Vendimi nr.13, datë 22.11.1993.
- Vendimi nr.4, datë 8.4.1994.
- Vendimi nr.8, datë 3.11.1994.
- Vendimi nr.3, datë 23.2.1995.
- Vendimi nr.4, datë 2.6.1995.
- Vendimi nr.1, datë 31.1.1996.
- Vendimi nr.46, datë 26.11.1996.
- Vendimi nr.13, datë 29.5.1997.
- Vendimi nr.16, datë 7.6.1997.
- Vendimi nr.57, datë 5.12.1997.
- Vendimi nr.16, datë 3.6.1998.
- Vendimi nr.75, datë 29.12.1998.
- Vendimi nr.77, datë 31.12.1998.
- Vendimi nr.2, datë 25.1.1999.
- Vendimi nr.40, datë 6.5.1999.
- Vendimi nr.61, datë 22.11.1999.
- Vendimi nr.65, datë 10.12.1999.
- Vendimi nr.8, datë 3.3.2000.
- Vendimi nr.12, datë 21.3.2000.
- Vendimi nr.20, datë 18.4.2000.
- Vendimi nr.33, datë 24.5.2000.
- Vendimi nr.37, datë 23.6.2000.
- Vendimi nr.38, datë 23.6.2000.
- Vendimi nr.39, datë 23.6.2000.
- Vendimi nr.49, datë 31.7.2000.
- Vendimi nr.5, datë 7.2.2001.
- Vendimi nr.28, datë 21.2.2001.
- Vendimi nr.33, datë 9.5.2001.
- Vendimi nr.43, datë 18.5.2001.
- Vendimi nr.49, datë 2.6.2001.
- Vendimi nr.95, datë 27.7.2001.
- Vendimi nr.97, datë 27.7.2001.
- Vendimi nr.106, datë 1.8.2001.
- Vendimi nr.163, datë 31.10.2001.
- Vendimi nr.178, datë 8.11.2001.
- Vendimi nr.185, datë 26.10.2001.
- Vendimi nr.205, datë 24.12.2001.
- Vendimi nr.213, datë 16.11.2001.
- Vendimi nr.6, datë 18.1.2002.
- Vendimi nr.8, datë 23.1.2002.
- Vendimi nr.18, datë 1.2.2002.
- Vendimi nr.28, datë 21.2.2002.
- Vendimi nr.37, datë 7.3.2002.
- Vendimi nr.40, datë 11.3.2002.



- Vendimi nr.75, datë 19.4.2002.
- Vendimi nr.76, datë 25.4.2002.
- Vendimi nr.135, datë 17.6.2002.
- Vendimi nr.152, datë 5.7.2002.
- Vendimi nr.171, datë 30.7.2002.
- Vendimi nr.186, datë 23.9.2002.
- Vendimi nr.212, datë 29.10.2002.
- Vendimi nr.2, datë 31.1.2003.
- Vendimi nr.3, datë 13.2.2003.
- Vendimi nr.8, datë 25.3.2003.
- Vendimi nr.9, datë 2.4.2003.
- Vendimi nr.18, datë 14.5.2003.
- Vendimi nr.32, datë 24.11.2003.
- Vendimi nr.34, datë 8.12.2003.
- Vendimi nr.2, datë 3.2.2004.
- Vendimi nr.3, datë 11.2.2004.
- Vendimi nr.5, datë 11.3.2004.
- Vendimi nr.7, datë 1.4.2004.
- Vendimi nr.13, datë 12.7.2004.
- Vendimi nr.16, datë 11.11.2004.
- Vendimi nr.1, datë 7.1.2005.
- Vendimi nr.2, datë 18.1.2005.
- Vendimi nr.7, datë 27.4.2005.
- Vendimi nr.9, datë 9.5.2005.
- Vendimi nr.17, datë 18.7.2005.
- Vendimi nr.34, datë 20.12.2005.
- Vendimi nr.37, datë 29.12.2005.
- Vendimi nr.39, datë 29.12.2005.
- Vendimi nr.41, datë 29.12.2005.
- Vendimi nr.1, datë 16.1.2006.
- Vendimi nr.2, datë 16.2.2006.
- Vendimi nr.4, datë 28.2.2006.
- Vendimi nr.6, datë 31.3.2006.
- Vendimi nr.15, datë 25.5.2006.
- Vendimi nr.14, datë 22.5.2006.
- Vendimi nr.18, datë 23.6.2006.
- Vendimi nr.20, datë 11.7.2006.
- Vendimi nr.22, datë 26.7.2006.
- Vendimi nr.26, datë 4.12.2006.
- Vendimi nr.29, datë 21.12.2006.
- Vendimi nr.30, datë 28.12.2006.
- Vendimin nr.9 datë 26.2.2007.
- Vendimi nr.19, datë 3.5.2007.
- Vendimi nr.20, datë 4.5.2007.

- Vendimi nr.26, datë 13.6.2007.
- Vendimi nr.40, datë 16.11.2007.
- Vendimi nr.44, datë 26.12.2007.
- Vendimi nr.6, datë 5.3.2008.
- Vendimi nr.9, datë 19.3.2008.
- Vendimi nr.12, datë 20.5.2008.
- Vendimi nr.14, datë 21.7.2008.
- Vendimi nr.16, datë 25.7.2008.
- Vendimi nr.17, datë 25.7.2008.
- Vendimi nr.18, datë 29.7.2008.
- Vendimi nr.19, datë 18.9.2008.
- Vendimi nr.21, datë 1.10.2008.
- Vendimi nr.22, datë 7.10.2008.
- Vendimi nr.24, datë 12.11.2008.
- Vendimi nr.25, datë 5.12.2008.
- Vendimi nr.27, datë 15.12.2008.
- Vendimi nr.5, datë 6.3.2009.
- Vendimi nr.8, datë 12.3.2009.
- Vendimi nr.11, datë 23.4.2009.
- Vendimi nr.12, datë 28.4.2009.
- Vendimi nr.13, datë 4.5.2009.
- Vendimi nr.14, datë 3.6.2009.
- Vendimi nr.15, datë 8.6.2009.
- Vendimi nr.16, datë 24.2.2009.
- Vendimi nr.19, datë 9.7.2009.
- Vendim nr. 20, datë 29.9.2009.
- Vendimi nr.23, datë 23.7.2009.
- Vendimi nr.25, datë 24.7.2009.
- Vendimi nr.27, datë 27.7.2009.
- Vendimi nr.29, datë 21.10.2009.
- Vendimi nr.31, datë 2.12.2009.
- Vendimi nr.1, datë 25.1.2010.
- Vendimi nr.2, datë 3.2.2010.
- Vendimi nr.3, datë 5.2.2010.
- Vendimi nr.4, datë 12.2.2010.
- Vendimi nr.5, datë 2.3.2010.
- Vendimi nr.8, datë 23.3.2010.
- Vendimi nr.9, datë 23.3.2010.
- Vendimi nr.11, datë 6.4.2010.
- Vendimi nr.12, datë 14.4.2010.
- Vendimi nr.15, datë 15.4.2010.
- Vendimi nr.17, datë 23.4.2010.
- Vendimi nr.18, datë 23.4.2010.
- Vendimi nr.21, datë 29.4.2010.

- Vendimi nr.22, datë 5.5.2010.
- Vendimi nr.27, datë 26.5.2010.
- Vendimi nr.29, datë 31.5.2010.
- Vendimi nr.30, datë 17.6.2010.
- Vendimi nr.31, datë 18.6.2010.
- Vendimi nr.32, datë 21.6.2010.
- Vendimi nr.33, datë 24.6.2010.
- Vendimi nr.34, datë 8.10.2010.
- Vendimi nr.1, datë 12.1.2011.
- Vendimi nr.4, datë 23.2.2011.
- Vendimi nr.7, datë 7.3.2011.
- Vendimi nr.12, datë 15.4.2011.
- Vendimi nr.15, datë 3.5.2011.
- Vendimi nr.17, datë 16.5.2011.
- Vendimi nr.19, datë 1.6.2011.
- Vendimi nr.20, datë 1.6.2011.
- Vendimi nr.24, datë 9.6.2011.
- Vendimi nr.25, datë 10.6.2011.
- Vendimi nr.28, datë 23.6.2011.
- Vendimi nr.29, datë 30.6.2011.
- Vendimi nr.35, datë 25.7.2011.
- Vendimi nr.38, datë 20.9.2011.
- Vendimi nr.43, datë 6.10.2011.
- Vendimi nr.44, datë 7.10.2011.
- Vendimi nr.48, datë 8.11.2011.
- Vendimi nr.52, datë 1.12.2011.
- Vendimi nr.3, datë 3.2.2012.
- Vendimi nr.5, datë 16.2.2012.
- Vendimi nr.12 datë 5.3.2012.
- Vendimi nr.19 datë 2.4.2012.
- Vendimi nr.21 datë 16.4.2012.
- Vendimi nr.23, datë 23.4.2012.
- Vendimi nr.25, datë 8.5.2012.
- Vendimi nr.26, datë 8.5.2012.
- Vendimi nr.27, datë 9.5.2012.
- Vendimi nr.28, datë 9.5.2012.
- Vendimi nr.33, datë 24.5.2012.
- Vendimi nr.38, datë 5.7.2012.
- Vendimi nr.41, datë 19.7.2012.
- Vendimi nr.42, datë 19.7.2012.
- Vendimi nr.45, datë 23.7.2012.
- Vendimi nr.47, datë 26.2.2012.
- Vendimi nr.48, datë 26.7.2012.
- Vendimi nr.52, datë 5.12.2012.



- Vendimi nr.58 datë 24.12.2012.
- Vendimi nr.60, datë 28.12.2012.
- Vendimi nr.6, datë 26.2.2013.
- Vendimi nr.7, datë 27.2.2013.
- Vendimi nr.8, datë 8.3.2013.
- Vendimi nr.9, datë 15.3.2013.
- Vendimi nr.10, datë 18.3.2013.
- Vendimi nr.11, datë 5.4.2013.
- Vendimi nr.12, datë 16.4.2013.
- Vendimi nr.13, datë 27.2.2013.
- Vendimi nr.14, datë 17.4.2013.
- Vendimi nr.16, datë 19.4.2013.
- Vendimi nr.19, datë 25.4.2013.
- Vendimi nr.24, datë 29.5.2013.
- Vendimi nr.27, datë 24.6.2013.
- Vendimi nr.29, datë 27.6.2013.
- Vendimi nr.31, datë 10.7.2013.
- Vendimi nr.32, datë 10.7.2013.
- Vendimi nr.36 datë 25.7.2013.
- Vendimi nr.37, datë 25.7.2013.
- Vendimi nr.39, datë 26.7.2013.
- Vendimi nr.54, datë 23.12.2013.
- Vendimi nr.3, datë 23.1.2014.
- Vendimi nr.5, datë 5.2.2014.
- Vendimi nr.10, datë 6.3.2014.
- Vendimi nr.14, datë 21.3.2014.
- Vendimi nr.20, datë 4.4.2014.
- Vendimi nr.28, datë 15.5.2014.
- Vendimi nr.30, datë 16.5.2014.
- Vendimi nr.33, datë 9.6.2014.
- Vendimi nr.37, datë 30.6.2014.
- Vendimi nr.38, datë 30.6.2014.
- Vendimi nr.42 datë 7.7.2014.
- Vendimi nr.45, datë 25.7.2014.
- Vendimi nr.46, datë 30.7.2014.
- Vendimi nr.47, datë 30.7.2014.
- Vendimi nr.53, datë 1.12.2014.
- Vendimi nr.54, datë 5.12.2014.
- Vendimi nr.55, datë 5.12.2014.
- Vendimi nr.56, datë 5.12.2014.
- Vendimi nr.57, datë 5.12.2014.
- Vendimi nr.59, datë 23.12.2014.
- Vendimi nr.19, datë 15.4.2015.
- Vendimi nr.38, datë 12.6.2015.

- Vendimi nr.43, datë 26.6.2015.
- Vendimi nr.50, datë 10.7.2015.

*Vendime të Mbledhjes së Gjyqtarëve*

- Vendimi nr.14, datë 19.2.2009.
- Vendimi nr.15, datë 19.2.2009.
- Vendimi nr.27, datë 25.3.2009.
- Vendimi nr.22, datë 9.3.2010.
- Vendimi nr.105, datë 24.12.2010.
- Vendimi nr.34, datë 8.4.2011.
- Vendimi nr.112, datë 13.10.2011.
- Vendimi nr.113, datë 13.10.2011.
- Vendimi nr.142, datë 1.12.2011.
- Vendimi nr.152, datë 21.12.2011.
- Vendimi nr.14, datë 31.1.2012.
- Vendimi nr.35, datë 13.3.2012.
- Vendimi nr.40, datë 28.3.2012.
- Vendimi nr.50, datë 20.4.2012.
- Vendimi nr.52, datë 20.4.2012.
- Vendimi nr.60, datë 16.5.2012.
- Vendimi nr.61, datë 16.5.2012.
- Vendimi nr.80, datë 3.7.2012.
- Vendimi nr.92, datë 19.7.2012.
- Vendimi nr.138, datë 14.12.2012.
- Vendimi nr.36, datë 7.3.2013.
- Vendimi nr.37 datë 7.3.2013.
- Vendimi nr.53, datë 7.5.2013.
- Vendimi nr.63, datë 29.5.2013.

*Vendime të Kolegjit*

- Vendimi nr.12, datë 13.2.2009.
- Vendimi nr.20, datë 6.3.2009.
- Vendimi nr.22, datë 12.3.2009.
- Vendimi nr.28, datë 26.3.2009.
- Vendimi nr.36, datë 3.4.2009.
- Vendimi nr.41, datë 15.5.2009.
- Vendimi nr.42, datë 19.5.2009.
- Vendimi nr.43, datë 19.5.2009.
- Vendimi nr.49, datë 1.6.2009.
- Vendimi nr.52, datë 15.6.2009.
- Vendimi nr.60, datë 3.7.2009.
- Vendimi nr.67, datë 15.7.2009.

- Vendimi nr.73, datë 18.9.2009.
- Vendimi nr.74, datë 18.9.2009.
- Vendimi nr.84, datë 9.10.2009.
- Vendimi nr.85, datë 9.10.2009.
- Vendimi nr.89, datë 16.10.2009.
- Vendimi nr.90, datë 16.10.2009.
- Vendimi nr.95, datë 6.11.2009.
- Vendimi nr.97, datë 13.11.2009.
- Vendimi nr.98, datë 13.11.2009.
- Vendimi nr.103, datë 20.11.2009.
- Vendimi nr.13, datë 22.2.2010.
- Vendimi nr.17, datë 3.3.2010.
- Vendimi nr.18, datë 5.3.2010.
- Vendimi nr.24, datë 9.3.2010.
- Vendimi nr.25 datë 16.3.2010.
- Vendimi nr.31, datë 23.4.2010.
- Vendimi nr.36, datë 23.4.2010.
- Vendimi nr.40, datë 11.6.2010.
- Vendimi nr.42, datë 23.6.2010.
- Vendimi nr.45 datë, 2.7.2010.
- Vendimi nr.46, datë 2.7.2010.
- Vendimi nr.47, datë 2.7.2010.
- Vendimi nr.51, datë 9.7.2010.
- Vendimi nr.65, datë 1.10.2010.
- Vendimi nr.67, datë 11.10.2010.
- Vendimi nr.69, datë 11.10.2010.
- Vendimi nr.72, datë 22.10.2010.
- Vendimi nr.75, datë 22.10.2010.
- Vendimi nr.80, datë 28.10.2010.
- Vendimi nr.90, datë 17.12.2010.
- Vendimi nr.91, datë 10.12.2010.
- Vendimi nr.94, datë 10.12.2010.
- Vendimi nr.96, datë 17.12.2010.
- Vendimi nr.99, datë 20.12.2010.
- Vendimi nr.100, datë 20.10.2010.
- Vendimi nr.101, datë 24.12.2010.
- Vendimi nr.104, datë 24.12.2010.
- Vendimi nr.20, datë 10.3.2011.
- Vendimi nr.24, datë 11.3.2011.
- Vendimi nr.26, datë 17.3.2011.
- Vendimi nr.31, datë 25.3.2011.
- Vendimi nr.33, datë 1.4.2011.
- Vendimi nr.42, datë 22.4.2011.
- Vendimi nr.45, datë 28.4.2011.



- Vendimi nr.57, datë 3.6.2011.
- Vendimi nr.58 datë, 3.6.2011.
- Vendimi nr.69, datë 1.7.2011.
- Vendimi nr.74, datë 14.7.2011.
- Vendimi nr.75, datë 14.7.2011.
- Vendimi nr.78, datë 18.7.2011.
- Vendimi nr.79, datë 18.7.2011.
- Vendimi nr.80, datë 20.7.2011.
- Vendimi nr.82, datë 20.7.2011.
- Vendimi nr.88, datë 22.7.2011.
- Vendimi nr.90, datë 22.7.2011.
- Vendimi nr.94, datë 16.9.2011.
- Vendimi nr.96, datë 16.9.2011.
- Vendimi nr.101, datë 22.9.2011.
- Vendimi nr.102, datë 22.9.2011.
- Vendimi nr.107 datë, 26.9.2011.
- Vendimi nr.114 datë 26.10.2011.
- Vendimi nr.115, datë 26.10.2011.
- Vendimi nr.120, datë 27.10.2011.
- Vendimi nr.123, datë 4.11.2011.
- Vendimi nr.135 datë 25.11.2011.
- Vendimi nr.139, datë 25.11.2011.
- Vendimi nr.141, datë 25.11.2011.
- Vendimi nr.145, datë 16.12.2011.
- Vendimi nr.146, datë 19.12.2011.
- Vendimi nr.147, datë 19.12.2011.
- Vendimi nr.148, datë 19.12.2011.
- Vendimi nr.3 datë 13.1.2012.
- Vendimi nr.10, datë 23.1.2012.
- Vendimi nr.11, datë 23.1.2012.
- Vendimi nr.23, datë 24.2.2012.
- Vendimi nr.25, datë 1.3.2012.
- Vendimi nr.29, datë 1.3.2012.
- Vendimi nr.30, datë 2.3.2012.
- Vendimi nr.31, datë 5.3.2012.
- Vendimi nr.53, datë 20.4.2012.
- Vendimi nr.68, datë 18.5.2012.
- Vendimi nr.69, datë 1.6.2012.
- Vendimi nr.72, datë 15.6.2012.
- Vendimi nr.74, datë 15.6.2012.
- Vendimi nr.76, datë 15.6.2012.
- Vendimi nr.77, datë 15.6.2012.
- Vendimi nr.84, datë 12.7.2012.
- Vendimi nr.88, datë 13.7.2012.

- Vendimi nr.89, datë 13.7.2012.
- Vendimi nr.94, datë 14.9.2012.
- Vendimi nr.99, datë 25.9.2012.
- Vendimi nr.101, datë 25.9.2012.
- Vendimi nr.103, datë 25.9.2012.
- Vendimi nr.112 datë 8.10.2012.
- Vendimi nr.118, datë 30.10.2012.
- Vendimi nr.127, datë 4.12.2012.
- Vendimi nr.140 datë 19.12.2012.
- Vendimi nr.143, datë 19.12.2012.
- Vendimi nr.1, datë 15.6.2013.
- Vendimi nr.5, datë 18.1.2013.
- Vendimi nr.6 datë 18.1.2013.
- Vendimi nr.7 datë 21.1.2013.
- Vendimi nr.12, datë 25.1.2013.
- Vendimi nr.15 datë 5.2.2013.
- Vendimi nr.23, datë 8.2.2013.
- Vendimi nr.24 datë 8.2.2013.
- Vendimi nr.27, datë 20.2.2013.
- Vendimi nr.30, datë 22.2.2013.
- Vendimi nr.32, datë 26.2.2013.
- Vendimi nr.33, datë 4.3.2013.
- Vendimi nr.50, datë 15.4.2013.
- Vendimi nr.57, datë 17.5.2013.
- Vendimi nr.60, datë 17.5.2013.
- Vendimi nr.61, datë 17.5.2013.
- Vendimi nr.74, datë 7.6.2013.
- Vendimi nr.76 datë 28.6.2013.
- Vendimi nr.79 datë 4.7.2013.
- Vendimi nr.80, datë 4.7.2013.
- Vendimi nr.83, datë 5.7.2013.
- Vendimi nr.86, datë 12.7.2013.
- Vendimi nr.87, datë 12.7.2013.

### **Vendime të Gjykatës së Lartë**

#### *Vendime të Kolegjeve të Bashkuara*

- Vendimi nr.371, datë 27.10.2000.
- Vendimi unifikues, nr.3, datë 24.1.2007.
- Vendimi unifikues nr.3, datë 29.3.2012.

#### *Vendimi të Kolegjit Administrativ*

- Vendimi nr.00-2014-1797, datë 03.06.2014.

#### *Vendime të Kolegjit Civil*

- Vendimi nr.1138, datë 19.6.2003.
- Vendimi nr.1275, datë 3.7.2003.
- Vendimi nr.484, datë 25.4.2006.
- Vendimi nr.00-2007-1470 (1181), datë 18.10.2007.
- Vendimi nr.00-2008-585 (179), date 11.03.2008.
- Vendimi nr.00-2009-500 (34), datë 19.02.2009
- Vendimi nr.00-2008-481 (160), date 28.4.2009.
- Vendimi nr.00-2010-193 (52), datë 2.2.2010.
- Vendimi nr.00-2010-1158 (360), datë 30.9.2010.
- Vendimi nr. 00-2010-1351 (436), datë 2.12.2010
- Vendimi nr.00-2010-1414 (445), datë 7.12.2010.
- Vendimi nr.00-2011-2308 (572), datë 15.12.2011.

#### *Vendime të Kolegjit Penal*

- Vendimi nr.1042, datë 9.7.2010.
- Vendimi nr. 00-2010-1362 (812), datë 17.9.2010.

#### **Vendime të Gjykatave (juridiksioneve) Kushtetuese të huaja**

##### *Andorra*

- Vendimi nr.94-1-CC, datë 16.12.1994.

##### *Austria*

- Vendimi i datës 10.03.2001.
- Vendimi nr. G 103/00, datë 28.06.2001.

##### *Belgjika*

- Vendimi nr. 16/94, datë 9.2.1994.
- Vendimi nr. 90/94, datë 22.12.1994.

##### *Bosnje – Hercegovina*

- Vendimi nr.U-5/04, datë 31.3.2006.
- Vendimi nr.U17/07, datë 4.10.2008.

##### *Çekia*

- Vendimi nr. Pl. US 33/00, datë 10.1.2001.
- Vendimi nr. US 265/07, datë 6.6.2007 i Dhomës së Dytë.

#### *Franca*

- Vendimi nr. 2003-469 DC, datë 26.3.2003.

#### *Gjermania*

- Vendimi BVerfGE 1, 14, datë 23.10.1951 i Senatit të Dytë.
- Vendimi nr. 2 BvE 1/88, datë 13.6.1989 i Senatit të Dytë.
- Vendimi nr. 2 BvR 1938/93, 2 BvR 2315/93, datë 14.05.1996 i Senatit të Dytë.
- Vendimi 2 BvR 2728/13, 2 BvR 2728/13, 2 BvR 2729/13, 2 BvR 2730/13, 2 BvR, 2731/13, datë 14 janar 2014, i Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë.

#### *Hungaria*

- Vendimi nr. 1260/B/1997, datë 9.2.1998.

#### *Italia*

- Vendimi nr.13 të vitit 1960.
- Vendimi nr.140 i vitit 1970.
- Vendimi nr.399, i vitit 1987.
- Vendimi nr.1146 i vitit 1988.
- Vendimi nr. 330, datë 18-29 korrik 1996.
- Vendimi nr.71 i vitit 2001.
- Vendimi nr.376, datë 22 – 28 nëntor 2001.
- Vendimi nr.455 i vitit 2002.
- Urdhëresa nr.343, datë 13-25 nëntor 2003.
- Vendimi nr.24 i vitit 2004
- Vendimi nr.25 i vitit 2004.
- Urdhëresa nr.79 e vitit 2006.
- Urdhëresa nr.103 të vitit 2008.
- Vendimi nr.334, i vitit 2008.

#### *Kosova*

- Aktgjykimi në rastet K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12, datë 20.7.2012.
- Aktgjykimi në rastin KO 95/13, datë 9.9.2013.
- Sqarim i Aktgjykimit në rastin KO 29/11, datë 1.4.2011.

#### *Kroacia*

- Vendimi nr. U-II-603/2001, datë 28.03.2001.



- Vendimi nr.U-I/1583/2000, datë 24 mars 2010.

#### *Moldavia*

- Vendimi nr. 2/1998, datë 19.1.1998.

#### *Polonia*

- Vendimi nr.K 18/04, datë 11.5.2005.
- Vendimi nr.SK45/09, nëntor 2011.

#### *Rumania*

- Vendimi nr. 972/2012, datë 21.12.2012.

#### *Slovenia*

- Vendimi nr. U-I-332/94, datë 11.4.1996.

#### *Spanja*

- Vendimi nr.STC 50/84 i vitit 1984.
- Vendimi nr.62, datë 5.5.2011.

#### *Turqia*

- Vendimi nr. K.2000/50, datë 12.12.2000.
- Vendimi nr. E.2008/16, K.2008/116, datë 5.6.2008.

#### *Ukraina*

- Vendimi nr. 13-rp/2008, datë 25.6.2008.

#### **Vendime të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.**

- GJEDNJ, çështja “Buchholz kundër Gjermanisë”, datë 6 maj 1981.
- GJEDNJ, çështja “Bock kundër Gjermanisë”, datë 29 mars 1989.
- GJEDNJ, çështja “Gast dhe Popp kundër Gjermanisë”, aplikimi nr.29357/95, datë 25 shkurt 2000. GJEDNJ, çështja “Klein kundër Gjermanisë”, aplikimi nr.33379/96, datë 27 korrik 2000.
- GJEDNJ, vendimi i Dhomës së Madhe, çështja “Ruiz-Mateos kundër Spanjës”, datë 23 qershor 1993, aplikimi nr. 12952/87
- GJEDNJ, çështja “Krčmář kundër Çekisë”, aplikimi nr. 35376/97, datë 3 mars 2000.
- GJEDNJ, çështja “Pammel kundër Gjermanisë”, datë 1 korrik 1997.
- GJEDNJ, çështja “Pierre-Bloch kundër Francës”, datë 21 tetor 1997.

- GJEDNJ, çështja “Süssmann kundër Gjermanisë, datë 16 shtator 1996.
- GJEDNJ, Vendimi i Dhomës së Madhe, çështja “Refah partisi kundër Turqisë”, aplikimet nr. 41340/98, 41342/98, 41343/98 dhe 41344/98, datë 13 shkurt 2003.
- GJEDNJ, vendimi i Dhomës së Tretë, aplikimi nr.54268/00, çështja “Qufaj Co. sh.p.k. kundër Shqipërisë”, datë 18 nëntor 2004.
- GJEDNJ, Vendimi i Seksionit të katërt, datë 23 tetor 2007, çështja “Gjonboçari dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, aplikimi nr.10508/02.
- GJEDNJ, vendimi i Dhomës së Katërt, aplikimi nr. 3738/02, çështja “Marini kundër Shqipërisë”, datë 18.12.2007.
- GJEDNJ, vendimi i Dhomës së Katërt, ankimi nr. 18381/05, çështja “Mishgioni kundër Shqipërisë”, datë 07.12.2010.
- GJEDNJ, vendimi i Dhomës së Katërt, aplikimi nr.26866/05, çështja “Shkalla kundër Shqipërisë”, datë 10.5.2011.

### **Vendime të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë**

- Vendimi i GJED, C 6/64, datë 15.7.1964, çështja “Costa v. Enel”.
- Vendimi i GJED, C 106/77, datë 9.3.1978, çështja “Simmenthal”

### **Faqje Interneti**

- [www.blhr.org/media/documents/Applicability\\_of\\_Article\\_6.doc](http://www.blhr.org/media/documents/Applicability_of_Article_6.doc),
- [www.interights.org/files/.../INTERIGHTS%20Article%206%20Manual.pdf](http://www.interights.org/files/.../INTERIGHTS%20Article%206%20Manual.pdf)
- [http://www.punetejashtme.gov.al/files/userfiles/Marreveshjet\\_Dypaleshe\\_me\\_te\\_gjitha\\_vendet.pdf](http://www.punetejashtme.gov.al/files/userfiles/Marreveshjet_Dypaleshe_me_te_gjitha_vendet.pdf)
- [www.bundesverfassungsgericht.de](http://www.bundesverfassungsgericht.de)
- [hudoc.echr.coe.int](http://hudoc.echr.coe.int)
- [www.venice.coe.int](http://www.venice.coe.int)
- [www.cortecostituzionale.it](http://www.cortecostituzionale.it)
- [www.gjk.gov.al](http://www.gjk.gov.al)
- [www.germanlawjournal.com](http://www.germanlawjournal.com)
- [digitalcommons.lmu.edu](http://digitalcommons.lmu.edu)
- [http://www.echr.coe.int/Documents/Protocol\\_16\\_explanatory\\_report\\_ENG.pdf](http://www.echr.coe.int/Documents/Protocol_16_explanatory_report_ENG.pdf)
- [conventions.coe.int/Treaty/Commun/ListeDeclarations.asp?NT=214&CM=8&DF=01/08/2014&CL=ENG&VL=1](http://conventions.coe.int/Treaty/Commun/ListeDeclarations.asp?NT=214&CM=8&DF=01/08/2014&CL=ENG&VL=1)
- [www.interights.org/files/.../INTERIGHTS%20Article%206%20Manual.pdf](http://www.interights.org/files/.../INTERIGHTS%20Article%206%20Manual.pdf).
- [www.codices.coe.int](http://www.codices.coe.int)